



INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE
COMMERCIAL AND COMPETITION LAW
(IIPCCL)

IIPCCL PUBLISHING, Graz-Austria

Balkan Journal of Interdisciplinary Research

ISSN 2410-759X (print)
ISSN 2411-9725 (online)

Vol 3, No. 1 - May 2017

Graz, Austria 2017

Editor in Chief
PhD (Uni Graz) Endri Papajorgji

Editing
Dr. Gerti Dajçi

Scientific Cordinator
Prof. Dr. Horst-Dieter Westerhoff

Editorial Assistant
Ines Todhe

Graphic Design
Bardhok Zefi

**Copyright © 2015 IIPCCL – International Institute for Private, Commercial and
Competition Law**

ISSN 2410-759X (print)
ISSN 2411-9725 (online)

Vol 3, No. 1 - May 2017



**This work is licensed under a CC License of
Attribution-Noncommercial-NoDerivatives 4.0 International (CC BY-NC-ND 4.0).
Based on a work at iipcl.org.**

PUBLISHER

© IIPCCL- International Institute for Private, Commercial and Competition Law

**Schönbrunnngasse 12,
8043 Graz, Austria**

Email: bjir.journal@gmail.com, research@iipcl.org

Web: <http://www.iipcl.org/>

**This Journal is printed for IIPCCL
by Drimm Publishing House
Vienna, Austria**

Balkan Journal of Interdisciplinary Research

Vol 3, No. 1 - May 2017

ISSN 2410-759X (print)
ISSN 2411-9725 (online)

About the Journal

Balkan Journal of Interdisciplinary Research is an international peer-reviewed journal published three times a year by International Institute for Private, Commercial and Competition Law. The need for different approaches in science, such as in business, economics, law, social sciences and other fields is a must in the whole field of scientific research. Academics, Professors, Researchers, Students and the whole world is in a new era of communication, which causes fast changes and gives birth to scientific and cultural debates. Our Journal is interested in promoting the exchange of idea, and to bring together researchers and academics from all over the countries. In this sense, we welcome papers not only in the above cited fields, but also in other fields of scientific research. Welcome to **BJIR**, which is open for the academic world, universities, research institutions, PhD students, academic and non-academic researchers. Aiming at scientific excellence and quality, this journal will promote the best inputs in scientific and academic research, on the prospective of local, international, global developments in business, economics, law, social-, but also natural sciences. All manuscripts will be double blind peer reviewed by the members of the editorial board who are noted experts in the appropriate subject area.

Editor in Chief, Prof. assoc. Dr. PhD (Uni Graz) Endri Papajorgji

Balkan Journal of Interdisciplinary Research

Editor in Chief, Prof.assoc. Dr. PhD (Uni Graz) Endri Papajorgji

International Editorial Board

Prof. Dr. Jürgen Wolfbauer
Montanuniversitaet Leoben (Austria)

Prof. Dr. Rajmonda Duka
University of Tirana (Albania)

Prof. Dr. Horst-Dieter Westerhoff
Universität Duisburg-Essen (Germany)

Dr. Afërdita Berisha-Shaqiri
University of Pristina (Kosovo)

Dr. Mladen Andrić
Croatian Diplomatic Academy (Croatia)

Prof. Ass. Dr. Naim Baftiu
University of Prizren (Kosovo)

Prof. Dr. Iraj Hashi
Staffordshire University (UK)

Prof. Dr. Nabil Ayad
University of East Anglia, London (UK)

Dr. Eda Bezhani
University of Durres (Albania)

Prof. Ass. Dr. Arseno Gjipali
University of Tirana (Albania)

Prof. Dr. Bektash Mema
University of Gjirokastra (Albania)

Prof. Dr. Ilia Kristo
University of Tirana (Albania)

Prof. Dr. Azem Hajdari
University of Pristina (Kosovo)

Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti
University of SEEU (Macedonia)

Prof. Dr. Joseph Mifsud
University of East Anglia, London (UK)

Prof. Dr. Lindita Milo-Lati
University of Tirana (Albania)

Dr. Hans-Achim Roll
Rechtsanwalt (Germany)

Prof. Ass. Dr. Evis Kushi
University of Elbasan (Albania)

Prof. Dr. Mimoza Karagozi (Kore)
University of Tirana (Albania)

Prof. Em. Heinz Dieter Wenzel
University of Bamberg (Germany)

PhD (Argosy University) Gerti Dajçi
Tirana Business University (Albania)

Dr. Sasha Dukoski
University of Bitola (Macedonia)

TABLE OF CONTENTS

Roli strategik i NVM-ve në ekonominë rajonale	9
<i>Mimoza Luta</i>	
Current challenges faced by the EU	15
<i>Gledina Mecka</i>	
Konflikti sovjetiko –shqiptar mbi pronësinë e anijeve luftarake të Bazës Detare të Pashalimanit (maj 1961)	21
<i>Etleva Smaçi</i>	
Vlerësimi i performancës në sektorin bankar	32
<i>Fatbardha Morina</i>	
Disa vërejtje në përkthimin e veprës së Oscar Wilde “Portreti i Dorian Greit” ...	44
<i>Nikoleta Kalldrëmshiu</i>	
Prurje të Kadaresë në standardin e shqipes në fushën e fjalëformimit	49
<i>Gladiola Durmishi Elezi</i>	
Shqipja për fëmijë pjesë e qytetarisë europiane dhe integritit social.....	58
<i>Nikoleta Kalldrëmshiu</i>	
Trajtimi i Kushtit Penal s’i një ndër mjetet e sigurimit të ekzekutimit të detyrimeve që njihen në legjislacionin e sotëm shqiptar.....	64
<i>Neritan Cena</i>	
Dy specie të reja në listën e peshqëve të shqipërisë	70
<i>Gegë Ndoka</i>	
Optimizimi i rrjetit turistik Rasti i qytetit të Durrësit	88
<i>Besjana Tosuni</i>	
Aktiviteti fizik kunder te gjitha formave te plakjes	101
<i>Gjulio Zefi</i>	
Ndihma juridike në procesin penal ne Republiken e Kosoves.....	107
<i>Taulant Bajrami</i>	
Depresioni dhe Ankthi tek adoleshentët si dhe ndërlidhja e tyre me suksesin në shkollë.....	116
<i>Kaltrina Skoro Murtezaj Blerina Vehbiu</i>	

Të Ardhurat Vendore dhe Autonomia Fiskale Rasti i Shqipërisë.....	128
<i>Fatlum Nurja</i>	
Links in the Value Chain, Cooperation and the Impact of Government Subsidies in Medicinal and Aromatic Plants Sector.....	139
<i>Merita Gecaj</i>	
Feminine motifs through times and different places.....	146
<i>Emine Shkodra</i>	
Muzika pianistike pas viteve 90'	152
<i>Ana Kaçinari</i>	
Politika si normativitet: Një qasje vlerore ndaj qeverisjes.....	157
<i>Julian Myftari</i>	
Matja e ndikimit te decentralizimit fiskal ne zhvillimin ekonomik vendor Rasti i njësive vendore te Qarkut Lezhë.....	163
<i>Fatlum Nurja</i>	
Human Resources Management in Private and Public Sector in Albania	179
<i>Vebina Resuli</i>	
Tipare të arkitekturës së kishave të Vithkuqit në Shekujt 17, 18.....	191
<i>Rozela Dhimgjini</i>	
Edukata dhe arsimi në Dibër nga lashtësia deri në periudhën e parë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.....	197
<i>Fatjon Kica</i>	
Emigracioni në Shqipëri dhe ngjarjet e ambasadave në fillim të viteve '90	204
<i>Brunilda Duriçi</i>	
Bulqiza's environment and economy focused on the climate change.....	211
<i>Aishe Begu Balla</i>	
Perceptual differences between students and teachers witnessing school bullying.....	216
<i>Dorina Batalli</i>	
Evoluimi i së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare parë në aspektin e të drejtave të gruas deri në vitin 1946.....	229
<i>Lorena Musai Enkeleda Millonai</i>	

Mësimi i diferencuar në shkallë të ndryshme të vështirësisë, në shkollat fillore në Kosovë.....	237
<i>Behxhet Gaxhiqi</i>	
Dhuna ndaj gruas në këndvështrimin e legjislacionit vendas dhe atë ndërkombëtar	246
<i>Lorena Musai</i> <i>Enkeleida Millonai</i>	
Programet e individualizuara të trajtimit të të dënuarve.....	257
<i>Edlira Jahiu (Ylli)</i>	
Mbi lirinë dhe barazinë : J. Rowls	267
<i>Suela Ibrahimllari</i>	
Ndërtimi i institucioneve shëndetësore-farmaceutike që nga periudha e pasluftës në Kosovë.....	275
<i>Arbenita Pajaziti</i> <i>Melisa Troshani</i>	
Legal basis for granting a marketing authorization for drugs in Kosovo	283
<i>Melisa Troshani</i> <i>Arbenita Pajaziti</i>	
Peisazhi shqiptar i gjysmës së dytë të shekullit të XIX-të	290
<i>Agron Mesi</i>	
Hartimi dhe ndryshimi i bazës ligjore në sektorin farmaceutik në Kosovë që nga periudha e pasluftës.....	303
<i>Arbenita Pajaziti</i> <i>Melisa Troshani</i>	
Stresi në punë dhe burnouti tek mësuesit në shkollat 9-vjeçare	309
<i>Iris Mitro</i> <i>Ergyseyda Bylyshi (Caushi)</i>	
Përdorimi i burimeve të jashtme të kreditimit nga NVM në Shqipëri – Analizë e Anketës SAFE.....	317
<i>Eugen Musta</i>	
Shkathtësitë e menaxhimit të drejtorit të shkollës ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.....	330
<i>Venera Këndusi</i>	

How are online violence programs affecting the transformation of adolescent behavior towards the others?	335
<i>Brikena Kullolli</i>	
Migration and remittances - their impact on social and economic developments in Albania	339
<i>Juventina Ngjela</i>	
Koncepti mbi strategjitë e të kuptuarit në kurrikulën e gjuhës shqipe të klasës së tretë	347
<i>Majlinda Lika</i>	
Reflections about the concept of being in the world and the coexistence with the other.....	356
<i>Jetmira Fekolli</i>	
Leximi i lektyrës shkollore dhe roli i saj në formimin e përgjithshëm të nxënësve	363
<i>Myrvete Dreshaj-Baliu</i>	
Fenomeno del phishing, la possibilita della configurabilita del delitto di truffa nel phishing	373
<i>Arta Hasa (Jakupi)</i>	
Developing students' writing skill through peer feedback	385
<i>Osman Osmani</i> <i>Fikret Pajaziti</i> <i>Laodim Terziu</i>	
Planifikimi menaxherial dhe efekti në performancën e bizneseve në Kosovë.....	395
<i>Venet Shala</i> <i>Labinot Hashani</i>	
A comparative study of provision of primary schools and teachers supply between rural and urban local government areas in Bayelsa State, Nigeria.....	404
<i>Japo O. M. Amasuomo</i> <i>Chukwuma N. Ozurumba</i>	
Bashkëpunimi kulturo-arsimor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në vitet 1970-1971.....	423
<i>Kosovar Basha</i>	

Roli strategik i NVM-ve në ekonominë rajonale

Msc. Mimoza Luta

Abstrakt

Qëndrimi ndaj ekonomisë rajonale duhet të jetë përherë i drejt dhe i sinqertë. Objektivi i Komunes është hapja e mikrobizneseve dhe favorizimi i ekonomisë së lirë të tregut, avancimi i NVM-ve kryesisht i ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese, zhvillimi i turizmit, privatizimi, rivitalizimi dhe punësimi i të rinjve, krijimi i infrastrukturës juridike, krijimi i kushteve dhe inkurajimi për thithjen e investimeve nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm, diaspora, mjetet e BE, FMN, Bankës Botërore etj. Po ashtu, prioritet është caktimi i Zonës Industriale, Inkubatorëve dhe Parqeve për biznese, organizimin në Shoqata dhe në Konzorciume të bizneseve etj, si dhe ambientimin për shitje në tregje.

Roli i NVM-ve në ekonomi

NVM-të janë shtylla kryesore të ekonomisë kombëtare. Ato janë baza e sistemit ekonomik të ndërmarrjes së lirë. Për shumë njerëz zotërimi i një NVM-je, për shkak të pavarësisë së madhe dhe të ardhurave financiare që sjell, është tepër joshëse. Madje disa e kanë patur ëndërr të te gjithë jetës të kenë në zotërim një biznes të vetin.

Megjithatë, shumë njerëz ngurojnë të venë në jetë një ëndërr të jetës për shkak të mendimit se nuk kanë arsimim, përvojë dhe para të duhura ose thjesht tremben se mund të dështojnë. Megjithatë duke filluar rishtas një biznes, përpara dalin vështirësitë dhe rreziqet reale.

Vitet e fundit ka patur gjallërim të madh të NVM-ve drejt botës së zhvilluar. Bile në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik, aftësi të tilla janë vlerësuar shumë. Në shumicën e ekonomive të zhvilluara 6-15 % e popullsisë që punon janë burra dhe gra të NVM-ve. P.sh. në Mbretërinë Bashkuar (United Kingdom) nga 27 milion njerëz që punojnë rreth 3.4 milion të punësuar në tregti dhe industri punojnë në NVM.

Është e njohur që pas kolapsit të ekonomive të centralizuara, sektori privat shfaqet me një shpejtësi impresionuese në të gjitha ekonomitë e tranzicionit dhe numri i NVM-ve rritet nga dita në ditë. Gjithashtu dihet fakti që rritja e aktivitetit sipërmarrës është orientuar më shumë në tregti se sa në industri apo prodhim.

Zhvillimi i NVM-ve është elementi esencial i zhvillimit ekonomik. Rëndësia strategjike e NVM-ve është e njohur (vërtetuar) në mbarë botën për arsye të mëposhtme:

1. NVM-të kontribuojnë në rritjen e punësimit në një shkallë më të lartë sesa ndërmarrjet e mëdha.
2. NVM-ja është shtylla kryesore e ekonomisë së tregut dhe për ekonomitë e tranzicionit në një periudhë afatgjate ajo mund të siguroj pjesën më të madhe të punësimit.
3. NVM-të prodhojnë kryesisht për tregun e brendshëm, duke shfrytëzuar kryesisht burimet kombëtare.
4. Zhvendosja nga ndërmarrjet e mëdha ish shtetërore në ndërmarrjet më të vogla dhe firma private do të rrit numrin e pronarëve, që përfaqëson një grup njerëzish me një angazhim dhe përgjegjësi më të madhe se në ish ekonomitë e centralizuara.

5. Numri i rritur i NVM-ve do të sjell më fleksibilitet për shoqërinë dhe ekonominë, si dhe mund të lehtësoi novacionin teknologjik dhe të siguroj mundësi signifikante për idetë e reja dhe për aftësitë për tu zbatuar.
6. NVM-ja përdor dhe zhvillon kryesisht teknologjitë dhe aftësitë e brendshme.
7. Zhvillimi i NVM-ve është faktor kyç për zhvillimin e rajonal të vendit.

Gjendja e ekonomisë së biznesit tek nvm-të si dhe perspektivat e tregut

Në Komunën e Pejës deri më tani janë regjistruar mbi 3400 biznese private, ku 80 % prej tyre janë përqendruar në tregti.

Qyteti i Pejës e ka fituar epitetin kryesor të Kosovës duke zhvilluar tregti më Malin e Zi, Shqipërinë, Maqedoninë, Turqinë dhe disa vende tjera.

Shtytje kah një zhvillim i ekonomisë ishte themelimi i një numri të madh të NVM-ve. Meqenëse NVM-të janë faktor themelor që ndikojnë në rritjen e të ardhurave kombëtare si dhe zvogëlimin e papunësisë si çështje thelbësore paraqitet kreditimi për themelimin e NVM-ve të reja dhe zgjerimi i afarizmit për ato ekzistuese. Një nga problemet kryesore që ballafaqohen ndërmarrjet private është mungesa e burimeve financiare.

Mirëpo, përkrah themelimit të një numri të madh të NVM-ve janë themeluar edhe një numër i madh i institucioneve bankare dhe institucioneve tjera jo bankare që mundësuan krijimin e tregut financiar, edhe pse ende kushtet e kreditimit janë të pavolitshme duke filluar nga afati i shkurtër kohor, norma e lartë e kamatave, periudha e shkurt e pushimit (greis periudha), kështu që për shkak që disa projekte investive afatgjate nuk mund të realizohen për shkak të afatit të shkurtër kohor të kthimit të kredive.

Në Komunën e Pejës ekzistojnë 7 degë të bankave të Kosovës më disa filiale të tyre dhe shpresohet se në të ardhmen e afërt sistemi bankar vazhdimisht do ti përmirësoj shërbimet për bizneset pejane.

Vështrimi i NVM-ve për Komunën e Pejës

Spektori i NVM-ve është burim kryesor i gjenerimit të vendeve të punës dhe rritjes së të ardhurave. Prandaj, sektori privat është motor i rritjes dhe tranzicionit në mbarë Komunën e Pejës. NVM-të në Pejë, shumica prej tyre biznese familjare përjetuan një ekspansion të shpejt gjatë viteve 1990-ta, posaqerisht në sektorin e tregtisë. Kjo nuk ishte rezultat i kushteve të favorshme dhe mjedisit të përshtatshëm, por më tepër si reaksion i qytetarëve të Pejës ndaj largimit masiv të shqiptarëve të kësaj komune nga sektori shoqëror dhe vendosjen e të ashtuquajturave "masa të dhunshme" nga regjimi i atëhershëm.

Më fillimin e riregjistrimit, janë regjistruar dhe riregjistruar 3499 biznese sipas Zyrës për regjistrimin e bizneseve pranë Ministrisë për Tregti dhe Industri, nga të cilat 95 % me pronar të vetëm.

Në mënyrë që të arrihet zhvillimi i NVM-ve duhet krijuar kushte për funksionimin e duhur të sistemit ligjor dhe strukturave institucionale të cilat do të mbështesin sektorin privat. Kështu, institucionet vendore duhet ti kushtojnë vëmendje të posaçme kësaj çështje të rëndësishme dhe të nxitojnë në kompletimin ligjor dhe institucional që do

të kontribuonte në zhvillimin dhe zgjerimin e sektorit të NVM-ve. Prandaj mbetet akoma për të punuar në këtë drejtim.

Një faktor i rëndësishëm për një zhvillim të efektshëm të sektorit privat është financimi nga jashtë. Në Pejë ekziston një numër i kufizuar i instrumenteve financiare dhe një sistem i financimit të NVM-ve por ende nuk është e kënaqshme. Në Komunën e Pejës ekzistojnë 7 Banka komerciale që janë të licencuara dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Pejë, kështu që kushtet e tyre për financimin e NVM-ve nga themelimi e deri në vitin 2010 janë përmirësuar por ende kamatat janë të larta dhe afati i kthimit të kredive është i shkurt. Por shpresojmë se në bazë të konkurrencës këto kushte do të përmirësohen dukshëm.

Komuna e Pejës sikurse Komunitet tjerë të Kosovës ka kaluar dhe po kalon në një periudhë tranzicioni duke filluar nga ardhja e UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë në përputhje me rezolutën 1244 të OKB-së. NVM-të po luajnë një rol vendimtar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e Pejës në të ardhmen. Ato sigurojnë punësim të madhe të punëtorëve duke kontribuar në përmirësimin e gjendjes sociale. NVM-të mendohet të jenë çelës i zhvillimit ekonomik të mëtutjeshëm,¹.

Komuna e Pejës ka potencial të mjaftueshëm për zhvillimin e NVM për arsye se ka një popullatë të re, popullatë që nga ana tregtare është e përgatitur, ka pozitë të volitshme tregtare.

1. Treguesit demografik

<i>Sipërfaqja</i>	<i>603 km²</i>	
<i>Popullsia</i>	<i>181.130</i>	
<i>Dendësia</i>	<i>300 ba.km²</i>	
<i>Mosha mesatare</i>	<i>24</i>	
<i>Jeta mesatare</i>	<i>70 meshkuj</i>	<i>75 femra</i>


2. Struktura e ndërmarrjeve private

Tabela II.2.: Numri i ndërmarrjeve sipas llojit të pronësisë në % (përqindje):

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i pronësisë</i>	<i>%</i>
<i>1</i>	<i>Biznes individual</i>	<i>95.4</i>
<i>2</i>	<i>Ortakëri e përgjithshme</i>	<i>3.5</i>
<i>3</i>	<i>Ortakëri e kufizuar</i>	<i>0.1</i>
<i>4</i>	<i>Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar</i>	<i>1</i>
<i>5</i>	<i>Shoqëri aksionare</i>	<i>0</i>
<i>6</i>	<i>Kompani e huaj</i>	<i>0</i>
	<i>Gjithsej</i>	<i>100</i>

Paraqitja grafike II.2. Nndërmarrjet sipas llojit të pronësisë:

¹ .Një veshtrim i NVM-ve në Komunën e Pejës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.



3. Klasifikimi i ndërmarrjeve


Ndërmarrjet klasifikohen në:

- Mikrondërmarrje nga 1-5 punonjës
- Ndërmarrje të vogla nga 6-49 punonjës
- Ndërmarrje të mesme nga 50-249 punonjës
- Ndërmarrje të mëdha nga 250 – e më shumë punonjës


Në Komunën e Pejës klasifikohen këto ndërmarrje:

<i>Klasifikimi i Ndërmarrjeve</i>	<i>Numri i Ndërmarrjeve</i>
<i>Mikrondërmarrje</i>	3,398
<i>Ndërmarrje të vogla</i>	96
<i>Ndërmarrje të mesme</i>	5
<i>Ndërmarrje të mëdha</i>	0
Gjithsej	3,499

II.3:Klasifikimi i mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla, mesme dhe mëdha në menyre grafike.



Paraqitja grafike II.4: Bizneset e regjistruara në %



5. Numri i punëtorëve sipas sektorëve të bizneseve private

Tabela II.5: Numri i punëtorëve sipas sektorëve të bizneseve private

Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	39	123
Ndërtimtaria	115	339
Industria nxjerrëse, prodhimtaria dhe furnizimi me energji	367	1215
Tregtia	1804	2819
Hotelet dhe restorantet, ndërmjetësim financiar dhe qiratë	439	799
Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	353	536
Tjera (Administrimi publik dhe i mbro.sig. social i detyrueshëm, Arsimi, Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	382	744
Gjithsejt	3499	6575

Tabela II.5. Numri i punëtorëve sipas sektorëve të bizneseve private në %

Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	0.1	1.9
Ndërtimtaria	3.3	5.2
Industria nxjerrëse, prodhimtaria dhe furnizimi me energji	10.6	18.5
Tregtia	51.6	42.8
Hotelet dhe restorantet, ndërmjetësim financiar dhe qirat	12.5	12.2
Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	10.1	8.1
Tjera (Administrimi publik dhe i mbro.sig. social i detyrueshëm, Arsimi, Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	10.9	11.3
Gjithsejt	100	100

Problemet që për momentin e ngarkojnë ekonominë e Pejës

Ekonomia e Pejës po ballafaqohet me probleme të shumta si:

Mungesa e infrastrukturës juridike, sistemi financiar, kushtet e kreditimit të NVM, politika fiskale dhe doganore, politika e transformimit të pronës përmes procesit të privatizimit dhe freskimi me investime kapitale, papunësia si një potencial me i çmuar për popullatë etj.

Aktivitetet investuese dhe inovative të NVM-ve

Në përgjithësi është pranuar së shumica e vendeve të reja të punës në ekonomi janë krijuar nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Është njohur së ndërmarrjet mikro krijojnë të ardhura të menjëhershme. Në mënyrë që të ecin me progresin, teknologjinë, globalizimin, NVM-të duhet bërë investime dhe të përkrahin ripërtëritjen e aktiviteteve të tyre vazhdimisht. Janë disa gjëra që akoma ka nevojë dhe duhet ti përdor në këtë aspekt. Këto veprime duhet të fokusohen në krijimin e një mjedisi politik që të stimulojnë zbatimin e aktiviteteve hulumtuese dhe zhvilluese në mes të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, një paraqitje produktive mbetet interesimi për tërë Komunën. Sot shoqëria konfrontohet me sfidat e reja që përfshijnë globalizimin, liberalizimin e tregtisë dhe ndryshimet teknologjike. Këto ndryshime në ekonominë globale japin nevojën për

përkrahjen dhe ndihmën e investimeve në hulumtime dhe zhvillime ndërmjet NVM-ve. Një pjesë e ndërmarrjeve kanë investuar në rehabilitimin e dëmeve të luftës, dhe pjesa tjetër kanë investuar në zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese. Në përgjithësi këto investime janë bërë pothuajse nga ndërmarrjet e vogla ose përmes mjeteve nga burimet tradicionale të financimit (si huat nga shokët apo anëtarët e familjes).

Mirëpo me zhvillimin e sektorit financiar janë rritur investimet në krahasim më vitet e para të pasluftës. Edhe pse ndërmarrësit janë të vetëdijshëm se ku duhet të investojnë por rrethanat në të cilat pas konfliktit ushtarak i ka detyruar që ti fokusojnë investimet në rindërtim dhe rehabilitim të mjeteve ekzistuese të biznesit të tyre.

Propozime mbi politikat kyçe të NVM-ve

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme gjithashtu duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e nivelit të performancave të tyre, të tentojnë në adaptimin e parimeve moderne të menaxhimit, ta ngritin kualitetin e standardeve të produkteve dhe shërbimeve të tyre dhe gjithashtu të depërtojnë në tregjet e jashtme. Kjo mund ta zbusë jobalancin e tanishëm në mes eksportit dhe importit në Komunën e Pejës, do ta shtojë prodhimtarinë vendore dhe do ta shtojë punësimin.

Liberalizimi i ekonomisë dhe funksionimi i favorshëm i rrethinës tregtare janë politikat kryesore të cilat do të udhëheqin zhvillimin ekonomik të Komunës së Pejës. Heqja e barrierave për tregti dhe hapja ndaj ekonomive tjera si dhe përmirësimi i mëtejme i politikës tatimore duhet të konsiderohet seriozisht nga vendim-marrësit për një periudhë afatmesme dhe afatgjate.

Përfundime

Në fund konkludojmë së qëllimi i punimit të kësaj teme ka qënë të dihet për zhvillimin e ekonomisë para dhe pas luftës, zhvillimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe privatizimin e tyre, rolin, përkufizimin, tipet e aktiviteteve dhe shkaqet e dështimit të NVM-ve.

Përkundër problemeve të përgjithshme ekonomike të bartura nga viteve paraprake në politiken fiskale, kushtet e kreditimit të NVM -ve, konkurrencën jo lojale, sistemin doganor, e sidomos në vonesat e politikave operacionale lidhur me privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do ti qaset një administrim të mirëfilltë ekonomik, sidomos në ato segmente që e favorizojnë ekonominë e lirë të Tregut dhe hapjen e mikrobizneseve, avancimin e NVM, kryesisht atyre prodhuese dhe përpunuese, zhvillimin e turizmit, punësimin e të rinjve dhe krijimin e infrastrukturës juridike.

Literatura

1. Autor: Çepani, Ariana, Sipërmarrja dhe Manaxhimi i Biznesit të Vogël, shtypshkronja PEGI, Tiranë, 2001.
2. Gjendja e ekonomisë në Komunën e Pejës, Autor: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik –Pejë.
3. Një vështrim i gjendjes dhe veprimtarisë së NVM-ve në Komunën e Pejës. Autor: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik –Pejë.

Current challenges faced by the EU

PhD (C.) Gledina Mecka

Albanian National Bar Association, Tirana

Abstract

The European Union is an organization sui generis composed by member states which have transferred part of their sovereignty in certain policy areas. These member states have harmonized laws on economic and political issues. The EU integration begun after World War II. It started by six Western European countries as founders, to promote development in peace, security, and economic sector. The EU is considered a successful project and a cornerstone of European democracy and integrity. On the other hand, the EU is facing political and economic pressures, including slow growth and high unemployment, as well as the rise of populist political parties, at least some of which harbor anti-EU or “euroskeptic” sentiments. Such factors are complicating the EU’s ability to deal with a multitude of internal and external challenges. Among the most prominent are the June 2016 vote in the United Kingdom (UK) in favor of leaving the EU; the Greek debt crisis and lingering concerns about the eurozone; the migration and refugee crisis; a resurgent Russia; and a heightened terrorism threat. This paper aims to make a brief analysis of the most concerning challenges EU is currently facing.

Keywords: EU challenges, economic pressure, refugee crisis, Eurosceptic.

Introduction

Today’s European Union began as the European Coal and Steel Community in 1951. According to O’Sullivan, the community was an attempt to prevent a future war in Europe because it meshed the national industries on which the machinery of war then depended. Founded by Belgium, France, West Germany, Italy, the Netherlands and Luxembourg, the Community over the course of 50 years grew into the EU. Along the way, the European Economic Community (EEC) was created in 1957 to integrate the economies of the same six countries, expanding in 1973 to include the United Kingdom (UK), Ireland and Denmark.¹ The European Union is an organization sui generis composed by member states which have transferred part of their sovereignty in certain policy areas. These member states have harmonized laws on economic and political issues. The EU integration begun after World War II. It started by six Western European countries as founders, to promote development in peace, security, and economic sector. Currently, the EU has 28 member states which share a customs union; a single market (where four freedoms: goods, services, people, and capital move freely); common trade policy; agricultural policy; and euro as a common currency. Euro is used by 19 member states which constitute the “eurozone”. Twenty-two EU members participate in the Schengen area.

The EU is largely viewed as a success story and as a cornerstone of European stability and prosperity. Currently, however, the EU faces a range of political and economic

¹ <http://web.international.ucla.edu/euro/article/164869>, *European and Russian Studies*, Peggy McNerny, Director of Communications.

pressures, including slow growth and persistently high unemployment in many EU countries, as well as the rise of populist political parties, at least some of which harbor anti-EU or “euroskeptic” sentiments (as well as anti-immigrant views). Such factors are complicating the EU’s ability to deal with a multitude of internal and external challenges. Among the most prominent are

- the June 2016 vote in the United Kingdom (UK) in favor of leaving the EU;
- the Greek debt crisis and lingering concerns about the eurozone;
- the migration and refugee crisis;
- a resurgent Russia; and
- a heightened terrorism threat.²

The EU has been built through a series of binding treaties, and has characteristics of both a supranational entity (in specified areas, sovereignty is shared and EU institutions hold executive authority) and an intergovernmental organization (in other areas, cooperation is pursued by consensus). Over the years, member states have sought to harmonize laws and adopt common policies on an increasing number of issues.³ There are some common institutions which are used by the EU member states to set policies, such as decisionmaking. This instrument has a supranational nature. In some areas, such as foreign policy, it is required unanimously of the 28 member states. The institutions of the EU are not the same as the member states’ but they have the *sui generis* nature.

1. Differences and Tensions within the EU

There has been a continuous tension within the EU since there are member states which want a closer union through further integration and on the other hand there are members which want that EU to stay on a more intergovernmental level so they can keep their sovereignty more intact. Thus, there are member states which have not accepted certain parts of integration, such as the Schengen area and the Eurozone also. Another issue is also the EU “expansion” or further enlargement. In the 1990s and 2000s, the EU tried to reform the EU institutions, mainly the decisionmaking processes. This process was materialized by the Lisbon Treaty which entered into force in 2009. Despite this, there are still issues and complexity in decisionmaking, which still remains a largely consensus-based one. The EU enlargement is an important issue and countries which aspire to become members of the EU have to fulfill some political and economic criteria, such as the Copenhagen Criteria. On the other hand, there are member states which do not think that the EU enlargement would be a good thing. The reasons are the EU’s institutional capacities and the financial issues.

2. Current political and economic situation

The economic worldwide recession in 2008-2009, as well as the eurozone debt crisis visibly influenced the European economies. Because of these factors there was a

² <https://www.everycrsreport.com/reports/R44249.html#Content>, *The European Union: Current Challenges and Future Prospects*, February 15, 2016 – September 20, 2016.

³ <https://www.everycrsreport.com/reports/R44249.html#Content>, *The European Union: Current Challenges and Future Prospects*, February 15, 2016 – September 20, 2016.

decrease in economy growth and an increase in the general unemployment through many EU member states. Economic differences within the EU have also produced policy divisions between member states.

2.1. *Anti-EU Political Parties*

The Anti-EU Political Parties are nationalist and antiestablishment political parties which have appeared recently. These Anti-EU Political parties are often called as "euroskeptic" political parties because they are not for giving too much power to the EU and diminish the national sovereignty. The way the eurozone crisis was handled and the immigration fears made that these parties appear and have support by people. Other factors are the globalization phenomenon and the EU identity crisis due to the EU enlargement tendency.

2.2. *The Brexit*

UK voted in favor of a British exit from the EU due to the economic dissatisfaction, globalization and immigration.

The UK government must still enact the referendum results, presumably by invoking Article 50 of the Treaty on European Union—the so-called exit clause that outlines procedures for a member state to leave the EU. The invocation of Article 50 will trigger a two-year period for withdrawal negotiations to be concluded. The EU also may decide to extend the time for negotiations. The UK remains a full member of the EU until the withdrawal process is completed, and EU law continues to apply in the UK until that time.⁴

2.3. *The Greek Crisis*

The Greek debt crisis in 2009 was a concern for the eurozone safety. There were risks that Greece might exit the eurozone. Greece asked EU for more financial help. Instead of this, the government accepted the EU demands for further economic reforms in order to stay in the eurozone. Greece has still difficulties in its way toward economic improvement, but also it has reached some sort of balance.

2.4. *Migratory Pressures*

Recently, Europe is facing huge migration and refugee crisis from Syria, Iraq, Afghanistan, Africa, South Asia, etc.

According to the United Nations, more than 1 million refugees and migrants sought to enter the EU in 2015, and over 90% were from the world's top 10 refugee-producing countries.⁵

Managing this crisis was difficult and many efforts showed to be not successful in 2015.

This raised doubts if the EU was capable to integrate into its society the refugees and immigrants. On the other hand neither these minorities were able to fit with the society in the EU, so there were a lot of tensions and criminal activity and terrorism. At the same time, concerns exist about increasing societal tensions and xenophobia in Europe. Germany, Sweden, and other EU countries have seen an increase in the number of violent incidents against migrants and refugees over the past few months (Yardley, 2016, 13).

⁴ <https://www.everycrsreport.com/reports/R44249.html#Content>, *The European Union: Current Challenges and Future Prospects*, February 15, 2016 – September 20, 2016.

⁵ U.N. High Commissioner for Refugees, *Refugee/Migrants Emergency Response-Mediterranean*, at <http://data.unhcr.org/mediterranean/regional.php>.

The refugee crisis has reached an unprecedented level, because the Syrian and Iraqi conflicts are at a ferocity and intensity not seen since World War II; up to 300,000 people have been killed in the Syrian Civil War alone. Most of these people are not coming to Europe for economic reasons, or because they are on a mission of any kind, but because they are in fear of their lives. They are seeking refuge. They are the human embodiment of the price of war. Their plight is a human manifestation of what the voluntary European Union (EU) was created to avoid in Europe itself: war.⁶ In the aftermath of World War II, leaders in Western Europe were anxious to secure long-term peace and stability in Europe and to create a favorable environment for economic growth and recovery. In 1951, six countries—Belgium, the Federal Republic of Germany, France, Italy, Luxembourg, and the Netherlands—decided to establish the European Coal and Steel Community (ECSC), which is regarded as the first step in the European integration project. On November 1, 1993, the Treaty on European Union (also known as the Maastricht Treaty) went into effect, encompassing the EC and establishing the modern-day European Union. The EU was intended as a significant step on the path toward not only greater economic integration but also closer political cooperation. The Maastricht Treaty contained provisions that resulted in the creation of the Eurozone, in which participants share a common currency, a common central bank (the European Central Bank, or ECB), and a common monetary policy (there is no common fiscal policy, however, and member states retain control over national spending and taxation, subject to certain conditions designed to maintain budgetary discipline). The European Union (EU) is a political and economic partnership that represents a unique form of cooperation among 28 sovereign states (see Figure 1). It is the latest stage in a process of European integration begun after World War II, initially by six Western European countries, to promote peace and economic development. Its founders hoped that by pooling sovereignty in certain sectors (primarily economic ones at first), integration would foster interdependence and make another war in Europe unthinkable. The EU has been built through a series of binding treaties, and has characteristics of both a supranational entity (in specified areas, sovereignty is shared and EU institutions hold executive authority) and an intergovernmental organization (in other areas, cooperation is pursued by consensus). Over the years, member states have sought to harmonize laws and adopt common policies on an increasing number of issues. EU members share a customs union, a single market (in which goods, people, and capital move freely), a common trade policy, a common agricultural policy, and a common currency (the euro) that is used by 19 member states (collectively referred to as “the Eurozone”).⁷ Currently, however, the EU is facing several significant internal and external challenges amid a complex political and economic backdrop.⁸

3. The Current Political and Economic Context

A number of political and economic factors are contributing to the current uncertainty surrounding the future of the EU project. To varying degrees, they are also challenging the legitimacy and structure of the EU and its institutions.

In a number of areas, 2016 could be the year when international affairs begin at least to stabilise after the rollercoaster ride of unexpected crises seen since 2014.

European Union's member-states, growing concerns regarding the region's struggling

⁶ <http://www.fairobserver.com/region/europe/challenges-facing-the-eu-today-23190/>, John Bruton.

⁷ The European Union: Current Challenges and Future Prospects Kristin Archick Specialist in European Affairs June 21, 2016, pg. 4.

⁸ The European Union: Current Challenges and Future Prospects Kristin Archick Specialist in European Affairs June 21, 2016, pg. 4.

businesses and sluggish GDP growth are giving rise to Euroscepticism, or a lack of faith in the EU's ability to bring about significant improvements

In a number of areas, 2016 could be the year when international affairs begin at least to stabilise after the rollercoaster ride of unexpected crises seen since 2014.⁹

As Europe approaches the second half of the 21st-century's second decade, it faces pressing issues of anti-EU sentiment, sluggish economic growth and high unemployment. While many are calling for a greater degree of integration between the European Union's member-states, growing concerns regarding the region's struggling businesses and sluggish GDP growth are giving rise to Euroscepticism, or a lack of faith in the EU's ability to bring about significant improvements. According to a report released in October of 2013 by the International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies, 120 million Europeans were at risk of falling into poverty.¹⁰ Currently, however, the EU is facing several significant internal and external challenges amid a complex political and economic backdrop. Against this political and economic backdrop, the EU is grappling with several major challenges.

The refugee crisis;

The Greece Crisis;

The UK Referendum;

The EU is currently facing several major challenges: the global refugee crisis, a difficult recovery from the fiscal crisis of 2008, security crises to the East and South, and the potential exit of the United Kingdom from the EU.

the June 2016 vote in the United Kingdom (UK) in favor of leaving the EU;

the Greek debt crisis and lingering concerns about the eurozone;

the migration and refugee crisis;

a resurgent Russia; and

a heightened terrorism threat.

Lack of Strong Leadership and Strategic Vision

Historically, the development of the EU has largely been driven forward by several key countries acting as an "engine." French and German leadership was essential to establishing the common currency, and France and the UK were instrumental in forging EU common foreign and security policies. Many analysts suggest, however, that a strong EU "engine" has been lacking over the last few years. Although German Chancellor Angela Merkel has played a central role in responding to the eurozone crisis, Russian aggression in Ukraine, and the migrant and refugee flows, critics view her as being too hesitant and tactical in many instances, rather than acting as a leader of Europe writ large. Meanwhile, others argue that too much power in the EU now resides with Germany alone, in part because other leaders—including French President François Hollande—have been constrained by domestic politics and economic preoccupations.

Some observers assert that European leaders do not have a robust or shared strategic vision for the EU. Those of this view point to what they consider to be ad hoc, piecemeal responses that eschew hard decisions about further integration or fail to address issues with an eye to ensuring a strong, stable, united, economically vibrant

⁹ <http://www.bbc.com/news/uk-35125052>, Robin Niblett, Director, Chatham House, 4 January 2016

¹⁰ <https://www.reference.com/history/problems-facing-europe-today-9384b0fe811d5fca#>

EU in the long term. Many analysts have raised particular worries about the apparent divergence between Germany and France over how to manage the Greece crisis and what this could portend for their respective visions of the EU's future more broadly.⁴

Conclusions

As a conclusion to this paper, the EU is considered a successful project and a cornerstone of European democracy and integrity, but nowadays it is facing political and economic pressures, including slow growth and high unemployment, as well as the rise of anti-EU political parties or the so-called "euroskeptic". These factors are making it difficult for the EU to deal with a lot of internal and external challenges and issues, such as the Brexit, the Greek debt crisis, the migration and refugee crisis, a resurgent Russia, and the terrorism threat. This paper aimed to make a brief analysis of the most concerning challenges EU is currently facing. However, the EU is trying to balance the situations and to focus on economic re growth. It is also focusing on enlargement policies.

References

- U.N. High Commissioner for Refugees, Refugee/Migrants Emergency Response-Mediterranean, at <http://data.unhcr.org/mediterranean/regional.php>.
- Jim Yardley, "Sexual Attacks Widen Divisions in European Migration Crisis," *New York Times*, January 13, 2016.
- <https://www.everycrsreport.com/reports/R44249.html#Content>, The European Union: Current Challenges and Future Prospects, February 15, 2016 – September 20, 2016.
- <http://web.international.ucla.edu/euro/article/164869>, European and Russian Studies, Peggy McNerny, Director of Communications.
- <http://www.fairobserver.com/region/europe/challenges-facing-the-eu-today-23190/>, John Bruton.

Konflikti sovjetiko –shqiptar mbi pronësinë e anijeve luftarake të Bazës Detare të Pashalimanit (maj 1961)

Etleva Smaçi

Lektore në Akademinë e Forcave të Armatosura, Tiranë

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë dhe të arrijë në disa përfundime mbi zhvillimet që ndodhën në Bazën e Vlorës, në pranverën e vitit 1961. Krahas konfliktit politik dhe konfliktit ushtarak, në bazë u zhvillua edhe një konflikt i pastër me natyrë juridike, në lidhje me zotërimin e mjeteve të Bazës Detare. Ky konflikt lidhej me pronësinë e 12 nëndetëseve, 2 bazave lundruese dhe një sasi anijesh ndihmuese. Këto mjete të marinës detare, ishin dislokuar në Bazën e Vlorës në vitet 1957 dhe 1959, mbi bazën e dy marrëveshjeve të nënshkruara mes qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së BS. Si marrëveshje të shkruara në sfondin e Luftës së Ftohtë, ato kishin shumë ekuivoqe që ndikuan në pretendimet e palëve.

Qeveria shqiptare e pretendonte pronësinë e nëndetëseve bazuar në aktet e dorëzimit, kurse qeveria e BS e shihte këtë akt dorëzimi, si shprehje të faktit që nëndetëse sovjetike kishin mbërritur në territorin shqiptar. Edhe disa elemente të tjerë, që kishin të bënin me afatet kohore të marrëveshjeve, që ishin të kufizuara, apo ndalimin e dhënies me hua të tjerëve, flasin në favor të pretendimit të Bashkimit Sovjetik. Nëndetëset nuk ishin falur. Ato ishin dhënë në përdorim, për aq kohë, sa udhëheqja komuniste shqiptare ndiqte e bindur politikën e Moskës dhe i shërbente qëllimeve të saja në rajon. Ndryshimi i kontekstit historik, kalimi në krah të një partnerit tjetër ideologjik Kinës, ndryshoi dhe formën e marrëdhënieve me BS, duke çuar në konfliktin e lartpërmendur. Si u zgjidh ky konflikt është edhe subjekt i punimit.

Fjalë Kyçe: Baza e Vlorës, nëndetëse, Bashkimi Sovjetik, qeveria e RPSH, pronësi.

Hyrje

Baza e Vlorës u themelua me vendim të Këshillit të Ministrave të BS më 27 korrik 1957. Në historiografinë e deri tashme ajo është trajtuar shpesh si bazë e Traktatit të Varshavë, madje si e vetmja në Mesdhe. Një vështrim i kujdesshëm i dy marrëveshjeve të vitit 1957 dhe vitit 1959, qartëson se kjo bazë, u krijua mbi një marrëveshje dy palëshe mes ministrisë së MMP të Shqipërisë dhe ministrisë së Mbrojtjes së BRSS. Ajo u krijua me qëllim që të siguron mbrojtjen e RPSH dhe për të mundësuar bazimin e përkohshëm të anijeve nënujese e mbiujese të BS. Për këtë qëllim u pa e nevojshme që në Bazë e Vlorës në harkun kohor 1957 -1959 të vinin 12 anije nënujese dhe mbiujese. Fillimisht këto anije ishin të pajisura me ekuipazhe sovjetike.

Bazuar në marrëveshjet ushtarake të '57 dhe 59-s, nëndetëset do t'u jepeshin në përdorim efektivëve ushtarakë shqiptarë, sipas një grafiku të përcaktuar nga palët. Dorëzimi i këtyre anijeve u bë pjesërisht, për shkak të ashpërsimit të marrëdhënieve mes udhëheqjes së BS dhe udhëheqjes komuniste shqiptare. Konflikti mes tyre kishte natyrë ideologjike, por që bërë shtrat edhe në marrëdhëniet ushtarake mes dy vendeve. Madje marrëdhëniet ushtarake ishin ato që mbajtën peshën më të madhe të kësaj krize. Baza e Vlorës u konsiderua "molla e sherrit". Pozicioni strategjik i saj ishte shumë i lakmuar. Por me pozicionimin hapur të PPSH pas mbledhjes së Bukureshtit në krah të

Kinës, BS vendosi ta ndëshkonte Shqipërinë. Krahas ndërprerjes së ndihmave ekonomike, u ndërpreu edhe ndihmat ushtarake. Kjo cenoi ndjeshëm gatishmërinë e Bazës Detare, duke i dhënë shkas, komandës së Traktatit të Varshavës, të kërkonte likuidimin e saj. BS sovjetik paraqiti vetëm një alternativë që baza të mund të vazhdonte të ekzistonte. Vënie e Bazës në dispozicion të komandës së TV, me praninë në Bazë vetëm të efektivëve sovjetikë. Ky propozim u bë së pari nga komandanti i TV, marshall Greçko, e më pas nga Hrushovi, i mbështetur nga udhëheqësit e tjerë të bllokut komunist. Përfaqësuesi shqiptar, ministri i Mbrojtjes e refuzoi në mënyrë të prerë këtë propozim. Pranimi i tij do të thoshte cenim i integritetit të vendit, kështu që refuzimi ishte një hap i rëndësishëm i hedhur nga udhëheqja shqiptare. Në përgjigje të refuzimit shqiptar, mbledhja e KPK të TV, më datë 28-29 mars vendosi tërheqjen e trupave sovjetike nga Baza e Vlorës si dhe mjeteve të cilat ajo kishte dislokuar në bazë. Pikërisht, kërkesa e BS për të marrë gjithçka materiale, që kishte sjellë për fuqizimin e Bazës së Vlorës, përbën një nga momentet më të rëndësishme në marrëdhëniet e Shqipërisë me BS dhe TV. Mënyra se si u zgjidh ky konflikt, analizohet në këtë artikull nga një këndvështrim i ri, i paanësuar dhe emocional, siç është bërë para viteve 90-të.

Letërkëmbimi mes Mehmet Shehu dhe Kosigini për Bazën e Vlorës

Vendimin e KPK për likuidimin e bazës së Vlorës, nxori në pah një sërë problemesh që lidheshin me mjetet luftarake dhe bazën materiale që ndodhej në bazë. Çfarë do të ndodhte me to? Do të liheshin në Shqipëri në mënyrë që baza të vazhdonte funksionet e saj, apo do të kërkohej dorëzimi i tyre, që do ta bënte pothuajse të pamundur funksionimin e bazës? Moska kishte vendosur t'i shkonte ndëshkimit të Shqipërisë deri në fund, duke kërkuar të rimerrte gjithçka që mendonte se i takonte. Dhe këtë mendim e kishte shprehur hapur e pa rezerva një nga ushtarakët e lartë sovjetik të Bazës që në fillim të konfliktit.¹

Në këto kushte më 5 prill 1961, Mehmet Shehu iu drejtua me një letër të gjitha vendeve anëtare të TV.² Akuza e shkëlqes së neneve 3 dhe 5 zë një vend të gjerë në letër përmes lojës së fjalës "sulm". Për qeverinë shqiptare nuk kishte asnjë shkëlqes të këtyre neneve. Sulmi sipas letrës së Mehmet Shehut kishte ekzistuar, por nuk ishte realizuar. Shpallja e ekzistencës së një komploti imperialist kundër RPSH, e kishte venë udhëheqjen komuniste shqiptare në pozitë të vështirë me TV. Ajo u përpoq ta stiste sa më mirë e sa më shpejt zgjidhjen e "lëmshit" të bërë me komplotin, duke bërë një gjyq model stalinist. Ai që do të paguante për komplotin me prova të sajua ishte admiralit Temo Sejko, drejtues i Bazës së Vlorës deri në fillim të vitit 1960³

Pika tjetër e nxehtë e kësaj letre ishte çështja e bazës së Vlorës. Vendimi i marrë nga KPK cilësohej një vendim i padrejtë dhe qeveria shqiptare nuk do të pranonte kurrsesi për t'ua dorëzuar BLD të Vlorës ekuipazheve sovjetike.⁴ E vetmja rrugë për të ishte dorëzimi në kohë sa më të shkurtër i të gjitha mjeteve të BLD të Vlorës ekuipazheve

¹ AQFA. F.1460, V.1960, D.1, fl.3. Ditari i M. Planit, Në raportimet e incidenteve të ndodhura në bazën e Vlorës, është i njohur ai mes kundëradmiralit Jegorov dhe Kap. Rang. II Dashamir Ohri. Ky konflikt përfundoi me ultimatumit e kundëradmiralit Jegorov se "anijet janë sovjetike, ato ju janë dorëzuar formalisht, këtu komandoj unë."

² AQSH.F.14-AP/TV, V.1961, D.1, fl.85, Letër e Mehmet Shehut drejtuar qeverive anëtare të TV dhe vendeve vëzhguese. Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, "Shqipëria: Nga Pakti...f.180

³ Gjyqi i Teme Sejkos u zhvillua në fund të majit të vitit 1961, në kohën kur sovjetikët ishin larguar nga baza e Vlorës

⁴ Po aty...fl.90.

shqiptare.

E bindur se nuk mund ta ndalte largimin e trupave ushtarake sovjetike nga Vlora, qeveria shqiptare me anë të letrës së Mehmet Shehut u dorëzua përpara faktit se baza detare ishte drejt likuidimit. "Në rast se qeveria sovjetike nuk pranon të zbatojë marrëveshjet ekzistuese mbi bazën e Vlorës dhe vendos të largojë forcat e veta ushtarake –detare nga kjo bazë në përputhje me vendimet e KPK, qeveria e RPSH, megjithëse është kundër këtij vendimi, nuk do të nxjerrë pengesa."⁵ Ajo që nuk e dallon këtë letër nga gjithë letrat e tjera të shkruara nga qeveria shqiptare është deklarimi i besnikërisë ndaj kampit të socializmit dhe TV. Më 26 prill me një letër të gjatë⁶ A. Kosigini⁷ do të jepte verdiktin e Moskës mbi bazën e Vlorës. Që në hyrje të letrës ai do të sillte në kujtesën e qeverisë shqiptare se hyrja në TV nuk kishte qenë aspak meritë e veçantë e saj. Kjo pjesëmarrje ishte një iniciativë e qeverisë sovjetike, madje shkonte më tej në konstatimin se qenia anëtare e OTV i kishte shërbyer Shqipërisë si një garanci e shëndoshë për sigurimin e Shqipërisë që ajo nuk e kishte pasur kurrë gjatë gjithë historisë së saj.

Ngritja e Bazës së Vlorës gjithashtu ishte iniciativë e qeverisë sovjetike. Kjo thuhej qartë në letrën e Kosiginit, duke e konsideruar bazën një pikë mbështetje për OTV. Dhe si e tillë ajo edhe kishte marrë një vëmendje të rëndësishme nga Moska duke u furnizuar me 12 nëndetëse, 2 baza lundruese dhe një sërë mjedesh të tjera.

Letra i bënte me dije qeverisë shqiptare se ajo e kishte mbyllur ciklin gati 15 vjeçar të miqësisë me BS. Kështu ajo i humbiste të gjitha mundësitë për të rivendikuar të drejta që ajo mendonte se i takonin, duke përfshirë edhe qenien e saj në TV dhe të mirat materiale që buronin nga ky anëtarësim. "Është e kuptueshme se udhëheqja shqiptare nuk mund të shpresojë më tutje se BS do ta ndihmojë atë mbi bazën e mëparshme, ndihmë që kanë të drejtë ta marrin vetëm miqtë dhe vëllezërit e vërtetë."⁸ Kjo politikë jomiqësore do t'i kushtonte Shqipërisë, pasi ajo jo vetëm u akuza si minuese e bashkëpunimit ushtarak, por dhe ju kërkua në mënyrë të prerë në mbështetje të vendimit të KPK, më 29 mars, të dorëzonte gjithçka kishte marrë nga BS për ngritjen e bazës luftarake detare të Vlorës.

Qeveria sovjetike duke shprehur keqardhjen njoftonte se ajo do të tërhiqte të gjitha nëndetëset e saja, anijet mbiujëse dhe mjedet e tjera. Për këtë arsye ajo i lutej qeverisë shqiptare t'i jepte udhëzime autoriteteve ushtarake që deri më 20 maj 1961 të heqin të gjitha ekuipazhet shqiptare nga të gjitha anijet, nëndetëset dhe anijet ndihmuese, të cilat në kohën e vet u dërguan nga BRSS në Shqipëri për organizimin e BDU.⁹ Evakuimi i forcave ushtarake detare sovjetike të vendosura në Vlorë do të bëhej nga admiral i FLD të Detit të Zi, V.A. Kasatanov.

Kosigini i mëshon në letër idesë se marrëdhëniet e ardhshme midis dy vendeve, përfshi edhe bashkëpunimin ushtarak, do të përcaktoheshin nga qëndrimi që pala shqiptare do të mbante. Madje në këtë këndvështrim duke besuar në ndonjë pendesë të mundshme të udhëheqësve shqiptarë, apo ndoshta edhe të ndonjë ndryshimi të

⁵ *Po aty...*fl.91

⁶ *AMPJ*, V.1961, D.42/5, fl.40, Traktati i Varshavës, Letër e A. Kosiginit drejtuar qeverisë së RPSH në përgjigje të letrës së 5 prill 1961 të Mehmet Shehut, *AQSH*, F. 490, V.1961, D.1149, fl.20, Letërkëmbim midis RPSH dhe BS për çështjet e bazës ushtarake detare të Vlorës; , Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, "Shqipëria: Nga Pakti i Varshavës në Nato", *Studime Historike* Tiranë: Botim i Institutit të Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, nr. 3-4, 2008, f.180

⁷ * **A.N.Kosigin**, (1904- 1980),zëvendëskryetar i KM të BRSS, 1960-1980 ka qenë anëtar i KQ të PKBS, anëtar i BP të KQ të PKBS

⁸ *Po aty*, fl.49

⁹ *Po aty*, fl.50, Gjithashtu shiko: Ana Lalaj,"Shqipëria: Nga Pakti i V...", f.180.

mundshëm të tyre, duket se ai e lë në mënyrë diplomatike një "deriçkë" të hapur kur deklaroi se *"kur marrëdhëniet midis vendeve tona të normalizohen....atëherë në interes të gjitha vendeve socialiste mund të rivendosej baza detare ushtarake e Vlorës."*¹⁰

Në periudhën prill- qershor 1961 janë shkëmbyer një mori letrash dhe notash zyrtare ndërmjet dy qeverive, të cilat në qendër kanë bazën e Vlorës. Ajo ishte kthyer realisht në një plagë të rëndë, të cilën askush nuk tentonte ta shëronte. Përkundrazi secila palë shkaktonte një të çarë të re, duke akuzuar palën tjetër pas çdo përkeqësimi. Letrës së Kosiginit qeveria shqiptare iu përgjigj më 8 maj.¹¹

Ajo u përqendrua vetëm tek baza e Vlorës. Gjithë vëmendja u përqendrua për të fituar sa më shumë nga kjo betejë. Pala shqiptare kërkonte të mbante me forcë anijet luftarake, që sipas saj i ishin dhënë falas. Për të nënshkrimi i dy marrëveshjeve për pajisjen e BLD të Vlorës me 12 nëndetëse dhe mjete të tjera luftarake, nënkuptonte dorëzim të tyre tek pala shqiptare. Dorëzimi interpretohej si kalim i mjeteve luftarake në pronësi të shtetit shqiptar. Për këtë midis dy palëve ishin hartuar dokumentet përkatëse të rregullta.¹²

Ekzistenca e marrëveshjeve dhe togfjalëshi "falas" i përdorur në marrëveshjen e vitit 1959 do të ishte kali i betejës së shtetit shqiptar në luftë me qeverinë sovjetike. Propozimi i palës shqiptare ishte që të gjitha anijet luftarake të ndodhura në bazë të kompletoheshin me ekuipazhe shqiptare. Por duket se me shumë gjasa edhe ajo vetë e ka kuptuar se juridikisht kishte shumë pak argumente për të mbrojtur pronësinë e rivendikuar. Kështu që gjeti mënyrën që në letren 8 majit të artikulonte se *"për hir të miqësisë së përjetshme që lidh popullin shqiptar me popullin sovjetik ajo nuk do të kundërshtonte largimin e mjeteve luftarake me ekuipazhe sovjetike."*¹³

Veprimtaria e komisionit të përbashkët sovjetiko shqiptar

Përsa i përket 4 nëndetëseve të marra në dorëzim [nga BS] dhe ku shërbimi kryhej nga të dy ekuipazhet si dhe bazës lundruese "Nemiçov" (Tomori), qeveria shqiptare ishte kategorike që ato i takonin asaj. Për evakuimin e trupave sovjetike u propozua ngritja e një komisioni i cili mendohej se do të fillonte nga puna para datës 20 maj. Përpara se komisioni të niste punën qeveria sovjetike i dorëzoi shtetit shqiptar një promemorie që vinte si përgjigje e letrës së 8 majit dhe propozimeve që ajo përmbante. Beteja tashmë zhvillohej haptas në të gjitha planet. Ajo ishte përqendruar në BDU të Vlorës ku vazhdonin të shënoheshin incidente të shpeshta.¹⁴ Po kaq ofensive ishte dhe beteja diplomatike me letra, përgjigje e takime. Më 18 maj, zëvendësministri

¹⁰ Po aty, fl.51

¹¹ AMPJ, V.1961, D.42/5, fl.53, Traktati i Varshavës, Letra e qeverisë së Shqipërisë drejtuar qeverisë së BRSS më 8 maj 1961; Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, *Shqipëria*..f.312

¹² Po aty, fl.53.

¹³ Po aty, Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, "Shqipëria: Nga Pakti i V..."f.181

¹⁴ AQFA, F.1460, V.1960. D.1, fl 105- 106, Ngjarje kryesore të kohëve të fundit; Shënim i datës 2 maj 1961. "Instruktorët sovjetikë në bazën e dragaminës Nr. 844, hodhën në det një kovë me pjesë këmbimi Kovës i ishin shpuar tri vrima që të fundosej menjëherë. Shënim i datës 3 maj 1961. Kapiten Leit. sovjetik Krillov, në mënyrë shumë brutale duke u futur në punët e brendshme të partisë sonë i ka bërë kapiten Izet Vençanit këto pyetje:

Pse e keni ngritur kaq tensionin?

Çfarë gjyqi po përgatitet të behet tek ju?

Çfarë origjine ka kryeministri juaj?

Pse ja keni ndërruar emrin partisë nga Partia Komuniste në Parti e Punës?

Ku ndodhet Liri Belishov dhe a do të dali në këtë gjyq?

Halim Budo priti ambasadorin sovjetik Shikin.¹⁵ Në deklaratën e ambasadori Shikin konfirmoi po të njëjtin qëndrim që sovjetikët kishin paraqitur një muaj më parë me letrën e Kosiginit. Deklarata u quajt e papranueshme nga Halim Budo.

Po në 18 maj 1961, qeverisë shqiptare iu dorëzua promemoria e qeverisë së BS.¹⁶ Në promemorie thuhej qartë se qëndrimi i RPSH se “*gjoja të gjitha mjetet e FUD që gjenden në Vlorë i përkasin Shqipërisë*” ishte një interpretim arbitrar i marrëveshjeve. Duke i ashpërsuar tonet qeveria sovjetike, e quajti pretendimin shqiptar si pushtim të anijeve sovjetike¹⁷. Kjo sipas saj çonte në përkeqësim të marrëdhënieve jo vetëm me BS, por edhe vendet e tjera të Bllokut Komunist. Pala sovjetike sillte një argument të ri që lidhej me kontekstin kohor politik kur u nënshkruan marrëveshjet. Marrëveshjet thuhej në promemorie ishin përfunduar në kushte krejtësisht të tjera.¹⁸ Por kohët kishin ndryshuar. Dhe ndryshimi kishte ardhur nga pala shqiptare, që kishte vendosur të niste një aleancë të re, duke nënkuptuar lidhjet me RP të Kinës.

Pala sovjetike e pranoi propozimin shqiptar të datës 8 maj për një takim në Tiranë. Ajo njoftoi se kishte caktuar një delegacion të përbërë nga shoku N.P. Firjubin zëvendësministër i Punëve të Jashtme, A. I. Antonov, zëvendës i parë i shefit të Shtabit, N.D. Sergejev, zëvendës i parë i shefit të Shtabit të FUD, S.T. Astani, shef i Degës së Pestë europiane të MPJ të BRSS.¹⁹ Delegacioni mbërriti në MPJ të RPSH më 19 maj. Por klima e marrëdhënieve ishte tepër tensionuar. Të dyja palët merrnin raporte aspak të pëlqyera nga ushtarakët që ndodheshin në Bazën e Vlorës (sovjetikët) dhe ushtarakët shqiptarë që ndodheshin në BS.

Kjo u reflektua që në takimin e parë. Halim Budo që kryesonte delegacionin shqiptar paraqiti një deklaratë sipas të cilës autoritet sovjetike kishin ndaluar atasheun ushtarak shqiptar në Moskë të merrte kontakt me ushtarakët e marinës dhe të organizonte nisjen e tyre.²⁰ Budo i akuzoi autoritet sovjetike se ato i mbanin mbyllur brenda shkollave ushtarakët shqiptarë. Përpara të dy delegacioneve ai deklaroi se kjo ishte me të vërtetë një gjë monstruoze.²¹

Pas këtyre deklarimeve, ai njoftoi dhe ndërprerjen e mbledhjes. Për delegacionin sovjetik ky veprim, u konsiderua si një vazhdimësi e sjelljeve armiqësore të shqiptarëve në kuadër të acarimit të marrëdhënieve mes vendeve. Pala shqiptare shfaqti hapur tendencën për të shtyrë fillimin e punës së komisionit. Me pretekstin e problemit të pazgjidhur të ushtarakëve të marinës që duhet të ndihmoheshin të ktheheshin në Shqipëri, punimet nuk filluan as në datën 20 maj, pavarësisht përpjekjeve të Firjubinit. Deklarimi zyrtar se ushtarakët shqiptarë të marinës ishin të lirë për t’u kthyer në

¹⁵ AMPJ, V.1961, D.42/5, f. 60; Informacion, datë 18 maj 1961, mbi pritjen e ambasadorit Shikin nga zëvendësministri Halim Budo.

*I.V. Shikin, (1906- 1973), në vitet 1960 -1961 ambasador i BRSS në Shqipëri.

¹⁶ AMPJ, V.1961, D.42/5, fl.66, Promemorie.

¹⁷ Po aty...fl.67.

¹⁸ Po aty

¹⁹ Po aty...fl.68 Delegacioni mbërriti në Tiranë më datë 18 maj 1961. Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, “Shqipëria: Nga Pakti i V...”, f.181.

²⁰ AMPJ, V.1961, D.42/6, fl.3, Bëhet fjalë për ndalimin e atasheut ushtarak dhe përfaqësuesit të Shqipërisë në TV, gjeneralmajor Halim Ramohito.

Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, “Shqipëria: Nga Pakti i V...”, f.181.

*Përbërja e delegacionit të RPSH, Halim Budo, kryetar, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, kundëradmiral Hito Çako, anëtar, komandant i FLD, gjeneral Todi Naço, komandant i artilerisë së UPSH, kolonel Ernest Jakova, zëvendës Drejtor i Drejtorisë Operative të UP, Vasil Skorovoti, kryetar Dege në MPJ, ekspertë: kolonel Mendu Backa, Kap. Rang. II Mark Plani, nënkolonel Mitat Luçi, Kap. Ran. III Shefqet Pinari, Ndreçi Riza.

²¹ Po aty...fl.4.

Shqipëri u vu kusht për nisjen e bisedimeve.²²

Ndërsa pala shqiptare e zvarriste çdo ditë nisjen e punës, pala sovjetike kërkonte fillimin e menjëhershëm të saj. Duket sikur sovjetikët kishin ngut të iknin nga baza e Vlorës një orë e më parë. Padyshim gjendja e tensionuar në bazë ka qenë një arsye madhore për të shmangur konfrontimet e panevojshme. Gjendja në bazën e Vlorës ishte si në prag lufte. Komanda shqiptare e bazës dyshonte se ushtarakët sovjetikë mund të largoheshin nga baza fshehurazi. Këtë e dëshmon edhe biseda e zhvilluar në datën 2 maj mes komandantit të FLD, kundëradmiral Hito Çakos dhe këshilltarit sovjetik, Kap Rang. I Kulik.

Hito Çako- *“Në ditët e fundit nga ana jonë vrojtohen çfaqje të shumta për përgatitje të sforcuar për largimin tuaj nga baza e Pashalimanit. Këto veprime na detyrojnë të arrijmë në konkluzion se ju po mejtoni të largoheni arbitrarisht.”*²³

Bisedimet rifilluan më datën 22 maj. Pala shqiptare ju përmbajt argumentit se në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara asaj i lindte e drejta të kërkonte zbatimin e tyre. Kjo nënkuptonte mbajtjen e të gjitha nëndetëseve dhe të mjeteve të tjera luftarake. Për këtë qëllim ajo iu referua akteve të dorëzimit të gjitha mjetet luftarake.²⁴

Qeveria shqiptare harronte me vetëdije një fakt juridik shumë të rëndësishëm të sanksionuar në protokollet e marrëveshjeve se kalimi i nëndetëseve dhe mjeteve të tjera tek FARSH do të bëhej sipas një kalendarit pune të përcaktuar më parë. Ai do të fillonte në vitin 1961 dhe do të shtrihej deri në vitin 1965. Kjo ishte e lidhur ngushtë me përgatitjen e ekuipazheve. E drejta për diskutim lindte vetëm për 4 nëndetëset e dorëzuara në tremujorin e parë të vitit 1958, siç ishte parashikuar në marrëveshjen e vitit 1957.

Por në marrëveshjen e vitit 1957 fjala nuk del asgjekund “falas”. Kjo marrëveshje parashikon në nenin 3 të saj furnizimin pa shpërblim të anijeve, të armatimit etj, kurse kur flitet për nëndetëset përdoren fjalët “jepen” dhe “përdorim”. Që të dyja këto fjalë si nga pikëpamja kuptimore, ashtu edhe nga ana juridike nuk kanë kuptim të pastër pronësie. Në protokollin e datës 22 maj pala, shqiptare deklaroi se sipas marrëveshjeve në fuqi të cilat janë shumë të qarta, nuk kishte vend për kontestime.²⁵ Halim Budo paralajmëroi sovjetikët se heqja e të gjitha mjeteve luftarake nga ana e tyre e linte vendin pa mbrojtje, *“në rrezik të hapur nga imperialistët”*.

Por arsyetimi i tij u hodh poshtë nga Firjubini me argumentin se për shkak të gjendjes së krijuar, baza i kishte humbur aftësitë e saj mbrojtëse. Dhe për të treguar se largimi i anijeve nuk ishte shkak i rrezikut u shpreh se baza është e paaftë për të kryer detyrat, me anije ose pa anije, kjo është njëlloj.²⁶ Mendimin e tij e mbështeti admirali Sergejev. Ai iu referua raportimeve të incidentëve nga palët dhe bëri të qartë se *“nuk mund të flitet për ndonjë aftësi luftarake kur instruktori sovjetik e hap kapakun e nëndetëses dhe kërkon zbatimin e rregullores më elementare të anijes, kurse shoku shqiptar e mbyll.”*²⁷

Kryetari i delegacionit Firjubin ju kundërvu tendencës së delegacionit shqiptar për ta çuar bisedën tek pronësia e mjeteve luftarake, në fjalën e tij më 23 maj.²⁸ Aktet e dorëzimit nga ushtarakët sovjetikë tek ushtarakët shqiptarë, ai i mori si prova të mbërritjes së anijeve në Bazën e Vlorës në gjendje të mirë teknike. Gjithashtu akti i

²² *Po aty...*fl.9.

²³ AQFA, F.1460, V.1960, D.1, fl.99, Bisedime mes komandave datë 2 maj 1961.

²⁴ AMPJ, V.1961, D.42/6, fl.16, Deklaratë e H.Budos në mbledhjen e parë të komisionit datë 22 maj.

²⁵ *Po aty...*fl.33.

²⁶ *Po aty...*fl.34.

²⁷ AMPJ, V.1961, D.42/6, fl.84, Protokoll Nr.2.

²⁸ AMPJ, V.1961, D.42/6, fl.40, Bisedime të datës 23 maj 1961.

dorëzimit, sipas Firjubinit, ngarkonte me përgjegjësi palën që e kishte në përdorim mjetin luftarak për t'u përgjigjur për mirëmbajtjen e saj. Pra ky akt nuk nënkuptonte ndryshim të pronësisë së mjetit, por thjesht një kalim për përdorim sipas nevojave të ushtrisë shqiptare.

Në fakt nuk ka një marrëveshje dhurimi [blerje gjithashtu jo] që mund të mbështeste kërkesën shqiptare për pronësinë e mjeteve luftarake. Përderisa BS u investua ushtarakisht në ngritjen një baze sovjetike në gjirin e Vlorës, ardhja e këtyre mjeteve ishte logjike. Por ato nuk erdhën si mjete për zhvillimin e forcës ushtarake të Shqipërisë jashtë kontrollit të BS. Nëse do të ishte e pranueshme ideja e ndihmës ekonomike për Shqipërinë, ato mund të kishin ardhur shumë më herët anëtarësimit të saj në TV.

Argumenti tjetër që trajtoi Firjubini ishte mënyra e lëvrimit të këtyre mjeteve. Ai hodhi idenë se lëvrimi pa shpërblim dhe lëvrimit i tyre në pronësi të palës shqiptare kishte diferencë të dukshme juridike. Për ta mbështetur idenë ai solli argumentin se çështjet e pronësisë së anijeve dhe materialeve ushtarake ishin çështje mjaft serioze dhe për rrjedhojë ato nuk mund të liheshin rastësisht "në heshtje" në hartimin e marrëdhënieve të tilla.

Kjo do të thoshte sipas Firjubinit, se nëse BS do të kishte në plan t'i falte nëndetëset, akti zyrtar i faljes do të ishte shkruar ndryshe. Oficeri që i dorëzoi anijet do të ishte i autorizuar për t'i dhënë ato në pronësi të Shqipërisë me një akt dhurimi.²⁹ Por akti i marrëveshjes së datës 21 shtator 1958 vetëm specifikonte se "oficer detar sovjetik vetëm dorëzoi, ndërsa oficeri shqiptar i mori në dorëzim..."³⁰

Ky argument mund të quhet i drejtë po të kihen parasysh dy hipoteza që mund të ngrihen nga ky debat. Dhurimi i mjeteve të tilla luftarake kishte një kosto shumë e madhe ekonomike. Gjithashtu e madhe ishte edhe kostoja politike që buronte nga ky veprim. Të pajisje një vend tjetër me nëndetëse në kulmin e Luftës së Ftohtë kjo ishte shprehje e hapur e militarizmit të tij. Debatu më i ashpër mes SHBA dhe BS në këtë periudhë ishte pikërisht gara e armatimit. Kjo do të ishte një tezë shumë e pëlqyer për perëndimin për të sulmuar BS me të njëjtat armë që ai sulmonte. Pra armatosjen e vendeve satelite për qëllime revanshiste. Fshehja e qëllimit të vërtetë, pra pranisë së nëndetëseve si mjete luftarake të BS, mendojmë se ishte arsyeja kryesore përse kjo marrëveshje ishte me kaq ekuivokë, që u shfaqën sapo filloi kriza.

Firjubini ashtu si pala shqiptare përdori marrëveshjet për të kundërshtuar pretendimet e tyre për pronësi. Një ndër argumentet lidhej me mënyrën se si ishte formuluar neni nëntë i marrëveshjes së vitit 1959. Sipas këtij neni pala shqiptare angazhohej të mos i jepte armatimet, pajisjet që do të merren në bazë të kësaj marrëveshjeje, në shtete dhe persona të huaj fizikë e juridikë. Ky kufizim sipas Firjubinit do të ishte absurd nëse Shqipëria do të ishte pronare e këtyre mjeteve, "sepse pronari ka të drejtë t'i disponojë ato sipas pëlqimit."³¹ Gjithashtu përdorimi i anijeve nga pala shqiptare ishte i vlefshëm sipas Firjubinit për aq kohë sa ajo përmbushte detyrat për të cilat ato ishin dhënë. Qëllimi i tyre ishte sigurimi i zonës së gjirit të Vlorës, nga sulmet e NATO-s. Baza kishte humbur aftësinë luftarake, pas konflikteve sovjetiko-shqiptare. Mospërmbushja nga ana e Shqipërisë e detyrave ushtarake, për të cilat ishin dhënë nëndetëset, i hiqte të drejtën jo vetëm juridikisht, por edhe moralisht të përdorimit të këtyre anijeve.

²⁹ Po aty...fl.42.

³⁰ Po aty...fl.42, Firjubini ju referua një rregulli të vendosur si në ushtrinë sovjetike ashtu edhe në ushtrinë shqiptare. Të gjitha mjetet ushtarake si nëndetëset, anijet mbiujëse që kanë një vlerë të madhe jepen në përgjegjësi të këtij apo atij oficeri me akte. Kjo do të thotë që nga ai çast i marrjes në dorëzim ai mban përgjegjësi të plotë për ruajtjen e materialit të dorëzuar.

³¹ Po aty...fl.41.

Duke shkelur marrëveshjet e vitit 1957 dhe vitit 1959 pala shqiptare jo vetëm nuk mund të pretendonte të drejtën e pronësisë mbi këto mjete luftarake, por e privonte veten edhe nga e drejta për t'i përdorur ato.³²

Interes paraqet edhe argument i admiralit Sergejev,³³ sipas të cilit, qeveria sovjetike në krijimin e bazës së Vlorës ishte nisur nga parimi që t'i krijohej mundësia FLD sovjetike dhe shqiptare për të siguruar një bazë detare të avancuar në teatrin luftarak të detit Mesdhe dhe të sigurohej aftësia mbrojtëse BS. Pra Sergejevi e tha në mënyrë më të drejtpërdrejtë se territori shqiptar u përdor për interesat gjeostrategjike në këtë rajon. Për të hedhur poshtë pretendimet e palës shqiptare, Sergejevi iu referua gjithashtu faktit juridik se që të dyja marrëveshjet kishin një afat kohor të mirëpërcaktuar. Për rrjedhojë ai ngrii pyetjen për delegacionin shqiptar se *“si mund të pretendohet për pronësi me një afat të kufizuar.”*³⁴

Të gjithë argumentet e lartpërmendur e shtynin BS të kërkonte në mënyrë kategorike largimin nga Shqipëria të 12 nëndetëseve, 2 bazave lundruese, 12 anijeve mbiujëse, 22 anijeve ndihmëse etj. Të ndodhur përpara fakteve anëtarët e delegacionit shqiptarë provuan të luajnë me togfjalëshin “pa shpërblim” si dhe me ekzistencën e akteve të dorëzimit të mjeteve luftarake në momentin që ato kishin hyrë në territorin e Shqipërisë. Edhe pse Halim Budo e nisi deklarinimin e tij të datës 23 maj me pohimin *“se nuk e vëmë aspak në diskutim se ato janë ndërtuar me duart e punëtorëve sovjetikë”*³⁵ zgjidhja dukej shumë e vështirë dhe komisioni vërtitej në të njëjtat shtate, duke kaluar në momente të veçanta në sulme me karakter politik.

Debati i lindur për pronësinë e mjeteve luftarake zbuloi një tjetër “kleçkë” të bazës së Vlorës. A kishte apo jo njësi ushtarake sovjetike në Shqipëri? Ky debat lindi pas kërkesës së TV që baza të funksiononte vetëm me ushtarakë sovjetikë dhe të varej në mënyrë direkt nga Komanda e Bashkuar e TV. Mirëpo qeveria shqiptare një kërkesë të tillë e quajti shkelje të sovranitetit të vendit. Dhe mendojmë se kishte të drejtë. Një vendosje e trupave sovjetike pa praninë e trupave shqiptare do të ishte një pushtim i vetëpranuar i një territori shqiptar. Deri në pranverën e vitit 1961 trupat e vendosura në bazën e Vlorës ishin trupa shqiptare dhe trupa sovjetike.³⁶

E kemi trajtuar edhe në kapitullin e marrëveshjeve ushtarake tezën se krijimi i bazës së Vlorës i hapi rrugë stacionimit të trupave sovjetike në Shqipëri. Dhe ky stacionim ndodhi vërtetë duke filluar prej vitit 1957 ku krahas këshilltarëve ushtarakë erdhën dhe ekuipazhet e nëndetëseve dhe mjeteve të tjera luftarake, që u shtuan deri në vitin 1959 kur u nënshkrua marrëveshja e dytë për zgjerimin e bazës.

Manovra që pala sovjetike luajti në vitin 1957 ishte mospërmendja e këtij fakti në marrëveshje, duke i quajtur këta efektivë “instruktorë”³⁷ E interesuar që të mos bëhej e ditur prezenca ushtarake e saj në Mesdhe, pala sovjetike propozoi që ekuipazhet sovjetike të mbanin uniformën shqiptare. Ekzistenca e njësisve ushtarake sovjetike është e dukshme në hartimin e rregullores së 3 gushtit të vitit 1959.

Në këtë rregullore thuhet se *“detarët dhe oficerët e shërbimit të detyrueshëm mbajnë shenjat*

³² Po aty...fl.41.

³³ Po aty...fl.80, Protokoll Nr.2, datë 23 maj 1961.

³⁴ Po aty...fl.81.

³⁵ Po aty...fl.61.

³⁶ Në bazën e Vlorës në dy nëndetëse kishte ekuipazhe të përbashkëta. Nëndetëset e tjera kishin ekuipazhe sovjetike. Po kështu me ekuipazhe të përbashkëta ishte baza lundruese Tomori.

³⁷ Neni i 3, marrëveshja e vitit 1959 e përmendur më parë, dhe neni 5 i marrëveshjes së vitit 1959 ku efektivët sovjetikë cilësohen “me cilësinë e instruktorëve”, marrëveshje e përmendur më parë.

dalluese dhe lentet në kapele me mbishkrimet shqip sipas veshjes së detarëve të RPSH.”³⁸ Po aty bëhet dallimi me të ashtuquajturit “instrukturë”, të cilët do të mbanin uniformën që u takonte sipas kategorisë së shërbimit ushtarak të FLD të Detit të Zi. Për të mohuar këtë ekzistencë përdorimi i gjuhës ruse gjatë manovrave detare ishte konsideruar shkëlqje e rëndë nga përfaqësuesit sovjetik në bazë.

Në raportin e incidenteve një ndër ngjarjet që kishte cenuar sigurinë e bazës ishte pikërisht ajo e 29 dhjetorit të vitit 1960. Komandanti i gjuajtësit Nr. 500, Kap. Leit II Dino, i ishte drejtuar me megafon në gjuhën ruse, një anijeje italiane, pasi ajo nuk i ishte përgjigjur sinjaleve ndërkombëtare të dhëna nga gjuajtësi. Komanda shqiptare e justifikoi veprimin e oficerit shqiptar me faktin se gjuha ruse ishte një ndër gjuhët më të njohura në botë. Por thelbi i këtij incidenti ishte mosruajtja e sekretit ushtarak për praninë e efektivit sovjetik në bazën e Vlorës.³⁹ Por fakti që në raportet e Ministrisë së Mbrojtjes përmenden, veprimtari të ndryshme agjenturore të Perëndimit me fokus bazën e Vlorës, flet se ky fakt ishte i njohur.

Në mëngjesin e datës 24 maj duket se Moska kishte urdhëruar evakuimin sa më të shpejtë të trupave, pasi palët nuk po bënë asnjë përpjekje për të gjetur kompromis. Firjubini i deklaroi komisionit se pala sovjetike duke ngulur këmbë vendosmërisht për kthimin e të gjitha anijeve është e detyruar në kohën e tanishme të japë udhëzime për largimin nga gjiri i Vlorës vetëm të një pjese të anijeve.⁴⁰

Edhe kjo seancë u shoqërua me tensione. Firjubini i bëri të qartë delegacioni shqiptar, se fjalët e bukura për miqësinë ishin krejt në të kundërt deklarimet e udhëheqjes shqiptare mbi politikën e dëmshme të BS. Dhe jo vetëm kaq, por për Firjubinin këto sulme nuk ishin as befasi, as edhe të habitshme. “Ne e njohim këtë metodë që përdorni për t’ua hedhur fajin tuaj të tjerëve.”⁴¹ Ky mund të quhet një aludim i qartë për sjelljet qaramane të Enver Hoxhës tek sovjetikët sidomos për marrëdhëniet me Jugosllavinë. E megjë Enver Hoxha ishte shënjestra si projektues i kësaj çarje, ishte detyrë e palës shqiptare të bënte mbrojtjen e zjarrtë të Enver Hoxhës. Hito Çako u përbetua përpara delegacionit sovjetik se “shoku Enver nuk kërkon dhe as lejon të cenohet kjo miqësi.”⁴²

Seanca e fundit e kësaj maratone bisedimesh ishte ajo e datës 25 maj. Edhe kjo seancë nisi me ankesat e palëve. Një ditë më parë ishte rënë dakord që komisioni të vepronte në nivel ekspertësh në bazën e Vlorës⁴³. Krahas evakuimit të efektivëve sovjetikë do të bëhej dhe inventarizimi i mjeteve dhe armatimeve luftarake. Por sipas admiralit Kasatanov, një prej ekspertëve shqiptar, Kap. Rang. II Mark Plani kishte orientuar gabim ekspertët. Sipas këtij të fundit pajisjet që i përkisnin brigadës së nëndetëseve nuk do të merreshin të gjitha por vetëm minimumi i nevojshëm.⁴⁴ Ky nuk mendojmë se ka qenë një orientim i gabuar, por një përpjekje e shqiptarëve për të mbajtur sa më shumë nga baza materiale me të cilët sovjetikët i kishin furnizuar gjatë kohës së “artë.”

Pala shqiptare e konsideronte të domosdoshme mbajtjen e një pjese të teknikës për funksionimin e mëtejshëm të bazës. Kështu, Halim Budo propozoi që nëndetëset që

³⁸ AQFA, Fondi 100/3, V.1960, D.163, f.18, Rregullore: “Mbi mënyrën e dhënies ndihmë efektivit shqiptar..”

³⁹ AQFA, F.1460, V.1960, D.1, fl.94.

⁴⁰ AMPJ, V.1961, D.42/6, fl.100, Protokoll Nr.3, Gjithashtu shiko: Ana Lalaj, “Shqipëria: Nga Pakt i V...”, f.182.

⁴¹ Po aty, fl.106.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty...fl.110, komisioni i ekspertëve kryesohej nga admiralit Kasatanov për BS dhe kundëradmirali Hito Çako për palën shqiptare.

⁴⁴ Po aty...fl.118.

do të largoheshin të mbanin vetëm silurët që kishin në përbërje të tyre. Përsa i përket atyre që ishin në depo ato *“janë për bazën dhe janë të bazës”* u shpreh ai. Madje nga dëshpërimi ai ju drejtua delegacionit sovjetik me habi se si ata e pranonin lënien e bazës pa silurë. *“Po si mund të na lini neve pa silurë?”*⁴⁵

Komisioni gjithashtu kishte diskutuar edhe planin e evakuimit. Nga komanda sovjetike ishte kërkuar leje që largimi të ndodhte më 26 maj 1961, në orën 8.00 të mëngjesit. Por, duket se të papriturat ishin pjesë e kësaj situate amorfe. Në planin e evakuimit të komandës sovjetike nuk ishte parashikuar largimi i instruktorëve sovjetikë që shërbenin në ekuipazhet me efektivë të përbashkët.

Kjo mund të ishte një taktikë e fundit për të bërë të mundur kalimin e bazës në duart e sovjetikëve. Por largimi i tyre ishte domosdoshmëri pasi shumë prej incidenteve kishin ndodhur pikërisht në ekuipazhet me efektivë të përbashkët. Kjo kërkesë u konsiderua nga delegacioni sovjetik si një kërkesë e re, e pa trajtuar me parë, për të cilën duhet të diskutohej me qeverinë e BS. Debatu për instruktorët rikthehu edhe njëherë tensionet në punën e komisionit.

Firjubini: “Domethënë largimin e anijeve tona ju e lidhni me atë të instruktorëve?”

Halim Budo: Natyrisht. Siç e thamë ne s’jemi kundër largimit të tyre por këto janë të lidhura me njëra –tjetrën.

Firjubini: Ju vë në dijeni, shoku Halim, ne nesër në mëngjes anijet nuk do të jenë aty, por do të nisen.

Halim Budo: Mund të ikni, po në qoftë se do të largohen edhe instruktorët sovjetikë.

*Firjubini: Unë e përsëris nesër anijet ikin.”*⁴⁶

Me këtë dialog u mbyll ose më saktë u ndërpre puna e këtij komisioni. Firjubini njoftoi me anën e një letre zyrtare zëvendësministrin Halim Budo se në përputhje me afatin e koordinuar, 8 nëndetëse dhe baza lundruese Kotelnikov do të largohen nga gjiri i Vlorës në orën 8.00 të datës 26 maj të vitit 1961. Në orën 18.30, Halim Budo i kërkoi Firjubinit që bashkë me mjetet të largoheshin edhe instruktorët. Ai kërkoi gjithashtu dorëzimin e 20 silurëve dhe 50 detonatorëve⁴⁷.

Loja e acarimit të nervave deri në minutën e fundit ishte tipologjia e këtyre bisedimeve. Në orën 21.00 të mbrëmjes, Firjubini njoftoi Halim Budon se zëvendëskomandanti i flotiljes shqiptare Qamil Poda kishte refuzuar të jepte lejen për nisjen e anijeve sovjetike. Budo i quajti shpifje pretendimet e Firjubinit dhe i bëri të ditur se *“përsa i përket largimit do të veproni sipas letrës së orës 18.30.”*⁴⁸ Largimi i anijeve luftarake nga gjiri i Vlorës u bë më 26 maj, siç edhe ishte parashikuar. Ky akt shënoi likuidimin e bazës së Vlorës.

Në përfundim të këtij konflikti, duke u nisur nga faktet historike, konflikti për pronësinë e anijeve luftarake detare nuk u fitua nga asnjëra prej palëve. U bën një ndarje mes BS dhe Shqipërisë. Marina luftarake detare e Shqipërisë arriti të mbante katër nëndetëse dhe bazën lundruar “Nemiçov”, që i ishte dhënë emri baza lundruese “Tomorri”. Këto mjete luftarake ishin pjesë e marrëveshjes së parë të vitit 1957. Mendojmë se këto mjete nuk u kërkuan me forcë, pasi tashmë ato ishin plotësuar me efektivë shqiptarë. Nxitja e një konflikti të mëtejshëm, i kalonte caqet e mungesës së një klauzole juridike, siç ishte fakti që këto nëndetëse duhet t’i kthehesh BS në rast të një revokimi të marrëveshjeve siç ndodhi.[në nënshkrimin e marrëveshjeve prioritet

⁴⁵ *Po aty ...f.124.*

⁴⁶ *Po aty...f.129. Telegram i orës 18.30, Gjithashtu shiko: Ana Lalaj,“Shqipëria: Nga Pakt i V...”, f.182*

⁴⁷ *Po aty.*

⁴⁸ *Po aty...f.135.*

i ishte dhënë anës politike dhe ushtarake, jo juridike].

Bashkimi Sovjetik mori 8 nëndetëse dhe bazën lundruese "Kotelnikov". Ai mbajti gjithashtu dy gjuajtës luftarak që ndodheshin në Sevastopol për riparim. Të dyja palët vazhduan të kërkojnë të drejtën e pronësisë së mjeteve edhe pas vitit 1961. Madje qeveria shqiptare tentoi ta shtronte këtë problem edhe pas vitit 1990, kur në vend ndodhi ndryshimi i sistemit.⁴⁹ Mjetet luftarake që ngelën në Bazën e Vlorës, u bënë baza e Marinës shqiptare. Por ndryshimet që ndodhën në strukturën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë pas viteve 90-të, si dhe koha e prodhimit të këtyre mjeteve luftarake, bënë që ato të kishin një fund "pa lavdi", duke përfunduar për skrap.

⁴⁹ Ministri i Mbrojtjes Safet Zhulali, ngriti një komison pedagogësh të Departamentit të Historisë Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura për të shqyrtuar mundësinë e rimarrjes së këtyre mjeteve luftarake.

Vlerësimi i performancës në sektorin bankar

Msc Fatbardha Morina

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

Abstrakt

Banka ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Zhvillimi botëror ekonomik dhe financiar do të ishte thuajse i pamundur nëse sistemi bankar nuk do të ekzistonte. Sektori bankar në Shqipëri është karakterizuar nga ndryshime të rëndësishme strukturore, ku theksohet në mënyrë të dukshme rritja e numrit të bankarve, ristrukturimi dhe privatizimi i bankave shtetërore. Prandaj vlerësimi i performancës së këtij sektori është i rëndësishëm, pasi ky sektor mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri.

Ky punim përshkruan se cilët janë faktorët kryesor të cilët ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe performancën e bankave. Gjatë këtij studimi është përdorur analiza teorike dhe analiza e treguesve të publikuara nga Banka e Shqipërisë për të parë performancën e sistemit bankar dhe performancën e Raiffeisen Bank dhe Bankës Kombëtare Tregtare si bankat kryesore në treg. Gjithashtu është studiuar ndikimi që kanë aktivet fikse, shpenzimet operative dhe totali i depozitave në efikasitetin dhe performancën e sistemit bankar.

Shumë studime të kryera tregojnë për një përmirsim të performancës së sistemit bankar shqiptar, por është e rëndësishme të merren masa për sa i përket cilësisë së aktiveve.

Fjalët kyçe: performancë, kredi të këqija, ROA, ROE.

Hyrje

Sistemi bankar është një sektor i rëndësishëm në mbarvajtjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Rëndësia e këtij sektori bëhet akoma më e veçantë në rastin e një vendi në zhvillim siç është vendi ynë. Prandaj studimi i sektorit bankar është mëse i domosdoshëm duke qenë motorri kryesor i zhvillimit të ekonomisë së vendit. Ai përbën burimin kryesor të financimit të individëve dhe bizneseve, për vetë faktin se vendi ynë nuk ka një treg financiarë të zhvilluar. Duke qenë një vend i cili ka pësuar transformime të mëdha duke kaluar nga një sistem kapitalist drejt një ekonomie të tregut të lirë, sistemi bankar ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Prandaj themi se bankat janë institucione të rëndësishme në procesin e ndërmjetësimit dhe janë faktor i rëndësishëm në rritjen ekonomike, nga ana tjetër rritja ekonomike shoqërohet me zgjerimin dhe zhvillimin e sistemit financiar. Shqipëria ka një sistem financiar pothuajse tërësisht të bazuar në banka dhe vlerësimi i performancës së tyre është përcaktues i ekonomisë së vendit. Prania e bankave të huaja në Shqipëri ka ndikuar në përmirsimin e teknologjisë, aftësive administrative, know-how-n, duke rritur produktivitetin. Në fillim si pasojë e hyrjeve të bankave të huaja u duk një përmirsim i mjedisit konkurrues, ku bankat zgjeruan degët e tyre, duke ofruar më shumë shërbime dhe produkte bankare.

1. Analiza e sistemit bankar sipas literaturës kombëtare dhe ndërkombëtare
Bankat në ekonominë e vendeve në zhvillim kanë pasur një zhvillim në aspektin e aktiveve të tyre, depozitave, dhe bazës së kapitalit e cila është vendosur nga

marrvëshja e Bazel II, e cila ka udhëhequr shumë vende për ristrukturimin e sektorit financiarë. Me këtë rritje pritej një përmirsim i efikasitetit të këtyre bankave dhe ndikimi pozitiv në ekonomine e vendit të tyre e cila është evidentuar nga *Levine dhe Renelt (1992)* të cilët thanë se: "Zhvillimi në sektorin financiarë ka një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të vendit". Kjo pritet pasi bankat janë një burim kryesor financimi dhe pranimiti depozitash. Prandaj vlersimi i performancës dhe monitorimi i kushteve të tyre financiare është i rëndësishëm për aksionerët, depozituesit, qeverinë, agjentët rregullatorë, menaxherët, investitorët akademik dhe ato potencial. Në vlersimin e performancës efikente të bankave merren në konsideratë një numër kriteresh të tilla si: fitimi, likuiditeti, cilësia e aktiveve dhe qëndrimet ndaj strategjisë së menaxhimit të rrishtit. Sipas (Barr and Siems 1994) siç cihet nga (*Ayady, Adebayo and Omolehinwa 1998*) raportet nuk masin në mënyrë direkte aftësinë menaxheriale për të kthyer një sërë inputesh në një sërë outputesh. Koncepti i efikasitetit është përdorur për të karakterizuar përdorimin e inputeve për të prodhuar outpute. Sipas Forsuon dhe Hjalmarson (1974) efikasiteti është një pasqyrim i performancës gjatë procesit të transformimit të një sërë inputesh në një sërë outputesh. Autorët theksojnë se efikasiteti është një koncept relativ, ku performanca e një njësie ekonomike duhet të krahasohet me një njësi standarte. Identifikimi i një standarti duhet të përfshijë gjykimin e vlerës në lidhje me objektin e aktivitetit ekonomik. Megjithatë ekonomistët bëjnë ndarjen e efikasitetit ekonomik në dy komponent të veçantë: efikasiteti dhe efikasiteti teknike. Përcaktimi formal i efikasitetit teknike sipas Koopmans (1951) është: *Rritja e prodhimit të një outputi kërkon reduktimin e të paktën një outputi tjetër ose rritjen e të paktën një inputi tjetër*. Një bankë mund të jetë teknikisht efikente për arsye teknike të tilla si: trajnim dhe nivel të kapitalit human të ulët ose përdorim të një teknologjie të vjetëruar. Inefikasiteti-X (ose ineffikasiteti e kostos relative ndaj firmës me praktikën më të mirë) e firmës është përcaktuar si dallimi mes shpenzimeve të kësaj firme dhe firmës me praktikën më të mirë, e cila është e ngjashme në madhësi dhe në çmimet e inputeve (Leibenstein, 1966). Thelbi i kësaj ineffikasiteti, ndryshe nga ineffikasiteti teknike e cila rridhte nga nivelet e ulta të njohurive, kapitalit human apo teknologjisë së vjetëruar, është se ajo rrjedh nga *mospërdorimi efikent* i faktorëve dhe teknologjisë. Studimi i ineffikasitetit-X përpiket të kapë ineffikasitetin e një banke (kur jepen inputet, outputet dhe çmimet e tyre) relativisht ndaj bankave të tjera.

Performanca e bankës mund të përkufizohet si kapaciteti i bankës për të gjeneruar përfitime të qëndrueshme. Fitimshmëria është thelbësore për një bankë për të ruajtur vazhdueshmërinë e aktivitetit të saj si dhe për investitorët që të marrin fitime të drejta, por ajo është gjithashtu e rëndësishme për mbikqyrjen e saj. Fitimshmëria garanton një raport të aftësisë paguese më elastike, madje dhe në kontekstin e një mjedisi biznesi me rrisht (Banka Qëndrore Europiane, 2010).

Sipas McCloy, Campbell dhe Cudeck (1994), performanca përfshin veprime që lidhen me qëllimet individuale dhe organizative. Më konkretisht, performanca është e lidhur me aftësinë në kryerjen e punës (Somers & Birnbaum, 1998). Orpen (1985) ka raportuar se performanca është ndikuar nga karakteristikat e punës, perceptimi i roleve të punës, dhe mbështetje e perceptuar organizative duke përfshirë trajnimin dhe mësimin.

Sipas Yet (1996), e meta me e madhe e kësaj qasje është se ajo mbështet në vlersimin krahasues të treguesve të performancës, duke e krahasuar performancën e një bankë me një nivel ideal të performancës ose me bankën lider. Pasi këto standarte mund të jenë arbitrare dhe mashtrues. Për më tepër, Sherman dhe Gold (1985) theksuan se raportet financiare nuk marrin parasysh performancën në terma afatgjatë, dhe

mbledhin shumë aspekte të performancës të tilla si, operacionet , marketingu dhe financimi, duke fshehur shumë karakteristika të cilat duhet të ishin të dukshme. Sipas Zhang dhe Longyi (2009) e konsideron matjen tradicionale të performancës si të papërshtatshme, duke nxjerr në pah mangësitë si më poshtë:

1. I kushtohet vëmendje e veçantë treguesve financiarë, duke injoruar treguesit e paprekshëm.
2. Fokusohet shumë në analizën e kushteve të brendshme të veprimit duke përjashtuar faktorët e jashtëm.
3. E vë theksin në aktivitetet tradicionale , duke neglizhuar aktivitetet e paprekshme.

2. Skemat e incentivës së punonjësve

Krizat kanë theksuar rëndësinë e përfshirjes së matjeve cilësore të qeverisjes së bankës për të vlersuar performancën. Aspekte të ndryshme të qeverisjes së saj e influencojnë performancën. Çështja kyçe e qeverisjes përfshin balancimin e fuqive në nivelet e larta të menaxhimit. Kjo ka të bëjë me ndarjen e roleve midis shëfit të financës nga ai i rriskut, duke bërë në këtë mënyrë gadishmërinë për të zhvillime dhe sfida të ndryshme.

Vroom (1994) shqyrtoi studime që lidhen me efektet e grupeve, mbikëqyrjes, përmbajtjen e punës, pagat, dhe shtigjet e karrierës. Gjetjet përfshijnë: (a) punonjësit kryejnë punën më efektive nëse ato janë të lidhura me arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe (b) punonjësit kryejnë punën në mënyrë më efektive nëse shpërblimet përfshijnë paga, promovime, dhe njohje sociale.

3. Efiçenca e sitemit bankar në Shqipëri

Marzhi neto i interesave është një matës i efiçencës së bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar. Marzhi neto i interesave mund të llogaritet si diferencë e të ardhurave nga interesat /aktive mesatare që sjellin të ardhura, me shpenzimet për interesa /aktive mesatare që sjellin të ardhura.

Tabela 1. *Tregues të përfitueshmërisë nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative).*


Treguesit	Dhjetor `10	Dhjetor `11	Dhjetor `12	Dhjetor `13
Të ardhura nga interesat/aktivet mesatare që sjellin të ardhura (1)	8.11	7.78	7.73	7.32
Shpenzime për interesa /aktive mesatare që sjellin të ardhura (2)	3.78	3.57	3.72	3.42
Marzhi Neto nga Interesat (NIM) {(1)-(2)}	4.32	4.2	4.01	3.89

Rezultati financiar neto i sektorit bankar në fund të vitit ishte pozitiv, me një vlerë prej rreth 6.6 miliardë lekësh dhe me përmirësim në masën 74%, krahasuar me fitimin e vitit 2012. Të ardhurat neto nga interesat shfaqën një rënie të lehtë, ndërkohë që të ardhurat nga veprimtaritë e tjera u rritën me 1.14 miliardë lekë. Siç, shihet sistemi bankarë gjatë vitit 2013 ka pësuar një rënie të marzhit neto nga interesat kjo si pasojë e rritjes së kredive me probleme të cilat nuk i kanë siguruar të ardhura bankave.

Analiza e efijencës së sistemit bankar Shqiptar sipas ROE, ROA

Fitimi mund të matet përmes disa treguesve. Dy treguesit kryesorë janë:

- Kthimi nga kapitali aksioner (në %), ROE i cili mat raportin e fitimit neto vjetor kundrejt kapitalit aksioner të bankës. Kthimi nga kaitali aksioner arrin nivelin më të lartë gjatë 2010 e cila kap një vlerë prej 7.6% dhe më pas ja një trend rënës i cili arrin në 0.8% gjatë vitit 2011, Kjo ka ardhur si pasojë e rezultatit më të ulët financiar, ndërkohë që rritja e aktiveve ka pasur ndikim jo material.
- Kthimi nga aktivet mesatare (në %), ROA i cili mat raportin midis fitimit neto vjetor kundrejt mesatares së aktiveve totale të bankës. Kthimi nga aktivet mesatare është raporti i dytë më i rëndësishëm për matjen e performancës bankare. Aksionerët e bankës janë më pak të ndjeshëm ndaj ROA krahasuar me ROE , por gjithsesi ky



mbetet një parametër i rëndësishëm. ROA jep të dhëna mbi efijencën e përdorimit të aktivitet bankarë për të prodhuar fitim.

Grafiku 1. Treguesit e ROE dhe ROA

Performanca e Sistemit Bankar Shqiptarë gjatë viteve 2009-2013

Ekonomia Shqiptare duket me ritme të mira gjatë viti 2010. Por ritmet e rritjes filluan të dobsoheshin nga viti 2011 dhe në vazhdim. Këto ritme të ulta janë si pasojë e konsumit dhe e investimeve private të dobëta. Gjithashtu në këto vite për herë të parë rritja e stokut të kredive shënoi vlera negative, e cila tregon për një rritje të kredive që nuk performojnë mirë. Gjatë vitit 2013 inflacioni rezultoi 1.9%. Duke qenë se gjatë këtyre viteve kemi një dinamikë të dobët ekonomike dhe monetare, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare stimuluese, krahas ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Banka e Shqipërisë ka prioritet të punës së saj forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit. Politika e saj ka synim të sigurojë një sistem bankar Shqiptarë të mirëkapitalizuar dhe të mirqeverisura, me parametra të fortë financiare dhe me praktika të shëndosha për administrimin e rreziqeve.

1. Analiza e performancës bankarë sipas treguesve të aktiveve, depozitave, kredive, kapitalit aksioner.

❖ Analiza e aktiveve

Siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme nëse bëjmë një analizë të aktiveve themi se ritmet më të larta të rritjes i ka pasur gjatë vitit 2011 më rreth 13%, ndërsa gjatë

vitit 2012 ritmet e rritjes ishin më të pakta, prej 6%. Gjatë 2013 rritjet e aktiveve ishin vetëm 3.9% krahasuar me 2012 e cila tregon për një përmirsim të moderuar të aktiveve. Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 0.4% gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2013, në krahasim me normat 1.3% dhe 2.8% të regjistruara përkatësisht gjatë viteve 2012 dhe 2011¹. Plogështia e aktivitetit ekonomik u shkaktua kryesisht nga ecuria e dobët e investimeve dhe e konsumit privat, të cilat vijuan të vuajnë nga besimi i ulët i agentëve ekonomikë dhe nga kushtet e shtrënguara të financimit. Konsumi dhe investimet private nuk janë favorizuar edhe nga politikat konservatore të bankave ndaj kreditimit. (Sipas Tabelës 1)

❖ Analiza e depozitave

Sipas një analize horizontale të të dhënave të depozitave rezultoi se rritjen më të madhe e kanë pasur në vitin 2011, ndërsa gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013 rritja ka qenë 7.3% dhe 3.4% përkatësisht. Kjo rënie e ritmeve të rritjes së depozitave është si pasojë e normave të ulta të normave të interesit të depozitave që ofrojnë bankat. Kjo i ka shtyrë depozituesit të investojnë në instrumenta të tjera financiare. Ecuria e depozitave, gjatë këtij viti, është prekur edhe nga veprimtaria e institucioneve të reja financiare jobanka dhe nga prezantimi i instrumenteve financiarë afatgjatë², duke rezultuar tërheqës për individët. Ecuria e depozitave të individëve ka ndjekur një ritëm ngadalësues gjatë vitit 2013, duke shënuar një rritje prej 1.7% në fund të tij. Të nxitur edhe nga ulja e normës së interesit të depozitave në banka, individët kanë zhvendosur një pjesë të kursimeve të tyre financiare drejt këtyre institucioneve. Normat e interesit të depozitave kanë ndjekur një trajektore rënëse. Në fund të vitit 2013, norma e interesit për depozitat e reja njëvjeçare në lekë ishte 2.5%, kundrejt vlerës 5.2% të shënuar një vit më parë. Rënia e ndjeshme e interesave të depozitave në lekë ka reflektuar sinjalet e politikës monetare dhe ecurinë e likuiditetit në sistemin bankar. Të dy këta tregues kanë favorizuar reduktimin e interesave në lekë gjatë vitit, ndërkohë që normat e interesit të depozitave në euro janë shfaqur më të qëndrueshme. Në fund të vitit, norma e interesit mesatar për depozitat me afat në euro ishte 1.35% përkundrejt nivelit 2.3% një vit më parë.

❖ Analiza e kredisë për ekonominë.

Nëse analizojmë treguesin e kredisë për ekonominë gjatë viteve 2010 deri në vitin 2013 do të shohim se ritmet e kredisë janë të ulta dhe derisa përsojnë një rënie gjatë vitit 2013. Nga viti 2010 deri në vitin 2011 kishim një rritje të kredisë me 15.33% e cila tregon për aftësinë e bankës për të financuar huamarrësit. Portofoli i kredive në valutë është rritur me 26,7 miliardë lekë ose 8.45 për qind, gjatë vitit 2010. Rritja më e lartë evidentohet në tremujorin e katërt me rreth 12.5 miliardë lekë ose 3.8 për qind. Duket se ka pasur një tendencë në rritje për kreditimin e ekonomisë në monedhën lekë, duke qenë se në terma relativë rritja e këtij portofoli është më e madhe se e atij në valutë, me 10.7 për qind. Kredia e dhënë në lekë, në terma absolutë është rritur me 14.3 miliardë lekë ku, edhe në këtë portofol, rritja e tremujorit të katërt ka qenë më e larta me 5.6 miliardë lekë ose 3.9 për qind.³

Viti 2011 u karakterizua nga zhvillime mjaft pozitive përse i përket procesit të kreditimit. Sistemi bankar vijoi të kreditojë ekonominë vendase, me një ritëm rritjeje të portofolit të kredisë ndjeshëm më të lartë, krahasuar me një vit më parë. Portofoli i

¹ Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë 2013.

² Në muajin tetor të këtij viti u prezantuan në treg letrat me vlerë të qeverisë me afat maturimi 10-vjeçar në lekë dhe në muajin dhjetor ato me afat maturimi 2-vjeçar në euro.

³ Raporti vjetorë i Mbikqyrjes 2010.

saj u reduktua me 7 miliardë lekë gjatë këtij viti dhe në fund të tij është 1.2% më i ulët se në vitin 2012. Kredia në valutë ka vijuar të tkurret, duke shënuar një rënie vjetore prej 3.4% në fund të vitit. Krahas saj, kredia në lekë është ngadalësuar ndjeshëm në krahasim me një vit më parë - në fund të vitit 2013, rritja vjetore e saj qëndron në nivelin 2.2%. Ecuria e dobët e kredisë, gjatë vitit 2013, ka materializuar veprimin e njëkohshëm të faktorëve të ofertës dhe të kërkesës.

❖ Analiza e kapitalit aksioner.


Në fund të vitit 2010, kapitali aksioner i sistemit paraqitet në nivelin 93.1 miliardë lekë. Gjatë këtij viti, rritja e tij vlerësohet në 8.2 miliardë lekë (9.8 për qind), kundrejt rritjes 13.4 miliardë lekë (18.7 për qind) gjatë vitit 2009. Peshja e tij ndaj totalit të pasiveve përgjatë një viti është zvogëluar me 0.17 pikë përqindje, duke arritur në 9.4 për qind.⁴Nëse shohim tendencën e kapitalit aksioner ai pëson një rritje prej 4.5% gjatë 2011. Gjatë viti 2012 ai ka një rritje prej 4.7%. Gjatë vitit 2012 rritja e kapitalit aksioner ka qenë e njëtrajtshme dhe e shpërndarë në mënyrë pothuaj të barabartë përgjatë gjithë vitit. Gjatë viti 2013 kapitali aksioner ka pasur një rritje prej 1.47% e cila është shumë më e ulët se ajo në 2012.

Tabela 2. Treguesit e Performancës së Sistemit Bankar Shqiptarë

Treguesi	2010	2011	2012	2013
Aktivitet në total (miliardë lekë)	990.6	1,120.2	1,187.9	1,234.3
në % të PBB	80.1%	84.6%		
Depozitat në total (miliardë lekë)	816.7	924.1	991.7	1,025.5
në % të GDP	65.7%	69.8%		
Kredia për ekonominë (miliardë lekë)	490.9	566.2	577.8	567.15
në % të GDP	39.5%	42.8%		
Kapitali i aksionerëve (miliardë lekë)	93.1	97.3	101.8	103.307
ROE (in %)	7.6	0.8	3.8	6.4
ROA (in %)	0.7	0.1	0.3	0.5

Burim : Shoqata Shqiptare e Bankave, Raport i mbikqyrjes 2012

Grafiku 2. Treguesit e Performancës së Sistemit Bankar Shqiptar



⁴ Raporti vjetor i Mbikqyrjes 2010.

Cilësia e aktiveve të sistemit bankarë gjatë viteve 2009-2013.

Gjatë vitit 2010 rritja e kredive me probleme rezultoi me 21,4 miliardë lekë. Rritja në terma absolutë mbetet pothuajse në nivele të njëjta me rritjen gjatë vitit 2009 (20.8 miliardë lekë), por duke qenë se gjatë këtij viti, ritmet e rritjes së tepërisë së kredisë me rreth 40.9 miliardë lekë janë më të ulëta se në vitin 2009 (53.1 miliardë lekë), treguesi i cilësisë së kredisë paraqitet më i përkeqësuar, duke arritur në rreth 13.96 për qind nga 10.5 për qind në dhjetor 2009. Struktura e portofolit të kredive sipas klasave të cilësisë, në fund të vitit 2010, shfaq rënie të peshës së klasifikimit "standard" të kredive dhe rritje të lehtë të peshës së kredive të klasifikuara në klasën "në ndjekje". Ndërkohë, pesha e kredive me probleme ka ardhur në rritje nga tremujori në tremujor gjatë vitit 2010, duke rezultuar kështu dhe më e lartë se fundi i vitit të kaluar. Gjatë vitit 2011, kredia me probleme është rritur me rreth 37.73 miliardë lekë. Ritmi i rritjes së kredisë me probleme ka qenë më i lartë se ritmi i rritjes së tepërisë së kredisë së sistemit bankar, e si rrjedhojë evidentohet rritje e treguesit të cilësisë së portofolit të kredisë "kredi me probleme ndaj tepërisë së kredisë të sistemit bankar" me rreth 4.8 pikë përqindjeje, duke arritur në rreth 18.77%. Në fund të vitit 2011, analiza e strukturës së portofolit të kredisë sipas klasave të cilësisë, evidenton rënie të peshës së kredive cilësore kundrejt rritjes së peshës të kredive me probleme. Në portofolin e kredive cilësore, evidentohet rënie e kredive të klasifikuara "standarde" dhe rritje e lehtë e peshës të kredive të klasifikuara "në ndjekje". Ndërkohë, në portofolin e kredive me probleme, evidentohet rritje e peshës për të treja klasat, por rritje më e madhe evidentohet në peshën e kredive të klasifikuara "nënstandarde" dhe "të humbura". Gjatë vitit 2012, kredia me probleme është rritur me rreth 23.7 miliardë lekë. Ritmi i rritjes së kredisë me probleme ka qenë më i lartë se ritmi i rritjes së tepërisë së kredisë së sistemit bankar, e si rrjedhojë evidentohet rritje e treguesit të cilësisë së portofolit të kredisë "kredi me probleme ndaj tepërisë së kredisë të sistemit bankar" me rreth 3.7 pikë përqindjeje, duke arritur në rreth 22.5%. Kreditë, siç tregojnë shifrat, kanë rrezik të madh mosshlyerje ndaj bankat tona (që në fakt janë gati krejtësisht të huaja) s'kanë mundësi tjetër përveçse të ekspozohen së tepërmi ndaj qeverisë duke mbajtur mbi supë rreth 70% të borxhit publik ndërkohë që të gjithë investitorët e tjerë jo-shtetërorë blejnë jo më shumë se 17% të këtij portofoli. Një portofol kaq i njëtrajtshëm do skandalizonte çdo bankier evropian.⁵ Gjatë vitit 2013, kreditë më probleme janë rritur me 3.16 miliardë lekë nga viti i kaluar. Gjithashu pjesa që zëne kreditë e këqija ndaj totalit të kredive ka arritur në 23% duke treguar për një performancë jo të mirë të sistemit bankarë. Ndërkohë ulja e dërgesave të emigrantëve ka ndikuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në uljen e aftësisë paguese të klientëve shqiptarë pa lënë mënjanë uljen e madhe të ritmit të rritjes ekonomike të Shqipërisë, që ka sjellë zbehjen e dinamizmit të ekonomisë dhe operatorëve ekonomikë. Së fundi, një tjetër arsye është dhe detyrimet e papaguara të qeverisë ndaj bizneseve private për punët publike të kryera (Elvin Meka 2014). "Rritja e huave të pakthyera, e "kredive të këqija" është një thikë me dy presa: nga njëra anë shtrëngon gjendjen e likuiditetit në sistemin financiar, duke shkaktuar edhe shtrëngimin e kriterëve dhe kujdesin e bankave për huadhënie të mëtejshme, gjë që çon në nënfinancimin e ekonomisë në përgjithësi. Ka një lidhje shkak-pasojë mes huave me probleme dhe financimit të ekonomisë, e cila hyn në një rreth vicioz: mosfinancimi i ekonomisë nuk gjeneron likuiditet, investime dhe kërkesë konsumatore, që nga ana tjetër rrit vështirësitë në gjendjen e likuiditetit të klientëve dhe komprometon aftësinë e tyre paguese në banka, duke

⁵ Endrit Avdullari, Gazeta dita, "E keqja e kredive të këqija".

ushqyer akoma dhe më shumë portofolin e huave me probleme. Më tej, kjo gjendje ul fitimin e bankave dhe rrit kërkesat për kapital, duke i detyruar bankat të zgjedhin një alternativë investimi me më pak rrezik, siç janë titujt qeveritarë dhe mos i kanalizuar fondet drejt ekonomisë private, pra biznesit dhe individëve. Si rezultat rrezikohet rritja ekonomike” thotë Elvin Meka Dr. në shkencat ekonomike, kryeredaktor i revistës”Bankieri”. Prandaj rritja çdo vit e kredive me probleme mund të çoj në një situatë të vështirë financiare në Shqipëri.

Tabela 3: Klasifikimi i kredive


Klasifikimi i kredive	2009	2010	2011	2012	2013
Standard loans (në milionë lekë)	374.204,07	387.752,90	418.129,62	399.947,00	388.170,00
Në ndjekje (në milionë lekë)	28.569,71	34.597,98	41.877,25	48.042,82	46.001,00
Nënstandart (në milionë lekë)	21.330,24	30.290,43	52.664,15	56.066,27	43.180,00
Të dyshimta (në milionë lekë)	12.296,60	17.972,63	22.093,44	29.840,56	24.238,00
Të humbura (në milionë lekë)	13.490,55	20.255,68	31.452,67	43.919,71	65.570,00
Totali (në milionë lekë)	451.900,17	490.869,62	566.217,14	577.816,36	567.159,00

Burim : Shoqata Shqiptare e Bankave të përshtatura

Tabela 4. Klasifikimi i kredive të këqija në përqindje ndaj tepricës së kredisë.

Vitet	2009	2010	2011	2012	2013
NPL (milionë lekë)	47.117,39	68.518,74	106.210,27	129.826,54	132.988,00
Kredi të këqija/ Totalin e kredive	10%	14%	19%	22%	23%

Grafiku 3. Trendi i kredive të këqija




Faktorë që ndikuan rritjen e nivelit të kredive të keqija

Sistemi bankar përballet me disa probleme dhe sfida si: kreditë e këqija dhe problemet në procesin e huadhënies, kolaterali dhe problemet që ai shfaq, problemet e auditimit të brendshëm, shtrirja gjeografike e përqendruar e sistemit bankar, kultura ekonomike dhe lidhja me produktet e shërbimet bankare, parandalimi dhe pastrimi i parave, aspektet operacionale dhe mosfunksionimi i bursës së letrave me vlerë etj. Problemi më shqetësues është ai i huave me probleme, të cilat vijnë si pasojë e disa faktorëve si: problemet ekonomike të kredimarrësit, si pasojë e keqparashikimit për të ardhmen, abuzimi i kredimarrësit, abuzimi i analistit të kredisë dhe mosprofesionalizmi i tyre, dhënia pa kriter e kredive duke synuar maksimizimin e fitimit, mosha e re e sistemit bankar shqiptar, “korrupsioni” bankar, regjistri i kredive etj. Është thelbësore për suksesin afatgjatë të bankave ti japin një drejtim riskut të kredisë. Me nocionin risku i kredisë nënkuptohet mundësia që një huamarrës të dështojë në shlyerjen e detyrimeve ndaj huadhënësit, ose mund të thuhet që i referohet rrezikut që një palë në një transaksion të caktuar nuk do të jetë e aftë të përmbushë detyrimet kontraktore me një palë tjetër, ose do të jetë e aftë të përmbushë ato pjesërisht. Me risk të kredisë kuptohet pamundësia e kredimarrësit dhe e garantuesit të kredisë ose e kundërpartisë për aktivet e tjera, për të përmbushur detyrimet ndaj bankës sipas kushteve të marrëveshjes së lidhur mes palëve.⁶ Pjesën më të madhe të kredive të këqija e zënë kreditë e dhëna bizneseve dhe korporatave, të cilat përbëjnë rreth 79% të portofolit të kredive të këqija në krahasim me atë të dhëna individëve. Shkakët e rritjes së nivelit të kredive me probleme sigurisht i atribuohen si faktorëve të brendshëm, ashtu edhe atyre të jashtëm. Ku ndër faktorët e jashtëm kryesor, duhet përmendur kriza ekonomike, pasi modelet e riskut të kreditit në të cilat u zhvilluan portofolet, nuk e parashikuan gjatësinë dhe ashpërsinë e saj (Deloitte, “Non-Performing Loans in the Albanian Banking System”, mars 2013).


Performanca e Raiffeisen Bank , Banka Kombëtare tregtare

a) Përqëndrimi i bankave në sistemin bankar shqiptar

Sistemi bankar në Shqipëri ndikohet shume nga 6 banka kryesore. Bankat më të fuqishme në treg janë Banka Raiffeisen dhe Banka Kombëtare Tregtare. Nëse bëjmë një analizë të përqëndrimit të tyre në treg themi se pjesën më të madhe të tregun në depozita e zë Raiffeisen Bank me 26% e cila ndiqet nga Banka Kombëtare tregtare me 16%. Pozicionimi i Raiffeisen Bank si bank lider në treg ka ardhur si rrjedhojë e emrit të mirë që ka fituar në treg dhe si pasojë e besimit si një bankë e besueshme nga ana e klientëve.



⁶ Përkufizimi sipas rregullores 52 për administrimin e rrezikut të kredisë se Bankës së Shqipërisë.



b) Ecuria e performancës së bankave


Raiffeisen Bank

Me normat e interesit që i ka zbritur poshtë 1%, Banka Raiffeisen, më e madhe në vend për sa u përket aktiveve, duket se nuk ka qenë e interesuar gjatë 2013-s që të tërhiqte kursimet e shqiptarëve, (në linjë me strategjinë bankës mëmë për të ulur ekspozimin në tregjet e Europës Qendrore e Lindore) ndryshe nga bankat e tjera që kanë qenë aktive në këtë drejtim dhe kanë ndarë “tortën” e lënë nga Raiffeisen. Sipas të dhënave të detajuara nga Shoqata e Bankave, depozitat e Raiffeisen janë reduktuar me 38 miliardë lekë, apo 14% me bazë vjetore në 2013-n. Tkurrja e depozitave të Raiffeisen lidhet edhe me një strategji të bankës për të bërë një kalim nga depozita në “fondin e investimeve” që ka krijuar dy vite më parë, me synimin për të ulur vlerën totale të bilancit që e lejon të ketë kapitalizim më të vogël (një strategji e kërkuar nga banka mëmë në Vjenë). Siç shihet procesi i kreditimit ka në rënie të vazhdueshme edhe gjatë 2013.

Banka kombëtare tregtare

Banka që i ka rritur më shumë depozitat në vlerë absolute është BKT, që i ka shtuar ato me gati 20 miliardë lekë. Megjithatë, kjo bankë e uli kreditimin për ekonominë në vitin 2013, teksa e përqendroi investimin e parave të lira në letrat me vlerë të qeverisë. BKT, e cila deri dy vjet më parë kryesonte rritjen e huadhënies për ekonominë në vend, për herë të parë ka ulur stokun e kredisë për bizneset e individët, teksa është përqendruar në blerjen e letrave me vlerë të qeverisë. Sipas të dhënave të Shoqatës së Bankave, stoku i huas së kësaj banke është tkurrur lehtë me 147 milionë lekë, me bazë vjetore. Gjatë vitit 2013 shihet se BKT-ja ka pasur një rënie të kthimit nga aktivet që tregon se nuk po i përdor me efikasitet aktivet. Gjithashtu edhe kthimi nga kapitali ka pësuar një rënie. Pavarësisht nga mjedisi i një tregu në stanjacion në vitin 2013, BKT vijoi rritjen e bazës së kredisë për individët, e cila arriti në 253 milionë dollarë amerikanë, me 18% rritje nga viti paraardhës. Në segmentin e kredive për individët, pjesa e tregut e BKT-së u rrit me 2.7 pikë përqindje, duke arritur nivelin e 18% dhe duke marrë pozicionin lider në këtë aspekt në gjysmën e parë të vitit në Shqipëri.

	Aktivet			Huatë			Investimi në letra me vlerë		
	T IV 2012	T IV 2013	Ndyshimi në %	T IV 2012	T IV 2013	Ndyshimi në %	T IV 2012	T IV 2013	Ndyshimi në %
R a i f - feisen	317323	290561	-8,4	135047	127997	-5,2	122818	109766	-10,63
BKT	247404	272543	10,2	90415	90268	-0,2	90844	117308	29,13



Konkluzione

- Hyrja e bankave të huaja ka nxitur zhvillimin e sistemit bankar duke bërë që të rritet konkurenca midis bankave, dhe kjo ka bërë që të kemi një përmirsim të efikasitetit dhe të ofrimit të shërbimeve më të mira bankare, për vete faktin se ato kanë financuar biznese të cilat çojnë në rritjen ekonomike.
- Sistemi bankar shqiptar ka pasur një ecure pozitive gjatë viteve 2009-2013, por ritmet e zhvillimit kanë qenë të ngadalta. Kjo tregohet nga raportet e mbikqyrjes si dhe nga raportet e bankës së Shqipërisë, të cilët tregojnë për një rritje të nivelit të aktiveve gjithashtu kemi një rritje të kthimit nga kapitali, dhe kthim nga aktivet, por ritmet e tyre të rritjes reflektojnë një ngadalsim të sistemit bankar.
- Bankat në Shqipëri janë përballur me një sërë problemesh dhe sfidash ku ndër më kryesoret përmendim rritje të vazhdueshme të portofolit të kredive të këqija duke u bërë një problem shqetësues për ekonominë e vendit. Kjo ka bërë që të ulet procesi i kreditimit të bizneseve duke ulur investimet dhe ulja e investimeve bën që të bie produkti i brendshëm bruto.
- Nëse shohim bilancet e bankave vëm re se kemi një rritje të kolateralit që është sekuestruar nga banka dhe kjo shpesh herë bëhet burim abuzimi duke u shitur më lirë dhe duke rrezikuar tregun e pasurive të paluajtshme.
- Një problem tjetër tepër shqetësues është mungesa e profesionalizmit nga ana e audituesve të cilët duhet të jenë të pavarur dhe duhet të paraqesin situatën reale të bankave.
- Gjatë viti 2013 sistemi bankar nuk e ka luajtur rolin e saj në ekonomi, atë të kreditimit të bizneseve dhe individëve, por ka investuar në aktivitete më të sigurta ndonse më norma më të ulta interesi.

Rekomandime

- Sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 16 banka të cilët e shtrin aktivitetin e tyre në të gjithë Shqipërinë, por vetëm 5 banka janë ato të cilat mbizotrojnë tregun duke bërë që mjedisi konkures ti favorizojë këto banka dhe konkurenca të zhvillohet midis bankave të tjera.
- Ristrukturimi i procesit të kreditimit me qëllim që të shmangët rritja e mëtejshme e kredive të këqija. Marrja e masave me qëllim që të bëhet pastrimi i bilanceve nga

kreditë e këqija dhe përmirsim i sistemit fiskal në lidhje më nxjerrjen jashtë bilancit të kredive të këqija.

- Përmirsim i kapacitetit teknik dhe strukturës së menaxhimit të rrishtit. Trajnim i vazhdueshëm i stafit në lidhje më procedurat e miratimit të kredive . Duhet që bankat të punësojnë punonjës profesionist, sidomos analistët e kredive, dhe ti motivojnë ata. Në këtë mënyrë, do të ulet korrupsioni bankar dhe abuzimi i analistëve, ç'ka gjeneron kredi të këqija.
- Gjithashtu duhen shtuar kontrollet mbi njësitë që janë përgjegjëse për procesin e kreditimit
- Duhet të bëhen përmirsime në lidhje me normat e interesit të depozitave pasi gjatë viteve të fundit kemi një rënie të tyre.
- Diversifikim i portofolit të kredive në mënyrë që të ulet rreziku i dështimit të tyre në një sektor të vetëm.
- Është thelbësore për suksesin afatgjatë të bankave ti japin një drejtim rrishtit të kredisë.

Bibliografia

- Allen L. and Rai A. (1996) —Operational Efficiency in Banking: An International Comparison, *Journal of Banking and Finance* 20. Pp655-672.
- Banka e Shqipërisë (2011), Raporti Vjetor 2010, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2012), Raporti Vjetor 2011, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2013), Raporti Vjetor 2012, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2014), Raporti Vjetor 2013, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2011), Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare 2010, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2012), Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare 2011, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2013), Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare 2012, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Banka e Shqipërisë (2014), Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare 2013, Banka e Shqipërisë, Tiranë.
- Bikker, J.A. (2010), "Measuring Performance of Banks: An Assessment", *Journal of Applied Business and Economics* vol. 11(4) 2010, 141-159.
- Europa Central Bank, "Beyond ROE – How to measure bank performance", 2010.
- Deloitte " Non-Performing Loans in the Albanian Banking System", mars 2013.
- Farrell, M.J. (1957), "The Measurement of Productive Efficiency", *Journal of the Royal Statistical Society*, Series A, 120 (3), 253-281.
- Hawkins J and Mihaljek D, " The banking industry in the emerging market economies: competition, consolidation and systemic stability - an overview", *BIS working paper*, no 4.
- Kalluci I, " Analiza e sistemit bankar shqiptar nën këndvështrimin rrezik-performancë", Banka e Shqipërisë, 2011.
- Kristo S, Lati L, Tushaj A, " Konkurenca në sistemin bankar shqiptar-vëmendje e kërkuar", *Revistë ekonomike katërmujore*, prill 2008.
- Saha Aand T.S. Ravisankarb, "Rating of Indian commercial banks: A DEA approach", *European Journal of Operational Research* 124 (2000) ,187-203.
- Shoqata Shqiptare e Bankave [http:// www.aab.al/](http://www.aab.al/)

Disa vërejtje në përkthimin e veprës së Oscar Wilde “Portreti i Dorian Greit”

Nikoleta Kalldrëmxiu

Analizë

Përkthimi është një proces mbresëlënës që i ngjashëm me kritikën letrare bëhet në vetvete shtojcë e veprës së krijuar. Përkthimi pasuron gjuhën tonë dhe dëshmon për potencialin e kësaj të fundit. Puna e përkthyesit është ajo e njohësit të mirë të kulturës dhe gjuhës së të paktën dy popujve. Përkthyesi zotëron kulturën të interpretojë shenjën gjuhësore si palimpsest gjuhësor, ku presin të dalin në pah si arti ashtu edhe dija të bashkuara në një të vetme.

Secila gjuhë ka identitetin e saj, tiparet e saj krejt të veçanta. Por kjo nuk e bën përkthimin një veprimtari të frikshme dhe të pazeaurueshme. Përkundrazi larmia e mendimit dhe e formës gjuhësore është një përvojë, në mos një profesion i bukur. Përvoja e e përkthimeve është një dëshmi e mundësive që ofrojnë gjuhët për t’u transmetuar te njëra tjetra. Objekti i punës së përkthyesit, siç edhe do ta ilustrojmë më poshtë nuk janë përkthimi i fjalëve, lokucioneve apo strukturave të veçanta të shkëputura nga konteksti dhe rrethanat ligjërimore. Vëmendje nga ana e përkthyesit i kushtohet përqendrimit në thënien kryesore, i unitetit global të kuptimit^[1].

Pa u zgjatur te metodat e sotme të përkthimit si një veprimtari me interes në rritje në këtë mëtim të shkurtër do t’i drejtohem vetëm një lloj përkthimi, që është ai artistik i cili shkon gjithmonë paralelisht me problemin e besnikërisë me origjinalin. Fakti që duhet të sjellësh një vepër letrare nga gjuha burimore lidhet si me talentin artistik të përkthyesit ashtu edhe me punën e tij si studiues. Përkthyesi i ndarë midis botës akademike dhe asaj të letrave, mbetet krijuesi i një ndërthurjeje tërheqëse të dyjave, Ai përcjell pavarësisht ngarkesës “Papërkthyeshmërisë linguistike” dhe “Papërkthyeshmërisë kulturore”, qasjen e dy botëve që i bashkon universaliteti njerëzor dhe për sa kohë ka parametra të afërt edhe ai gjuhësor.

gjithkush një njuh më shumë se një gjuhë të huaj e di se midis gjuhëve ka ndryshime sikurse ka edhe ngjashmëri. Më tej gjuhëtarët kanë përpunuar parime universale që vlejné për të gjitha gjuhët[2], d.m.th në çdo gjuhë veç parimeve universale veprojnë dhe rregulla të veçanta. Pra ka parime dhe parametra. Pa dashur të lodhim atë që lexojmë por për ta nxitur lexuesin të mendojë se përkthimi nuk është një veprimtari thjesht artistike, do të japin disa shembuj ku ilustrojmë se si duke ruajtur kuptimin kemi realizuar rregullat e ndryshme që ofron gjuha dhe mundësitë e secilës për t’u shprehur. Së dyti, do të përmendim rolin e sinonime në përkthim, si dhe vlerën e tyre stilistike. E treta, lidhet me realizimin e konceptit meqenëse ai është edhe qëllimi final i çdo krijimi artistik, të ndikojë dhe të formojë kulturën e lexuesit.

Vepra e zgjedhur për qëllimin e mëtitimit është romani i njohur i Oskar Wilde “Portreti i Dorian Greit”, i cila bën lidhjen midis objektit *bukurisë* dhe shprehjes së saj të mirës apo *shëmtimit*; *afësisë së objektit Bukurisë për të prodhuar ndjesi të jashtëzakonshme. I ndikuar tërësisht nga hedonizmi*, autori ka vendosur bukurinë fatale si prodhim i kësaj doktrine, të jetuarit veçse për kënaqësi. Edhe kjo fjalë nuk zë vend në fjalorin e gjuhës shqipe, kur edhe mund të zinte vend sepse hedonika zë vend sot si degë e psikologjise dhe e etikës.

Termi gjuhësor që do të ndeshim më shpesh është konotacioni I cili te leksikologjia angleze shërben për të shmangur paqartësinë apo dykuptimësinë e termave të tillë si “nuancë kuptimore”. Duhet thënë se “konotacioni tregon ato aspekte të kuptimit të cilat nuk e cenojnë referencën apo denotacionin e fjalës, por ka të bëjë me faktorë dytësorë, si forca emocionale, niveli i formalitetit, karakteri eufemistic etj³”.

Sa më bukur zgjidhet fjala aq më tepër efekt ka ajo te lexuesi. Fabula e romanit ilustron vargjet e një autoriteti tjetër të fortë në fushën e letërsisë Sh. Bodler: “Oh, buhuri... ti nxit në krim të ulët ose ngjall lumturi”.

Vëmë re se edhe në përkthimin e Bodlerit autori ruan fjalën *bukuri* të shqipes edhe në rastin e efektit negative të saj. Ky efekt sqarohet nga konteksti.

Pse zgjodhëm veprën e Oscar Wilde “Portreti i Dorian Greit” dhe jo një vepër tjetër ose së paku jo një vepër tjetër të tij siç është “Rëndësia e të qenit i ndershëm”,^{4[3]} ku mund të duken disa vështirësi në përkthimin që në titull të veprës, për shkak të mungesës së emrit të përveçëm në shqipe.

“Portreti i Dorian Greit” është përkthimi im i parë në gjuhën angleze dhe ka qenë literaturë e detyruar për nxënësit e shkollave të mesme, të cilët sot, besoj, bëjnë leximin dygjuhësh të tij, Si i tillë disa shpjegime të saj do t’i vlenin si mësuësve dhe nxënësve të shkollës së mesme ashtu dhe përkthimtarisë në përgjithësi. Duhet thënë se kjo vepër ka edhe një përshtatje të realizuar për nxënësit e shkollës 9 - vjeçare me pak faqe dhe e pajisur me pyetje për të realizuar kuptimin.

Shpesh në gjuhën burimore autori transmeton nuancat më të holla të kuptimit dhe shpesh ky efekt qëndron prapa këtyre nuancave të holla. Sinonimia, edhe pse me karakter universal, shfaq veçantie e saj në gjuhë të ndryshme si pasojë e ndërveprimit të faktorëve të tillë si huazimi, neologjizmi, variantet gjeografike, sqarimi çifteve gjegjëse sinonimike jo gjithmonë në përkthim realizohen si të tilla. Në gjuhën angleze një problem përbën gjetja e gjegjëseve të cifteve që përshkruajnë kundërvënien formale -joformale,

Thamë se kjo kundërvënia është dalluar gjatë përkthimit në vargun sinonimik chap~fellow ~man ~gentelman, dhe në vepër është shprehur me vargun sinonimik çunak~djalë~burrë~zotëri aty ku emri nuk ka dalë I shoqëruar me mbiemra.

Sic e dimë gjuha shqipe, falë sinonimisë së saj të zhvilluar, ofron mundësi për të shfrytëzuar këto marrëdhënie për një përkthim sa më të përshtatshëm. Ndaj edhe në këtë studim ajo do të silltet edhe si burim i stilit, ashtu edhe i konotacionit

Pranëvënia e sinonimeve pranë njëra- tjetrës, kur ata vetë dallohen nga shkalla dhe intensitetit është një mjet stilistik, i cili përdoret shumë edhe nga shkrimtarët tanë, p.sh te I. Kadare. Disa përmendin princa të kahershëm, të tjerët këmbëngulnin se ishin më të mocme se princat (I. Kadare. Prilli i thyer)

Samara i kushton një vëmendje të veçantë vargut të fjalëve sinonimike, I cili përdoret për të rritur nivelin e shprehjes, shkallën e intensitetit të veprimit.

Shembull të tillë e gjejmë edhe te Wilde[4]: *Some rascally adventurer; some Belgian brute ca aventuriera faqezinj, ca belgjianë kriminelë.*

Në rastin tonë *brute* gëzon konotacion emotiv, lidhet me emocionin e diçkaje të egër të pështirë që e gjejmë veçse te kafshët. *brute* në një përkthim fjalë për fjalë do të ishte *shtazë*. Zgjedhja kriminel i shkon çiftit sinonimik kriminel ~shtazë duke e pasuruar në këtë mënyrë vargun sinonimik të fjalëve.

Në të njëjtën mënyrë është vepruar për *rascally*~ maskarenj~ faqezinj duke e shtuar

intensitetin e përskrimit të vrasjes së babait të Dorian Grait.

Po të marrim çiftet sinonimike *love* dhe *adore* të cilat në anglishte sikurse edhe në shqipe dallohen nga shkalla e intensitetit, ku e para është asnjë dhe e dyta shpreh edhe pasionit, në veprën artistike është ruajtur ky dallim duke mos i zëvendësuar ato me një fjalë të vetme.

Ajo që duam të vërejmë është se aty kemi një shembull ku *adore* vlen të shpjegohet përse i përket nivelit të informalitetit, ku ajo shpreh një vlerësim të përgjithshëm jodiskriminues: *I adore simple pleasures~ unë adhuroj kënaqësitë e vogla (fq 47) ose Unë i vlerësoj kënaqësitë e vogla.*

Në të dyja rastet edhe shpjegimi dhe sinonimia do t'i shkonin për shtat pasurimit të një fjalore shpjegues apo sinonimik të gjuhës shqipe.

Shkalla e intensitetit të një veprimi që realizohet nëpërmjet sinonimisë del me një shembull të tillë si

Vepra e cila ngarkohet e gjitha prej humorit dhe do të duhej një studim më vete për të parë mënyrat e realizimit të saj *etj) përdorimi i foljes blush nënkupton se kjo vjen si pasojë e turpit dhe e sikletit, si p.sh;*

For the future I shall be able to look her in the face without a blush." Në të ardhmen do ta shoh në sy pa u skuqur/a faint blush colored his cheeks for a moment, and he started up. "

Në të gjitha këto raste fjala ka kuptimin asnjë të saj dhe kjo është ruajtur prej përkthyeses. Por në rastet që kjo nuk është e mundur

Por për të zbrëthyer humorin në dialogun e Wilde ku thuhet:

"A blush is very becoming, Duchess," remarked Lord Henry.

E skuqura është shenjë e mirë^[5]. është përdorur antonimia e kuptimit duke i shtuar shpjegimit të kësaj fjale, si shenjë e zemërimit dhe e turpit. Fjala *shenjë* është kaq e zakonshme për të përkufizuar gjuhën e shenjave.

Variantet semantike që dallohen nga konotacioni vlerësues, i cili shpreh kryesisht një qëndrim pozitiv ose negativ që përfohet nga folësi tek referenti. Kështu kemi çiftet sinonimike *notorious* dhe *famous*, bile dhe *infamous*, ku e para trasmeton një ndjenjë negative dhe përcmimi për personin që flitet.

His extraordinary absences became **notorious**, and, when he used to reappear again in society, *Kur mungesa e tij në shoqëri bëhej e pajustificueshme* ku negativiteti është shprehur nëpërmjet parashtesës *pa* dhe kuptimi i *famëkeqes* që është përkthimi i drejt-përdrejtë i saj tregon se diçka e keqe ndodhte teksa Gray nuk shfaqej në shoqëri.

Kjo tregon se gjuha në mos ka fjalë, ka larmi mjetesh për të përcjell të njëjtin kuptim apo të njëjtin mesazh. Parashtesa - *pa në gjuhën shqipe ka kuptim privativ dhe antonimik*. Studiuesit e kanë trajtuar njohjen e fjalës si pjesë e përvetësimit të fjalorit dhe formimit të koncepteve. Kjo njohje nënkupton: Aftësinë për ta kuptuar fjalën kur është e nevojshme

Aftësinë për ta lidhur fjalën me një objekt apo me një dukuri.

Fjala *bukuri* apo mbiemri *i bukur* është koncepti që gjen ndoshta referencë më të denjë në botën reale. Si diçka që materializon, vesh përmbajtjen tonë natyrisht meriton një zbrëthim të mëtejshëm. Vetë koncepti i bukurisë te Wilde do të duhej t'i besojë një artikull më vete, pasi është të parit e saj si diçka sipërfaqësore, mbivlerësim, teprim i forcës dhe kënaqësisë që rrjedh prej saj që shkakton tragjedinë e personazhit të tij. Bashkëlidhur me këtë artikull një ese për të bukurën dhe punën që na bën gjuha^[6]

,megjithëse ne kemi qëllimin të shohim se si është realizuar përkthimi nga pikëpamja e mjeteve gjuhësore vazhdojmë të japim disa shembuj që përkojnë me rolin e çifteve sinonimike

Beauty ~wonder ~charm.

Vetë personazhi kryesor një i ri me bukuri të pazakontë njihet si princi Magjepsës, e cila mund t'i shtohet vargut të sinonimeve të fjalës bukuri si sharmë ose magjepsje *Konotacioni i tipareveshoqërues mund të gjendet te grupi sinonimik Beautiful-handsome-pretty* ku secila prej tyre përshkruan një lloj të veçantë të bukurisë njerëzore: *beautiful* lidhet me përsosmërinë, *handsome* me bukurinë mashkullore, ndërsa *pretty* lidhet kryesisht me *diçka delikate e zakonshme për të përshkruar bukurinë femërore.*

Me mjete të tjera të gjuhës është përkthyer nga gjuha burimore

a) përdorimi i *nyjës të gjinisë mashkullore dhe femërore në vend të mbiemrit*

Disguised as a pretty boy ~e maskuar si djalë me rroba dhe kapele kalorësi (fq 55)

në vend të ; *e maskuar si djalë faqepadirsur se nga vetë përdorimi i nyjës së gjinisë femërore konteksti e shmang përdorimin e epitetit.*

Përdorimi nyjës së gjinisë mashkullore për ta përshkruar këtë lloj bukurie.

He äas flushed ëith excitement and pleasure, and looked extraordinary handsome./Ai u skuq nga kënaqësia dhe ashtu dukej shumë i bukur (fq 101)

, as one who was "caressed by the Court for his handsome face, which kept him not long company." /Që e kishte dashur gjithë oborri mbretëror për bukurinë e tij, por jo për shumë kohë (fq 179)

He was certainly wonderfully handsome, with his finely curved scarlet lips, was there, as well as. /Ishte kaq i bukur me buzët e kuqe të skalitura,. fq34

Përkthimi duke ruajtur çiftin sinonim të mbiemrave në shqipe; I bukur ~simpatik

How proud and **handsome** he was, with his chestnut curls and insolent pose! ëhat passions had he bequeathed? /Sa krenar e **simpatik** ishte me kacurrelat dhe pozën e tij mendjemadhe

b) Përdorimi i përemrit një në kuptim përcmues

They say he has sold himself to the devli for a pretty face/la ka shitur shpirtin djallit për atë fytyrë të bukur fq 235 ose për një fytyrë të bukur në vend të përkthimit fjalë për fjalë ... për një fytyrë vajze

What are you now? A third-rate actress with a pretty face/ një aktore e dorës së fundit me një fytyrë të bukur.

c) Për qëllime stilistike

his guardian's wife, a pretty professional invalid who had spent the preceding winter in Cairo, gruaja e tutorit të tij një invalide e zonja dhe e bukur që e kishte kaluar dimrin e kaluar në Kairo

në vend të : *një gruaja simpatike është përdoruar e bukur për të theksuar humorin e Eilde në përshkrimin e cilësive të gruas.*

c) Përdorimi i frazeologjisë

It was not conscience that made me do so: it was a sort of cowardice. I take no credit to myself for trying to escape." "Conscience and cowardice are really the same things, Basil. Conscience is the trade-name of the firm. That is all. S' ishte ndërgjegjja që më la të veproja, por një lloj frike. S'ia fal vetes që u përpoqa t'ia mbathja. Frika dhe vetëdija janë pothuajse e njëjta gjë. **Frika e ruan vreshtin.** Kjo është proverbi shqiptare që ka zëvendësuar përkthimin fjalë për fjalë: *vetëdija është vetëm etiketa e mallit frikë.*

Krijesa që përshkruhet si e bukur si simbol i përsosmërisë është Margaret Deveruks dhe Doriani nga Sibill Vein ku është marr parasysh perceptimi delikat i vajzës që vlerëson si përsosmërinë fizike ashtu edhe atë morale.

She said that he was **very earnest** and had a **beautiful** nature. *Ai është shumë i ciltër dhe me një natyrë të butë.*

Në një fjalorth brenda librit bukuri do të ishte paraqitur kështu:

Bukuri ~emër~ 1. * 1. shumë e këndshme për t'u dëgjuar dhe për t'u parë që kënaq syrin dhe mendjen 2. Që josh, tundon apo nxit veprime dhe ndjenja të kundërta 3. Nevojë për çlirim dhe energji të tona mendore dhe shpirtërore 4. Mrekulli 5. E ndryshme nga mendimi dhe materiale 6. përsosmëria morale dhe fizike krijesë e bukur

Një veprim tjetër ruajtja e korrespondenca në përkthimin e fjalëve të huazuara dhe atyre në gjuhën angleze. Happiness ~felicity/ holy ~sacred/ wish~desire/ need~ require etj.

I, e bukur mbiemër

Bukuria dhe shëmtimi janë tema të zakonshme në letërsi. Tema e dashurisë dhe e pasionit, ndërgjegjes dhe frikës, çunakut dhe zotërisë gjithashtu kanë gjetur një shpjegim gjuhësor

Kuptohet që përfitimi do të ishte më i madh për nxënësit e shkollës së mesme të cilët formojnë kulturën e tyre gjuhësore dhe letrare. Lidhur me teknikat e përkthimit, ky është një përkthim që i ka qëndruar besnik origjinalit në domethëniet dhe mesazhet dhe veçanërisht në evidentimin e vlerave të gjuhës shqipe.

Kjo do t'i orientonte nxënësit drejt në formimin tyre gjuhësor dhe letrar, por mund të shërbej si udhëheqës në veprimtaritë e tyre të mëtejshme sipas rubrikave të caktuara. Po sjell dy mundësi aktiviteti që i shërbejnë gjuhës shqipe. P.sh:

Gjeni një titull alternative për veprën. Krahasojeni titullin që gjetët me origjinalin ose me atë të shokëve tuaj.

Grumbulloni koncepte të tjera në vepër dhe renditni si sinonime të fjalës

Shpjegimet e hollësishme natyrisht i shërbejnë pasurimit të fjalorit nga ana e nxënësit dhe qartësisë dhe pavarësinë e mendimit të tij. Ato e ndihmojnë atë në të shkruar, me një stil origjinal. Pasurimi i fjalorit dhe njohja e gjegjëseve në shqipe sidomos kur këto vijën nga gjuhë pothuaj ndërkombëtare, do të shmangnin përdorimin e fjalëve të huaja. Sa më e pasur të jetë një gjuhë, në koncepte dhe shprehje aq më të pakta janë mundësitë e huazimeve dhe kalkeve gjuhësore nga gjuhë të tjera. Rezultat e punëve të dobëta me shkrim vijnë edhe si pasojë e mungesës së fjalorit, elegancës që vijnë si pasojë e njohjes së shqipes në variantin më të thjeshtë të saj, që shpesh i ngjan ligjërit të përditshëm.

Mendoj që në të ardhmen vepra të cilat lidhen me punën e nxënësve të pajisen dhe me shënime sqaruese për përkthimtarisë, gjë e cila do t'i shërbente si punës me gjuhën shqipe ashtu edhe me gjuhën e huaj.

Literatura

- Shezai Rrokaj, cështje të gjuhës shqipe 2, Tiranë 2009, fq 31.
Rami Memushaj, Gjuhësia gjenerative, Tiranë 2003, fq 203.
Rendësia e të qenit i ndershëm, përktheu N. Kalldrëmxiu, Morava 2003.
Oscar wilde, Portreti i Dorian Greit' përktheu N. kalldrëmxiu, TOENA 2005.
O. Wilde, The portret of Dorian Gray, Modern library, 1998.

Prurje të Kadaresë në standardin e shqipes në fushën e fjalëformimit

Prof As. Gladiola Durmishi Elezi
University of Vlora "Ismail Qemali"

Analizë

Procesi i globalizmit u hap rrugë prurjeve të fjalëve nga vende perëndimore, por duhet të themi se edhe krijon lidhje shumëplanëshe me kulturën, bashkësinë gjuhësore e shoqërore, duke u mbështetur në vlerat etnike dhe kulturore përkatëse. Vlera të tilla përcjell pa më të voglin dyshim edhe vepra e Kadaresë.

Leksiku i veprës së tij sjell përfitime, jo vetëm me pasurinë që ka, por edhe me hijeshinë që i jep fjalës me ngjyresat e duhura për çdo rast që kërkohet. Zgjedhja e leksikut është dobësia e vetë shkrimtarit. Në përzgjedhjen e leksikut ai synon të veçantën, estetikën shpesh modernisten e filozofiken.

Në filozofinë e tij ka kritere të fjalës e shprehjes së vërtetë. Ndërfutja e përgjithësimeve filozofike në tekstin narrativ është një nga konstantet e veprimit stilistik dhe njëkohësisht parim krijues e kompozicional.

Gjuhës i ka sjellë shumë fjalë të dobishme në jetën praktike, me kuptime e brendi të thella filozofike edhe në aspektin e drejtpërdrejtë letrar artistik e gjuhësor. Gjuha e Kadaresë është simbol i traditës gjuhësore shqipe në ditët e sotme, është simbol i ideve, ndjenjave, gjykimeve të pavarura në artin letrar dhe atë shoqëror. Ismail Kadareja harton e krijon lirshëm, ligjëron me leksik të zgjeruar e të peshuar mirë, duke përzgjedhur fjalë të fuqishme, të mprehta për filozofinë e për logjikën që kanë. Vepra e Kadaresë me origjinalitetin dhe individualitetin e vet dëshmon se vepra letrare është gjuhëkrijuese dhe po aq botëkrijuese. Ajo dëshmon gjithashtu, se gjuha si shprehje e përvojës njerëzore, e pasuruar ndër shekuj e breza, "është e gatshme ose mund të përgatitet shpejt për të përcaktuar individualitetin krijues".

"Kadareja i dha një fytyrë moderne prozës shqipe, në të gjithë përbërësit e vet, shmangu prej saj rutinën dhe mjetet e harxhuara, theu skemat e strukturave të mendimit, të formave dhe të ligjërimit artistik. Arriti të pasqyrojë tek kjo prozë dimensionin filozofik e universal, duke e futur në shtratin e letërsisë moderne. Duke ardhur në këtë shtrat proza e Kadaresë vuri në qendër dramën e individit dhe të kombit, kërkimet morale dhe situatat ekzistenciale në jetën e tyre, përsiatjet filozofike për raportet e individit me shoqërinë dhe për integritetin e personalitetit njerëzor" (Bulo, 1988, 178-179).

Letërsia e Ismail Kadaresë është gjithëpërfshirëse përse i takon fjalësit, tematikës, erudicionit, thellësisë së mendimit. E konstruktuar përmes pasionit të thellë për artin letrar, ajo pulson nga imagjinata e fuqishme, stili i larmishëm e dramatik i rrëfimit. Me këtë potencë artistike, Kadareja është pranuar e njohur tashmë edhe përtej hapësirave shqiptare, gati në mbarë botën si autor i një korpusi të gjerë veprash e sprovash letrare. Krijmtaria e tij çmohet si për tematikën dhe lëndën që autori përzgjedh ashtu edhe për vlerat e larta artistike, pasurinë ligjërimore, sprovat stilistike e gjuhëpasuruese të tij. Përgjithësisht, letërsinë e tij e karakterizon një botë e dendur, e ndërthurar me thellësi mendimi e shtrirje psikologjike si dhe me një sistem të përpunuar të legjendave, të cilat autori i vesh me përmasat e ligjërimit homerik, me vibrimet e ligjërimit shekspirian,

me magjinë e rrëfimit markezian, për të hyrë kështu në panteonin e vlerave letrare të botës. Kjo botë e letërsisë, tek Kadareja është shumë e pasur, ndërtohet përmes një diskursi estetik të nivelit të lartë. Në të ngjizen, përbluhen e hibridizohen trajtat empirike homerike, të cilat përbashkohen në shtratin e narrativitetit të veçantë, atij të përveçëm, kadareian. Pa asnjë mëdyshje, vlerat e letërsisë së Kadaresë, këtij gjeniu tregimtar i tejkalojnë përmasat kombëtare, rajonale, evropiane dhe hyjnë denjësisht në përmasat e letërsisë botërore. Ajo çka e bën këtë letërsi të madhe e universale, mbetet pasioni i thellë që ndeshet kudo për letërsinë, i brumosur me traditën epike të rrëfimit letrar, që nga ajo homerike deri te shkollat e tregimtarisë moderne, të cilat autori di t'i përpunojë e t'i ushtrojë si një mjeshtër i rrallë.

Fjala shqipe ka gjetur te Kadareja një mjeshtër të madh të përpunimit të saj artistik, që zotëron përmasat e një fenomeni që vjen rrallë, por që fiksohet dhe qëndron gjatë e duke ushtruar ndikim të fuqishëm në krejt ecurinë e letrave dhe të mendimit përparimtar të kombit shqiptar madje, mund e duhet të thuhet se asnjë prej krijuesve të gjallë bashkëkohës të Kadaresë nuk e ka autoritetin dhe prestigjin e fjalës së tij. E parë në tërësi, vepra e Kadaresë shfaqet si një univers që të mahnit me galerinë e pafund të personazheve, me groteskun dhe tragjizmin njerëzor, me lirizimin dhe gjëmimet epike, me apokalipset, tiranitë dhe rilindjen e popujve. Pra, është një vepër komplekse, shumëplanëshe, shumëzërëshe (polifonike), një vepër që ka një vazhdimësi, që ka një koherencë, në planin estetik, në planin stilistik. Natyrisht, në aspekte të përmbytjes së saj, ajo sigurisht që ka evoluar, sigurisht që është përsosur më tej (Ciraku & Vinca, 2006).

Këto janë arsytet që të shtyjnë të mbash në duar veprën voluminoze të Kadaresë, për të vështruar gjerësisht gjuhën në një kontekst të plotë, për të parë nga afër e përmes një analize të detajuar, të thukët, si dhe ku e merr fjalën autori, si e përpunon, si e përfshin në rrjedhën ligjërimore dhe çfarë rikrijon ai në leksematikën e shqipes, duke u dhënë "patentën" e vet kadareiane deri edhe fjalëve të zakonshme, krejt natyrshëm, qoftë ajo një emër, mbiemër, folje, ndajfolje etj. Me mjeshtëri të veçantë autori ynë krijon dhe kërkon, asgjë nuk flak e nuk lë të shkojë kot, pasuron me kuptime të reja fjalët plaka e të harruara, por edhe ruan me fanatizëm pastërtinë gjuhësore dhe, sa herë gjen rastin, i qaset edhe zëvendësimit me aq mjeshtëri të fjalës së huaj me fjalën shqipe. Kujt nuk ia kap syri e nuk i gozhdohet vëmendja nga krijime të tilla si *arkëmort* për arkivol, *tabut*, *fortafolës* për altoparant e sa e sa të tjera, disa prej të cilave edhe si fjalëkrijime ad hoc, si p.sh. *rimorkatoriozaur* (Caushi & Shkurtaç, 2004) etj. Si rrjedhojë, autori siguron në mënyrë të garantuar mbrojtjen, pasurimin, zhvillimin dhe unifikimin e gjuhës letrare. Kadareja është përdorues i sakë i fjalëve në vepër, i përdor ato në përshtatje me kontekstin dhe idenë që do të japë, duke ia gjetur secilës vendin më së miri. Ja pse fjalët e tij janë mbresëlënëse, pasi ai ua gjen vendin dhe trajtën e duhur të gjitha fjalëve që përdor, duke ia përshtatur idesë dhe stilit të tij. Lexuesi i Kadaresë e di mirë se nuk është vetëm gjuha letrare e përdorur në veprën e tij, por edhe format dialektore, të cilave mund t'u japë edhe ngjyime stilistikore ose nuanca kuptimore të ndryshme nga fjalët e shqipes standarde. Këto vërehen dhe janë të kapshme për studiuesin dhe jo për lexuesin e thjeshtë, prandaj është detyrë e studiuesit që t'i marrë, t'i klasifikojë dhe t'i vlerësojë në kuadrin e asaj që i takon një gdhendësi të palodhur të fjalës shqipe, çfarë është në të vërtetë Ismail Kadareja. Prurjet dhe frytet e atij qëmtimi të pandërprerë që bën Kadareja në arealet e shqipes

së folur, qofshin edhe krahinore e anësore, janë të atilla nëpërmjet të cilave jo vetëm jepet ngjyresa a koliriti vendor e hapësinor, po edhe pasurohet e begatohet gjuha letrare, pasi Kadareja merr pa asnjë paragjykim fjalë të dy dialekteve të mëdha ose edhe prej të folmeve e deri prej sociolekteve të shqipes. Ndërkaq, duke qenë një shkrimtar hijerëndë, i lexueshëm jo vetëm në hapësirat e Shqipërisë, po edhe më gjerë, gjithandej trevave shqiptare dhe në diasporë, përveçse në përkthimin në gjuhë të huaja, tashmë të shumta, fjalët, frazeologjizmat dhe mënyrat e të thënit të veprave të Ismail Kadaresë marrin një “status” tjetër, atë të gjuhës letrare të përpunuar këndshëm edhe me prurjet më të vyera prej të folmeve popullore. Mund të shihet qartë kjo, sidomos në veprat e dhjetëvjeçarit të fundit, sidomos ato me tematikë nga Kosova dhe hapësirat veriore, ku gjejmë aq shumë prurje të zgjedhura prej gegërishtes.

Lidhur me këtë është rasti të citojmë këtu një vlerësim të Gj. Shkurtajt, i cili duke trajtuar pikërisht virtytin e Kadaresë si fjalëzgjedhës i palodhur, ka shkruar: “Ismail Kadareja, në përputhje me synimet e tij gjuhëpastruese e gjuhëpasuruese, mban edhe qëndrim të anësuar (enkas e hapët) dhe parapëlqyes jo vetëm ndaj fjalëve e frazeologjizmave gege po edhe ndaj disa formave fonetike të shenjuara si “**jashtë normës**” meqë përmbajnë **-n** të parotacizuar (aty ku shqipja standarde ka trajtat përkatëse me **r**). Të tilla janë: *baltinë* (e jo *baltirë*); *ballinë*, *barnatore*, (*farmaci*) ku baza është *shumësi barna* (gegërisht) dhe jo *barëra* (toskërisht), *bishtnim*, *bishtnonte*, *cubnisht*, *çeltinë*, *i damun*, *fisanak*, *fshehtinë*, *grunajë*, *grunarët*, *guranë*, *gjethinë*, *hekurinë*, *hidhnaqth*, *hirnore*, *hirnosje*, *idhnaqë*, *ikanak*, *kotni*, *krenajat*, *larginë*, *mëkatnim*, *mjegullinë*, *ngrehinë*, *plehnajë*, *qyqnajë*, (+aq shumë fjalë të tjera me prapashtesën **-najë**); *rrethanak*, *rrethinë*, *rrëgallinë*, *rruginë*, *skamnor*, *sterrinë*, *shkretinë*, *shpartallinë*, *shpellanë*, *shpellinë*, *shpeshtinë*, *shpirtnisht*, *vathinë*, *vetanak*, *vjetran*, *zabullinë*, *zbrazëtinë* (krahas *zbrazëtirë*), *zgauringë*, *zjarrm* (krahas *zjarr*)” (Shkurtaj, 2009, 163).

Në sythin e titulluar “Fjalë të marra nga shqipja e moçme, nga folklori dhe nga të folmet gege”, Shkurtaj ka theksuar se në fjalësin e veprave të Kadaresë, të nxjerrë nga T. Çausi “janë renditur rreth 2000 fjalë, shumica e të cilave nuk gjendet në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe” (Shkurtaj, 2009, 163). Fjalëkrijimi sipas Shkurtajt përbën “arën” më të lakmueshme e më të lëvruar prej Kadaresë, por arsyeja nuk është e lidhur gjithmonë me rrethanën se Kadareja përdor fjalë të reja. Një nga arsyet e asaj morie fjalësh që nuk i ka FGJSSH është se Kadareja parapëlqen dhe përzgjedh për indin e veprave të tij edhe shumë fjalë të trevave anësore, fjalë të bukura e me ngjyresë të këndshme, që sjellin hijeshi e larmi shprehjeje, që e njomin dhe e këngëzojnë prozën kadareiane, paçka se shumë syresh mund të jenë edhe fjalë a forma fjalësh të gegërishtes. Ai kërkon dhe nuk rresht së qëmtuari e së thithuri fjalën e thënë bukur në popull e në letërsinë paravajtëse, prandaj ai përzgjedh herë nga letërsia e shkruar gege, herë nga botimet e folklorit geg, po ai merr edhe drejtpërdrejt nga të folmet popullore të gegërishtes, sidomos nga kosovarishtja dhe nga shkodranishtja. Nga shqyrtimi i fjalësit të nxjerrë nga studiuesi T. Çausi, na del se një sasi e madhe fjalësh të tij janë prurje të drejtpërdrejta nga gurrat e ligjërimeve të gegërishtes dhe nga tradita shkrimore e autorëve gegë, ndërsa një pjesë tjetër janë të përvetuara nëpërmjet një “filtri” të kthimit a rrafshimit drejtshkrimor me normën e sotme të shqipes standarde. Bashkohemi plotësisht me vlerësimin e drejtë të Shkurtajt se *hulumtimi i pandëprerë, vjelja dhe përfshirja e fjalës së bukur popullore nga Kadareja ka mëtime të thekshme gjuhëpastruese, gjuhëmbrojtëse dhe sidomos gjuhëfënisnikëruese* (Shkurtaj, 2009, 164).

E veçanta e Ismail Kadaresë, pra, mbetet pikërisht në fushën e fjalëve dhe ka të bëjë me "lëndën" që zgjedh dhe përdor ai, me hapësirat prej nga vijnë prurjet leksikore dhe mjetet fjalëformuese, por edhe me atë proces shoshitjeje e shqyrtimi të përhershëm të këtij krijuesi për të shtuar ato lloje fjalësh e shprehjesh që u shkojnë për shtat dhe mëtimeve të tij krijuese dhe tematikës që ai trajton në veprat e veta. Ai vëzhgon e dëgjon çfarë thuhet, shfleton dhe vjel në dokumente të moçme të shqipes, grumbullon dhe pastaj përzgjedh me durim dhe, pavarësisht nga ato që nden gjuha në gjithë larminë e gjerësinë e saj, i vihet edhe një punë të ngultë përpunuese e krijuese (Shkurtaç, 2009, 164).

Universaliteti i veprës së Kadaresë u krijua në pjesën dërrmuese të saj në kushtet e letërsisë së realizimit socialist, d.m.th në mungesën e lirisë së plotë krijuese. Por, Kadareja, me talentin e tij, arriti që të kalonte kufizimet që impononte koha dhe madje, t'ia rrënojë themelet sistemit totalitar. Veprat e tij "*Pashallëqet e mëdha*", "*Ura me tri harqe*", e të tjera, janë metafora madhore të antitotalitarizmit. Kadareja u bë shkrimtar botëror, i vetmi shkrimtar shqiptar, madje që ka fituar në mënyrë të plotë statusin e shkrimtarit botëror, duke qenë thellësisht shqiptar, duke bërë sintezën e asaj që quhet kombëtare, vendore, me atë që është universale, e përgjithshme, gjithënjëzore.

Ndërkaq, korpusi letrar i Kadaresë është i rëndësishëm edhe në planin e stilistikës. Kadareja është i rëndësishëm, në radhë të parë, me prozën e tij, me romanet e tij, ndonëse edhe si poet ka vlerat dhe prurjet e tij origjinale e ligjërimpasuruese. Por Kadareja është i rëndësishëm për kulturën shqiptare, madje më gjerë, edhe për eseistikën. Duke filluar nga vepra "Autobiografi e popullit në vargje", "Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe", "Eskili ky humbës i madh", "Ftesë në studio", "Pesha e Kryqit", "Dialog me Alen Boskenë", e deri tek më e fundit, "Dantja i pashmangshëm", Kadareja ka treguar se ai jeton me problemet, qofshin letrare, kulturore, qofshin edhe politike, shoqërore. Nga ky aspekt, Kadareja mund të thuhet se është një zë i kohës, është një ndërgjegje e saj, është një ndërgjegje para së gjithash e botës shqiptare, e cila artikullohet në mënyrë të mrekullueshme në hapësirën shqiptare dhe në hapësirën e përgjithshme botërore (Ciraku & Vinca, 2006).

Për Kadarenë dhe pasurinë ligjërimore e mirëfilli për leksematikën e veprave të tij, mbas shënimeve dhe shqyrtimeve të T. Çaushtit e Gj. Shkurtaçit, duhet përmendur edhe vepra e Natasha Sotirit "Fjalori i veprave të Ismail Kadaresë" si dhe disa artikuj e kumtesa të mbajtura me rastin e 70-vjetorit të lindjes së I. Kadaresë *. Megjithatë, mund të thuhet se, deri më sot, në shkencën tonë të gjuhësisë mungojnë vështrime, kritika e, sidomos studime për gjuhën e shkrimtarëve, veçanërisht studime gjuhësore-stilistike, por edhe thjesht studime gjuhësore.

Natyrisht, të hedhësh dritë mbi çështje të veçanta gjuhësore dhe pikërisht për fjalëformimin në veprat e Kadaresë nevojitet një studim i hapët dhe i gjerë. Thellimi në një studim të mirëfillt shkencor të vlerave gjuhësore të veprës së këtij autori paraqet rëndësi të veçantë jo vetëm në aspektin e gjerë të vlerave letrare që përcjell vepra e tij, por edhe në atë gjuhësor, sidomos me prurjet e padiskutueshme pohuese, pasuruese dhe tëholluese në fjalësin dhe shndërrimet semantike të shqipes.

Në kumtesën tonë, duke shfrytëzuar të dhënat e materialit të vjelë, na rezulton se ka një përdorim të gjerë të tipave fjalëformues të njohur në gramatologjinë e shqipes. Në veprat e Kadaresë, në bazë statistikash do të veçonim prejardhjen, e cila mbetet mënyra më prodhimtare dhe më e larmishme në sistemin e fjalëformimit. Evidentohen

kryesisht, formimet parashtesore, prapashtesore, parashteso-prapashtesore, si dhe pa ndajshitesë. Duke shfrytëzuar materialin e vjelë nga vepart e autorit, si dhe duke u mbështetur në përqasjen me të dhënat e Gramatikës së Gjuhës Shqipe, dhe në studimet e realizuara kryesisht për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, mund të shohim që prejardhja është jo vetëm mënyra më prodhimtare, por edhe më e larmishmja. Edhe qëllimi i këtij studimi është të analizojmë prurjet gjuhësore të fjalëve të prejardhura në përdorimin konkret të ky autor. Për të arritur në një analizë modeste të llojeve të ndryshme të formimeve jemi ndalur të disa vepra, duke grumbulluar një material të mjaftueshëm për këtë trajtim. Kështu, në studimin e fjalëformimit parashtesor jemi ndeshur konkretisht me shembuj, pjesë të ligjëratës që burojnë nëpërmjet fjalëformimit: *emra*, *mbiemra*, *folje ndajfolje* të formuara nga tema të parme dhe nga parashtesa të ndryshme. Po ashtu, në studimin e fjalëformimit prapashtesor kemi ndeshur shembuj të formimit të fjalëve me prapashtesa nga tema të parme. Edhe në këtë aspekt shquajmë fjalë që janë pjesë të ndryshme të ligjëratës, ku mbizotërojnë: *emra*, *mbiemra*, *folje*, *ndajfolje*. Në formimin parashteso-prapashtesor ndeshim pjesë të ndryshme të ligjëratës si: *emra*, *mbiemra*, *folje*, *ndajfolje*.

Kategoria leksiko-gramatikore e emrave përbën një nga klasat më të pasura të fjalëve në gjuhën shqipe, prandaj ishte e natyrshme që në punimin tonë të ndaleshim veçanërisht në mënyrë të posaçme në klasën e emrave. Ato e kanë rritur dhe po e rrisin gjithnjë e më shumë sasinë e njësive që përfshihen në këtë kategori fjalësh.

Ndër dy tipat themelorë të kësaj mënyre, vendin parësor dhe prodhimtarinë më të madhe e ka tipi *prapashtesor*. Kjo, normalisht, lidhet me zhvillimin dhe veprimtarinë e përgjithshme të procesit të krijimit të fjalëve të reja si dhe me natyrën e strukturës morfologjike të këtyre fjalëve në gjuhën shqipe. Pranojmë se, “kjo denduri dhe rritje e formimeve ndajshitesore në fushën e emrave është e lidhur, për kategori të veçanta semantike, edhe me procesin e mënjanimin të formimeve jondajshitesore, karakteristike, kryesisht për gjuhën e periudhës së Rilindjes Kombëtare, por edhe për gjuhën e shekujve XVI-XVIII edhe me procesin e ndrydhjes së gjinisë asnjësore në gjuhën shqipe të ditëve tona, proces, që ka filluar mjaft kohë më parë” (Hysa, 209). Këtu, do të vëmë në dukje një kategori të gjerë emrash të veprimit, por edhe të fushave të tjera.

Në kuadrin e zhvillimeve gjuhësore të shqipes së sotme na intereson të theksojmë procesin e çintegrimit të gjinisë asnjësore në përgjithësi dhe atë të emrave prejfoljorë asnjësorë në veçanti. Ajo që duhet të vihet në dukje është se parashtesimi e prapashtesimi e pasurojnë inventarin e leksemave të shqipes edhe me mjete të tjera, që vijnë si nga fjalëpërbërja edhe nga përngjitja. E. Hysa vë në dukje se “disa formime kanë në përbërjen e tyre disa elemente, natyra e të cilave po afrohet gjithnjë e më shumë me ndajshitesat. Formimet e kësaj natyre lidhen më shumë me fjalëpërbërjen nga e cila kanë dalë, por edhe nga e cila janë larguar apo largohen” (Hysa, 59).

Në formimin e emrave me prapashtesa ndodhin edhe procese të tjera në temat fjalëformuese, sidomos rënie tingujsh fundorë p.sh.: në temat fjalëformuese foljore të tipit *zymto +j* që bashkohen me prapashtesën *-im*. Dhe ky rast është krejt normal, që u përmbahet tërësisht rregullave të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Te Kadareja ndeshim prirjen që shihet në tema fjalësh, të cilat bashkohen me prapashtesa të caktuara duke na dhënë fjalë të veçanta, si në shembullin *ç+ jetë > çjetë*, i cili është një formim tipik kadareian, pasi njihet rregulla e përdorimit të parashtesës *ç-* në gjuhën

shqipe. Fjalë të tilla si *çjetë*, i shohim në aspektin e prurjeve dhe risive leksikore. Por, në të njëjtën kohë na interesojnë për studim edhe në rrafshin morfologjik, kryesisht fjalëformim. Për më tepër, interpretimi fjalëformues nis si rrjedhojë e temës fjalëformuese, e cila përbën edhe bërthamën kuptimore ose si quhet ndryshe, sememën e njësisë së re.

Duke qenë njohës i mirë i gjuhës së gjallë, i gjuhës popullore, i dialekteve, i ligjërimeve të saj e i stilit, ai zbulon vlera të plota e të gjithanshme të fjalës shqipe, duke mos i trajtuar të shkëputura, por gjithnjë në përdorimet e mundshme në kontekste të ngushta e të gjera, në leksemantikën e saj e në lidhjet e shumta sintagmatike e paradigmatiske të njohura e të krijuara nga ai vetë ose të rigjallëruara. Me neologjizmat ai dëshmon se njih mirë vlerën kuptimore, vlerën emocionale, vlerën artistike dhe fjalëformuese të fjalës, e sidomos atë fjalëformuese, duke u cilësuar me të drejtë jo vetëm si krijues letrar, por edhe krijues gjuhësor.

Duke marrë për bazë vlerën fjalëformuese të njësisë leksikore ai krijoi një varg fjalësh të reja me të cilat, shtoi ndjeshëm fondin e fjalësit të shqipes, duke zgjeruar edhe strukturrën kuptimore të këtij leksiku. Në këtë drejtim ai ka ofruar mjaft krijime që janë ngulitur në gjuhën shqipe dhe janë përfaqësuar në fjalorin e shqipes së sotme, por edhe krijime të rastit, të cilat mund të jetojnë në letërsinë artistike ose presin të aktivizohen në këtë fjalor.

Në këtë punë dobiprurëse shumëfish, ai ka ndjekur këto rrugë: ka krijuar fjalë e shprehje të reja me brumin e shqipes, duke marrë si mbështetje dhe si gjedhe ndërtimet ekzistuese e të qëndrueshme, që nuk dalin nga sistemi fjalëkrijues standard (me përjashtime të disa krijime të rastit për motive e qëllime artistike). Më të goditurat janë fjalët e përbëra, por nuk as të pakta e as më pak pasuruese edhe formimet me parashtesa e prapashtesa, që njihen më prodhimentet në shqipen e sotme. Zgjerimi dhe pasurimi i përmbajtjes leksikore të fjalës si dhe pasurimi i fjalëve me ngjyrimet të reja stilistike është puna e frytshme e tij në fushën e krijimtarisë leksikore, duke ndikuar që rrethi semantik i fjalëve të shtohet cilësorisht e në pikëpamje vëllimore. Kjo punë e autorit jo vetëm nga specialistë gjuhës, por edhe nga filologë të njohur i siguron Kadaresë vend të zgjedhur në rrethin e krijuesve gjuhësorë.

Në përgjithësi fjalëkrijimet e tij dhe aktivizimi i shumë ekzistuesve, nxjerrin në dritë dukuri e çështje të lidhura me veçantitë e shqipes siç janë gjedha fjalëformuese, kufiri midis përbërjes e përngjitjes, mundësitë e ndajshesimit, kushtëzimi i kuptimit të njësisë së re nga kuptimet e morfemave fjalëformuese dhe një varg çështjesh të tjera të kësaj fushe.

Nëpër faqet e veprave të Kadaresë kemi nxjerrë në dukje jo vetëm vlerat letrare, por veçanërisht vlerat gjuhësore, sidomos pasurinë e gjerë fjalëformuese që e karakterizon atë. Kadareja, si njohës i mirë i gjuhës shqipe i ligjeve dhe i vlerave të saj, di ta përdorë fjalën kur duhet dhe si duhet.

Të fasësh për fjalëformimin do të thotë të flasësh për një proces relativisht të gjerë në gjuhën shqipe, por edhe të veçantë. E veçanta konsiston në faktin se pavarësisht nga trajtimet dhe analizat e shumta fjalëformuese që janë bërë, kreu i fjalëformimit të çdo gjuhe mbetet gjithmonë i hapur. Themi mbetet i tillë, pasi dimë se çdo gjuhë pasurohet vazhdimisht me fjalë të reja, të cilat shpesh marrin kuptime të veçanta. Kjo vjen si rrjedhojë e shtimit të mjeteve fjalëformuese, që tashmë konsiderohen mjaft të rëndësishme në mbarëvajtjen dhe realizimin e këtij procesit të fjalëformimit. Fjalët e

një gjuhë pasi përdoren dhe rimerren, ritrajtohen, pësojnë ndryshime në strukturën e vet morfologjike duke u përdorur në kontekste të ndryshme gjuhësore. Një pjesë e mirë e tyre dalin nga përdorimi, gjë që do të thotë se këto fjalë zëvendësohen me fjalë të tjera, të cilat kanë prirje depërtuese në tërësinë e sistemit gjuhësor të shqipes. Përveç kësaj, mund të themi se një pjesë tjetër e konsiderueshme fjalësh (qofshin këto emra, mbiemra, folje etj. ritrajtohen, riformësohen, bashkohen me mjete të ndryshme fjalëformuese (përmendim këtu parashtesat, prapashtesat etj.).

Këto lëvizje gjuhësore, normalisht, e kanë filluesën të përdorimit të individëve të veçantë qofshin këta shkrimtarë, studiues, gjuhëtarë të mirëfilltë, të cilët kanë njohje të mirë e të thelluar të burimeve të pasurimit të gjuhës shqipe, si dhe të mundësive për mbështetje në strukturën gramatikore të saj. Njëri prej tyre, që spikat në mënyrë të veçantë, është I. Kadareja, i cili dallohet për mjeshtërinë e përdorimit të gjuhës. Mënyra si ai bën përzgjedhjen gjuhësore mbetet e admirueshme dhe padyshim, për të hulumtuar në veprën e tij, për të kuptuar realisht hapësirat dhe përmasat e prurjeve dhe vlerave që ndejnë veprat e tij.

Kjo gjuhë, e cila përveç motorit të fuqishëm të sintaksës, që i jep mundësi të punojë duke shfrytëzuar dhuntitë sintetizuese të gjuhëve gjermanike edhe elegancën e gjuhëve analitike latine, përveç pasurisë së nyjave, parashtesave e prapashtesave, që janë kanxhat që sigurojnë betonarmenë e një gjuhë, sistemit të fjalëformimit, që e ka ndër më të larmishmit e befasuesit, përdorimit të shkathët të fjalive lidhore, që janë ndër mekanizmat më të hollë të një gjuhë, larmisë së thekseve të fjalëve dhe shkurtësisë së ndajfoljeve, çka bën që vargu të dallgëzojë lirshëm apo të pritët ngutshëm si në zgrip, kjo gjuhë ka qenë në trysinë e përhershme të dramës së kombit të vet (Kadare, 262).

Duke marrë shkas nga vetëvlerësimi që Kadareja i bën shqipes themi me bindje se është pikërisht kjo gjuhë, që i dha potencial të veçantë veprës së tij.

Përfundime

Mënyrat dhe mjetet e formimit të fjalëve të reja, ashtu edhe modelet e këtyre formimeve që janë gjallëruar në mënyrë të veçantë janë:

- Parashtesat: *për-, nën-, stër-, pa-, mos-, ç-, sh-, zh-* etj.
- Prapashtesat: *-ar, -tar, -or, -tor, -an, -ak, -ajë, -esë, -ec*, të emrave të vepruesit: *-im, -imë, -je*; të emrave abstraktë të cilësisë: *-or, -tor, -shëm*; të mbiemrave: *-ore, -ishtë*; të ndajfoljeve të mënyrës: *-isht, -azi, -thi*; të ndajfoljeve e foljeve *-o, -so, -to* etj.
- Kompozimi

Neologjizma me parashtesa

Shfrytëzon gjedhet e fjalëformimit të shqipes. Formimet me parashtesa janë dukshëm më të pakta se ato me parashtesa dhe me kompozim. Mbizotërojnë fjalëformimet me parashtesat: *për-, stër-, ri-, sh-, mos-, pa-* etj.;

për-: *përhum, përflak, përshkëndit, përndjek, përdhunë, përndjell* etj.;

stër-: *stërkthej, stërmundoj, stërshtet, stërkthej, stërmendoj, stërkthim, stërngop, stërkungull* etj.;

sh-: *shkishëroj, shkapërcej, shpaguaj* etj.;

shpër-: *shpërvesh, shpërbluaj, shpërfshij, shpërdredh* etj.;

ç-: *çjetë, çburrëri* etj.

zh-: *zhvirgjëroj, zhgradoj, zhburos* etj.

Neologjizma me prapashtesa. Fjalëkrijimet me prapashtesa janë të shumta e dalin me larmi në prozën e Kadaresë. Më të shpeshta në përdorim dalin neologjizmat e krijuara me prapashtesat: *-im, -imë, -më, -inë, -shëm, -isht*, etj.

Në fushëkrijimtarinë gjuhësore shquhet për kompozitat e shumta e të larmishme, kompozitat shumë origjinale dhe me rëndësi për shqipen letrare. Në fondin e madh të këtyre fjalëve të përbëra ka shumë neologjizma të goditur. Mbushja e klasave leksiko- fjalëformuese me njësi të reja paraqitet si prirje e veçantë e krijimtarisë së autorit, ashtu si dhe kthimi i tyre në tipar stilistik.

Në fushëkrijimin e neologjizmave- kompozita, zënë vend mjete tipësore me klasa të tëra fjalëformuese. Përshkrimin e saktë, të hollë e të detajuar të sendeve, objekteve e dukurive të realitetit, autorie arrin fort mirë me njëfjalëzimin. Edhe pse autori është pasionant i përshkrimeve të gjata, prirja drejt sintetizimit e shoqëruar me krijimin e njëfjalëshave rrit dukshëm aftësitë përshkruese narrative .

Autori del novator me fjalë, si: *arkëmort, gjakhypës, gjakshlyes* etj.

Shumica e këtyre neologjizmave janë dykuptimshe dhe përdoren me kuptime të tjera në kontekste të caktuara. Ato kanë dhe ngjyrimet emocionale të larmishme e të theksuara si dhe shprehësi të lartë.¹ Ndërtimi, kuptimi, vlerat e përdorimit janë me interes për studim. Neologjizmat më të shumta janë formimet me gjymtyrë të figurshme dhe me kuptim të përgjithshëm të figurshëm.

Një tip neologjizmesh janë ata që emërtojnë nocione të reja arkëmort, këmishënatë etj. Ato shënojnë * -emri i pjesës së trupit + mbiemri: *duarkëputur, bishtngrehur, këmbëzbathur, ballëprerë, kokëkëputur* etj.

-emri i pjesës së trupit + emër i një sendi që ka një tipar dallues: *kokëshkëmb, hundëshqiponjë, kokëderr, mendjefemër* etj.

-emri i pjesës së trupit + mbiemër që shënon tipar të figurshëm të kësaj pjese të trupit: *trutharë, ballëprerë* etj.

-emër nocioni, dukurie e objekti + mbiemër: *dritëshkurtër, lumëmadh, lumëzi*, etj.

Neologjizmat stilistikë krijohen si nevojë e brendshme e jetësohen mrekullisht nga makrokonteksti gjuhësor ku hyn njësi gjuhësore e krijuar. Në këto makrokontekste gjuhësore krijohen terrene të përshtatshme për krijime leksikore, sidomos për kompozitat, si formime me ngjyrimet të theksuaraemocionuese shprehëse për rrafshin artistik (për figurat letrare) dhe të gjitha së bashku për informacion jetësor e letrar.

Formime të tilla, ndonëse nuk janë trajtuar specifikisht brenda limiteve të kësaj kumtese, por janë fryt i një studimi më të thellë, nxjerrin dukshëm në pah vlerat risuese të gjuhës së autorit, që mbetet përherë model studimi e interpretimi për shumë breza

Literatura

1. Agalliu, F. *Gjuha e Nolit: në veprat origjinale të tij*, Tiranë, 2000.
2. Bullo, J. *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Tiranë, 1988, f. 178-179.
3. Çiraku, Y., Vinca, A. *Vepra e Kadaresë një univers që të trondit me galerinë e personazheve të saj. Intervistë me rastin e 70-vjetorit të lindjes së shkrimtarit. Intervistoi: Laura Konda*, Tiranë, 2006.

¹ Sh. Islamaj, *Gjuha...*, vep. cit., f. 140.

4. Çaushti- T. , Shkurtaj, Gj. *Kadareja dhe fjala shqipe*, ALBAS, Tiranë, 2004
5. Demiraj, Sh. *Gjuha e Sami Frashërit*, BUSHT, SSHSH, Tiranë, 1957.
6. Dhima, Th. *Veçori të frazës në prozën e Ismail Kadaresë*.
7. Hysa, E. *Formimi i emrave me ndajshitesa*.
8. Haxhi, A. *Proza e Fishtës në pamje gjuhësore (Sistemi foljor)*, Camaj- Pipa, Shkodër, 2 003.
10. Islamaj, Sh. *Gjuha dhe stili i Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000.
11. Karagjozi (Kore), M. *Vështrim etnolinguistik i veçorive të qytetit të Gjirokastrës në veprën e I.Kadaresë*.
12. Lamaj, A. *Identiteti sociolinguistik i personazheve në prozën e I.Kadaresë*.
13. Meniku, L. *Konektorët e tekstit në veprën e I.Kadaresë*.
14. Sotiri, N. *Për një fjalor të gjuhës së Kadaresë*.
15. Shkurtaj, Gj. *P esha e fjalës shqipe*, UFO-Press, Tiranë, 2009.
16. Shkurtaj, Gj. *Disa vërejtje për gjuhën e Naim Frashërit*, "Studime filologjike", 1971, nr. 2.
17. Kadare, I. *Ftesë në studio*, Tiranë, 1990.

Shqipja për fëmijë pjesë e qytetarisë evropiane dhe integritit social

Doktorante Nikoleta Kalldrëmxiu

Abstrakt

Qëllimi i kësaj kumtese lidhet me pasqyrimin e disa aspekteve të zhvillimit të shqipes për fëmijë si pjesë e të kaluarës, të tashmes dhe perspektives evropiane së saj; me qëllim mësimin e qytetarisë nëpërmjet traditës së shqipes së shkruar, në fokusin e kontributit social-etik të saj dhe vlerave evropiane. Nga ana tjetër, të argumentojë nevojën e studimeve plotësuese dhe veprave leksikografike për fëmijë që prekin të ardhmërinë e shqipes.

Për të parë se çfarë ofron komuniteti shqiptar në shekuj për të vegjlit dhe për të rinjtë i jemi drejtohem parimit të historizmit, duke rishikuar vepra dhe studime gjuhësore dhe letrare të autorëve L. Matrënga, N. Frashëri, S. Frashëri. Ndërthurja e metodës të induksionit dhe të deduksionit janë bërë për të ripërkufizuar konceptin e qytetarisë, si prurje në kulturën dhe edukimin shqiptar dhe sfidë për të ardhmen.

Traditajonë në edukim fillon që në shek. XVI, në Itali me shkollën shqipe të Matrëngës, Pavarësisht se mbështetet në moralin kishitar ajo tregoi për barazinë gjinore në edukim (djem e vajza) dhe dobishmërinë e zhvillimit të personalitetit në gjuhën amtare. Ajo duhet studiuar më thellë, dhe jo vetëm aty, por te i gjithë komuniteti shqiptar në botë.

Rilindësit gjithashtu krijuan një traditë të mirëfilltë në edukim në përputhje me planin mësimor të arsimit fillor të projektuar nga vetë ata. Etika për fëmijë në këtë periudhë mori kuptimin e dashurinë për qeniet e gjalla, respektin e guximin, trimërinë e ndershmërisë, bamirësisë, ndjesës, bekimit, punës, vlerës dhe dobisë së saj, pastërtinë dhe kujdesit. Ndjenjat patriotike të tyre u ndërthurën me përhapjen e diturisë dhe theksuan ngritjen morale që vjen nëpërmjet saj, si mjeti së vërtetës. Morali i propaganduar nga Rilindësit e kapërceu moralin e krishterë dhe nëpërmjet gjuhës pruri idealet e Rilindjes Evropiane.

Ringjallja e këtyre vlerave qytetare tregon se kjo periudhë është e një humanizmi të lartë, që theksonin vlerën e dinjitetit të njeriut ndaj të cilës sot ndjehet një afri morale dhe intelektuale. Edukimi qytetar i të vegjëlve është sfidë për të ardhmen. Shqipja është në stade të tilla zhvillimi që mundësojnë përzgjedhjen. Përtej fjalorit që ekzekutojnë të drejtën qytetare apo politikën arsimore që realizojnë një edukim të tillë, besoj se çdo qytetar i vogël evropian ka të drejtë të gjejë aty shpjegimin, përfytyrimin, integrimin, sugjerimin e botës dhe shoqërisë në gjuhën e tij, Fjalorët moshorë, do të kenë një impakt në rritjen e kompetencave të tilla si qytetare, personale njohurive mbi etikën dhe integrimin evropian. Kjo është po aq e nevojshme sa barazia materiale dhe shërbimet bazë, që të zhvillohet personaliteti e atyre që ne i quajmë e ardhmja dhe që do të jetë evropiane. Kështu, qytetarët e përcaktuar si produkt i prejardhjes, duhet t'i lënë vendin qytetarëve evropian të mësuar të jetojnë në shoqëri bashkë me të tjerë, në një shumëllojshmëri situatash e rrethanash. Është e drejtë që duhet ekzekutuar.

Fjalë kyçe: fjalor për të vegjël e të rinj, e drejtë evropiane, etikë, edukim qytetar, traditë.

Hyrje

Mësimi i qytetarisë fillon nga bërthama familjare, me fqinjët, me të afërmit, me qytetin, me gjithë vendin. Ky spektër sot është më i gjerë kur flitet për një botë globale dhe të parashikuar të së ardhmes sonë.

Qëllimi i kësaj kumtese lidhet pikërisht me pasqyrimin e disa aspekteve të zhvillimit

të shqipes për fëmijë si pjesë e të kaluarës, të tashmes dhe perspektives evropiane së saj. Ajo kërkon të sjellë shembuj nga tradita ,parë nga këndvështrimi social- etik dhe të vlerave evropiane.

Për këtë është bërë hulumtimi dhe rishikimi i literaturës që lidhet me historinë e gjuhës shqipe dhe arsimit shqiptar, të drejtën qytetare evropiane, me qëllim zgjerimin dhe pasurim e konceptit për qytetarinë, si dhe për të argumentuar nevojën e studimeve plotësuese dhe veprave leksikografike për fëmijë, që prekin ardhmërinë e shqipes.

Metodologjia

Për zgjidhjen e drejtë të detyrës se çfarë ofron shqipja e shkruar për të vegjël e për të rinj në shekuj, do t'i drejtohem parimit të historizmit.

Ndërthurja e metodës të induksionit dhe të deduksionit është bërë për të ripërkufizuar konceptin për qytetarinë, si prurje në kulturën dhe edukimin shqiptar dhe sfidë për të ardhmen.

Tradita jonë qytetare dhe ajo evropiane për të vegjël e për të rinj

Zhvillimi i kulturës sonë kombëtare dhe qytetare (Rrokaj, 2002, 220) natyrisht shkon paralelisht me atë historisë së gjuhës shqipe, teksteve shkollore të përdorura në shkollën shqipe dhe edukimit qytetar të pasqyruar në to.

Tradita jonë në edukim e kalon fjalën e nënës, vlerëe cila duhet të afirmohet Ajovazhdon edhe sot,si pjesë e “Edukimit në demokraci” brenda territorit të Shqipërisë, por edhe në hapësirat ku banojnë arbëreshët¹ apo i gjithë komuniteti shqiptar. Kujtojmë se shkolla shqipe fillon me Matrëngën në Itali dhe pavarësisht se u mbështetet në moralin kishtar, tregoj për barazinë gjinore në edukim (djem e vajza) dhe dobishmërinë e zhvillimit të personalitetit në gjuhën amtare.

Rilindësit gjithashtu krijuan një traditë të mirëfilltë në edukim në përputhje me planin mësimor të arsimit fillor të projektuar nga ata. Etika për fëmijë në këtë periudhë mori kuptimin e dashurisë për qeniet e gjalla, respektit, ndjesës, bekimit, guximin, trimërisë,ndershmërisë, bamirësisë, punës,² vlerës dhe dobisësë saj, pastërtisë dhe kujdesit.

Ndjenjat patriotike të tyre u ndërthurën me përhapjen e diturisë. Ata u treguan të vegjëlve se populli shqiptar është ndër të parët popuj që erdhën nga Hindia dhe zunë vend në kontinentin evropian ashtu siç tregohet te Dituritë (Frashëri, 1974, 4) e N. Frashërit. Ata theksuan ngritjen morale që vjen nëprmet diturisë, si mjet i së vërtetës. Poezitë morale të N. Frashërit ndihmojnë përfytyrimin e fëmijës për ndërtimin e koncepteve të etikës.

Mes teksteve të tjera shkollore (Bishqemi, 2008, 60) përmendim Alfabetare e gjuhës shqip e S. Frashërit ishte një vepër e përbashkët e katër atdhetarëve të shquar: Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos e Koto Hoxhit. Ky libër i vogël me 136 faqe, me material nga gjuha, aritmetika, historia, gjeografia, morali e filozofia, zë vend të nderuar midis veprave më me vlerë të Rilindjes sonë kombëtare. Vepra ka rëndësi

¹ Shih te shtojca: Bashkësitë arbërishtfolëse të Italisë. A cura della cattedra di lingua e letteratura Albanese dell'università della Calabria. Quadro normative a sostegno dellaminoranza linguistic albanese.

² Dheu është flori (1957) , fq 4.

rëndësia metodike dhe në përhapjes e fjalësit dituror në gjuhën shqipe historinë e deri në edukimin moral. Ato përbëjnë një thesar që duhet zbuluar më mirë nënë shërbbim të edukimit të vegjëlve dhe të rinjve.

Morali i propoganduar nga Rilindasit e kapërceu moralin krishterë dhe nëpërmjet gjuhës pruri idealet e Rilindjes Europiane.

Si letërsia jonë e kultivuar ashtu edhe folklori sollën vlerën e besës dhe të kuvendit si cilësi të shqipes së qytetëruar duke bërë ngritjen cilësore të ndërgjegjes qytetare ndër të vegjël.

Ringjallja e këtyre vlerave qytetare tregon se kjo periudhë është e një humanizmi të lartë, që theksonin vlerën e dinjitetit të njeriut ndaj të cilës sot ndiejmë një afri morale dhe intelektuale. Kur flasim për statusin e etikës në shoqëritë e hapura, doemos e kemi fjalën për kufij të rinj etike që mund t'i vendosen "qytetarit", që do të jetojë moralisht ndryshe. Dobitë e zhvillimit të personalitetit dhe pranimit të idesë "të mirës të përgjithshme", janë themelore për të edukuar vlera humane, të respektojë "tjetrin" dhe "të tjerët", të sigurojë gjerat me meritë. Karakteri historik i etikës të rilindësit, ashtu të paktën siç i përmendëm më lart, jo vetëm nuk e pengon formimin kulturor dhe moral të vegjëlve, por tregojnë universalitet dhe largpamësi në trajtimin e saj.

Edukimi qytetar i të vegjëlve sfidë për të ardhmen

Në kuadër të edukimit të brezit të ri me dimensionin historik e kulturor, me dimensionin etik, i cili përfshin edhe aspektet afektive dhe emocionale, merr rëndësi artikulumit i pavarur i fjalës shqipe në mjediset shkollore dhe jashtë saj.

Pas rivendosi së gjuhës shqipe në shkollën e mesme edhe si pjesë e nevojës sonë për të shkuar në Bashkësinë Evropiane të veshur me gjuhën shqipe, që e kemi ruajtur e përpunuar, por vlen të bëhet edhe më tej me studimeve plotësuese apo vepra leksikografe (Shkurtaç, 2006, 229), e veçanërisht ato që prekin të ardhmen e saj (për grupmoshën fillore).

Duke folur për të drejtën Evropiane hapa të reja duhet të ndërmerren kundrejt të vegjëlve, integritet të tyre në një shoqëri tejet qytetare dhe evropiane. Gjuha e tyre që shpreh e duhet të shprehi kulturën, shoqërinë, traditën shqiptare, vlen të zërë vend jo vetëm në tekste mësimore, por edhe në vepra të tilla si thesaurus, fjalor mësimor që do t'i ndihmojnë në punët me shkrim e me gojë duke zhvilluar e shprehur qytetarinë e tyre njohuritë mbi etikën e estetikën duke realizuar të drejtën evropiane për përgjegjësinë, bashkëpunimin, tolerancën, përzgjedhjen, pjesëmarrjen.

Pas hireve dhe vlerave të mëdha të gjuhës angleze, por edhe gjuhëve të tjera të mëdha të Evropës e kemi për detyrë të tregojmë se për të vegjlit tanë ekziston në komunitetin evropian një numër fantastik fjalorësh për fëmijë, me piktura me përkufizime, thesaurus, enciklopedik, mësimor. Po ne?

Shqipja është në stade të tilla zhvillimi që mundësojnë përzgjedhjen. Përtej fjalorit që ekzekuton të drejtën qytetare apo politikën arsimore që realizojnë një edukim të tillë, besoj çdo qytetar i vogël evropian ka të drejtë të gjejë të gjejë shpjegimin, përfytyrimin, i integritimin, sugjerimin e botës dhe shoqërisë në gjuhën e tij. Kjo është po aq e nevojshme sa barazia materiale dhe shërbimet bazë, që të zhvillohet personaliteti e asaj që ne e quajmë të ardhme dhe që do të jetë evropiane.

Ndërkohë që testimet tona kombëtare nxjerrin rezultate të pakënaqshme në punët

e pavarura një pjesë e mënyrës së pavarur të shkruarit mësohet nëpërmjet fjalorëve. Duke komunikuar e folur bukur e mirë, besoj ka ardhur koha që edhe me modelet evropiane të plotësohet kuadri mësimor, dituror i shqipes që do të ndikonte në zhvillimin etik e social.

Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në diasporënë kuadër të rëndësisë që i kushtohet mësimi i gjuhës amtare në fokus të cilave janë skemat kulturore, konventat, vlerat në kuadër të "Edukimi për demokraci" nëkatër njësi kulturore shqiptare: në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në diasporën shqiptare, në Zvicër", ndaj vepra të tilla nuk i pret vetëm shkolla jonë, por e gjithë bashkësi shqiptare, edhe në trevat shqiptare jashtë Republikës. Qytetaria nuk është një fjalë e vetme. Ajo përbën një koncept bazë në shoqëri. Sferë semantike (Rrokaj, 2005, 117) e saj përfshin; të drejtën, moralin, etikën, qytetarin.

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe fjala etik, moral, qytetari e qytetar përkufizohen :

Etikë (Fjalori i gjuhës së sotme, 2005, 308) ~ 1. Shkenca që studion moralin, parimet, normat dhe rregullat e sjelljes së njerëzve në shoqëri 2. Morali i një shoqërie i një klase, i një grupi shoqëror

Moral (Fjalori i gjuhës së sotme, 2005, 804) ~ tërësia e parimeve, e normave dhe e rregullave që janë krijuar historikisht dhe në kushte të caktuara ekonomiko-shoqërore dhe që përcaktojnë sjelljen e veprimtarisë së njerëzve në një shoqëri; vetë sjellja e njeriut sipas këtyre parimeve, normave e rregullave. Moral i krishterë 2. Mësim a përfundim logjik që nxjerrim nga një ngjarje a nga diçka tjetër dhe na ndihmon në jetën e në veprimtarinë tonë. Morali i fabulës 3. Sjellje që lidhet me nderin; ndershmëri etj Qytetari (Fjalori i gjuhës së sotme, 2005, 1086) ~ Të qenët qytetar i ligjshëm i një shteti të caktuar, vetëdija e njeriut të lirë për të drejtat dhe detyrat që ka në një shtet; mënyra e jetesës në një qendër të banuar sipas rregullave e detyrave shoqërore. Ndjenjë e qytetarisë, Normat e qytetarisë

Qytetar (Fjalori i gjuhës së sotme, 2005, 1086) ~ mb 1. Që ka të bëjë me qytetin, i qytetit, që banon në qytet ose e ka prejardhjen nga qyteti familje qytetar . jetë qytetare 2. Libër Që është tipar dallues i njeriut të lirë, i cili është i vetëdijshëm për detyrat që ka në një shtet; që ka të bëjë me jetesën sipas rregullave dhe detyrave shoqërore , drejt. Civildetyrë qytetare. Edukatë qytetare. Të drejtat qytetare

Besoj se mund të jemi pak më konkretë, më të hapur e të thjeshtë për ta shpjeguar etikën kështu:

Etikëem ~ traditë, sjellje, marrëveshje, kuvend, mirësjellje, njerëzillëk, humanizëm, zakon, higjienë, dije.

Morale mb~ i mirë, i ndershëm, i nderuar, i drejtë, i virtytshëm em~ mësim, kuptim, mesazh Moral em~ qëndrim, mirëbesim, guxim, vetëolerësim, humor

Qytetarem ~ nënshëtitas i përgjegjshëm, emigrant apo vendas

Integrim do të thotë bashkim. Kështu, qytetarët e përcaktuar si produkt i prejardhjes, teorikisht mund t'i lënë vendin qytetarëve të mësuar që jetojnë në shoqëri bashkë me të tjerë, në një shumëllojshmëri situatash e rrethanash. Është e drejtë që duhet ekzekutuar. Nisur nga parime sa moderne, aq edhe tradicionale didaktike, mund të shtojmë dhe rëndësisë që ka lënda e gjuhës shqipe në zhvillimin social, etik dhe profesional të nxënësit mendojmë se parasysh këto kërkohet një përsosmëri të kompetencës leksikore së nxënësit, integrimi i plotë i njohurive ka për çelës gjuhën shqipe.

Mendoj se një vend si i yni nuk e ka aq të lehtë kostot e ndryshimeve të teksteve mësimore.

Për t'iu përgjigjur nevojave dhe vështirësive mund të hartohen fjalorë të integruar njohurish, thesaurus³ apo fjalor shpjegues për ciklin e arsimit bazë. "Mungesa e një pune të qartë e të plotë me fjalorin, mospërdorimi nga ana e nxënësve të fjalorit shpjegues, zbeh aftësinë e tyre për të hulumtuar për fakte e dukuri dhe kufizon mundësinë për të punuar në një shumëllojshmëri situatash mësimore (Gjokutaj, 91)".

E drejta qytetare i përket dimensionit kulturor dhe prodhimi sot të veprave leksikografike për të vegjël e të rinj, besoj është pjesë e një trashëgimie të qëndrueshme që duhet të shkëmbehet me të tjerat. E drejta⁴ qytetare evropiane i përket barazisë dhe mundësisë në edukim.

Besoj që përpiqemi shumë, por duhet të përpiqemi më tepër për ardhmërinë e shqipes dhe shqipes së qytetëruar.

Përfundime

Një vlerësim i traditës të autorëve që kanë kontribuar për zhvillimin etik të vegjëlve dhe të rinjve, tregonse duhen ringjallur vlerate kësaj periudhë të një humanizmi të lartë, që theksonin vlerën e dinjitetit të njeriut ndaj të cilës sot ndjejmë një afri morale dhe intelektuale.

Një përkufizim më i mirë i fjalëve dhe termave në fjalorë mësimor apo thesaurus në përshtatje me veçoritë moshore dhe që do të ketë një impakt në rritjen e kompetencave të tilla si qytetare, personale, njohurive mbi etikën dhe integrimin evropian, do të mbështeste zhvillimin e tyre shpirtëror dhe profesional.

Një fjalor mësimor i shqipes del si një mjet pune i domosdoshëm për t'iu pasur në bibliotekat dhe tavolinat e çdo shqiptari, si qytetar i vjetër i një kontinenti të vjetër.

Besoj, që këto rezultate e dallojnë e duhet ta dallojnë petkun tonë kombëtar në një botë globale.

Kjo që na ndihmon që të sugjerojmë që me një vepra leksikografike për të vegjël e të rinj, kemi zgjedhur një strategji të mirë për rritjen e kompetencave të tilla si qytetare, personale njohurive mbi etikën dhe integrimin evropian. të sigurt se nesër do të kemi një qytetar: ndryshe, të lirë, të fortë, të veçantë, të gjallë, të shkathët, bujar, publik, të hapur, të kujdesshëm, të mençur, të duruar, punëtor, vlerësues, jo fyes, të kënaqur, delikat, të vërtetë, të rritur, të inkurajuar, të mahnitshëm, të fortë, të bashkuar, fitues, të besës, të kuëndit, të gjendur, të urtë, të rregullt, të shëndoshë, të pastër, të dashur, të mirë, të drejtë, me personalitet, atdhetar dhe evropian.

Është e natyrshme të kemi besim se fjala e pavarur shqipe zhvilluar si komunikim qytetar do të jetë burrërore, fisnike, qytetare dhe largpamëse.

³ Disa vargje sinonimik eshkëputur nga projekti im përnjë fjalormësimor për CU:


e mirë~ e bukur, e dobishme, i aftë, e besueshëm, i sjellshëm, i virtytshëm, i ndershëm/ natyral~ i gjallë, i çiltërpunë~detyrë, projekt, profesion, përgjegjësi/ dorë~ndihmë~mbështetje~përkrahje bëj~ krijoj, ndërtoj, formoj 2. fitoj 3. performoj 4. zgjidh 5. plotësoj 6. shërbej 7. përgjigjem 8. plotësoj, 9 kënaq 10. ia dal 11. Vazhdoj/ ndërkombëtare~të gjithë botën~globale~universale/ qytetar~emigrant~banor~vendasit

⁴ E. Kunamano, E drejta e qytetarisë në BE; Liria si aftësi për veprim, barazia si mundësi e të gjithëve për të mira material dhe shërbime bazë në mënyrë që të mbrohet dinjiteti human, pjesëmarrja si nevojë për të kontribuar për interesin e përgjithshëm, përgjegjësi për vete, të tjerët dhe të ardhmen e botës dhe solidaritet mes popujve duke kapërcyer barrierat politike, kulturore dhe sociale. Këto janë thelbi për të drejtën demokratike të qytetarisë,

Bibliografi

- Dhrimo, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
A. Bishqemi, *Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë e për të rinj*, Tiranë, 2008.
J. Thomaj, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005.
J. Thomaj, M. Samara, A. Sinani. *Fjalashqipe dhe shkollajonë*. Gjuhajonë, VII, 2/1987, f. 18.
M. Gjokutaj, Karakteristikat e tëlexuaritësotëm, fq 91.
Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë, 2009.
Sh. Rrokaj, *Filozofia e gjuhës*, Tiranë, 2010.
Sh. Rrokaj, *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2005.

Shtojca



Trajtimi i Kushtit Penal s'i një ndër mjetet e sigurimit të ekzekutimit të detyrimeve që njihen në legjislacionin e sotëm shqiptar

Neritan Cena

Analizë

Një ndër mjetet më të përdorshme të sigurimit të ekzekutimit të detyrimeve në qarkullimin civil është kushti penal i cili mund të gjejë zbatim në çdo marrëdhënie kontraktore që palët mund të lidhin me njëra – tjetrën qofshin këta persona fizikë apo juridikë ose edhe vetëm persona juridikë. Sipas profesorit të njohur francez të së drejtës civile Boris Starch¹ në librin e tij e drejta civile detyrimet (droit civil, obligations), kushti penal është një ndërshkim i cili përfaqëson vlerësimin e dëmeve dhe interesave që mund të pësojë kreditori si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve ose ekzekutimit të vonuar të detyrimeve nga ana e debitorit, ku ky ndërshkim është gjithmonë një vlerësim kontraktual i dëmeve dhe interesave që mund të pësojë kreditori si rezultat i mospërbushjes ose përbushjes së vonuar të detyrimit nga ana e debitorit.

Në nenin 541 të Kodit Civil kushti penal përkufizohet si detyrimi për të paguar një shumë të hollash ose për të kryer një detyrim tjetër (të ndryshëm nga ai kryesor) për riparimin e dëmit ose për nxitjen e ekzekutimit të detyrimit. Një detyrim i tillë mund të parashikohet nga palët si në kontratën kryesore ashtu edhe në një dokument të veçantë. Në praktikën e përditshme një mjet i tillë parashikohet nga palët në përmbajtjen e kontratës kryesore në të cilën parashikohen edhe sanksionet për palët në rast se nuk e përmbushin detyrimin në mënyrën apo afatin e caktuar në kontratë mjafton të përmendim këtu rastet e kontratave të sipërmarrjes së lidhur ndërmjet palëve ku përgjithsisht parashikohet se në rast vonese në dorëzimin e veprës nga ana e sipërmarrësit ose të pagimit të çmimit nga ana e porositësit ata do të detyrohen që të paguajnë një penaltet të caktuar i cili përbën kusht penal dhe shërben si garanci për të nxitur palët që ti përmbushin detyrimet e tyre në mënyrën dhe afatin e caktuar në kontratë.

Nga përmbajtja e nenit 541 të K. Civil rezulton se rastet për të cilat mund të parashikohet kushti penal janë :

- a) Mospërbushja e plotë e detyrimeve;
- b) Mospërbushja e detyrimit në mënyrën e duhur.

Ajo që duhet theksuar dhe që del qartë edhe nga vetë përkufizimi i kushtit penal, është që ky i fundit nuk duhet kuptuar si një mjet që i jep mundësinë debitorit që të çlirohet nga detyrimi duke paguar kushtin penal, por përkundrazi ai ka për qëllim të nxisë ekzekutimin e detyrimit, ashtu siç përmendet edhe nga neni 541 i K. Civil. Kjo kuptohet edhe nga fakti se, debitori nuk ka të drejtë të zgjedhë midis ekzekutimit të detyrimit ose pagimit të kushtit penal, por është i detyruar të ekzekutojë detyrimin kryesor, ashtu siç është parashikuar në kontratë.

Qëllimi kryesor i cili i shtyn palët që në një marrëdhënie kontraktore të parashikojnë kushtin penal është dyshimi që ata mund të kenë në aftëritë përmbushëse dhe

¹ Droit Civil, Obligations me autor Boris Starch

korrektesën ndaj njëra – tjetrës. Gjithashtu qëllimi i aplikimit të kushtit penal është se **Së pari**: Kushti penal mënjanon ose më qartë shmang vështirësitë e vlerësimit gjyqës/r të dëmeve dhe interesave. Aplikimi i kushtit penal përbën një marrëveshje ndërmjet palëve i cili mënjanon diskutimin mbi realitetin dhe rëndësinë e dëmtimit tek kreditori. Megjithatë siç do të shohim edhe më vonë debitori ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë pakësimin e kushtit penal kur ky i fundit është më i lartë se dëmi që në fakt ka pësuar kreditori si rezultat i mospërbushjes së detyrimit nga ana e debitorit ose të ekzekutimit jo në mënyrën e duhur të tij..

Së dyti : Kushti penal vepron njëkohësisht edhe si një mjet presioni mbi debitorin. Në disa raste kur qëllimi fillestar për të nxitur ekzekutimin e detyrimit nuk arrihet, atëherë kushti penal shërben për të shpërblyer dëmet. Në praktikë si për të vërtetuar këtë tezë, kushti penal parashikohet përgjithësisht më i lartë se dëmet, në mënyrë që kreditori të jetë i mbuluar nga humbjet dhe për debitorin del më e leverdisshme të ekzekutojë detyrimin sesa të paguajë kushtin penal.

Më lart theksuam se kushti penal zbatohet në dy raste ;

1. Kur detyrimi nuk ekzekutohet dhe në këtë rast kreditori ka të drejtë të kërkojë ose ekzekutimin e detyrimit ose pagimin e kushtit penal dhe dëmeve që e kalojnë sasinë e kushtit penal.
2. Kur detyrimi nuk ekzekutohet në mënyrën e duhur dhe në këtë rast kreditori ka të drejtë të kërkojë kushtin penal si dhe sasinë e dëmeve të shkaktuar në mënyrë kumulative.

Pavarësisht nga fakti se në Kodin Civil nuk bëhet një klasifikim i kushtit penal, personalisht mendoj se kur palët në marrëveshje parashikojnë se në rast mosekzekutimi të detyrimit nga ana e debitorit ky i fundit do të detyrohet t'i paguajë kreditorit një shumë të caktuar të hollash ose kryerjen e një detyrimi tjetër kemi të bëjmë me kusht penal vlerësues për shkak se shuma e caktuar si kusht penal përfaqëson vlerën e dëmeve dhe interesave që kreditori ka pësuar si rezultat i mospërbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, ndërsa në rastet kur kushti penal është parashikuar për mospërbushje të detyrimit në mënyrën e duhur nga ana e debitorit kemi të bëjmë me kusht penal gjobor ose disiplinor. Dallimi ndërmjet tyre qëndron në faktin se i pari i nënshtrohet afateve të posaçme të parashkrimit dhe konkretisht afatit 6 mujor të parashikuar nga neni 115 gërma "a" e K.Civil ndërsa për të dytin nuk mund të flitet për afat parashkrimi. Nga aplikimi i kushtit penal gjobor del edhe karakteri nxitës i ekzekutimit të detyrimit nga ana e debitorit i cili krahas ekzekutimit të detyrimit do të detyrohet të paguajë edhe kushtin penal për përbushje jo në mënyrën e duhur të detyrimit. Natyrisht që edhe si rezultat i parashikimit të kushteve penale vlerësuese nuk përjashtohet karakteri nxitës i ekzekutimit të detyrimit nga ana e debitorit për shkak se për debitorin do të ishte më e leverdisshme ekzekutimi i detyrimit sesa pagimi i kushtit penal i cili përgjithësisht është më i lartë sesa vlera e detyrimit. Mendoj që këto dy kushte penale mund të bashkëekzistojnë brenda të njëjtës marrëveshje që palët mund të lidhin me njëra – tjetrën për zbatimin e kushtit penal. Në rastin e parë pra në rastin e zbatimit të kushtit penal vlerësues ai nuk përbën gjë tjetër vetëm se një llogaritje paraprake e dëmeve që mund të vijnë nga mosekzekutimi i detyrimit nga ana e debitorit dhe në këtë rast ka për qëllim të shkarkojë palën nga barra e provës për dëmet, prandaj kreditori mund t'i kërkojë ato në mënyrë alternative në rast se nuk do të jetë i interesuar më që debitori të ekzekutojë detyrimin e tij. Ndërsa në rastin e dytë

ekzekutimi i detyrimit do të shoqërohet së bashku me pagimin e kushtit penal pra aplikimi i kushtit penal në këtë rast nuk do të shërbejë si alternativë për kreditorin siç shërben në rastin e kushtit penal vlerësues ku i përket kreditorit të zgjedhë nëse do të kërkojë ekzekutimin e detyrimit ose pagimin e kushtit penal.

Siç u theksua edhe më lart pavarësisht nga fakti se në dispozitat e K.Civil që bëjnë fjalë për kushtin penal nuk bëhet një klasifikim i kushtit penal indirekt nga përmbajtja e neneve 542 dhe 543 të K.Civil del që kushti penal ndahet në kusht penal vlerësues dhe gjobor ose disiplinor.

Kështu në nenin 542 të K.Civil parashikohet se :

“Kreditori nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit”

Ndërsa në nenin 543 paragraf 1 të K.Civil parashikohet se :

“Kur kushti penal është caktuar për rastin e moszekutimit të detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal” .

Ndërsa në nenin 543 paragraf 2 të K.Civil parashikohet se :

“Kur kushti penal është caktuar për rastin e ekzekutimit të detyrimit jo në mënyrën e duhur, dhe debitori nuk e ka ekzekutuar detyrimin e tij në mënyrën e duhur, kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal” .

Nga përmbajtja e neneve 542 dhe 543 paragraf 1 të K.Civil rezulton se kemi të bëjmë me kusht penal vlerësues i cili përfaqëson vlerën e dëmit që pëson kreditori si rezultat i mospërmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit ku këto dispozita e kushtëzojnë zgjedhjen e tij çfarë do të thotë se kreditori ka të drejtë të kërkojë ose ekzekutimin e detyrimit ose pagimin e kushtit penal. Ndërsa nga përmbajtja e nenit 543 paragraf 2 i K.Civil rezulton se kemi të bëjmë me kusht penal disiplinor i cili caktohet me marrëveshje të palëve me qëllim për të nxitur ekzekutimin e detyrimit madje kreditori ka të drejtë që në një rast të tillë të kërkojë jo vetëm ekzekutimin e detyrimit por edhe pagimin e kushtit penal.

Ajo që duhet theksuar është fakti se parashikimi i kushtit penal nuk përfaqëson shembullin e një marrëveshje të kushtëzuar ose të një detyrimi me kusht, në kuptimin që realizimi i marrëveshjes qëndron pezull deri në verifikimin e mospërmbushjes për shkak se verifikimi i mospërmbushjes është një element krijues dhe jo kushtëzues për zbatimin e kushtit penal në ndryshim nga veprimi juridik me kusht ku ngjarja e kushtëzuar do të duhej të përmbushej me anë të veprimeve të atij personi i cili do të kishte interes që ngjarja të mos ndodhte.

Duke u nisur nga kuptimi i kushtit penal si një kontratë aksesore dimë që debitori nuk ka të drejtë të zgjedhë detyrimin që do të përmbushë por ai duhet t'i përmbahet parashikimeve të bëra në kontratë. As kreditori nuk ka të drejtë zgjedhjeje para ekzekutimit, kjo e drejtë i lind atij kur detyrimi nuk është përmbushur dhe ai mund të kërkojë, ose ekzekutimin e tij ose pagimin e kushtit penal. Prandaj si përfundim duhet të themi se kushti penal është një detyrë aksesore e cila i bën të mundur kreditorit që të bëjë të mundur ekzekutimin e kontratës dhe në rast se atë nuk e arrin atëherë ai bën të mundur që më shpejt dhe më lehtë të marrë dëmshpërblimin. Kjo vjen si pasojë e faktit që kreditori nuk është i detyruar të provojë dëmin deri në kufijtë e kushtit penal (as të provojë ardhjen e dëmit dhe as sasinë e tij);; por ai do të shpërblehet për

të, ashtu siç është kontraktuar nga palët. Kreditori detyrohet të provojë vetëm dëmin përtej kufijve të kushtit penal në qoftë se do të kërkojë të shpërblehet edhe për të. Në praktikën gjyqësore shpesh herë ndodh që nga ana e kreditorit të kërkohej edhe përmbushja e detyrimit edhe pagimi i kushtit penal nga ana e debitorit dhe jo rrallë herë edhe nga ana e gjykatave vendoset detyrimi i debitorit që të paguajë edhe vlerën e detyrimit edhe vlerën e kushtit penal për të cilin palët kanë rënë dakord në kontratë. Një qëndrim i tillë është i gabuar për arsye se siç u theksua edhe më lart në rast të mospërmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit kreditori ka të drejtë të kërkojë ose përmbushjen e tij ose pagimin e kushtit penal kjo del edhe nga vetë përmbajtja e nenit 542 të K.Civil në të cilin parashikohet se :

“Kreditori nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit”.

Në fakt e drejta e zgjedhjes i përket kreditorit nëse do të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose pagimin e kushtit penal.

Marrëveshja për kushtin penal duhet të bëhet me shkrim pavarësisht nga lloji dhe forma e kontratës kryesore (neni 545 i Kodit Civil). Forma me shkresë për marrëveshjen për kushtin penal kërkohej jo për efekt vlefshmërie, por për efekt provueshmërie. Kjo do të thotë që në qoftë se marrëveshja nuk është bërë me shkrim ajo nuk do të jetë e pavlefshme, por vetëm nuk mund të provohet me dëshmitarë. Ky përfundim rrjedh nga parimet e përgjithshme të Kodit Civil, për vlefshmërinë e veprimit juridik.

Kushti penal vjen si pasojë e fajit të debitorit, i cili prezumohet (si në çdo rast tjetër të përgjegjësisë në të drejtën civile në të cilën faji prezumohet) dhe kreditori nuk është i detyruar ta provojë atë. Debitori në qoftë se dëshiron të çlirohet nga detyrimi, duhet të provojë se mospërmbushja e kontratës nuk ka ardhur për faj të tij, por për rrethana të cilat nuk mund t'i ndalonte (siç mund të jetë rasti i forcës madhore ose ai i rastit faktor), ku në një rast të tillë kreditori nuk mund të kërkojë pagimin e kushtit penal për shkak se mosekzekutimi i detyrimit ka ardhur për shkaqe të pavarura nga vullenit i debitorit.

Ky përfundim del edhe nga karakteri plotësues i kushtit penal, dhe në rastin kur mosekzekutimi i detyrimit ose ekzekutimi i parregullt i tij, ka ardhur si pasojë e rrethanave të cilat debitori nuk mund t'i ndalonte, pra nuk ka faj për përmbushjen e detyrimit kryesor, atëherë nuk ka vend të kërkohej edhe pagimi i kushtit penal. Ky përfundim shpjegohet me faktin se pamundësia e ekzekutimit të detyrimit pa fajin e debitorit e shkarkon këtë nga detyrimi, ai shuhet, dhe si pasojë duke mos ekzistuar një detyrim kryesor, nuk ekziston as kushti penal si një detyrim plotësues, sepse ai ndjek fatin e detyrimit kryesor.

Palët kontraktuese vendosin lirisht për madhësinë e kushtit penal. Kjo e drejtë është një zbatim i parimit të lirisë kontraktore por me qëllim për të shmangur abuzimin kur kushti penal është caktuar shumë më i lartë se dëmi, atëherë ai mund të ulet nga gjykata. Është për tu theksuar se, ulja e kushtit penal mund të bëhet vetëm gjatë një procesi gjyqësor dhe duhet të kërkohej nga debitori. Gjithashtu ulja e kushtit penal nuk mund të bëhet kurdoherë, por vetëm në rastet e parashikuara në ligj. Neni 544 i Kodit Civil i ka vënë një limit uljes së masës së kushtit penal domethënë, gjykata mund të ulë kushtin penal deri në kufijtë e dëmit të pësuar. Ajo s'mund të ulë dëmin përtej këtyre kufijve. Duke u bazuar në përfundimet e mësipërme i vetmi limit që kemi para të vendosur për vendimin e gjykatës ka qenë interesi i debitorit.

Në rastet kur debitori do të kërkojë nga gjykata uljen e kushtit penal, është ai që duhet të provojë se kushti penal është kontraktuar në një shumë, shumë më të madhe se dëmi që kreditori ka pësuar dhe është gjithashtu debitori ai që duhet të provojë edhe sasinë e dëmeve që i kanë ardhur efektivisht kreditorit, pasi për këtë të fundit sasia prezumohet në kufijtë e kushtit penal. Duke u nisur nga sa u tha më sipër, gjykata mund të ulë shumën që do të paguhet si kusht penal nga debitori duke u bazuar në kriteret e mësipërme, por ajo kurrësi nuk mund të vendosë ta shkarkojë debitorin nga pagimi krejtësisht i kushtit penal.

Por në qoftë se kreditori, përveç kushti penal do të kërkojë edhe sasinë e dëmeve përtej kushtit penal (ashtu siç neni 543/1 i Kodit Civil i jep të drejtë) atëherë barra e provës i bie kreditorit për të provuar ardhjen e këtij dëmi dhe sasinë e tij, e cila duhet të jetë më e madhe se kushti penal. Në analogji sa u tha më sipër në qoftë se debitori do të pretendojë se kushti penal është shumë më i lartë se dëmi që i është shkaktuar kreditorit, i takon atij të provojë sasinë e dëmit në qoftë se do të kërkojë nga gjykata uljen e dëmit.

Pra barra e provës përcaktohet nga dy parime të rëndësishme të së drejtës :

1. parimi i prezumimit të fajësisë në përgjegjësinë civile.
2. barra e provës për të provuar një fakt i takon atij që e pretendon atë.

Parashkrimi i kushtit penal

Kur folëm për kuptimin e kushtit penal theksuam që ai ndahej në kusht penal vlerësues dhe në kusht penal disiplinor ku kjo ndarje bëhet jo vetëm për efekt të kërkimit por edhe për efekt të parashkrimit duke theksuar se afati i posaçëm i parashkrimit prej 6 muajsh i parashikuar nga neni 115 pika a e K.Civil i referohej vetëm kushtit penal vlerësues dhe jo kushtit penal disiplinor për të cilin nuk gjen zbatim ky afat i posaçëm parashkrimi.

Ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje është se :

A ka të drejtë kreditori të kërkojë shpërblimin e dëmit pasi është parashkruar padia për kërkimin e kushtit penal?

Nëse po a nuk do të përbënte kjo një mënyrë të tërthortë për të kërkuar kushtin penal kur ky është parashkruar bëhet fjalë këtu për kushtin penal vlerësues që parashikohet për mosekzekutimin e detyrimit dhe që parashikohet në mënyrë alternative me kërkimin e dëmeve)?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet t'i referohemi jo vetëm qëllimit të kushtit penal, por dhe parimeve që parashikohen në Kodin Civil.

Siç dhe kemi theksuar më lart kushti penal ka për qëllim të tij të nxisë ekzekutimin e detyrimit dhe duket qartë që, në fazën në të cilën jemi duke analizuar problemin që shtruar më lart ai nuk e ka arritur këtë qëllim. Përveç kësaj kushti penal (vlerësues), siç e kemi përmendur më parë është një përlllogaritje e dëmeve të mundshme duke synuar kështu sidomos, lehtësimin e barrës së kreditorit për këto dëme. Me parashkrimin e padisë për kërkimin e kushtit penal kreditori do të humbasë këtë privilegj të dhënë nga ligji, prandaj do të ishte më e leverdisshme për të, që të vepronte në kohë.

Por nga ana tjetër nuk ka asnjë arsye që të rëndohet së tepërmi pozita e kreditorit duke mos iu lejuar atij të padisë debitorin për dëmet, apo të marrë vetëm sasinë e

dëmeve përtej kushtit penal. Duke mbajtur parasysh këtu se, padia për shpërblimin e dëmeve lind nga detyrimi kryesor dhe gjithashtu se kushti penal kontrahohet në përgjithësi nga palët në një shumë më të lartë se dëmet e parashikuara në mënyrë që kreditori të jetë i siguar.

Neni 124 i Kodit Civil parashikon gjithashtu se parashkrimi i padisë për kërkesën kryesore shkakton parashkrimin e padisë edhe për kërkesën aksesore dhe jo anasjelltas. Prandaj duke u bazuar në ato që u thanë më sipër kreditori duhet të ketë të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmeve. Rënia e prezumimit në favor të debitorit është një dënim i mjaftueshëm për mosushtrimin e padisë brenda afatit të parashikuar nga ligji. Prandaj në këtë rast debitori do të ketë barrën e provës për gjithshka që ai do të kërkojë para gjykatës, por e drejta e tij nuk do të parashkruhet.

Dy specie të reja në listën e peshqëve të shqipërisë

Msc. Gegë Ndoka

Gjinnazi jopublik "Rogacionistet", Lezhë

Abstract

In this article are scientifically described, morphological and bio-metric features, ecology, distribution, scientific and economic importance, status, location and time of capture for two new species in Albania. Also there are briefly described some of the key data for 32 other species that are caught in the lagoons of Lezha Kune and Vain. The aim of this work was to study and listing of fish species for these lagoons, but two species not known until now in Albania, were discovered during research work, which forms the basis of this article. The research paper is based on the original conserved biodiversity in these lagoons, which includes species that do not apply to fisheries. Based on original material gathered during a year, I have described 34 species classified in 9 orders, 17 families and 27 genus. The importance of this study lies in the fact that these species are not listed previously by other author and for the first time, they listed scientifically highlighting two new species of fish within Albania. With the listing of these species is given a more complete configuration and accurate fish diversity Kune-Vain lagoon. In this article, it is succinctly described fauna and flora of the area, hydrology, some physico-chemical characteristics of wastewater lagoons, and climatic features. To provide the requested information is scientific study based on research, comparative, interactive and laboratory methods. Referring to this resource with ecological, economic, tourist, scientific and didactic, I recommend that institutions management, research and scientific perform full investment toward a deeper study of all biological diversity of these wetlands that comprise the main habitat and his heart, and that have a value in preserving the diversity of irreplaceable national and international living species.

Fjalët kyçe: Species, morphology, Lagoon, Kune-Vain, fish.

Hyrje

Lagunat shquhen si zemra të ekosistemeve bregdetare me habitate shumë të përshtatshme për diversitet të lartë biologjik. Në këto laguna konsevohet një fond i gjallë natyror që veshtirë të gjendet në ekosisteme të tjera, Peshqit janë rruazorët më të përshtatshëm për këto ujra ku i jepet mundësia e shfrytëzimit të kriposhmerisë së lartë e të ulët, në varësi të stineve vjetore, prandaj këto mjedise janë shumë favorizuese për të bërë kerkime shkencore mbi biodiversitetin. Nga të dhënat paraprake rezultoi se për lagunat në përgjithësi në Shqipëri mungonjë studime shkencor të kësaj natyre, e në veçanti për Lagunat Kune dhe Vain të Lezhës nuk rezultoi asnjë studim i mirfilltë shkencor për listimin e peshqëve të kapura në këto laguna, e për rrjedhojë, një studim i tillë ishte i nevojshëm si një vlerë më tepër në fushën e shkencës natyrore. Ky studim është rezultat i një pune kerkimore një vjeçare të realizuar gjatë periudhës Dhjetor 2011-Dhjetor 2012, ku janë përshkruar karakteristikat e pergjithshme dhe specifike të llojeve të peshqeve lagunor, matjet biometrike, sistematika, veçoritë dalluese, ekologjia e tyre, përhapja dhe rëndësia ekonomike e shkencore, statusi i tyre etj.

Punimi bazohet në fondin original të ruajtur në këto laguna. Bazuar në materialin original, është bërë një përshkrim i saktë e në menyre shkencore i **34 specieve** të kapura në këto laguna, duke u referuar në literaturat keyesore të autorëve më të njohur shqiptar e të huaj. Rëndësia e këtij studimi qendron në faktin se për herë të parë listohen shkencërisht speciet e peshqeve të sistemit lagunor Kune-Vain dhe statusi i tyre duke veçuar këtu dy specie të reja të kapura të cilat i shtohen për herë të parë listës së peshqëve të Shqipërisë.

Nga **349** speciet e peshqëve të regjistruara në Shqipëri, sipas(Dhora, 2010), në sistemin lagunor Kune-Vain janë kapur, fotografuar e përshkruar **34** specie të klasifikuara në **9 rende, 17 familje** dhe **27 gjini**, nga të cilat veçojmë **2** specie të familjës **Gobidae**, pikerisht: *Pomatoschistus marmoratus* dhe *Zosterisessor ophiocephalus*, që shtohen për herë të parë në listën e peshqëve të Shqipërisë, duke e quar këtë listë në **351 specie**. Punimi shoqerohet me foto origjinale të specieve. Këtujepet literatura e përdorur për qellime studimore në këto laguna.

Për realizimin e kësaj pune falenderoj pedagogët e Fakultetit të Shkencave Natyrore të USH "Luigj Gurakuqi" Shkoder, drejtuesit, ishdrejtuesit dhe specialistët e peshkimit, si dhe në menyre të veçantë peshkatarët e zonës Kune-Vain, që më mbështetën gjatë gjithë kohës së kryerjes së studimit.

Të dhëna të përgjithshme mbi sistemin lagunor Kune-Vain

Pozita gjeografike

Sistemi lagunor kune-Vain bën pjesë në Ultësirën Perendimore të zonës Mesdhetare Fushore të Shqipërisë Veriore, buzë detit Adriaetik, midis paralelit 41°50' dhe meridianit 19°40', 5 km në perendim të qytetit të Lezhës. Shtrihet në të dy anët e lumit Drin në formë brezi me gjatësi 10 km dhe gjërësi 1.8-5 km, me një sipërfaqe 2297 ha, me një vijë bregdetare 16.2 km të ndara:

- 1.Sipërfaqe ujore-50.4%
- 2.Pyje-10.4%
- 3.Sipërfaqe e përmbytur nga uji, ligatina, pellgje uji-26.6%
- 4.Kanale, rrugë, ndertesa, kullota, tokë arë-8.8%
- 5.Plazhe-4.4%

Masivi Kune-Vain është formuar nga veprimtaria tektonike dhe energjia e lumit Drin. Produktet e imëta të alternimit në formë llumrash u transportuan nga rrymat e ujrave dhe u vendosën në pellgun detar në Delten e lumit Drin e cila është mbushur intensivisht me depozitime aluvionale që u zhytën drejt detit Adriatik, ndersa në veri e në lindje ato kufizohen nga zona malore me pwrbrwjw kryesisht gelqerore.

Karakteristikat fizike

Nr	Parametrat	Njesia	Kune	Vain
1	Gjatësia maksimale	m	5800	3750
2	Gjerësia maksimale	m	950	2000
3	Thellësia maksimale	m	5	4.5
4	Thellësia mesatare	m	1	1
5	Sipërfaqe ujore	ha	250	850

Klima

Sistemi Lagunor Kune-Vain në bazë të monografisë “Klima e Shqipërisë” ndodhet në zonën Mesdhetare Fushore Veriore, që dallohet për klimen e butë të kushtëzuar jo vetëm nga relievi i ulët, por edhe nga ndikimi i ndjeshëm i masave të ngrohta ajrore detare. Nga perëndimi, kjo zonë është krejt e hapur, ndersa nga ana veriore dhe lindore është e kufizuar nga mallet e larta të cilat ndikojnë në depertimin e masave ajrore me origjinë kontinentale që nëpërmjet luginave lumore zbresin deri në hapësirën bregdetare të Adriatikut. Kjo zonë ka potencial të madh energjie dhe diellzimi. Zgjatja relative e diellzimit është 57% në vit, ndersa numri i ditëve me diell është 231 ditë në vit. Në këto kushte, temperatura mesatare mujore e ajrit ndryshon në kufijt tepër të gjërë nga 6.9°C në Janar që është muaji më i ftohtë i vitit dhe 24°C në Gusht, që është muaji më i ngrohtë. Temperatura mesatare vjetore e ajrit në këto zona ka qenë 16.8°C. Me gjithë afërsinë me detin, verehen dhe vlera mjaft të ulëta të temperaturave minimale të ajrit që në situatë të veçanta sinoptike e kalojnë kufirin -10°C.

Hidrologjia

Nga pikpamja hidrologjike sistemi lagunor Kune-Vain është mjaft kompleks pasi në të derdhen ujra kontinentale, puse artizanale, lidhja me lumin Drin, derdhjet e ujrave të hidrovoreve në Ishull Shengjin e Tale. Ujëkembimi mes detit dhe lagunave bëhet nëpërmjet grykave të cilat shpesh mbyllen nga rëra që sjell deti. Në këtë mjedis krijohen ekosisteme ujore me pozicione të ndërmjetme mes tokës dhe ujrave detare si sigures të ushqimeve me origjinë kontinentale. Ndarja funksionale e këtij mjedisi ngre në një shkallë të madhe ekologjinë kontinentale duke e bërë atë më të dallueshme se të tjerat. Në pjesën veriore të këtij kompleksi (Kulari) dhe në pjesën lindore (Lymi), thellësia arrin deri në 6m e cila ka një vlerë universal në drejtimin dhe organizimin ihtik që në saj të stratifikimit termik, kriptomëria bie duke i dhënë mundësi grumbullimit të llojeve dhe masave të ndryshme të peshkut në rastet kur bie temperatura dhe ngrihet shtresat e sipërme të ujit.

Drejtimi kryesor i ujrave nëntokësore është Juglindje drejt Veriperëndimit d.m.th. nga shtrati i lumit Drin në drejtim të detit. Ujrat nëntokësore janë 0.5-1.2m, mineralizimi 0.5-0.83%. Lagunat ndryshojnë shpesh nivelin e ujrave jo vetëm nga dita në ditë, por dhe dia herë gjatë 24 orëve me influencat e baticë-zbaticave. Regjimi hidrik i lagunave përcaktohet nga dendësia e procesit të ujëkëmbimit me detin, nëpërmjet grykave dhe kanaleve të komunikimit. Ky proces është rrjedhim i baticë-zbaticës. Amplitudat e nivelëve të ujrave në laguna janë shumë më të vogla se ato të detit të hapur. Kjo vjen nga aftësia e pamjaftueshme shkarkuese e kanaleve që lidhin lagunat me detin. Vëllimi i ujrave që grumbullohen në lagunat bregdetare nga rreshjet ka ecuri të kundërt me sasinë e ujit që largohet prej tyre gjatë procesit të avullimit. Kjo bën që nivelet e ujrave të lagunave gjatë periudhës së thatë të jenë më të ulëta, ndersa gjatë periudhës së lagësht ato janë më të larta. Temperatura në dimër zbret deri 1°C dhe në verë arrin 43-44°C. Salaniteti në dimër është 20-32% dhe në verë 65-75%.

Habitatet

Lagunat janë sisteme më produktive të botës së gjalle me një biodiversitet të lartë. Ato përbëjnë një kompleks habitatesh të përshtatshme për praninë e një larmie organizmash të gjalla. Ky diversitet i lartë biologjik i dedikohet faktoreve favorizues kryesisht atyre ekologo - gjeografik.

Në këto laguna gjenden tipe, nën tipe e komunitete të ndryshme habitatesh si :

1. Det – bregdet
2. Ligatinor që përfeshijnë grykederdhjen e lumit Drin, habitatet lumore, kënetore, lagunore
3. Jo ligatinore që përfeshijnë pyjet, shkurret, livadhët , tokat arë.

Aspekte floristike

Lagunat e Lezhës kanë një shumëllojshmeri të madhe bimësh të larta që i kalojnë 250 lloje të ndara në bime lignozë dhe herbozë. Në bimët lignozë bëjnë pjesë pyjet dhe shkurret, ndera në ato herbozë bëjnë pjesë bimët gramofite. Sipas studimeve të bëra nga prof. dott M.Marsimllari dhe prof. dott A. Mullaj gjenden 277 lloje bimesh të ndara në 67 familje, 202 gjini nga të cilat 16 lloje janë të rrezikuara.

Vegjetacioni ujqor mbulon një sipërfaqe të rëndësishme në fundet e lagunave të këtij kompleksi Kune-Vain. Aspektet kryesore që formojnë “livadhe nënujqore” të lagunave janë *Ruppia cirrhosa* dhe *Zostera noltii*. *Zostera nolti* ka një përhapje të gjërë duke i dhënë fizionominë kryesore “livadheve nënujqore”ku mbulon 40-50% të sipërfaqës totale të fundeve lymore të lagunave. Biocenozat e ketyre dy specieve bimore përfaqësojnë burimin kryesor për prodhimin e okigjenit i domosdoshëm për ekzistencën e faunës ujqore, strehen dhe ushqimin e kësaj faune, e sidomos për peshqit.

Aspekte faunistike

Sistemi lagunor Kune-Vain dallohet për një shumëllojshmeri organimash shtazore. Nga gjallesat e ulta dominon *Rhizostoma pulmo* në muajt e nxehtë të verës takohen nëpër xunktha dhe ferra, përfaqësues të gjinive *Colias*, *Gonopteris etj*. Nga ortopteret nëpër barishtoret bie në sy karkaleci *Lacusta migratoria*. Buzë ujrave takohet *gjinia Libellula* e *Odonatoptereve, Coleoptera si dhe gjinia Culex* e mushkonjave. Në vijë kular gjenden përfaqësues të klasës *Hydrozoa*. Nga *crustacea* dominojnë: *Carcinus aestuarii*, por nuk mungojnë *Squilla mantis, Penaeus kerathurus*.

Tek molusqet Zoterojnë kudo gjinitë *Helix* dhe *Helicigona*. Kudo shihen në sasi të mëdha guacka dykapakore ku dominojnë gjinitë *Cardita, Mytilus* dhe *Tellina*. Nga gastropodet zoteron gjinia *Murex*, por janë prezent dhe *Cephalopoda* si: *Sepia officinalis* dhe *Octopus vulgaris*.

Peshqit: Lidhja e lagunave me detin nëpërmjet grykave ka krijuar kushte të përshtatshme për furnizimin e tyre me peshq të llojeve të ndryshme të cilat futen nëpër gjole në kerkim të ushqimit. Në sistemin lagunor Kune-Vain dominojnë qefuj, spalca, ngjala, levreku, shojza, aterina etj. Të gjithë llojet e peshkut që gjenden në këto laguna kryesisht migrojnë nga deti në lagunë dhe përbëjnë rreth 18.5% të llojeve të peshkut që gjenden në Shqipëri.

Zvarraniket: Nga zvarraniket takohen kudo breshkat, gjarperinjte dhe zhapinjte ku dominojnë: *Emys orbicularis*, *Testudo hermani*, *Tarentola mauritanica*, *Lacerta viridis*, *Pseudopus apodus*, *Natrix natrix*, *Natrix tessellata*, *Vipera amodytes*.

Amfibet: Në kompleksin lagunor Kune-Vain takohen *Bufo viridis*, *Pelophylax ridibunda*, *Rana dalmatina*, *Salamandra salamandra*, etj.


Shpendet: Në lagunat e Lezhës gjenden 196 lloje shpendesh të ndarë në: të përhershëm, dimeronjës, veronjës, aksidental. Prania e kolonive të shpendeve në lagunë tregon potencialin e lartë të biodiversitetit dhe mundësive rekreative.

Gjitaret: Në këto laguna gjenden edhe mjaft gjitarë carnivore, insektivore e herbivore: *Vulpes vulpes*, *Lepus europaeus*, *Mustela nivalis*, *Canis aureus*, *Rattus norvegicus* dhe *Lutra lutra*.

Përshkrimi i specieve të kapura

1- *Pomatoschistus marmoratus* (Risso, 1810)

Gobius reticulatus (Valenciennes, 1837)



Gobius leopardinus (Nordmann, 1840)

Gobius ferrugineus (Kolombatovic, 1891)


Atherina marmorata (Risso, 1810)

Gobius microps microps (Buen, 1923)

Gobius (Pomatoschistus) microps (Borcea, 1934)

Emertimi shqip:

Rendi - Perciformes



Familja - Gobiidae

Gjinia - Pomatoschistus

Gjatësia maksimale: 65 mm

Vendi i kapjes: Merxhan, (Korrik-Gusht)

Materiali: 10 individë me gjatësi 25-45mm

Veçoritë dalluese:

- Forma e trupit shumë e zgjatur, me gjatësi deri në 65mm, por e zakonshme është 30-45mm, me 40-46 (37-48) luspa në serinë anësore. Rruaza 33 (31-34).
- Zona nga koka e deri në rrezen e fundit të pendës së parë dorsal është pa luspa dhe ka kanale mupkze në kokë.
- Luspat e trunqut janë shumë më të mëdha se ato të pjesës së përpërme të trupit, ndersa në pjesën e përparme të barkut ka luspa të vogla cikloide.
- Goja relativisht e madhe me dhëmbë të vegjel, të shumtë, konike, të përkulur nga prapa dhe të prirur në disa rreshta.

- Çarja e gojës arrin në nivelin e skajit të përparëm të syrit.
- Sytë janë të vendosur shumë lart, me formë lehtësisht ovale dhe hapësira interorbitale është e ngushtë (10-15% e HL.). Bebjë e syrit me ngjyrë të gjelbër në blu.
- **Pendët:** D1 VI (V-VII); fillon gati në gjysmën e pendës së gjoksit. Lartësia e saj tek mashkulli është më e ulët se e trupit, ndersa tek femra është e barabartë. Rrezja e dytë dhe e tretë janë më të larta. Ka tre breza të errët që alternohen me breza të bardhë. Në rrezet 5-6 tek mashkulli ka një njollë të errët-blu. D2 I + 9 (8-10); pak më e lartë se e para dhe me 4-5 breza të errët të alternuara me breza të kthjellët. Hapësira interdorsale është më e madhe se tëk speciet e ngjashme, me dimensionet e saj sa gjatësia e diametrit të syrit. A I + 9 (8-10); fillon në drejtimin e rrezëve 2-3 të pendës së dytë kurrizore dhe mbaron pak para saj. Normalisht është transparente. P 19-20 (17-21), shumë të zhvilluara, përfundojnë në drejtim të fundit të pendës së parë dorsal dhe janë me pak kolorime. Pënda barkore V, lehtësisht e pigmentuar, me skaje lehtësisht të zbkuruara. Penda e bishtit C, me skaje disi të rrumbullakosura dhe gjatësia e saj është më e shkurtër se e kokës, ka 4-7 breza të errët.
- **Ngjyrimi:** Trupi me ngjyrë gri. Skajet e luspave të pajisura me kromatofore. Përgjatë kurrizit duken qartësisht njëra pas tjetrës 5 zona të veçuara në formë shale, ku e para lokalizohet në fillim të pendës së parë kurrizore, e dyta dhe e treta korespondojnë me fillimin dhe fundin e shirita të errët njeripastjetrit pendës së dytë kurrizore, e pesta në fund të trungut të bishtit dhe e katërta midis dy të fundit. Në gjatësinë anësore dukën qartë 6-7 shirita të errët njeripastjetrit ku i fundit përfundon në trungun e bishtit në formë çekiçi. Gjithashtu këto njolla nuk janë karakteristike e kësaj specie. Në skajin e poshtëm-anësor të syrit kalon një brez i errët që përfundon në buzë, paralel dhe poshtë kasaj ekzistojnë disa të tilla vija të shkurtëra. Tëk femra është e pranishme në mjekër një njollë e shkurtër e madhe në formë triëndore, ndersa tëk mashkulli është më e dobët dhe më pak evidente. Ngjyrat tëk femra janë më pak intensive se tëk mashkulli.


Ekologjia: Në ujrat bregdetare, me rërë të cekët, në 20 m (madje mbi 60-70 m në dimër në Detin e Zi); hyn në ujërat e njelmëta dhe hipersaline. Ushqehet me Krustace të vegjël, poliketë, larva etj. Riprodhohet në pranverë dhe verë (Mesdhe); mars deri në mesin e shtatorit (Varna, Deti të Zi); përsërit hedhjen e vezëve. Vezët, 1.0 x 0.6 mm, nën gurë dhe guacka. Seksualisht maturohet 1 vjeç. Pjelloria 307-1,226 në 2.8-4.8 cm. Jetëgjatësia, 2 vjet.

Pëhapja: Atlantiku lindor (Gadishulli Iberik), Deti i Zi dhe Deti Azov, gjithashtu Knali i Suezit dhe futur në Liqenin e Karunit, Egjipt. Në Mesdhe, i bollshëm në brigjet e Adriatikut,

Rëndësia: Me gjithë bollekun e ekzemplarëve, pjesa e konsiderueshme mbrohet në lagunë. Kjo specie dhe të tjera të ngjashme me këtë nuk paraqesin rëndësi apo interes ekonomik të veçantë. Mund të përdoret për gjueti sportive.

Lista e Kuqe IUCN-Statusi: E pa vlerësuar.

Referencat: Cottiglia, 1980; Internet, 2012.




2- *Zosterisessor ophiocephalus* (Pallas 1811)

Gobius ophiocephalus (Pallas, 1811)

Gobius viridis (Otto, 1821)

Gobius filamentosus (Risso, 1826)

Gobius filamentosus (Risso, 1826)



Emertimi shqip: Burdullak

Rendi - Perciformes

Familja - Gobiidae

Gjinia - *Zosterisessor*

Gjatësia maksimale: 24.5cm

Vendi i kapjes: Merxhan, Cekë, Zaje

(Dhjetor, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator)

Materiali: 10 individë me gjatësi 17-21cm

Veçoritë dalluese:

- Trupi i zgjatur paksa i shtypur, i mbuluar me luspa ktenoide të vogla 59-64 (53-68). në rreshtin anësor.
- Koka e madhe (trashë), e rrumbullt.
- Goja e madhe, e pjerrët, që nuk zgjatet drejt anës së prapme të syrit.
- Nofullat të dala dukshëm.
- Prania e shume gjeniporeve në linjën anësore e transversal dhe prezenca e kanaleve të mukozës.
- Prania e 5-6 rreshtave vertikale të zgjatura nga lart-poshtë.
- **Pendët:** D1 VI (V-VII); D2 1 + 14-15 (13-16) dhe afer njëra-tjetrës e të zhvilluara mirë; AI + 14-15 (12-16); P 18-19 (17-20). Rrezet e pendëve janë të lira në ekstremitetin e sipërm.
- 28 (27-29) rruaza.
- **Ngjyrimi:** gjelbër-verdhë në të ullirit, trupi me 12-14 breza kafe vertikale të parregullt në anët e tij; njolla të vogël të errët në anët e bazë së pendës së bishtit dhe në këndin e sipërm të lob të pendës së gjoksit.

Ekologjia: Specie eurihaline, i ujit i njelmët të estuareve dhe lagunave, në substrate


baltë, pranë zgavrave, në mesin e rrënjëve. Ushqehet me peshq të vegjël (sandmelt, gobies) dhe krustaceve mëdha (të tilla si Leander). Riprodhohet në Prill-Maj (estuaret Tuzlov, Deti i Zi) ose Korrik (Varna), duke leshuar dyherë vezë. Arrin pjekurinë seksuale në vitin e dytë ose tretë, ndersa jetëgjatësinë e ka 5 vjet.

Përhapja: Mesdhe, Detit të Zi dhe Detit Azov. Kjo spesie nuk është e prezantuar në listën e peshqëve të Shqipërisë. Gjetet i zakonshëm në lagunat bregdetare të Adriatikut, përfshirë këtu edhe ato të Shqipërisë.

Rëndësia: Peshk i gjuetisë artizanale e sportive. Prezente ne tregjet e Adriatikut, e ndryshme në tregjet Turke dhe e rrallë në tregjet e detit të Zi. Tregtohet i freskët.

Lista e Kuqe IUCN-Statusi: Të dhëna të paplota (DD)

Referencat: Cottiglia, 1980; FAO.ECEE, 1987; Internet, 2012; Manzoni & Tepedino, 2008.




3-*Anguilla anguilla* (Linnaeus, 1758).

Emertimi shqip: Ngjala, gjala, mesholla, ngjala, njala.

Gjatësia maksimale: 150 cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Dhjetor-Gusht)

Materiali: 10 individë me gjatësi 30-45cm




4-*Atherina boyeri* (Risso, 1810).

Emertimi shqip: Aterina symadhe

Gjatësia maksimale: 13 cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje
(Dhjetor-Gusht)

Materiali: 20 individë me gjatësi 5-10 cm




5-*Belone belone* (Linnaeus, 1761).

Emertimi shqip: Peshku lejlek.

Gjatësia maksimale: 90 cm

Vendi i kapkjes: Merxhan,
(Qershor, Gusht, Shtator)

Materiali: 3 individë me gjatësi 8-23.5 cm



6-*Engraulis encrasicolus* (Linnaeus, 1758)
Emertimi shqip: Açuga, Gavroja, Inçuni
Gjatësia maksimale: 20cm.
Vendi i kapkjes: Merxhan (Dhjetor)
Materiali: 2 individë me gjatësi 10.7 cm.



7-*Sardina pilchardus* (Walbaum, 1792)
Emertimi shqip: Bokfa, Sardelë, Sardelja.
Gjatësia maksimale: 27.5cm.
Vendi i kapkjes: Kune, Vain
(Tetor, Nentor, Dhjetor)
Materiali: 10 individë me gjatësi 10-13 cm.




8-*Aphanius fasciatus* (Nardo 1827).
Emertimi shqip: Çeliku me rripa.
Gjatësia maksimale: 6cm_(M) 7.2cm_(F).
Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Qershor-Gusht)
Materiali: 20 individë me gjatësi 4-5.5 cm_(M) 5-6.5 cm_(F).



9- *Gambusia holbrooki* (Girard 1859).
Emertimi shqip: Barkaleci pikalosh, Barkuleci,
peshku i mushkonjave.
Gjatësia maksimale: 3.5cm_(M) 8cm_(F).

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Qershor-Gusht)

Materiali: 40 individë me gjatësi 1.5-5.5 cm



10- *Chelon labrosus* (Risso 1826)

Emertimi shqip: Vijoshi, qefulli i dimrit, mavr

Gjatësia maksimale: 60cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Dhjetor Shtator)

Materiali: 10 individë me gjatësi 14-30 cm




11- *Liza aurata* (Risso, 1810)

Emertimi shqip: Veshari, veshfloriri.

Gjatësia maksimale: 59cm

iametr kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Gusht-Shtator)

Materiali: 5 individë me gjatësi 20-33 cm



12- *Liza ramada* (Risso, 1827)

Emertimi shqip: Qefulli i vjeshtës, kryegjati, kokëdhani, kryeholli, kryeprefti, qerfi.

Gjatësia maksimale: 70cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Dhjetor-Shtator)

Materiali: 10 individë me gjatësi 20-34cm



13- *Liza saliens* (Risso, 1810)

Emertimi shqip: Veshverdhi, gasturi.

Gjatësia maksimale: 35cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje
(Dhjetor-Shtator)

Materiali: 10 individë me gjatësi 12-27 cm



14- *Mugil cephalus* (Linnaeus, 1758)

Emertimi shqip: Cumërr, qefullvere, gushtaku, cumrraku.

Gjatësia maksimale: 100cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje
(Qershor-Shtator)

Materiali: 15 individë me gjatësi 15-54cm

15- *Parablennius sanguinolentus* (Pallas,1811)




Emertimi shqip: barburiqi i ndryshkët

Gjatësia maksimale: 20 cm.

Vendi i kapkjes: Vain (Gusht, Shtator)

Materiali: 5 individ me gjatësi 9-15 cm



16- *Parablennius tentacularis* (Brünnich,1768)


Emertimi shqip: barburiqi tentakulëgjatë

Gjatësia maksimale: 15 cm.

Vendi i kapkjes: Merxhan, Vain (Mars, Gusht)

Materiali: 3 individë me gjatësi 7-8 cm

17- *Salaria pavo* (Risso 1810).



Emertimi shqip: Peshk guri, peshku i gurit, barburiaqi pallua, bukurina, marxhani, peshk guri pallua
Gjatësia maksimale: 13cm
Vendi i kapjes: Merxhan, Zaje, Cekë, (Dhjetor-Shtator)
Materiali: 10 individë me gjatësi 5-12cm



18- *Lichia amia* (Linnaeus, 1758)
Emertimi shqip: Lojbë, glica, lica
Vendi i kapjes: Merxhan, (Korrik, Gusht)
Gjatësia maksimale: 200 cm
Materiali: 2 individë me gjatësi 25cm



19- *Seriola dumerili* (Risso, 1810)
Emertimi shqip: Gofa
Vendi i kapjes: Merxhan, (Dhjetor)
Gjatësia maksimale: 190 cm
Materiali: 2 individë me gjatësi 12.5 cm.



20- *Trachinotus ovatus* (Linnaeus, 1758)
Emertimi shqip: Lojbë pikaloshe, Lojba me pika
Vendi i kapjes: Merxhan, (Tetor)
Gjatësia maksimale: 70 cm
Materiali: 3 individë me gjatësi 16 cm.




21- *Gobius niger* (Linnaeus, 1758)

Emertimi shqip: Burdullaku i zi

Gjatësia maksimale: 18cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Qershor-Gusht)

Materiali: 5 individë me gjatësi 8-10.5cm



22- *Dicentrarchus labrax* (Linnaeus, 1758)

Emertimi shqip: Levreku, bafa (femra), lapri (levrek i vogël), lavraku.

Gjatësia maksimale: 100cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Dhjetor, Korrik)

Materiali: 10 individë me gjatësi 20-35cm




23- *Dicentrarchus punctatus* (Block, 1792)

Emertimi shqip: Levreku pikalosh.

Gjatësia maksimale: 70cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Qershor, Korrik, Gusht)

Materiali: 5 individë me gjatësi 5-20cm



24- *Mullus barbatus* (Linnaeus, 1758)

Emertimi shqip: Barbuni

Gjatësia maksimale: 30cm.

Vendi i kapkjes: Kune, Vain (Qershor-Gusht)

Materiali: 15 individë me gjatësi 4-18 cm



25-*Epinephelus aeneus* (Geoffroy Saint-Hilaire, 1817)

Emertimi shqip: Kerni i bardhë

Gjatësia maksimale: 120cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, (Teor)

Materiali: 1 individ me gjatësi 10cm.



26- *Diplodus annularis* (Linnaeus, 1758)

Emertim shqip: Sargu bishtzi, spari bishtzi.

Gjatësia maksimale: 24cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje
(Dhjetor, Korrik, Gusht)

Materiali: 5 individë me gjatësi 6-11.5cm.



27- *Diplodus sargus* (Linnaeus, 1758).

Emertimi shqip: Sargu i bardhë, sargu i zakonshem.

Gjatësia maksimale: 45cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje
(Qershor)



Materiali: 5 individë me gjatësi 8-10cm.

28- *Diplodus vulgaris* (E.Geoffroy St. Hilaire 1817).

Emertimi shqip: Sargu me dy shirita të zi.

Gjatësia maksimale: 45cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Gusht).

Materiali: 5 individë me gjatësi 10cm.



29- *Sarpa salpa* (Linnaeus 1758)

Emertimi shqip: Arava, Salpe, Salpa.

Gjatësia maksimale: 46cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, (Gusht,Shtator)

Materiali: 5 individë me gjatësi 16cm.



30- *Sparus aurata* (Linnaeus, 1758).

Emertimi shqip: kocë, spari, kokë praruar, ullorja

Gjatësia maksimale: 70cm

Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje (Korrik
Gusht)

Materiali: 5 individë me gjatësi 10-20cm.



31- *Solea solea* (Linnaeus, 1758)

Emertimi shqip: Gjuhëza e detit, gjuheza e
kanalit, gjuheza e zakonshme._



Gjatësia maksimale: 70cm
Vendi i kapkjes: Merxhan, Cekë, Zaje
(Dhjetor, Qershor, Korrik, Gusht)
Materiali: 5 individë me gjatësi 11-16.5cm

32- *Hippocampus hippocampus* (Linnaeus, 1758)
Emertimi shqip: Kalë deti, Kali i detit turishkurtër
Gjatësia maksimale: 15cm
Vendi i kapkjes: Merxhan, (Nëntor)
Materiali: 2 individë me gjatësi 8-9cm.

33-*Syngnathus abaster* (Risso 1827)



Emertimi shqip: Gjilpëraza shiritazazë
Gjatësia maksimale: 21mm
Vendi i kapkjes: Merxhan, (Korrik, Gusht)
Materiali: 5 individë me gjatësi 3-10cm.

34-*Syngnathus acus* (Linnaeus, 1758)



Emertimi shqip: Bistra, Gjilperez, Peshkagjylpana, Peshku gjëlpërë
Gjatësia maksimale: 50 cm
Vendi i kapkjes: Merxhan, (Nëntor, Dhjetor)
Materiali: 3 individë me gjatësi 25-28cm.

Lista e specieve të peshqeve të kapur në sistemin lagunor Kune-Vain Lezhë (2011-2012)

Rendi	Familja	Nr	Emertimi shkencor	Stafusi
Anguilliformes	Anguillidae	1	<i>Anguilla anguilla</i> (Linnaeus 1758)	CR
Atheriniformes	Atherinidae	2	<i>Atherina boyeri</i> (Risso, 1810)	LC
Beloniformes	Belonidae	3	<i>Belone belone</i> (Linnaeus 1761)	E pa vlerësuar
Clupeiformes	Engraulidae	4	<i>Engraulis encrasicolus</i> (Linnaeus, 1758)	E pa vlerësuar
	Clupeide	5	<i>Sardina pilchardus</i> (Walbaum, 1792)	E pa vlerësuar

Cyprinodontiformes	Cyprinodontidae	6	<i>Aphanius fasciatus</i> (Nardo 1827)	E pa vlerësuar
	Poeciliidae	7	<i>Gambusia holbrooki</i> (Girard 1859)	E pa vlerësuar
Mugiliformes	Mugilidae	8	<i>Chelon labrosus</i> (Risso, 1826)	LC
		9	<i>Liza aurata</i> (Risso, 1810)	LC
		10	<i>Liza ramada</i> (Cuvier, 1826)	LC
		11	<i>Liza saliensis</i> (Risso, 1810)	LC
		12	<i>Mugil cephalus</i> (Linnaeus 1758)	LC
Perciformes	Blennidae	13	<i>Parablennius sanguinolentus</i> (Pallas, 1811)	E pa vlerësuar
		14	<i>Parablennius tentacularis</i> (Brünnich, 1768)	E pa vlerësuar
		15	<i>Salaria pavo</i> (Risso 1810)	E pa vlerësuar
	Carangidae	16	<i>Lichia amia</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
		17	<i>Seriola dumerili</i> (Risso, 1810)	E pa vlerësuar
		18	<i>Trachinotus ovatus</i> (Linnaeus, 1758)	E pa vlerësuar
	Gobiidae	19	<i>Gobius niger</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
		20	<i>Pomatoschistus marmoratus</i> (Risso 1810)	E pa vlerësuar
		21	<i>Zosterisessor ophiocephalus</i> (Pallas, 1811)	DD
	Moronidae	22	<i>Dicentrarchus labrax</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
		23	<i>Dicentrarchus punctatus</i> (Block, 1792)	E pa vlerësuar
	Mullidae	24	<i>Mullus barbatus</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
	Serranidae	25	<i>Epinephelus aeneus</i> (Geoffroy Saint-Hilaire, 1817)	NT
	Sparidae	26	<i>Diplodus anularis</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
		27	<i>Diplodus sargus</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
28		<i>Diplodus vulgaris</i> (E. Geoffroy St. Hilaire 1817)	E pa vlerësuar	
29		<i>Sarpa salpa</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar	
30		<i>Sparus aurata</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar	
Pleuronechthiformes	Soleidae	31	<i>Solea solea</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar
Syngnathiformes	Syngnathidae	32	<i>Hippocampus Hippocampus</i> (Cuvier, 1829)	DD
		33	<i>Syngnathus abaster</i> (Risso 1827)	LC
		34	<i>Syngnathus acus</i> (Linnaeus 1758)	E pa vlerësuar

Literatura

- Cottelat, M. and Freyhof J. 2007: Handbook of European freshwater fishes.
- Cottiglia, M. 1980: Pesci lagunari.
- Dedej, Z., Dragoti N., Abeshi, P. 2007: Zonat e mbrojtura të Shqipërisë.
- Dhora, DH. 2008. Fjalor i emrave të kafshëve të Shqipërisë (Emri shkencor – Shqip – Anglisht).
- Dhora, Dh. 2010: Regjistër i Specieve të Faunës së Shqipërisë 2010.
- FAO.ECEE 1987: Fishes FAO D' identification des species pour les besoins de la peche. Mediterranee et mer noire. Zone Peche 37. Revision 1. Vol. II. Vertebres, Red. W. Fisher et M. Schneider et M.-L. Bauchot. Rome.
- Internet 2012: Fishbase.org.
- Konferencë shkencore. Lezhë 2000: "Potencialet ekonomike dhe njerzore të rajonit të Lezhës dhe prioritetet e zhvillimit për të ardhmen".
- Konferencë shkencore. *MarCoastEcos* 2012: "Peshqit e lagunave të Vilunit dhe Kune-Vainit".
- Konventa e Bernes.1979: "Për ruajtjen e florës dhe faunës së eger dhe mjedisit natyror Evropian".
- Manzoni P., Tepedino V. 2008: Grande Enciclopedia illustrata dei pesci .
- MMPAU.2010: Strategjia nacionale dhe plani i veprimit për biodiversitetin.
- MMPAU. 2009: Raport për gjendjen e mjedisit.
- MMPAU. 2007: Strategjia e peshkimit dhe akuakulturës 2007-2015.
- MMPAU. 2011: Plani i menaxhimit të peshkimit dhe akuakulturës 2011-2013.
- Paparisto, K. Demiri, M. Mitrush, I. Qosja Xh. 1998 : Flora e Shqipërisë-1. Ak. e Shk. të RPSSH.
- Poljakov, G. D., FILIPI, N. & BASHO, K. 1958: Peshqit e Shqipërisë. Universiteti Shtetëror i Tiranës.
- Qendra e VNM. 2010: Plani i menaxhimit të zonës kënetore Kune-Vain për periudhen 2010-2019.
- Rakaj, N. 1995: Peshqit e Shqipërisë.
- Smajlaj, Rr. & Ulqini, D.: Lista e peshqëve të gjoleve të kripura. Buletini shkencor USh"Luigj Gurakuqi"/seria e shkencave të natyrës. Nr. 62 2012.
- REC. 2006: Plani Lokal i veprimit në mjedisit – Komuna Shengjin.

Optimizimi i rrjetit turistik Rasti i qytetit të Durrësit

Besjana Tosuni
Universiteti Europian i Tiranës

Abstrakt

Lëvizja e turistëve rreth botës përfaqëson zhvendosjen më të madhe të njerëzve jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm. Kjo lëvizje ndikon fuqishëm në ekonominë lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Në Shqipëri një pjesë e rëndësishme e turistëve rendisin si arsye kryesore të vizitës ,aventurën, çmimet e lira dhe kontaktet me natyrën. Guidat e ecjes në këmbë mund të kontribuojnë në kënaqësinë e turistëve, promovimin e turizmit dhe zhvillimit të rajonit gjatë lëvizjeve të tyre në rrjetin e turizmit. Turistët vlerësojnë lloje të ndryshme atraksionesh turistike dhe kanë nevojë gjithashtu për një sërë facilitetesh.

Destinacionet turistike nuk veprojnë gjithmonë në mënyrë racionale, emocionet që të fal një destinacion i shtojnë edhe më shumë kompleksitetin vendimarrjes për të qënë pjesë e tij. Lëvizja e turistëve brenda një destinacioni varen nga faktorë që lidhen me karakteristikat turistike, si buxheti, koha, preferencat apo njohuritë e destinacionit, karakteristikat e destinacionit në lidhje me tërheqjet apo nivelin e aksesit.

Ekzistenca e një modeli matematikor që përfshin faktorët kryesorë që shpjegojnë lëvizjen e turistëve të pavarur në një destinacion, në mënyrë dinamike, do të bëjë të mundur krijimin e një mjeti të adaptueshëm softwerik. Ky mjet do të përmbushë nevojat specifike të turistëve, duke lejuar përdorimin e rrjetit në mënyrë optimale nga ana e profileve të ndryshme turistike, si dhe nevojat e qeverisë rajonale dhe biznesit, duke lejuar vendime më të mira dhe ofertën e produkteve relevante turistike.

Ky punim identifikon rëndësinë e turizmit për zhvillimin rajonal, gjen kriteret kryesore të lëvizshmërisë së turistëve, duke përdorur si mbështetje kryesore shtigjet e rrjetit. Njeh modelin e nevojshëm që zhvillon themelet për ndërtimin e modelit matematikor që shpjegon lëvizjen e turistëve në destinacion, duke bërë të mundur një mjet të ardhshëm adaptues softwerik.

Fjalët kyçe: modeli matematik, turizëm, zhvillim rajonal, rrjeta.

Hyrje

Turizmi është një aktivitet kompleks që përfshin aktorë të shumtë dhe faktorë socio-ekonomik. Ne mund të identifikojmë palët e interesuara nga sektori privat dhe publik, individët apo kompanitë , ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorët, me përfshirjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Mes tyre, këto lloje të ndryshme të marrëdhënieve kryhen në kohë dhe hapësira të ndryshme. Kur ne studiojmë këtë sektor, ne vetëm mund të konkludojmë se turizmi është një rrjet i kompleksitetit të madh që përshkruan sjelljet, veprimet dhe marrjen e vendimeve nga aktorët e tij dhe marrëdhëniet e ndryshme të vendosura në mesin e tyre. Një ngjarje në rrjet është e izoluar, ajo ndikohet gjithmonë nga karakteristikat e lojtarëve, lloji i marrëdhënieve të vendosur në mesin e tyre dhe konteksti përreth. Por nga ana tjetër, ngjarja do të ndikojë aktorët dhe marrëdhëniet që janë të vendosura në fqinjësinë e tyre. Përtej kompleksitetit të madh, turizmi është gjithashtu një sistem i rrjetit dinamik. Duke

qenë rrjet konstrukti teorik i përshtatur për analizën e problemeve komplekse me shumë variabla të ndërlidhura në mënyrë dinamike, ai është i përshtatshëm për të studiuar aktivitetin e turizmit në qasje të shumta.

Përparësia kryesore e studimit të turizmit me qasjen e rrjeteve referuar, sipas Dredge (2006), është aftësia për të analizuar ngjarjen e një fenomeni në disa rrjete të ndryshme dhe ndërlidhjen mes tyre. I njëjti autor mendon se mund të ketë vendime të ndryshme politike që ndikojnë në një rrjet dhe se lojtarët mund të ndërveprojnë dhe të kryejnë role të ndryshme në rrjete të ndryshme. Ky pozicion zgjeron perspektivën e studimit të turizmit për ekzistencën e rrjeteve të shumta paralele në nivele të shumëfishta dhe ekzistencën e ndërveprimeve të ndryshme mes tyre. Kjo ide është baza për ndërtimin fillestar të modelit tonë.

Rëndësia e turizmit për zhvillimin kombëtar dhe rajonal, në format e saj të ndryshme, është e njohur nga shumë studime. Rajoni i Durësit nuk është përjashtim, pasi ai integron specifikat e një destinacioni që ndodhet në territorin qëndror të Europës.

Ekzistenca e shtigjeve të ecjes mund të jetë një instrument i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit, sidomos në turizmin e qëndrueshëm të gjelbër. Shtigjet e ecjeve janë një mjet i rëndësishëm për të promovuar edukimin mjedisor dhe social, duke inkurajuar respektimin dhe përmirësimin e njohurive në lidhje me natyrën dhe trashëgiminë tonë. Fakti që shtigjet çojë njerëz në zonat rurale, kontribon në zhvillimin socio-ekonomik të kësaj zone, duke minimizuar shkretëtirëzimin e njeriut dhe duke i dhënë përfitime për një grup të objekteve të ndryshme mbështetëse si të ushqimit dhe të akomodimit. Ne mund të themi se shtigjet e ecjes janë një faktor i rëndësishëm për aktivitetin e turizmit dhe në zhvillimin e shumë rajoneve.

Kuptimi i lëvizjes turistike brenda një destinacion ka pasoja të rëndësishme për përmirësimin e produktit të turizmit, duke lejuar aktorët lokalë për të zhvilluar një ofertë përshtatur më mirë nevojave të ndryshme të turistëve (Zoltan & McKercher, 2015). Për të realizuar përdorimin e shtigjeve, ne duhet të identifikojnë faktorët që ndikojnë në lëvizjen e turistëve në rajon. Nga analiza e bërë, mobiliteti i lidhur me lëvizjen turistike është hetuar gjerësisht, por lëvizshmëria në lëvizjet brenda-destinacionit tregon disa mungesa në studimit (McKercher & Lau, 2008). Siç përmendet nga Kitazawa dhe Batty (2008), ekziston një nevojë e qartë për të zhvilluar modele të reja që mund të shpjegojnë lëvizjen e këmbësorëve.

Zgjedhja e qytetit të Durresit për të kryer këtë studim është për shkak të kombinimit të disa faktorëve që lidhen me karakteristikat unike të rajonit, në veçanti faktin se territori integron një numër të madh të atraksioneve natyrore, sociale dhe kulturore, fakti që popullsia është e shpërndarë në mbarë territorin, të privuar nga vende të vetmuara të njeriut, si dhe niveli i lartë i sigurisë në rajon. Këto karakteristika lejojnë turistët të ecin lirshëm nëpër territor, sipas preferencave të tyre, në përsëritje me popullsinë lokale.

Bazuar në hulumtimet e mëparshme (Frias & Cabral, 2013) (Frias, Cabral, & Costa, 2014) ky artikull synon të identifikojë bazat teorike që lejojnë realizimin e modelimit matematik të lëvizjes së turistëve në zonën e studimit. Nëpërmjet këtij modeli do të jetë e mundur për të krijuar mjete kompjuterike që përmirësojnë turizmin në atë territor, dhe paralelisht të sigurojë zhvillimin e rajonit si një i tërë.

I. Lidhjet e turizmit për zhvillimin rajonal

Lëvizja e turistëve rreth botës përfaqëson zhvendosjen më të madhe të njerëzve jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm. Kjo lëvizje ndikon fuqishëm në ekonomitë lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare (Miguéns & Mendes, 2008). Turizmi është një nga aktivitetet më të rëndësishme ekonomike në mbarë botën, duke luajtur një rol të madh në ekonomitë e shumë vende dhe rajoneve (Baggio, 2008). Në këtë kuptim, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) "Tendencat e të vërtetat e Turizmit në vitin 2014" (OECD, 2014), e konsideron turizmin si një aktivitet të rëndësishëm ekonomik. Në vendet e OECD, ajo përfaqëson 4.7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP), 6% të punësimit dhe 21% të eksporteve të shërbimeve.

Por turizmi jo vetëm që ka rëndësi të madhe në vlerësimin ekonomik por identifikon një grup të ndikimit pozitiv ekonomik, social, fizik, psikologjik, kulturor dhe politik. Sipas Bernardo Trindade (Turismo de Portugal IP, 2011), turizmi luan një rol qëndror në ekonomi, duke qenë lider në eksportet, qëndrueshmërinë, dhe krijimin e vendeve të punës. Për shkak të karakteristikave të tij, turizmi krijon vende pune dhe është një nga drejtuesit kryesorë të zhvillimit rajonal në Shqipëri.

Turizmi, përveç numrit të madh të lojtarëve, integron një kompleksitet të lartë për shkak të gamës së gjerë të palëve të interesuara dhe për faktin se nuk është e mundur të identifikojmë në mënyrë të qartë kufijtë e tij.

Motivet e perceptuara për të zgjedhur një destinacion për turne janë; lehtësirat ose facilitetet, atraksionet kryesore dhe karakteristikat e peizazhit. Qëkurse turistët mund të kenë informacion të detajuar rreth destinacionit, ata duan të kenë jo vetëm tiparet e peizazhit, por një shërbim turistik që përfshin tërheqjet kryesore dhe objektet mbështetëse. Rëndësia e objekteve për të mbështetur turizmin është e përfunduar nga disa autorë. Në këtë linjë të mendimit Khadaroo dhe Seetanah (2007) argumentojnë se nuk është me e mundur të zhvillojmë turizmin pa siguruar ekzistencën e infrastrukturës së transportit që mundëson aksesin dhe lëvizjen e turistëve në territor, të tilla si ekzistenca e aeroporteve, porteve dhe rrugëve. Një tjetër element i zhvillimit ka të bëjë me disponueshmërinë e një sërë infrastrukturash bazë, të tilla si elektriket, kanalizimet, uji i freskët, komunikimi, shërbimet shëndetësore dhe të sigurisë.

Atraksionet turistike apo pikat me interes turistik, i referohen vendeve, ngjarjeve apo ndërtesave që turistët zakonisht vizitojnë. Siç mund të shihet, tërheqja e turizmit është e lidhur ngushtë me produktin turistik. Kur turistët zgjedhin një destinacion, si rregull, nuk e bëjnë atë vetëm për një arsye, por nga një grup i përvojave. Pra, produkti turistik duhet integruar në një sërë atraksionesh të ndryshme turistike të vendosura në një vend apo rajon të caktuar, për të siguruar përvoja të reja për turistët. Turizmi multi-destinacional lejon turistët të rregullojë përvojën e tyre, duke u dhënë atyre lirinë e lëvizjes në kërkim për atraksione të ndryshme, duke lejuar optimizimin e përvojës së tyre dhe marrjen në kontakt me popullsinë lokale. Zhvillimi i turizmit bazuar në sferat, veçanërisht në zonat rurale, ka potencial të madh për të krijuar përfitime ekonomike dhe sociale, duke kontribuar në zhvillimin rural dhe rajonal (Howley, et al., 2012).

Lidhur me destinacionin e Durrësit, ai është një destinacion turistik që, pavarësisht nga demokratizimet e fundit të transportit ajror, është penalizuar nga kostoja e transportit për të hyrë në rajonin. Është e mundur që të perceptojnë një shqetësim në

rritje për të zhvilluar bukuritë natyrore dhe kulturore në tregjet specifike të turizmit, të tilla si golf, shtigjet për këmbësorë apo turizmin fetar.

II. Kontributi i tureve në këmbë në zhvillimin e turizmit

Turet në këmbë nëpër territore ofrojnë ndërveprim të madh me popullatën lokale, sidomos në zonat rurale. Turizmi rural lidhur me turet përfshin disa avantazhe: (1) i lejon turistët të shkojnë më thellë në zonat rurale dhe me dendësi të ulët të popullsisë; (2) ndihmon kontaktet me natyrën dhe ofron një përvojë në pasurimin e gëzimit dhe të edukimit qytetar; (3) mund të kryhen pothuajse gjatë gjithë vitit, edhe pse ka përputhshmëri më të madhe mes muajve të ngrohtë dhe duke qenë e pakëshillueshme në periudha të shkurtra për shkak të kushteve të vështira meteorologjike të dimrit; (4) merr një ndikim të ulët në peizazhin dhe nuk përfshin, si rregull, lëvizje masive; (5) siguron të ardhura shtesë për fermerët dhe sipërmarrësit e vogjël rural; (6) të siguron ndikim më të madh ekonomik në rajon, në kuptimin që të ardhurat mbeten në ekonominë lokale (Howley, et al., 2012). Aftësia e njerëzve për të hyrë në zonat e natyrës mund të ketë një ndikim negativ në ruajtjen e tokave, ujit, vegjetacionit, faunës dhe formacionet gjeologjike në shtigje ekzistuese dhe në rrethinat e saj, duke kontribuar gjithashtu për të humbur deponimit dhe zjarret në pyje (Braga 2006).

Durrësi duke qënë një territor me një imazh të fortë turistik, lidhur me natyrën dhe traditat sociale-kulturore, politikave rajonale e turizmit duhet të përforcojë turizmin jo ndërhyrës që nuk ndryshon ekuilibrin e brishtë ekologjik dhe social të rajonit. Për shkak të avantazhet kryesore të përshkruara më lart, turizmi rural lidhur me aktivitetet në këmbë mund të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të rajonit. Ekzistenca e tureve lejon turistët të njihen me rajonin dhe është një faktor i rëndësishëm i tërheqjeve turistike. Pavarësisht avantazheve që lidhen me ekzistencën e tyre, përdorimi i tij nuk e zhvleftëson nevojën për të marrë masat e nevojshme për të kufizuar ndikimin negativ që vjen me të.

Pasi pamë avantazhet dhe rreziqet që lidhen me turet e ecjeve, po jap më shumë detaje të karakteristikave kryesore të shtigje të tyre.

III. Faktorët që ndikojnë në lëvizjen e turistëve

Më poshtë synohet të analizohet se si dhe pse turistët lëvizin në një rajon të caktuar, dmth, arsyet që çojnë turistët për të zgjedhur një vend të veçantë turistik mbi tjetrin dhe për të identifikuar modelet e tyre të lëvizshmërisë brenda një destinacioni turistik. Procesi i vendimmarrjes turistike ka dy faza të ndryshme, përkatësisht: (1) një planifikim të mëparshëm të udhëtimit, për të përcaktuar destinacionin dhe parametrat e përgjithshme të udhëtimit; (2) një modifikim të udhëtimit, gjatë udhëtimit për të rregulluar dhe përcaktuar detajet (Bansal & Eiselt, 2004). Në të dy rastet, ka një numër të madh të faktorëve që ndikojnë në atraktivitetin e destinacionit turistik. Këta faktorë mund të ndahet në dy komponente kryesore, ato që lidhen me atributet e faqeve turistike dhe faktorët që lidhen me gjendjen e brendshme të turistëve.

Edhe pse ky studim është përqendruar në lëvizjet brenda një destinacioni, për të kuptuar më mirë çështjet që ndikojnë në të, është thelbësore të identifikojmë faktorët

që ndikojnë në vendimmarrjen për të zgjedhur një destinacion. . Ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në zgjedhjen e një destinacioni, Për të bërë përmbledhjen e tyre, është hartuar figura 4.1 e cila tregon faktorët kryesorë që ndikojnë në tërheqjen e një destinacioni turistik . Secila nga pesë kategoritë që kemi gjetur mund të jetë e lidhur me gjendjen turistike apo kushtet fizike, natyrën dhe ngjarjet kulturore e sociale , kohën e lirë dhe aventurën për motivet e udhëtimit, mjedisin socio-ekonomike dhe kushtet fizike.

Nga analiza e faktorëve të mëparshme dhe marrëdhëniet e tyre , mund të themi se ekziston një lidhje e fortë mes tyre, përkatësisht: (1) mjedisit socio-ekonomik, për shkak se ai është një aktivitet që nuk ka të bëjë me shpenzime të konsiderueshme financiare dhe kontribon në formimin qytetar; (2) natyrën, duke lejuar kontakt të drejtpërdrejtë me natyrën në një mënyrë të qëndrueshme; (3) kulturore dhe sociale, për të siguruar marrëdhënie të ngushtë me popullatën lokale, duke bërë të mundur një përsëritje të fortë me ngjarjet kulturore dhe sociale lokale; (4) të kohës së lirë dhe aventurës, rrugët e ndryshme lejojnë përvoja të reja dhe një ndjenjë të relaksimit; (5) të turizmit dhe mbështetje të infrastrukturës, të cilat turistët janë të varur të tilla si strehimi, ushqimi dhe transporti rrugor.

Duke kërkuar tani për lëvizjen e turistëve brenda një destinacioni dhe faktorët që ndikojnë në lëvizjen e tyre, rezulton se vetëm një pjesë e vogël e turizmit botëror është bërë për të përmbushur një interes të veçantë (Deng, mbretit, dhe Bauer, 2002). Në këtë kuptim turisti ka tendencë




Figura 4.1: Faktorët që ndikojnë në tërheqjet turistike

për të kërkuar eksperiencë të ndryshme, të takojë lloje të ndryshme të tërheqjes turistike. Në këtë drejtim, arrijmë në përfundimin se turistët janë më të prirur për të zgjedhur një circuit multi dimesional , ku ka tërheqje turistike të një niveli mesatar, në krahasim me udhëtimet që kanë destinacione të ngjashme.

Duke pasur parasysh se të klasifikuarit e atraksioneve turistike lejon të kategorizojmë, vlerësojmë dhe krahasojmë zgjedhje të ndryshme të mundshme, duke ndihmuar turistin me detyrën e vendosjes së destinacionit, literatura është analizuar për të identifikuar faktorët që ndikojnë në vendimin turistik, kur ata janë duke udhëtuar përgjatë territorit, në kërkim të klasifikimeve të mundshme për këta faktorë. Autorët

Lew dhe McKercher (2006) të klasifikuar në dy grupe të mëdha, një në lidhje me karakteristikat e destinacionit dhe të tjerat lidhur me karakteristikat e brendshme të turistëve. Karakteristikat destinacioni i referohen: (A1) origjinës së udhëtimit dhe vendndodhjes së banesës; (A2) destinacioneve të udhëtimit dhe vendeve tërheqëse; (A3) aksesit të transportit. Karakteristikat e brendshme janë të ndarë në: (B1) disponueshmërinë e kohës; (B2) motivet, interesat dhe përbërja; (B3) njohuritë mbi destinacionin dhe vlerat emocionale.

Me qëllim për të kuptuar sjelljen hapësinore të turistëve që vizitojnë vendpushimet janë identifikuar disa faktorë kohorë, hapësinore, e socio-ekonomikë dhe tipologjitë e ndryshme të personalitetit. Është arritur në përfundimin se karakteristikat kohore dhe hapësinore kanë fuqi më të madhe shpjeguese se karakteristikat socio-ekonomike. Në mënyrë të ngjashme, duke studiuar lëvizjen e turistëve që vizitojnë rajonin e Europës, me një mënyrë të pavarur dhe individuale, Lau dhe McKercher (2010) identifikuan një sërë faktorësh që bashkohen në faktorët njerëzore, fizike dhe kohorë.

Në studimin e kryer nga McKercher dhe Lau (2008) që përqipet për të identifikuar modelet e lëvizjes së turistëve në mjedisin urban, është konsideruar se këto janë të prekur nga modifikimet gjatë udhëtimit dhe zgjatje të përkohshme të vizitës së destinacionit.

Në bibliografi në lidhje me studimin e zgjedhur për mënyrën e transportit, Masiero dhe Zoltan (2013), analizuan korrelacionin midis faktorëve të ndryshëm që lidhen me lëvizjen e turistëve, duke përfshirë zgjedhjen për mënyrën e transportit dhe zgjatjen e vizitës në një zonë turistike. Ata kishin grumbulluar faktorët më të rëndësishëm në karakteristikat individuale dhe mënyrën e transportit të përdorur. Sipas këtyre autorëve zgjedhja e mënyrës së transportit ndikohet nga variablat demografike dhe niveli i njohurive të territorit.

Në një studim tjetër, i kryer nga Zoltán dhe McKercher (2015), ku lëvizja e turistëve është regjistruar me përdorimin e një karte elektronike, janë identifikuar disa faktorë që mund të ndikojnë në lëvizjen e turistëve, në mënyrë të veçantë të transportit, njohja me destinacionin, origjina e turistëve, përbërja e grupit, karakteristika të udhëtimit, karakteristika të destinacionit, personaliteti i turistëve dhe arsytet për të udhëtuar.

Sipas studimit të kryer nga Howley (2012), në ekzistencën e shtigjeve, është konstatuar se turistët nuk kanë interesa homogjene. Kjo tregon se është e rëndësishme të dini preferencat e turistëve.

Në këtë studim, turistët vijnë në destinacion nga ajri apo deti. Në varësi të faktorëve të ndryshëm, lëvizja e turistëve në destinacion është bërë duke përdorur mjete të ndryshme të transportit, të tilla si makinë, biçikletë, në këmbë, transport publik apo shërbime specifike turistike për turistët. Bazuar në studimin e turizmit të kryer nga qeveria për turistët që kishin vizituar rajonin në vitet 2014 dhe 2015, grup-mosha kryesore ka qenë midis 25 dhe 54 vjeç, për një mesatare prej 44 vjeç. Përbërja e grupit të udhëtimit ishte kryesisht grupe ose çifte, 31.6% dhe 33.7% respektivisht. Si një motivim për të marrë lundrimin, shumica e tyre theksojnë nevojën për të pushuar dhe kohën e lirë (54.1%), e ndjekur nga biznesi ose të punës (31.6%) dhe vizituar familjen ose miqtë (13.2%). Në lidhje me përcaktimin e karakteristikave të destinacionit, zgjedhja e parë ishte natyra dhe ambienti i qetë.

IV. Procesi i modelimit

Hulumtuesit Samuelson dhe Nordhaus (2005) përcaktojnë modelin se si një instrument formal përfaqëson aspektet themelore të një sistemi kompleks, me anë të disa marrëdhënieve themelore. Kur aplikohet për ekonominë reale, ata transformojnë botën komplekse reale në skemat e thjeshtësuara që lejojnë studimin e saj. Chiang dhe Wainwright (2005) konsiderojnë se një model ekonomik ka nevojë për të përdorur një strukturë që është thjeshtuar analitikiisht. Kjo nevojë për thjeshtimin është motivuar nga kompleksiteti ekstrem i ekonomisë reale dhe për shkak se është e pamundur për të kuptuar të gjitha ndërlidhjet e tij në një kohë. Për këtë arsye, Kaewsuwan mbështet se ekonomistët përdorin modele për të shpjeguar proceset ekonomike, për të shqyrtuar një çeshtje ekonomike ose për të zhvilluar një teori të re.


Jo të gjitha modelet ekonomike pranojnë si të vërtetë formën tradicionale matematikore të ekuacioneve. Matematika ekonomike është një qasje e analizave ekonomike, ku ekonomistët përdorin simbolet matematikore dhe teorema për të formuluar probleme si një ndihmës për të strukturuar procesin e të menduarit. Modelet mund të marrin një gamë të gjerë të formateve, duke përfshirë grafet, tabelat dhe diagramet, të cilat mund të përkthehen në ekuacionet matematikore dhe pastaj të përdoren si bazë për gjuhën e programimit, në mënyrë që të prodhojnë aplikimet kompjuterike.

Procesi modelimit, sipas Mooney dhe Swift (1999), ka katër hapa, por ne mund ti përmbledhim ato në tre. E para ka të bëjë me hartimin e një modeli të thjeshtuar të përfaqësimit të botës reale. E dyta ka të bëjë me konceptimin e modelit të problemit, në zbatimin praktik dhe në rastin e modeleve matematikore, ajo i referohet shprehjes matematikore dhe kufizimeve. Hapi i tretë ka të bëjë me zbatimin e modelit të vërtetë, marrja e rezultate të konfirmuara, përshtatshmërinë e tyre. Ky hap i fundit ndërmerr një cikël interaktiv dhe dinamik për të rregulluar modelin me kërkesat e botës reale. Për të matur ndryshimet që ndodhin në ekonomi, Kaewsuwan (2012) beson se duhet të ekzistojë një zhvillim në teorinë ekonomike, në mënyrë që të parashikojë evolucionin e sistemit ekonomik nga vetë ai. Për të arritur këtë qëllim, është e rëndësishme të bëjmë një analizë historike të të dhënave, duke përdorur njohuritë matematikore dhe aplikimin e metodës shkencore. Pastaj, ekonomistët aplikojnë modelin për të marrë një model që shpjegon problemin specifik. Së fundi, ata testojnë modelin dhe nëse konfirmohet, ai mund të përdoret si një teori e re ekonomike. Në modelimin e menaxhimit të trafikut urban, modeli më i përdorur gjerësisht që parashikon lëvizjen e këmbësorëve është modeli i algoritmit të gjetjes së rrugës më të shkurtër. Ky model nuk mund të shpjegojë plotësisht lëvizshmërinë e njeriut, sepse ka faktorë të tjerë që duhet të identifikohen, në mënyrë që modeli të mund të interpretojë realitetin e objektit në bazë të studimit sa më afër të jetë e mundur. Pra, modelet marrin një fuqi më të madhe shpjeguese të realitetit (Kitazawa & Batty, 2004), qoftë në mjedisin urban ose rural.


Për të arritur një model është e nevojshme që të përmbushim një proces të tërë për të marrë informacion, ku mbledhja e të dhënave, ruajtja dhe përpunimi janë veçanërisht të rëndësishme dhe duhet të reflektojnë një metodologji të veçantë. Mbledhja e të dhënave mund të kryhet drejtpërdrejt, për të dhëna jo-ekzistuese, ose tërthorazi, të dhënat ekzistuese të ofruara nga palët e treta. Në rastin e parë përdorim metoda të tilla si vëzhgimi i drejtpërdrejtë, ndërsa i dyti mund të merret duke studiuar ish

dokumente ose duke përdorur të dhënat e mbajtura nga të tjerët.


Për të dhënat e magazinimit, ekzistojnë tri lloje logjike të organizimit të informacionit, hierarkike, të rrjetit dhe relacionale. Në rastin e parë të dhënat janë organizuar në një strukturë pemë , ku informacioni shkon nga një deri në shumë gjenerues. Modeli i rrjetit është një zgjerim i modelit të mëparshëm, ku nuk mund të ketë marrëdhënie nga shumë përdorues në një. Së fundi, në modelin relational të dhënave janë shpërndarë në një format të dyfishtë të tabelës hyrëse, ku query dhe përpunimi i të dhënave kryhet nga kolona apo rreshti .



Modeli Hierarkik



Modeli i Networkut



Modeli Relacional

Figura 3.1.Llojet logjike të organizimit të informacionit

Përpunimi i të dhënave i referohet veprimeve të bëra me një grup të caktuar të të dhënave, për të nxjerrë informacionin e nevojshëm, të cilat mund të paraqiten në formate të ndryshme, diagrama ose tabela.

Në këtë studim, ne kemi marrë të dhëna primare me përdorimin e mjeteve të GIS (Sistemi Informativ Gjeografik) dhe të dhënat dytësore për të kuptuar mjedisin kontekstuale. Të dhënat janë ruajtur në një tabelë të regjistrimit të dyfishtë dhe më pas përpunohen duke përdorur një spreadsheet dhe një software matematikor.

V. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Për të bërë këtë studimin, janë identifikuar disa (rrugë ecjeje) footpaths, zyrtare dhe jo-zyrtare, (shtigje , rrugë hekurudhore, rrugë të këmbësorëve, etj), dhe kjo ka bërë përfaqësimin e saj gjeografik duke përdorur një mjet si GIS . Fillimi dhe fundi i footpaths ishin të lidhura duke përdorur rrjetin e rrugëve dhe shtigjeve. Zgjedhja e rrugëve dhe shtigjeve u bazuar në njohuritë që turistët kanë nga territori, duke kombinuar sigurinë me minimizimin e distancës dhe përpjekjet për të shpenzuar minimalisht nga këmbësorët. Në këtë mënyrë është projektuar një rrjet që integron

të gjitha shtigjet.

Duke përdorur dokumentacionin e ofruar nga Qeveria dhe Agjensia Rajonale e Udhëtimeve që veprojnë në rajon, janë kryer identifikimet e faqeve në dispozicion të natyrës, kulturës dhe turizmit social në Durrës. Pas kësaj i shënojmë ato në hartë dhe ndërtoj rrjetin që i bashkon ato. E njëjta detyrë u përmbush për mbështetjen e infrastrukturës, të ushqyerit dhe vendeve të akomodimit.

Për rrjetet e identifikuar më sipër, kam ndërtuar tabela me identifikimin e nyjeve dhe gjatësisë midis skajeve të saj, si dhe matricës e afërsisë së distancave. Para fillimit të ecjes, një turist këmbësorë që dëshiron të përshkrojë një shteg të veçantë duhet të llogarisë kohën që ai ka nevojë për ta bërë atë. Për të optimizuar turin e tij, duke zvogëluar kohën e shpenzuar në të, turisti mund të plotësojë shëtitje e tij me mjete të tjera të transportit. Kështu, është identifikuar edhe rrjetit ekzistues i transportit publik në destinacion dhe pikat e tyre më të afërt të ndaluar në çdo shteg. Pastaj, kam zhvilluar një sërë simulimesh për të vlerësuar mundësinë e një turist në këmbë duke shijuar shtigjet. Për të ndërtuar këto simulime, ne caktojmë të njëjtat kufizime. Turistët kanë një vend të caktuar të akomodimit dhe mund të ecin për një periudhë të ditës, si dhe mund të përdorin transportin publik në dispozicion (autobus, taksi, me qira makinë), gjatë ditëve të javës, ose në fundjavë.

Secili prej rrjeteve të identifikuar më parë (footpaths, tërheqjet natyrore, kulturore dhe sociale, strehim, të ushqyerit dhe objekteve mbështetëse të transportit publik) mund të përfaqësohet nga një matricë që kontribuon në matricën globale të turizmit, me qëllim për të ndërtuar modelin tonë të bazuar në një kombinim linear të matricave që mbështesin nivele të ndryshme të strukturës së rrjetit global. Çdo nivel gjeneron një grafik, nga ku do të nxirret matrica korresponduese.

VI. Formulimi ynë

Për të arritur formulimin matematikor që shpjegon lëvizshmërinë turistike, është e nevojshme të identifikojmë faktorët që kontribuojnë në këtë lëvizje dhe peshën e tyre relative. Rrjeti i gjeneruar nga secila variabël do të jetë vetëm një dimension i matricës që do të përfaqësojë të gjithë modelin. Këto rrjete të pjesshme i referohen territorit, rrugëve dhe shtigjeve, pikave logjistike mbështetëse, transportit publik dhe tërheqjeve turistike. Lidhja midis rrjeteve të ndryshme është realizuar nga mbivendosje gjeografike të kulmeve të saj.

Në mënyrë që të lehtësojmë përpunimin e të dhënave dhe të përmbushim faktorin afërsi dhe kuptimin e mundësisë, një thjeshtësim i rrjetit të turizmit është bërë nga grumbulli i pikave me distanca më afër se 200 metra nga njëri-tjetri. Kjo lejon të identifikojmë kulmet kryesore, sheshet, që përfshijnë disa kulme nga rrjetet e pjesshme, të natyrës e një fuqie më të madhe për të tërhequr turistë, shih figurën 7.1.




Figura 7.1: Grumbulli i nyjeve

Çdo kulm V_r nga rrjeti botëror i turizmit, do të ketë një vlerë prej atraktivitetit dhënë nga shumica e vlerave të kulmeve të ndryshme të rrjeteve të pjesshme që ekzistojnë fizikisht në atë vend, pak a shumë nën 200 metra. Vlera e tërheqjes është e peshuar me vlerën e probabilitetit të caktuar për preferencat e turistëve. Preferenca turistike jepet nga niveli i shërbimeve që percepton turisti që

mund të arrihet me përdorimin e kulmit. Ne mund të shprehim vlerën e çdo kulm (1) si më poshtë:

$$\hat{f}_{(v_n)} = \rho_1 P_{T_n}^2 + \rho_2 P_{N_n} + \rho_3 P_{C_n} + \rho_4 P_{S_n} + \rho_5 P_{R_n} + \dots + \rho_m P_{X_n} \quad (1)$$

Ku:

$f(V_n)$ - A është dobia maksimale që turisti mund të ketë me përdorimin e kulmit V_n ;

N - pikat tërheqëse natyrore;

T - Pikat e hyrjes në shtigjet për këmbësorë. Pasi është konsideruar se rrugët për këmbësorë kanë një vlerë më të lartë tërheqëse, krahasuar me faktorë të tjerë, ajo merr

një vlerë me shprehjen kuadratike ($P_{T_n}^2 P_{T_n}^2$) në funksion (1);

C - Pikat tërheqëse kulturore;

S - Pikat tërheqëse sociale;

R - Feeding (restorante) vende tërheqëse;

P - Është pesha e secilit komponent ose grup i komponentëve në kulm $P_{X_n} P_{X_n}$. Kjo është pesha e X pikëve që ekzistojnë në kulmin n. Nëse ka më shumë se një është shuma e tij e ponderuar, në qoftë se nuk ekziston asnjë, supozohet se vlera është zero; ρ_m - është vlera e shërbimeve caktuar për konsumin e çdo vektori, që është, probabiliteti i caktuar nga turisti në çdo pikë ose grup i pikave;

n - Indeksi i caktuar për çdo kulm.

Meqë niveli i aksesit për çdo kulm duhet të merren parasysh, ne duhet ta përfshijnë këtë vlerë në shprehjen (1), duke marrë shprehjen (2).

$$f_{(v_n)} = \hat{f}_{(v_n)} + \sum_{j=1}^k \rho_{m_j} P_{A_j} \quad (2)$$

$P_{A_j} P_{A_j}$ - është pesha dhënë qasjes.

Kjo bëhet nga thithja nga kulmi n i vlerës midis individit dhe vendndodhjen e kulmit në fjalë. Ajo paraqet përpjekjen që turistët kanë për të arritur në kulmin n.

Duke pasur parasysh se qëllimi i turistëve është të maksimizojnë nivelin e shërbimeve të marra në të gjithë udhëtimin, ne duhet të shtojmë të gjitha kulmet ku turistët do të kalojë. Një rrugë e mundshme është identifikuar nga funksioni (3), kjo shprehje për zbatimin e algoritmit DIJKSTRA.

$$\sum_{j=1}^k f_{j(v_n)} \quad (3)$$

Çdo kulm i një nënbashkësie (N, T, C, ...) është i ndarë në disa kategori të nivelit më të ulët, secili prej tyre ka peshë të ndryshme specifike dhe vlerë të dallueshme të shërbimeve për çdo turist. E konsideruar si një shembull, pesha e rrjetit të pikave tërheqëse natyrore mund të shprehin si më poshtë në shprehjen (4).

$$P_{N_n} = \alpha_1 P_{NM_n} + \alpha_2 P_{NL_n} + \alpha_3 P_{NP_{a_n}} + \dots + \alpha_\tau P_{NP_{\tau_n}} \quad (4)$$

ku:

$P_{NM_n} P_{NM_n}$ - është pesha n e natyrës ;

$P_{NL_n} P_{NL_n}$ - është pesha n e lagunës;

$P_{NP\alpha_n}$ $P_{NP\alpha_n}$ - është pesha n e parkut natyror;

$P_{NP\tau_n}$ $P_{NP\tau_n}$ - është pesha n e plazhit

$\alpha_\tau \alpha_\tau$ - është vlera e shërbimeve e caktua për secilin vektor konsumi, $\tau = 1, 2, \dots, 7$
Brenda çdo nënkategorie të atraksioneve, pesha është përcaktuar si produkt i faktorëve të tillë si reputacioni, afërsia me pikat e tjera të interesit ose kostoja e përdorimit të tij. Për shkak se individët janë të ndryshëm, në bazë të preferencave të para, opsionet e mundshme mund të jetë të kufizuara. Si një shembull, nëse turisti ka marrë me qira një strehim për të gjithë qëndrimin në një vend, të gjitha vendet e tjera të akomodimit marrin një vlerë null.

Një tjetër situatë e thjeshtimit është kur turisti supozon se nuk ka ndërmend për të vizituar pikat e një karakteristikë të veçantë, në këtë rast, të gjitha pikat me këtë funksion do të marrin vlera null. Në terma matematikore, nëse turistët që nuk duan të vizitojnë kishat, çdo pikë e kishave do të marrë një vlerë të shërbimeve të barabartë me zero dhe mund të imponojë kushtet e mëposhtme.

$$\sum_{j=1}^n \alpha_{n_j} P_{c_{g_j}} = 0 \quad (5)$$

Sipas rëndësisë së tij, si një burim i rrallë, analiza e qëndrueshmërisë e çdo udhëtimit duhet të analizohet në aspektin e disponueshmërisë të përkohshme. Kështu, çdo kulm dhe skaj të ketë një vlerë të lidhur në kohë, që përfaqëson numrin e njësisive të kohës (t) të kërkuar për turistët që gëzojnë pikat totale që lidhen me këtë kulm, ose që kalojnë nëpër një skaj. Në fund, shumica e njësisive të kohës që kalon në skajet dhe në nyjet nuk mund të tejkalojë kohën totale të udhëtimit caktuar nga turistët.

$$\sum_{j=1}^k t_j = t_{max} \quad (6)$$

Ku:

C_g - Pikat tërheqëse kulturore ;

t_j - Njësia kohë, duke zgjedhur si njësi standarde minutën;

t_{max} - njësi kohe maksimale në dispozicion për të kryer udhëtimin.

Modelimi matematik do të sigurojë një kuptim më të mirë të modeleve të lëvizjes së turistëve, duke identifikuar motivet dhe kufizimet. Këto njohuri, si pjesë e një sektori strategjik për zhvillimin rajonal, lejojnë interpretuesit ekonomik dhe politikëbërësit për të marrë vendime më të mira, duke çuar në optimizimin e burimeve ekzistuese sipas pritjeve reale të turistëve. Nga ana tjetër, modeli matematikor do të lejojë që të ndërtojmë mjete që do të ndihmojnë turistët, në mënyrë individuale, të zgjedhin përvojën e tyre.

VII. Përfundime

Territore të vogla destinacionesh turistike janë të ndjeshëm ndaj katastrofave natyrore dhe vuajnë nga një disavantazh i veçantë në cilësinë e tyre të zhvillimit ekonomik. Të njëjtat veti që venë këto destinacione në disavantazh e bëjnë destinacionin një studimi

të dobishëm për mbështetjen e shkencëtarëve. Destinacione të tilla janë të preferuara si njësi studimore, duke u bërë themeli për përparimet e rëndësishme në shumë fusha shkencore, për shkak se janë sistem që mund të kontrollohen.

Është e njohur se turizmi shkakton një efekt të qëndrueshme pozitiv në rritjen ekonomike të vendeve të vogla ose rajoneve. Durrësi është i vendosur në një rajon të Evropës, ku turizmi është njohur si një aspekt strategjik i zhvillimit të saj, kështu, që ka kuptim të studiojmë lëvizjen e turistëve në rajon.

Krijimi i një modeli matematikor që rrit zhvillimin e rajonit përmes turizmit të përshtatur, merr një rëndësi të madhe në ekonominë rajonale dhe lejon të ndërtojme mjete që do të ndihmojë turistët, në mënyrë individuale, të zgjedhin përvojën e tyre.

Referencat

- Baldacchino, G. (2008). Trains of Thought: Railways as Island Anthitheses. *Shima: The International Journal of Research into Island Cultures*, 2 (1), pp.29-40.
- Bansal, H., & Eiselt, H. (2004). Exploratory research of tourist motivations and planning. *Tourism Management*, 25 (3), 387-396.
- Braga, T. (2006). *Pedestrianismo e Percursos Pedestres: manual de formação* (1 ed.). Pico da Pedra, Açores, Portugal: Amigos dos Açores.
- Chiang, A. C., & Wainwright, K. (2005). *Matemática para economistas* (4^a ed.). (A. S. Marques, Trans.) Rio de Janeiro: Elsevier Editora Ltda.
- Debbage, K. G. (1991). Spatial behavior in a bahamian resort. *Annals of Tourism Research*, 18 (2), 251-268.
- Deng, J., King, B., & Bauer, T. (2002). Evaluating natural attractions for tourism. *Annals of Tourism Research*, 29 (2), 422-438.
- Deschenes, P. J., & Chertow, M. (2004). An island approach to industrial ecology: towards sustainability in the island context. *Journal of Environmental Planning and Management*, 47 (2), 201-217.
- Dredge, D. (2006). Policy networks and the local organisation of tourism. *Tourism Management*, 27 (2), 269-280.
- Filieri, R., & McLeay, F. (2014). E-WOM and accommodation an analysis of the factors that influence travelers' adoption of information from online reviews. *Journal of Travel Research*, 53 (1), 44-57.
- Frias, A., Cabral, J., & Costa, Á. (2014). Otimização do uso dos trilhos pedestres em São Miguel e sua modelação matemática. In *Proceedings of the 21st Workshop da APDR - Estratégias, Infra-estruturas e Redes Empreendedoras para o Desenvolvimento Regional* (pp. 54-68). Angra do Heroísmo: Associação Portuguesa para o Desenvolvimento Regional.
- Howley, P., Doherty, E., Buckley, C., Hynes, S., Rensburg, T. v., & Green, S. (2012). Exploring preferences towards the provision of farmland walking trails: A supply and demand perspective. 29 (1), 111-118.
- Kaewsuwan, S. (2002). *Importance of Models in Economics*. Retrieved November 3, 2014, from http://www.gaoshan.de/university/tp/Importance_of_Models_in_Economics.pdf
- Khadaroo, J., & Seetanah, B. (2007). Transport infrastructure and tourism development. *Annals of Tourism Research*, 34 (4), 1021-1032.
- Lau, G., & McKercher, B. (2007). Understanding tourist movement patterns in a destination: A GIS approach. *Tourism and Hospitality Research*, 7 (1), 39-49.
- Lew, A., & McKercher, B. (2006). Modeling Tourist Movements: A Local Destination Analysis. *Annals of Tourism Research*, 33 (3), 403-423.
- Lue, C.-C., Crompton, J. L., & Stewart, W. P. (1996). Evidence of Cumulative Attraction in

- Multidestination Recreational Trip Decisions. *Journal of Travel Research*, 34, 41-49.
- Masiero, L., & Zoltan, J. (2013). Tourists intra-destination visits and transport mode: a bivariate probit model. *Annals of Tourism Research*, 43, 529-546.
- Mckercher, B., & Lau, G. (2008). Movement Patterns of Tourists within a Destination. *Tourism Geographies: An International Journal of Tourism Space, Place and Environment*, 10 (3), 355-374. 22
- Miguéns, J., & Mendes, J. (2008). Travel and tourism: Into a complex network. *Physica A: Statistical Mechanics and its Applications*, 387 (12), 2963-2971.
- Mooney, D. D., & Swift, R. J. (1999). *A course in mathematical Modeling*. United States of America: The Mathematical Association of America.
- Murphy, P., Pritchard, M. P., & Smith, B. (2000). The destination product and its impact on traveller perceptions. *Tourism Management*, 21 (1), 43-52.
- OECD. (2014, março 07). *OECD Tourism Trends and Policies 2014*. (O. publishing, Ed.)
- Quivy, R., & Campenhoudt, L. V. (1998). *Manual de investigação em ciências sociais*. Porto. Retrieved 11 4, 2014, from <http://www.fep.up.pt/docentes/joao/material/manualinvestig.pdf>
- RAA. (2009). *Estudo sobre os Turistas que visitam os Açores. 2005 – 2006*. Angra do Heroísmo: Serviço Regional de Estatística dos Açores (SREA).
- Samuelson, P. A., & Nordhaus, W. D. (2005). *Economia* (18 ed.). (E. fontáinha, & J. P. Gomes, Trans.) Aravaca: McGraw-Hill Interamericana de España, S.A.U.
- Schubert, S. F., Brida, J. G., & Risso, W. A. (2011). The impacts of international tourism demand on economic growth of small economies dependent on tourism. *Tourism Management*, 32, 377-385.
- Shih, H.-Y. (2006). Network characteristics of drive tourism destinations: An application of network analysis in tourism. *Tourism Management*, 27 (5), 1029-1039.
- Turismo de Portugal IP. (2011). *Plano Estratégico Nacional do Turismo: proposta para revisão no horizonte 2015 - versão 2.0*. Lisboa: Turismo de Portugal IP.

Aktiviteti fizik kunder te gjitha formave te plakjes

Gjudio Zefi

University of Shkodra

Abstract

The number of people aged over 60 years is growing rapidly. Over time it has also been observed that people are aging differently from one another, have come to define the concept of biological age and chronological age. Aging is this characteristic that is highlighted with the decrease in the toning of the muscles with negative effects in postural problems, joint and the structural composition of the bones. Strength, power and speed decrease appears to be the most problematic without excluding the loss of balance and flexibility. Esercitasi with a regular physical activity in old age brings a number of advantages which improve a number of organs and physiological functions, in particular functions of the locomotor apparatus, cardiovascular, respiratory, nervous. The goal is to be as creative and choose to do exercises to include all types of physical conditional -resistance, strength, balance and flexibility.

Plakja e popullsise ne Europe eshte ne nje rritje graduale dhe te dhenat e Eurostat vene ne dukje qe po arrihet ne nje reduktim te "rritjes potenciale" vjetore te GDP europiane,nga 2-2,5% ne 1,5% ne 2025.Sipas nje studimi te bere ne 2005 nga Komisioni europian "ne periudhen 2005-2050,brezi i moshes 55-65 vjeç(dmth punetoret e moshuar) do te rriten me 8,7%,ndersa numri e individeve te moshes 65-79(personat e moshuar) do te rritet me 44% e i personave shume te moshuar(mbi 80 vjeç) do te rritet me nje perqindje mbi 180%"(periodiku Euronote).Gjatë dy dekadave të fundit edhe Shqipëria ka patur një transformin të thellë demografik të shoqëruar me një rritje të numrit të përsoneve mbi 65 vjeç dhe rënie të numrit të fëmijëve dhe të rinjve. Në vitin 2011, numri i personave 65 vjeç e lart është rritur më shumë se 4 herë në 318 mijë. Në të ardhmen, ndryshimi në shpërndarjen e moshës pritet që të jetë shumë i ndjeshëm gjithashtu. Përqindja e më të moshuarve 60 vjeç e siper eshte rritur nga 11 përqind deri në vitin 2011 ndersa do te vazhdoje te rritet sipas parashikimeve me 29 përqind deri në vitin 2060. ("Popullsia dhe dinamika e popullsisë në Shqipëri". Tirana, INSTAT 2014)

Te gjendur perballe kesaj panorame te perspektives demografike lind pyetja : Çfare duhet te bejme?

Sensibilizimi i strukturave qeveritare dhe ojç-ve per situaten aktuale dhe te perspektives.

Rregullimi i legjislacionit qe ndihmon permiresimin e kushteve te jeteses per keto fasha te moshes.

Gjetjen e mundesive per financimin e ndertimin e infrastruktures se pershtatshme per te rregulluar aktivitetin fizik ne ndihme te ketyre personave.

Procesi i plakjes ka akoma ane te paqarta dhe jane te panumerta teorite qe kerkojne ti japin nje shpjegim shkencor ketij procesi .Per disa studjues te gjenetikes mplakja eshte nje proces i paracaktuar gjenetikisht;per te tjeret mplakja shkaktohet nga disa difekte te ADN. Ndersa studjues te tjere besojne qe procesi i mplakjes eshte i lidhur

me aftesine e pergjigjes dhe te eficences se sistemit imunitar.Me kalimin e kohes eshte vene re edhe se si personat plaken ne menyre te ndryshme njeri nga tjetri,duke arritur qe te percaktojne konceptin e moshes biologjike dhe moshes kronologjike.Mbi bazen e ketyre koncepteve mund te dallojme dy tipe te mplakjes:

Plakjen natyrale,qe i dedikohet ndryshimeve graduale e fiziologjike qe ulin ne menyre progresive aftesine e pershtatjes se te moshuarit(ne kete rast moshja biologjike korrespondon me moshen kronologjike)

Plakja e parakohshme,qe varet nga faktore gjenetik,kushtet e pafavorshme te jeteses,punat skllaveruese,te kequshqyerit,abuzimi me alkoolin e drogen ,etj.(ne kete rast moshja biologjike kalon moshen kronologjike)

Pavarsisht nga tezat e ndryshme mbi shkaqet e mplakjes,jane te qarta ndryshimet fiziologjike ku nder te parat jane ato cerebrale. Truri,qe arrin tek njeriu volumin dhe peshen maksimale rreth moshes 25 vjeç ,reduktohet me shpejtesi me mplakjen deri ne masen 10% te volumit fillestar.Ky reduktim sjell paralelisht dhe degjenirimin e neuroneve cerebrale.Nje aspekt i lidhur ngusht me reduktimin e transmetimit neuronal eshte ai i uljes se forces muskulare. Mplakja paraqet kete karakteristike qe evidentohet me uljen e tonifikimit te muskujve me pasoja ne problemet posturale,artikulare e deri ne perberjen strukturore te kockave. Ulja e tonifikimit muskulor ndikon dukshem edhe ne sistemin e frymemarrjes per shkak te nje hapje me te vogel te kraherorit e per pasoje uljen e volumit te frymemarrjes,kjo në kurriz të të gjitha indeve që kërkojnë oksigjen për aktivitetin e tyre metabolik.

Tani do te analizojme peramatrat e rendesishem te aktivitetit fizik si forcen,fuqine e shpejtesine.

-Forca muskulore,si ajo statike e dinamike,ulet lehte deri ne moshen 45 vjeç e nga kjo periudhe e me vone ulet me 5% per çdo dekada keshtu qe, ne moshen 65 vjeç reduktimi i forces rezultoen te jete rreth 25%.(Grimby,G&Saltin,B). Shkaku kryesor i renies muskulore ne te moshuarit eshte i percaktuar nga reduktimi i mases muskulore te llojit sasior e jo cilesor. Studjues te tjere kane konfirmuar kete teori duke analizuar numrin e fibrave te muskujve kuadriceps femori tek kufomat.Ata kane demonstruar qe ne harkun e jetes,nga 20 deri ne 80 vjeç,kemi nje reduktim te mases muskulore deri ne 40%.

-Disa studjues kane vene re nje **shpejtesi** me te madhe ne levizje tek te moshuarit qe praktikonin nje stervitje te rregullt te forces me pesha ne raport me subjekte te te njejtës moshe qe benin nje jete sedentare dhe ne raport me te moshuar qe praktikonin notin e vrapimin.Autoret kane evidentuar qe kjo renie e shpejtesise i dedikohet shperndarjes se miozines ne tipet e ndryshme te fibrave.Eshte vene re ne nje grup te moshuarish qe nuk praktikonin ushtrimet fizike,ne ata qe praktikonin notin dhe vrapimin ,nje permbajtje me larte e miozines se ngadalshme ne krahasim ma ata qe perdornin ushtrime fizike te stervitjes se forces. Keto studime tregojne se si nje stervitje e rregullt e forces,gjate periudhes se mplakjes,mund te kontribuojë ne mbajtjen e karakteristikave morfo-funksionale te fibrave te shpejta te muskujve. (Klitgaard H., Jiang B., Bell G., Harris B., 1995).

-Persa i perket **fuqise** disa studjues kane demonstruar qe ne harkun kohor qe shkon nga 65 ne 84 vjeç,si ne meshkuj dhe ne femra,verehet nje renie e fuqise ne rreth 3,5% per çdo vit te moshes.Te njejtës studjues ne nje studim te bere me perpara kane treguar qe pas 12 jave stervitje eshte verifikuar nje rritje mesatare prej 13-30% te forces

izometrike te muskulit kuadriceps, te bicepsit femoral dhe e fuqise ne ekstremitetet e poshtme. Renia e fuqise eshte me e dukshme pas moshes 50 vjeç dhe eshte me e theksuar tek meshkujt se sa tek femrat: kjo jo per shkak te ndryshimeve qe peson ATP apo te seksionit transversal te muskulit, por me ndryshimin e funksioneve të tjera të tilla si rekrutimi maksimal të njërive motorike dhe degjenerimin e neuroneve motorike alfa. (Skelton, D. A., Greig, C. A., Davies, J. 1994).

Te merresh me aktivitet fizik te rregullt ne moshen e trete sjell nje sere perfitimesh qe permiresojne nje seri organesh e funksionesh fiziologjike e ne menyre te veçante funksionet e aparatit lokomotor, kardiovaskular, te frymemarrjes, nervor. Ti shohim keto perfitime me specifikesht:

-Aparati lokomotor

Kockat: rezistence sa me te madhe per rritjen e mineralizimit e rritjen ne trashesi te spesorit. Ky proces favorizohet nga terheqjet e ushtruara gjate levizjeve qe influencojne pozitivisht ne raportin ndermjet osteociteve dhe osteoblasteve.

Muskujt: rritje si te tonusit dhe te mases muskulore, per pasoje permiresimin e forces muskulare por dhe te shpejtesise e te rezistences.

Artikulationet: stervitja ne pergjithsi jep efekte positive duke e bere levizjen me te rrjedhshme e funksionale. Ky efekt nderhyn pozitivisht ne koordinimin dhe kontrollin e levizjeve.

-Aparati kardiovaskular

Jane regjistruar efekte positive persa i perket rritjes se pompimit sistolik, rritje te volumit kardiak, rritje te kapilareve ne muskuj, ulje e frekuences kardiake ne pushim e reduktim i kohes se rikuperimit pas nje sforcimi.

-Aparati i frymemarrjes

Fuqizim i diafragmes dhe i muskujve te tjere te kafazit, ulje e frekuences respiratore (aktet e frymemarrjes jane me thelle), rritje te kapacitetit jetesor.

-Sistemi nervor

Me shume ndjeshmeri ne neuronet qendrore e periferike me permiresim te pozicioni te trupit ne hapsire. Rritje te shpejtesise se perçimit te impulsit nervor, ulje te kohes se reagimit, permiresim te sinkronizimit te fibrave muskulore.

Ne perfundim te vleresimit te ketyre perfitimeve mund te konfirmojme qe aktiviteti fizik eshte kundershitari kryesor per te gjitha format e plakjes. Te levizesh, sipas nje programi te pershtashem do te thote te vonosh sa me shume te qenurit joeficient duke ruajtur nje imazh te mire per vetveten dhe shrytezuar sa me mire aftesite personale. Por nuk duhet te harrojme gjithashtu perfitimet edhe ne sferen psiqike me permiresimet ne aftesine a vetkontrollit, perqendrimin, aftesine se vullnetit e te çlodhjes.

Perfundime

Per te ndihmuar te moshuarit qe te fillojne te merren me aktivitet fizik dhe ta vazhdojne ate me poshte po tregojme tre menyra se si ta perballojne ate.

1. Futeni aktivitetin fizik ne jeten e perditshme.

Aktiviteti fizik duhet te jete nje sjellje normale e perhershme qe te prodhoje perfitime shendetsore. Duhet te pergatitemi qe te kemi sukses sa me shpejt te jete e mundur duke zgjedhur aktivitetin me te pershtatshem per ju, duke u ushtruar ne menyre te sigurte. Te mbahen shenime per progresin tuaj qe te shikohen sukseset dhe te beni

aktivitetin tuaj fizik stil te jete se perditshme. Shume prej nesh duke patur nje sere preukupimesdh ditore te rendesishme e kane te lehte qe ta vendosin aktivitetin fizik ne fund te listes se gjerave qe duhe te bejne çdo dite. Por duhe te kujtojme qe, te qenurit aktiv eshte nje prej gjerave me te rendesishme qe duhet te behen çdo dite per te mbajtur e permiresuar shendetin tuaj.

Duhet te beheni aktiv qe ne mengjez perpara se te filloni te merreni me gjerat e zakonshme ditore. Mendojeni kohen tuaj te ushtrimeve si nje moment te nje takimi te veçante dhe shenoheni ne grafikun ditor. Nqs frekuentimi i palestrave eshte i paperballueshem per ju financiarisht apo e keni te pamundur spostimin ne distanca te largeta, bejani me te lehte vetes. Merrni 2 libra me nje peshe mesatare dhe mbajeni prane poltronit keshtu qe gjate kohes qe shikoni tv mund te punoni me pak pesha per forcimin e kraheve. Levizni neper dhome dhe gjuani topin nderkohe qe nipi juaj eshte duke luajtur. Dilni te beni pazar sa me shume por jo duke mbajtur pesha te renda. Merrni pjese ne takime te ndryshme qe zhvillohen ne qendra sociale dhe diskutoni me miqte tuaj. Mund te merresh me aktivitet per nje kohe relativisht te gjate por kjo mund te ndahet edhe ne pjese me te vogla gjate gjithë dites duke bere ate qe te pelqen me shume dhe di ta besh me mire.

Behu me i shoqerueshem duke rene dakord me nje te aferm ose komshi qe te beni ushtrime apo aktivitet fizik se bashku. Shume vete mendojne se te kesh nje shoqerues ne aktivitet fizik ndjehen me te inkurajuar.

Beni shetitje ne distanca te ndryshme ne vende qe ju pelqejne me shume me miqte tuaj duke provuar qe te shtoni paksa ritmin e te ecurit. E ne qofte se ju pelqen jeta ne natyre e ajer te pastër, provoni shetitjen me biçiklete, peshkimin, jogging ose eskursionet duke degjuar muzike apo diçka tjeter qe ju pelqen me shume.

▪ Eshte e mundur qe te jeni me aktiv neqoftese:

-Mendoni qe ti jepni rendesine e duhur aktivitetit fizik,

-Perfshini ato veprimtari qe ju pelqejne me shume,

-E ndjeni qe mund ta beni aktivitetin fizik ne menyre korrekte,

-Besoni qe ky aktivitet eshte i sigurte,

-Mundeni te futni ne programin tuaj ditor marrjen me aktivitet fizik,

-Mendoni se keni mundesine financiare per te perballuar kostot e palestrave

-Shikoni perfitime shendetsore gjate marrjes me ushtrime fizike .

▪ Mund te jemi aktiv ne shume vende dhe ne shume menyra:

-Kur zbrazim çantat me ushqime pasi kemi bere pazar, mund ti **forconi** krahët tuaj duke ngritur disa here shishen me leng frutash apo pakon e sheqerit perpara se t'i vendosim ne vendin e caktuar.

-Kur shkoni per te blere rrisni **rezistencen** tuaj duke parkuar makinën sa me larg dyqanit keshtu qe i jepni mundesi vehtes per te ecur sa me gjate. Alternative tjeter mund te jete zbritja nga autobuzi urban dy apo tre stacione me perpara se te afroheni dyqanit tuaj te preferuar.

-Ne vend qe te telefononi kolegun apo mikun tuaj shkoni dhe takojeni vete ate, bile duke ngjitur dhe shkallet ne vend te ashensorit!

-Dilni nga shtepia pa ndonje qellim te caktuar duke i dhene vehtes mundesi per te shtuar hapat e bere gjate dites .

-Kur qendroni ne radhe per te blere diçka, provoni te praktikoni ekuilibrin tuaj duke qendruar me gjithë peshen e trupit here ne njerën kembë e here ne tjetren, keshtu

rritni forcen dhe ekuilibrin.

-Nderkohe qe flisni ne telefon ne shtepi vendoseni njeren kembe ne nje karrike e provoni te perkuleni lehte keshtu do te rritni perkulshmerine dhe elasticitetetin-

-Nderkohe qe po pergatitni dreken dhe pritni te valoje uji beni disa perkulje me krahe te mbeshetur tek muri apo disa ulje-ngritje duke thyer gjunjet.

2. Provoni te gjitha llojet e aktivitetit apo te ushtrimit fizik.

Pjesa me e madhe e personave tentojne te koncentrohen ne nje aktivitet apo lloj te ushtrimit fizik dhe mendojne se kjo eshte e mjaftueshme. Objektivi eshte ai qe te jeni sa me krijues dhe te zgjidhni te beni ushtrime qe te perfshijne te kater llojet e kondicionit fizik-rezistencen, forcen, ekuilibrin dhe fleksibilitetin. Duke i perzier te gjitha keto do t'ju ndihmoje qe te perfitoni nga çdo lloj ushtrimi si dhe do t'ju reduktoje merzine si dhe rezikun e traumave.

-Ne qofte se ngrini pesha kombinoni keto ushtrime pas nje fare kohe me biçikleten ergometrike apo tapetin rrotullues.

-Ne mbarim te ciklit beni disa ushtrime stretching.

-Nese doni te perqendrohemi tek rezistenca, sigurohuni qe te shtoni edhe ushtrime te stretching, ekuilibrit si dhe te forces.

-Po te doni te beni ushtrime force çdo dite duhet te kombinoni punen e grupeve te ndryshem te muskujve.

3. Planifikoni nganjehere dhe nderpreje te zgjatura per arsye te ndryshme.

Mplakja mund te nenkuptoje me shume kohe per te udhetuar per te vizituar pjestare te tjere te familjes qe jetojne larg ose te beni pushime larg shtepise. Mund te tranferoheni ne nje shtepi tjetër apo te ne nje vend tjetër. Nganjehere ndodhin dhe ngjarje te paparashikuara-semundje ne familje apo vdekja e nje njeriu te dashur. Te gjitha keto ngjarje mund te nderpresin aktivitetin e perditshem fizik. Te gjitha keto nderpreje mund ta bejne te veshitare bile nganjehere te pamundur qe te respektojme rregullin e te ushtruarit me aktivitet fizik.

Me poshte po rendisim disa ide se si mund te rifillohet:

-Mos u trego shume i ashper me vetveten duke kuptuar qe do te kete momente qe nuk mund te besh aktivitet fizik.

-Mjafton te mos ndjehesh i vetmuar dhe do te kuptosh qe mund te kthehesh ne rutinen e aktivitetit te perditshem.

-Sa me pare te fillosh te merresh me nje lloj aktiviteti aq me mire do te ndjeheni dhe aq me e lehte do te jete kthimi ne jeten e perditshme.

-Flisni me mjekun tuaj se kur mund te filloni te merreni me aktivitetin ditor, nese eshte nderprere te ushtruarit fizik per arsye te ndonje semundje .

-Mendoni per arsyet qe te kane bere qe te fillosh te merresh me aktivitet fizik si dhe objektivat qe i ke vene vetes. Kujto motivacionin si dhe perfitimin qe ke patur duke bere ushtrime fizike.

-Kerkojini familjes dhe miqve tuaj qe t'ju ndihmojne per tu kthyer ne gjendjen e meparshme. Nganjehere eshte e nevojshme qe te kesh nje shok gjate te ushtruarit me aktivitet fizik. Here te tjera ndoshta ka me vlere mbeshetja vetem me fjale.

-Provoni te beni diçka me te lehte ose ndryshe nga ajo qe keni bere me pare sepse mund t'ju jape besimin e nevojshem per te rifilluar marrjen me aktivitet fizik te rregullt.

Bibliografi

- Klitgaard H., Jiang B., Bell G., Harris B., Saltin B., Gollnick P. D., Roy R. R., day M. K., Greenisen M. (1995). Human fiber size and enzymatic propertirs after 5 and 11 days of spaceflight. *L. Appl. Physiol.* 78: 1733-1739.
- Skelton, D. A., Greig, C. A., Davies, J. M., & Young, A. (1994). Strength, power and related functional ability of healthy people aged 65 89 years. *Age and Ageing*, 23, 371 377.
- Grimby,G&Saltin,B. (1983) "The Ageing muscle" *Clinikal Physiology* 3: 209-218.
- Periodiku Euronote (2005).
- INSTAT"Popullsia dhe dinamika e popullsisë në Shqipëri". Tirana, INSTAT(2014).

Ndihma juridike në procesin penal ne Republikën e Kosovës

Taulant Bajrami

Hyrje

Ndihma juridike është një nga të drejtat kryesore të të pandehurit e cila si e tillë është e garantuar edhe me anë të Kushtetutës, e cila paraqet të drejtën më të rëndësishme në procedurën penale, respektimi i së cilës paraqitet si garantuese e ligjshmërisë të vendimeve gjyqësore dhe është kusht kryesorë pa respektimin e së cilës nuk mund të përmbushen presmisat për një gjykim të drejtë dhe të paanëshëm.

Respektimi i kësaj të drejte paraqet nivelin e demokratizimit të një shteti, ngase mbrojtja juridike nuk është vetëm në interes të individit ndaj te cilit zhvillohet procedura penale por është në interes të përgjithshëm të shoqërisë dhe shtetit.

Qëllimi kryesor i kësaj të drejte është nxjerrja e një aktgjykimi të drejtë dhe të ligjshëm në procedurën penale, gjë që arrihet vetëm pas një pune shumë komplekse të organeve që e zhvillojnë procedurën penale e në të cilat vërtetohen saktësisht faktet më të rëndësishme për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm dhe konstatimin e së vërtetës material. Në pozitën e të pandehurit shpeshherë paraqiten personat të cilat nuk kanë njohuri mbi këto procese juridike, dhe të cilët gjatë procedurës duhet të përballen edhe me palëm paditëse të cilët janë profesionistë juridike. Prandaj me që i pandehuri nuk ka përgaditje juridike, do të jetë shumë më efektive ushtrimi i funksionit të mbrojtjes nga ana e avokatit, i cili mund ta përfqësojë të pandehurin gjatë gjitha fazave të procedurës penale dhe mund të ndërmerret vetëm ato veprime procedurale të cilat janë të autorizuar nga ana e të pandehurit

Qëllimi i punimi është njohja dhe analizimi i kuadrit ligjor vendor dhe ndërkomtar që parashikon dhënien e ndihmës ligjore, fushat dhe individët që mund të përfitojnë, procedurat për caktimin e avokatit falas, rolet e ndryshme që kanë institucionet e përfshira. Punimi është i ndarë në dy pjesë ku fillimisht në pjesën e parë flitet për standardet ndërkomtare në fushën e ofrimit të ndihmës juridike, ndërsa në pjesën e dytë flet për legjislacionin penalë në Kosovë i cili garanton këtë të drejtë.

I. Aktet ndërkomtare të cilat përcaktojnë detyrimet e shtetit në fushën e ndihmës juridike penale

Një sërë aktësh ndërkomtare kanë përcaktuar parimet themelore dhe kriteret mbi të cilat ofrohet ndihma juridike. Si aktë të tilla ndërkomtare janë disa prej akteve të Kombeve të Bashkuara si Konventa Ndërkomtare për të Drejtat Civile dhe Politike pastaj aktet e Këshillit të Evropës si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Evropiane e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian si dhe disa raste gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Standardet e Kombeve të Bashkuara përcaktojnë disa garanci minimale ndaj një personi i cili akuzohet për një veprë penale, të cilat përcaktojnë se i akuzuari duhet të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij. Në qoftë se nuk ka mbrojtës, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtës falas në cilindo rast nëse ai nuk ka mjete për të paguar.¹ Pra siç

¹ Konventa ndërkomtare për të Drejtat Civile dhe Politike e OKB-së, Neni 14, paragrafi 3, pika d.

shihet kjo përcakton dy kushte thelbësore të cilat duhet të plotësohen që një person të përfitojë mbrojtjen nga një avokat i caktuar kryesisht: e para nëse me këtë mbrohet interesi i përgjithshëm shoqëror, pra realizohet qëllimi i drejtësisë dhe e dyta avokati duhet të caktohet në rast se personi i akuzuar nuk qëndron mirë ekonomikisht për të paguar avokat. Përveq Konventës ndërkomtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me 20 Dhjetor 2012 ka miratuar Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së mbi aksesin në ndihmë juridike në sistemin e drejtësisë penale të cilat kërkojnë nga shtetet të ndërtojnë sistem më efektiv të ofrimit të ndihmës juridike falas. Sipas këtyre udhëzimeve e drejta për ndihmë juridike përfshin forma të ndryshme veprimesh duke filluar nga mbrotja ligjore e duke vijuar në edukimin ligjor dhe aksesin ndaj informacionit ligjor, si dhe përcaktojnë se ndihma juridike duhet ti ofrohet gjatë gjitha fazave të procedimit, pra që nga moment kur ai është thirrur në satcion policor e deri në përfundim të procesit.²

Po ashtu këto udhëzime kërkojnë nga shtetet që të vendosin kriteret për licencimin e ofruesve të ndihmës juridike, si dhe ngritjen e mekanizmave efektiv të mbikëqyrjes të këtyre ofertuesve.³ Një dokument tjetër i rëndësishëm i cili përcakton detyrimet e shtetit në fushën e ndihmës juridike në procesin penal është edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në pjesën ku flet për të drejtat e personit të akuzuar ndër të tjera parasheh të drejtën e personi të akuzuar të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.⁴

Po ashtu Këshilli i Evropës ka miratuar edhe Paktin Ndërkombëtar për të drejtat e njeriut i cili ndër të tjera parasheh të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar.⁵

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka luajtur një rol të rëndësishëm në interpretimin e këtyre parimeve duke përcaktuar dhe zhvilluar parime dhe rregulla të hollësishme për mënyren se si duhet të sigurohet ndihma juridike dhe çështje tjera të lidhur me ndihmën juridike, duke interpretuar këto rregulla në rastet e parashtruara pranë saj, si përsëmbull në rastet Balliu kundër Shqipërisë, nr.74727/01 të datës 16 Qershor 2005, rasti Haxha kundër Shqipërisë nr.29861/03 të datës 8 tetor 2013.

II. Ndihma juridike në procesin penal në Kosovë

E drejta për të pasur mbrojtës gjatë procesit penal është një ndër parakushtet themelore për realizimin e një procesi të drejtë dhe të pa anëshëm penal, pa përmbushjen e të cili nuk mund të arrihet qëllimi i drejtësisë. Si e tillë kjo e drejtë njihet nga të gjitha legjislacionet e brendshme.

² Parimet dhe Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Akses në ndihmën juridike në Sistemin e Drejtësisë Penale, Udhëzimi nr.4,5,6, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 2012.

³ Po aty, Udhëzimi nr.15.

⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, Neni 6, paragrafi 3, pika c.

⁵ Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike, Këshilli i Evropës, Neni 14 paragrafi 3, pika d.

Kushtetuta e Kosovës

Edhe Kosova garanton këtë të drejtë me anë të aktit më të lartë Kushtetutën e saj. Ndër të tjera që në Kushtetutë Kosova garanton të drejtat e të akuzuarit për kohë të mjaftueshme për të përgaditur mbrojtjen e vet si dhe garanton të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe , nëse nuk ka mjete të mjaftueshme , t'i sigurohet mbrojtja falas.⁶ Po ashtu edhe tek e drejta për gjykim të drejtë dhe të pa anëshëm Kushtetuta garanton se çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj, po ashtu ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.⁷ Siç shihet Kosova me anë të aktit më të lartë juridike garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke i respektuar kështu dispozitat e Koventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara - Konventës Ndërkombtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat sipas Kushtetutës së Kosovës aplikohen drejtpërdrejtë dhe kanë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.⁸

Pra kjo e drejtë sipas Kushtetutës së Kosovës i njihet çdokujt, pavarësisht statusit të tij racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë e mendimeve politike etj, me qëllim për të ruajtur barazinë e shtetasve para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.

Pra siç shihet nga dispozitat e nenit 30 pika 5, dhe nenit 31 pika 6 shteti ndihem e mbrojtësit pa pagesë ia siguron shtetasve të cilët nuk kanë mundësi financiare apo në rastet e mbrojtjes së nevojshme të parapra me Kodin e Procedurës Penale për të cilat do të flasim më vonë. Nga kjo rrjedhë që shteti nuk është i detyruar që të sigurojë avokat nëse ekzistojnë arsye objektive, siç janë rastet kur personat kanë mundësi financiare për pagesë, ose kanë nivel të duhur arsimorë dhe njohuri rreth procesit penal apo nëse personi i akuzuar heq dorë vullnetarisht nga e drejta e mbrojtjes.

Nga dispozitat e lartëcekura, shihet se Kushtetuta jo vetëm që kërkon nga shteti të njohë të drejtën në ndihmë ligjore dhe të mos e cënojë, por kërkon edhe ndërrmarrjen e masave për të realizuar atë.

Kodi i Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale në mënyrë më detajizuar rregullon të drejtën në mbrojtje juridike në procesin penal, ku ndër të tjera parashikon organet kompetente për caktimin e mbrojtësit , kualifikimet e mbrojtësit, të drejtat dhe detyrimet e tij, mbrojtjen në rastet e detyruara me qëllim të garantimit dhe respektimit të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të pa anëshëm.

Kodi i Procedurës Penale personit të dyshuar dhe të pandehurit të drejtën në mbrojtje gjatë gjitha fazave të procedurës penale.⁹ Ky kod ka inkorporuar në tërësi në këtë

⁶ Kushtetuta e Kosovës, Neni 30, paragrafi 3 dhe 5.

⁷ Po aty, Neni 31, paragrafi 2 dhe 6.

⁸ Po aty, Neni 22.

⁹ Kodi i Procedurës Penale, Neni 53, paragrafi 1.

dispozitë standardet ndërkomtare në fushën e ndihmës juridike sipas së cilave ndihma juridike duhet të ofrohet nëpër të gjitha fazat e procedurës penale :

- Kur ndalohet apo thirret si i dyshuar
- Gjatë hetimeve paraprake
- Gjatë gjykimit
- Gjatë fazës ankimore

Në cilën do fazë të procedurë, Kodi e obligon organin përkatës që zhvillon procedurën që ta udhëzojë të pandehurin për të drejten e tijë në angazhimin e mbrojtjesit.¹⁰ Po ashtu e njeja dispozitë rregullon heqjen dorë nga mbrojtësi e cila do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet qartë dhe e vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtat e tijë në mbrojtjes, përveq në rastet e mbrojtjes së detyrueshme. Kodi kërkon që heqja dorë nga mbrojtësi të bëhet me shkrim dhe të shënohet në procesverbal të cilin e nënshkruan edhe i pandehuri. Rast të tillë në të cilën heqja dorë nga avokati nuk është bërë me shkrim ka raste nga praktika gjyqësore ku Gjykata Supreme ka vendosur për kthimin e lëndës në rigjykim për shkak se i pandehuri nga ana e gjykatës është njoftuar me të drejtën e tijë për mbrojtës por nuk është deklaruar nëse pajtohet që të ketë mbrojtës apo jo, përkatësisht nuk ka nënshkruar procesverbalin në të cilin konstatohet se ai ka hequr dorë nga mbrojtësi.¹¹ Një aktgjykim lidhur me rastet kur i akuzuari nuk pranon mbrojtës edhe në rastet e mbrojtjes të detyruar Kodi e ka rregulluar duke caktuar avokatin në gadishmëri detyrë e të cilit është që ta këshillojë të pandehurin gjatë procedurës. Për rastet të tilla kur një i akuzuar heqë dorë edhe nga mbrojtja e detyruar, në praktikën e sajë ka vendosur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut si në çështjen *Balliu kundër Shqipëris*, në të cilën çështje pas dështimit të avokatit të Balliut për të marrë pjesë në gjykim , nuk pranoi të mbrohet vetë, gjithashtu ai refuzoi të mbrohet edhe nga avokati i caktuar sipas detyrës zyrtare . Pas refuzimit të dyfishtë gjykata vazhdoi gjykimin pa praninë e avokatit. Balliu i drejtohet GJEDNJ me ankesën se ai nuk ka përfituar nga ndihma juridike. GJEDNJ në këtë rast vendosi se Balliu duke refuzuar caktimin e avokatit kryesisht pa ndonjë arsye kishte heq dorë nga e drejta për tu mbrojtur me avokat, ndërsa autoritet përkatëse kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një gjykim të drejtë.¹²

Në rastet e mbrojtjes së detyrueshme ky Kod ka përcaktuar obligimin për gjykatat apo organin që zbaton procedurat, që të caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzimet publike nëse këtë nuk e ka bërë i pandehuri apo të afërmit e tijë.¹³ Mos caktimi i mbrojtësit në rastet e mbrojtjes së detyruar do të përbënte shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.¹⁴

III. Roli i avokatit në procedurën penale

Detyra kryesore e avokatit në procedurë penale është ti shërbejë të akuzuarit, përmes realizimit të mbrojtjes së tij e cila arrihet përmes vendosjes së një mardhënie besimi dhe konfidenciale me të akuzuarin. Avokati duhet ti diskutojë me të akuzuarin për mënyrën e përfaqësimit si dhe të kërkojë nga i akuzuari të gjitha informacionet me

¹⁰ Po aty, Neni 53.

¹¹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Nr. 23/2015 i dates 01.02.2015.

¹² Rasti i GJEDNJ-së , Balliu kundër Shqipëris, nr.74727/01,

¹³ Kodi i P rocedurës Penale, Neni 57, paragrafi 2.

¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatws Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 26/2004.

qëllim të realizimit të një mbrojtje efektive.

Avokati është i obliguar të marrë mbrojtjen e ofruar të të pandehurit, pavarësisht nga personaliteti i të pandehurit dhe lloji i veprës, si dhe të përfaqësojë palën e dëmtuar në çështjet penale Avokati nuk duhet ta refuzojë mbrojtjen në çështjet penale për shkak se mbrojtja është e vështirë, se ekzistojnë prova të pamohueshme mbi veprën e kryer, se pala ka pranuar kryerjen e veprës, për shkak të peshës së veprës dhe reagimet e opinionit publik.¹⁵

Avokati në procedurë penale gëzon të drejta të njëjta që ia nje ligji edhe të pandehurit, përveç atyre që shprehimisht i rezervohen të pandehurit personalisht. Avokati ka të drejtë të komunikojë lirisht me të pandehurin gojarisht ose me shkrim sipas kushteve që garantojnë fshehtësinë dhe për këtë shteti është i obliguar që të ndërmarë masa që realizimi i komunikimit mes avoktit dhe të akuzuarit të jetë konfidencial . Avokatika të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikojë shkresat dhe provat e çështjes ¹⁶ Po ashtu avokati ti drejtojë pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të njihet me të gjithë materialin e lëndës , të kërkojë informacione dhe dokumente nga institucione punlike etj.

Mirpo përveq të drejtave Avokati ka disa detyrime në procedurën penale të cilat më detajisht përcaktohen me dispozitat e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Ndër të tjera avokati, në kryerjen e profesionit të vet, ka për detyrë që gjithnjë të ruajë autoritetin e gjykatave, organeve të administratës dhe autoriteteve tjera pranë të cilave jep ndihmë juridike dhe të shprehë respektin e duhur ndaj tyre, si dhe është i obliguar të këshillojë klientet e tij për sjelljen e tyre në respekt të gjykatës.¹⁷ Avokati duhet të silltet me respekt dhe dinjitet edhe ndaj kundërshtarit, duke u përpjekur që të krijojë kushte, që kontesti të zgjidhet sa më shpejt, nuk duhet ta shfrytëzojë mosdijen, lajthimin ose frikën e palës kundërshtare, veçanërisht nëse ajo nuk ka përfaqësues juridik, për të arritur sukses të pajustificueshëm për palën e vet.

IV. Kualifikimet e avokatit dhe zgjedhja e tij për përfaqësim

Në legjislacionin e Republikës së Kosovës ofrimi i nihmës juridike në proceset penale monitorohet nga Oda e Avokatëve të Kosovës në bashkupunim me Agjensinë e Ndihmës Juridike. Për të ushtruar funksionin e avokatit një person në procedurën penale i angazhuar nga klienti, apo i angazhuar kryesisht duhet ti ketë disa kualifikime si të ketë shtetësin e Republikës së Kosovës, diplomën e fakultetit juridik, zotësinë e veprimit, provimin e juris podencës etj.¹⁸

Shteti në rastet e mbrojtjes së detyruar angazhon një avokat të licencuar nga ana e Odës së Avokatëve të Kosovës. Oda e Avokatëve miraton listën e avokatëve për të përfaqësuar në rastet sipas detyrës zyrtare apo në ofrimin e ndihmës juridike falas, e cila vihet në dispozicion organeve të cilat e zhvillojnë procedurën ndaj të akuzuarit.¹⁹ Oda për të qenë transparente para opinionit bën publike në faqen zyrtare në internet

¹⁵ Kodi i Etikës Profesionale te Avokatit , Neni 31, 32.

¹⁶ Kodi i Procedures Penale, Neni 61.


¹⁷ Kodi i Etikës Profesionale te Avokatit, Neni 40, 46.

¹⁸ Ligji për avokatinë i Kosovës, Neni 10.

¹⁹ Rregullore për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, Oda e Avokatëve të Kosovës Neni 4, paragrafi 1.

listat javore të angazhimeve të avokatëve nga instutucionet përkatëse.

Vetëm në fillim të këtij viti gjatë muajit janar Oda e Avoaktëve ka angazhuar rreth 1100 avokatës sipas detyrës zyrtare. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur nr i angazhimeve të avokateve sipas detyrës zyrtare në qytetet më të mëdha të Kosovës



Diagrami 1. Të dhënat mbi nr. e avoktëve të angazhuar në mënyrë ex-officio²⁰

Siç shihet numri me i madh i angazhimeve është në kryeqytet gjë që është normale duke pasur parasysh se është qyteti me numrin më të madhe të banorëve, dhe është krejtësisht normale që edhe delikuenca në qytet e mëdha do jetë në numër më të mëdha, pastaj vie qyteti i Gjilanit me 190 Angazhime dhe ai i Prizrenit.

Oda e avokatëve për angazhimin e një avokati në mënyrë ex-officio, përcakton edhe disa kriteret të nivelit profesional të cilat duhet ti përmbushë një avokat për të qenë pjesë e kësaj liste, ku për bazë merr përvojën e punës në bazë të cilave pastaj cakton për përfaqësim avokatin për përfaqësim në polici, në department të përgjithshëm të gjykatës, apo në department për të mitur dhe krime të rënda. Po ashtu kriter tjetër në përcaktimin se cili avokat do të përfaqësojë palën në procedurë është selia e zyrës së avokatit, sipas së cilit kriter Avokatët do të caktohen për përfaqësim ex-officio edhe në ANJF vetëm në qytetin ku e kanë selinë e zyrës e përjashtimisht në mungesë të avokatëve edhe në qytetin më të afërt.²¹ Edhe praktika e GJEDNJ-së përcakton se thjesht caktimi i një avokati nuk është i mjaftueshëm për ta përmbushur detyrimin e shtetit për të siguruar ndihmë juridike falas. Nëse avokati i ndihmës juridike nuk arrin të sigurojë përfaqësim efektiv, dhe kjo është e dukshme apo është sjellë në vëmendjen e autoritetit të shtetit, atëherë shteti ka detyrimin të ndërhyjë dhe korigjojë dështimin. Lidhur me këtë çështje GJEDNJ vendosi në rastin *Kamasinski kundër Austrisë*, ku GJEDNJ u shpreh " Një shtet nuk mund të jetë përgjegjës për çdo mangësi nga ana e avokatit të caktuar për qëllime të ndihmës juridike", sipas GJEDNJ-së "Pavarësia ligjore profesionale e dhënë nga shteti nënkupton se sjellja e mbrojtjes është një çështje ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, qoftë i caktuar nga shteti apo i financuar privatisht, Gjykata pajtohet se autoritet e shtetit duhet të ndërhyjë vetëm në qoftë se dështimi i avokatit për të siguruar përfaqësim efektiv është i dukshëm apo është sjellë në vëmendjen e tyre në njëfarë mënyre"²²

Oda e avokatëve varësisht nga përvoja e punës së avokatit përcakton se :

- Të gjithë avokatët e deklaruar për përfaqësimin ex-officio, pa kategorizim/dallim do të përfaqësojnë rastet ex-officio në polici

²⁰ Të dhëna statistikore nga web faqja e Odës së Avokatëve të Kosovës.

²¹ Rregullore për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, Oda e Avaktëve të Kosovës Neni 4, paragrafi 1, pika 9.

²² Rasti *Kamasinski kundër Austrisë*, GJEDNJ, Vendimi i dates 19 dhjetor 1989, paragrafi 65.

- Të gjithë avokatët të cilët kanë përvojë më pak se tre vite si; avokatë, prokuror ose gjyqtar do të përfaqësojnë të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale në çdo nivel të departamenteve të përgjithshme të prokurorive dhe gjykatave si dhe ofrimin e ndihmës juridike falas në ANJF.

- Të gjithë avokatët të cilët kanë përvojë mbi tre vite si; avokatë, prokuror ose gjyqtar do të përfaqësojnë të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale në çdo nivel të prokurorive dhe gjykatave, në Departamentin për të Mitur dhe Departamentet e Krimeve të Rënda.²³

Pra siç shihet legjislacioni penal në Kosovë, nuk i ofron mundësi personit të cilit i angazhohet sipas detyrës zyrtare avokatit në rastet e mbrojtjes së detyruar apo në rastet e pamundësis ekonomike për pagesë, që të bëjë përzgjedhjen e avokatit emrit të caktuar për përfaqësim, por kjo bëhet nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Kjo është një zgjidhje e cila është në përputhje edhe me praktikën gjyqësorë të GJEDNJ-së, si në rastin *Ramon Franquesa Freixas kundër Spanjës*, ku Ramon u ankua pranë kësaj gjykate se të drejtat e tij sipas Neni 6 pika 3 (c) ishin shkelur, sepse për ta mbrojtur atë në një çështje penale atij ishte caktuar një avokat i specializuar në legjislacionin e punës. GJEDNJ në vendimin e saj konstatoi se ankesa e tij ishte e pa bazë, sepse Neni 6 (3) (c) nuk i garanton të drejtën për të zgjedhur cilin avokat duhet t'i caktojë gjykata dhe sepse ankuesi nuk kishte paraqitur ndonjë provë bindëse për të mbështetur pohimin e tij se avokati ishte i paftë për ta mbrojtur.²⁴

V. Rastet në të cilat mbrojtja juridike është e detyruar

Një ndër parakushtet kryesore për tu arritur një gjykimi i drejtë dhe i paanëshëm është respektimi i të drejtës për mbrojtje, e cila është e drejtë e të pandehurit në procedurën penale që të ketë një person të pregaditur juridiksht për ushtrimin e funksionit të mbrojtjes së tij. Pra, kjo e drejtë parimisht është e drejtë individuale e personit të akuzuarit nga e cila i akuzuari shprehimisht mund të heqë dorë. Mirëpo Kodi i Procedurës Penale ka shkuar edhe më tej, duke caktuar disa raste apo rrethana të cilat nëse paraqiten është e obliguar mbrojtësi juridik përkatësisht avokati edhe nëse pala nuk e dëshiron atë është detyrë e shteti që të ja sigurojë atë me shpenzime të shtetit. Sipas Kodit të Procedurës penale Në qoftë se i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat e tij të afërt, gjykata ose një organ tjetër kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.^o

Sipas Kodit të Procedurës Penale i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar:

- nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paafësisë mendore dhe kështu është i paftë që të mbrohet vetë me sukses;
- gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;
- nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër

²³ Rregullore për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, Oda e Avokatëve të Kosovës, Neni 4, paragrafi 5.

²⁴ *Rasti Ramon Franquesa Freixas kundër Spanjës*, GJEDNJ, vendimi i dates 21 nëtor 2000.

penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;

- në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; dhe
- në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për veprën penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi.

Pra siç shihet nga kjo dispozitë e Kodit të Procedurës Penale mbrojtja e detyrueshme i ofrohet të akuzuarit për shkaqe të ndryshme siç janë: 1) shkaqet të cilat kanë të bëjnë me cilësi të caktuar të të pandehurit (kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër, ose me çrregullime e paaftësi mendore), 2) shkaqet të cilat kanë të bëjnë me peshën e veprës penale e cila është lëndë e procedimit (kur aktakuza është ngritur kundër tij për veprën penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim), 3) Shkaq që kanë të bëjnë me veçori të procedurës penale. Në të gjitha këto raste KPP përcakton se është obligim i shtetit që të caktojë avokat në mënyrë zyrtare i cili paguhet nga ana e shtetit. Kodi i Procedurës Penale parashih përjashtimin e personave juridike nga mbrojtja e detyruar me shpenzime publike.²⁵

VI. Caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar

Kushtetuta e Kosovës në nenin 22 ka paraparë aktet juridike ndërkomtare të cilat kanë zbatim të drejtëpërdrejt në Kosovë. Në mesin e këtyre akteve është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj si dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj. Sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut personit të akuzuar do ti sigurohet mbrojtja juridike fals në dy raste dhe atë në rastet kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë dhe rast tjetër kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar. Në përputhje me këtë konventë edhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ka paraparë rastet kur të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike edhe kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar. Mbrojtësi me shpenzime publike i caktohet të pandehurit nëse : nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për veprën penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me 8 ose më shumë vjet, ose këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.²⁶ Siç shihet nga kjo dispozitë kjo lloj mbrojtje i caktohet të pandehurit vetëm me kërkesën e tij dhe nëse plotësohen disa kushte si të mos ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme, procedura të zhvillohet për vepra të dënueshme prej 8 e më shumë vitesh, në rastet kur i pandehuri nuk mund t'i paguajë shpenzimet e mbrojtjes dhe në rastet kur organi i cili zhvillon procedurën pavarësisht nga dënimi i parashikuar, vlerëson se caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike është në interes të drejtësisë.

²⁵ Po aty, Neni 57, paragrafi 4

²⁶ Po aty, Neni 58, paragrafi 1.

Përfundime

Siç vërhet nga mësipër legjislacioni penal në fushën e ndihmës juridike në masë të madhe plotëson standardet juridike ndërkombtare për ndihmë juridike. Në përputhje me këto standard Kosova ka siguruar të drejtën e cilit do qytetarë që nuk ka mundësi financiare, apo kur e kërkon interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe drejtësisë të ketë ndihmë juridike me shpenzime publike. Këtë ndihmë juridike shteti i ofron qytetarëve në të gjitha situatat kur personi ndalohet apo thirret si i dyshuar, gjatë hetimeve paraprake, gjatë gjyqimit si dhe gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Ndihma juridike ofrohet në të gjitha qytet e vendeve nga avoktët të cilët janë paraqitur në listën e Odës së Avokatëve për ndihmë juridike falas dhe zakonisht veprohet në atë mënyrë që ofrojnë ndihmë vetëm brenda qyteteve në të cilat ata kanë selinë e tyre.

Ndihma juridike në proceset penale edhe pse sipas legjislacionit është bërë përpjekje të jetë cilësore ngase me rregulloren për caktimin e avokatëve në mënyrë zyrtare janë paraprë disa kritere të cilat lidhen kryesisht me përvojën e punës së avkatëve, për përfaqësimin e të pandehurit në departamentet përkatëse, në zbatimin praktikë shpeshherë ka ankesë së avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare shpeshherë ushtrojnë mbrojtje formale, duke mos kërkuar kohë për tu njohur mirë me dosje dosjen penale, prandaj është e domosdoshme rritja e mekanizmave mbikyrëse dhe monitoruse për avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në aspektin praktik në rastet e caktimit të avokatit nga gjykata takimi avokat-klient bëhet në sallën e gjyqit, gjë që e bën mbrojtjen jo shumë cilësore, si për shkak të kohës jot ë mjaftueshme ashtu edhe për shkak të mungesës së kontaktit që do të krijonte besimin tek klienti

Në çështjet penale ku të përfshirë janë të miturit, shumica e tyre mbrohen nga avokatët e caktuar kryesisht sipas detyrës zyrtare dhe të cilët nuk kanë ndonjë specializimin në fushën penale për të mitur, prandaj është e nevojshme që një numër i caktuar i avokatëve nga lista për angazhime zyrtare të specializohen dhe trajnohen në këtë fushë

Është e rëndësishme që të ketë ndryshime ligjore të cilat i mundësojnë të pandehurit që vetë të zgjedh avokatin të cilin e dëshiron në mbrojtje por gjithmon duke u kufizuar në listën e Odës së Avokatëve.

Depresioni dhe Ankthi tek adoleshentët si dhe ndërlidhja e tyre me suksesin në shkollë

Kaltrina Skoro Murtezaj
Kolegji Fama

Blerina Vehbiu
Kolegji Fama

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të vlerësohet sukcesi dhe ndërlidhja e saj me depresionin, ankthin në mes të nxënësve të shkollave të mesme në Prizren, si dhe krahasimet gjinore në mes të adoleshentëve me depresion dhe ankth. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë adoleshent të moshës 14 deri 20 vjeq, ku është bërë përpjekje që përmes rreth njëzet e pesë pyetjeve të matet prezenca e depresionit, ankthit, krahas gjinive, si dhe ndërlidhja e tyre me suksesin në shkollë. Ky hulumtim është realizuar me nxënësit e klasave të teta, nënta, dhjeta, njëmbëdhjeta dhe dymbëdhjeta të shkollave të mesme në Prizren. Mjet matës është përdorë pyetësori me pyetje të mbyllura ku, subjektet janë përgjigjur në pyetje në atë mënyrë që ata kanë pasur opsione të përgjigjeve me alternativë (1-4). Mostra përbëhet prej $n=34$ rasteve prej të cilëve 47.1% ($n=16$) të respondentëve kanë qenë mashkuj dhe 52.9% ($n=18$) kanë qenë femra. Sa i përket dallimeve gjinore mes adoleshentëve të shkollave të mesme edhe pse femrat kanë treguar pikë më të ulëta të depresionit, është vërejt se nuk ka pasur dallime signifikante sa i përket depresionit në mes të meshkujve dhe femrave. *Dallimet gjinore tek adoleshentët me ankth*, sa i përket ankthit edhe përkundër asaj që femrat kanë rezultu me pikë më të lartë të ankthit, sipas krahasimit të mesatareve gjegjësisht analizimit të t-testit nuk ka pas dallime signifikante. *Dallimet gjinore tek adoleshentët me ankth*, sa i përket ankthit edhe përkundër asaj që femrat kanë rezultu me pikë më të lartë të ankthit, sipas krahasimit të mesatareve gjegjësisht analizimit të t-testit nuk ka pas dallime signifikante. (2) *Sukcesi dhe ndërlidhja me depresionin*, sa i përket ndërlidhjes së suksesit me depresionin tek femrat ka rezultu me keshtu pike te ulta te depresionit me nje mesatare me te larte te suksesit *Sukesi dhe ndërlidhja me ankthin*. Ndërlidhja e suksesit me ankthin te femrat ka rezultu me pika te larta të ankthit por edhe me mesatare te lartë të suksesit ku meshkujt kanë tregu pika më të ultë të ankthit por edhe me një mesatare më të ulët të suksesit të tyre.

Hyrje

Adoleshenca është periudhë kalimtare e zhvillimit të individit, ndërmjet fëmijërisë dhe moshës së rritur, kjo periudhë e zhvillimit përshkohet nga një varg ndryshimesh dramatike (në planin organik, emocional, dhe social), kurse në raste të veçanta me turbullira dhe strese. Psikologët konsiderojnë se adoleshenca fillon në kohën e pubertetit. Termi pubertet i referohet periudhës së pjekurisë fizike (seksuale) që fillon rreth moshës dhjetë ose dymbëdhjet vjeçare për vajzat dhe trembëdhjet ose katërbëdhjetë vjeçare për djemt. (Murtezani, 2006).

Problemet që paraqiten në këtë periudhë

Në fillim të shekullit të 20-të, shumë njerëz e shifinin adoleshencën si periudhë me paqëndrueshmëri të madhe dhe emocione të forta. Adoleshenca rrjedh

nga fjala “adolescere-pjekuri”. Ajo eshte nje periudhe kalimtare e zhvillimit te individit,ndermjet femijerise dhe moshes se rritur,respektivisht nje rugetim qe e ndjek individi per te ariturr statusin e te rriturit.

Kjo peridhe zhvillimi pershkohet me nga nje varg ndryshimesh dramatike:ne planin organik,emocional,social.Shpeshhere adoleshenca percillet me ndryshime renjesore ne sjelljen e individit.Psikologu Stanly Holl(1916) konsideronte se ndryshime te medha ne adoleshence ndodhin ne aspektin e stresit.Keshtu ai e portretizonte adoleshencen si nje periudhe “Stuhie Emocionale dhe Stresi”,e mbushur me vuajtje dhe rebelizem kunder autoritetit te te rriturve.

Ashtu si zhvillohet trupi gjate adoleshences.zhvillohet edhe menyra e te menduarit.

- Adoleshentet nuk arijne te kuptojne se jo te gjitha mendojne si ata,dhe se njerezit e tjere mund te kene mendime te ndryshme
- Eshte prirje e adoleshenteve per te ndjere se ata jane vazhdimisht nen vezhgimin e te tjereve dhe se njerezit jane gjithmone duke gjykuar pamjen dhe sjelljen e tyre.Kjo ndjenje e te qenit vazhdimisht”ne qender te vemendjes”mendohet se duhet te jete burim I druajtjes,I merakut per pamjen e jashtme te vet adoleshentit.
- Tek adoleshentet praqitet tendenca,se ata jane unike,shume te rendesishem dhe te imunizuar.Per shembull nje adoleshent mund te kembengul qe te tjeret nuk e kuptojne dashurine e tij per nje moshatare,sepse kjo dashuri sipas tij eshte unike dhe speciale.Shume adoleshente besojne se ata jane aq te ndryshem nga njerezit e tjere sa jane te imunizuar nga gjerat negative qe iu ndodhin te tjereve.Kjo nejenje shoqerohet me rrezikun e mendjehlesise qe iu kanoset adoleshenteve.
- Adoleshentet jane te etur per te shpallur pavaresine e tyre prej prinderve,por njekohesisht u tremben edhe pergjegjesive te moshes se rritur.Ata e kuptojne se perpara kane shume detyra dhe vendime te rendesishme.Dhe ne vecanti,ne nje shoqeri te perparuar nga pikepamja teknologjike,kjo periudhe zhvillimi kuptohet se ka nje fare stresi.

Ne trurin e adoleshentit ndodhin ndryshime te medha ne aspektin e fijeve nervore dhe te sinapsave te tyre.Te menduarit ne femijeri eshte konkret,tani me ne adoleshence te menduarit eshte abstrakt.

Te adoleshenti persosen edhe me tej proceset e rendesishme mendore te cilat jane:Forcimi i kujteses afatgjate,Vemendja i nenshtrohet vullnetit te individit dhe fokusohet per nje kohe me te gjate ,gjuha posedon nje fond te zgjeruar fjalesh,poashtu arrijne sukses ne zoterimin e aftesive te reja si p.sh:mund ti parashikojne ngjarjet dhe te shtrojne hipoteza per te ardhmen dhe qeshtje qe i preokupojne vet ata.

Procesi i formimit të identitetit

Identiteti është nocion me të cilin përkufizohet ndjenja ,e cila mundëson që personaliteti të përjetojë vetëveten si person i veçantë,i pavarur,i vetedijshëm prë gjendjen e tij somatike,pjekurinë seksuale,për raportin e tij ndaj njerëzve në shoqëri si dhe raportin e tyre ndaj tij.Adoleshentët janë në kërkim të identitetit që rezulton me vetëdijesim të lartë për veten e tyre.Sipas Eriksonit,cështja e identitetit,paraqet objektivin themelor në periudhën e adoleshences.Adoleshenti nuk mund tu shmanget pyetjeve karakteristike në këtë moshe si”

- Kush jam unë?

- Cfarë do të bëhem?
- Si përshtatem me botën?
- C'është jeta?
- A duhet t kem sukses në jete?

Adoleshentët përpiqen tu gjejne pergjigje këtyre pyetjeve teksa përpiqen të gjejnë një vend në botën sociale (Shnajder, 2003).

Nga ana tjetër, zhvillimi i tyre kognitiv i bën më të aftë për të menduar në mënyrë abstrakte, të parashikojnë ngjarjet, të jenë në gjendje të mendojnë relativisht mirë. Megjithatë nuk u mundësohet që vetvetiu të marrin vendime të rëndësishme lidhur me qështjet sikurse janë formimi i familjes, zgjedhja e profsionit të ardhshëm (Terry, 96-97).

Studiuesja Xhailigen (C. Gilligan, 1983) e ndrrëlidhte formimin e identitetit me ndryshimet gjinore. Ajo ishte e mendimit se meshkujt e formojne identitetin e tyre si individë të vecuar, ndyshe nga femrat të cilat, me sa duket, identitetin e tyre e formojnë duke u bazuar më tepër në përgjegjësitë dhe raportet sociale sesa në marrëdhëniet individuale.

Këto diferenca gjinore në formimin e identitetit na ndihmojnë për të kuptuar më mire disa nga problemet që kanë meshkujt dhe femrat gjatë bashkëveprimit.

Depesioni është një sëmundje që afekton si trupin ashtu edhe mendjen. Në këtë gjendje një individ ndjehet i mërziur, i trishtuar, i irrituar, i pashpresë, i pandihmë, i turpëruar, tepër i lodhur, por edhe suicidal (National Institute of Mental Health [NIMH], 2007). Depresioni në adoleshencë ndodh shpesh në bashkëpunimin me çrregullime të tjera such as anxiety, disruptive behavior, eating disorders or substance abusetë tilla siç janë: çrregullimet e ankthit, çrregullimet e të ushqyerit, si dhe abuzimet me substanca. It can also lead to increased risk for suicide (NIMH, 2008). Ai gjithashtu mund të çojë në rritje të rrezikut për vetëvrasje (NIMH, 1998). Në një periudhë prej një viti 9.5 për qind të popullsisë së SHBA-ve (rreth 19 milion njerëz) vuajnë nga depresioni. Tre llojet më të zakonshme të depresionit janë: depresioni madhorë, distimia (ju thjesht nuk ndiheni të lumtur), dhe çrregullimi bipolar ose depresioni maniak (karakterizohet nga luhatje të skajshme dhe të paparashikuara të gjendjes shpirtërore). (Hobbs, 2000). Depresioni madhorë karakterizohet kur një individë provon një ose më shumë epizode të depresionit madhorë, në fëmijët dhe të rinjët një epizodë zgjatë mesatarisht nga 7 deri në 9 muaj (Birmaher et al., 1996a, 1996b), dhe ka shumë karakteristika të ngjajshme me ato të të rriturve. Fëmijët në depression mund të humbasin interesin në aktivitetet e tyre normale, ata kritikojnë veten dhe të tjerët mendojnë se kritikojnë ata, ndihen të padashur, pesimist, apo edhe pa shpresë për të ardhmen, ata mendojnë se jeta nuk është e vlefshme të jetohet, dhe mendimi vetëvrasës mund të jetë i pranishëm. Fëmijët dhe të rinjët me depression janë shpesh nervoz, dhe ky nervozizëm i tyre mund ti çojë në sjellje agresive, ata janë të pavendosur, kanë probleme në përqëndrim, munges të energjisë ose motivimit, dhe kanë gjumë të çrregulluar (DSM-IV). Një çrregullim më serioz është distimia në të cilën personi kalon një gjendje depressive shpirtërore, në pjesën më të madhe të një intervali kohorë të paktën dy vjeçare dhe kjo ka më shumë simptome kronike për shkak të natyrës saj të vazhdueshme, fillimisht distimia paraqitet në fëmijëri apo adoleshencë (Akiskal, 1983). Adoleshenti është në depression për pjesën më të madhe të ditës, në shumicën e ditëve, dhe simptomat mund të vazhdojnë për disa vjet.

Kohëzgjatja mesatare e një periudhe në fëmijët dhe të rrinjët me distimi është rreth 4 vjet (Kovacs et al.,1997a).Ndonjëher fëmijët janë në depresion për aq kohë ku ata nuk e vërejnë si disponimi i tyre ndryshon nga zakonisht dhe në këtë mënyrë mund të mos ankohen për ndjenja depresive.Shtatëdhjet për qind e fëmijëve dhe të rrinjeve me distimi kanë përvoj dhe eksperiencë epizodike të depresionit madhorë.(Kovacs et al., 1994). Kur kemi një kombinim të depresionit madhorë dhe distimisë atëherë gjendja është referuar si depresion i dyfisht.

Çrregullimi bipolar ose depresioni maniak është një gjendje shpirtërore e trazirave, në të cilën epizoda manike alternohet me epizodë të depresionit, gjendja fillon në adoleshencë.Manifestimi i parë bipolar i një sëmundjeje është zakonisht një epizodë depresive.Karakteristika e parë manike mund të mos ndodhë edhe për disa muaj apo vite më pas, ose mund të ndodhë gjatë smundjes së parë depresive ose më vonë, pas një periudhe me simptome (Strober et al., 1995).Studimet tregojnë se një në çdo kohë ndërmjet 10 dhe 15 për qind e fëmijëve dhe adoleshentëve ka disa simptome të depresionit (Smucker et al., 1986).Prevalenca e diagnostifikuar e depresionit madhorë midis të gjithë fëmijëve të moshave 9.-17. është vlerësuar në 5 për qind (Shaffer et al., 1996c).Mbizotërimi i çrregullimit të distimis në të rinjët është llogaritur rreth 3 për qind (Garrison et al., 1997)Para moshës së pjekurisë seksuale, depresioni madhorë dhe çrregullimi i distimisë janë çrregullime njësoj të përbashkëta si te djemt ashtu edhe te vajzat (Rutter , 1986).Por pas moshës 15 vjeq,depresioni është dy herë më i zakonshëm në vajza dhe gra se sa në djem dhe burra.(Wiessman & Klerman , 1977;McGee et al., 1990; Linehan et al., 1993). Mjekësia konvencionale zakonisht depresionin e trajton me antidepressant dhe psikoterapi ose një kombinim të këtyre dyjave (Weil, 2005).

Çrregullimet e ankthit janë çrregullime më të zakonshme psikiatrike në SHBA. Ato karakterizohen nga shumë simptome fizike të tilla si: djersitje të tepërt, tensioni i muskujve, mpirje , frymë të cekët.Simptomemet emocionale të çrregullimeve të ankthit ndodhin njëkohësisht me ato fizike dhe përfshijnë agitacion, ndjenjat e irealitetit, ndjenjat dënimit të pashmangshëm, nervozizëm dhe drojë.Çrregullimet e ankthit klasifikohen në kategoritë e ndryshme si të tilla janë : çrregullimet e ankthit të ndarjes, çrregullimet e ankthit të përgjithësuar, çrregullim i ngulët-maniakal , çrregullimet e panikut, stresi postraumatik dhe çrregullimet e ankthit social /fobit. (Prousky, 2005). Prevalenca e grupit të çrregullimeve e njohur si çrregullim i ankthit e kombinuar me çrregullime tjera mendore në fëmijëri dhe adoleshencë është ajo me e lartë pothuajse në të gjitha vendet (Costello et al., 1996).Ankthi i ndarjes është shpesh i lidhur me simptomemet e depresionit, si : pikëllimi, tërheqja, vështërsi në përqëndrim, dhe fëmijët e tillë shpesh kanë frikë se ata ose një antarë i familjes mund të vdes.Rreth 4 për qind e fëmijëve dhe të rinjëve vuajnë nga çrregullimi i ankthit të ndarjes (DSM-IV).

Ky çrregullim mund të zhvillohet pas një stresi si vdekje ose sëmundje në famije, trauma sidomos fizike apo sulme seksuale të cilat në një masë mund të sjellin në rrëmujë.

Fëmijët me çrregullime të ankthit të përgjithësuar shqetësohen tepër në lidhje me mënyrën e të gjitha ngjarjeve të ardhshme që do të ndodhin, ata shqetësohen tepër lidhur me ecurinë e tyre akademike ose aktivitetet sportive duke u bazuar në kohë ose edhe në lidhje me fatëkeqësitë natyrore si tërmetet.Ata kanë tendencë për të kërkuar miratim dhe kanë nevojë për pohim të ecurisë së vazhdueshme të frikës së tyre.(DSM-

IV). Fëmijët me fobi sociale (gjithashtu i quajtur çrregullim i ankthit shoqërorë) kanë një frikë dhe janë të sikletosur në situata sociale, gjatë një shfaqje, ose në qoftë se ata duhet të flasin në klasë ose vende publike, të marrë në bisedë me të tjerët, të hanë, të pijnë, ose të shkruajnë në publik. Adolehentët dhe të rriturit janë në gjendje të njohin se frika e tyre është e tepruar apo e paarsyeshme, edhe pse kjo nuk e ndalon njohjen e frikës, frika e tyre mund të zgjasë për disa javë dhe ndërhyjnë në jetën e përditshme rutinore, sociale, punë apo shkollë. Ata mund ta kenë të pamundur për të folur në situata sociale ose në prani të njerëzve të panjohur. Fobia sociale është e zakonshme dhe mbizotërimi që fillon nga 3 deri në 13 për qind në varësi të madhe është se si frika në situata të ndryshme të sjell shqetësim (DSM-IV; Black et al., 1997). Në disa studime, shumica e atyre me çrregullime të ankthit u zbuluan se ishin femra (DSM-IV). Adolehentët janë të prekshëm nga presioni i shoqërimit nga gjinia për shkak se janë në procesin e zhvillimit të identifikimit të rolit gjinorë, në këtë kontekst vajzat bëhen më të prirura të kenë simptoma depresive se djemtë. Nolen-Hoeksema and Girgus (1994) presented sex role attributes that are related to gender differences in depression. Nolen-Hoeksema and Girgus (1994). Roli i diferencave gjinore është reflektuar në dobësi të nën llojeve të depresionit (Blatt, Hart, Quinlan, Leadbeater, & Auerbach, 1993; Leadbeater, Blatt, & Quinlan, 1995). Lloji i depresionit interpersonal është më e shpeshtë për vajzat sesa për djemtë, dhe karakterizohet nga frika e braktisjes nga të tjerët, preokupimi për ndjenjat e vetëvlerësimit dhe humbjen e kompetencave. Në këto studime një frekuencë më të lartë të çrregullimeve u gjet në vajza. Deri më sot disa studime kanë treguar marrëdhënjet në mes të zhvillimit të depresionit dhe roleve gjinore në adolehencë. Në një mostër nxënës të klasave 9 deri në 12, Allgood-Merten dhe Lewinsohn (1990) kanë gjetur një rezultat të ulët mbi atributet mashkullore konsiderohet të jetë një masë e vetë-efikasitetit i lidhur me ndjenja depresive për të dy gjinitë djemëve dhe vajzave, është interesante pasi që atributet për kontrollin femrorë ka pas ende dallime gjinore në ndjenjat depresive mes adolehentëve në këtë studim.¹

Procedura e Hulumtimit

Pas përpilimit të pyetësorit, dhe pas përzgjedhjes së subjekteve, ato janë plotësuar nga adolehentët e shkollave të mesme në Prizren, në mënyrë të rastësishme, pyetësori është aplikuar në nxënës të klasave të 8, 9, 10, 11, dhe 12, në Prizren, fillimisht i'u janë ofruar udhëzimet përkatëse dhe në rast paqartësie çdo nxënës i'u është ofruar ndihmë, kohëzgjatja e plotësimit të pyetësorit nga ana e adolehentëve ka zgjatë rreth 25 minuta, dhe pasi janë kompletu pyetësorët, më pas të dhënat nga pyetësorët janë koduar ashtu që të mund të bëhen analizat sistematike të informatave në databazë SPSS (Statistical Package for Social Sciences) 12.0.

Matja e simptomave depresive, është bërë nëpërmjet Qendrës Epidemiologjike të Studimit të Shkallës së Depresionit (CES-D) e cila është përdorur për të vlerësuar gjendjen depresive (Radloff, 1977). CES-D është shkallë njëdimensionale, që nuk është dizajnuar për të diagnostifikuar depresionin klinik, por më shumë të vlerësojë nivelin e simptomave të depresionit. Ai mund të përdoret në mënyrë valide si instrument matës i gjendjes depresive dhe vuajtjet emocionale tek adolehentët dhe si një hap i parë efikas dhe efektiv në mostrat më të mëdha të popullsisë, siç është popullsia në

¹ DSM-IV. See American Psychiatric Association (1994).

shkolla.

Mjet matës është përdorë pyetësori me pyetje të mbyllura ku, subjektet janë përgjigjur në pyetje në atë mënyrë që ata kanë pasur opzione të përgjigjeve me alternativë (1-4), gjithsej kanë qenë 25 pyetje prej të cilave 7-pyetje kanë qenë për matjen e prezencës së depresionit si (*Unë ndihem i gëzuar dhe në qejf*), dhe çdo përgjigje që është dhënë nga ana e repondentëve ka pasur këto rezultate: 1-shumë shpesh, 2-nganjëher, 3-rrallë, 4-shumë rallë, ku rezultati më i ulët ka tregu nivele më të larta të depresionit. Kurse 7 pyetje të tjera kanë qenë për matjen e prezencës së ankthit si (*Mua më kaplon një ndjenjë e frikës, sikur do të më ndodhë diçka e tmerrshme*) dhe çdo përgjigje që është dhënë nga ana e repondentëve ka pasur këto rezultate : 1-asnjëher, 2-herëpashere, 3-shpesh, 4-gati gjithmonë, ku rezultati më i lartë ka tregu nivele më të larta të ankthit.

Analizat Statistikore

Rezultatet e fituara në studim do të analizohen, ku do të përdoren parametrat statistikore, të vlerave mesatare dhe vlerave deskriptive, siç janë mesatarja (M), devijimi standard (Ds), signifikanca (p), dhe ti testi (t).

Përshkrimi i mostrës

Përzgjedhja e mostrës

Mostra është zgjedhur pa ndonjë mostrim të caktuar. Kushti ka qenë që nxënësit të jetë në klasën e 8, 9, 10, 11 dhe 12. Pra mostrimi ka qenë mostrim komod (convenience sampling).

Karakteristikat e mostrës së përfshirë në hulumtim

Mostra përbëhet prej n=34 rasteve prej të cilëve 47.1% (n=16) të respondentëve kanë qenë meshkuj dhe 52.9% (n=18) kanë qenë femra, (shih tabelën 1.0 për distribuimin e gjinisë në përqindje).

Tab.1.0

Gjinia				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid mashkull	16	47.1	47.1	47.1
femer	18	52.9	52.9	100.0
Total	34	100.0	100.0	

Sa i perket vendbanimit siç po shifet edhe në tabelën 1.1 të gjithë respondentët e përfshirë në këtë hulumtim banonin në qytet.

Tab.1.1

Vendbanimi				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid qytet	34	100.0	100.0	100.0

Sa i perket suksesit të adoleshentëve nga klasa e tetë (8) gjerë në klasën e nëntë nga mesatarja e sukseseve për çdo klasë veq e veq femrat kanë treguar sukses më të lartë,

shih tabelën1.2 në vijim.

Tab.1.2

	Gjinia	N	Mean	Std. Deviation
Suksesi8	mashkull	16	4.3750	.61914
	femer	18	4.7222	.46089
Suksesi9	mashkull	16	3.7500	1.61245
	femer	18	3.9444	1.86207
Suksesi10	mashkull	16	3.1875	1.75950
	femer	18	3.9444	1.86207
Suksesi11	mashkull	16	3.0625	1.69189
	femer	18	3.6667	2.05798
Suksesi12	mashkull	16	2.0625	1.98221
	femer	18	1.5000	2.20294

Viti i lindjes

Viti i lindjes				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid 1991	1	2.9	2.9	2.9
1992	2	5.9	5.9	8.8
1993	8	23.5	23.5	32.4
1994	12	35.3	35.3	67.6
1995	5	14.7	14.7	82.4
1997	3	8.8	8.8	91.2
1998	3	8.8	8.8	100.0
Total	34	100.0	100.0	

Niveli arsimor i baballarëve

Arsimi baba				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid shkollen filllore	1	2.9	2.9	2.9
shkollen e mesme	13	38.2	38.2	41.2
shkollen e larte	14	41.2	41.2	82.4
universitetin	6	17.6	17.6	100.0
Total	34	100.0	100.0	

Niveli arsimor i nënave

Arsimi nena				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid nuk eshte shkolluar fare	1	2.9	2.9	2.9
shkollen filllore	6	17.6	17.6	20.6
shkollen e mesme	12	35.3	35.3	55.9
shkollen e larte	10	29.4	29.4	85.3
universitetin	5	14.7	14.7	100.0
Total	34	100.0	100.0	

Në pyetjen se a punoni adoleshentët janë përgjigjur si në vijim.

A punoni				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid jo	20	58.8	58.8	58.8
po	14	41.2	41.2	100.0
Total	34	100.0	100.0	

Rezultatet

Gjinia		N	Mean	Std. Deviation
depresionitotal	mashkull	16	12.5000	3.26599
	femer	18	11.8333	3.16692

Gjinia		N	Mean	Std. Deviation
Ankthitotal	mashkull	16	15.0000	4.57530
	femer	18	15.3889	3.27448

Descriptive Statistics

Gjinia		Mean	Std. Deviation	N
mashkull	depresionitotal	12.5000	3.26599	16
	suksesitotal	16.4375	5.95504	16
femer	depresionitotal	11.8333	3.16692	18
	suksesitotal	17.7778	6.64703	18

Descriptive Statistics

Gjinia		Mean	Std. Deviation	N
mashkull	Ankthitotal	15.0000	4.57530	16
	suksesitotal	16.4375	5.95504	16
femer	Ankthitotal	15.3889	3.27448	18
	suksesitotal	17.7778	6.64703	18

Diskutim

Rezultatet e fituara nga ky hulumtim të cilat janë zhvilluar në bazë të dy hipotezave kryesore (1) *Dallimet gjinore tek adoleshentët me depresio dhe ankth*, nga rezultatet e lartëshënuara për sa i përket dallimeve gjinore mes adoleshentëve të shkollave të mesme edhe pse femrat kanë treguar pikë më të ulëta të depresionit, është vërejt se nuk ka pasur dallime signifikante sa i përket depresionit në mes të meshkujve dhe femrave. *Dallimet gjinore tek adoleshentët me ankth*, sa i përket ankthit edhe përkundër asaj që femrat kanë rezultu me pikë më të lartë të ankthit, sipas krahasimit të mesatareve gjegjësisht analizimit të t-testit nuk ka pas dallime signifikante.

(2) *Suksesi dhe ndërlidhja me depresionin*, sa i përket ndërlidhjes së suksesit me depresionin tek femrat ka rezultu me keshtu pike te ulta te depresionit me nje mesatare me te larte te suksesit

Sukesi dhe ndërlidhja me ankthin. Ndërlidhja e suksesit me ankthin te femrat ka rezultu me pika te larta të ankthit por edhe me mesatare te lartë të suksesit ku meshkujt kanë tregu pika më të ultë të ankthit por edhe me një mesatare më të ulët të suksesit të tyre.



Konkludim




Një nga objektivat e këtij hulumtimi ishte krahasimi gjinorë mes adoleshentëve me depresion dhe ankth edhe pse rezultatet tona nuk kanë qenë signifikante mund të themi se ka pas dallime qofshin ato të mëdha apo të vogla, edhe nga shfletimi i literaturës në hulumtime të shumta zakonisht femrat kanë rezultu me pikë më të larta të simptomeve të depresionit dhe ankthit, në hulumtimin tonë rezultoj me pikë më të lartë të nivelit të depresionit në favor të meshkujve. Në bazë të rezultateve të arritura është pare një nivel i lidhshmërisë në mes të pikëve të depresionit, ankthit dhe suksesit edhe pse nuk kemi hasur në rezultate signifikante megjithatë mund të konkludojmë se suksemi ka ndërlidhje me nivelin e simptomave te ankthit dhe të depresionit.




Rekomandimet

Çdo hulumtim i ardhshëm në këtë drejtim do të ishte mjaftë i nevojshëm dhe do ta pasuronte literaturën e gjuhës shqipe. Hulumtimi në fjalë ka qenë i fokusuar vetëm në adoleshentë, prandaj do të ishte mjaftë e nevojshme të studiohet edhe në popullacione dhe grupmosha te ndryshme.

Aneks







Group Statistics

	Gjinia	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Suksesi8	mashkull	16	4.3750	.61914	.15478
	femer	18	4.7222	.46089	.10863
Suksesi9	mashkull	16	3.7500	1.61245	.40311
	femer	18	3.9444	1.86207	.43890
Suksesi10	mashkull	16	3.1875	1.75950	.43987
	femer	18	3.9444	1.86207	.43890
Suksesi11	mashkull	16	3.0625	1.69189	.42297
	femer	18	3.6667	2.05798	.48507
Suksesi12	mashkull	16	2.0625	1.98221	.49555
	femer	18	1.5000	2.20294	.51924

Referencat

1. Boeree, G. (2004). Teorite e personalitetit. Tirane: Plejad.
2. Brooks – Gunn, J., & Perterson, A. C. (1983). Girls at puberty: Biological and psychosocial perspectives. New York: Plenum Press.
3. Conger, J., & Peterson, A. (1984). Adolescence and youth. New York: Harper & Row.
4. Dragoti, E. (1994). Adoleshenti. Tirane: Hipokrati.
5. Erikson, E. H. (1963). Childhood and society. New York: Norton.
6. Hall, G. S. (1916). Adolescence. New York: Appleton.
7. Juniku, N. (1994). Kaptina nga psikologjia. Shkup: Asdreni.
8. Lala, H. S. (2010). Fjalori I psikologjise. Tirane: Albas.
9. Lulzim Murtezani, Psikologjia e zhvillimit-Cabej, Tetovë 2006.
10. Silvia Shnajder-“C’po ndodh me mua”(liber per vajzat), Albas, Tiranë, 2003.
11. Terry f. Petijohn “Psikologjia nje hyrje koncize” fq 96-97.
12. Weil, Andrew, “Six Supplements for Treating Depression” *Self Healing*, Feb. 2005 p. 4-5.
13. Prousky, Jonathan E., ND, “Orthomolecular Treatment of Anxiety Disorders”, *Townsend Letter for Doctors & Patients*, Feb/Mar 2005, #259/260;82-87.
14. Costello, E. J., Angold, A., Burns, B. J., Stangl, D. K., Tweed, D. L., Erkanli, A., & Worthman, C. M. (1996). The Great Smoky Mountains Study of Youth. Goals, design, methods, and the prevalence of DSM-III-R disorders. *Archives of General Psychiatry*, 53, 1129–1136.
15. DSM-IV. See American Psychiatric Association (1994).

Të Ardhurat Vendore dhe Autonomia Fiskale Rasti i Shqipërisë

Fatlum Nurja PhD

*Decentralization & Local Governance Expert
Planning and Local Governance Project (PLGP) in Albania*

Abstrakt

Në fillim të dekadës së fundit të shekullit të XX-të (viti 1992), pasi u realizuan zgjedhjet e para demokratike dhe të lira, i gjithë sistemi ndryshoi dhe njëkohësisht së bashku me ndryshimet e tjera erdhën edhe ndryshime në ndarjen e administrative dhe territoriale të vendit si dhe në organet e qeverisjes vendore.

Shqipëria ka bërë hapa të dukshëm në reformat e decentralizimit të qeverisjes vendore, në transferimin e funksioneve nga qeveria qendrore.

Tema më e debatueshme sa i përket reformave decentralizuese ka qenë ajo e decentralizimit të financave të cilat herë pas here nuk kanë ndjekur funksionet që transferoheshin nga qeverisja qendrore drejt asaj vendore duke i prezantuar mandatet vendore si të pa financuara.

Përveç kësaj, problem ka qenë dhe fuqia vendimmarrëse në lidhje me financat nga ana e strukturave vendore apo thënë më sakte Autonomi fiskale. Pavarësisht përpjekjeve për të rritur financat vendore në vitet e fundit, koeficienti i autonomisë fiskale është në nivelin 70% (2015). Rritja e financave vendore është bërë nëpërmjet rritjes së transfertave të kushtëzuara apo granteve konkurruese për të cilat njësitë vendore nuk kanë fuqi vendimmarrëse e për pasojë koeficienti i Autonomisë fiskale ka pësuar ulje.

Fjalë kyçe: Decentralizim, Autonomi fiskale, Të ardhura vendore.

Parashtrësë

Në këtë punim vëmendje i është kushtuar analizës krahasuese e të ardhurave vendore ndër vite si dhe një krahasim me vendet e Evropës juglindore. Me tej në punim bëhet një analizë të elementëve përbërës të financave vendore dhe kryesisht të transfertave ndërqeveritare duke u ndalur dhe analizuar shkaqet, arsyet dhe ndikimeve në funksionimin e qeverisjes vendore.

Po kështu, pavarësisht analizës sasiore të treguesve të financave vendore objektivi i punimit është ballafaqimi i këtyre treguesve me treguesit e Autonomisë fiskale si një tregues i cili prezanton "cilësinë" e këtyre financave nga këndvështrimi i Autonomisë Vendore.

"Konteksti institucional i decentralizimit fiskal nënkupton mbi të gjitha zhvillim ekonomik, natyrën e sistemit ligjor, procesin e vazhdueshëm të reformave ekonomike dhe politike, organizimin e institucioneve monetare dhe financiare, dhe tensionet që dalin nga dallimet etnike, fetare, apo ekonomike" (Wildasin, D. 1997), gjithashtu "Decentralizimi fiskal, pra caktimi i funksioneve shpenzuese dhe burimeve e të ardhurave ka një ndikim të dukshëm për qeverisjen dhe cilësinë e qeverisjes" (Humphlick, Frannie & Antonio Estache. 1995).

Këto përcaktime tregojnë qartë rëndësinë që ka decentralizimi fiskal në konsolidimin e autonomisë vendore në përgjithësi dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik vendor

në veçanti.

Pas rënies së regjimeve totalitare, vendet e Evropës Lindore, kanë patur programe dhe kanë adaptuar strategji për të zbatuar programe decentralizuese në mënyre për t'i dhënë kompetenca më të gjera qeverisjes vendore duke respektuar parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, atë të ndërtimit të saj në bazë të parimit të decentralizimit dhe të ushtrimit të qeverisjes në bazë të parimit të autonomisë vendore.¹

Është e natyrshme që në lidhje me këtë temë përveç parimeve të përgjithshme dhe bazat teorike ku mbështetet decentralizimi fiskal me interes të një analize krahasuese është edhe të preken qasje të nivelit të raporteve fiskale dhe financiare të qeveris qendrore me atë vendore, ose analiza e transfertave qeveritare.

Decentralizimin fiskal

Pavarësisht qartësisht dhe përcaktimit të koncepteve të mësipërme që përvijojnë decentralizimin politik dhe atë administrativ, është shumë domethënëse vëmendja që i është kushtuar përshkrimit të konceptit të decentralizimit fiskal dhe financiar. Decentralizimi fiskal lidhet para së gjithash me krijimin e mundësive, për financimin e funksioneve të mbështetura apo të ashtuquajtura "subsidy" apo të subvencionuara. "...Vendosja e menaxhimit financiar efektiv dhe transparent është në thelbin e çdo përpjekjeje për të reformuar sektorin publik.. Qenia përkrahës i vërtetë i procesit të decentralizimit, duhet të bësh që karakteristikat themelore të një sistemi për menaxhimin e decentralizuar financiar të përfshijnë: **(a)** transparencën e dhënies së fondeve **(b)** shumave e fondeve në dispozicion të institucioneve vendore të jete të parashikueshme dhe **(c)** autonomi vendore të vendimmarrjes në shfrytëzimin e burimeve. (DDSMS, PNUD, 1996:p.48)

Pra, decentralizimi fiskal, na kërkon jo vetëm transferim burimesh financiare dhe autoritet fiskal tek njësitë vendore, por kërkon që burimet duhet të jenë të parashikueshme në mënyrë që të bëjnë të mundur një proces planifikimi. Po kështu kërkon që shpenzimet të jenë transparente dhe të bëhen në mënyrë autonome.

Duke përdorur definicionin e autonomisë si një kombinim të fuqisë për nisma dhe një imuniteti për kontrolle nga lart (Clarc, G.L.A. 1984: p195-208), ne mund të shikojmë më thellë, brenda kushteve për zhvillim vendor dhe vlerësimin të shkallës, se cilat reforma decentralizuese janë drejtuar nga ose përçarur tek zhvillimi ekonomik vendor si një funksion i veti i Vetëqeverisjes vendore.

Politikat dhe parimet e Bashkimit Evropian, në lidhje me subsidiaritetin, harmonizimin fiskal dhe kontrollet e stabilizuara gjithashtu kanë demonstruar efekte në politikat e ekonomive në zhvillim dhe në ndryshim. (Shah, A. 2004)

Por, qeveritë qendrore nuk kanë qenë të interesuara të heqin dorë nga funksionet e tyre dhe t'i decentralizojnë ato për t'i dhënë më shumë kompetencë dhe resurse qeverisjes vendore dhe ky është edhe një nga paradokset që i ndodh procesit në çuarjen përpara të reformave decentralizuese dhe se ato janë të nxitura më shumë nga sipër se sa duhej të ishin të nxitura nga poshtë. (Boussuyt, J. & Goulld, J. 2000). Por kjo është më se e kuptueshme në vendet postkomuniste, si rezultat i një trashëgimie të fortë centriste.

<> Këto dy parime janë vendosur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Nenin 13.

Kuadri Ligjor për Decentralizimin Fiskal ne Shqipëri

Temat e konsolidimit financiar të qeverisjes vendore kanë qenë shpesh pjesë e debateve politike mes krahëve të ndryshëm të saj ose e debateve mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Gjithsesi kuadri ligjor për burimet financiare të qeverisjes vendore ka ndjekur në vija të përgjithshme kuadrin ligjor bazë që është hartuar dhe miratuar gjatë dekadës së fundit dhe që përcaktonte transferimin e kompetencave dhe funksioneve tek njësitë vendore.²

Pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim, shpesh nga raportet e institucioneve ndërkombëtare qeverisja vendore është quajtur historikisht e pa financiar.

“Sa e vështirë është për të matur nevojat për shpenzimeve te qeverisjes Lokale, aq është mjaft e qartë se NjQV-të shqiptare janë te keq financuara.” (USAID/PLGP, 2015) Një sërë ligjesh e përkufizojnë dhe e përcaktojnë këtë panoramë gri. Këto ligje fillojnë me implementimin e strategjisë se pare te decentralizimit te adaptuar ne 1999 dhe vazhdojnë deri tani ku aktualisht ndodhet ne Parlament Ligji “ Për financat e Vetëqeverisjes vendore” një ligj që vjen për herë të parë në ambientin e financave vendore në Shqipëri. Pa i hyre kësaj analize ligjore, kuadri ligjor ka qene pothuaj adekuat por implementimi, apo delegimi i kompetencave si dhe ndjekja ne dinamike te funksioneve me financa ka qenë një e metë e kësaj reforme, kjo e krahasuar dhe me vendet e tjera te Evropës Juglindore (Figura 4).

Të ardhurat e Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Të ardhurat vendore në Shqipëri përbëhen kryesisht nga i) të ardhurat e veta; ii) transfertat ndërqeveritare që ndahen në ii/a) Granti i Pakushtëzuar dhe ii/b) Granti i Kushtëzuar, iii) huamarrja vendore; iv) donacionet dhe te ardhura te tjera te parashikuara me ligj. (Ligji No.139/2015)

Në Figurën 1, paraqitet struktura e të ardhurave vendore. Në këtë figurë dallohet qartë që këto të ardhura kanë ardhur duke u rritur në mënyrë pothuajse konstante që nga viti 2002 vit që fillon dhe monitorimi i indikatorëve te decentralizimit fiskal dhe raportimi i tyre. Ato kanë qenë më të larta në vitin 2009 dhe më pas ka filluar rënia e tyre. Kjo situatë ka vazhduar në vitin 2013, dhe më pas në vitin 2014 kemi rritjen e tyre në mënyrë të dukshme duke e kaluar me 1 miliard lek vitin 2009. Në këtë vit (2014) të ardhurat e veta kanë qenë 14,6 miliard lek³, Granti i pakushtëzuar 12,47 dhe Granti i kushtëzuar 5,57 miliardë lek.⁴

Me pas, ne vitin 2015 kemi serish rritje e të ardhurave vendore deri në masën 40 Miliard lek.


Figura 1: Përbërja bazë e të ardhurave vendore (me qarqe) në miliardë lekë (2002-2015)

² Ne vitin 2012, u bë një analize e thelle e decentralizimit fiskal dhe u dhanë një serë konkluzioneve ne ketë Dokument politikash “Decentralizimi Fiskal në Shqipëri” . Në këtë dokument, jepen rekomandime ku një pjese e tyre janë miratuar nga ligjvënësit dhe qeveria.

³ 140 Lek = 1 EURO


⁴ Të dhënat e Ministrisë së Financave në bazë të raportimeve në web.

Burimi: PLGP/USAID



Ajo që vihet re është që, vitet e fundit kemi një tendencë në rritje të financimeve të qeverisjes vendore në total (pas vitit 2013), e cila ka ardhur kryesisht nga rritja e Grantit të Kushtëzuar, ose te Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR). Fondi i zhvillimit te rajoneve është transferte ndërqeveritare, një grant konkurrues që administrohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve. Paraqitja e kësaj shtate në % të tipit të financimeve në raport me totalin jepet në grafikun më poshtë (Figura 2). Granti konkurrues, si një transferte e kushtëzuar futet në skemën e financimit te qeverisjes vendore në vitin 2006, duke filluar edhe rrudhjen e Autonomisë fiskale ne % paçka se rriten në vlerë absolute të ardhurat vendore.


Figura.2: Përbërja bazë e të ardhurave vendore (me qarqe) në % (2002-2015)



Burimi: PLGP/USAID

Një situatë e tillë pavarësisht se në vlerë absolute prezanton rritje e të ardhurat vendore relativisht cenon shkallën e autonomisë fiskale. Pavarësisht kësaj rritje në vlerë absolute e të ardhurave vendore nder vite, ato nuk kanë pësuar rritje ne raport me PBB (Figura 3)

Figura 3. TE ardhurat e Qeverisjes Vendore ne Shqipëri si % e PBB dhe e të ardhurave te përgjithshme publike 2002-2015.



Burimi: NALAS 2016, PLGP/USAID


necessarily enables development and virtual visit to every gallery, museum and studio of any popular artists. Also new trends of conceptualism already opened the contours of every creative mind to work without being judged how he works and what he does with his individual creative abilities. Kosovo in this point of conceptualism developed with huge steps from the beginning of the new millennium, in which we are living now. I have the impression that the emergence of the term "conceptual art" for its makers, opened a vast artistic universe because now everything is considered possible. I recall the opening of the exhibition some years after the last war of Kosovo. The exhibition was entitled "Sexpozita" in the full sense it was well received and with no prejudices, moreover it triggered a great curiosity to see what was presented there, and more interestingly was the fact that how would the public react when it sees these works which mainly showed human bodies, different and very sensitive female postures, sometimes positioned in the center of the dart board. And thus, in fact, happened the opening of enlightened minds in the sense of prejudices which existed throughout Albanian minds of all of our national territories, but this enlightenment, if we can call it "New millennium, new way of thinking", unfortunately isn't accepted by some deep rural families who are still contoured by the tradition of canon.

References

- "Women in Art", Shareholder.com Retrieved October 2014.
- Figurative Art Gallery, "Abdurrahim Buza, piktori i popullit, i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" (Abdurrahim Buza, peoples painter, of Peoples Socialist Republic of Albania), Tiranë, 1980.
- Ferid Hudhri: Fine Arts. In: Genc Myftiu (Hrsg): Guide of Albanian History and Cultural Heritage, Sustainable Economic Development Agency, Tirana 2000, S. 97f.
- Çabej, Brikena. "Piktura Italiane, Mjeshtrit dhe kryeveprat e gjithë kohërave" (Italian painting, masters and masterpieces of all time), translated book, year 1998.
- Performing Body, artist Abramović, authors Abramović, Dobrila Denegri (Charta, 1998) [ISBN 978-88-8158-160-3](#).
- Willard, Charlotte, "Artistë të Famshëm Modernë" (Modern Famous Artists), 2007.
- Katalog "Dita e Prishtinës", June exhibition, 11 June 2002.
- Katalog " Femra Krijuese/ Creative Women/", Colective exhibition, Art Gallery of Gjilan, March, 2005.
- Balkan Erotic Epic, as producer and director, [Destricted](#) (Offhollywood Digital, 2006).
- Catalogue "Sekspozita", New Balkans Presents, Prohelvetia.
- Kujtim Buza, "Ime mëmë, modelja e parë shqiptare nudo" (My mum, first Albanian nude model), published in Panorama, 2013.
- Balkan Epic, (Skira, 2006).
- Artist Lisa Levy mocks pretentiousness by sitting naked on a toilet at a Brooklyn gallery, by Christopher Moore, New York daily news, January 2006.

Muzika pianistike pas viteve 90'

Ana Kaçinari

Universiteti i Arteve, Tiranë

Pas viteve 90' proceset transformuese përfshinë sigurisht edhe artin muzikor e së bashku me të edhe muzikën pianistike. Së pari ndryshoi qëndrimi estetik mbi vetë artin muzikor, ndryshoi statusi i kompozitorit në raport me lirinë krijuese, me publikun dhe me përfitimet ekonomike. Konkretisht, muzikantët filluan të ndjenin nevojën për grupime në Shoqata që do të organizonin shfaqjen e krijimtarisë së tyre dhe do të krijonin risorse të ardhurash.

Studiuesi As. Prof Nestor Kraja shkruan kështu në librin e tij për këto fillime: *Fillimi i viteve '90, i mbarsur me ngjarje historike radikale poliedrike, përbën në zhvillimin e historisë së krijimtarisë muzikore një lloj kufiri, për mbylljen e një epike rritjeje të ndrydhur dhe njëkohësisht fillimin e zhvillimeve të lira muzikore.*

Ky ndryshim i madh, me shpejtësinë që ndoqën ngjarjet politike nuk mundej të mos mpinte, të paktën për një moment, zhvillimet muzikore shqiptare. Dhe ishte e natyrshme stepja: ndryshimet hapësinore tridimensionale kërkonin një startim të ri, një moment përqëndrimi për të hyrë në udhët e reja, që edhe vetë ato të stepnin me shumllojshmërinë e tyre. Kur kujtoj atë periudhë, nuk di pse menjëherë më shkon mendja tek vepra "Agorofobia " e Sokol Shupos, së cilës mjafton kjo e vërtetë e madhe për ti dhënë vlerë.

Një nga momentet kryesore historike të fillimit të viteve 90' është krijimi i fondacionit "The Albanian Musicians Trust" më 1991, dhe koncertet me veprat më të mira të konkursit të krijimtarisë, organizuar nga ky Fondacion të kryesuar nga June Emerson dhe Ledi Caroline Legare në bashkëpunim të ngushtë me kompozitorin Feim Ibrahim.

Duke komentuar këtë koncert N. Kraja shkruan:

Në koncert ravijëzohen dy tendanca krijuese: tradicionale dhe novatore. Artistët e drejtimit të parë, shumica e të cilëve kanë meritën e hedhjes së bazave dhe fizionomisë së muzikës sonë kambëtare, hezitonin në pritje të drejtimeve të reja të pashmangshme muzikore, të përfaqësuara nga të dytët, të cilët kërkonin me çdo mjet të arrinin kohën e humbur.

Ky proces reflektohet nga tendenca për eksperimentim muzikor por akoma në përgjithësi i pa bazuar mbi njohjen e plotë teorike të problemeve, por që sidoqoftë ravijëzon një rrugë të vrullshme drejt tyre.⁴

Në janar të vitit 1994 u krijua "Shoqatës së Muzikës së Re Shqiptare" e cila përmbodhi në gjirin e saj instrumentistët dhe kompozitorët më të njohur të vendit.

Në Maj të vitit 1994 Shoqata "Muzika e Re Shqiptare" organizon Festivalin e parë Kombëtar të Krijimtarisë së re me pjesmarrjen e forcave më të mira të vëndit në gjinitë e muzikës instrumentale, ku u ekzekutuan dhe vepra pianistike,

Po atë vit kompozitori Sokol Shupo organizon me shoqatën e tij si Seksioni Shqiptar i ISCM Festivalin "Ditët e Muzikës së Re '94", i cili megjithëse ishte konceptuar si ballafaqim i kulturave Evropiane, kishte në vetvehte edhe një natë me muzikë të krijësve shqiptarë. Këto dy Shoqata udhëhoqën për më shumë se një dekadë jetën artistike moderne në vend duke u shndërruar në propaganduesit më të mirë të muzikës së shekullit dhe njëkohësisht dhe të kompozitorëve e instrumentistëve

shqiptarë.

Duke u kthyer pak në kohë kujtojmë se historia e muzikës pianistike shqiptare, megjithëse i gjen fillesat e saj në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe gjatë periudhës së Mbretit Zog, u zhvillua në gjerësi dhe në thellësi pikërisht pas vitit 1944, pra pas Çlirimit të vendit.

Ato pak vepra të para Luftës së dytë Botërore jo vetëm që nuk hynë në jetën koncertale të varfër të Shqipërisë, por nuk mundën të shndërrohen në shfrytëzim të traditës muzikore pianistike në Shqipëri. Ato ishin shprehje e kërkesave të para për afrim me kulturën e madhe muzikore të kontinentit, ishin tentativa që mbartinin ngjyrimet imitative, por që padyshim puna e tyre duhet të konsiderohet si kontribut për bazat e para të një literature edhe pianistike në vendin tonë.

Ndërkaq, pas Luftës kërkesat dhe kushtet kishin vënë për zgjidhje ndërtimin e një kulture të vërtetë kombëtare muzikore, në frymën dhe në rrugën e kombeve të tjerë kryesisht të Evropës Lindore. Duke dashur të analizojmë karakteristikat e kësaj lëvizjeje me drejtim për nga zhvillimet e vërteta muzikore duhet të themi se përgatitja e një numri të vogël artistësh me potencial krijues nëpër shkollat perëndimore, të cilët nisën të krijojnë për këtë instrument i lidhi fillimet tona pianistike me disa veçori stilistike të caktuara.

Tonin Guraziu dhe Ramadan Sokoli, që janë të parët në krijimin e miniaturave pianistike në historinë e muzikës shqiptare u shkolluan në Itali, duke marrë sigurisht eksperiencën më të mirë të muzikës së kohës, që lëvrohej në këtë vend me tradita të pasura. I pari nga ata, me tendencat e tij shopeniane, apo me dashurinë për Debussynë, i dyti me kërkesën e rëndësishme për afrim me karakteristikat melo-harmonike të muzikës folklorike konturuan dhe ngjyrimet e para të muzikës pianistike të asaj kohe.

Këto ishin fillesat e muzikës sonë pianistike, por ajo u zhvillua vit pas viti e dekadë pas dekada në forma gjithnjë e më të larmishme e komplekse, në ngjyrimet stilistike të ndryshme, në zhvillime të caktuara të teknikës si dhe në të gjitha mjetet shprehëse muzikore.

Pra, Historia e Muzikës sonë ka vënë një kufi ndarës, ose më mirë njeh një valë të re zhvilluese në fundin e viteve 60. Sigurisht, duke gjykuar mbi zhvillimin e muzikës koncertale pianistike kjo është e saktë, por muzika pianistike nuk filloi me Koncertin instrumental (Çesk Zadeja 1968), por me forma më të vogla pianistike si miniaturat e Harapit, Larës, Zadesë, Ibrahimit, etj. Rapsodinë e Harapit e shumë të tjera. Nga ana tjetër vitet 90' nuk ishin vetëm vitet e hapjes së një epoke të re demokratike, por ishin edhe vitet e kontakteve të reja intensive dhe të frutshme me kulturën e madhe Evropiane. Ky bazament i ri social, politik, informativ, komunikativ, sigurisht do të sillte, siç solli, risi të rëndësishme edhe në zhvillimin e muzikës pianistike në vendin tonë. Këto dy kufij, të cilët përcaktohen nga kërkesat në përmbajtje por edhe në formë të artit tonë muzikor në përgjithësi dhe të muzikës pianistike në veçanti përcaktojnë dhe tri etapat kryesore të zhvillimit të muzikës pianistike shqiptare.

Zhvillimi i muzikës pianistike në vendin tonë u realizua përmes kontributit të një grupi të madh krijuesish, me përgatitje e qëndrime estetike individuale, me aftësi dhe axhilitet të ndryshëm krijues. Ky zhvillim u realizua përmes debateve e situatave të vështira politike që kalonte vendi. Erërat e kërkesave të reja, që sillnin zakonisht Pleniumet e Komitetit Qendror, qoftë për lidhje me kulturën e vendeve të lindjes,

qoftë për afrimin e muzikës me atë të popullit, apo të masivizimit të saj, qoftë për tablotë ku të pasqyroheshin hovet rinore, qoftë për forcimin e luftës së klasave mund të konsiderohen tallazet në të cilat u farkëtua muzika jonë më e mirë.

Në këtë atmosferë u krijuan, u botuan dhe u luajtën nëpër koncerte të niveleve të ndryshme veprat tona pianistike më të mira, që nga Skicat pianistike të nxjerra nga Baleti Delina të Zadesë, Tokata e Ibrahimit, Romanca e Harapit apo baladat e Larës përbëjnë kreshtat e muzikës sonë pianistike të periudhës së diktaturës komuniste. Me dhjetra vepra të tjera kanë pikasur pas viteve 90' me kontribute të rëndësishme nga Peçi, Shupo, Zacharian, Kraja, Tole, Sina, etj. Të gjitha këto ndikuan në konfigurimin e literaturës pianistike në Shqipëri, ku roli kryesor i takon krijuesit.

Si përfundim mund të themi se muzika pianistike në Shqipëri ka filluar të bulëzojë në vitet e para të shekullit XX si kontribut i figurave të para të artit muzikor paraprofesionist në vend. Me epiqendër në qytetin e Shkofrës partiturat e para u pasuan nga të tyjerat gjithnjë e më cilësore në këndvështrim të realizimeve formale, harmonike, melodike e së fundi edhe të teknikës apo fakturës pianistike.

Në këtë fazë të parë mund të përcaktojmë si më të rëndësishëm faktin e lindjes së një literature të tillë, për tu pasuruar më pas në periudhën e dytë të njohur nga Historiografia jonë e që përcaktohet në vitet 1945 – 1990.

Faza e dytë e yhvillimit të muzikës pianistike shqiptare, e cila në vetvehte mund të ndahet në tri segmentë të dallueshëm kohorë (1945 – 1965; 1965 – 1980 dhe 1980 – 1990) është dhe faza më e gjatë në kohë dhe ajo e thellimit të të gjithë elementëve që do të përbënin fizionominë e muzikës sonë pianistike si pjesë e rëndësishme e yhvillimit dhe traditës muzikore në vendin tone. Përmes aplikimit të të gjitha gjinive përfasqësuese, që nga miniatuere e deri në koncertet e mëdha ciklike për piano e orkestër në këtë faze dallohen figura të shquara kompozitorësh, të cilët vulosën jo vetëm profesionalizmin muzikor pianistik, por dhe arritën të krijojnë vepra të cilat i kanë rezistuar dhe do ti rezistojnë kohës. Pikërisht në këtë fazë dallohen dhe disa individualitete krijuese të cilët brenda të menduarit melodik arritën të gjenin një gjuhë specifike muzikore për të komunikuar me publikun.

Me gjithë politizimin e tejskajshëm të segmenteve të ndryshme kohore të kësaj faze mund të vijmë në përfundimin e muzika pianistike shqiptare pati pak ose aspak influencë rrymat korrente. Përveç ndonjë titulli, i cili nuk kishte të bënte me përmbajtjen muzikore apo me teknikat e krijimit të muzikës pianistike, këto devijime paten një efekt marginal.

Nga ana tjetër duhet të pohojmë se megjithatë zhvillimet muzikore pianistike në Shqipëri, ashtu si dhe e gjithë muzika e kompozuar në këtë periudhë pati një ndryshim të madh me yhvillimet muzikore të kontinentit, të cilat për hir të hapësirave shprehëse dhe zhvillimit të tejskajshëm teknologjik kishin arritur të krijojnë lëndë muzikore krejtësisht shumë ë të zhvilluara dhe shumë më të ndryshme nga muzika që krijohej brenda Shqipërisë.

Arritjet e artit tonë muzikor në gjinitë e muzikës pianistike mund të përcaktohen në këto drejtime kryesore:

- Krijimi i një repertori muzikor pianistik në rrafshet profesionale.
- Krijimi i audiencës së etur për krijimtarinë e re pianistike.
- Krijimi i një plejade të tërë pianistësh të aftë për të përballuar teknikën pianistike të kohës gjithnjë e në rritje.

- Krijimin e një plejade të tërë krijuesisht të rinj të cilët do të mundësonin zhvillimin tërësor të komponentëve të muzikës pianistike shqiptare brenda caqeve që koha lejonte.

Kristalizimi i disa raporteve të caktuara brenda teknikës kompozicionale në rritje me lëndën folklorike, me harmonitë që mbartëte kjo lëndë specifike, meshkrimin pianisti gjithnjë e në zhvillim, me strukturat e ndryshme formale, me kërkesën për tingëllima të reja pianistike apo edhe të harmonizuara me ato orkestrale, me kontrastet muzikore që pasqyronin zhvillimin e dramaturgjisë kryesisht në veprat e gjinive të mëdha, etj. Të gjitha këto e shumë të tjera element më të imtë, të cilët i trajtuam konkretisht në analizat e mësipërme do të përbëjnë rëndësinë dhe risinë e muzikës sonë pianistike të kësaj faze të dytë.

Në fazën e tretë (1990 – e deri në ditët e sotme) muzika pianistike shqiptare eci në një rrugë të re. Kjo jo vetëm për faktin e ndryshimeve të mëdha të kushte social – ekonomike, por edhe pasi në sistemin e ri që shoqëria jonë vendosi, raporti i peshës specifike që muzika në përgjithësi, por dhe muzika pianistike në veçanti njohu me të gjitha komponentët e jëtës ndryshoi.

Artisti nuk gëzoi më përkrahjen, mbështetjen dhe njëkohësisht detyrimin nga shteti. Veprat nuk bliheshin më dhe ai u struk në përsiatje individuale, duke pasur si relacion vetëm shembujt më të mirë të muzikës bashkohore botërore. Kështu përthyerja midis publikut dhe kompozitorit erdhi duke u bërë gjithnjë e më e dukshme. Megjithatë nga ana tjetër kemi evoluime konkrete të të menduarit muzikor, të cilësisë racionale të veprave të veçanta, si dhe arritje konkrete të nivelit ekspresiv të veprave të veçanta.

Në pikpamje të pianizmit, si pjesë e teknikës kompozicionale veprat e pas viteve 90' paraqesin risi të dukshme, duke ravijëzuar emra të rinj kompozitorësh dhe sidomos emra të rinj pianistësh të cilët gradualisht po i dedikohen gjithnjë e më shumë ekzekutimit dhe interpretimit të muzikës së kohës. Veprat e ndryshme të miniaturave pianistike apo ato koncertale në vendin tonë u zhvilluan më tepër në fushën e muzikës joprogrametike, apo siç quhet muzikës së pastër.

Gjithashtu karakteristikë kryesore e tyre është mbështetja mbi intonacionet tona karakteristike folklorike dhe në zhanret tona popullore.

Megjithatë ato përshkohen nga një teknikë e zhvilluar koncertale pianistike dhe tingëllima të pasura instrumentale. Vepra të tilla si Taccata e Zadejës apo ajo e Ibrahimit, "Humoreska" e Zadejës apo Paparistos, Vallet e baladat e Kozma Larës, miniaturat e Harapit apo ato të autorëve të tjerë kanë mbetur në fondin e artë të literaturës pianistike në vendin tonë.

Tematika e krijimtarisë pianistike Shqiptare ka një theks të rëndësishëm në drejtim të karakterit epiko-heroiko-lirik e të gërshetuara me tendenca drejt ndërtimeve virtuozë. Ndërkohë veprat e Kozma Larës kanë një përthyerje më tepër për nga meditim i epik.

Të tilla emocione dhe figura krijojnë sidomos Baladat e K. Larës për piano2. Megjithatë figurat lirike zënë një vend të gjerë në miniaturat e ndryshme të krijuesve tanë të kësaj periudhe. Ato shkrihen në ritmikën dhe intonacionet e përgjithshme të muzikës sonë popullore me ngjyrimë të larmishme nga të gëzuarat deri tek ato humoristike. Një vend të rëndësishëm zenë krijimi i figurave artistike epike legjendare, ndër të cilat mund të shënojmë Baladat e Larës, veprat e ndryshme të Zadejës etj.

Temat me variacione ndahen në vepra të cilat përqëndrohen në tema të cituara apo të përpunuara nga krijimtaria e gjerë popullore dhe nga tema të krijuara, gjithmonë

në kuadrate formale të rregullta dhe mbi konceptet tematike krijuese.

Veprat më të mira shquhen për nga rinovimet harmonike, formale, fakturore dhe në përgjithësi nga krijimi i figurave individuale dhe të karakterizuara muzikore. Temat me variacione më të ekzekutuara dhe më të njohura janë ato të Zadejës, Harapit, Larës etj.

Referenca

Nestor Kraja „Muzika Instrumentale Shqiptare“ Shtypshkronja Morava 2005.
Historia e Muzikës Shqiptare Vol. 2, Përgatitur nga Instituti i Lartë i Arteve Tiranë 1983.
Historia e Muzikës Shqiptare dispencë, Vol. I, ShBLSH 1983.

Politika si normativitet: Një qasje vlerore ndaj qeverisjes

Julian Myftari

Abstrakt

Një nga dukuritë shënjuese të shekullit të XX, rezulton të jetë venitja e qasjeve normative ndaj qeverisjes, politikës dhe politikës në favor të atyre materialiste, utilitariste, apo dhe formalo-burokratike. Duket se qeverisja-politika luhateshin midis një materializmi determinist të tipit marksist, ose utilitarizmit individualist të tipit ekonomik-liberal. Politika u kthye në shkencore, duke u shndërruar në një shtojcë të historisë apo ekonomisë. Përballë saj “qenia politike” e gjeti veten të transformuar në një pjesëz e mekanizmit të stërmadh të historisë. Ajo u zvogëlua me shpejtësi marramendëse për sa kohë botëkuptimet mbi “të mirën” apo vlerat për ta arritur të atë, ishin kthyer në tej-politike. “Vlerat” dhe “e mira” nuk ishin më atribut i politikës sepse diskutimi rreth tyre i takonte privates së njeriut, në varianti liberal, ose ishin të përcaktuar shkencërisht në variantin marksist. Kjo qenie politike ishte e detyruar të strukej tek privatja pa pasur mundësi shkëmbimi dialektik me ambientin politik ku gjallonte, duke mos jetësuar raportin dinamik midis vetes dhe shoqërisë që përbën vetë esencën e saj përkufizuese. Pra njeriu u kthye në një qytetar me aftësi të kufizuara për shkak të zhveshjes nga aspekti normativ-vleror i politikës dhe qeverisjes. Kjo pati pasoja jo të vogla në aftësinë e tij për ti bërë ballë strukturave të pushtetit dhe ideologjive politike mbizotëruese të kohës.

Kështu, rezulton e nevojshme një qasje normativo-vlerore e politikës dhe qeverisjes, si hapësirë tensioni midis qytetarit si qenie politike dhe vetë veprimtarisë qeverisëse. Kjo do të mundësonte jo vetëm ndërtimin e qytetarit si raport midis individit dhe publikës, por dhe ndërtimin e një veprimtarie qeverisëse si raport i të mirës së përgjithshme me individin.

Fjalë kyçe: Vlera, Normative, Politika, Historike, Marrëdhënie Politike.

Shekulli XX duket të jetë një nga periudhat më virulente për sa i përket zhvillimeve historike, kjo si për dinamikën e ngjarjeve historike, ashtu dhe për metamorfozat e skajshme të koncepteve që bëjnë të mundur bashkëjetesën e individëve në shoqëri. Asnjë shekull më parë, aq sa ai i XX, nuk u ka premtuar njerëzve pasjen e një raporti me komunitetin e tyre si anëtarë me të drejta të plota të tij. Rritja e numrit të shteteve dhe copëtimi i perandorive të mëdha, valët e ndryshme të demokracive të reja, parime si ato të vetëvendosjes së popujve, apo dhe suksesi i paprecedentë i ideologjive politike të së majtës marksiste, krijonin idenë se shtetet do qeveriseshin me parime krejt të ndryshme nga të mëparshmet. Dukej sikur ideali kantian i autonomisë po merrte jetë dhe po paralajmërohej një rol krejt të ri që individit do kishte si entitet aktiv në politikën e komunitetit të tij.

Në mënyrë paradoksale, përballë kësaj vale risish koncepti i vlerave si qasje normative ndaj politikës dhe komunitetit politik u gjend krejt i reduktuar. Kjo për shkak se dy variantet “fituese” të organizimit shoqëror të shekullit të XX, liberalizmi dhe marksizmi, kishin një qasje jo domosdoshmërisht normative ndaj shtetit dhe politikës. Kjo së pari, sepse liberalizmi pretendon një neutralitet ndaj vetë vlerave

dhe merr rolin e një meta-ideologjie që nuk propagandon ide mbi jetën e mirë apo shtetin e drejtë, drejtësinë në vetvete etj., apo dhe sepse nuk konsideron ndonjë antropologji përmbajtjesore mbi njeriun¹ pra nuk krijon modelin e njeriut të mirë apo idealin e individit në raport me të tjerët.

Edhe nën marksizëm roli i vlerave ishte krejt i reduktuar. Kjo sepse vetë individit si person autonom u cenua. Në këtë sistem politik-ideologjik, individit ishte shndërruar në një pjesëz të realitetit për shkaqe si të metafizikës (antimetafizikës) të filozofisë së kohës, ashtu dhe për shkaqe strukturore institucionale. Për shkaqe të metafizikës filozofike pasi "realitet" konsiderohej materialja dhe historia ishte zhvillimi dialektik i materiales. Kjo pamundësonte konceptin e ngjarjes mirëfilli, pra çdo ngjarje shikohej si pjesë e një historisë së strukturës dhe më shumë sesa ngjarja bënte historinë ishte, historia që (zh)bënte ngjarjen. Rrjedhimisht ngjarja nuk kishte kuptim të pavarur të vetin dhe individit luante një rol të paqenë përballë historisë, për sa kohë ai nuk mund të prodhonte ngjarje.

Gjithashtu shteti komunist, për shkak se donte dhe të ishte një aleat ndihmës i "historisë", dhe jo thjeshtë ta ndiqte atë, krijoi struktura institucionale të cilat jo vetëm emuluan pikëpamjen e tij filozofike mbi individin dhe historinë, por bënë të mundur dhe mungesën e individit dhe çka është më e rëndësishmja më tej ekzistencën e tij si person politik.

Strukturat institucionale-juridike të shtetit të diktaturës së proletariatit, kuptueshëm reduktonin rolin e individit duke e vendosur atë nën të tërën. Kjo pamundësonte një raport midis individit dhe të tërës duke qenë se individit nuk ekzistonte, e tëra jepej si një fakt i atypëratyshëm dhe i pandryshueshëm. Pra, marrëdhënia ishte e pamundur derisa nuk arrihej të kishte një pavarësi relative të individit për tu kthyer në person. Unifikimi shkencor i realitetit², i hoqi njeriut distancën e duhur midis vetes dhe strukturës historike, ku ai mund të ndërjegjësohej si unitet me veten, me një autonomi nga rrethana, kështu ai përfundon së qeni thjeshtë pasoja e historisë së bërë shkencë. Duke qenë se pushteti komunist, shpeshherë, e veçanërisht në Shqipëri, e gjeti vendin në gjendje shumë të prapambetur, zhvillimet që ai solli nga pikëpamja teknologjike si në industri ashtu dhe në bujqësi, u perceptuan si shprehje shkencore të ideologjisë, dhe përforcuan idenë se ideologjia ishte shprehje e një të vërtete shkencore. Kështu, arsyeja personale dhe vullneti individual nuk luanin ndonjë rol të rëndësishëm në jetën e komunitetit.

Në periudhën pas-komuniste problemi i raportit të individit me politikën duhet të shikohet të paktën në dy përmasa, qoftë në frontin akademik si pikëpamje e njohjes së politikës në një pikëpamje shkencore, ashtu dhe në atë politik, si aktivitet i aktorëve politik. Madje dhe ndarja e e këtyre përmasave rezulton e vështirë po të kemi parasysh se ndryshimi i sistemit të qeverisjes, importoi koncepte të tjera mbi politikën, dhe pikëpamje të tjera mbi vetë studimin e politikës, kryesisht empirike-analitike.

Të dy këto dimensionet, të studimit të politikës dhe të vetë politikës, janë të lidhura

¹ Kjo sepse teori të politikës që mbizotëruan në perëndim gjatë gjysmës së dytë të shekullit, si ajo e biheavioralizmit, apo dhe pozitivizmi në përgjithësi nuk shohin si të nevojshme apo dhe të mundshme një përjasje antropologjike mbi natyrën e njeriut.

² "Në sukseset e mëdha që ka arritur populli ynë në ndërtimin socialist të vendin, një kontribut të veçantë ka dhënë dhe shkencën jonë e re." Enver Hoxha, "Pjesë Nga Raporti I Shokut Enver Hoxha Mbjatur Në Kongresin E 8 Të Ppsh," Drejtësia Popullore 11 (1981): 17.

me njëra tjetrën, kjo sepse ekziston një problematikë e raportit të shkencës politike me objektin e saj dhe një problematikë e natyrës së objektit si aktivitet publik shoqëror. Të dyja këto aspekte janë në mënyrë dialektike të rëndësishme pasi, për nga vetë natyra politika si objekt nuk arrin të ketë atë pavarësi ontologjike nga përfaqësimet gnoseologjike ndaj saj, për shkak se nuk është si objekte të tjera të njohjes që i përkasin shkencave natyrore dhe që janë dukshëm më pak të diktueshme nga njeriu. Politika si aktivitet qëllimor i njeriut, varet në natyrën e saj nga pikëpamjet që kemi mbi të. Dhe shkencën e saj është aktivitet qëllimor i njeriut. Rrjedhimisht kemi një përputhje të papërshtatshme midis natyrës së vetë shkencës dhe natyrës së objektit të saj në rastin shkencë politike-politikë. Kjo papërshtatshmëri është pasojë e faktit se të dyja fenomenet kanë natyrën e mjetit. Shkencën është "mjet" për të dalluar realitetin (ose më zakonisht pjesë të tij) dhe politika është "mjet" që përdoret për të prodhuar një realitet të caktuar. Duke qenë se mjetet kanë një natyrë jo të pavarur atëherë kemi të bëjmë me raportin midis dy entiteteve të varura të cilat në mënyrë rrethore, ndikojnë tek njëra tjetra dhe varësinë kryesore e kanë ndaj njëra tjetrës. "Hulumtuesi shkencor në mënyrë aktive ndikon mbi marrëdhëniet mbi të cilat hulumton" (Asheim, 1979, 5). Pra nuk mund të ketë një neutralitet të mirëfilltë, ashtu siç pretendojnë qasjet empirike që mbizotërojnë sot në shkencën politike shqiptare. N.q.s. kjo është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, kërkim neutraliteti ky, që ka qenë i pasuksesshëm në paraqitjen e një realiteti në të cilin e ka të pamundur të mos ndikojë. Por, mungesa e suksesit të një përfaqësimi neutral nga disiplina e shkencës politike dhe nga vetë politika si aktivitet, pason nga pamundësia e mosndikimit në natyrën e politikës. Gjithashtu shtrihet dhe në faktit se pikëpamjet empirike dhe neutrale mbi politikën në të vërtetë ndikojnë mbi realitetin politik. Realitetin politik, për shkaqe të paradigmave dhe metodologjisë së tyre këto qasje empirike e copëtojnë në shumë pjesëza të matshme empirikisht. Pretendimi i tyre për neutralitet ndaj vlerave individuale dhe shoqërore në tërësi prodhon pikërisht një realitet, vlera e kryesore e të cilës është copëzimi. Ky copëtim teknik i realitetit, pamundëson një narracion dypalësh midis individit dhe politikës dhe pamundëson qenien politike si të tillë, si reaguese ndaj tërësisë politike në të cilën bëjmë pjesë. Dukë qenë se individit e shikon veten si pjesë dhe vetë tërësia shoqërore nuk ofron një unitet konceptual, realiteti si i tillë rezulton të konceptohet si i pjesshëm.

Historikisht, problematika e shkencës politike në raport me objektin e saj shihet edhe si moment i ndarjes së shkencës politike si disiplinë me vete. "Si disiplinë e lëvruar dhe jo thjeshtë si zëvendësuese e problematikave të tjera shkencore, shkencën politike u krijua në universitetet moderne dhe u zhvillua bashkë me tendencën e tyre për të forcuar specializimin në botën e dijes" (Riemer, 1985, 609).

Edhe pse qasjet empirike që mbështeten fortë sot, nuk përjashtojnë krejt ekzistencën e qasjeve normative-vlerore, mëkati fillestar i shkencës politike perëndimore që lind si specializim apo si skizmë kërkon një ndarje midis dy qasjeve. Nga ky "mëkat fillestar" i gjenezës së vetë disiplinës, ideja e specializimit të dijes ka shkuar deri aty sa të përgjithshmen apo studimin e politikës si ideal apo vlerë ta ndajnë nga studimi i së veçantës, pra shkencën politike na servir dy përmasa të kithëta me njëra tjetrën atë normative dhe atë empirike. Kjo ndarje ka ardhur si pasojë se vetë koncepti i specializimit ka marrë vendin e konceptit të së përgjithshmes, d.m.th. koncepti i ndarjes apo specializimit ka marrë rolin e vlerës, e një finaliteti aksiologjik absolut. Ai

ka zëvendësuar vlerën e përgjithshme si pikë arritje e shoqërisë, shkencës politike dhe politikës. Kështu pikëpamja normative mbi politikën është transformuar si njëra nga pikëpamjet. Vlerat janë kthyer në një prej alternativave të dallueshme dhe në pamje të parë të barasvlerëshme me qasjet e tjera empirike të politikës. Pra ne mund, jo vetëm të zgjedhim disa prej vlerave, por mund të zgjedhim edhe të mos zgjedhim vlera, apo të mos trajtojmë dimensionin vleror. Sigurisht kjo përmbysje e vlerës si epnore në vlerën si një ndër alternativat e përqasjes ndaj politikës, është qartësisht në favor të qasjeve empirike-teknike për sa kohë vetë ideja e një ndarje teknike mbizotëron si një meta-rregull, si një rregull mbi rregullat, pra si një kriter epror klasifikimi i disiplinës dhe i objektit të saj, politikës. "Një hulumtues studion ose demokracinë ose shfaqjet empirike të saj por jo të dyja" (Gerring, 2006, 104) duke rezultuar kështu në një ndarje midis perspektivave përfundimtare të shoqërisë si vizion dhe përditshmërisë së veprimit konkret. "Studiuesit e shkencave sociale vazhdojnë të ngulmojnë për dallimin midis argumenteve përkrahuese dhe atyre vlerore, (Gerring, 2006, 105) duke favorizuar në mënyrë të vazhdueshme të parat përballë të dytave sepse kjo duket se i shkon më për shtat botëkuptimit sektarist të realitetit.

Edhe pse mund të duket se në vendin tonë kjo përqasje jo vlerore e politikës është e shëndetshme në aspektin funksional ndaj sistemit demokratik, pasi tenton të krijojë një realitet të dallueshëm nga sistemi komunist i cili kërkonte njëjtësim të realitetit në një unitet holistik, ajo ngjason me të sepse pikëpamja empirike-shkencore mbi realitetit, krijon perceptimin e realitetit dhe subjekteve të realitetit, si objekte. Tentativa për ta parë shkencën politike si "shkencore" edhe pse nuk i ngjan tashmë tërësisht tentativës marksiste për ta parë "politikën" si shkencore, rrezikon të ketë një pasojë të ngjashme me të. Megjithëse politika dhe shkenca politike e periudhës paskomuniste duket sikur bën krejt të kundërtën e periudhës së mëparshme, ato përsëri reduktojnë deri në eliminim konceptin e "substancës" nga individit dhe vetë politika sepse këto qasje nuk interesohen për ideale vlerash apo për ndonjë metafizikë të individit. Individit për to është një qenie e prirur për realizmin e interesave personal dhe politika është mjete ndërmjetësues i këtyre interesave. Duke qenë se "tek substancialiteti është themeli i vazhdimësisë, ku shumësia lidhet me njëshin, i ndryshmi me identiken, pjesët me të tërën" (Gonella, 1959, 24). Këto qasje pamundësojnë pikërisht vijueshmërinë e vazhdimësisë së personit përtej kolektives apo ekzistencës së mbyllur private.

Pra individit nuk i jepet mundësia të ketë një vizion mbi të mundshmen e një të tërë por i jepen të "vërteta" të pjesshme (Rama, 2006, 20) të cilat nuk arrijnë të kenë komunikim me të tërën. Tashmë individit nuk ka një të përgjithshme me të cilën të komunikojë sepse të gjitha leximet që i jepen për realitetin janë jo vlerore dhe pa valencë përtej aktuales dhe kjo pamundëson kalimin e individit nga individualitet fizik në person moral, pra nga qenie egoiste në qytetar të republikës. "Personaliteti është zotërimi i individualitetit, është liria e Unit, arsyeja formale e individualitetit" (Gonella, 1959, 24). Kështu individit rezulton në të njëjtën situatë moskomunikimi me të jashtmen politike, të ngjashme me atë në të cilën gjendej në "Shqipërinë socialiste", sepse nuk arrin të gjejë vektorë me valencë për ta drejtuar veten përtej imediateve së tij. Si të thuash, në mungesë të një diskursi prezent normativ, individit bëhet jo komunikues, pra ai nuk arrin të krijojë habitat normal ku jeton qytetari, dhe si pasojë ai nuk arrin as komunikimin individual "qua persona". Kjo pamundësi komunikimi

me një të jashtme vlerore, e cila përbën një përmasë të domosdoshme të vetë kalimit nga individ në person, pra në qytetar, ka si pasojë jo vetëm mos ndërtimin e politikës si vlerë, por dhe të vetë ndërtimit të personit si vendtakimi i vlerës me materialen. Pra njeriu, si person moral, i cili duhet të ishte vendndodhja e këtij takimi mungon së qeni i tillë për sa kohë, as vlera nuk qëndron e dallueshme, por dhe tentativa për ta dalluar vlerën konsiderohet si e padobishme si nga shkenca politike ashtu dhe nga politika. Njeriu i mos-ndërtuar si pikëtakim pamundëson veten e tij, për shkak se mungesa e kontaktit midis tij dhe të tërës apo politikës pamundëson vetë ekzistencën e të dyja poleve që përbëjnë këtë vendtakim.

“Është gjithmonë motivi i mohimit të universalitetit (në përgjithësi) që reflektohet në mohimin e universalitetit të personit (si partikularitet) (Rama, 2006, 20). Në të kundërt ajo që do mundësonte një raport midis vetes dhe tërësisë është raporti me universalen si mungesë të individuale. Të dyja identitetet, ai tërësor dhe ai individual, mundësohen nga vendtakimi pra nga hapësira ku mund kontaktojnë, duke konceptuar individualen materiale si një vend ku mund të krijohet raporti me të tërën. Ato lindin si akt mohimi-pranimi, vetë njeriu lind aty ku takon politikën dhe politika e takon individin në hapësirën psikologjike që ky ndërton. Kjo hapësirë është lokusi ku mundësohen, personi dhe politika si “osmozë kimike” dy elementesh.

Kjo marrëdhënie midis vetes si: 1) identitet individual paraprak dhe 2) raport me të jashtmen si mungesë e vazhdueshme që individi ka tek vetja, plotëson përkohësisht por në mënyrë të vazhdueshme identitetin e tij personal dhe nga ana tjetër bën që individi t’i rezultojë vetes, si një dinamikë që zhvillohet në një vete me mungesa. Është tërësia shoqërore dhe politike ajo siguron këtë raport midis vetes, mungesës së vetes dhe “jashtësisë” si vend ku realizohen kërkesat e personit si të domosdoshme për krijimin e tij personal. Duke qenë se krijimi i ekzistencës personale nuk është shprehje e një cilësie fizike apo pozitive, të matshme nga jashtë, por shprehje e mungesave të tij, e gjithë kjo lëvizje krijuese e personit si qytetar nuk është e një natyre faktike por e një natyre normative morale. Personi krijohet si raport i kërkesave që dalin nga mungesat e tij dhe ekziston si ontologji e procesit të përzgjedhjes së mungesës më të rëndësishme ndër zinxhirit të mungesave që ai ka³. “Ajo çka ishte ontologjike në këtë, ishte pikërisht fakti që njëri prej kërkesave i duhej të merrte rolin e përfaqësueses të gjithë zinxhirit të kërkesave” (Szkudlarek, 2016, 63). Pra për krijimin e një raporti politik me realitetin, individi nuk duhet ta shikoj veten si qenie empirike tashmë të përfunduar por si qenie në raport me mungesat, rrjedhimisht me kërkesat e tij. Dhe akti i zgjedhjes së mungesave kryesore, është akti që përcakton atë si qenie tërësore dhe i garanton lëvizjen brenda vetes e cila mundëson dhe lëvizjen jashtë qenies së tij individuale, në rrafshin politik-publik.

Mungesa e ideologjive klasike në politikë sot mund të konsiderohet si një simptomë e mungesës së normative, megjithatë fakti se normativja dhe vlerorja si përfaqes ndaj politikës është e mundur vetëm si mbizotërim i një ideologjie rezultoi i gabuar. Përkundrazi vetë korniza e shtetit demokratik nën vlerat liberale mund të përdoret për të ndërtuar këtë raport normativ me politikën dhe të politikës. “Nuk ka humbje

³ Një nga momentet ku mund të dallojmë ekzistencën e “personit” moral në Shqipëri ishte në ndryshimin e sistemeve në fillim të viteve 90, ku “personit” krijohet si një raport i zgjedhjes midis mungesave. Liria si mungesë krijoi tensionin midis individit aktual-fizik dhe “Lirisë” duke bërë që personi të ndërmerre një lëvizje drejt lirisë si objekt normativ.

të substancës morale n.q.s. morali politik nuk lidhet me një konceptim të caktuar të jetës së mirë, megjithëse liberalizmi akuzohet se ka një konceptim abstrakt, pa gjak, bosh të moralitetit (Der Hartogh, 1990, 202)". Pra ne mund të krijojmë një politikë si ndjekje vlerash pa përcaktuar paraprakisht një listë përfundimtare të tyre, por mungesa e një përcaktimi paraprak nuk do të thotë absolutisht ta kthejmë politikën thjeshtë si një përshkrim empirik të realitetit kolektiv si shumë pjesësh të palidhura me njëra tjetrën. Substanca morale nuk humb kur nuk ka një dakordësi universale të atypëratyrshme mbi vlera specifike, madje mund të themi se është pikërisht aty ku kjo dakordësi nuk është, se personi politik-moral mundësohet, sepse mbi të nuk imponohet si fakt asnjë e vërtetë në të cilën ai nuk ka marrë pjesë si qenie autonome. Pra si përfundim mund të themi se është e pamundur të konceptohet një qasje tërësisht shkencore e politikës, sikundër një prirje klasike shkencore-neutrale e vetë shkencës politike dhe politikës do të ishte gjithashtu e dëmshme dhe jo e besueshme. Pra një qasje normative që merr në konsideratë koncepte si e mira e përgjithshme, shteti i drejtë, jeta e mire etj. është e domosdoshme. Si Marksizmi i demokracisë popullore, ashtu edhe liberalizmi , nuk kanë arritur të ndërtojnë dialogun normativ midis individëve dhe shoqërisë në Shqipëri në mënyrë që konceptet e mësipërme të arrijnë të krijojnë përmbajtje. Megjithatë, duket se një formë e liberalizmit të diskutuar dhe të bazuar tek diskutimi, ngelet zgjidhja më e mundshme për të arritur një qasje të tillë duke qenë se krijon hapësirë dialogu midis dhe brenda individëve dhe ky dialog brenda dhe midis individëve do mundësonte raportin individ-shoqëri.

Referencat

- Asheim, Bjorn T. "Social Geography—Welfare State Ideology or Critical Social Science?". *Geoforum* 10, no. 1 (1979): 5-18.
- Den Hartogh, Govert. "Rationality in Conversation and Neutrality in Politics." *Analysis* 50, no. 3 (1990): 202-05.
- Gerring, John, and Joshua Yesnowitz. "A Normative Turn in Political Science?". *Polity* 38, no. 1 (2006): 101-33.
- Gonella, Guido. *La Persona Nella Filosofia Del Diritto*. 1959.
- Hoxha, Enver. "Pjesë Nga Raporti I Shokut Enver Hoxha Mbajtur Në Kongresin E 8 Të Ppsh." *Drejtësia Popullore* 11 (1981): 17.
- Rama, Shenasi. "Probleme Politike Shqiptare I." Princi, Tiranë (2006).
- Riemer, Neal. "The Tragedy of Political Science: Politics, Scholarship, and Democracy. By Ricci David M. (New Haven, Conn.: Yale University Press, 1984." *American Political Science Review* 79, no. 02 (1985): 609-10.
- Szkudlarek, Tomasz. *On the Politics of Educational Theory: Rhetoric, Theoretical Ambiguity, and the Construction of Society*. Routledge, 2016.

Matja e ndikimit te decentralizimit fiskal ne zhvillimin ekonomik vendor Rasti i njësive vendore te Qarkut Lezhë

PhD Fatlum Nurja

*Decentralization & Local Governance Expert
Planning and Local Governance Project (PLGP) in Albania*

Abstrakt

Nevojat në rritje të njësive vendore për kapitale financiare, për të bërë të mundur financimin e projekteve të tyre në infrastrukturë dhe jo vetëm, për të përmirësuar e për të mbështetur planet e zhvillimeve vendore nuk kanë gjetur hapësirë në qeverisjen qendrore në tërë këtë hark kohor që nga fillimi i proceseve decentralizuese në Shqipëri. Vetëm 9.1 % (2014) e shpenzimeve të konsoliduara publike zënë shpenzimet vendore në të dy nivelet Bashki dhe Qarqe. Temat e decentralizimit fiskal janë tepër te debatueshme në harkun kohor 2002 – 2014 që shtrihet punimi, ndërsa temat e zhvillimeve vendore dhe rolit të njësive vendore në këtë proces janë pothuaj të paprekura fare ose janë të adresuara në mënyrë sipërfaqësore dhe përkrahëse. Diskursi nëse thellimi i decentralizimit, në veçanti atij fiskal dhe si do ndikonte ai në zhvillimin ekonomik, është trajtëse e këtij punimi. Hipoteza e punimit është: Nëse thellohet decentralizimi fiskal zhvillimi ekonomik vendor ka kaheje pozitive. Përgjigjet ndaj pyetjeve kërkimore si: (i) A ndikon decentralizimi fiskal në zhvillimin ekonomik vendor; (ii) A mund të bëhet një matje e tillë në mënyrë empirike ekonometrike; dhe (iii) Cilët janë faktorët që ndikojnë në thellimin e decentralizimit fiskal dhe si ndikojnë ato në performancën e indikatorëve të zhvillimit ekonomik vendor, do jene ato që do drejtojnë punën kërkimore. Unë kam sjellë në këtë punim, studimin e rastit të njësive vendore te Qarkut të Lezhës për periudhën 2002 – 2014.

Fjalë kyçe: zhvillimi ekonomik, decentralizim fiskal, te ardhura vendore.

Hyrja

Pas rënies së komunizmit në Evropën Lindore, në këto vende në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90 ka një trajektore të lëvizjes së këtyre nga ekonomi e planifikuar nga qendra në ekonomi të orientuar nga kërkesat e tregut dhe më e decentralizuar. Këto vende janë përballur me shumë sfida në përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të siguruar një zbatim të suksesshëm të reformave të decentralizimit fiskal (Prud'homme, R. 1995:p201-220).

Reformat e qeverisjes vendore janë reforma të rëndësishme si pjesë e transformimit të sistemeve politike por në të njëjtën kohë, ato si reforma kanë dhënë edhe kontributet e tyre si reforma në zhvillimin ekonomik në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (Horvath, M.Tomas, 2000). Po kështu edhe në vendet e Evropës Juglindore reformat kanë pasur të njëjtën trajektore, me vështirësi më të mëdha, të filluara më vonë sidomos pas shpërbërjes të Jugosllavisë dhe marrëveshjes së Deytonit, pas marrëveshjes së Ohrit si dhe pas Planit të Ahtisarit për Kosovën. Nisur nga këto, autor si Will Barlett vënë në dukje që:

“Në vendet e SEE-së decentralizimi i qeverisjes në nivel rajonal si në reforma

administrative apo fiskale ka pasur zgjerime apo implikime të ndryshme.” (Barlet, 2013:4)

Sa i përket decentralizimit dhe rolit të tij në zhvillimin ekonomik, nga vëzhgimet dhe disa matjeve empirike në bëra vendet e SEE-së kemi komente dhe përfundime të ndryshme që tregojnë se nuk ka një recetë të ngjashme apo “gjithëpërfshirëse.” Për shembull në Bosnje-Hercegovinë, prishja apo dëmtimi i kapitalit social dhe humbja e besimit reciprok ka dhënë një efekt negativ në sektorin e zhvillimit të SME-ve (Rus and Igljic, 2005-Barlet.W, 2013:7).

Duke i krahasuar këto me modele transformimi në Poloni apo edhe në Slloveni (Evropa Qendrore dhe Lindore) kur politika fokusohet në krijimin e mundësive duke mobilizuar resurse vendore tregon se ajo mund të mbështetet edhe nga burime të jashtme për financime infrastrukturore apo rritje kapacitetesh njerëzore. Në këto vende shumë vëmendje i është dhënë raportit apo ndërlidhjes mes decentralizimit dhe rritjes ekonomike apo zhvillimit ekonomik.

Duke përmirësuar llogaridhënien apo edhe raporteve dhe marrëdhëniet në term, atë vetëqeverisjes vendore, ka mendime që decentralizimi mund të mbështesë zhvillimin vendor dhe për rrjedhojë nga shuma e këtyre ekonomive vendore sjell ngritjen e ekonomisë së vendit. (Oates, 1993).

Por a mund të kemi evidencë empirike nga këto vëzhgime, dhe si janë ato në vendet e tjera të Evropës Lindore apo Qendrore? Sipas (Limi, 2009), ka studime që kanë gjetur lidhje mes decentralizimit dhe rritjes ekonomike, ndërsa të tjerë kanë gjetur lidhje negative (Rodrigues Pose and Bodman, 2011). Kurse të tjerë nuk kanë gjetur lidhje apo ndërveprim ndërmjet këtyre ndryshoreve (Rodrigues Pose and Bwire; Bodman, 2011). Për ekonominë në ndryshim, (Rodrigues Pose dhe Kroijer 2009), kanë gjetur në matjet e tyre empirike lidhje negative mes rritjes ekonomike dhe decentralizimit fiskal në 16 vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, edhe pse rritja e fuqisë për taksa vendore duhet të ketë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike.(Bartlett. W; Malekoviç. S; Manastiriotis. V, 2013: 8)

Në dekadat e fundit i është kushtuar një vëmendje të madhe specialistëve të zhvillimit të agjencive zhvillimore multilaterale si dhe qeverisjes me fokus decentralizimin fiskal si një instrument primar për të promovuar zhvillimin ekonomik (UN, 1991; Oates, 1994; Bruno and Pleskoviç, 1996).

Përcaktimi apo përkufizimi më i përshtatshëm dhe më i pranuar sot në botë për “shkallën e zhvillimit” i referohet propozimit të ekonomistit francez Francois Perroux të vitit 1966. Ai është autori kryesor i teorisë së poleve të rritjes, e krijuar në vitin 1950. Ishte Francois Perroux (1903-1987) çelësi dhe themeli më i rëndësishëm teorik i gjithë konceptit. Ishte argumenti i tij i cili shpjegon mënyrën dhe formën e rritjes ekonomike në mënyrën e mëposhtme:

“Është një fakt i dukshëm dhe i padiskutueshëm se rritja nuk është uniforme në vende të ndryshme, por rritja ka shkallë të ndryshme intensiteti në pika të ndryshme, apo në pole, dhe pastaj ajo përhapet nëpërmjet kanaleve dhe rezultati i tij përfundimtar për ekonominë shtetërore është i ndryshëm në rajone të ndryshme”.(Vystouple, 2003).

Backgourndi teorik/Rishikimi i literaturës dhe gjenerimi i hipotezave

Siç edhe është përshkruar më sipër, konteksti institucional i decentralizimit fiskal nënkupton mbi të gjitha zhvillim ekonomik, por dhe këtu ka këndvështrime të

ndryshme. Ndërsa disa autor kanë një qasje optimiste dhe prezantojnë e mbështesin një raport pozitiv lidhjeje mes decentralizimit fiskal dhe zhvillimit ekonomik vendor (Oates, 1993; Yilmaz 1999; Iimi, 2005), autor të tjerë si (Xie, Zou. 1999) kanë gjetur evidenca të ndryshme. (Bodman, P; Heaton K.A and Hodge, A. 2009)

Ne mund të shikojmë thellë brenda kushteve për zhvillim ekonomik dhe të vlerësojmë masën se cilat nga reformat decentralizuese janë udhëhequr apo drejtuar pikërisht tek zhvillimi vendor. (Leonardo G.Romeo, 2003)

Për zhvillimin ekonomik vendor nuk ka një definicion të vetëm, ashtu siç nuk kishte edhe një definicion për decentralizimin. Sipas (Çapkova, S. 2005) ai mund të përmbledhet në këtë fjali:

“Përgjithësisht, zhvillimi ekonomik vendor prezanton një strategji të gjerë në të cilën aktorët dhe institucionet vendore përpiqen të përdorin në mënyrën më të mirë, resurset vendore, për ruajtjen dhe krijimin e vendeve të punës si dhe forcimin dhe promovimin e aktiviteteve të bizneseve” Çapkova, S.(2005).

Shqipëria, për arsye të shumta që nuk janë objekt i kësaj teme, klasifikohet si një vend me ekonomi në ndryshim (UN. 2012). Në mënyrë të veçantë, në nivele të ulëta është gjendja ekonomiko-sociale në disa zona më pak të zhvilluara të vendit dhe në mënyrë më të dukshme kjo evidentohet në zonat rurale apo edhe në disa degë të ekonomisë që kanë mjaft ndikim në nivelin e ulët ekonomiko-social në shkallë vendi (Banka Botërore, 2014).

A kanë efekt këto politika decentralizuese dhe sidomos decentralizuese fiskale sa i përket vendeve që ekonomitë e tyre i përkasin grupit të ekonomive në zhvillim apo në ndryshim? Mund të themi se në përgjithësi politikatat e parimet e Bashkimit Evropian sa i përket subsidiaritetit, pra vendimmarrjes sa më afër përfituesit të shërbimit, harmonizimit fiskal dhe kontrolleve stabilizuese, janë duke demonstruar gjithashtu efekte në politikatat e ekonomive në zhvillim dhe në ato në ndryshim. (Shah, A. 2004).

Indikatorët bazë që matin edhe decentralizimin fiskal ashtu si dhe në vendet e Evropës lindore dhe asaj Juglindore pra edhe në vendin tonë, kanë qenë pjesë e monitorimit të vazhdueshëm nga institucione dhe partnerë ndërkombëtar. Treguesit e performancës së decentralizimit fiskal si: shpenzimet vendore si % e PBB, të ardhurat vendore si % e PPB, shpenzimet dhe të ardhurat vendore si % e të ardhurave kombëtare janë monitoruar dhe raportuar nga institucione dhe partnerë ndërkombëtar si WB, USAID, PNUD, KE, NALAS etj. Për këto indikatorë flitet dhe në studimet ndërkombëtare të cilët përpiqen të matin autonominë apo decentralizimin fiskal. (Akai, N and Sakata , 2002).

Ka shumë rëndësi të kuptohet dhe vlerësohet në mënyrë të gjerë zhvillimi ekonomik vendor i cili në vetvete përfshinë të gjithë përpjekjet dhe veprimet që bën komuniteti për të përmirësuar kushtet ekonomike-shoqërore dhe cilësinë e jetesës së banorëve përkatës. Sipas Akai dhe Sakata (2002) por edhe Stansel (2005), të cilët në studimin e tyre janë bazuar në veçimin dhe ndarjen e të dhënave në shtetet dhe në zonat metropolitane të SHBA-ve, nxjerrin konkluzion që decentralizimi fiskal kontribuon pozitivisht në rritjen ekonomike. (Akai, N and Sakata, M. 2002), (Stansel, D. 2005).

Për zhvillimin ekonomik janë bërë dhe po bëhen hapa të rëndësishëm në shkallë vendi, nga ana tjetër është punuar jo pak për programe zhvillimi rajonale, si dhe për programe zhvillimi të veçanta vendore. Megjithatë, organet e qeverisjes vendore janë në fazën e konsolidimit të këtij funksioni pasi edhe baza ligjore sektoriale ka

munguar. (PLGP/USAID. 2012).

Qeveritë qendrore nuk kanë qenë të interesuara të heqin dorë nga funksionet e tyre dhe t'i decentralizojnë ato për t'i dhënë më shumë kompetencë dhe resurse qeverisjes vendore dhe ky është edhe një nga paradokset që i ndodh procesit në çuarjen përpara të reformave decentralizuese dhe se ato janë të nxitura nga sipër më shumë se sa duhej të ishin të nxitura nga poshtë. (Boussuyt, J. & Goullid, J. 2000).

Por, "Konteksti institucional i decentralizimit fiskal nënkupton mbi të gjitha zhvillim ekonomik, natyrën e sistemit ligjor, procesin e vazhdueshëm të reformave ekonomike dhe politike, organizimin e institucioneve monetare dhe financiare, dhe tensionet që dalin nga dallimet etnike, fetare, apo ekonomike" (Wildasin, D. 1997), gjithashtu "Decentralizimi fiskal, pra caktimi i funksioneve shpenzuese dhe burimeve e të ardhurave ka një ndikim të dukshëm për qeverisjen dhe cilësinë e qeverisjes" (Humphlick, Frannie & Antonio Estache, 1995). Këto përcaktime tregojnë qartë rëndësinë që ka decentralizimi fiskal në konsolidimin e autonomisë vendore në përgjithësi dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik vendor në veçanti.

Duke përdorur definicionin e autonomisë si një kombinim të fuqisë për nisma dhe një imuniteti për kontrolle nga lart (Clark, 1984: p195-208), ne mund të shikojmë më thellë, brenda kushteve për zhvillim vendor dhe vlerësimin të shkallës, se cilat reforma decentralizuese janë drejtuar nga ose përçarur tek zhvillimi vendor.

Decentralizimi fiskal si instrument i zhvillimit ekonomik vendor

In terms of employment, only 45 percent of the organizations that participated in the report offered part time jobs. The other 55 percent of the organizations offered full-time jobs only. Despite this fact, the number of employees that work on part-time

basis is very small compared to the number of employees that work on full-time. This is in relation to the fact that only 2.9 percent of the total employees work on part-time basis. In terms of employment by gender, the report has established that 49.6 percent of male employees and 50.4 percent female employees work in these organizations. With regard to this issue, the report indicates that Albanian organizations have made significant progress in addressing this issue.



With regard to performance that was measured in terms of annual turnover and VAT payment, 20 percent of the organizations rated “very good” while 45 percent of them rated “good.” Another 30 percent of the organizations rated average while one company did not rate itself. Therefore, it was excluded in this part of analysis. This affected the results of performance by 5 percent, but it did not affect the results (Sims, 2007).

With regard to education profile for the human resource personnel that work in the organizations under report, 65 percent of them have high education profiles while 35 percent of them have medium education profiles. When managers were asked whether they had conducted any form of training on their employees, 70 percent of the managers said that they had conducted such trainings. On the other hand, 30 percent of the managers said that they had not conducted such training. In terms of experiences, 50 percent of the managers that participated in the report said that they were experienced while 45 percent of them said that they were not experienced. Out of these managers, only one manager did not answer this question. The report revealed that 35 percent of these organizations had offices to deal with human resource issues, 40 percent had human resource staffs while 20 percent of these organizations did not have offices or human resource staffs to deal with human resource issues. In terms of organizational structures in HR, 20 percent of the organizations had human resource managers while 75 percent of these organizations had human resource employees to deal with human resources issues. For the organizations that had human resource managers, the report established that employees were supposed to go through assistants before they could see the general managers.

In terms of the number of staffs that work in human resource facilities in the organizations under report, the report established that there were only 1569 of these

staffs. This composed 4.95 percent of all employees that work in the organizations under report. When asked to rank three human challenges that are expected to face Albanian organizations in the next three years, 50 percent of the managers ranked changes in performance of managerial staffs to be the first most challenge. Another 50 percent of these managers ranked getting talented managers to be the second most challenge that Albanian organizations will face in the next three years. On the other hand, 60 percent of the managers ranked employee training and development to be the third most challenge that Albanian organizations will face in the next three years (Albright, Winston, & Zappe, 2011). Over all, the report established that 60 percent of human resource facilities for the organizations under report were tasked with daily administrative jobs such as salaries and employees' benefits. The report also established that 25 percent of these facilities were tasked with mediating and resolving conflicts among employees while 15 percent of these organizations were tasked with formulating business strategies for the organizations.

Recommendations

1. The above data analysis indicates that only 4.95 percent of the staffs that work in the organizations under study in this report are based in human resource facilities. In relation to this fact, this report recommends that it would be prudent to increase this number so that Albanian organizations can deal with human resource issues more efficiently.
2. The above data analysis also shows that about 20 percent of organizations under investigation in this report do not have human resource facilities or even human resource personnel to deal with human resource issues. This means that human resource issues in these organizations might not be handled professionally because there are few employees in these organizations to deal with these issues. In relation to this fact, this report recommends that all Albanian organizations should have human resource personnel offices or human resource staffs to deal with human resource issues (Durai, 2010). This can improve human resource management in Albania.
3. It is largely evident from the above findings that very few of the organizations under report have human resource offices or personnel that deal with employment issues among other pertinent human resources issues in Albanian organizations. This means that a lot of human resource issues in Albanian organizations might go unresolved. In order to deal with such issues, this report recommends that Albanian organizations should advance their human resource facilities so that they can be able to deal with human resource issues amicably. The report presumes that even if human resource issues in Albania are dealt with, majority of them might not be dealt with amicably. For this reason, it would be prudent to advance human resource facilities in Albania to deal with human resource issues amicably (Lawler *et al.*, 2012).
4. The research has established that three challenges namely changes in performance of managerial staffs, developing employees' talents through trainings and acquiring talented managers will be the three top most challenges that Albanian organizations will face in the next three years. In relation to this finding, this report

recommends that these three issues need to be addressed as soon as possible. Consequently, the report recommends that further researches should be conducted to establish how these organizations may deal with the challenges in question. The report also recommends that human resource management staffs in Albanian organizations need to devise various human resource practices to deal with these challenges before it is too soon to deal with those issues.

Conclusion

This study made a conclusion that people have insignificantly no proper awareness of the importance of HRM functions. Moreover, the study concluded that the most common model in the Albanian organizations was expected to be the traditional model Administrative. A good number of Albanian organizations do not understand the critical functions that managers and human resource practices play in resolving HR management issues. Data analysis supports this claim by showing that 20 percent of the twenty organizations that participated in the report had no human resource offices or even human resource personnel to deal with human resources issues. The researcher makes this conclusion based on the presumption that at this age organizations should not be slow in adopting human resource practices. This notwithstanding, the report demonstrates that a significantly good number of these organizations have made effort towards human resource practices. This is in relation to the fact that the report has established that 35 percent of these organizations have offices that deal with human resource issues and 40 percent of them have human resource staffs to deal with human resource issues. Finally, in relation to the fact that about 50 percent of the managers that participated in the report cited changes in performance of managerial staffs to be the first most likely challenge that Albanian organizations might face in the next three years, this is a challenge that need to be addressed. In addition, talent development as well as employee training and development are other human resource issues that Albanian organizations need to deal with. In terms of insight, this report proposes that further researches need to be conducted regarding how Albanian organizations need to deal with human resource challenges they might face in the near future.

References

- Appelbaum, E., Bailey, T., Berg, P. and Kalleberg, A (2000). *Manufacturing advantage: why high performance work systems pay off*. Cornell University Press, Ithaca, NY.
- Butler, P., Felstead, A., Ashton, D., Fuller, A., Lee, T., Unwin, L and Walters, S. (2004). *High performance management: a literature review*. Centre for Labour Market Studies, University of Leicester.
- Fisher, D. 1989. Current and Recurrent Challenges in HRM. *Journal of Management*. Vol: 15 pg. 157-178.
- Fried, Y., & Ferris, G. R. (1987). The validity of the Job Characteristics Model: A review and meta-analysis. *Personnel Psychology*, 40(2), 287-322.
- Guest, D (1987). Human resource management and industrial relations. *Journal of Management Studies*, 24:5, 503-521.
- Guest, D., Conway, N. and Dewe, P., 2004, "Using Sequential Tree Analysis to Search for

- 'Bundles' of HR Practices.", *Human Resource Management Journal*, 2004, Vol. 14 Issue 1, p79-96.
- Kyle Bruce, "Henry S. Dennison, Elton Mayo, and Human Relations historiography" in: *Management & Organizational History*, 2006, 1: 177-199.
- Lepak, D and S. A. Snell, 1998. Virtual HR: Strategic HRM in the 21st Century. *Human Resource Management Review*. Vol: 25. p 91-99.
- Albright, S., Winston, W., & Zappe, C. (2011). *Data analysis and decision making*. Mason, Ohio: South-Western/Cengage Learning.
- Durai, P. (2010). *Human resource management*. Chennai: Pearson.
- Lawler, E. et al. (2012). *Effective human resource management: A global analysis*. Stanford, Calif: Stanford Business Books, an imprint of Stanford University Press.
- Sims, R. (2007). *Human resource management: Contemporary issues, challenges and opportunities*. Greenwich, Conn: Information Age Publ.

Appendix

Questionnaire

The following questionnaire is part of my work.

This questionnaire also would come to help and your firms or state institutions to better understand the importance and human resources department in a business organization. I would be grateful if you would help me with the information that is required to collect the questionnaire.

I. This section seeks to obtain the basic information needed for basic activities of your enterprise or state institutions

The Company

1. Name

2. The number of full-time employees: _____

The number of part-time employees: _____

Male / female in your company _____

You Average income _____

4. Industries or sector where the enterprise operates _____

5. Please specify the products or services your company's main
_____HRM model.

6. What is the legal status of your company?

Partnership

Limited liability Company (Ltd)

Joint venture

Other (please specify)

7. Is your company certified with an ISO certificate for its products?

Yes No

8. What is the level of performance of your organization (this level, determine on the basis of your annual turnover or VAT paid)

Very good

Good

Average

Weak

Very poor

9. IF is weak can list the reasons why?

II In this section would like to receive information for HR management personnel and more for those who are responsible of this department.

10. What is your education profile?
 High Medium
11. Have you conducted training for employees / HR?
 Yes No
12. What is your experience in positions of employees / HRM?
13. What is the shape of the structure that deals with employees / HR in your organization?
 Office sector department director other (specify)
14. How is called structure
 Employees HR Staff other
15. How many employees at this facility personnel / HR at your firm?
16. What is the organizational structure of the office / department personnel / HR? HRM?
 Manager / director
 Employees
 Other
17. Does your organization have a:
 Business Strategy
 Strategy for Personnel / HR
 Other
18. In order to solve the problems with human resources general manager sees you
 Assistance partner other
19. HR in your organization is responsible for:
1. Daily administrative relating to the presence, movement; calculation of salaries and employee benefits?
 2. Mediation and Conflict Resolution with employees
 3. Modification of policies on employment, assessment development, compensation and benefits and employee occupational
 4. Consulting and contribution to the organization's strategies
20. What you consider as the most important challenges (rank 3) for HRM in your org next 3 years?
 Changes in managerial staff the organization's performance
 Talent managers Employee Engagement
 Training and development
 Other
 Organizational developments
 Leadership Development

Tipare të arkitekturës së kishave të Vithkuqit në Shekujt 17, 18

Rozela Dhimgjini

Vithkuqi është një nga vendbanimet e Shqipërisë Juglindore, që dëshmojnë zhvillimin e shpejtë ekonomiko-social gjatë gjysmës së dytë të shek. 17 dhe më shumë se gjysmës së parë të shek. 18.

Sipas kodikut të Korçës, Vithkuqi në gjysmën e dytë të shek. 18 “kishte afërsisht tetë mijë banorë. Kjo shifër pretendohet nga ekzistenca e dhjetë kishave dhe dy manastireve “ (Rrembeci, 8-9).

Për të gjykuar më saktë mbi arsyet që shoqërojnë këtë zhillim të vrullshëm ekonomiko-politik, në mungesë të dokumentaionit të trashëguar, do përpiqemi të analizojmë disa nga strukturat ndërtimore të objekteve të sipërpërmendura që ruhen ende.

Stili arkitekturor, cilësia, teknikat dhe materialet e ndërtimit janë tregues i rëndësishëm jo vetëm i nivelit ekonomiko-politik të shoqërisë në një periudhë të caktuar, por edhe atij social dhe kulturor.

Arkitektura pasbizantine, përbën një kapitull të veçantë studimi të kulturës ndërtimore¹. Shumë objekte të kultit të krishterë që nga shekulli i XVI trashëgojnë mjaft tipare estetike dhe elementë konstruktivë të periudhës bizantine, e megjithatë ndiehet qartë përpunimi dhe përshtatja e strukturave ndërtimore me kushtet e reja ekonomiko-politike të vendit (Meksi & Thomo, 1982, 102).

Duke nisur nga gjysma e parë e shek. XVI, rifillojnë të ndërtohen faktore të kultit të krishterë. Kishat e kësaj periudhe janë të thjeshta e modeste, ndërtohen me materiale bazike (afër vendndodhjes) dhe ngrihen kryesisht në vende të thella e të largëta. Megjithatë, ekzistenca në këtë shekull ende e një numri të madh të popullsisë vendase me besim fetar të kultit të krishterë, çoi në rindërtimin e kishave edhe në disa qytete, kryesisht të paislamizuara.

Arkitektura pasbizantine, cilësinë më të lartë të shprehjes estetike dhe teknikes ndërtimore e arrin në fund të shek. XVII e më tepër në shek. XVIII². E përbashkëta e “detyrueshme” që kanë kishat e kësaj periudhe, është paraqitja e tyre strukturale shumë e thjeshtuar në pamje të jashtme³. Forma e brendshme e mbulesës së naosit, një apo tre nefësh, (strukturë e larmishme harqesh, qemeresh apo kupolash) nuk shfaqet jashtë, por qendron detyrimisht e fshehur nga çatia dy apo treujëse, që i jep ndertesës pamjen e një bazilike. Kjo pamje nuk mund të tjetërsohet apo ndikohet as nga ngritja e tamburit në pjesën qendrore, që mbetet elementi i vetëm kryesor në formulimin arkitektonik të jashtëm.

Kishat e Vithkuqit të kësaj periudhe, nga gjendja fizike që të mundësojnë përshkrimin e hollësishëm struktural dhe arkitektonik e që njëkohësisht përbëjnë objekt studimi të pikturës murale të kultit, janë Kisha e Shën Mëhillit, Kisha e Shën Mërisë, Kisha e Shën

¹ Një material të detajuar mbi ndërtimet e kultit të krishterë gjatë kësaj periudhe në vendin tonë, na paraqet P.Thomo, Kishat Pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë, 1998.

² Kishat e para u ngritën në shek. XVII e më tepër në shek. XVIII, pasi turqit kishin lëruar urdhërin për ndalimin e ndërtimit të kishave të krishtera. G.Koch, Albanien, Kunst und Kultur im Land der Skipetaren. Köln 1989. f.194.

³ Ishte e detyrueshme nga sunduesit turq, që kishat të mos ishin të dallueshme nga jashtë, fakt që pengonte ngritjen e kupolave. G.Koch, f.194.

Pjeter dhe Pavlit, Kisha e Shën Kozmait dhe Damjanit në Manastirin e Shën Pjetër dhe Pavlit, si dhe Kisha e Shën Gjergjit (duke i renditur në mënyrë kronologjike).

Kisha e Shën Mëhillit

1. Kisha e Shën Mëhillit në Vithkuq është kisha më e vjetër e më madhe, që ruhet nga kjo periudhë. Kjo kishë është ndërtuar në vitin 1682, sipas mbishkrimit në portën jugore të saj:

Asht ndertue prej themeli në vitin 1682 dhe asht pikturue ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuem i taksiarkëve te gjithëmëdhej, Mihael dhe Gabriel me shpenzimet e të krishtenëve që gjinden në këtë qytet dhe me kontributin, mundimin dhe lodhjen e prift Stavorit, ikonom dhe epitrop (në kohën) e episkopimit të gjithëshejtit Mitropolitit të Kosturit Zotit Krisanth, (në kohën) e priftnisë së priftenve të shumëdevotshëm, në vitin 1728, tetor 1 (Popa, 1958, 225).

Në këtë mbishkrim të kishës evidentohen disa të dhëna të rëndësishme që duhen analizuar:

1-Për ndërtimin e saj kanë kontribuar të gjithë të krishterët e Vithkuqit (*element shumë i rëndësishëm social*).

2-Ky vendbanim konsiderohej „qytet“ (*informacion i rëndësishëm për urbanologjinë shqiptare*).

3- Ndërtimi i kishës së Vithkuqit varej nga Mitropolia e Kosturit (*detaj i rëndësishëm gjeopolitik, që mund të studiohej dhe më tej*).

Kisha përbëhet nga tre pjesë kryesore: naosi, narteksi dhe hajati. Bërthamë kompozicionale arkitekturore si edhe shkarkesë gravitacionale strukturore është kupola qendrore e naosit me përmasa të përgjithëshme 15.5 x 9.5m. Naosi përbëhet nga tre nefe, ai qendror dhe dy anësor. Nefi qendror ka dyfishin e gjerësisë së nefeve anësore dhe është më i lartë. Nefet ndahen nga njëri-tjetri nga dy akse gjatësore kolonash. Rrjeti i kolonave lidhet në të dy drejtimet me harqe, të cilët ngrihen në drejtim të mureve jugore e perëndimore të kishës, duke krijuar berthama katrore. Mbi këto bërthama (rrjet trarësh) shkarkojnë kupolat që mbulojnë nefet anësore. Nefi qendror mbulohet me qemer cilindrik gjatë gjithë gjatësisë së tij, pesha e së cilit mbështetet në kolonat ndarëse. Pas aksit të tretë të kolonave (duke numëruar nga perëndimi) ndërpriten nefet gjatësore nga një nef tërthor sa gjerësia e naosit, i cili krijon në prerjen me nefin qendror një bërthamë, mbi të cilën shkarkon kupola qendrore. Nefi qendror mbyllet në anën lindore të kishës me një apsidë e cila del jashtë perimetrit të tij dhe shkarkon mbi katër pilastra dhe dy gjysëmpilastra.

Narteksi, që shtrihet në anën perëndimore duket qartë që është shtuar më vonë dhe ndryshon nga naosi si nga teknika e ndërtimit ashtu dhe nga trajtimi i hapsirës së brendëshme (Thomo, 1998, 48).

E gjithë kisha mbulohet nga një çati të gjerë dyujëse me rrasa guri, e cila fsheh dhe nuk përcjell jashtë asgjë nga struktura e brendëshme shumë e larmishme. I vetmi element volumetrik i eksterierit që transmeton diçka nga brenda kishës është apsida lindore me elementë shumë të kursyer dekorativ. Pilastrat e saj lidhen ndërmjet tyre, ashtu si edhe dritaret e vogla, me harqe me majë, që përfundojnë me kornize guri të gdhendur me kujdes (krahasuar me muraturat e tjera). Muratura e kishës është relativisht e rregullt, me gurë të latuar dhe skuadruar kryesisht vetëm nga ana a jashtme. Blloqet e gurit duket se janë prej smërçi te zonës perreth ashtu si edhe

materiali lidhës ("arasan" rërë e ashpër nga përrrenjtë dhe gurët e thërmuar, lidhur me gëlqere të vjetëruar).

Në pjesën jugore të kishës, para hyrjes së saj, shtrihet përgjatë gjithë fasadës hajati i hapur. Pësia e rëndë e çatisë masive me rrasa guri që mbulon 2/3 e lartësisë së kishës balancohet këndshëm nga harkada elegante, që hapet mbi trembedhjetë kampata me kolona të holla prej guri në forme cilindrike.

Përpara pamjes jugore të kishës shtrihet një shesh i gjerë, i rrethuar me muraturë guri. Në anën veriore të kishës ndodhen varrezat e vjetra të fshatit.

Vlen të theksohet, se kisha e shën Mëhillit është kisha e parë e tipit bazilikal me hapësira të lidhura mire, q mbështeten mbi një koncept të qartë kompozicional me permasa të mëdha. Kjo kishë i paraprin ndërtimeve të rëndësishme bazilikale të kishave të Voskopojës, të ndërtuara në gjysmën e parë të shek. XVIII⁴.

Kisha e shën Mërisë

Kisha e shën Mërisë është bazilikë njënefëshe me kupolë. Përmasat e saj janë 7,90 x 4,80m. Dy çifte gjysëmpilastrash që dalin nga muri verior dhe jugor, lidhen ndërmjet tyre me sistem harqesh, që ndajnë hapësirën e brendshme në tri pjesë jo të barabarta. Mbi pjesën më të madhe, atë qendrore, ngrihet kupola, ndërsa nga pjesa lindore hapet apsida që mbyll zonën e altarit. Muri i jashtëm i apsidës dekorohet me shtatë harqe me majë në formë fund lundre, motiv të cilin e gjejmë dhe në kishën e shën Mëhillit në Vithkuq. Kisha mbulohet me një çati të gjerë treujëse, që fsheh strukturën e brendshme dhe kupolën.

Në pjesën perëndimore (ashtu si edhe në disa kisha të tjera të Vithkuqit), në një periudhë më të vonë është shtuar narteksi (Thomo, 46), ndërtim shumë modest, pa tavan, i mbuluar vetëm me çati druri. E gjithë kisha ka vetëm dy dritare të ngushta në murin jugor dhe në apsidë, të cilat bëjnë që brenda saj të depërtojë shumë pak ndriçim natyror.

Datimi i saktë i kishës nuk është i ditur, pasi mbi muret e saj nuk ruhet, si rëndom, ndonjë mbishkrim që do të ndihmonte në përcaktimin e tij. Por duke krahasuar teknikën dhe materialet e ndërtimit, mendohet që kjo kishë të jetë e ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. 17të.

Veç të tjerash, edhe në këtë kishë, si në atë të shën Mëhillit në Vithkuq, narteksi është i mëvonshëm, ndërsa për dekor përsëritet motivi i harkut në formë fund lundre⁵.

⁴ Tre bazilikat e mëdha të Voskopojës, ajo e Shën Mëhillit (1720-25), e Shën Kollit (1721-50) dhe e Shën Thanasit (1724-45).

⁵ R. Rousseva e daton kishën e Shën Mërisë në Vithkuq në shek. 18. Shih: *Iconographic Characteristics of the Churches of Moschopolis and Vithkuqi (Albania)*, Makedonika 35, (2005-2006), fq.163-181, f.164. P.Thomo, në: *Kishat pasbizantine në Shqipëri e Jugut*, f.47, e daton kishën në gjysmën e dytë të shek. 17. Ai bazohet në datimin e tij, në formën e kompozimit planimetrik e volumor si dhe në motivin dekorativ të pamjes së jashtme të apsidës, atë të harkut në formë fund lundre, që gjendet dhe në kishën e Shën Mëhillit në Vithkuq, të vitit 1682. Për mendimin tim, struktura ndërtimore më e larmishme dhe e rregullt e kishës së Shën Mëhillit, duhet të jetë e një periudhe më të vonë se ajo e Shën Mërisë. Të dyja kishat kanë muratura me blloqe të punuara guri smerç. Mënyra shumë e ngjashme e ndërtimit nuk e përjashton mundësinë e të njëjtit grup ndërtuesish.

Manastiri shën Pjetër dhe Pavlit

Manastiri ngrihet mbi një kodër në hyrje të fshatit Vithkuq, në verilindje të tij, para Urës së Zotos. Pozicioni i tërhequr nga fshati, por shumë dominues falë lartësisë së vendndodhjes, i përshtatet më së miri konceptit strategjik të pozicionimit të manastireve. Ky ansambël ndërtimor, përmban brenda gjurmës së sotme të murit rrethues, kishën e Shën Pjetër dhe Pavlit, ndërsa rreth 20m jashtë tij, kishën e vogël të Kozmait dhe Damianit, e cila shërbente edhe si varrezë për murgjit e manastirit⁶. Përpara rrënimt nga Lufta e Dytë Botërore, referuar gjurmëve si edhe disa fotove të trashëguara, në tre anët e oborrit të brendshëm, para hyrjes së kishës, ngriheshin konakët e manastirit. Ato ishin ndërtime dy-tre katëshe, të pozicionuara në formë U-je, dhe funksiononin si ambiente banimi e shërbimesh për murgjit e manastirit (Thomo, 51). Nga materiali i vjetër fotografik, është vënë re se ato ishin ndërtim i kujdesshëm e i kombinuar, prej guri dhe druri, me vlera dhe elementë të shumtë arkitektonikë (Papakozma, 81). Historiku i ndërtimit të manastirit trajtohet në shkrimin e A. Papakozma, i cili është mbështetur në dorëshkrimet e arkivit personal të I.M.Qafëzezit⁷. Një përmbledhje të datimeve dhe ndërtimeve kryesore rreshton dhe P.Thomo në trajtimin e tij të këtij kompleksi (Thomo, 50-55).

Kisha e shen Pjeter dhe Pavlit

Kisha e manastirit të Shën Pjetër dhe Pavlit në Vithkuq është ndërtimi kryesor i kompleksit. Ky objekt është i tipit bazilikal me kupolë të evidentuar, që shkarkon mbi një planimetri të brendëshme në përmasat 14.70 x 8.0m. Hyrja për në kishë nis me një portik të vogël në qoshen veri - perëndimore. Bazilika vetë përbëhet nga naosi, që ndahet nga tre nefe gjatësore, ku ai i mesit është më i lartë e më i gjerë nga ato anësore⁸. Nefet ndahen nëpërmjet kolonash. Bazilika ndërpritet në mes nga një nef tërthor, i cili nuk është më i gjatë se gjerësia e kishes. Në ndërprerjen e nefit qendror gjatësor me atë tërthor, kryqëzimi harqeve që mbështeten nga kolonat në muraturë dhe anasjelltas, formojnë një sistem kuadratik traresh mbajtës, mbi të cilët shkarkon tamburi i lartë, që mbulohet nga kupola kryesore. Ndryshe nga kishat e tjera, kupola qendrore jo vetëm që është element kryesor arkitekturor dhe statik, por evidentohet si i tille dhe në pamjen e jashtme.

Nefi qendror është i mbuluar me qemer cilindrik, që fillon e ngrihet nga dy ekstremet

⁶ Mbi manastirin e Shën Pjetër dhe Pavlit gjejmë të dhëna historike e arkitektonike në përshkrimin „Manastiri i Shën Pjetër dhe Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit“, nga Aleko Papakozma, Monumentet, Nr. 1, 1983, f. 77-85. Po ashtu dhe në P.Thomo, „Kishat Pاسبizantine në Shqipëri e Jugut“, Tiranë 1998, f. 50-54.

⁷ Nga “Kontribut në historinë e qytetit Vithkuq. Themelimi dhe ndërtimi i manastirit Shën Pjetër dhe Pavli” (1956, Nr.1, fq.1), një doreshkrim në arkivin personal të I.M.Qafëzezit, janë nxjerrë të dhënat mbi historikun e ndërtimeve që dihen mbi këtë manastir. Aty është mësuar, se manastiri kishte tre etapa kryesore ndërtimi, në vitet 1709-1710, 1736 dhe 1759-1764. Në 1709 është themeluar ky manastir, dhe po në këtë vit janë ndërtuar muret dhe kolonat. Në etapën e dytë, më 1736, është ndërtuar një kishë e vogël, e quajtur „Anagjirve“ ose „Shën Kozmait dhe Damjanit“. Një kishëz e vogël, e cila është pikturuar më 18 Maj 1750. Në etapën e tretë të njohur ndërtimore, në vitin 1759, u rindërtua kisha që ndodhej brenda manastirit Shën Pjetër dhe Pavli. Ajo vazhdon me pikturimin e kishës në vitet 1763-1764. Më 1764 përfundon e gjithë puna në këtë manastir. A.Papakozma, f.78, 79.

⁸ Në pjesën perëndimore të kishës, gjendej më parë dhe narteksi. Sot ruhen vetëm gjurmët e tij. A.Papakozma, f.82.

për çdo kambat drejt qendrës, ndërsa nefet anësore mbulohen me kupola të vogla, që mbështeten mbi rrjetin kuadratik të trarëve, që formohet nga ndërpreja e harqeve lidhës ndërmjet kolonave dhe mureve të jashtme.

Kisha e shën Kozmait dhe Damianit

Kjo kishë e vogël ndodhet pranë sheshit të varrezave të manastirit dhe ka funksionin e qimiterit. Ajo është ndërtuar rreth 20m jashtë murit rrethues të manastirit. Kishëza është 12m e gjatë dhe 4,5m e gjerë. Është konceptuar me 2 kate, duke shfrytëzuar pjesërisht terrenin e pjerrët mbi të cilin është ngritur. Të dyja katet e kishës mbulohen nëpërmjet qemerësh cilindrikë dhe kanë lartësi të ndryshme. Kati i poshtëm arrin në lartësinë maksimale 2m ndërsa kati i sipërm është 3,30m i lartë.

Kati i sipërm i ndërtesës përbëhet nga naosi dhe narteksi me një gjatësi prej 3,40m. Në anën lindore të narteksit gjendet një nishë apsidale me dy dritare të vogla, që shoqërohet nga dy nisha të tjera me madhësi të ndryshme. Edhe naosi, hapsira kryesore e kishës, ka dy dritare të vogla në murin verior. Gjatësia e naosit ndërpritet më tej nëpërmjet një ikonostasi, që kufizon pjesën e altarit. Ikonostasi është prej druri, ka dy hyrje dhe kishte tre ikona të mëdha, vepra të Kostandin Shpatarakut⁹. Në njërën prej ikonave gjendet dhe nënshkrimi „Dora e Jerodhjakon Kostandinit prej Shpatit“ si dhe datimi 1748 (Popa, 1955, 211).

Lidhja ndërmjet dy kateve bëhet nëpërmjet shkallës shumë të pjerrët, që del sipër në pjesën e narteksit. Madhësia e katit të poshtëm është sa kati i sipërm pa pjesën e narteksit. Ky kat është konceptuar pa asnjë dritare, por ka vetëm një çarje të vogël për ajrosje në murin lindor.

Arkitektura e kishës së Shën Kozmait dhe Damianit tregon karakteristikat tipike të qimiterëve, të cilat normalisht janë dy katëshe dhe kanë pak dritare (Stoyanova-Cucco, 1992, 281-308).

Kisha e Shën Gjergjit

Kisha e Shën Gjergjit në Vithkuq paraqet një tip më të evoluar ndërtimor dhe arkitekturor. Bazilika tre nefëshe, ka nefin qendror më të gjerë dhe më të lartë se ato anësor. Nefi i ngritur simetrikisht mbi dy të tjerët ofron mundësinë e dritareve në pjesën e sipërme, përmbi çatitë e nefëve anësore. Në pjesën lindore të nefit qendror hapet apsida me të njejtën gjerësi sa ajo e këtij nefi. Apsida është e dekoruar me gjysëmpilastra të gjatë, që formojnë ndërmjet tyre nike të harkuara në pjesën e sipërme.

Naosi i kësaj kishe nuk ndërpritet nga nefe tërthor e kisha nuk ka kupolë. Kjo bazilikë trenefëshe ka përmasat 12 x 9,80m. Në pjesën perëndimore te naosit duket qartë narteksi i shtuar më vonë,¹⁰ disi më i ngushtë, me teknikë më të varfër dhe jo i përmasuar mirë. Përgjatë tërë fasadës jugore shtrihet hajati i hapur.

Muratura relativisht e rregullt, me blloqe guri smërçi, është përforcuar në disa rreshta me breza prej trarësh druri. Kisha mbulohet në pjesën qendrore me çati katërujësë dhe nefet anësore me çati njëflegërshe me plloça guri.

⁹ Ikonat gjenden sot në Muzeun Mesjetar të Korçës.

¹⁰ Në datimin e narteksit në një periudhë më të vonë, bazohet P.Thomo në faktin se narteksi është më i ngushtë se naosi dhe nuk harmonizohet me të. P.Thomo, f. 55.

Kisha nuk ruan mbishkrime, por nga teknika më e strukturuar e ndërtimit, mendohet të jetë ndërtuar më vonë se kishat e lartpërmendura, në gjysmën e dytë të shek. XVIII (Thomo, 56).

Tipare arkitekturore të kishave të Vithkuqit

Në bazë të vëzhgimit të kishave të lartpërmendura, mund të themi se kishat e periudhës nga gjysma e dytë e shek. XVII deri në gjysmën e dytë të shek. XVIII, pra një periudhe afro 100vjeçare, janë kisha të tipeve të ndryshme, diku shfaqen si bazilika trenefëshe (kisha e Shën Mëhillit, e Shn Gjergjit, ndërsa diku tjetër si sallë një nefëshe me kupolë (kisha e Shën Mërisë), herë bazilikë me kupolë (kisha e Shën Pjetër dhe Pavlit) e herë kishëz me funksion të përcaktuar (si qimiteri i Shën Kozmait dhe Damianit). Pothuajse të gjitha kishat (veç qimiterit të manastirit) përmbajnë narteks para naosit (të shtuar në një periudhë më të vonë, si në kishën e Shën Mëhillit, Shën Mërisë apo Shën Gjergjit) dhe hajatin e hapur (perveç qimiterit)¹¹. Mënyra ndërtimore e këtyre kishave është shumë e ngjashme, me blloqe guri smerç te zonës, që dallojnë më tej nga rregullsia e ndërtimit apo nga shtimi i elementëve struktural (si traret e drurit në kishën e Shën Gjergjit).

Dekoret ndërtimore janë te pakta dhe të përqendruara në pjesën e apsidës. Ndriçimi është kryesisht i dobët dhe vjen nga dritare të vogla e të pakta në numër. Madhësite e tyre variojnë nga kisha në kishë dhe nuk lidhen me periudhën e ndërtimit.

Tiparet e përbashkëta në teknikat e ndërtimit të objekteve që trajtuam më sipër, tregojnë se nuk kemi të bëjmë me një stil të mirëfilltë arkitekturor apo kanunor kishtar të kësaj periudhe. Përcaktues në fizioninë e tyre është kryesisht mundësia e kufizuar e mjeteve dhe materialeve bazike të ndërtimit, që krijojnë një mënyrë ndërtimi rajonal, me tipare shumë të thjeshta konservative. Kishat nuk dallojnë shumë ndërmjet tyre nga tipologjia ndërtimore por vetëm nga permasat dhe ana funksionale. Këto të fundit kanë ndikuar disi në atë pak "fizionomi arkitekturore" pasi pothuajse të gjitha kanë përdorur të njejtat materiale të zonës, të njejtat teknika, e ndoshta për një kohe të gjatë, të njejtët mjeshtra. Gjithashtu është e dukshme, që nuk gjejmë patjetër një evolucion të mënyrës së konceptimit dhe realizimit në periudhat e mëvonshme.

Bibliografia

- A.Rëmbeci, *The Codex of the Holy Metropolis of Korça*, Albanohellenica nr. 4, 2011.
P.Thomo, *Kishat Pasbizantine në Shqipërinë e Jugut*, Tiranë, 1998.
G.Koch, *Albanien, Kunst und Kultur im Land der Skipetaren*. Köln 1989.
A.Meksi, P.Thomo, *Arkitektura pasbizantine në Shqipëri, Bazilikat, Monumentet Nr. 1*, 1982.
Th.Popa, „Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike“, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Nr. 1, 1958.
R.Rousseva, *Iconographic Characteristics of the Churches of Moschopolis and Vithkuqi (Albania)*, *Makedonika* 35, (2005-2006).
A. Papakozma, „Manastiri i Shën Pjetër dhe Pavlit në Vithkuq, datimi, urbanistika, arkitektura, mjeshtrit e ndërtimit“, *Monumentet*, Nr. 1, 1983.
M.Stoyanova-Cucco, „Monastic Cemetery and Hospital Chapels of the Balkans. Functions and Iconographical Programms“, *Annali di Foscari* 31, fasc.1-2, Rom (1992).

¹¹ Dhe kisha e manastirit të Shën Pjetër dhe Pavlit ka patur më parë një narteks në pjesën perëndimore, nga i cili kanë mbetur sot vetëm gjurmët e tij. A.Papakozma, f.82.

Edukata dhe arsimi në Dibër nga lashtësia deri në periudhën e parë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Fatjon Kica

Abstrakti

Kultura origjinale e etnosit ilir përbën një nga trashgimnitë më të vlefshme dhe interesante, në kuadrin e qytetërimeve të lashta mesdhetare. Ajo veçanërisht në periudhën antike, përfshin edhe aspekte të tilla të përparuara siç janë edukata dhe arsimi. Formimi i tyre ka karakter historik dhe u kushtëzua nga nevojat dhe kërkesat e një shoqërie që kaloi nga bashkësia primitive në një organizim të zhvilluar të tipit skllavopronar. *Në periudhën e Mesjetës rol të rëndësishëm në veprimtarinë kulturore dhe arsimore luajti kisha e krishterë. Kurse me pushtimin osman të këtyre trojeve, filloi gradualisht të përhapet dhe zhvillohet islamizmi nëpërmjet institucioneve të ndryshme fetare dhe kulturo-arsimore.*

Fjalët kyçe: Edukata, Kultura, Arsim.

Hyrje

Në lashtësi, Ilirët dhe rrjedhimisht edhe fisi i penestëve, përbënin një nga popullsitë më të vjetra të Evropës. Formimi i etnosit të tyre është një proces i gjatë historik. Vazhdimësia e banimit pa ndërpreje gjatë gjithë periudhave historike dëshmon se banorët e saj nuk jetuan të izoluar nga krahinat përreth, brenda e jashtë trevës. Në krijimin e lidhjeve ekonomike e kulturore krahinore, ndërkrainore, një rol të madh ka luajtur edhe sistemi rrugorë bashkëkohës i trevës. Vendbanimet e hershme të fiseve “Kala”, “Qyteza”, “Fshatra” etj, që gjenden gjatë gjithë luginës së Drinit të Zi, në zonën fushore dhe malore, si dhe qytetet e mëdha (Oskana, Oenea etj) janë pasqyrë e jetës së gjallë që janë zhvilluar që nga lashtësia deri në ditët tona në truallin e Dibrës.

Ilirët përmenden për herë të parë nga historiani i madh grek Herodoti në shek. V para erës sonë. Pikërisht në këtë kohe, ilirët hynë në dritën e historisë si një popull që dallohej për fizionominë e tij etnike, për zhvillimin e tij kulturor e politik, në mes popujve të Ballkanit. Vendosja e rendit skllavopronar, kalimi i hershëm në jetën urbane dhe formimi i qyteteve të fuqishme në trevat ilire, përcaktoi edhe rolin e veçantë që luajti etnosi ilir në historinë e lashtë të Ballkanit. Kultura origjinale e etnosit ilir përbën një nga trashgimnitë më të vlefshme dhe interesante, në kuadrin e qytetërimeve të lashta mesdhetare. Ajo veçanërisht në periudhën antike, përfshin edhe aspekte të tilla të përparuara siç janë edukata dhe arsimi. Formimi i tyre ka karakter historik dhe u kushtëzua nga nevojat dhe kërkesat e një shoqërie që kaloi nga bashkësia primitive në një organizim të zhvilluar të tipit skllavopronar. Me vendosjen e këtij rendi, edukata kthehet në një veprimtari më të organizuar shoqërore dhe lidhet njëkohësisht me një arsim që ka karakter klasor. Kjo veprimtari ka lënë gjurmë të qarta materiale dhe është dëshmuar drejtpërdrejt nga materiale epigrafike.

1. Edukata dhe arsimi në lashtësi

Nga pikëpamja e kushteve ekonomiko- shoqërore, në të cilat u zhvilluan edukata dhe më pas arsimi, dallojmë dy periudha kryesore:

- **Periudha prehistorike**, ku edukata si veprimtari shoqërore fillimisht lidhet me transmetimin e përvojës së punës, teknikës së prodhimit të veglave të punës, të dijës, të riteve e zakoneve që shkojnë krahas zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

- **Periudha e dytë**, kur edukata dhe arsimi kthehen në veprimtari të mirëfilltë, karakterizohet nga vendosja e rendit skllavopronar, veprimtaria e qyteteve në fushën ekonomike e kulturore dhe dalja e shtetit në fushën politike.

Si rrjedhojë e zhvillimit të brendshëm ekonomiko-shoqëror, të arritur gjatë periudhës së hershme të hekurit, bashkësia patriarkale filloi t'i linte vendin një shoqërie të diferencuar. Një vend të rëndësishëm zinin në të shtresat e reja shoqërore, të shkëputura nga gjiri i bashkësisë dhe të lidhura me prodhimin dhe shkëmbimin e mallrave.

Zejtaret, tregtarët, pronarët dhe skllavërit u mblodhën në vendbanime më të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike. Qendra të tilla si: Uskana, Oenea, Draodaku etj, zunë vendin e fortifikatave të vjetra fisnore. Ata prodhonin mallra për popullsinë e vet dhe për fshatrat përreth tyre. Ata ishin edhe tregje ku qarkullonin mallrat e ardhura nga Dyrrihi, Apollonia apo nga Greqia. Marrëdhëniet me Dyrrihin, Apolloninë apo edhe me Greqinë etj, u bënë përçues edhe në arritjet në fushën kulturore. Natyrisht këto arritje nuk u bënë si ndikim ose imitim thjeshtë i kulturës greke, por ato erdhën si rezultat i faktorëve të brendshëm të zhvillimit. Ato ndikuan ndaj njëri-tjetrit, por jo si një proces i njëanshëm imitimi.

Qyteti ilir, si një dukuri e zhvillimit ekonomik e shoqëror, ishte i lidhur me vendosjen e rendit skllavopronar dhe mbizotërimin e ekonomisë së mallrave. Nevojat e jetës qytetare dhe të vet ekonomisë kërkonin përdorimin e gjerë të shkrimit dhe të llogaritjeve, përgatitjen e specialistëve në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, njohjen e historisë, të gjuhës etj. Gjithashtu krahas lulëzimit të qyteteve ilire, u forcua dhe doli si një fuqi e rëndësishme edhe shteti ilir, i cili kishte nevojë për nëpunës, ushtarakë, diplomatë etj. Këto nevoja zgjidheshin nëpërmjet zhvillimit të formave të ndryshme të edukatës dhe të arsimit, të cilat morën formën e vet të plotë gjatë shek. III-II para erës sonë. Kjo është koha kur krijohet fizionomia e bashkësisë qytetare ilire, të njohura me emrat **Koinone e Doberëve** apo **Koinone Peneste-Doberase** në zonën e Dibërës. Në kuadër të shtetit ilir, qendrat kryesore të organizuara në formë të bashkësisë krahinore, të njohura me emrin Koinone, filluan në mënyrë të organizuar t'i afrohen procesit të edukimit. Procesi i edukatës në këto qendra pasqyrohet në disa drejtime, siç janë: edukata e punës, edukimi fizik dhe ushtarak. Puna në procesin e edukimit përfaqësohet kryesisht nëpërmjet lodrave të fëmijëve, që ngjallin interesin për punë. Këtu hyjnë figurat prej balte ose prej bronxi që paraqisnin kafshët e zbutura (delen, kalin, demin etj), apo shpendët e ndryshëm të gjetura në Selcë, Dimal, Antigone etj. Paraqitja e prodhimeve bujqësore, në simbolet e monedhave të qytetit Bylis, në lodrat e fëmijëve në Dimal apo trajtimi në relief i qeramikës, i figurës së bujkut në këtë qytet, përfaqësojnë pamje të edukatës së punës. Edukata fizike dhe ushtarake zinte vendin më të rëndësishëm në edukimin e të rinjve ilirë. Të dhënat e gërmimeve arkeologjike flasin në mënyrë të argumentuar se edukimi në qendrat ilire

gjatë periudhës së shek. IV-I p.e.s. ka qenë mjaft i organizuar, sidomos në Dyrrah, Apoloni, Butros, etj.

Në bazë të disa fakteve mund të konstatohet se në qytetet ilire kanë qenë të zhvilluara edhe shkencat natyrore. Në qytetin ilir Dimal është gjetur një orë diellore, ndërsa një mjet tjetër i tillë është gjetur pranë Butrintit. Mbreti ilir, Genti është i njohur si zbulues i një bime kurative, e cila për nder të tij mori emrin "Gentiana".

Gjurmët e vendbanimeve të hershme ilire në trevën e Dibrës, të cilat i përkasin mundësisht periudhës paraqytetare, janë ndeshur në fshatin Bellovë pranë Peshkopisë, në kodrën e Gradecit, në verilindje të fshatit Zdojan, në Herbel në zemër të fushës së Dibrës, në kalanë e Çukit në Zonën e Slllovës etj. Midis tyre të tërheq vëmendjen vendbanimi i Bellovës me objekte ilire, së bashku me materiale që tregojnë vazhdimësi jetese që nga epoka e neolitit e deri në shekujt mesjetarë. Shkallën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror që kishte arritur treva dibrane, para se të pushtohet nga Roma në vitin 168 p.e.s, e ndriçojnë në mënyrë të përafërt objektet e kulturës materiale, të zbuluara rastësisht në Çukën e Herbelit dhe brenda në Peshkopi. Në Çukën e Herbelit, në fillim të viteve '70 të shek. të kaluar u zbuluan rastësisht mjaft objekte, të cilat duket se përbënin inventarin e një varri të një banori, i cili i përkiste me siguri etnosit ilir.

Objektet qeramike të zbuluara i takojnë padyshim prodhimit vendës. Midis tyre duhen përmendur: një oinoke, një lekit dyvegjak, një tas, një shishe balte e lyer me breza verniku të zi dhe plot fragmente enësh prej balte të pjekur. Enët janë prodhuar me një punim të imët me përbërje brumi të pastër e të situr mirë dhe me pjekje të plotë. Fragmentet e gjetura në Çukën e Herbelit, nga ana tipologjike dhe e teknikës së prodhimit kanë pika takimi me enët e gjetura në Ploshtan, Pesjakë, Peshkopi, Tomin. Midis tyre ka gjithashtu pika takimi përsa i përket motiveve të zbukurimit, jo vetem linear vertikal e horizontal të incizuar që priten njëri me tjetrin, por edhe me ngulitje, me shirit në reliev, breza verniku të zi që përshkojnë trupin e enës etj. Qeramika e gjetur në Çukën e Herbelit duhet t'i përkasë shek. të 3-2 p.e.s. Pikat e takimit tipologjik dhe teknik që kanë objektet e Çukës së Herbelit me ato që kanë dalë në dritë në pika të tjera të trevës dibrane, tregojnë se kemi të bëjmë jo me një kulturë të izoluar, por me një kulturë materiale në shkallë krahinore të përvetsuar nga banorët e trevës para vendosjes së sundimit romak. Elemente të përbashkëta të kulturës materiale të përvetsuar nga banorët e trevës dibrane në pragun e pushtimit romak, vihen re dhe në gjetjet arkeologjike të zbuluara në vende të tjera të trevës – Peshkopi (në krye të rrugës " Abdyl Frashëri", pranë stadiumit të qytetit), në Tomin, në Rashnapojë etj. Objektet e gjetura në këto stacione arkeologjike na japin të drejtë të pohojmë se në pragun e pushtimit romak, banorët e trevës dibrane kishin arritur të përvetsonin mjeshtërinë e poçarisë cilësore (prodhime me brumë të pasur e të situr imët) dhe të siguronin prodhime të bollshme bujqësore, siç e tregojnë pitosat e mëdhenj që shërbenin për ruajtjen e drithërave. Peshat e vegjeve të zbuluara gjithandej dëshmojnë se banorët merreshin gjerësisht me endjen shtëpiake. Sasia e madhe e tjegullave të gjetura në mbarë trevën, tregon se shtëpitë e banorëve të paktën në zonën fushore, tashmë nuk mbuloheshin më si dikur me kashtë. Enët e llojeve të ndryshme, qoftë edhe në fragmente si vorba, tasa, vazo, gota, filxhanë të zbuluara me shumicë nëpër varre, tregojnë sasinë e madhe që kishte popullsia e kësaj treve.

Zhvillimi i natyrshëm i shoqërisë ilire u pengua nga pushtimi Romak. Ushtria romake

dhe ajo maqedonase përshkruan viset e penestëve (treva e sotme dibrane), gjatë luftës së tretë maqedonase-romake në vitet 172-169 para erës sonë, duke e kthyer atë në shesh luftimesh midis dy ushtrive. Megjithatë, pushtimi romak në shekujt e parë nuk arriti të ndalojë veprimtarinë ekonomike të bashkësive qytetare ose të ndikojë në fizionominë e kulturës ilire. Vetem pas mesit të shek. I para erës sonë filloi një politikë romanizuese, nëpërmjet krijimit të kolonive romake (Butrint, Bylis, Dyrrah, Skodër etj). Në fushën e arsimit dhe të edukatës, kjo u shoqërua me futjen e kulturës së shkrimit latin.

Që nga shek. I para erës sonë, kultura romake filloi të depërtonte nëpërmjet ndikimit arsimor. Kjo dëshmohet nga futja e shkrimit latin. Diçka të tillë e tregojnë edhe zbulimet e bëra në trevën dibrane të objekteve me shkrim latin. Gjatë shek. III-IV të erës sonë vihet re kundërshtimi i vendësve ilirë ndaj kulturës romake. Kjo shfaqet në rikthimin në emrat dhe veshjen vendase, ne nderimin e perendive të lashta ilire. Ky fenomen dëshmon për një përpjekje të ndërgjyegjshme kundër politikës romake të asimilimit. Si bazë e saj shërben tradita e lashtë kulturore-ilire e formuar prej shekujsh, ku rol të veçantë luajtën format e edukatës dhe të arsimit.

Një dukuri shumë e rëndësishme për traditën ilire të edukatës ishte edhe ruajtja e origjinalitetit të saj nga ndikimet asimiluese të kulturave dhe përvojave të huaja edukative. Shtresat e gjëra të popullsisë ilire, jo vetem që nuk përvetsuan kulturën edukative të huaj, por përkundrazi i bënë asaj një rezistencë të fortë, e cila kryesisht u manifestua në ruajtjen e dokeve, zakoneve, shprehjet artistike, veshjeve, gjuhës etj. Në gurët e varreve, ilirëve u pëlqente ta paraqisin veten në kostumet e tyre të cilët kanë ndryshime të theksuara nga veshjet romake dhe greke. Në bazë të fakteve dhe argumentave historike, vërtetohet se qysh në kohëra të lashta te ilirët ka ekzistuar një sistem i organizuar edukativ në fundament të edukatës popullore, në fillim ilire e pastaj arbërore. Ajo që është e rëndësishme në gjithë këtë proces historik dhe që bie shumë në sy, vihet re në format e kulturës materiale ilire, të cilat vazhduan të përpunoheshin gjer në mesjetën e hershme.

2. **Arsimi gjatë periudhës së mesjetës**

Në periudhën e Mesjetës rol të rëndësishëm në veprimtarinë kulturore dhe arsimore luajti kisha e krishterë. Roli i saj si udhëheqëse shpirtërore shpjegohet nga fakti se krahas burimeve ekonomike, kisha pati në dorë monopolin e kulturës dhe përgatitjen dhe inteligjencës së kohës. Shumica e njerëzve të kulturës, veçanërisht në shekujt e mesjetës së herët, ishin thuajse pa përjashtim klerikë. Në duart e klerikëve ishin filozofia e letërsia, arsimi dhe artet. Si qendra e propagandimit të doktrinës fetare, të arsimit dhe të veprimtarisë kulturore-artistike shërbyen manastiret ortodokse e katolike. Gjatë kësaj periudhe gjuha amtare shqipe ka qenë gjuha e folur në popull. Por, për kushtet e caktuara historike, ajo nuk arriti që të bëhej edhe gjuhë kulturore e shkruar dhe as gjuhë e arsimimit. Këtë rol e luajtën greqishtja, latinishtja dhe më vonë turqishtja. Por, meqenëse nuk arritën që të depërtojnë gjer në popull e të bëhej gjuhë e folur e tij në familje e në marrëdhëniet shoqërore, veprimtaria e kulturave në këto tri gjuhë u kufizua në korrespondencën dhe aktet zyrtare të administratës dhe ushtrisë së pushtuesit, në hierarkinë feudale vendëse, që u vu në shërbim të tij, në shërbesat fetare dhe në shkollat e tyre. Edhe gjatë periudhës së mesjetës, duke

u bazuar në trashëgimninë e pasur edukative dhe përvojën praktike nga e kaluara, populli shqiptar e organizoi edukimin e fëmijëve po ashtu në baza popullore. Nga sistemi popullor i edukatës kanë qenë të kushtëzuar qëllimi dhe idealet e edukatës, mënyra e jetës, traditat, doket, zakonet, psikologjia etnike, sistemi i normave morale etj. Prandaj fëmijët kanë qenë nën ndikimin edukativ të një sistemi të tillë. Lidhur me vlerën e lartë të edukatës popullore, profesori i njohur Bedri Dedja shkruan: “Forca e pedagogjisë popullore ka qenë një ndër faktorët më të rëndësishëm dhe në periudha të caktuara faktori kryesor në edukimin e brezit të ri me dashurinë për vendlindjen, nderin, besën, gatshmërinë për punën dhe ruajtjen e zakoneve dhe dokeve të veta. Idetë edukative morale dhe përgjithësisht, pikëpamjet pedagogjike popullore kanë gjetur një pasqyrim të gjerë në krijimtarinë gojore-letrare, në eposin, në këngët historike, në përrallat dhe në të drejtën zakonore..., në këngë e në ritet e motmotit, në legjendat, në këngët e djepit, në gjëegjëzat dhe në lodrat për fëmijë...”.

3. Kultura dhe arsimit pas pushtimit osman

Me pushtimin osman të trevës dibrane, filloi gradualisht të përhapet dhe zhvillohet islamizmi nëpërmjet institucioneve të ndryshme fetare dhe kulturo-arsimore. Përkatësia e krishterë e shqiptarëve (pjesërisht në ritin ortodoks dhe pjesërisht në ritin katolik) filloi të çenohej në dobi të përhapjes së islamit, fe zyrtare e shtetit osman. Me veprimtarinë e tyre ideologjike, me ndërprerjen e kontakteve me Evropën e krishterë dhe me pikëpamjen që u krijua se pushteti osman ishte i përjetshëm, misionarët islamikë arritën dalëngadalë të kultivonin tek banorët e trevës bindjen fetare kuranike dhe praktikën e riteve të sekteve myslimane. Kishat e krishtera, tashmë të braktisura nga besnikët e mëparshëm, dalëngadalë filluan të rrenoheshin dhe të ktheheshin në gërmadha.

Të dhënat e regjistrave turk të vitit 1571, 1591, përcaktojnë qartë dinamikën e procesit të islamizimit në zonën lindore të sanxhakut të Dukagjinit dhe të Dibrës. Procesi i islamizimit ishte intensifikuar tepër në këtë periudhë në Dibër, Lumë, Has etj. Sipas Kristo Frashërit, në Dibrën e Epërme si dhe në krahinën e Gollobordës pothuajse të gjithë shqiptarët kaluan në islamizëm, kurse e kundërta ndodhi në krahinën e Rekës ku krahas shqiptarëve myslimanë, pati dhe mjaft fshatra me shqiptarë që vazhduan të praktikonin, ashtu siç e praktikojnë edhe sot, fenë e krishterë të ritit ortodoks.

Përhapja e islamizimit në trojet shqiptare ishte një proces me rrjedhoja të shumanshme në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore të popullit shqiptar. Rezultati kryesor i këtij procesi ishte fakti se në strukturën konfesionale të tij tashmë, përfshihej si pjesë përbërëse popullsia myslimane. Ndryshimet në strukturën fetare të popullit shqiptar si rrjedhim i depërtimit të islamit, u pasqyruan edhe në arkitekturën dhe urbanistikën e vendbanimeve shqiptare. Një numër kishash u shndërruan në xhami, teqe, shkolla (mejtepe, iptidajje, medrese, gjimnaze etj), qendra bamirësie (imarete) etj, duke i shtuar kështu pamjes urbanistike të vendbanimeve në të cilat u përhap islamizmi, një aspekt islamiko-oriental. Normat dhe rregullat islamike u shtrinë edhe në fushën e organizimit të veprimtarisë ekonomike, veçanërisht të zejtarisë në qytete. Islamizimi i popullsisë shqiptare ishte një proces me ndikime të ndjeshme edhe në shumë aspekte të kulturës shpirtërore. Në doket, martesat dhe krijimtarinë artistike (gojore dhe të shkruar) u dukën shpejt elementët e kulturës islamiko-orientale.

Martesat në përgjithësi filluan të bëheshin brendapërbrenda secilit komunitet fetar. Përgatitja arsimore e shqiptarëve zhvillohej nën "kujdesin" e institucioneve të ndryshme fetare, prandaj edhe kultura e arsimit në vendin tonë, nuk mund të kishte një karakter të njëjshëm. Kështu ndërsa në institucionet fetare muhamedane arsimit jepej në gjuhën osmane dhe arabe, në ato të ritit ortodoks jepej në gjuhën greke. Po kështu elementi katolik i lidhur shpirtërisht me kurinë romake, e zhvillonte kulturën e vet mbi bazën e shkrimit latin. Kjo veçori la deri vonë gjurmë të thella në përgatitjen divergjente intelektuale të vendit, mbasi tri kulturat e huaja, të lidhura me tri fetë kundërshtarë që ekzistonin në Shqipëri, ndryshe nga viset e tjera të Ballkanit ishin një pengesë serioze në formimin e ndërgjegjes dhe të kulturës laike mbi një bazë të përbashkët kombëtare.

Kështu, me vendosjen e sundimit osman në trojet shqiptare dhe sidomos me përhapjen e Islamit, i cili pati ndikim të ndjeshëm edhe në mënyrën e jetesës, por edhe në kulturën materiale e shpirtërore, nis kontakti ballor i shqiptarëve me kulturën orientale, edhe pse shqiptarët historikisht kanë pasur lidhje kulturore si me Perëndimin ashtu edhe me Lindjen. Mirëpo, me pranimin e Islamit nga ana e tyre, lidhjet me Lindjen u zgjeruan, u shtrinë në disa fusha dhe u bënë më të drejtpërdrejta për një shtresë më të madhe të popullsisë. Pas pushtimit të Shqipërisë nga ana e osmanllinjve dhe islamizimit të pjesës më të madhe të popullatës së saj, osmanët, siç është e ditur, kanë sjellë në këto anë parimet e njëjta të cilat i kishin përvetsuar nga arabët dhe persianët. Në mesin e këtyre, bëjnë pjesë edhe shkollat fetare myslimane - mejtepetet dhe medresetë, të cilat, pas xhamive, i hasim shumë herët në Shqipëri. Në të vërtetë, fillet e para të veprimtarisë arsimore-edukative islame në trojet tona datojnë qysh nga periudha më e hershme e krijimit të bërthamave të para të komunitetit shqiptar të islamizuar. Kjo veprimtari në fillimet e saj është zhvilluar në xhami, ose pranë xhamisë. Pikërisht për këtë arsye edhe historia e veprimtarisë së arsimimit islam ndërlidhet me historinë e ngritjes së xhamive të para në këto troje, që ka filluar në vitet e para të vendosjes së pushtetit osman. Historikisht xhamia ka luajtur rol shumë më të gjerë dhe më kompleks se sa roli i saj si faktore apo si vend ku kryhej rituali i faljes (namazit). Ajo ka qenë institucioni themelor Islam, me të cilën kanë qenë të lidhura ngushtë jeta fetare, arsimore-edukative, kulturore, politike dhe shoqërore e myslimanëve qysh në fillimet e saj. Këtë rol xhamia ka vazhduar ta luante edhe tek ne, gjatë tërë periudhës së sundimit osman. Vetëm në qytetin e Dibrës kanë ekzistuar 8 xhamia si: xhamia e Haxhi Ibrahimit, xhamia e re, xhamia e Hiqnarit, xhamia e Teqesë, xhamia e Budulecit, xhamia e Bajram Begut, xhamia e Dollmehallës, dhe xhamia e "Dervish Mustafës". Sido që të jetë, xhamitë, si institucion më i rëndësishëm fetar islam, përgjithësisht në botën islame, e po ashtu edhe në trojet shqiptare, kanë njohur një shtrirje të madhe në kohë dhe hapësirë. Ato, gjatë tërë historisë së tyre, përveç se faktore u bënë edhe shkolla të para dhe më të vjetrat islamike dhe qendra të rëndësishme kulturore-arsimore. Më vonë, afër xhamive u ndërtuan godina për arsimin fillor, të ashtuquajtura **kuttab ose mejtepe**, numri i të cilave u rrit aq shumë, saqë në çdo fshat kishte të tillë, madje në shumë raste kishte edhe më tepër se një.

Arsimi fillor tek ne, në kohën e Perandorisë Osmane kryhej në mejtepe. Ky tip i shkollave (mejtepeve) ka qenë i përhapur në të gjitha trojet shqiptare. Arsimiti dhe edukimi i komunitetit mysliman shqiptar deri në gjysmën e parë të shekullit XIX, sikurse edhe arsimit dhe edukimit të komunitetit mysliman (miletit islam) në

Perandorinë Osmane, realizohej në kuadër të sistemit edukativ arsimor osman, i cili, si i gjithë sistemi shoqëror osman, mbështetej në postulatet e fesë islame. Me islamizimin e trevave shqiptare, rrjedhimisht edhe të trevës dibrane, krahas të tjerave u morën masa për organizimin e arsimit islam. Pushtuesit osmanë filluan të hapin shkolla turke. Në shek. XVII numri i këtyre shkollave u rrit me shpejtësi. Ndër shkollat islame që hapi pushteti osman, më të përhapurat ishin mejtepet, të cilët ndiqeshin nga fëmijët e popullsisë myslimane, kurse mësimin e zhvillonin klerikët e quajtur **mulla ose hafëz**. Më vonë hapen një numër i konsiderueshëm medresesh. Në këto shkolla përgatiteshin kryesisht kuadrot e klerit mysliman. Krahas njohurive fetare, që synonin përgatitjen e kuadrove për propagandimin dhe përhapjen e fesë islame në mejtepet dhe medresetë turke jepeshin edhe njohuri të karakterit laik.

Përfundime

Pozicioni gjeografik i trevës së Dibrës, u ka mundësuar dibranëve marrëdhënie dhe kontakte të gjëra me të gjitha krahinat brenda dhe jashtë Shqipërisë. Nëpërmjet këtyre kontakteve, dibranët kanë shkëmbyer arritjet më të përparuara në fushën ekonomike, politike, kulturore, arsimore që nga lashtësia e deri në ditët tona. Dibranët ashtu si gjithë shqiptarët janë trashëgimtarë të një etnije, të një kulture, si dhe të një edukate të organizuar me tradita të shëndosha.

E gjithë kjo trashëgimni etnike në zhvillimin ekonomik-shoqërorë, intelektual, estetik, kulturor, arsimor etj, kaloi tek shqiptarët të cilët jo vetem u bënë bartës të denjë të saj, po e zhvilluan atë edhe më tej.

Referencat

A. MHD (Muzeu Historik i Dibrës).

B. Biblioteka Kombëtare, Tiranë.

Historia e popullit shqiptar, vëll. I, Tiranë, Toena 2002.

Kaca, Iljaz. *Rrugët e vjetra të Dibrës*. Tiranë, albPAPER. 2003.

Ceka, Neritan. *Edukata dhe arsimit në lashtësi*, në Historia e Arsimit dhe Mendimit Pedagogjik Shqiptar. Tiranë, Nënë tereza, 2003.

Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Histori e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Tiranë, Nënë Tereza, 2003.

Kaca, Iljaz. *Dibra në faqet e një ditari arkeologjik*, Tiranë, albitipografia, 2012.

Frashëri, Kristo. *Historia e Dibrës*, Tiranë, albPaper, 2012.

Shkodra, Zija. *Qyteti Shqiptarë gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Tiranë, Mihal Duri, 1984.

Ihsanoğlu, Ekmeleddin. *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: Historia e Shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AIITC, Tiranë, 2010.

Sharofi, Haki. *Historia e Dibrës, Vëll. I*, Peshkopi, 1968.

Stërmilli, Haki. (dorëshkrim), *Dibra në Prag të Historisë*, Tiranë, 1940.

Zekaj, Ramiz. *Zhvillimi i kulturës Islame tek shqiptarët gjatë shek. XX*, Tiranë, Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islamik, 2002.

Emigracioni në Shqipëri dhe ngjarjet e ambasadave në fillim të viteve '90

MSc. Brunilda Duriçi

Doktorante pranë ISE, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Jetesa tepër e vështirë dhe izolimi për një kohë të gjatë nga bota kishte bërë që shumë shqiptarë të udhëhequr nga ideja se përtej kufirit shtetëror i priste toka e premtuar ku ata do të kishin mundësi të plotësonin ëndrrat e veta, donin të iknin sa më parë nga Shqipëria. Gjatë gjysmës së dytë të viteve '80, ishin shpeshuar shumë rastet e arratisjeve. Shpallja nga ana e qeverisë së nga 1 korriku i 1990, çdo qytetar shqiptar ishte i lirë për të udhëtuar jashtë shtetit dhe për të jetuar ku të donte u pa si rasti më i mirë për tu larguar drejt perëndimit. Por zvarritja e zbatimit të kësaj reforme, dyshimi i njerëzve në seriozitetin e deklaratave të regjimit, padurimi i tyre për të realizuar ëndrrat e tyre si dhe varfëria e skajshme që ata po vuanin dhe që po thellohej nga dita në ditë bënë që njerëzit të hidheshin në protesta. Si dhe të dyndeshin drejt mjedisve të ambasadave për të kërkuar strehim politik.

Fjalë kyçe: Izolim, Skamje, Krizë, Emigrim, Liri.

Hyrje

Ky studim shqyrton çështje të krizës së emigracionit të shqiptarëve në fillim të viteve 1990. Lëvizje të tilla në Shqipëri ishin mohuar për gati 45 vite regjim komunist dhe ishin shoqëruar me shkelje flagrante të kësaj të drejte njerëzore nga aktorë e faktorë të ndryshëm politik, social dhe ekonomik.

Gjatë viteve të regjimit komunist, populli shqiptar nuk kishte të drejtën e lëvizjes së lirë, as brenda kufijve të shtetit shqiptar dhe në mënyrë kategorike, ishte e ndaluar lëvizja e lirë jashtë kufinjve politik të Shqipërisë. Izolimi ishte i plotë, si në termat fizik të lëvizjes dhe të qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, ashtu edhe në termat e qarkullimit të informacionit. Situatës politike ju shtua edhe situata e rëndë ekonomike që kishte zaptuar vendin dhe që kishte zënë fill që në vitet 1980, dhe që filloi të përkeqësohej më tej gjatë viteve që pasuan. Në mesin e vitit 1990 vendi u zhyt në një kolaps të plotë. Duke karakterizuar këtë gjendje, pasuesi i Hoxhes, Ramiz Alia, pranonte se vendi ndodhej në kufinj të ekstrem të një gjendje të jashtëzakonshme. Në këtë situatë të rëndë u shfaq papritur një dukuri e panjohur më parë, futja e njerëzve në mënyrë masive në përfaqësitë e huaja diplomatike, duke kërkuar strehim politik. Për të frenuar fluksin e njerëzve që hynin në ambasada, forcat e rendit u përpoqën të merrnin masa, por ato nuk dhanë efektin që pritej, nuk mundën të ndalonin turmat e mëdha të njerëzve që futeshin në ambasada. Këtë dukuri nuk e ndaloi as nxjerrja e dekretit për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave për të udhëtuar jashtë shtetit. Deri në fund të qershorit 1990 ishin lëshuar rreth 8 mijë pasaporta. Në dhjetëditëshin e parë të korrikut 1990 ndodhën disa ngjarje të rënda, që tronditën më tej regjimin komunist. Më 2 korrik 1990, në orët e vona të mbrëmjes, një numër i konsiderueshëm qytetarësh tentuan të futeshin forcërisht në një nga ambasadat e huaja në Tiranë. Ndalesa që u bë nga forcat e rendit çoi në përleshje me to e në

demonstrim të hapur kundër shtetit. Demonstrata u shpërnda forcërisht. Ndërkohë vala e njerëzve të irrituar, që kërkonin të hynin në ambasada, po rritej së tepërmi dhe me qytetarë të ardhur nga rrethet e tjera të vendit (Akademia e Shkencave, 2009, 356).

Kriza ekonomike-politike si prelud i krizës së emigrimit të shqiptarëve

Fundi i viteve '80 e gjeti Shqipërinë në një situatë të rënduar ekonomike, nga ana tjetër, edhe situata politike me vdekjen e Enver Hoxhës në vitin 1985, kishte nisur të destabilizohej. Nën trysninë e këtyre ngjarjeve, udhëheqësi i ri i qeverisë, pasuesi i Hoxhës, Ramiz Alia, u detyrua të ndërmerre disa reforma për nxjerrjen e vendit nga kolapsi në të cilin kishte rënë.

Reformat ekonomike të ndërmarra nga pushteti i kohës rezultuan të dështuara, duke rënduar gjithnjë e më tepër ekonominë socialiste. Kjo situatë sollti mungesa akoma më të thella të furnizimit të popullsisë me produkte të konsumit të përditshëm duke arritur deri në mungesa të theksuara ushqimore. (Biberaj, 1990).

Pakënaqësia e masave kishte filluar të rritej çdo ditë e më shumë, ndërkohë që vendi po përballej gjithnjë e më tepër nga një krizë e gjithanshme. Paralelisht me reformat, regjimi mori dhe një sërë masash të tjera, kësaj radhe të rrepta, në mënyrë që të frikësonte të gjithë ata që kërkonin reforma rrënjësore. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj politike, Ramiz Alia përpiqej të qetësonte konservatorët dhe të dëshmonte se ai nuk do të lejonte që PPSH-ja të lëshonte monopolin e drejtimit politik të vendit. Ramiz Alia, vepronte me kujdes, në mënyrë që forcat konservatore, të kapura nga paniku dhe të dëshpëruara nga humbja e mundshme e pushtetit, të mos hidhedhin në veprime e të shkaktonin ndonjë tragjedi. Gjithashtu, me mjaft zgjuarsi dhe dinakëri, ai hidhte hapa të vegjël, por në mënyrë të pareshtur, drejt demokratizimit të vendit. Nëpërmjet kësaj taktike ai shmangu katastrofën dhe i vinte konservatorët gjithmonë përpara forcës së rrethanave dhe të shtrëngesave ekonomike dhe atyre ndërkombëtare, në mënyrë që ata ti pranonin ndryshimet si të pashmangshme. Në të vërtetë, Ramiz Alia dhe udhëheqësit e tjerë pragmatiste shqiptarë ishin kundër ndryshimeve të menjëhershme dhe rrënjësore dhe kundër pluralizmit politik, sepse, të interesuar për të ruajtur me çdo çmim pushtetin e tyre, propagandonin se shqiptarët nuk kishin pjekurinë politike dhe nuk ishin të gatshëm për pluralizëm, sipas tyre, në kushtet e Shqipërisë, pluralizmi do të dëmtonte unitetin kombëtar. (Duka, 2007, 319-320).

Duke marrë shkas nga kjo klimë ekonomike e politike në të cilën ishte katandisur vendi, për popullin shqiptar, e vetmja dritë jeshile për të ardhmen e tyre ishte largimi, për një jetë më të mire, në vendet e huaja demokratike. Që në gjysmën e dytë të viteve '80 u shënuan shumë raste të arratisjeve nga Shqipëria.

Ndërkohë në kushtet e rënda në të cilat po përballej vendi, si dhe situatës së presionuar nga ana e ndërkombëtarëve ndaj qeverisë shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, drejtuesi i ri i PPSH dhe qeveria e tij, bënë një shpallje publike në 1 korrik 1990, në të cilën deklaruan publikisht që çdo qytetar ishte i lirë për të udhëtuar jashtë shtetit dhe të jetonte ku të donte.

Përballë situatës dhe trysnisë në të cilën ndodheshin shqiptarët, kjo thirrje u bë një arsye më shumë dhe pse jo, rasti më i mirë për ta, për tu larguar drejt perëndimit. Mirëpo vonesa e qeverisë në realizimin e reformave të premtuara, krijuan mosbesim

zhgënjim ndaj qeverisë së re dhe premtimeve të bëra prej saj. Në këto kushte një pjesë e mirë e shqiptarëve shpërthyen në protesta në disa qytete shqiptare dhe për më tepër u dyndën nëpër dyert e ambasadave në Tiranë për të kërkuar strehim politik. Tashmë është mëse e kuptueshme dhe e natyrshme, që kjo lëvizje në ambasada të konsiderohet si pasojë e natyrshme e pakënaqësisë kolektive që mbizotëronte prej kohësh në shoqërinë shqiptare.

Në të ashtuquajturin eksod të korikut 1990, me mijra qytetarë shqiptarë nga e tërë Shqipëria, kryesisht të rinj e të reja, hynë në ambasadat e huaja të akredituara në Tiranë. (Raport i MPJ 1990).

Si fillim Ramiz Alia dhe qeveria komuniste shqiptare mbajti një qëndrim tepër të ashpër ndaj të ngjuarve pranë ambasadave, dhe nuk pranoi ti lejonte ata të largoheshin nga Shqipëria. Për këtë arsye azilantët nuk u pajisën me pasaporta dhe nuk u lejua ulja e avionëve që do të bënte transportimin e tyre. Nga ana tjetër dalja në faqet e para të gazetave europiane e dëmtoi së tepërmi imazhin e Shqipërisë. Presioni i opinionit publik european mbi regjimin komunist shqiptar ishte shumë i madh. Tirana zyrtare, e cila i kishte varur shpresat për mbijetesën e saj te vendet e Evropës perëndimore nuk mund ta shpërfillte këtë presion. Reagimi i opinionit publik perëndimor tregoi se mosbesim ndaj regjimit komunist të Tiranës, ushqenin jo vetëm shqiptarët por edhe perëndimorët. Ke-ja dërgoi një komision faktmbledhës në Tiranë për tu marrë me çështjen e azilantëve të ambasadave si dhe për të shqyrtuar shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut.

Të dymbëdhjetë qeveritë e KE-së protestuan pranë qeverisë së Tiranës për qëndrimin e saj ndaj tyre. Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë u lëkund së tepërmi dhe anëtarësimi i saj në KSBE (Këshilli i Sigurimit dhe Bashkëpunimit European) u vu në pikëpyetje. Pas këtij qëndrimi të jashtëzakonshëm, regjimi komunist shqiptar u detyrua të tërhiqej dhe pranoi ti lejonte të ngjuarit nëpër ambasada që të largoheshin nga Shqipëria. (Duka, 2007, 319). Në mënyrë që të realizohej largimi i personave në drejtim të vendeve perëndimore, u kryen nga pala shqiptare regjistrimet përkatëse të nevojshme për pregatitjen e pasaportave. Nga këto regjistrime rezultoi se në ambasada kishin hyrë 4.795 persona, të cilët ishin shpërndarë në këtë mënyrë:

3.163 në ambasadën e RFGJ

816 në ambasadën e Italisë

549 në ambasadën e Francës

77 në ambasadën e Turqisë

52 në ambasadën e Polonisë

51 në ambasadën e Çekosllovakisë

39 në ambasadën e Hungarisë

31 në ambasadën e Greqisë

6 në ambasadën e Jugosllavisë

6 në ambasadën e Egjiptit

5 në ambasadën e Bullgarisë (Muçostepa, 1993, 71)

Pajisja me pasaporta u krye në një kohë rekord, vetëm për 3 ditë. Më në fund, ky kontigjent njerëzish mundi të largohej nga Shqipëria, pa ndonjë incident, brenda 15 ditëshit të parë të korrikut.

Në datën 9 Korrik u ul në aeroportin e Tiranës avioni Jet Tupolev 154, i cili përdorej nga presidenti çekoslovak Valclov Havel. Me këtë avion u transferuan në Pragë 51 qytetarë shqiptarë, të cilët kishin hyrë në ambasadën çekoslllovakë. Sipas shtypit italian, në saj të ndërhyrjes së kancelerive diplomatike europiane, në datën 13 korrik 1990, u mundësua largimi nga Shqipëria i 4.803 refugjatëve, ndër të cilët, 2.000 të strehuar në ambasadën franceze, 2.000 në atë gjermane dhe 803 në atë italiane. Ata u nisën nga porti i Durrësit për t'u zbarkuar në atë të Brindisit e për të vazhduar më tej në drejtim të shteteve që u kishin ofruar strehim. Situata e atyre ditëve rezultonte të ishte tejet e rëndë. Kurrë më parë në Shqipëri gjatë 45 viteve të ashtuquajtura të pushtetit popullor, nuk kishin ndodhur ngjarje të atyre përmasave. Sigurisht, tentativa për të hyrë në ambasada ka patur edhe më parë gjatë 45 viteve të diktaturës komuniste, porse këto ngjarje kanë qenë shumë të pakta dhe kanë përfshirë individë ose grupe të vegjël shtetasish shqiptarë. Në fillim të vitit '1990, disa muaj para hyrjeve masive në ambasadat e huaja në Tiranë, janë shënuar disa raste të hyrjeve individuale të qytetarëve shqiptarë me kombësi greke në ambasadën greke.

Gjatë 45 viteve kish patur tentativa arratisjeje, të cilat, në pjesën më të madhe të rasteve kishin patur përfundime tragjike. Braktisja e atdheut konsiderohej nga sistemi i kohës si krimi e tradhëtia më e lartë ndaj Partisë, Atdheut e Kombit. Sigurisht, që hyrja e të rinjve e të rejave shqiptare në ambasadat e huaja në Tiranë, ishte rezultat i politikës miope të shtetit shqiptar të kohës, i cili u tregua i paaftë e apatik në reformat e demokratizimit që qeveria Alia kish në axhendën e saj. Megjithatë do të ishte naive të mendohej se një ngjarje e përmasave të tilla, e ndodhur në kontekstin politik e social të kohës, ka qenë thjesht një revoltë e popullit shqiptar në emër të demokracisë. Këtu doemos kanë patur ndikimin e rolin vet dhe qeveritë e vendeve demokratike, të cilat, përmes ambasadave dhe kanaleve të tjera të karakterit mediatik e kulturor, përcillnin mesazhe inkurajimi e mbështetjeje ndaj çdo lëvizjeje që trondiste themelet e shtetit komunist.

Nata e 2 korrikut, e përplasjes masive nëpër ambasada, ishte si të thuash nata finale e një veprë që kishte kohë që zhvillohej në bashkëpunim ose jo me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Tiranë. Një numër i konsiderueshëm qytetarësh shqiptarë hynë në kundërshtim me ligjet e kohës në territoret e ambasadave të vendeve perëndimore në Tiranë.

Më 3 korrik, në njoftimin zyrtar të ATSH-së, kjo ngjarje u përshkrua e minimalizuar dhe e shpërfillur si "veprime të disa huliganëve në Tiranë". Njerëzit që morën pjesë në këtë ngjarje, si dhe vetë ngjarja, u paraqitën si "një grup vagabondësh, ish të burgosurish për faje të vogla ordinere si vjedhje, llotarira klandestine, kumarxhinj, si dhe adoleshentë të mashtruar, që kërkuan të hyjnë forcërisht në ambasadën e RFGJ në Tiranë, duke goditur me gurë, tulla e mjete të tjera, mbrojtësit e rendit" (The New York Times, 04/07/1990 <http://www.nytimes.com/1990/07/04/world/>);

Vetë ish presidenti i fundit komunist Ramiz Alia në një libër të tij shkruan: "Eksodi i dy korrikut për mendimin tim qe tentimi i parë i hapur i rinisë drejt Europës, një tentim dramatik dhe i dhimbshëm. Vërshimi në ambasada u duk si një zgjidhje më e realizueshme për daljen në botë, sidomos pas rrëzimit të murit të Berlinit." (Alia, 1993, 152.)

Për fatin e mire të të gjitha palëve që merrnin pjesë, në këtë situatë mjaft të tensionuar që ishte krijuar, nuk pati incidente të rëndësishme. Në ato ditë, në Tiranë erdhën

përfaqesues te Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të cilët merrnin pjesë aktive në negociatat me Qeverinë Shqiptare, në mënyrë që të shmangej ndonjë incident, i cili mund ta degjeneronte situatën në drejtime të padëshiruara (“Enigmat e 2 korrikut ‘90”, 2003).

Është e qartë tani, sikurse ish mëse e qartë edhe në atë periudhë, se ikja ishte kryesisht e karakterit ekonomik. Ikej nga varfëria e mjerimi, drejt një ëndërre, për një jetë më të mirë e të sigurt. Çështja politike vinte mbas asaj ekonomike, dhe gjithsesi, pjesa më e madhe e njerëzve që hynë në ambasada, nuk zotëronin atë nivel kulturor e intelektual, sa për t’u përcaktuar si disidentë politikë.

Padyshim, që kish në mes tyre edhe të tillë, por në një numër të papërfillshëm sa për të patur një peshë në statistikat e pritshme. Edhe diplomatët e huaj u zhgënjyen nga përbërja e kontigjentit të njerëzve që hynë në ambasada. Ata kishin patur pritshmëri për një numër të madh intelektualësh e disidentësh politikë. Sekretari i ambasadës së RFGJ-së, ka deklaruar se “ Ne prisnim të tjerë njerëz, prisnim më shumë intelektualë, për të cilët kishim marrë edhe masat tona, por jo këtë kategori njerëzish të pashkolluar e me iluzione të gabuara për Gjermaninë”.

I ngarkuari me punë i ambasadës së RFGJ-së në Tiranë Ë.Daum është shprehur: “Shumica e njerëzve që kanë hyrë në ambasadën tonë janë njerëz që nuk mund të bëjnë asnjë lloj pune. Një në dhjetë vetë mund të punojë në Gjermani, kurse të tjerët nuk dihet se çfarë do të bëjnë.” (Muçostepa 1993, 78.)

Ngjarjet e 2 korrikut shënojnë fillimin e një epoke të re për shoqërinë shqiptare, fillimin e procesit të gjatë e të mundimshëm të demokratizimit politik, ekonomik e shoqëror të vendit. Proçes ky që vazhdon ende në ditët e sotme, me problematikën, me vështirësitë, sukseset dhe dështimet e rradhës. Lufta e egër e klasave, shkatërrimi i pronës private, burgimet dhe terrori sistematik, privimi nga e drejta e besimit, degradimi deri në uri e të ardhurave ekonomike për çdo familje në fshat apo qytet, këto dhe të tjera reforma shtërnguese tejet radikale, e kishin traumatizuar tej mase personalitetin e çdo shtetasi të këtij vendi. Ngjarjet e ambasadave shprehën haptazi divorcin e popullit me regjimin komunist, i cili u shpall nga disa mijra qytetarë, por që koha e mëpasme tregoi se ata ishin vetëm maja e ajsbergut e revoltës mbarëpopullore, e cila do të shpërthente pak muaj më pas. Sigurisht, gjithë ky proçes demokratik do të jetë në sfondin e atyre ngjarjeve të mëdha historike me përmasa europiane, të cilat shoqëruan mjaft vende pas rënies së Murit të Berlinit. Ato ngjarje do të sillnin ndikim të fuqishëm edhe në Shqipërinë e deriatëhershme staliniste, e cila do të nxirrte nga gjiri i saj protagonistët e lëvizjeve të njohura demokratike. Emigrimi i ketyre viteve është konsideruar nga shqiptarët si një ndër elementet kryesore për të përballuar jetën, dhe siguruar të ardhmen, veçanërisht ekonomike të individit, familjes dhe shoqërisë shqiptare.

Konkluzione

Largimet masive të ndodhura në vitet 90-të e më pas, janë të mpleksura me arsye/motive ekonomike e politike. Gjithashtu, duhet mbajtur mirë parasysh se këto janë nga largimet më të dalluara për nga numri i madh i njerëzve të përfshirë në to, aq sa llogariten të jenë pothuaj sa 1/3 e gjithë popullsisë së vendit. Ky numër kaq i madh njerëzish, ka qenë sfidë për vendet pritëse, por edhe për vendin ë origjinës, Shqipërinë,

e cila tashmë privohej nga braktisja e energjive të pallogaritshme intelektuale e fizike dhe të një moshe kryesisht të re, prej nga i krijoheshin asaj zbrazëti, të cilat do të kompensoheshin me vështirësi e për një kohë të gjatë.

Ngjarjet e 2 korrikut nuk ishin veçse maja e dukshme e ajzbergut e pakënaqësisë së përhapur në masën e popullit, si pasojë e politikës tejet shtrënguese e shterpë, e cila e çoi në mënyrë të pamohueshme vendin drejt një varfërie të tejskajshme sociale dhe ekonomike. Ato shënuan fillësën e largimeve në masë të shqiptarëve nga Shqipëria, në kërkim të tokës së ëndërrave të tyre, tokë e cila, për shumë vite me rradhë, për arsye të ndryshme, ishte personifikuar me Italinë fqinjë.

Ngjarjet e korrikut 1990, apo e ambasadave, sikundër artikulohej shpesh në ligjërimin mediatik e politik, shënojnë një lloj preludi për ngjarjet që do zhvilloheshin me ritëm të shpejtë në vitet e mëpasme. Ato ngjarje, para së gjithash, vranë frikën tek shtetasit shqiptarë. Kjo frikë kishte mbretëruar për gati gjysëm shekulli nën diktaturën komuniste, që cilësohet si më e egra në tërë kampin ish socialist.

Bibliografi

AMPJ, *Raport*, 1990.

Alia, Ramiz "Unë Ramiz Alia..", Tiranë, 1993.

Akademia e shkencave, "Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi IV", Toena, Tirane, 2009.

Biberaj, Elez. "Albania: A Socialist Maverick. Boulder", Colorado: Westview Press, 1990.

Duka, Valentina, "Historia e Shqiperise 1912-2000", shblu, Tiranë, 2005.

"Enigmat e 2 korrikut '90". Intervista të ndryshme për median e shkruar dhe atë televizive", Sh.Botuese Redona, 2003.

Muçostepa, H. "Në kërkim të parajsës", Sh.Botuese Dituria, Tiranë, 1993.

The New York Times, 04/07/1990 <http://www.nytimes.com/1990/07/04/world>

Bulqiza's environment and economy focused on the climate change

PhD (C.) Aishe Begu Balla
University of Tirana

Abstract

Climate change is a term used in climatology to denote the climate changes on earth on a global scale during various time, since the creation of earth. The climate in the valley of Bulqiza, given its special geographical position is very diverse and the study of this valley has a particular importance, not merely theoretical. Bulqiza belongs in the mediterranean climate zone, (northern mediterranean sub-districts).

The object of this paper is Bulqiza's environment and economy, in the focus of climate change. This paper treats how the climate changes affected and will affect the environment and the economy.

The aim is to sensitize the local and central institutions, population in general and students in particular, for the necessity of preventing environmental dangers identifying, analyzing, assessing and presenting all the problems to responsible institutions, as premises for the comprehensive development of this area today and in the future.

For the realization of the paper, we used written sources, and information provided from the Bulqiza's institutions and on the ground, through consultation with specialists and residents of the area. This paper contains analysis, comparison and synthesis in the form of conclusions and suggestions.

Treated issues, on a methodical and practical plan, constitute the basis of policy and strategy of socio-economic and environmental impact of Bulqiza's Municipality, which will include one municipality and seven communes.

Keywords: Bulqiza's climate, climate change, natural resources, intelligent agriculture, sliding, erosion.

Introduction

Climate change is a term used in climatology to show the climate changes on earth undergone globally in different times, since the creation of the earth until now. Climate change may be caused by internal terrestrial processes, external factors (eg changes in the increase of solar radiation) or recently by human activity. Today the term "climate change" in environmental policy is often associated with the current climate changes, including the raising of the average temperature of earth's surface known as global warming.

1. Bulqiza's climate features

Bulqiza's climate has a particular geographic position and its study has a particular importance. Bulqiza is part of the mediterranean climate (mediterranean northern subzones). (Hydrometeorology Institute, pg. 143, 1975)

Bulqiza, before '90, was under Dibra district's administration and there was still no specific studies in this field. Therefore, the importance of a thorough analysis of climate and climate performance elements increased, to be able to use real economic

climate in developing and improving human living conditions. In the analysis of climate conditions and its impact on the environment elements, we think that this is particularly important, since this region is known for its cold climate in the country and that is represented with Bualli Hill and Bulqiza itself.

In this study, we focus on the identification of the real climate richness and its components, the identification of negative climate features, the role of human activity and its preventing measures against harmful consequences. For this, we rely on Peshkopia's meteorological station data (657m above sea level) and Bulqiza's 744 m above sea level. (Perikli, Q. et al, pg. 96, 1991) Bulqiza had a ministration with simple tools that continuously used to send records to Peshkopia's station, which doesn't exist anymore since 90s.

The climate is not only cold because of the height above the sea level, but also as a result of the winds that blow in the valley. From the valley of the Black Drin, the wind penetrates blowing from the Bualli mount to the Mat valley. In the Bulqiza valley, winds are anual, and winter becomes harsh. Annual average temperatures reach 10 °C (July 19 °C, 0.6 °C in January) (Peshkopia's Meteorological Station, 2016). Bulqiza's climate is characterized by harsh cold winters and cool summers. Bulqiza is often beaten by cold winds and it often happens that the cold air down from the mountains stays in the valley for days in a row, often causing the disruption of temperature.

The showers are below the average of country. The annual average reaches 1187mm/year (Peshkopia's Meteorological Station, 2016). In Bulqiza it rained 964 mm in 2006. The wet season is winter (December), after which comes autumn. The driest months are July and August. In December it rains 122-126 m/m, and in July 24-26 mm. As seen, the disproportion starts growing by seasonal distribution of rainfall which is related to the influence of western and southern winds.

A part of the annual showers falls in the form of snow. The rainfall period during the year lasts 120 days, from the snowy 38-40 days, with a thickness of 0.5m - 1m, in the lower parts of the valleys and mountains in height up to 2m. (Perikli, Q. et al, pg. 195, 1991) Bualli mount is often blocked by snow during winter, becoming an obstacle for the transport of goods and people. This problem was permanently resolved by the tunnel in Bualli mount, opened as part of the Arberi Road.

Drought lasts up to two months, and even more, such as in 2005 and 2006, where drought lasted more. Droughts are naturally accompanied by consequences, especially for agriculture, making irrigation necessary in the countryside. In the climate regime, clear impacts in mainland are observed, which are expressed especially in the temperature regime (their annual amplitude is large enough) and raindrop (only 10% of the annual amount falls during the summer). (Perikli, Q. et al, pg. 195, 1991)

Naturally all these factors, including human activities, have had a strong impact on the environment and agriculture. Below, we briefly address the role of climate change and human role in environment and agriculture as the main economic branch, with which the major percentage of the population is involved.

2. The role of climate change in agriculture

Agriculture is the most sensitive sector of the economy with regard to climate change. Therefore without a clear plan for the harmonization policies related to climate change, living of the rural population is at risk, because the livelihoods of the majority of the rural population depends directly or indirectly on agriculture and consequently the climate impacts could undermine the progress made in reducing poverty and could have a negative impact on food security and economic growth in rural areas. (World Bank Report, 2009).

Impacts of climate change on agriculture in the four agro-ecological areas, through changes in temperature and precipitation, are important to agriculture. According to the WB, in the following 40 years, the average warming of Albania will be about 1.5 °C, compared with the less than 0.5 °C temperature increase during the past 50 years. However, annual averages are less important for agricultural production than the seasonal distribution of temperature and rainfall. Temperature increases are foreseen to be higher, while rainfall to decrease, especially during the summer. The increases of temperature during summer through the following years can go up to 4-5 ° in the north of Albania. (World Bank Report 2009).

Seasonal changes in climate have undoubtedly clear implications on agricultural products and farming in the case that there will be measures for adaptation, beyond the measures taken by farmers, such as the change of the time of planting, in response to changes in temperature, etc. The risks of climate change on agriculture can not be treated effectively, and can not be obtained effectively by the possibilities that can bring this change without a clear plan of harmonizing agricultural policies with climate change, by developing capacities of the key agricultural institutions and making the necessary investments on infrastructure, supporting services and different improvements on farms. The development of this plan includes quantitative analysis on high quality, consultation with key stakeholders, especially with the farmers and local agricultural experts, and investments in both human resources and physical capital. According to World Bank Report (2009), the negative impacts of a changing climate will have serious consequences in the agriculture and water sectors. This will have an impact on food security, nutrition and rural communities.

Its already a fact that the lack of field irrigation system, the partition of land in small plots, the inability of farmers for mechanization where over 80% of them have 1-2 acres land as in villages of Lejçan, Trebisht, Great Ostren in mountains of Golloborda, or in Peshk, Gjone e Lene of the Martanesh mountain etc., have led to the impoverishment and low productivity. Therefore it is now necessary to understand and support "intelligent agriculture" This new approach, known as "climate intelligent agriculture", highlights the need for agricultural practices, which can simultaneously increase the productivity in today's climate, build resilience to climate change and reduce greenhouse gas emissions - contributing to a "triple win" in the agricultural sector by providing sustainable solutions to the challenges posed by a global climate in change. (World Bank Report, 2009) To compensate the negative impacts of these projected scenarios, and to rely on the opportunities created by climate change, the international experience already offers alternative specific guidance on how to reduce the dependence of the agricultural sector to climate change.

Farmers are already facing the impacts of climate change and their living depends on their ability in approximating their efforts to respond to these effects, with the help of governments and the private sector. (World Bank Report, 2009) To cope with all this in terms of Bulqiza's climate, whose main features we briefly analyzed above, it is recommended for all central institutions, and local farmers to increase the capacity of new drainage, to rehabilitate existing infrastructure and drainage, to increase the capacity of new irrigation, to improve the efficiency of water use, to change crop varieties, to optimize fertilizer use etc. Farmers already understand the need for such actions, and optimistic efforts are being made in villages as Homesh, Okshatine, Boceve, Gjorica etc.

3. The human and climate change role on environment

Climate and its elements have an impact on the environment. The rate and direction of this influence can help or harm the environment. Similar to many other areas in Albania, Bulqiza is facing numerous environmental problems, such as erosion, landslides, misuse of natural vegetation, pollution of surface and underground water etc. Factors conditioning environmental problems are mainly natural, in particular the climatic ones, but even the human role has had a significant impact.

In the natural factors group, which are the main ones that have conditioned the emergence of environmental problems, we emphasize the spread of terrigenous rocks, water leaks destructive activity etc. In this regard, what plays an important role is the rainfall in the form of a heavy downpour and its large amount of 24-hour or the drop at the beginning of autumn when the land is evicting from the plants etc. Besides natural factors, the intensive development of erosion and degradation of the slopes, even the human factor has had an impact through deforestation, burning, overgrazing of vegetation and the herbaceous shrubs, misuse of land, terraces, paths etc. Hearths of erosion are powerful, and in many sections the slopes have degraded significantly, such as in Zercan, Kocaj (Bulqiza-Field) Cerenec, Golloborde etc. The main cause of their degradation is the appearance on the surface of clay rocks and the damage of natural vegetation. The largest erosion hearths lie exactly on these slopes. The opening of new lands in the 80s Twentieth Century has caused surface erosion and today in many sectors of the villages of Sopot, Valikardhe, Dragun, Vajkal etc., we see degraded lands. The improvement of the current situation would require protective measures such as the following:

- Planting trees on 325 ha of forest land, which are bare and under the direct action of surface erosion process, in the highlands of Golloborde, Martanesh, Shupeze (Gjuras) Bulqiza-Field ect.
- Cultivating 150-200 ha pasture with perennial vegetation to make the erosion less active, and to utilize them effectively, in all Bulqiza's villages. (Municipality of Bulqiza, 2015)
- Disciplining forest harvesting under appropriate law, adjusting mountain ambush stone walls, concrete, constructing singles hedges, on hilly slopes, improving soils in field, rehabilitating works of drainage-irrigation (Vajkali's field, Gjorice's field etc.), constructing embankments on either side of the river Black Drin, Okshtuni and Bulqiza, which each year during the period of precipitation take away large tracts

of land (villages of the downstream Gjorice, Upper Gjorice, Sofracan, Cerenec etc.), keeping the environment clean by uncontrolled development of businesses and manufacturing activities, campaigning for awareness of community residents for a clean and maintained environment etc.

It should be noted that cooperation between researchers, local decision makers and community will greatly facilitate the improvement of the situation today despite the lack of the necessary financial means, so the provision of these funds is important. Friendly relations between the nature and the inhabitants must be established, because we must think about future generations, who will demand much more from their working and living environment.

The situation in Mallakastra embodies this specific argument. The unstudied human intervention in this territory along the eastern slope of Okshtuni provoked an interesting phenomenon. In the large territory of 2-3 km of Cerenec flysch formations, Gjorica were affected by sliding mass movement. This activity appeared more intensively in the winter 2004-2005 and onwards. As a result, it caused rock mass displacement throughout slopes intersected by water mains and gravel, streams, rivers and surface water intensive rinsing. Consequently residential buildings in Mallakastra, Cerenec lower and upper Gjorica got damaged.

Naturally, when analyzing the causes, primarily many factors such as: lithological composition, the slope of the slopes, shortages and damage vegetation, humidity, community attitude etc., have to be seen and verified. When analyzing the lithological component, (flysch formations) seem to have helped the process. These deposits are easily susceptible to erosion processes. As well as molasses flysch's of quaternary deposits under dynamics of exogenous processes undergo alienation and displacement in downstream horizons relief. This is evident in the continual distortion of the terrain on which arising objects undergo damages (typical in the area of Mallakastra hills). Rock formations and deposits described above, contain water and water pressure, depending on their spatial position. (Shabani, S. and Kazanxhi, L., 1995)

Taking into account the factors mentioned above and those specific ones that were snowdrifts winter of 2004-2005, erosion processes in this area, provide materials friable products such as deluvione, proluvions, koluvione, alluvium, while intensive erosion is reflected in the numerous cracks field land, housing, etc. Custom sliding is sliding-leakage, while layers of reddish clay and has served as a contact boundary layer of reddish clay with gray clay. Gray clay layer, located beneath that reddish, has not slipped because it is more compact and its split asunder is not in compliance with the terrain. Therefore, this area generally presents a continuing danger sliding as it contains excessive moisture that makes unstable flysch formations, slippery and easily eroded. The irrigation canal opened above the village, which is not inserted in tubular steel or cemented, has also helped the process.

To stop the phenomena, the placing of concrete on the irrigation canal above Mallakastra district, the planting of trees on the forest community undertaken in all slopes, the building of cross walls to prevent erosion flow etc., is recommend. Furthermore, we develop yet another argument regarding the nature of environmental damages caused by human intervention.

Hydropower plants are traditionally seen as friendly to the environment. This because

they are sources of clean and renewable of the renewable energy, because it refers to the hydrological cycle, so the water is not wasted but released and returned to the rivers. Despite the various benefits of the use of hydropower as a renewable source of energy, negative environmental impacts are also present. These effects generally have to do with how the implementation of a hydro project affect the ecosystem of the river and its habitats and a thorough understanding of these issues is vital. It is naive to only consider the production of clean energy without thinking about possible negative impacts. While hydropower plants do not create as much pollution as many alternative sources, there are other consequences that might have skipped our attention. A careful observation reveals many damages to the environment, such as the occupation of large areas of pasture, forest or land and the impact on the fauna and flora and the territories occupied by new roads opened, the water se of Black Lake and Okshtuni etc. In both these valuable natural assets, hydropower are being built with negative impacts on environment. But which are the main impacts? That building hydropower. Plants affects the ecosystem, the change in the level of water (to Black Lake), the erosion, the use of water resources for irrigation and energy production during the summer and therefore the depletion of the desiccation of the lake, the changing of the natural habitat and natural life, the soil and vegetation damage from the track of road opening or the taking and discharging of water etc. Specifically the Black Lake in the municipality of Zerqan is considered one of the pearls and rare natural beauties of Albania. Situated in the mountains between Tirana, Librazhd, Mat and Dibra, Black Lake lies at an altitude 1800 meters above sea level (Perikli, Q. et al, pg. 207, 2006) with an exceptional tourist perspective. The ecosystem and biodiversity of this area is so rich, that the glacial lakes are as beautiful as those of Lura. The area of 2000 acres of the Black Lake (Municipality of Bulqiza, 2015) was declared a protected area in 2000, under the approval of the representative network of protected areas. The lake has a dark blue color, which is not found in any other lakes in the country due to the depth that goes up to 60 meters, and the density of the surrounding forest. The Black Lake area appears to be the pearl of Albanian nature, however exposed to danger, its biodiversity and ecosystem is beginning to fall apart. Residents of the municipality of Zerqan show that heavy machinery are working towards the Black Lake, and in picturesque field of Zog heavy machinery have began digging for the construction of a dam. Residents for months protested because an area of 40 hectares of forest belt from the river of Kaziakut up to Black Lake is ready to be cut (Municipality of Bulqiza, 2015). Also, the movement of heavy machinery to these areas means that has to do with the construction of one or more of hydropower stations which will be fed by the waters of the Black Lake and other lakes around. Damages at the hydro system for irrigation glacial lakes have started years ago. The establishment of dam by the materials obtained near of the road within the protected area, the opened channels and routes for the movement of heavy vehicles have damaged vegetation, soil and landscape. The Black Lake area still needs to be protected. Forest ecosystems have undergone serious damages mainly from illegal logging from 1997 onwards, but in the Black Lake there are parts of their unique beauty, due to the announcement of protected area for rich biodiversity and wonderful landscapes. No environmental impact study would have the effect of final destruction of this ecosystem, which is considered by values unique to the Balkan

Peninsula. In the Black Lake area, an area which has been announced protected a hydropower is being built. On the basis of environmental protection laws and the law on environmental impact assessment, the hydropower which is being built, must have the project on environmental impact assessment. Questions asked by residents, which have remained unanswered, eg. where will the hydropower plant get the water from, and will the lake dry or emerge the water from the lake in times of rainfall. The builders say that throughout the summer the hydro station will not pick lake water, while the contract penalties for non-compliance in these situations are unknown. The concept of protected area is "Protection of nature has priority over development". The issue of a building permission for a hydroelectric power station within a protected area is a concern for the impact that it will have on the water level of the Black Lake, and deforestation, whose assets are not found elsewhere in Albania and is almost an untouched area. This is a great harm being caused to the wealth of Albanian nature. Residents in 2014 onwards are opposing the implementation of the project but still there is no solution and the construction continues. For all the above, we conclude that the continued protection of these areas is a task of the regional authorities County (Regional Environmental Agency), local authorities etc. Therefore regional authorities (REA), which are responsible for the protection of these areas should exercise their legal effect to these destructive activities on landscapes. Local authorities should also undertake a campaign of reforestation areas, planting characteristic vegetation to restore the previous state and also to protect them from erosion.

Only the implementation of suggested actions can enable the return of these climatic conditions to a potential development area. We believe it is urgent and very important understanding the role of climate change on the environment, agriculture etc., and possible preventive actions by human. This article emphasizes the need for addressing these concerns and urges people and institutions at all levels to work together in providing intelligent and practical solutions.

References

- Bank, W. (2009). *Albania climate change and agriculture*. Retrieved 03 13, 2016, from <https://www.worldbank.org/eca/climateandagriculture>.
- Hydrometeorology Institute. (1975). *Albania Climate*. Tirana.
- Municipality of Bulqiza. (2015). *Report of 2015*. Bulqiza.
- Qiriazhi, P. (1991). *Physical Geography of Albania* (Vol. I). (T. U. Book, Ed.) Tirana: Academy of Sciences, Geography Studies Center.
- Qiriazhi, P. (2006). *Physical Geography of Albania* (Vol. II). (T. U. Book, Ed.) Tirana: Academy of Sciences, Geographic Studies Center.
- Sefedin Shabani, Leonard Kazanxhi. (1995). *Geological Enterprise of Bulqiza*. Bulqiza.
- Sutton, W. (n.d.). *World Bank Report*. Retrieved 02 19, 2015, from <http://agroweb.org/>

Perceptual differences between students and teachers witnessing school bullying

Dorina Batalli
University of Tirana

Abstract

The school environment deals with various forms of bullying, so students and teachers should face with this problem day by day. Many students and teachers express witnessing school bullying, but their perceptions go through important differences, which can be useful for a better understanding of the phenomena and other implementations of anti-bullying interventions.

Gjithashtu, burri ka të drejtë ta këshillojë dhe qortojë gruan, ta rrahë e ta lidhë atë nëse ajo refuzon t’i bindet, por burri nuk ka tagër mbi jetën e gruas. Siç shihet në këto dispozita konstatohet se sanksionohen rregulla në lidhje me dhunën në familje. Kanuni shkon më tej kur parashikon se nëse kunetërit rrahin një grua, prindërit e kësaj të fundit i lypin nderin, ndërkohë që nëse dikush jashtë familjes vret gruan, nderin e kërkon burri kurse gjakun e kërkojnë prindërit e saj. Nëse nëna është grindavece, i biri ka të drejtë ta përzerë atë nga shtëpia, por është i detyruar që vitin e parë t’i japë bukën e gojës.

Karakteristik në këtë kanun është parashikimi për virgjëreshat (femrat të cilat vishen si burrë) të cilat nuk veçohen nga gratë e tjera porse ato janë të lira të rrijnë me burra e megjithatë nuk kanë tagre në kuvend.

Kanuni i Labërisë, përmbante norma sjellje që nga lashtësia, nga ilirët, rendi gjinor, nga mesjeta dhe shtresëzime të reja. E drejta zakonore e Labërisë, ndonëse ka origjinën që nga lashtësia, gojëdhënat ia atribuojnë kanunin Papa Zhulit nga Zhulati, shekulli XI, i cili mendohet se ka qenë prift dhe prijës i Kurveleshit, i njohur përgjatë viteve 1080. Figura e papa Zhulit i takohës kohës së Bizantit. Kanuni i Labërisë mendohet se ka gjetur zbatim përgjatë viseve të Vlorës, Himarë, zonën bregdetare në tërësi, në Kurvelesh, Rrezome, Kardhiq, Rreze të Tepelenës dhe kudo ku banojnë labët si në Mallakastër e në një shkallë më të kufizuar në Gjirokastër dhe Delvinë. Rreth viteve 1840 – 1850 u bënë disa ndryshime në këtë kanun.

Edhe sipas kanunit të Labërisë, martesë ishte një marrëveshje që bëhej mes prindërve të çiftit të ri, pa u marrë mendimi i djalit apo i vajzës. Martesat shërbenin për të forcuar pozitat shoqërore të familjeve. Gruaja trajtohej si një qenie inferiore. Gruaja ishte në një pozitë pabarazie me burrin. Nga gjysma e dytë e shekullit të XVIII-të dhe fillimet e shekullit të XX-të, me ndryshimet e reja në shoqëri, tkurrjen e familjes, e cila nisi të zvogëlohej, duke u përmbledhur rreth trungut, konstatohet forcimi i pozitës së gruas, në ndryshim nga kanunet e zbatueshme në krahinat e tjera të Shqipërisë.

⁴ Shih neni 23, pjesa e dytë, Familja, Kanuni i Lek Dukagjinit.

Kështu gratë nuk do të visheshin më sipas zakoneve të lindjes (orientale), mund të shkonin në shkollë dhe u mor vendimi që të ndaloheshin fejesat që në djep.

Evoluimi i historisë së njerëzimit dhe gruas

Gjatë periudhës moderne, vitet 1700 dhe revolucionit francez, disa filozofë iluministë, si Voltaire, d'Holbach, Condorcet, kishin nisur të shpreheshin në favor të grave. Mary Wollstonecraft Godwin e lindur në Londër, në vitin 1759, ishte një filozofe dhe shkrimtare britanike, e konsideruar si themeluese e feminizmit liberal. Ajo u martua me filozofin William Godwin. Viti 1789, i cili është viti i fillimit të revolucionit francez, nuk kaloi pa u mirëpritur apo kritikuar edhe në Angli. Mary u përfshi pikërisht nëpërmjet shkrimeve të saj, në këtë rrymë të re që përshkonte shoqërinë. Ajo u bë e njohur për librin e saj "A vindication of the rights of the woman". Atje proklamoi se gratë nuk janë për shkak natyre inferiore karshi burrave por faji ishte i edukimit dhe i rregullave shoqërore që i imponoheshin. Ky është një ndër shkrimet e para të filozofisë feministe të botuar në vitin 1790. Sipas këtij shkrimi, gratë janë të rëndësishme për kombin për shkak të edukimit që i japin fëmijëve dhe janë shoqet e bashkëshortëve të tyre dhe jo thjesht bashkëshorte. Ato nuk janë thjesht sende zburuese por qenie njerëzore, titullare të të njëjtave të drejta themelore që u janë njohur edhe burrave. Ajo shkruajti: "Të mësuarat që nga fëmijëria, që bukuria është skeleti i gruas, shpirti i tyre merr formën e trupit të tyre dhe mbyllet në këtë guaskë dhe nuk bën gjë tjetër veçse zburon burgun e saj (Wallstonecraft, 157). Në dhjetë vjeçarët e parë të viteve 1800, gjatë fillësive të revolucionit industrial, gratë nisën të punësohen në fabrika edhe pse ende nuk ishin të barabarta me burrat. Në fund të viteve 1800, zhvillimi i shoqërisë në drejtim të urbanizimit dhe industrializimit, modifikoi mënyrën e jetesës e në këtë mënyrë edhe llojet e profesioneve. Gratë nisën të kenë më shumë autonomi. Ato filluan të arsimoheshin, të punësoheshin si infermiere, daktilografiste, sekretare, si shitëse, apo si punëtore në fabrika. Megjithatë ato vazhdonin të diskriminoheshin, shiheshin si shtëpiake gjithsesi, në shërbim të bashkëshortit dhe të fëmijëve. Shoqëria vazhdonte të mbetej maskiliste.

Në vitin 1890 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nisën shoqëritë e para femërore, që filluan të luftonin për të drejtën e votës dhe mundësinë për të marrë pjesë në jetën politike. Ky shembull u ndoq prej grave edhe në Britaninë e madhe në fillim të viteve 1900. Emmeline Pankhurst, themeloi në vitin 1903 Bashkim Social dhe Politik të Grave, me qëllimin e vetëm që gratë të arrinin të kishin të drejtën e votës. Qëllimi i tyre nuk ishte barazia vetëm në aspektin politik por edhe në atë juridik. Përpjekjet e këtyre grave për t'u njohur të drejtat, ishin shumë të ashpra duke pasur edhe sakrifica. Slogani që ato përdornin ishte "fakte dhe jo fjalë". Pankhurst u burgos disa herë.

Ndërkohë në Shqipëri, referuar institucioneve parlamentare konstatojmë se filluan të evidentoheshin në fund të vitit 1912, me shpalljen e pavarësisë. Kuvendi i Vlorës, shërbeu si organ legjislativ, për dy vjet deri në statutin e vitit 1914. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, përgatiti një draft kushtetues (statuti organik), që do të siguronte ngritjen e Asamblesë Kombëtare.

Fuqitë e Mëdha garantonin tërësinë dhe paprekshmërinë e tokave të Shqipërisë në kufijtë që ishin caktuar, duke njohur me të drejta sovrane princin Vilhelm Vid. Regjimi i princ Vidit u sanksionua nga Statuti Organik i Shqipërisë, i cili u hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit më datë 10.04.1914. Statuti organik i Shqipërisë

njihet edhe si Kushtetura e parë e shtetit shqiptar pas shpalljes së Pavarësisë. Ai përbehej nga 17 kapituj dhe 216 nene. Në këtë statut u proklamua se të gjithë shtetasit shqiptarë janë të barabartë përpara ligjit. Asnjëri nuk mund të ushtrojë vetëgjyqësinë në çfarëdo forme qoftë, përndryshe do t'i nënshtrohet dënimit të parashikuar nga ligji.

Në këtë statut është parashikuar garantimi i lirisë individuale, pacënueshmëria e pasurive të fituara ligjërisht, lira e të shprehurit.

Përgjatë luftës së parë botërore (1914 – 1918), gratë nisën të zinin vendet e burrave në punësim, për shkak se këta të fundit kishin shkuar në luftë. Gratë nisën të kryejnë profesionet e lodhshme të burrave. Megjithatë shpesh diskutohej, deri në kohët e vona nëse gruaja ka shpirt. “...Burri duhet të martohet dhe është gjë shumë e mirë, kur ai martohet me gruan që e dashuron. Nuk ka rëndësi nëse i pëlqen ai gruas apo jo. Një burrë i mençur nuk e kërkon dashamirësinë e një gruaje. Gruaja është trualli, kurse burri është mbjellësi. Si mund ta dashurojë toka fshatarin? Nuk ka se si. Mjafton që fshatari ta dojë tokën. Martohu. Veç mos harro se gruaja është vetëm një fushë dhe asgjë më shumë se kaq...Ato nuk kanë as mend, as shpirt. Pastaj për çfarë i duhen gruas ato? Për atë mjafton të jetë pjellore dhe të lindë shumë fëmijë. Mos harro...sipas ligjeve të sheritativit, dëshmia e një burri mund të barazpeshohet me dëshminë e tre grave...Një qenie që i mungon shpirti dhe arsyeja, nuk mund të ketë ide. Në jetën e përtej varrit gruaja nuk shkon as në parajsë, as në ferr. Pas vdekjes, ajo humbet, tretet. ...” (Said, 87).

Pas luftës së parë botërore, në 21 shtete u njoh e drejta e votës së grave. Megjithatë barazia me burrat ishte ende larg. Në këto vite në disa vende si Spanja, Italia, Gjermania, kushtet e grave nisën të vështirësoheshin e përkeqësoheshin pasi fashizmi dhe nacionalizmi i dha më shumë rëndësi kulturës maskiliste dhe antifeministe. Duçja proklamonte: “Gruaja duhet të bindet. Në shtetin tonë ajo nuk duhet të merret parasysht”⁵. Gruaja shihej si një objekt zburkures.

Në Shqipëri, pas zgjedhjeve të mbajtura në 31.01.1920, u krijua parlamenti i parë shqiptar. Ai përbëhej nga 37 anëtarë të zgjedhur nga vetë delegatët në Kongresin e Lushnjes. Kongresi shprehu vullnetin e shqiptarëve për të marrë fatin e vendit në duart e veta. Kryeministër u zgjodh Sulejman Delvina. Qëllimi i këtij kongresi ishte marrja e masave për të shpëtuar Shqipërinë nga rreziku i copëtimit. Megjithëse Shqipëria, nisi të hidhte hapa para, pozicioni i gruas, nuk dukej se po përmirësohej. Në ligjin “Për zgjedhjen e deputetëve” 05.12.1920, në nenin 6 theksohej: “...**gjithë ata burra që kanë mbushur moshën 20 vjeç e përpjetë, paguejnë a s’paguejnë vergji, kanë të drejtë vote në çdo zyre zgjedhjeje për zgjedhje të dytë**”. Pra gruaja ende nuk kishte arritur të drejtat e votës dhe nuk shihej si e barbartë me burrin. Ky ligj nuk dallohej për parime demokratike. Prej zgjedhjeve përjashtoheshin gratë dhe një pjesë e mirë e rinisë pasi zgjedhjet dy shkallës, pra do të bëheshin me votues të dytë. Zgjedhësit e parë duhet të kishin mbushur 20 vjeç dhe të dytët 25 vjeç, ndërkohë që për t’u zgjedhur deputet duhet të kishe mbushur moshën 30 vjeç.

Në zgjanimin e statutit të Lushnjes, në vitin 1922, u saksionuan të drejtat e qytetarëve në kapitullin e tretë. Sipas nenit 110, të gjithë pa ndryshim nënshtetësi, janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë baraz të drejtat civile, **përveç përjashtime të caktuara në ligj**. Të gjithë nënshtetasit gëzojnë baraz të drejtat politike dhe pranohen në të gjitha nëpunësitë civile e ushtarake, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj. Në ligjin “Për zgjedhjen e Mivvet të Kuvendit Kushtetues” të miratuar nga parlamenti më 05.10.1923, në n. 8 theksohet se: “Zgjedhës i parë është **çdo shtetas shqiptar mashkull që**

⁵ Skuola.net – Donne nella storia, saraasdp

gjendet i rregjistruem në listat e zgjedhësve dhe qi ka mbushun moshën e tij prej 18 vjetësh". Pra pavarësisht se flitej për barazi, konstatohej se kjo barazi nuk gjendet vend mes burrave dhe grave. Ligji përjashtonte nga e drejta e zgjedhjes aktive dhe pasive gratë.

Në vitin 1925, në Shqipëri u shpall Ligji Themeltar i Republikës Shqiptare, që përbën edhe kushtetutën e parë shqiptare. Republika ishte e bazuar në modelin e Republikës së Tretë Franceze (1870 – 1940), ishte parlamentare, me në krye një president të fuqishëm që ishte kreu i shtetit si dhe shëf i ekzekutivit (qeverisë). Pushteti ligjvënës ndërkaq i takonte dy dhomave të parlamentit, asaj të deputetëve dhe Senatit. Me këtë ligj u ruajtën parimet e ndarjes së pushteteve dhe sovranitetit⁶. Në kapitullin e III janë parashikuar të drejtat e qytetarëve. Neni 135 ndalonte çdo mundim trupi (torture). Në vitin 1928, Shqipëria shpallet Mbretëri Demokratike dhe parlamentare⁷. Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare, më datë 01.12.1928, në Titullin VI sanksionoi të drejtat e qytetarëve. Sipas nenit 191, çdo Shqiptar lind dhe rron i lirë. Në Shqipëri as blihet as shitet njeri; çdo njeri i blerë ose skllav, porsa të shkelë tokën shqiptare është i lirë. Neni 205 sanksiononte se çdo mundim trupi (torturë) është krejt i ndaluar. Kuvendi përveç statutit themeltar të Republikës Shqiptare miratoi edhe ligjin *"Për zgjedhjen e dhomës së deputetëve"* botuar në fletoren zyrtare nr. 10 të datës 14.03.1925. Nga ky ligj sërish mbeteshin të përjashtuar nga e drejta e zgjedhjes aktive dhe pasive gratë dhe ushtarakët.

Viktor Emanueli III, Mbret i Italisë dhe i Shqipërisë, Perandor i Etiopisë, duke proklamuar se po pranonte ofertën e kurorës së Shqipërisë, të vendosur prej Kuvendit Kushtetues të mbledhur në Tiranë më datë 12.04.1939, dekretoi Statutin Themeltar të Mbretërisë së Shqipërisë. Në kreun VI u përcaktuan të drejtat dhe detyrat e qytetarëve ku u sanksionua në n. 45 se qytetarët janë të gjithë një para ligjit. Ata gëzojnë të drejta civile dhe politike, dhe pranohen në pozicione civile dhe ushtarake përveç përjashtimeve të përcaktuara në ligj.

Gjatë periudhës së monarkisë, ligjit *"Për zgjedhjen e dhomës së deputetëve"* botuar në fletoren zyrtare nr. 10 të datës 14.03.1925 iu bënë vetëm disa ndryshime të vogla, por praktikisht, mbeti në fuqi deri në vitin 1945.

Ligji për zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit në Asambleenë Kushtetuese, i miratuar nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, i zgjedhur në Kongresin e Përmetit në vitin 1944, për herë të parë iu njoh grave e drejta e votimit dhe mosha minimale për të drejtën e zgjedhjes ishte 18 vjeç.

Në vitin 1946, në Shqipëri, me Statutin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, gruaja nisi të fitonte pozita të barabarta me burrin. Në n. 12 ky statut sanksiononte se të gjithë shtetasit janë njësoj përpara ligjit. Të gjithë shtetasit janë të barabartë pa ndryshim kombësie, race ose feje. Çdo akt që sjell privilegje në favor të shtetasvet ose që kufizon të drejtat e tyre për shkak ndryshimi në kombësi, racë ose fe, është kundra Statutit dhe sjell me vete dënime të parashikuara me ligjë. Është kundra Statutit dhe dënohet me ligj çdo provokim për të mbjellur urrejtje dhe grindje në mes të kombësive, racave dhe feve. Sipas n. 14, të gjithë shtetasit pa ndryshim seksi, kombësie, race, besimi, shkallë kulture ose banimi dhe që kanë mbushur 18 vjet, kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e pushtetit shtetëror. E drejta e votimit është e përgjithëshme, e barabartë, direkte dhe e fshehtë. Nuk kanë të drejtën e votimit personat që përjashtohen në bazë të ligjës. Neni 15 sanksionoi se gruaja është

⁶ 100 vjet shtet Drejtësia Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës, fjalim hyrës, 13 maj 2013 – Bashkim Dedja, Kryetar I Gjykatës Kushtetuese – gjk.gov.al

⁷ Oborrimbretërorshqiptar.al

njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe shoqërore. Gruaja ka të drejtë të shpërblehet njësoj me burrin për një punë të barabartë. Ajo ka po atë të drejtë dhe në sigurimet shoqërore. Shteti mbron veçanërisht interesat e nënës dhe të fëmijës duke siguruar të drejtën për një pushim të pagueshëm përpara dhe pas lindjes dhe duke krijuar shtëpira për gra që lindin dhe shtëpira për rritjen dhe strehimin e fëmijve. Të gjithë shtetasvet u garantohet liria e ndërgjegjës dhe e besimit. Neni 17 saksionoi se martesë dhe familja janë nënë mbrojtjeje e shtetit. Shteti cakton me ligj konditat juridike të martesës dhe të familjes. Prindërit kanë kundrejt fëmijve të lindur jashtë martesës po ato detyrime dhe detyra që kanë dhe kundrejt fëmijve të lindur me martesë. Fëmijët e lindur jashtë martesës kanë po ato të drejta që kanë dhe fëmijët e lindur me martesë. Të gjithë shtetasvet u garantohet liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e mbledhjes, e grumbullimit dhe e manifestimit publik. Sipas n. 18, për të gjithë shtetasit garantohet inviolabiliteti i personit. Asnjëri nuk mund të arrestohet për një kohë më tepër se tri ditë pa vendim të gjykatës ose pa pëlqimin e prokurorit publik. Dënimet nuk mund të caktohen dhe të jepen veçse në bazë të ligjës. Të gjithë shtetasit kanë, në kondita të caktuara prej ligjës, të drejtë njësoj të pranohen në nëpunësitë e shtetit.

Konkluzion

Këtë punim, do të donim ta mbyllim me disa fjalë nga Deklarata e të drejtave të gruas dhe qytetares, një test juridik francez që kërkon asimilimin e plotë ligjor, politik dhe social të gruas, i publikuar në vitin 1791 nga shkrimtarja Olympe de Gouges, mbështetur në modelin e Deklaratës së të drejtave të njeriut dhe të qytetarit në vitin 1789. *“Gruaja lind e lirë dhe me të njëjtat të drejta si burri. Dallimet shoqërore nuk mund të bëhen përveç se mbi interesin e përbashkët.”*

“Ligji duhet të jetë shprehje e vullnetit të përgjithshëm.”

Bibliografia

- Ali dhe Ninoja, autori Kurban Said, përktheu Guri Shyti, ISBN 978-99943-41-62-7, OMSCA.
Libri i zanafillw (Gjeneza).
M. Wollstonecraft, *“A vindication of the rights of the woman”*, 1970.
Shtefën Gjecovi, Kanuni i Lek Dukagjinit, ribotim 1933.

Legjislacioni

- Ligji *“Për zgjedhjen e deputetëve”* dt 05.12.1920.
Ligji *“Për zgjedhjen e Misvet të Kuvendit Kushtetues”* dt.05.10.1923.
Ligji Themeltar i Republikës Shqiptare, 1925.
Ligjin *“Për zgjedhjen e dhomës së deputetëve”*, dt. 14.03.1925.
Statuti i Lushnjes, 1922.
Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, dt. 01.12.1928.
Statutin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1946.

Aksesim në internet

- gjk.gov.al.
Oborrimbretërorshqiptar.al
Skuola.net

Mësimi i diferencuar në shkallë të ndryshme të vështirësisë, në shkollat fillore në Kosovë

Prof. assoc. Dr. Behxhet Gaxhiqi

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" Gjakovë

Me rastin e percaktimit të këtij hulumtimi i cili është me një rëndësi të veçantë, është shumë me rëndësi të cekim se deri më tani në këtë drejtim nuk është ndërmarrur asgjë konkrete, ngase siq dihet kanë ndikuar një numër i madh faktorëve të ndryshëm.

Me punën tonë do të mundohem që t'i specifikojm faktorët por edhe format dhe mundësit për zbatimin dhe aplikimin e një forme të këtill të mësimi, në shkollat tona.

Në vazhdimësi do ti njohim ata faktor të cilët janë efektiv dhe kanë ndikuar në këtë fushë të mësimi, në mënyrë që ti njohim dhe praktikojm në esencë në këtë fushë të mësimi.

Sot shumë nga ana e nxënësve në shkolla përdorin një varg formash dhe teknikash të ndryshme në mësim, dhe për këtë arsye nismëtarëve të shkollës duhet t'ju ofrojm një varg mundësish për ti shprehur dhe interpretuar aftësit e tyre në shkollë.

Rasti i përshpejtimit të teknikës dhe teknologjisë bëri që të ndihet nevoja që secili fëmijë të ketë aftësi në mënyra të ndryshme dhe për këtë ti ofrohen kushte që në një mënyrë ose në tjetrën të jenë të formuar dhe të zot për punë. Tema të cilën e kam zgjedhur për hulumtim i përgjigjet nevojave imanente të shoqëris nëpër të cilën po kalojmë sot.

Shumë nga ana e mësimit në ditët e sotme deri me sot aplikojn dhe përdorin një formë të njejt të ligjerimit, qka lënë për të nënkuptuar se nxënësit nuk mund të tregojn rezultate dhe efekte në mësim.

Thelbi dhe burimi i mësimi të diferencuar është përshtatja e përmbajtjeve të proceseve, metodave dhe materialeve, me ritmet e nxënies së nxënësve të ndryshëm, për ti arritur të njëjtat qëllime dhe objektiva. Duke u nisur nga arsyetja dhe mendimi se mësimi i diferencuar i gjuhës amtare dhe letërsisë është kërkesë e kohës por edhe e kushteve të reformimit të sistemit të arsimit dhe edukimit. "Gjatë përpjekjeve të deritanishme për të gjetur dhe zatur këso përmbajtje dhe forma metodike më të përshtatshme, para teorisë së mësimit në ditët e sotme u paraqiten dhe u parashtruan dilema të ndryshme se në çka të përqendrohej më shumë atë të përbashkëtën me të gjithë njerëzit e tjerë, te veçantë për vetëm disa njerëz apo vetëm ato veti dhe karakteristika për secilin nxënës" (Krasniqi, 2002, 235).

Përpunuesit por edhe përkrahësit teorik të sistemit të mësimi me tërë klasën, siq dihet klasën e kuptojnë si bashkësi relativisht të përhershme të nxënësve të moshave dhe paraditurive përafërsisht të njëjta te cilët nën udhëheqjen e arsimitarit dhe me pjesëmarrjen aktive të tyre në klasë edukohen dhe arsimohen.

Qëshjet e ndryshueshmërisë së nxënësve pikërisht në procesin e të nxënimit, detyrimisht të orienton drejt modelit të tanishëm të njohur dhe të pranuar të mësimit në ditët e sotme të diferencuar.

"Model ky i cili pranon forma metoda dhe strategji më të efektshme në procesin e punës mësimore në mësim, sepse kjo formë apo stategji e mësimi të diferencuar ju përgjigjet potencialeve dhe aftësive të ndryshme të të nxënimit në nivele dhe forma të ndryshme të shkollimit.

Ky model i mësimit në ditët e sotme pra mësimi i diferencuar vlerësohet si një praktik e sukseshme që

jep rezultate të kërkuara te të nxënëit.”¹

Përmes kësaj forme të mësimit përfitoj të gjitha grupet e nxënësve , duke filluar nga ata me vështirësi në të nxënë që kanë probleme në mësim e deri tek shtresa ma e lart e të kuptuarit të tyre , pra deri tek nxënësit e zgjuar dhe talent” (Zabeli, 2004, (Zabeli, 2004,30).

Megjithatë tash duhet të pranojmë se praktika e shkollës sonë deri me tani ka qenë e përqendruar në modelin tradicional të mësimit përmes se cilës pamundësohet marrja në konsideratë e nevojave dhe kërkesave të nxënësve gjë që kjo formë e tanishme,pra e mësimit të diferencuar,e forcon shumë ndjenjën e formimit të ndjenjave të nxënësve për punë në të nxënë dhe mësim .

Përdorimi deri me tani pra i formës frontale në mësim ka bërë që mësimdhënësit jo për nga dëshira por të ballafaquar me vështirësi si pasojë e modelit të aplikuar të mësimdhënjes pra të formës frontale të shfaqin edhe qëndrimin që shkon deri tek atje sa që duan te largojnë nga klasa nxënës me vështirësi te theksuar në të nxënë të cilët nxënës nga shumë shkaqe dhe faktor të ndryshëm tregoj rezultate dhe suksese të dobët në mësim.

Janë të shumta shkaqet që bënë të paraqitet dhe që me pak modifikime të qëndrojnë e të zbatohet edhe sot mësimi i njëhershëm me tërë klasën .

Por janë gjithashtu të shumta të natyrës se ndryshme vërejtjet dhe gjithnjë me të shpeshta thirrjet që ky. sistem i mësimit pra sistemi klasë orë dhe lëndë mësimore te zëvendësohet me një model te ri të mësimit i cili model t’ju përshatet nevojave dhe interesave të nxënësve duke pasur parasysh moshën afinitetin e tyre për të nxënë dhe mësim.

1.1. Sqarimi i nocioneve bazë për mësimin e diferencuar në mësim

Për ta hulumtuar sa më mirë dhe në mënyrë sa më të gjithanshëm problemin e mësimit të diferencuar ne shkalle te ndryshme te vështirësis, si problem me peshë dhe rëndësi të madhe përherë është aktuale dhe njeherit është e nevojshme t’i përcaktojmë dhe ti përkufizojmë disa nocione me të cilat mendojmë se do të ballafaqohemi në punën tonë studiuse.

Do të jetë njëra prej obligimeve por edhe detyrave që do të duhej ta bëjë çdo hulumtues. Ndodh shumë shpesh që në literaturë të gjenden mospajtime të shumta sa i përket termeve dhe nocioneve po ashtu edhe rreth përkufizimit , kuptimit dhe përmbajtjes së nocioneve.

Përkundër faktit se pjesa dërmuese e këtyre nocioneve janë të një procesi dhe dimensionit të përbashkët ku shpijnë drejt një synimi.

Mirëpo në punën tonë kemi të bëjmë me përdorimin e tyre të shpeshtë.

Duke u nisur nga konstatime termat që kërkojnë përkufizime e sqarime janë:

- nocioni mësim i individualizuar dhe
- nocioni mësim i diferencuar

a).Mësimi i diferencuar.Në literaturën didaktiko- metodike të kohë se re krahas ose madje edhe në vend të nocionit “ Mësim i individualizuar “ po përdoret e preferohet nocioni “ Mësim i diferencuar .“Në botimet e shkruara më herët por edhe në kohët e fundit mësimi i diferencuar po paraqitet e trajtohet si një model i veçantë midis dy sistemeve më të skajshme që janë; mësim i individualizuar dhe mësim i njëtrajtshëm frontal më tërë klasën .

Përmes tij po insistohet të shfrytëzohen përparësitë dhe neutralizohen dobësitë karakteristike të këtyre dy sistemeve të skajshme.

Nisja e mëtutjeshme e mësimit të diferencuar në shkollë unike është kuptimi sipas të cilit të gjithë nxënësit e klasës në shkollën e tipit dhe të nivelit të njëjtë duhet të përvojtojnë një

¹ Plani e programi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë për shkollën fillore, Klasa I-IV, Prishtinë, 1989.

minimum të diturive të domosdoshme nga të gjitha lëndët mësimore, dhe krahas kësaj në një mënyrë më të gjerë e më të thellë mund të mësojnë ndonjë nga lëndët ose edhe ndonjëren nga ato disiplinat të cilat nuk janë të përfshira në planin mësimor. Përmes kësaj forme të mësimimit, pra të mësimimit të diferencuar, sigurohet mundësia që nxënësit e klasës në shkollën e tipit e të nivelit të njëjtë të marrin edhe përmbajtje të vëllimit e të vështirësisë edhe nga fusha dhe disiplina të tjera që u përgjigjen interesave dhe afiniteteve të nxënësve dhe mundësive të përparimit të tyre.

Pikërisht për këtë mësimi i diferencuar është ai i cili mundëson përfilljen e intencave të shkollës unike, por edhe plotësimin e kërkesave individuale të nxënësve.²

Këtu e shohim të udhës të japim një përkufizim më të përafërt të mësimimit të diferencuar si një modaliteti i veçantë midis dy sistemeve më të skajshme mësimore që është.

Autor të ndryshëm të cilët u morën me këtë problematik të mësimimit, kanë dhënë përkufizime të ndryshme lidhur me mësimin e diferencuar. "Ndër autorët që është marrur me këtë problematik : (SLOTA), i cili me mësimin e diferencuar kupton tërësinë e masave dhe veprimeve mësimore përmes të cilave sistemi i njëtrajtshtëm i mësimimit më tërë klasën tejkalohet me masa më fleksibile të mësimimit" (Osmani, 1983, 12).

Nga ky konstatim (SLOTA) jep një përkufizim të përgjithshëm, ku përveç fleksibilitetit nuk jep përcaktues të tjerë që do të mësonin më shumë për mësimin e diferencuar.

- Një përkufizim të ngjashëm dhe jo fortë të përcaktueshëm e gjejmë edhe tek (ENCIKLOPEDIJA D), ku këtu mësimi i diferencuar kuptohet si masë organizative e cila në mënyrë demokratike i orienton nxënësit sipas dallimeve specifike ndërmjet tyre në grupe të përhershme ose të përkohshme si në grupet homogjene po ashtu edhe në ato heterogjene.

- Duke u nisur nga konstatimet e shumë autoreve të ndryshëm sot është problemë diskutimi i më shumë institucioneve e shoqatave të ndryshme, të cilat përpiqen gjithnjë që këtë formë të mësimimit ta ngrisin në një shkallë më të lartë të afirmimit dhe të zbatueshmërisë në mësim.

Sipas (KULIGOVSKA) mësimi i diferencua është sistem i organizimit të mësimimit i cili bënë të mundshëm përvojën e një fondi të caktuar të diturive e shkathtësive nga ana e gjithë nxënësve dhe nxitjen e zhvillimit e aftësive dhe të interesave individuale të tyre.

Nga ky sqarim i mësimimit të diferencuar mund të hetohet esenca e mësimimit të diferencuar dha dallimet e kësaj forme të mësimimit me sistemet më të skajshëm siç janë : mësimi i njëtrajtshtëm frontal me tërë klasën dhe mësimi krejtësisht i individualizuar.

Nga konstatimet e dhëna më lartë mësimi i diferencuar qëndron dhe duhet të kuptohet si një relacion midis polaritetit të mësimimit të nivelizuar frontal dhe lirisë individuale me q' rast gjithherë paraqitet raporti i arsimit të përbashkët të zhvillim individual, mësim i përbashkët dhe zhvillim i afiniteteve e mundësive individuale të çdo nxënësi në mësim" (Djordjevic, 1981, 117-118).

Për mësimin e diferencuar do të thoshim se është një modaliteti i veçantë i organizimit të mësimimit, i cili modaliteti i mësimimit kërkon që përmbi minimumin arsimor e të përbashkët e obligativ për të gjithë nxënësit të siguroj edhe përmbajtje por edhe dinamikë të të nxënësve dhe mësimimit që i përgjigjet afiniteteve dhe mundësive individuale të çdo nxënësi.

Në një burim e gjejmë sipas të cilit mësimi i individualizuar, ju përshatet të gjitha nevojave dhe mundësive individuale të nxënësve.

Mësimi i individualizuar nuk ka të bëjë vetëm me gjerësinë dhe thellësinë e lëndës mësimore, por ka të bëjë edhe me fushat e zgjedhjes së lëndës.

(Pedagogjia moderne) lejon që deri në një fare mase të bëhet edhe zgjedhja e përmbajtjeve të ndryshme dhe vlera e tyre të matet sipas logjikës e ekuivalencës e jo sipas logjikes e vlerës

² Pedagoska enciklopedija I.(1989) Beograd. fq. 127-128.

hierarkike.

Autor të ndryshëm këtë problematik e kanë trajtuar në forma të ndryshme ku në **disa burime e gjejmë sipas** së cilës mësimi i individualizuar nënkupton rrugët me të cilat mund të plotësohen nevojat individuale të çdo nxënësi, në atë mënyrë që të ndikojë në maksimum në procesin e nxënies dhe të zhvillimit të tij.

“Përveç këtij emërtimi në literaturë e gjejmë edhe përkufizimin sipas të cilit me mësimin e individualizuar nënkuptojmë rrugët me të cilën mund të plotësohen nevojat individuale të çdo nxënësi në atë mënyrë që të ndikojë në maksimum në procesin e nxënës dhe të zhvillimit të tij.”³ caktuar kohore të meret me pak ose më shumë me punë individuale të cilën e zgjedh vetë ose ja cakton arsimtari, por që i përgjigjet mundësive reale të tij” (Mandiq, 1985, 88-89).

Sipas (E.J. KIRILOVA 1986) me mësimin e individualizuar nënkuptojmë sistemin e metodave dhe organizimin e mësimin të drejtuar për tip të caktuar të personalitetit. Ndërsa autorët amerikan (GEJXH dhe BERLINER 2005), sipas tyre mësimi i individualizuar është përshtatje e detyrave e materialeve dhe përmbajtjeve dhe metodave të të nxënës dhe mësimin të çdo nxënësi ose një grupi ma të vogël nxënësishë me karakteristika të përbashkëta. Profesori i Universitetit të Pitsburgut (GLEN HEATHERS) 2003, i cili jep sqarime lidhur me mësimin e individualizuar, secila prej këtyre sqarimeve ka lidhmerin, dhe karakteristikën e vet

a) Nxënësit mund të kryejnë detyra të ndryshme, por edhe me qëllime të ndryshme por gjithmonë duke u bazuar në kuadër të një programi më të gjerë të punës mësimore.

Në bazë të këtij sqarimi të gjithë nxënësit i përcjellin sekuencat e njëjta të detyrave në kuadër të një programi të përbashkët, por në fusha të këtyre përmbajtjeve lejohet zgjedhja e përmbajtjeve specifike që e tërheq dhe e nxit punën e tyre kërkimore. ⁴

b) Nxënësit mund të përdorin material të ndryshme por duke punuar në zgjedhjen e detyrave të njëjta dhe për të njëjtin qëllim. Secili prej grupit të nxënësve mund të lexojnë material të tematikave të tjera

c) Tema e zgjedhur për mësim mund të mësohet në situata të ndryshme. Derisa disa nxënës e mësojnë temën në Bibliotekë, disa të tjerë mund të shikojnë fotografite vizuale –auditive, grupi tjetër punon me arsimtarin, por secili grup nga ana e nxënësve caktohet për atë pjesë që ka interesim ma të madhë.

ç) Në mësimin e individualizuar ekzistojnë mundësitë që nxënësi të punojë me ndonjë arsimtar gjatë punimit të ndonjë teme, apo në ndonjë fushë veprimtari tjetër, kjo mundësi u ipet nxënësve se ata dallohen për nga interesimi i tyre por edhe për nga nxënja e tyre për mësim. Fillimet e para të mësimin të diferencuar ishin fillimet e **Planit Dalton**, të zhvilluar rreth viteve 1910 nga pedagogjia, HELEN PARKHURST (1887-1973), plan të cilin ajo i vuri emrin e qytetit ku u eksperimentua për herë të parë. Helena, kishte krijuar një klasë me 40 fëmijë të moshave nga 8-12 vjeç, për të cilët vuri në jetë një sistem fisheve personale, nëpërmjet të cilëve secili nxënës kishte një plan individual.

E ndikuar nga shkrimet e (XHON DJUIT), ajo kishte vizituar shkollat e para të reja në EVROPE si dhe njherit dha mësim në shkollën e (MARIA MONTESORIT). Pedagogu gjerman Hat (Huth A.1986) ka insistuar për zbatimin e mësimin të diferencuar në shkollat fillore. Kjo ka qenë diferencimi i organizuar.

Klasat janë formuar në bazë të rezultateve të atestuara të aftësive intelektuale.

³ Fjalori i Fjalëve të Huaja, Prishtinë, 1988, fq. 257.

⁴ Po aty. fq.91.

“Për këto grupe homogjene të seleksionuara ka pasur zgjedhje të ndryshme të përmbajtjeve mësimore, procedurave dhe metodave të punës. Një organizim të njëjtë e ka zbatuar edhe Sikinger(Sickinger A.) në fillim të këtij shekulli në organizimin e mësimnit sipas niveleve dhe dijës së nxënësve në kuadër të punës në mësim.

Është mënyra e njëjtë e formimit të klasave. Në klasë është punuar sipas programit të *MANJHAJM të Gjermanisë*. Pas përvetësimit të programit nxënësit e klasave të ndryshme nuk i kanë pasur mundësitë dhe të drejtat e njëjta për vazhdimin e shkollimit.

Diferencimi i organizuar i jashtëm është zbatuar në Jena-Planin Petersenit.

Nxënësit i kanë ndarë në grupe, e më pastaj të njëjtit edhe në nëngrupe më të vogla, në mënyrë që ata të punojnë sipas aftësive të veta. Këtu hasim, përveç diferencimit të jashtëm edhe tendencat e diferencimit të brendshëm.

Një hap të mëtutjeshëm në drejtim të mësimit të diferencuar kanë dhënë përfaqësuesit e “shkollës punuese” gjermane. (*Gaudig (Gaudig H.)* e ka theksuar rëndësinë e punës së lire.”⁵

Kurse Shaibner (Schibner) është angazhuar për stilin personal të punës së çdo nxënësi. Modifikim të konsideruar për mësimin e individualizuar në Amerikë kanë dhënë : *Djui, Kolings dhe Kilpartik (projektet dhe metodat.*

(*Filip Kums 2005*) thekson: Nëse një nxënës i mëson përgjigjet më shpejt se sa shokët e vet të klasës, fillon ta kap monotonia, kurse, nëse i mëson më ngadalë atëherë ai demoralizohet.

A thua a nuk ekzistojnë rrugë më të mira që të shfrytëzohet kjo kureshtje natyrore e fëmijëve, llojllojshmëria dhe aftësia e tyre- pa marrë parasysh nivelin apo llojin e inteligjencës së çdo nxënësi veç e veç – që ata vetë ti njohin gjërat”. (Kums, 1971, 19). Diferencimi i mësimit shkollor me anë të mësimit të niveleve dhe rëndësive të ndryshme, ofron mundësinë e pranimit të atyre kërkesave.

Është e njohur se në gjysmën e shek.XX, lajmërohet prezantimi shkencor i problemit të ndryshimeve të diferencimit të mësimit.

Shkencëtarët, kryesisht pajtohen se të gjitha variabilet psikologjike (aftësitë, interesimet...) në gjithë popullatën distribuohen normalisht. Në këtë fakt bazohen thuaja se të gjitha hulumtimet e diferencave individuale.

Disa hulumtues janë munduar që në bazë të supozimeve të karta teorike të bëjnë hulumtimin e mësimit të diferencuar.

Sipas teorisë së Ajzenkovës (H.J. Eysenck 1986), ekzistojnë diferencat e natyrshme në konstituivin e sistemit nervor të njeriut të cilat normalisht përcaktohen, respektivisht radhiten, njëra pas tjetrës.

Për këtë njerëzit kushtëzohen në mënyra të ndryshme. Kushtëzimet paraqesin bazën e procesit mësimor prandaj disa persona mësojnë më mire se ata të rregullave tjera shoqërore.

Kjo teori paraqet orvatjen e sqarimit të diferencave të mësimit të diferencuar duke përdorur principet e thjeshta të hulumtimeve shkencore.⁶

Modeli struktural i intelektit të (*Gilfordovit 1987*) apostrofon ekzistimin e 120 faktorëve. Secili faktor i përcakton tri klasë të variablilit: përmbajtjet, operacionet, produktet.

Empirikisht është vërtetuar se ekzistojnë 98 faktor. Janë të shumta diferencat individuale në krahasim me zhvillimin e atyre faktorëve.

⁵ Po aty, fq.94

⁶ Prema djelju: Riqard Kirbi i Dzon Redford, Individualne razlike, Nolit Beograd, 1978, str.fq.37

Katel (Cattell.R.1856) konsideron se njerëzit dallojnë në krahasim me zhvillimin e aftësive: inteligjenca fluide (e rrjedhshme), inteligjenca e kristalizuar, faktori vizual dhe faktori i shpejtësisë.*Olport (Gordon Allport 1994)*, thekson faktin se karakteristikë e theksuar e njeriut është individualiteti i tij. Gjatë gjithë jetës sonë të zgjuar, edhe në ëndrra, i njohim njerëzit dhe kemi punë me njerëzit si individua të ndara, të caktuara dhe unike (Olport, 1969, 12).

Kjo për kohën e sotme është e nevojshme shumë, sepse fëmija ynë sot, nuk është çfarë ishte dje. Në kushtet e reja të jetës sot ai piqet më herët për shkollë dhe është më i përgatitur për një mësim më ekonomik, më racional dhe më efikas, sesa që ishte dje. Rëndësi tjetër e mësimi të diferencuar qëndron në faktin se bën të mundur dhe ndihmon realizimin e intencave të shkollës fillore unike.

Kjo është intencë e shkollës fillore unike sepse duke marrur parasysh mundësitë dhe interesat individuale të gjithë nxënësve t'u ofrojë bazat e përbashkëta të mësimi. *Klakhon i Mari & Kluckhen C. and Marray 2003*) pohojnë se çdo njeri në masë të konsiderueshme është: a) si edhe të gjithë njerëzit tjerë(i normës universale), b)si di sa njerëz të tjerë(i inormës grupore) c) si asnjë njeri tjetër(i norës idiosinkratike) (*Kenckoholn, Murry & Schneider, 1953, 53*).

Zhvillimi i shkencave psikologjike dhe pedagogjike ka kontribuar që të hedhet poshtë ideja mbi barazinë e nxënësve në klasë. Është vërtetuar se nuk ekziston asnjë aspekt i zhvillimit të nxënësve sipas të cilit klasa është grup homogjene. *Markovac1854* shqyrton dallimet e nxënësve në cilësitë trupore, zhvillimin metal, dijes dhe përparimit në mësim. Dallimet në të mbajturit mend tek nxënësit me inteligjencë të njëjtë përmbajnë rreth pesë vite (*Markovac, 1970,86*). *Janë të rëndësishme dallimet individuale të nxënësve në zhvillimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve. (Kvashqev D.Radivoj1987)* -tregon se nuk është zbuluar një aftësi e përgjithshme e zgjidhjes së problemeve, po është identifikuar grupa e aftësive të ndryshme të zgjidhjes së problemeve siç janë:

- a) aftësia e manipulimit me simbolet dhe rezonimin e simboleve matematikore,
- b) ndjeshmëria për problemet,
- c) aftësia e vendosjes dhe testimit të hipotezës,
- d) aftësia e të kuptuarit verbal,
- e) fleksibiliteti i mendimit,
- f) rezonimi i përgjithshëm dhe
- g) aktori i evolucionit logjik (*Kvasvec, 1978, 4-5*).

Ekzistojnë mundësi të ndryshme të diferencimit të procesit mësimor në krahasim me zhvillimin e aftësive mësimore të nxënësve për zgjidhjen e problemeve. Disa autor i dallojnë ndryshimet e brendshme nga ato të jashtme individuale të nxënësve. *Dzhensen (Jensen 1983)* fletë për ndryshimet individuale si pasojë e mësimi. **Sipas mendimit të tij, ekzistojnë dallimet e brendshme dhe të jashtme individuale.**

- a) Në dallimet e jashtme individuale bëjnë pjesë qëndrimet ndaj mësimi në shkollë, koha kronologjike etj. (*Kvasvec, 1978, 34*),
- b) kurse dallimet e brendshme individuale janë aftësitë, virtytet personale etj.

Që të realizohet mësimdhënia e diferencuar duhen plotësuar këto kushte thelbësore:

- a. hartimi i një programi mësimor cilësor,
- b. kryerja e veprimtarive mësimore të përshtatshme,
- c. grupimi fleksibël,
- d. vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve,
- e. aktivizimi i lartë i nxënësve,
- f. fokusimi i mësimdhënies në konceptet themelore.

g. *Hartimi i një programi mësimor cilësor*

Sipas studiuësve, programi mësimor cilësor duhet të ketë të përcaktuar disa cilësi:

- 1) *Të jetë i këndshëm (interesant)*
- 2) *Të jetë i fokusuar jo konfuz*
- 3) *Të ofroj zgjedhje për nxënësin*
- 4) *Ta angazhoj ata nga ana emocionale*
- 5) *Të jetë i qartë në atë që kërkon të arrijë*
- 6) *Të lejojë dhe stimulojë bashkëpunimin me nxënësit*
- 7) *Të fokusohet në produktet e nxënësve, që kanë rëndësi për ta,*
- 8) *Të ketë lidhje me jetën e nxënësve*
- 9) *Të jetë i freskët dhe befasues*
- 10) *Të jetë real, koherent dhe sfidues për nxënësit*
- 11) *Ti ftojë nxënësit të përdorin atë që kanë mësuar në mënyrë të dobishme*
- 12) *T'i përfshijë ata në vendosjen e qëllimeve dhe në vlerësimin e përparimit të tyre.*
- 13) *Kryerja e veprimtarive mësimore të përshtatshme*

Të mësuarit e diferencuar kërkon që të kryhen një sërë veprimtarish mësimore që janë të përshtatshme, ndër ato veprimtarish që duhet të përfshihen janë: *veprimtaria që angazhojnë dhe stimulojnë të gjithë nxënësit ti bëjnë ata që duke u angazhuar në aftësitë të përparojnë në mënyrë të vazhdueshme, veprimtari që angazhojnë të gjithë nxënësit e një klase në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga fakti se ata kryejnë të njëjtin veprimtari ose veprimtari të ndryshme. Veprimtaria që synojnë që të gjithë nxënësit , dhe jo vetëm më të përparuarit, të arrijnë nivelin optimal. Kur mësuesi dhe nxënësit punojnë së bashku me mënyrat më të mira për ti arritur këto qëllime në një atmosferë respekti reciprok dhe nxitjeje të përbashkët, ka më shumë mundësi për arritje personale dhe zhvillim.*

Ndërkohë, të mësuarit e diferencuar është i pamundur që të realizohet në kushtet kur në klasë kryhen veprimtari të tilla që nuk respektojnë kohën e nxënësit si psh:

- a) *të punuarit me një program mësimor që nuk përputhet me zhvillimin e nxënësve ose është i vështirë ose shumë i lehtë, me një program që nuk lidhet me jetën dhe përvojat e fëmijëve dhe detyrat mësimore që kanë natyrë thjesht krijuese.*

Radhitja dhe grupimi i nxënësve. Një mësimdhënie e diferencuar e suksesshme kërkon që grupimi i nxënësve në klasë të jetë fleksibil. " Më konkretisht, kërkon që mësuesi të alternojë sipas synimeve të tij punën me të gjithë klasën si punën me:

Punë në qifte ose në grupe të vogla dhe punë individuale. Çelësi për një grupim të suksesshëm të nxënësve në orën mësimore është ndërgjegjësim i mësuesve për qëllimet e tyre të mësimdhënies. Në mësimdhënien e diferencuar nxënësit grupohen dhe rigrupohen në mënyra të ndryshme dhe në bazë të parametrave të ndryshëm. Mësuesit mund ti grupojnë nxënësit në bazë të interesave të tyre, në bazë të profileve të tyre të të mësuarit si dhe në bazë të nivelit të gatishmërisë së nxënësve për të mësuar (Muka, Karaj & Cela, 2006, 30). " Disa nga detyrat e nxënësve janë të bazuara në gatishmërinë, disa të tjera në interesa, disa herë ndërtohen për tu përshtatur me stilin e të mësuarit.

Në një klasë të diferencuar mësimdhënia në të gjithë grupin mund të përdoret për të prezantuar ide të reja, kur kjo është e planifikuar, si dhe për të bërë të ditur rezultatet e të mësuarit. "Psh: një ditë nxënësit mund të punojnë me nxënës të tjerë të cilët kanë të njëjtin nivel të zgjidhjes së problemeve aritmetike. Një ditë tjetër ata mund të grupohen në bazë të një interesi të përbashkët, si psh: interes për të vizatuar. Kur mësuesit i kanë të qarta këto dy aspekte atëherë ai mund të vendosë t'i grupojë nxënësit në bazë të interesit, profilit të mësuarit ose gatishmërisë pra ti vendos nxënësit në një

grup homogjen ose në një grup heterogjen (Muka, Karaj & Cela, 2006, 33).

Por këto dy lloje grupimesh nuk duhet të jenë afatgjata

- b) Një mësues më përvojë të gjatë ka gjithmonë parasysh se nuk duhet të përdorë në mënyrë të tepruar një lloj grupimi dhe sidomos grupimin në bazë të nivelit të gatishmërisë së nxënësve për të mësuar.
- c) Ndërsa nëse një mësues përdor për një kohë të gjatë grupimin në bazë të nivelit të gatishmërisë së nxënësve për të mësuar ai nuk bënë gjë tjetër veçse i karakterizon nxënësit në nxënës të nivelit më të ulët dhe në nxënës të nivelit më të lartë.

Përmbledhje e punimit

Deri me sot me rastin e aplikimit të modelve të vjetëra të mësimdhënies efektet e përqendrimit të nxënësve në mësim nuk kanë qenë në nivelin e duhur të përqendrimit dhe të treguarit të rezultateve, për vete faktin se organizimi i mësimin nuk ka qenë i organizuar sipas niveleve të ndryshme të nxënësve në mësim.

Sepse mësimi nuk ka qenë i organizuar sipas niveleve të shkallës së ndryshme në mësim.

Përdorimi deri me tani pra i formës frontale në mësim ka bërë që mësimdhënësit jo për nga dëshira por të ballafaquar me vështirësi si pasojë e modelit të aplikuar të mësimdhënies pra të formës frontale të shfaqin edhe qëndrimin që shkon deri tek atje sa që duan të largojnë nga klasa nxënës me vështirësi të theksuar në të nxënë të cilët nxënës nga shumë shkaqe dhe faktor të ndryshëm tregojnë rezultate dhe suksese të dobëta në mësim.

Janë të shumta shkaqet që bënë të paraqitet dhe që me pak modifikime të qëndrojnë e të zbatohet edhe sot mësimi i njëhershëm me tërë klasën.

Por janë gjithashtu të shumta e të natyrës së ndryshme vërejtjet dhe gjithnjë me të shpeshta thirrjet që ky sistem i mësimin pra sistemi i klasës orë dhe lëndë mësimore të zëvendësohet me një model të ri të mësimin i cili model t'ju përshtatet nevojave dhe interesave të nxënësve duke pasur parasysh moshën afinitetin e tyre për të nxënë dhe mësim.

Duke e kuptuar si të domosdoshme dhe të rrugës së është mase enevojshme aplikimi i formave dhe modeleve më bashkohore të mësimdhënies e konkretisht i Mësimin të diferencuar.

Në aktualitetin e punës edukative arsimore aplikimi i mësimin të individualizuar, është kuptuar në një shkallë të ndryshme të përqendrimit për vetë faktin se mësimi i individualizuar ju përshtatet nevojave individuale të nxënësve në mësim, por gjithnjë duke e kuptuar mase të rrugës dhe të nevojshme se në shkollë dhe në shoqëri në përgjithësi nuk mund të gjejnë dy fëmijë, nxënës me një nivel të njëjtë të njohurive, shprehive dhe të shkathtësive.

Aktualiteti i ndryshimeve ka bërë që në një formë ose në tjetër të ndodhin ndryshime në të kuptuarit të përmbajtedheve metodave të ndryshme në të nxënë dhe mësim, dhe për këtë sfidat e reformave në fushat e ndryshme të edukimit dhe të arsimimit kanë bërë që nxënësit nismetar të shkollës fillore sot të mos vijnë më një diapazon të njëjtë të njohurive, dhe me një përgatitje të njëjtë në mësim, por të jenë ma të përgatitur për mësim, dhe për aktivitete të ndryshme në mësim.

Por janë gjithashtu të shumta e të natyrës së ndryshme vërejtjet dhe gjithnjë me të shpeshta thirrjet që sistemi i mësimin të njëtrajshëm me tërë klasën të shoqërohet ose edhe të zëvendësohet fare me sisteme e modalitete të reja të organizimit të mësimin.

Për këtë dhe për arsye të tjera, në literaturën didaktiko- metodike të kohës ma të re, krahas ose madje në vëndë të nocionit "Mësim i individualizuar, po përdorët e preferohet nocioni "Mësim i diferencuar."

Sepse kjo është njëra ndër format dhe metodat ma të përshtateshme dhe ma efektive në aktualitetin e problemit të fushës së edukimit dhe të mësimt.

Duke u nisur nga ky fakt duhet që të punohet në një avancim ma të përparuar që krahas mësimt obligativ e të përbashkët për të gjithë nxënësit të zbatohet edhe mësimi i diferencuar, sepse edhe kjo është nevojë imanent e shoqërisë.

Sot shkolla dhe shoqëria po përballet me shumë vështirësi dhe po kalon sfida të forta në mision për ndërtimin e jetës sociale, ekonomike dhe kulturore me qëllim të një jete sa ma të mirë dhe të begatshme për të gjithë shtresat e shoqërisë.

Arsimimi duhet të drejtohet kah zhvillimi i plot i personalitetit njerëzor dhe kah ndjenja e dinjitetit të tij. Arsimimi do ta forcoj respektin për të drejtat njerëzore dhe lirit themelore. Andaj me tej pajtohem se arsimimi do t'ju mundësoj të gjithë personave që të marrin pjesë efektivisht në shoqërinë e lirë, përkrah mirëkuptimit, tolerancën, dhe respektin për të gjithë.

Literatura

Krasniqi, dr, Islam (1997): Për një përgatitje më cilësore te nxënësve nismëtarë të shkollës fillore për lexim dhe shkrim, "Buletini " i Fakultetit Filozofik, Prishtinë, 1997, nr:XXIV.

Besho, Faruk, (2004): Mbi mundësinë e rritjes së shpejtësisë së transmetimit të njoftimeve në telegrafi duke marrë parasysh probabilitetin e përdorimit të shkronjave dhe fenomeneve të ndryshme në gjuhën shqipe, "BULETINI", i USHT-së ,nr:2.

Karaj, Prof. Dr. Theodor (2003): Trajtimi i Diferencuar i nxënësve, në Aspekte psiko-pedagogjike, ISP, Tiranë.

Karaj, Prof. Dr. Theodor (2003): Përfshirja e prindërve në edukim, në Aspekte psiko-pedagogjike, ISP, Tiranë .

Musai, Bardhyl (2003): Metodologjia e mësimdhënies, PEGI, Tiranë.

Miller, Bonnie (2003): Si të krijohet kontakti me nxënësit – Doracak për arsimtarë, QPEA, Prishtinë.

Musai, Bardhyl (1999): Psikologji edukimi – zhvillimi, të nxënët, mësimdhënia , PEGI, Tiranë.

Nano, Prof. Ass. Virxhil (2003): Trajtimi i fëmijëve me vështirësi shkollore, sfidë për përmirësimin e shkollës, në Kurrikula dhe shkolla – cikli fillor 5, ISP, Tiranë .

Saqellari, Spiro (2003): Fëmija im akoma nuk po flet... çfarë të bëjë? "Albin" Tiranë.

CDE (2003): Të gjithë ne jemi inteligjentë – Shmangia e diskriminimit intelektual të fëmijëve , Tiranë.

Behler, Robert F. Jack Snoëman (2004): Psikologhja e zbatuar në mësimdhënie ,ISP, Tiranë.

Të nxënët ndërveprues (2001):- Udhëzues 1. 2. 3. 4. 5. 6. 7.8. KEC & ARA, Prishtinë.

Petar Mandiq, Dr, (1985): Novacionet në Mësim, Prishtinë.

Maja Span. Mr. (1973): Primjena Programirane Nastave u Praksi, Zagreb.

Vaxhid. Nuredini Dr. (1999): Orientimi Profesional i nxënësve, Prishtinë.

Muzic. V. (1997): Metodologjia pedagogskog istrazivanja. Sarajevo.

Tomlinson, Carol Ann (2001): How to Differentiate Instruction in Mixed-Ability Classrooms. Alexandria, Virginia USA.

Bacon.

Nushi, Dr, Pajazit (1995): Psikologjia e përgjithshme, Universiteti i Prishtinës.

Dhuna ndaj gruas në këndvështrimin e legjislacionit vendas dhe atë ndërkombëtar

PhD Lorena Musai

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Magjistrat Enkeleda Millonai

Prokurore, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Abstrakt

Qëllimi i këtij artikulli është evidentimi jo vetëm i të drejtave të grave por edhe implementimi i tyre me sukses në jetën e përditshme. Të përshtatësh legjislacionin kombëtar me atë ndërkombëtarë është një sfidë për çdo shtet. Mbrojtja e grave nga diskriminimi dhe ushtrimi i dhunës, duke i siguruar atyre parimin e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pjesëmarrjen e tyre, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes me qëllim marrjen e masave të nevojshme për eliminimin e këtij diskriminimi në të gjitha format dhe shfaqjet e tij, nga çdo shtet duke përshtatur legjislacionin e tij të brëndshëm në zbatimin e konventave ndërkombëtare.

Fjalë Kyce: të drejta, grua, dhunë, mbrojtje, ligj.

Hyrje

Të flasësh për të drejtat e gruas në shoqërinë Shqiptare, është e rëndësishme të shohësh jo vetëm kuadrin ligjor të brëndshëm por edhe atë ndërkombëtar, për të kuptuar nëse po përparohet me hapa të mëdha apo të ngadaltë drejt impelemntimit të këtyre të drejtave. Barazia gjinore është sanksionur që në kohën e regjimit komunist, e cila e shihte gruan njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe shoqërore, ku martesat dhe familja ishin në mbrojtje të shtetit duke i dhënë në këtë mënyrë mbrojtje të vecantë gruas dhe fëmijëve. Paralelisht në nivelin ndërkombëtar jo vetëm të drejtave të grave iu dha rëndësi por edhe u tuteluan përsa i përket ushtrimit të dhunës ndaj tyre, ku mund të përmendim e Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW),1979. Me miratimin e K.Penal, K.Civil, nisi të vërehet se qëllimi i Shqipërisë, ishte drejt barazisë gjinore, drejt pranimit të mosdiskriminimit në bazë të seksit. Me ratifikimin e Konventës CEDAW, me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollit shtesë të kësaj konvente, me Ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, shteti shqiptar shprehu vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave.

Implementimi i të drejtave të gruas gjatë regjimit komunist në Shqipëri

Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Në pjesën hyrëse

proklamohej se meqë njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; meqë popujt e Kombeve të Bashkuara përsëri shpallën në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe në vlerën e personalitetit të njeriut dhe në barazinë midis burrave e grave dhe vendosën të nxisin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetesës në një liri më të plotë, Asambleja vendosi të shpallte këtë deklaratë, si ideal të përbashkët të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm i shoqërisë, duke pasur parasysh gjithnjë këtë Deklaratë, të synojnë që me anë të arsimit dhe edukimit, t'i kontribuojnë respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive dhe që me masa progresive kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurojnë njohjen dhe zbatimin e tyre të përgjithshëm dhe të njëmendtë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që ndodhen nën administrimin e tyre.

Sipas nenit 1 të kësaj deklarate, të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit në një frymë vëllazërore

Neni 2, sanksionoi se secilit i përkasin të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa kurrfarë dallimesh në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike. Përveç kësaj, nuk do të bëhen kurrfarë dallimesh në bazë të statusit politik, juridik apo ndërkombëtar të vendit ose territorit të cilit i përket ndonjë individ, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, apo kur ndodhet nën kujdestari ose është jovetëqeverisës a nën çfarëdo kufizimi tjetër të sovranitetit.

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 05.07.1950, në kapitullin III sanksionoi të drejtat dhe detyrat e shtetasve. Sipas nenit 14, të gjithë shtetasit janë njësoj përpara ligjës. Ata kanë për detyrë të konformohen me Kushtetutën dhe me ligjet. Nuk njihet asnjë privilegj për shkak origjine, pozite, pasurie ose shkallë kulture. Të gjithë shtetasit janë të barabartë pa ndryshim kombësie, race ose feje. Ç'do akt që sjell privilegje, në favor të shtetasve ose që kufizon të drejtat e tyre për shkak ndryshimi në kombësi, racë ose fe, është kundra Kushtetutës dhe sjell me vehte dënime të parashikuara me ligjë. Është kundra Kushtetutës dhe dënohet me ligjë çdo provokim për të mbjellur urrejtje dhe grindje në mes të kombësive, racave dhe feve. Neni 16 sanksiononte se të gjithë shtetasit pa ndryshim seksi, kombësie, race, besimi, shkallë kulture ose banimi dhe që kanë mbushur 18 vjeç, kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e pushtetit shtetëror. E drejta e votimit është e përgjithëshme, e barabartë, direkte dhe e fshehtë.

Neni 17 sanksiononte se Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe shoqërore. Gruaja ka të drejtë të shpërblehet njësoj me burrin për një punë të barabartë. Ajo ka po atë të drejtë dhe në sigurimet shoqërore. Shteti mbron veçanërisht interesat e nënës dhe të fëmijës duke siguruar të drejtën për një pushim të pagueshëm përpara dhe pas lindjes dhe duke krijuar shtëpi për gra që lindin dhe shtëpi për rritjen dhe strehimin e fëmijëve.

Sipas neni 19, Martesa dhe familja janë nën mbrojtjen e shtetit. Shteti cakton me ligj konditat juridike të martesës dhe të familjes. Për të gjitha çështjet në lidhje me

martesën janë kompetente vetëm gjykatat e shtetit. Prindërit kanë kundrejt fëmijve të lindur jashtë martesës po ato detyrime dhe detyra që kanë edhe kundrejt fëmijve të lindur me martesë. Fëmijët e lindur jashtë martesës kanë po ato të drejta që kanë dhe fëmijët e lindur me martesë.

Të gjithë shtetasve u garantohet liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e mbledhjes, e grumbullimit dhe e manifestimit publik.

Për të zhvilluar inisiativën e masave punonjëse në fushën e organizimit dhe aktivitetin e tyre politik, shteti u siguron shtetasve të drejtën që të bashkohen në organizata shoqërore: Fronti Demokratik, bashkimet profesionale, kooperativat, organizatat e Rinisë dhe të Gruas, organizatat sportive dhe të mbrojtjes, shoqatat kulturale, teknike dhe shkencore; shtetasit më aktivë dhe më të ndërgjegjshëm të klasës puntore dhe të masave të tjera punonjëse bashkohen në Partinë e Punës së Shqipërisë, pararoja e organizuar e klasës puntore dhe e gjithë masave punonjëse në luftën e tyre për ndërtimin e bazave të socializmit të punonjësve, si shoqërore ashtu dhe shtetërore.

Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike, miratuar dhe hapur për nënshkrim për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2 200 A (XXI) të datës 16.12.1966, hyrë në fuqi më datë 23.03.1976, në nenin 3 të saj, proklamonte se shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas lidhur me gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt.

Sipas nenit 6, ndërsa sanksionohej se e drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta, diferencohej se dënimi me vdekje nuk mund të jepet për krimet e kryera nga personat nën 18 vjeç dhe nuk mund të zbatohet ndaj grave shtatzëna, duke I dhënë këtyre të fundit një mbrojtje të posaçme.

Gjithashtu barazia mes burrit dhe gruas evidentohet edhe në neni 23, sipas të cilit, të dy kishin të drejtë për t'u martuar dhe për të formuar familje.

Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 28.12.1976, sanksiononte se të drejtat dhe detyrat e shtetasve ndërtohen mbi bazë e pajtimit të interesave të individit dhe shoqërisë socialiste, duke i dhënë përparësi interesit të përgjithshëm. Të drejtat e shtetasve janë të pandara nga plotësimi detyrave të tyre dhe nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me rendin socialist. Zgjerimi dhe thellimi i mëtejshëm i të drejtave të shtetasve lidhen ngushtë me zhvillimin socialist të vendit.

Të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit. Nuk njihet asnjë kufizim ose privilegj në të drejtat dhe detyrat e shtetasve për arsye seksi, race, kombësie, arsimit, pozite shoqërore a gjendjeje materiale.

Neni 41, përcaktonte se gruaja, çliruar nga shtypja politike dhe nga shfrytëzimi ekonomik, si forcë e madhe e revolucionit, merr pjesë aktivisht në ndërtimin socialist të vendit dhe në mbrojtjen e atdheut. Gruaja gëzon të drejta të barabarta me burrin në punë, në shpërblim, në pushim, në sigurimin shoqëror, në arsim, në tërë veprimtarinë shoqërore-politike dhe në familje qendrat shëndetësore të vendit.

Nëna dhe fëmija gëzojnë kujdes e mbrojtje të veçantë. Nëna ka të drejtën e pushimit të paguar para e pas lindjes. Shteti hap shtëpi lindjeje dhe çerdhe e kopshte për fëmijë. Martesa dhe familja janë nën kujdesin e mbrojtjen e shtetit dhe të shoqërisë. Martesa lidhet përpara organeve shtetërore kompetente. Prindët përgjigjen për mirërritjen dhe për edukimin komunist të fëmijëve. Fëmijët kanë për detyrë të kujdesen për

prindët e paaftë dhe pa mjete të mjaftueshme jetese. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë po atë të drejta e detyra si edhe fëmijët e lindur me martesë. Fëmijët e mbetur pa prindër dhe pa përkrahje rriten dhe edukohen nga shteti.

Në vitin 1979, tema mbi dhunën kundër grave, u ngrit në nivel ndërkombëtar me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminit ndaj grave (CEDAW). Kjo Konventë, u miratua dhe u hap për nënshkrim, për ratifikim dhe për Aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18.12.1979 dhe hyri në fuqi më 03.09.1981. Shtetet palë, në pjesën hyrëse të saj, proklamuan se duke vërejtur se shtetet palë të pakteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë për detyrë të sigurojnë të drejta të barabarta të burrit dhe të gruas, të shqetësuar se me gjithë instrumentat e ndryshme, vazhdon të ekzistojë një diskriminim i madh ndaj grave, duke rikujtuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin e atdheut të tyre dhe njerëzimit, se në situata varfërie, gratë përfitojnë të drejtë minimale të ushqimit, të shërbimeve mjekësore, të arsimit, të përgatitjes profesionale, dhe të rasteve për punë dhe për nevoja të tjera, të bindur se vendosja e rendit të ri ekonomik ndërkombëtar të bazuar në paanësi dhe në drejtësi do të kontribuojë në mënyrë kuptimplote nxitjen e barazisë midis burrit dhe gruas, duke theksuar se zhdukja e aparteidit, e të gjitha formave të racizmit, diskriminimit racial, kolonializmit, neokolonializmit, agresionit, pushtimit e sundimit të huaj dhe e ndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve, është e domosdoshme në mënyrë që burri dhe gruaja të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre, duke vërtetuar se forcimi i paqes dhe i sigurisë ndërkombëtare, ulja e tensionit ndërkombëtar, bashkëpunimi i ndërsjellë i të gjitha shteteve, pavarësisht nga sistemet e tyre shoqërore dhe ekonomike, do të nxitin progresin shoqëror e zhvillimin, dhe do të kontribuojnë rrjedhimisht në realizimin e barazisë së plotë midis burrit dhe gruas, rëndësinë shoqërore të nënës dhe të rolit të të dy prindërve në familje dhe në edukimin e fëmijëve dhe duke qenë të vetëdijshëm se roli i gruas në riprodhimin e jetës nuk duhet të jetë bazë për diskriminim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për eliminimin e këtij diskriminimi në të gjitha format dhe shfaqjet e tij, ranë dakort për çka është shprehur në këtë konventë.

Sipas kësaj Konvente, shprehja "*diskriminimi ndaj grave*" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtashme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsye zotohen të venë në zbatim fuqinë ndërhyrëse të shtetit, si një ndërhyrje positive. Kjo ndërhyrje do të bëhet duke marrë masa për parashkime ligjore, me qëllim marrjen e masave për të ndaluar çdo formë të diskriminimit ndaj gruas, vendosjen e një mbrojtje gjyqësore, si dhe nëpërmjet ndërhyrjes negative, për të mos ndërmarrë asnjë verpim që do të diskriminonte

gratë, apo politikë. Ndërhyrja pozitive do të ishte si në aspektin legjislativ ashtu edhe atë ekzekutiv.

Megjithatë gruaja gjatë regjimit komunist në Shqipëri, megjithëse proklorohej si e barbartë me burrin, ajo në të vërtetë u konstatua se u zhvesh nga natyra e saj femërore. Sido të ishte, me gjithëse quhej e barbartë me burrin, mentaliteti shqiptar nuk e trajtonte njësoj një grua të divorcuar si një burrë të divorcuar. Gruaja ishte e pabarabartë për të punuar në fabrika apo ndërmarrje të tjera, njësoj si burrat por asaj iu cënua feminiliteti, si një tipar dallues i saj.

Përafrimi i legjislacionit vendas me atë ndërkombëtar në kuadrin e dhunës

Me miratimin e K.Penal, K.Civil, nisi të vërehej se qëllimi i Shqipërisë, ishte drejt barazisë gjinore, drejt pranimit të mosdiskriminimit në bazë të seksit.

Me ratifikimin e Konventës CEDAW, me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollit shtesë të kësaj konvente, me Ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, shteti shqiptar shprehu vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 e miratuar përmes referendumit popullor, si akti ligjor më i lartë i shtetit sanksionoi parimin e barazisë dhe diskriminimit. Në nenin 5 të saj prokloroi se: *'Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të'*. Referuar hierarkisë së normave, Kushtetuta përcaktoi se ato gjejnë zbatim të drejtëpërdrejtë përveç kur për zbatimin e tyre kërkohet ratifikimi i tyre dhe i dha një epërsi mbi ligjet e shtetit, duke i vendosur në një plan me kushtetutën.

Evokimi drejtëpërdrejtë i Konventës Europiane për të drejtat e Njeriut, në Kushtetutë, i hapi rrugën garancive që ofronin organizmat ndërkombëtarë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut u pa tashmë si një institucion së cilës mund t'i drejtohej çdo person, organizëm joqeveritar ose grup individësh që pretendojnë se janë dëmtuar nga ndonjë shkelje e shtetit shqiptarë e të drejtave të njohura nga konventa ose protokollat e saj¹

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon qartësisht të drejtat dhe liritë e njeriut. Neni 15 i Kushtetutës përcakton: *"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre"*.

Sistemi ligjor shqiptar është i bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe i lirive të njeriut përbëjnë detyrim kushtetues. Jeta, martesë, familja gëzojnë mbrojtje të vecantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtazëna dhe nënat e reja kanë të drejtë në një mbrojtje të vecantë nga shteti².

Këto të drejta dhe liri, respektohen pa dallim për të gjithë njerëzit, qofshin këta

¹ Neni 17 i Kushtetutës.

² Neni 54 I kushtetutës përcakton se "çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e vecanërisht për moshën minimale për punën e fëmijëve që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin, jetën ose zhvillimin e tij normal.

shqiptarë apo me shtetësi të huaj apo pa shtetësi³ si dhe pa diskriminime për shkak të faktorëve të ndryshëm⁴.

Një ndër të drejtat e njeriut, e cila është mjaft e rëndësishme dhe shumë frymëzuese për evolimin e shoqërisë ndër vite, është fakti që askush nuk mund ti nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, c' njerëzor e poshtërues (neni 25 i Kushtetutës). Ky lloj trajtimi vlen në çdo aspekt të jetës së njeriut, qoftë kjo kur mbi të ushtrohet dhunë e çfarëdo lloj forme qoftë ajo, si dhe ndaj personave të cilët vuajnë dënimin me heqje lirie në një institucion etj. Kushtetuta që në pamje të parë duket sikur ofron vetëm dispozita deklarative, ka krijuar mekanizma garantues të përgjithshëm për mbrojtjen nga dhuna si: Sistemi Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit. Por megjithëse Kushtetuta sanksionoi barazinë ndërmjet burrave dhe grave kjo pabarazi vazhdon të mbetet e prekshme. Dhuna ndaj gruas, mbeti një problem social, me rrënjë në të kaluarën historike të këtij vendi. Viktimizimi i grave i ka ndër faktorët kryesorë gjendjen ekonomike, mentalitetin, të drejtën zakonore.

Kodi Civil, duke i trajtuar të gjithë njerëzit si të barabartë, nëpërmjet instituteve të tij, në nenin 322 sanksionoi rastet kur ndaj trashgimlënësit është ushtruar dhunë nga një trashgimtar, atëherë ky i fundit nuk mund të trashgojë duke qenë i padenjë. I padenjë do të konsiderohet ai trashëgimtar që ka ushtruar dhunë e konkretisht ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij; ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një veprë penale për të cilënparashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal; ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve; ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë. Pra siç vërtehet ky është parashikimi I një forme dhune familjare, e cila bënte të mundur që trashëgimlënësi të kishte mundësi për këto shkaqe të ëprjashtonte nga trahsëgimia një pjestar të familjes që ai e konsideronte të padenjë, pikërisht për këto arsye.

Ligji nr. 9198 datë 01.07.2004 "*Për barazinë gjinore në Shqipëri*" kishte si qëllim sigurimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave të garantuara nga Kushtetuta, promovimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave për të eliminuar diskrimin direkt dhe indirekt, bazuar në gjininë, në jetën publike të vendit, përcaktimin e përgjegjësiive të administratës qendrore dhe vendore për të hartuar politikën për promovimin e e një shoqërie gjinore të barabartë. Sipas n. 2 të këtij ligji "*shoqëri gjinore e barabartë*" është ajo shoqëri, ku burrat dhe gratë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në veprimtaritë e të gjitha fushave si partnere të barabarta, të ndajnë bashkarisht përgjegjësiutë dhe të gëzojnë të drejta politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të barabarta. "*Dhunimi i të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat*" ose "*diskriminim*"

³ Neni 16 përcakton se të drejtat dhe liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné një lloj edhe për të huajt, për personat pa shtetësi si në territorin e republikës së shqipërisë

⁴ Neni 18 vijon me përcaktimin se : Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkak të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësi prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmëndura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

janë veprimet aktive ose pasive që shprehin nënvlerësim, përbuzje dhe kufizim të të drejtave ose të privilegjeve për arsye të seksit. Pikërisht këtu u parashikua edhe ngacmimi seksual, si një sjellje e natyrës seksuale me fjalë ose veprime që i drejtohet një personi me të cilin ndodhet në punë, në biznes ose në marrëdhënie të tjera varësie. Me ligjin nr. 9970 datë 24.07.2008 "*Për barazinë gjinore në Shqipëri*" u shfuqizua ligji i mëparshëm. Tashmë ngacmimi seksual u inkadrua në shprehjen e ngacmimit për shkak të përkatësisë gjinore.

Kodi i Familjes i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2004, përshkruhet nga parimi se martesë dhe familja mbështeten në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, të cilët gëzojnë mbrojtje të vecantë nga shteti.

Në nenin 61 të kodit të familjes parashikohet për herë të parë masa urgjente kundër dhunës familje bashkëshortore dhe në mbrojtje të familjes, duke detyruar dhunuesin të largohet nga banesa bashkëshortore për një periudhë 3-vjecare⁵.

Ky kod solli disa dispozita të reja të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojnë interesat e bashkëshortit të dhunuar. Neni 62 i K.Familjes "*Masat kundër dhunës*" parashikon se: "*Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore*". E reja që sjell kjo dispozitë është që nuk përcakton gjininë e bashkëshortit të dhunuar. Megjithëse duke iu referuar zakoneve shqiptare, kanuneve, kemi parë se është gruaja e dhunuara thuajse gjithmonë, në konceptin e shoqërisë shqiptare. Dispozita e sipërpërmendur ligjore është formësuar për të treguar se në familje mund të dhunohet jo vetëm gruaja por edhe burri. Megjithëse në Përkurori apo Gjykatë, kallzimet nga ana e burrave janë shumë të pakta, sërish mendimi i legjislatorit ka qënë për t'i ofruar një mbrojtje të barabartë, pavarësisht gjinisë, të dy bashkëshortëve.

Me ligjin Nr. 9669 dt.18.12.2006 "*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*" legjislatori pati si qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjestarëve të familjes, të cilat janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj përkufizoi dhunën si çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik ndërkohë që dhuna në familje është çdo akt dhune i ushtruar midis personave që janë apo kanë qënë në marrëdhënie familjare. "*Viktimitë*" është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna kurse dhunues është personi i paditur për ushtrimin e dhunës.

Pjesëtarë të familjes sipas këtij ligji janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën "b"; ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose

⁵ Neni 61 Kod.Fam "*Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes, gjykata, me kërkesën e bashkëshortit tjetër, mund të përcaktojë të gjitha masat urgjente që lidhen me ta. Zgjatja e masave të parashikuara në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar dhe në asnjë rast të mos i kalojë 3 vjet.*"

bashkëjetuesit/es; d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit; dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

Ky ligj përcaktoi masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje .

Ky ligj sanksionoi organet shtetërore që kanë detyra dhe kompetenca për t'iu përgjigjur dhunës në familje dhe i jep mundësi gjykatave të lëshojnë urdhëra mbrojtje kundër dhunuesit.

Ligji përcakton dy lloje autoritetesh përgjegjëse, administrative dhe gjyqësore. Ministria e Punëve të Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti kryesor për koordinimin mbështetjen dhe mbikqyrjen. Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Arsimit, i referojnë rastet e dhunës në familje, dhe trajtojnë problematikat përsa i kanë në kompetencë.

Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse.

Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

Me ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*" i ndryshuar në vijim, legjislatori përcaktoi në nenin 4, pika 29 "*Viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare*" duke iu referuar dispozitave të ligjit të sipërcituar. Në nenin 5 përcaktoi se përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, gratë, vajzat në nevojë si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë pikërisht ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror dhe të krijojë mundësi për integrimin e individëve dhe familjeve nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e jetës së tyre.

Me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" u kërkuar të arrihej si qëllim parimi i barazisë në lidhje me gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, shtatzaninë, etj. Diskriminim sipas këtij ligji është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferenc që e bazuar në cilindo nga shkaqet e sipërcituara. Diskriminim i drejtëpërdrejtë është ajo formë që ndodh kur një person apo një grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se një person tjetër apo një grup tjetër personash në situatë të njëjtë apo të ngjashme. Diskrimi i tërthortë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta bënte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në raport me një person tjetër ose grup tjetër dhe kur kjo masë, kriter a praktik që nuk justifikohet objektisht nga një synim i ligjshëm ose kur mjetet e arritjes së tij synimi ose nuk janë të përshtatshme ose nuk janë të domosdoshme dhe në atë përpërsjetim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar.

Diskriminimi për shkak të shoqërimit është ajo formë e diskriminimit që ndodh kur ka një dallim, kufizim apo preferencë për arsye të shoqërimit me persona që i përkasin grupeve të sipërcituara.

Ky ligj u përafraua plotësisht me Direktivën e Këshillit 2004/42/KE të 29.06.2000 për "*Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave opavarësisht preardhjes*

racore apo etnike"; Direktiven e Këshillit 2000/78/KE të 27.11.2000 për "*Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*"; Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13.12.2004 për "*Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime*"; Direktivën e Parlemntit European dhe të Këshillit 2006/54/KE të 05.07.2006 për "*Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës*".

Konventa e Këshillit të Evropës "*Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*" – Konventa e Stambollit, u ratifikua me Ligjin nr. 104/2012. Objektivi i kësaj konvente është zbatimi i saj për të gjitha viktimat e dhunës në familje sidomos duke i kushtuar një rëndësi të veçantë grave. Kjo Konventë është hapur për ratifikim që nga 11.05.2011. Kjo Konventë kërkon të vendoset një tolerancë zero për këtë lloj dhune. Prandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve.

Kjo Konventë e njeh dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si një formë diskriminimi. Përmban gjithashtu një përkufizim të gjinisë sipas të cilit gratë dhe burrat nuk janë thjesht qenie biologjike femërore apo mashkullore, por ekziston një kategori sociale e gjinisë që përcakton rolet dhe sjelljet e grave dhe burrave.

Sipas kësaj konvente, dhuna kundër grave konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna në familje, nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike, ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën. Gjini nënkuptohen rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë.

Në një sërë ligjesh të tjera konstatohet se filluan të ndryshohen e të përshtaten duke pasur parasysh viktimën e dhunës në familje. Kështu ligji nr. 10 039 datë 22.12.2008, me ndryshimet që pësoi fillimisht në vitin 2013 e më pas në vitin 2014, ka si qëllim ushtrimin efektiv të së drejtës për t'iu drejtuar organeve të administratës publike dhe/ose sistemit të drejtësisë nëpërmjet dhënies së ndihmës juridike nga shteti për individët. Në nenin 13 të tij u përcaktua se të drejtën për të përfutur ndihmë juridike, e kanë ndër të tjera personat të cilët janë viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qënieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to.

Në ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve*", me ndryshimet që pësoi nga viti 2001 deri në vitin 2014, në n. 5 u përcaktua se të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindje politike, fetare ose filozofike, orintiemi seksual, identiteti gjinor, përkatësie të një grupi të caktuar etj. Gratë e paraburgosura dhe të dënuara trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë

tjetër abuzimi dhe keqtrajtimi që dënohen sipas ligjeve në fuqi. Të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i ofrohen menjëherë masa mbrojtje, mbështje dhe këshillime ligjore me qëllim rehabilitimin e tyre. Në rastet e dhunës ndaj grave dhe të miturave, mbahen parasysh nevojat specifike gjinore të tyre.

Ndërkohë, K.Penal, i miratuar me ligjin nr. 7895 të vitit 1995, në fillim përveç krimeve seksuale, nuk është se bënte ndonjë diferencim, pasur parasysh tërësinë e zhvillimeve ndërkombëtare, në ndërgjegjësimin e shoqërisë për dhunën në familje apo specifikisht atë ndaj grave. Parashikonte një përmbledhje të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve, martesës dhe familjes por duke mos u mbajtur parasysh se dhuna e ushtruar në familje kufizohej vetëm në këta anëtarë.

Krimet seksuale dhe ato të trafikimit ishin ndër krimet më specifike që i referoheshin gjinisë.

Megjithatë në kuadrin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë ndërkombëtar, edhe Kodi Penal, iu nënshtrua një tërësie ndryshimesh.

Prostitucioni filloi të shihej jo vetëm si një e keqe e personit që ushtronte por edhe për atë që përfitonte nga ky ushtrim. Me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012, u sanksionua se e dënueshme penalisht edhe dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit.

Po me këtë ligj, u sanksionua në n. 12/a të K.Penal, "Përndjekja" si vepër penale. Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.

Me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012, u sanksionua dhuna në familje, si një vepër penale e posaçme. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Me ligjin nr. 144 datë 02.05.2013, legjislatori vendosi të bënte disa shtesa dhe ndryshime në K.Penal, duke shtuar si vepër penale ngacmimin seksual. Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që çënojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke

krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose ofendues, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Me ligjin nr. 144/2013, edhe vepra penale e parashikuar nga neni 102 I k.Penal, "Kryerja e marrëdhënieve seksuale me të rritura" pësoi ndryshime, ku u sanksinuar se përbën veprë penale, edhe kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre. Gjykata e Strasburgut, ka pranuar se do të quhet veprë penale edhe shtrëngimi i bashkëshortes për të kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj, me bashkëshortin e vet, duke mbrojtur në këtë mënyrë ndjenjën e dinjitetit të gruas

Bibliografia

- Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut,1948.
Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë,1950.
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,1998.
Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW),1979.
Kodi Civil.
K.Penal, 1995.
Kodi i Familjes,2004.
Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" – Konventa e Stambollit,2011.
Direktiva e Këshillit 2004/42/KE për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave opavarësisht preardhjes racore apo etnike",2000.
Direktiva e Këshillit 2000/78/KE për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës",2000.
Direktiva e Këshillit 2004/113/KE për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime,2004.
Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës",2006.
Ligji nr. 8328 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve",1998.
Ligji nr. 9198 "Për barazinë gjinore në Shqipëri" ,2004.
Ligji nr. 9355 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore",2005.
Ligji Nr. 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare",2006.
Ligji nr. 10221 "Për mbrojtjen nga diskriminimi",2010.
Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike,1966.

Programet e individualizuara të trajtimit të të dënuarve

Edlira Jahiu (Ylli)

Psikologe

Gjatë qëndrimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të burgosurit kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete edukative dhe argëtuese që organizohen nga IEVP Rehabilitimi i të burgosurve, si një nga qëllimet kryesore të sektorëve të kujdesit social në IEVP, përfshin edhe ndjekjen e programeve të trajtimit në grup të të burgosurve, duke iu dhënë mundësi atyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të institucionit dhe të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe të nxisin interesin, për arsimimin, formimin profesional, veprimtaritë kulturore, sportive etj.

Për të siguruar mbarëvajtje në drejtim të trajtimit të të burgosurve dhe një klimë të sigurt në IEVPenale është mjaft i rëndësishëm bashkëpunimi ndërdisiplinor. Bashkëpunimi duhet të konsistojë në referim rastesh dhe shkëmbim informacioni. Në çdo institucion, stafi i kujdesit social përbehet nga punonjës sociale, psikologe dhe edukatore, ku bazuar në strukturën e sektorit secili prej tyre ka përgjegjësitë e përcaktuara.

Punonjësi social është përgjegjës për identifikimin e problemeve në rrafshin psiko-social, ofrimin e këshillimit për përfitimin e shprehive sociale dhe të komunikimit, vendosjen e marrëdhënieve të shkëputura me familjen, krijimi i rrjeteve mbështetëse (OJF, shërbimi i provës, institucione lokale), referimi tek psikologu i rasteve me shqetësime emocionale dhe probleme të sjelljes.

Nga ana tjetër roli i psikologut në trajtimin e kategorisë të dënuar me probleme të shëndetit mendor është shumë i rëndësishëm pasi psikologu planifikon dhe kryen këshillimet individuale për lehtësim emocional për personat që paraqesin shqetësime ankthi, depresion, etj. Një rol të rëndësishëm ka gjithashtu dhe edukatori që merret me përfshirjen e të dënuarve në aktivitete të përbashkëta kulturore, sportive, fetare, etj, përfshirjen në programe arsimore dhe të formimit profesional, përfshirjen në aktivitete punësimi. Ky lloj bashkëpunimi siguron ndjekjen e planit të dënimit në bashkëpunim me të burgosurin dhe planit të individualizuar të trajtimit për kategori të veçanta të burgosurish me qëllim lehtësimin e vuajtjes së dënimit dhe rehabilitimin dhe ri-integrimin e kësaj kategorie në shoqëri.

Programet e individualizuara të trajtimit të të dënuarve janë programe të hartuara nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qëllim trajtimin e të dënuarve sipas standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare.

Çdo dosje psiko sociale shërben për të ndjekur në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e trajtimit psiko-sociale të cdo të dënuari dhe të paraburgosur. Hartimi i planit të vuajtjes së dënimit është pjesë e kësaj dosje. Qëllimi i këtij programi është aftësimi i specialistëve për hartimin e një plani në bashkëpunim me të burgosurin, që siguron lehtësim të vuajtjes së dënimit, rehabilitim dhe ri-integrim në shoqëri si dhe aftësimi i specialistëve për hartimin e një plani të individualizuar trajtimi për kategori të veçanta të burgosurish.

Një PVDR duhet të jetë individual, të mbështetet në objektiva realiste dhe të arritshëm, të mbështetet në prirjet, nevojat dhe interesat e të burgosurit, të jetë transparent me

të burgosurin, të mbështetet në parimin e konfidencialitetit, të synojë rehabilitimin dhe përgatitjen e të burgosurit për jetën e lirë, të jetë human dhe jo ndëshkues. Ai duhet të përfshijë një trajtim multidisiplinar, si dhe të marrë në konsideratë kushtet infrastrukturore që ofrojnë IEVP-të.

Plani i vuajtjes së dënimit përfshin: këshillim dhe terapi, arsimim dhe formim profesional, punësim, shërbim bibliotekar, edukim përmes përfshirjes në aktivitete sportive, fetare dhe kulturore. Stafi i sektorit të edukimit gjatë procesit të hartimit të PVDR duhet të marrë në konsideratë krijimin e besueshmërisë; ruajtjen e konfidencialitetit; t'i bëjë të ditur të burgosurit, se plani do të hartohet bashkërisht dhe se ai mund të marrë pjesë aktive në vendimmarrje, si dhe të informojë mbi përfitimet e përfshirjes në aktivitete. Gjatë hartimit të planit punonjësi social duhet të vlerësojë gjithashtu kontekstin social kulturor të familjes së të dënuarit, veprën penale dhe masën e dënimit, rrezikshmërisë, nevojat psikologjike e sociale të tij, si dhe aftësinë dhe vullnetin e të burgosurit për punë, arsimim dhe formim profesional.

Një PVDR përmban këto rubrika: qëllimi, objektivat (në varësi të problemeve të evidentuara), objektiva afatshkurtër, objektiva afatgjatë, aktivitete konkrete për ndërhyrje, asistencë psikologjike (këshillim individual, në grup, terapi, etj), formim profesional, arsimim, punësim, aktivitete sportive, krijimi dhe forcimi i rrjeteve mbështetëse, vlerësimi i ecurisë së PVDR, arritjet dhe vështirësitë gjatë punës. Punonjësi i kujdesit social diskuton me të burgosurin planin e vuajtjes së dënimit dhe bën rivlerësimin dhe ndryshimin në përputhje me ecurinë e trajtimit, mundësisht çdo 3 muaj.

Hartimi sipas rregullave të përcaktuara të hartimit të PVDR është shumë i rëndësishëm pasi jo vetëm garanton dokumentimin e procesit të ndjekjes së të dënuarve, por dhe është objekt inspektimi i vazhdueshëm nga ana e DPB-së, si dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, të cilat kryejnë monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Programi “Mbështetje, ndihmë dhe monitorim i personave me probleme të shëndetit mendor” për kategorinë persona me çrregullime psikologjike dhe psikiatrike në konflikt me ligjin

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i gjendjes psiko-emocionale dhe ruajtja e rezultateve të arritura, përmes ofrimit të asistencës në fushën psikologjike, mjekësore dhe sociale. Ecuria e këtij programi bëhet përmes matjes së indikatorëve në mënyrë konstante duke bërë dhe dokumentimin në dosjen psiko-sociale.

Ky program përmban raportin e vlerësimit psikologjik, ku plotësohen të dhënat personale si dhe data e plotësimit të raportit. Psikologu i institucionit përshkruan në një rubrikë të veçantë llojin e çrregullimit dhe simptomat që paraqet. Në këtë raport mbahen të dhëna mbi personalitetin, (emocionaliteti, socializimi, vetëvlerësimi, ankthi, agresiviteti, etj) si dhe të dhëna të tjera mbi vëmendjen, perceptimin, aftësinë për të menaxhuar konfliktet, të kuptuarit, impulsiviteti, përmbajtja e mendimit, etj). Në fazën e parë bëhet një përshkrim i historikut mbi përdorimin e substancave, background-i familjar dhe lloji i marrëdhënies me familjen dhe përcaktimin e ndërhyrjes dhe objektivat e vendosura.

Në fazën e dytë vlerësohet gjendja psikologjike dhe simptomat që raportohen gjatë

trajtimit. Në këtë fazë vendosen të dhëna mbi ecurinë e trajtimit në raport me objektivat e vendosura dhe cilësinë e marrëdhënieve të krijuara në I.E.V.P.

Programi i ndërhyrjes për të burgosur të huaj

Numri i të burgosurve të huaj ka ardhur në rritje në institucionet penitenciare. Kjo ka bërë të nevojshëm zhvillimin e modeleve të ndërhyrjes specifike për këtë kategori. Objektivi kryesor është të lehtësohet integrimi i tyre në mjedisin penenciar dhe më pas në shoqëri, kjo duke respektuar detyrën për të mos bërë dallime për çështje racore, kombësie apo besimi.

Programi prek 2 fusha të mëdha ndërhyrjeje: ndërhyrje edukative tërësisht formuese dhe ndërhyrje shumë kulturore me objektiv të dyfishtë, njohjen e kulturës për të lehtësuar përshtatjen dhe pengimin e ndikimeve të dëmshme të grupeve ekstremiste ndërkohë që qëndrojnë në burg.

Gjatë këtij programi ndërhyrja zhvillohet në tre fusha: Informacion Juridik dhe Vlera Demokratike si të drejtat e njeriut, vlerat kushtetuese, të drejtat e të huajve, etj. Grup Ndërhyrjeje Kulturore, nëpërmjet grupeve të debatit me 30% shqiptarë, mbi rolet gjinore, fenë, familjen. Veprimtari Ndërkulturore të Hapura, si konferenca, video-forume, teatër, etj, që bëjnë të ditura veçantitë e kombeve dhe kulturave të tjera.

Programi për parandalimin e vetëvrasjes

Hapësira e vuajtjes së dënimit duhet konsideruar jo vetëm si një hapësirë e mbushur me rreziqe, por si një vend veçanërisht i mbushur me rreziqe ku duhet të vihen në jetë disa mekanizma njerëzorë dhe materiale për të eliminuar, apo zbutur së paku efektet negative që mund të sjellë burgimi.

Parandalimi i vetëvrasjes në burg është një çështje e detyruar nga Përmbledhja e Legjislacionit mbi sistemin e Burgjeve dhe të Paraburgimit, ligji nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar¹. Është e qartë se burgjet janë mbartëse të grupeve që tradicionalisht cilësohen si në rrezik për sa i përket përqindjes së vetëvrasjeve në përgjithësi si të mënjanuar socialë, toksikomanë, të sëmurë mendorë. Si faktorët më konkretë mund të rendisim :

- Impakti psikologjik i burgimit
- Prekja shpirtërore nga kryerja e krimit
- Impakti personal dhe familjar që mund të nënkuptojë jehona e kryerjes së krimit.
- Mungesa afektive socio-familjare që nënkupton vetë burgimi.
- Në një lloj të caktuar krimi, ai ekonomik, ndjenja e diskreditimit social dhe humbjes ekonomike reale ashtu si dhe shkatërrimi i mënyrës së jetesës së shpresuar.
- Reformat e fundit për përmbushje e plotë të dënimit, heqja e faljes së dënimeve, heqja e shlyerjes së dënimit nga puna, etj.

Gjithsesi studimi i profileve që paraqesin rrezik na jep një spektër tepër të gjerë, ç'ka bën të domosdoshme që t'u kushtohet vëmendje të ashtuquajturave paralajmërime apo sinjale alarmi ashtu si dhe situatave të veçanta, të cilat bëjnë të nevojshme marrjen e disa masave provizore që shmangin aktin fatal. Mbi të gjitha duhet përforcuar kontrolli nga ana e personelit penenciar dhe të hartohet një sistem i përshtatshëm

¹ Ligji nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", të ndryshuar. <http://ëëë.dpbsh.gov.al/neëëeb/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=522>

koordinimi ndërmjet fushës së sigurisë, trajtimit dhe shëndetësisë.

Objektivat e këtij programi janë: zbatimi sistematik i linjave të parandalimit ndaj grupeve të cilësuar si në rrezik, pikasja e të burgosurve me probleme personale specifike apo situatave të caktuara krize të cilat mund të çojnë në një sjellje vetëvrasëse, shmangia e një përfundimi negativ të mundshëm për rastet që përfshihen në Programin e Parandalimit të Vetëvrasjeve dhe përcaktimi i një linje veprimesh dhe bashkërendimi ndërmjet ekspertëve të ndryshëm të sigurisë, trajtimit dhe shëndetit që ndërhyjnë në këtë Program.

Ky program zbatohet dhe është hartuar për këto kategori:

a. Të burgosur veprimtaria kriminale e të cilëve është e lidhur me dëmin ndaj personave të tilla si: përdhunim, vrasje në familje, vrasje e zakonshme, etj, ku rreziku më i lartë është gjatë ditëve të para të burgimit, veçanërisht tek të burgosurit e sigurisë së lartë.

b. Të burgosur që paraqesin simptoma të qarta nervozizmi, ankthi, depresioni, etj.

c. Të burgosur që kanë kryer përpjekje të mëparshme për t'u vetëvrasur ose që kanë familjarë me historik vetëvrasës.

Përveç këtyre kritereve, duhen mbajtur parasysh edhe shumë faktorë të tjerë rrethorë, të cilët duke u bashkuar te ky subjekt mund ta bëjnë atë të prirur ndaj sjelljeve apo përpjekjeve për t'u vetëvrasur si faktorë mjedisorë, ndarjet apo konfliktet familjare, ngjarje negative të tilla si vdekje, aksidente të pësuar nga familjarët apo miqtë, etj ; ndryshime në gjendjen e procesit gjyqësor, penale apo penitenciare apo komunikime mbi vendime administrative apo gjyqësore që përbëjnë një hap prapa në trajtim dhe që mund të jenë befasuese dhe/ose negative si dhe faktorë personalë si tolerancë e ulët ndaj frustrimit, repertori i pakët përgjigjesh, simptomatologji depresive ciklike, historik i gjatë konsumi substancash toksike, alkooli apo ilaçesh.

Çdo rast është i individualizuar, si rrjedhim, nuk mund të përcaktohet "apriori" kohëzgjatja e Programit. Ajo do të vlerësohet çdo javë nga grupi i trajtimit sipas raporteve të hartuara. Mosdalja nga programi do të vendoset nga një marrëveshje e arsyetuar grupi, i cili do t'i propozojë Drejtorit të IEVPenale që të japë një tjetër Urdhër. Ky urdhër do të pasqyrohet në të gjithë dokumentacionin penitenciar të të burgosurit ashtu si dhe në regjistrin e hyrjes dhe daljes nga programi.

Grupi i trajtimit do të rishikojë zhvillimin e të burgosurve për të cilët është vendosur moslargimi nga programi në mënyrë periodike dhe të rregullt, duke i kaluar grupit të drejtimit raporte mujore.

Programi i Mendimit Prosocial (Think First)

Sjellja agresive është padyshim e vështirë për t'u ndryshuar. Zakonisht nis nëpërmjet zemërimit dhe përshkallëzohet tek individë të cilët e shohin botën ndërpersonale në mënyrë të shtrembëruar. Kësaj i shtohet edhe energjia që jep aktivizimi emocional që ndjehet të rinjtë, emocion ky i cili rrjedh pikërisht nga këto ide të shtrembëruara në lidhje me botën.

Njerëzit, në mënyrë të përgjithshme, zgjedhin të mos veprojnë në mënyrë të dhunshme, sepse e cilësojnë një gjë të tillë si diçka imorale apo thjesht si një sjellje të gabuar. Subjektet e dhunshëm, nga ana e tyre mendojnë ndryshe. Për shumë të rinj dhuna është një sjellje e mësuar, e instaluar dhe që jep shumë përfitime.

Mendo së pari (Think First) është një program trajtimi i cili është hartuar posaçërisht për të dënuarit, të cilët mendohet se përbëjnë rrezik të mesëm deri në rrezik të lartë, që kanë shfaqur një model të përgjithshëm të veprës penale dhe nuk kanë kryer ndonjë krim në të kaluarën e tyre. Programi është hartuar nga profesori Jamses McGuire, një psikolog ligjor klinik në Britaninë e Madhe, për t'u përdorur nga shërbimet e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës në Angli dhe në Uells, por është i adoptuar gjithashtu edhe nga disa shërbime korrektuese në Australi².

Programi "mendo së pari" është një bllok i 22 grup-seancash, ku secila seance zgjat dy orë. Përveç kësaj, të dënuarit mund të marrin pjesë në seancat para-grup dhe post-grup të cilat nuk zhvillohen në grup por individualisht. "Mendo së pari" është një program i ndërtuar mbi parimet e teorisë së njohjes, mendimit dhe të sjelljes. Kjo metodë synon të adresojë qëndrimet e autorëve të veprave penale dhe proceset themelore të mendimit që ndikojnë në sjelljen e të dënuarve.

Qëllimi parësor i programit është të ndihmojë të dënuarit që të marrin pjesë në program për të fituar praktikë dhe të përdorin aftësitë në zgjidhjen e problemeve si dhe të fitojnë aftësitë të tjera të cilat do të lejojnë që të dënuarit të menaxhojnë jetën e tyre dhe vështirësitë e tjera pa përdorur forcën dhe mënyra të tjera të dhunshme. Për shembull, të dënuarit (në përgjithësi) kanë tendencë të jenë të ngurtë në përgjigjet që ata zgjedhin në rrethana të caktuara problematike. Në qoftë se një mashkull i dënuar është në një bar dhe vëren një mashkull (një i huaj) që e shikon atë në sy, ky mund të jetë rasti që i dënuari mendon se mashkulli tjetër po e sfidon për matjen e forcës.

Përgjigja e të dënuarit mund të jetë ajo që gjithmonë ai bën kur dikush është duke vepruar në këtë mënyrë ndaj tij, ai shkon dhe e qëllon me grusht. Nëse i dënuari do të kishte ndaluar dhe të mendonte mbi situatën, ai mund të kishte kuptuar se i huaji nuk po e shikonte "për sfidë", por thjesht po vështronte një femër ulur pas tij. Në rastin hipotetik, i dënuari, jo vetëm që reagon në mënyrë impulsive, por gabon në zgjidhjen e situatës. Programi adreson pikërisht problematikat me sjellje agresive duke bërë të dënuarin të analizojë situatën përmes pyetjes: a kishte një veprim alternativë që mund të ishte ndërmarrë për të përmirësuar situatën në një mënyrë më pro-sociale? Vlerësimet e programit, deri më sot, kanë dhënë rezultate paraprakisht pozitive për cilësitë e tij rehabilituese. Një vlerësim fillestar i programit, i kryer nga kërkues shkencor në Universitetin e Liverpulit³, gjeti ndryshime pozitive para dhe pas programit në testet psikometrike matëse mbi qëndrimet ndaj ofendimit, ndjeshmërisë për viktimën dhe impulsivitetit.

Një numër studimesh mbi efektivitetin e programit janë kryer gjithashtu nga dy grupe studiuesish në Mbretërinë e Bashkuar: një grup nga Njësia e Studimeve të Shërbimit të Provës në Universitetin e Oksfordit dhe një tjetër nga Universitetet e Leicester dhe Liverpool. Të dy grupet kërkimore kanë raportuar reduktime të konsiderueshme në normat e recidivizmit të atyre që kanë përfunduar programin në krahasim me ata që nuk kanë arritur ta përfundojnë. Megjithatë, përdorimi si një grup krahasimi i atyre që nuk arritën të përfundonin programet (ose jo-përfunduesit) nuk është ideal. Të

² McGuire, J. (2008) Social Problem Solving and Offending: Evidence, Evaluation and Evolution, Chapter 10. The Think First Programme.

³ Hollin, C. R., McGuire, J., Hounscome, J., Hatcher, R., Bilby, C., & Palmer, E. J. (2008). Cognitive skills offending behaviour programmes in the community: A reconviction analysis. *Criminal Justice and Behavior*, 35, 269-283.

dy grupet e studiuesve kanë treguar se jo-përfunduesit ishin tashmë në një rrezik më të lartë si recidivist sesa ata që arritën ta përfundojnë programin. Kjo qëndron për arsye se ata që janë në një rrezik më të lartë për të rikryer një vepër penale kanë më shumë probabilitet të ridënohen (McGuire, Bilby, Hatcher, Hollin, Hounscome, & Palmer, 2008, 21-40).

Hulumtimi i kryer nga Universitetet e Leicester dhe Liverpool, për këtë arsye, ka bërë një krahasim të të dënuarve që kanë përfunduar programin me një grup individësh të ngjashëm të cilët kishin marrë një dënim alternativ me punë të detyruar në komunitet. Kur merren parasysh efektet e moshës, rrezikun për recidivizmin, gjininë dhe llojin e veprës penale të vazhdueshme, ata të cilët kishin përfunduar programin kishin pothuajse tridhjetë për qind më pak të ngjarë të ishin recidivist në krahasim me grupin e krahasimit.

Një gjetje e zakonshme në këto kërkime është shkalla e lartë e jo-përfundimit të programeve (kjo është e përbashkët për të gjitha programet e komunitetit dhe jo vetëm e programit “mendo me parë”). Normat për jo-përfundim të “mendo me parë” shkonin nga 62 në 72 për qind të atyre që janë urdhëruar nga gjykatat për të marrë pjesë në program. Edhe pse ka shenja se këto shifra janë përmirësuar që nga koha e kryerjes së studimit, këto gjetje duhet të ngrenë pyetje në lidhje me faktin nëse ofrimi i programeve duhet të rritet në mënyrë që të bindë më shumë të dënuarit për të përfunduar këto programe (Hollin & Hatcher, 2013).

Pra si përfundim, agresioni është njëherazi një fenomen emocional, i sjelljes dhe konjitiv. Ndaj dhe për këtë arsye ato ndërhyrje që kanë për synim ta luftojnë duhet të mbajnë parasysh gjithashtu edhe këtë natyrë të tijen”, shkruajnë autorët e programit, (Goldshtein, Glik dhe Gibbs 1998, f. 2).

Programi ART

Programi i trajnimit të menaxhimit të zemërimit (ART), është i ngjashëm në shumë aspekte me programin mendimit prosocial – ky program ofron ushtrime të veçanta njohëse të sjelljes që kanë për qëllim për të zhvilluar proceset e mendimit dhe qëndrimeve në lidhje me krimin dhe sjelljen kriminale të të dënuarve. Programi ART ndryshon nga programi i mendimit prosocial dhe programet e tjera pasi është një program për një vepër specifike. Kjo do të thotë se programi aplikohet për një grup të veçantë të të dënuarve. Siç dhe vete emri sugjeron, programi ART i drejtohet të dënuarve të cilët kanë shfaqur sjellje të dhunshme apo agresion dhe probleme me sjelljen.

ART është projektuar fillimisht nga Profesor Arnold Goldstein në SHBA për përdorim për kategorinë “të mitur të dënuar” por është përhapur gjeografikisht dhe aplikohet tani për të dënuarit në të gjithë Amerikën e Veriut si dhe në vende të tilla si Britania e Madhe, Holanda dhe Suedia. Kjo eksperiencë tashmë është huazuar edhe nga Shqipëria. Përveç kësaj, përmbajtja e programit, është zhvilluar fillimisht për punën me fëmijët dhe adoleshentët dhe gjithashtu është përshtatur për përdorim për të dënuarit e rritur dhe ata me probleme mendore.

Programi ART përbëhet nga tri pjesë. Çdo grup seancash përbëhet prej katër komponentëve dhe gjatë programit këto komponentë zëvendësohen me njëri-tjetrin në mënyrë që çdo komponent të prezantohet në mënyrë të barabartë. Tre komponentët janë shfaqja e aftësive, trajtimi i menaxhimit të zemërimit dhe trajtimi

i arsytimit moral. Secili prej tyre do të shpjegohet më në detaje .
Programi ART ka qenë subjekt i shumë studimeve vlerësuese për të testuar efektshmërinë e tij. Vlerësimet kanë raportuar rezultate pozitive në përputhje me qëllimet e programit si dhe rezultate në përmirësim të sjelljeve të tilla si normat e reduktuara të riarrestimeve, reduktim të recidivizmit dhe funksionim më të mirë të komunitetit. Kërkime të tjera kanë prezantuar rezultate të përziera, si psh. përmirësim në funksionet njohëse që synon ART por jo përfitime në ndryshimin e sjelljes.

Programi “Mbështetje, ndihmë dhe monitorim për personat që kanë varësi nga substancat narkotike

Targetgrupi janë personat përdorues të substancave narkotike, në konflikt me ligjin. Qëllimi i zbatimit të këtij programi është të arrihen rezultate konkrete në punën me persona me varësi nga substancat. Objektiva kryesore janë rehabilitimi i personave ish-përdorues të substancave për periudhën e qëndrimit në burg dhe riintegrimi i tyre në shoqëri. Grupi i punës i cili ndjek këtë program përbëhet nga mjeku (infermieri), psikologu, punonjësi social ose edukatori dhe punonjësi me uniformë. Në këtë program ofrohet ndihmë mjekësore (terapi medikamentoze), psikologjike dhe sociale. Trajtimi për këtë kategori bëhet bazuar në dhënien e mbështetjes psikologjike, trajtim i specializuar mjekësor, trajtim në grup, takime me familjarët, terapi okupacionale, ajrim dhe sport. Ecuria e këtij programi kontrollohet përmes matjes së indikatorëve në mënyre konstante për të parë arritjet dhe progresin e të dënuarit i cili ndiqet me program individual trajtimi për të dënuar me varësi nga substancat narkotike. Ecuria ndiqet dhe dokumentohet në raportin e vlerësimit psikologjik, faza e parë dhe faza e dytë. Në fazën e parë vlerësohet ecuria e ndjekjes duke mbajtur te dhëna mbi: lloji i substancës së përdorur, kohëzgjatja e përdorimit, lloji i trajtimit të mëparshëm, nëse ka marrë, arsyet e fillimit të përdorimit të substancës, shkalla e varësisë fizike/ psikologjike, çrregullime psiko- emocionale prezente (shoqëruese), çrregullime të sjelljes, prezenca e simptomave fizike, funksionimi konjitiv dhe vlerësimi i nevojave (aplikimi i testeve). Vazhdimi i programit për personat me varësi nga substancat narkotike gjatë fazës së dytë konsiston në trajtimin e temave: Menaxhimi i konflikteve, sjelljes agresive, komunikimi, etj. Për realizimin e këtyre temave do të organizohen grupe me persona, të cilët paraqesin këto lloj shqetësimesh. Në grupet e diskutimit do të merren shembuj konkrete, të cilët do të kenë si objektiv reduktimin e sjelljeve agresive, zgjidhjen e konflikteve, përdorimin e metodave të psikologjisë së njohjes dhe sjelljes për menaxhimin e emocioneve. Qëllimi është pjesëmarrja e sa më tepër personave, përpunimi dhe aftësimi në gjetjen e mënyrave më pozitive të të jetuarit. Çdo objektiv i arritur shënohet në dosjen psiko-sociale. Gjatë fazës së dytë plotësohet dhe ecuria e përgjithshme e personit në lidhje me programin dhe trajtimi i mëtejshëm (përcaktimi i seancave të reja individuale/në grup).

Program i individualizuar trajtimi për të rinjtë

Ky program përmban të dhëna personale: emër/ mbiemër, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, arsimimi, recidivist ose jo, masa e dënimit, vepra penale. Programi përmban historinë e rastit, përkujdesja nga të afërmit, raportet me ta;

zhvillimi fizik e konjitiv, dëshirat, problemet; problemet shëndetësore; socializmi: sa i aftë është të krijojë marrëdhënie me të tjerët, shkalla e integritetit, ecuria në vazhdimësi, niveli i përshtatjes.

Në varësi të të dhënave të marra gjatë intervistës paraprake përcaktohen dhe objektivat dhe ecuria e përgjithshme e të burgosurit në vazhdimësi ndaj programit të trajtimit të individualizuar. (Reagimi në këshillime individuale, në grup, aktivitete e veprimtari trajtuese).

Program trajtimi për të dënuarit në prag lirimi

Objektivi i programeve të trajtimit për të dënuarit në prag lirimi, është realizimi i suksesshëm i riintegritimit shoqëror për personat që përfundojnë dënimin, kjo si në aspektin psiko-emocional ashtu edhe në atë social, si dhe shmangia e riciklimit të tyre në rrugën e kriminalitetit.

Targetgrupi përbëhet nga personat që ndodhen në prag të lirimit e veçanërisht të dënuarit që kanë qëndruar në izolim për një periudhe të gjatë kohore. Kohëzgjatja e programit mund të varioje nga dy javë për personat me një dënim relativisht të ulët, në një muaj për të dënuarit që kanë qëndruar për një kohe të gjate në izolim. Ndërkohe, periudha e realizimit të programit mund të diferencohet edhe në varësi të nevojave individuale të të dënuarve që përbejnë targetgrupin në fjale.

Periudha e lirimit, megjithëse përben një moment të shumëpritur për shumicën e të dënuarve kërkon gjithësesi një ripërshtatje psiko-emocionale e sociale ndaj një ambienti të ri dhe një mënyre të re jetese veçanërisht për personat me dënim afatgjatë. Megjithë informacionin e marrë dhe ruajtjen e kontakteve sociale me familjaret dhe te njohurit, qëndrimi i gjatë në izolim, veçanërisht për të dënuarit afatgjatë, shkakton atrofi fizike e shpirtërore dhe mungesë të shprehive të domosdoshme sociale e të informacionit të freskët për të pasur orientimin e duhur në komunitetin jashtë burgut.

Nga ana tjetër edhe kur ekziston predispozicioni i duhur i të dënuarit për t'u përfshirë në mënyre aktive në procesin e riintegritimit, në shumë raste komuniteti shoqëror nuk ofron mundësitë dhe burimet e duhura materiale e sociale për një person që ka qenë në izolim. I sapoliruari do të gjendet në shumicën e rasteve përballë një sërë sfidash të karakterit psikologjik e social që mund të lidhen me punësimin e tij, rindërtimin e raporteve familjare e sociale, sjellje paragykuese e diskriminuese, mungesë besimi në vetvete etj. E gjithë kjo mori sfidash nëse nuk do të përballohet në mënyrën e duhur mund ta kthejë të dënuarin e porsaliruar në një potencial të mundshëm për t'u rikthyer në rrugën e krimit dhe kjo e bën të domosdoshëm intensifikimin e punës dhe mbështetjes së stafit edukativ në periudhën e paralirimit të të dënuarit në mënyre që ai të mbështetet në mënyrë profesionale në procesin e riintegritimit social.

Gjatë zhvillimit të këshillimeve individuale me të dënuarin, stafi i Kujdesit Social duhet të ofrojë vazhdimisht suport për të, në rastet kur ky i fundit mund të përjetojë një nivel të rritur të stresit që mund t'i paraprijë daljes nga institucioni dhe përballjes me një ambient të ri.

I sapoliruari duhet të referohet në strukturat e duhura që mund ta ndihmojnë atë dhe duhet të mësohet t'u drejtohet këtyre strukturave në mënyrën e duhur si në rrugë verbale ashtu edhe në kontaktet me shkrim.

Aktivitetet në grup do të realizohen me të dënuar në prag lirimi, targetgrup i cili

mund të diferencohet edhe në bazë të nevojave dhe karakteristikave të veçanta siç janë: kohëzgjatja e qëndrimit në institucion; nevoja për punësim apo për mbështetje materiale; nevoja për arsimim, etj. Gjate zhvillimit të aktiviteteve në grup, punonjësi i Kujdesit Social synon zhvillimin tek të dënuarit të shprehive të domosdoshme për t'u orientuar në situata sociale në të cilat ata do të përfshihen.

Programi “Mbështetje, psikologjike dhe monitorim i të miturve në konflikt me ligjin”

Targetgrupi janë të mitur (14-18 vjeç) në konflikt me ligjin. Qëllimi i këtij programi është rehabilitimi social i të miturve në konflikt me ligjin. Qendra rehabilituese dhe riintegruese e Kavajes, është qendra e vetme ku mbahen të miturit e dënuar të cilët janë gjykuar dhe privohen nga liria për vepra të ndryshme penale. Në këtë institucion të miturit edukohen dhe bëhen gati të dalin në komunitet pas lirimit të tyre. Në këtë qendër ndodhen mesatarisht 40 të mitur. Instituti i të miturve Kavajë është ndërtuar në vitin 2009 me mbështetjen dhe investimin e Bashkimit Europian me një fond prej 2.7 milion Euro. Në këtë qendër trajtohen minorenë të moshave nga 14 deri në 18 vjeç. Ambientet janë përshtatur në mënyrë për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie në drejtim të riintegrit të tyre. Kjo është një qendër e cila nga organizmat monitorues është cilësuar si një qendër bashkëkohore e cila plotëson kushtet optimale për trajtimin dhe edukimin e kësaj kategorie. Që nga viti 2010 këtë qendër e ka mbështetur organizata “Save the Children” përmes zbatimit të projektit “ promovimi i drejtësisë së të miturve”. Riedukimi i kësaj kategorie fillon me përfshirjen e tyre në procesin arsimor të detyruar 9-vjeçar. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një nga drejtimet më të rëndësishme të politikave shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Parimi kryesor për të garantuar një trajtim human të fëmijëve është se legjislativi dhe çdo vendim që merr shteti ose institucionet, duhet të jenë gjithmonë në interesin më të lartë të fëmijës.

Lloji i asistencës së ofruar për këtë kategori është psikologjike, edukative dhe sociale. Ecuria: Matje e indikatorëve në mënyrë konstante. (Dokumentimi në dosjen psiko-sociale). Programi individual i trajtimit përmban: të dhëna personale (emër/mbiemër, datëlindja, data e ardhjes në institucion, emri i specialistit që e trajton); historia e rastit; situata familjare, të afërmit që përkujdesen; nëse ka qenë i dënuar më parë? (Nëse po, specifik detajet); zhvillimi fizik (a ka zhvillim fizik normal apo të vonuar në raport me moshën, a ka ndonjë problem shëndetësor të evidentuar?); zhvillimi konjitiv (A ka zhvillim konjitiv normal në raport me moshën, sa cilësor është diskutimi?); ecuria në veprimtaritë e përbashkëta (Si sillet me bashkëmohatarët e tjerë? A ka talente, aftësi apo prirje të veçanta dhe ku duhet stimuluar, sa arsim ka dhe ç'mendim ka mbi edukimin?); emocionaliteti (Shkalla e ankthit që përjeton, si reagon në situata stresuese, sa vetëvlerësim ka?); socializimi (sa i aftë është të krijojë marrëdhënie me të tjerët, me kë preferon të shoqërohet, si pozicionohet në grup (shkalla e integrit, pranohet apo refuzohet nga të tjerët?); aftësitë (Cilat janë pikat e tij të dobëta dhe të forta, Çfarë i pëlqen dhe çfarë jo?); aktivitetet argëtuese (a i pëlqen të marrë pjesë në aktivitete argëtuese, (si lojëra etj.), a shfaq interesa të veçanta?); marrëdhëniet me familjen (Si janë kontaktet e tij me familjen dhe të afërmit dhe sa e rëndësishme është për të familja, a interesohen familjarët për të? Cili është personi

më i rëndësishëm në familje për të?) Ky program përmban objektivat, trajtimin dhe vlerësimin.

Duke iu referuar sa më sipër, sektori i edukimit duhet të kuptojë rëndësinë e zhvillimit dhe të zbatimit të programeve të rehabilitimit social, rritjen e aftësive sociale të dënuarit dhe përgatitjen e tyre për jetën e lirë.

Bibliografi

1. Ligji nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", të ndryshuar. <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=522>
2. McGuire, J. (2008) Social Problem Solving and Offending: Evidence, Evaluation and Evolution, Chapter 10. The Think First Programme.
3. Hollin, C. R., McGuire, J., Hounscome, J., Hatcher, R., Bilby, C., & Palmer, E. J. (2008). Cognitive skills offending behavior programs in the community: A reconviction analysis. *Criminal Justice and Behavior*, 35, 269-283.
4. McGuire, J., Bilby, C., Hatcher, R. M., Hollin, C. R., Hounscome, J., Palmer, E. J. (2008). Evaluation of structured cognitive-behavioural treatment programs in reducing criminal recidivism. *Journal of Experimental Criminology*, 4, 21-40.
5. Hollin, C. R., & Hatcher, R. M. (2013). Working with young offenders. In K. D. Browne, A. R. Beech, and L. A. Craig. *Assessments in forensic practice: A handbook*. Chichester: John Wiley & Sons.
6. Goldstein, A. P., Glick, B. and Gibbs J.C. (1988). *Aggression Replacement Training*. Champaign, Ill.: Research Press.
7. <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=40> (mbi programet e trajtimit)

Mbi lirinë dhe barazinë : J. Rowls

PhD (C.) Suela Ibrahimllari

Abstrakt

Në filozofinë politike shpesh vihen përballë koncepte të ngjashme për nga kuptimi, por që në realitet shpesh derivojnë në nocione antonimike të njëra-tjetrës. Kjo ndodh, sepse edhe vetë sistemet demokratike ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, në mënyrën e njohjes dhe vënies së tyre në jetë. Kështu Holmes shprehet se: "Nuk kam asnjë respekt për barazinë, që për mua s'është veçse idealizim i smirës" (Kis, J., 1998, fq.59), duke e lidhur barazinë me elementë të moralit, asaj që është e mirë dhe është e keqe.

Por lind pyetja: A janë liria dhe barazia koncepte që i vishen etalone matëse të moralitetit në sistemet politike, siç është demokracia përfaqësuese? Apo mos ndoshta në këto sisteme konceptet ngrejnë dilema dhe paradokse, sepse i atashohen elementëve të tjerë të sistemit politik, siç janë pushteti, sovranit, e drejta, ligji etj...? Deri ku shkon ky atashim dhe a mund të bëhemi skeptikë për t'i vendosur konceptet si brenda sistemit politik ashtu edhe brenda moralit?

Ky punim ka për qëllim t'u japë përgjigje pyetjeve të mësipërme, duke u fokusuar dhe thelluar në njohjen dhe refleksionin filozofik të ideve të Rowls. Njohja e filozofisë së tyre, si përfaqësues të filozofisë politike postmoderne, do të orientojë diskutimin mbi demokracitë e sotme përfaqësuese si dhe mbi mënyrën se si këto koncepte në varësi të përdorimit të tyre çojnë në denigrim dhe jo vetëm në konsolidim të demokracive të sotme.

Fjalët kyç: liria, barazia, demokracia përfaqësuese, Rowls.

Hyrje

Vlerat e lirisë dhe barazisë, janë bërë pjesë e refleksioneve filozofike që kur ato u bënë pjesë e diskutime historike nga Revolucioni Francez. Por ato janë atashuar me koncepte të tjera siç është "drejtësia", "proporcionaliteti" "paanësia" etj...

Ndryshe nga nocioni i lirisë, që mund të jetë lehtësisht i përvetësueshëm nga cdo qenie njerëzore; nocionet "barazi" dhe "drejtësi" si nocione të lidhura në mënyrë të pashmangshme me njëri-tjetrin; kthehen në nocione subjektive dhe relative. Nga pikëpamja filozofike nocioni i mbirenditur është ai i "drejtësisë", si nocion qartësisht i pasur me parakushte që përmes kompromisit shoqëror përcaktojnë se çfarë është e drejtë ose jo. Përmes refleksionit në fushën e filozofisë politike le t'i kuptojmë konceptet më gjerësisht.

1. Rreth kuptimit të lirisë dhe barazisë në filozofinë politike

Një nga elementët thelbësorë në ideologjinë politike bashkëkohore është **liria**. Dy pyetjet kryesore që lindin në lidhje me këtë element janë:

a. Çfarë është liria dhe çdo të thotë që dikush gëzon liri për të bërë ose jo një veprim të caktuar?

b. Cilat janë caqet e lirisë vetjake?

Filozofët e kanë përkufizuar lirinë, si diçka që varet nga alternativat që shtrohen para individit dhe aftësia e tij për të zgjedhur mes tyre. Kështu sipas Mill: "*Hapësira e*

përshtatshme e lirisë së njeriut, përfshin sferën e brendshme të vetëdijes, duke kërkuar lirinë e ndërgjegjies në kuptimin më të gjerë lirinë e mendimit dhe të ndjenjës, lirinë absolute të opinionit dhe shprehjes për të gjitha çështjetet: praktike, ose teorike, shkencore, morale ose teologjike..., lirinë e prirjeve dhe realizimit të tyre, e ndërtimit të planeve të jetës sonë në mënyrë të tillë që t'i përshtaten karakterit tonë, e veprimit sipas dëshirës sonë, në bazë të pasojave që mund të rrjedhin pa pengesë nga të tjerët... liria, brenda të njëjtëve kufij, e bashkimit të individëve, liria për t'u bashkuar për çdo qëllim, që nuk sjell dëmtimin e të tjerëve ...”(Stumpf, S. E., fq145) Në këtë këndvështrim dallojmë se liria është e brendshme dhe varet prej aftësive personale; dhe e jashtme e kushtëzuar nga alternativat e paraqitura para individit në funksion të realizimit të interesave të tij.

Në një këndvështrim tjetër, liria në veprim përcaktohet si pozitive dhe negative. “Liria shoqërore negative realizohet kur veprimet e një personi tjetër nuk e ndalojnë dikë të bëjë atë që do. Liria shoqërore pozitive realizohet kur njerëzit e tjerë janë të gatshëm të ndihmojnë dikë të bëjë sic dëshiron...Liritë pozitive bien ndesh me ato negative.”(Kis, J. 1998, fq196-197) Këto forma të shqyrtimit të lirisë në veprim janë vënë shpesh herë në diskutim, madje Isaiah Berlin, reflekton me mosbesim ndaj lirisë pozitive, duke shpalosur më pas realitetin e shfaqjes së saj në format e rregjimeve totalitare. Lind pyetja: po kur një individ nuk ka mundësi zgjedhjeje mes alternativave për të vepruar? Përgjigjet e pyetjes do të ishin të larmishme, por thelbi i tyre përqëndrohet në tre drejtime: pamundësia fizike për të zgjedhur, sanksionet, kostot e zgjedhjes.

Përgjegjësinë për pamundësinë e realizimit të zgjedhjes e mban edhe qeveria. Në këtë rast mendohet se shtetasit kanë më pak liri zgjedhjeje, kur qeveria është më aktive në marrjen e vendimeve të ndryshme politike. Por në fakt qeveritë:

- Kufizojnë liritë, herë me të drejtë dhe herë pa të drejtë në forma të ndryshme.
- Zgjerojnë lirinë, duke ofruar alternativa të ndryshme.
- Por ka dhe politika të caktuara, të cilat kërkojnë një vlerësim kritik për mundësitë e reja që ofrojnë, mundësi që kanë efekte anësore të prishjes së mundësive ekzistuese.

Atëherë kur zgjedhja e një individi është e mirëfilltë? Mendimet në lidhje me përgjigjen e kësaj pyetje ndahen në dy drejtime:

a. Zgjedhja e lirë është e mirëfilltë, kur individi nuk është nën varësinë apo shtrëngesën e diçkaje

b. Zgjedhja e lirë është e mirëfilltë kur nuk përcaktohet nga forma të jashtme.

Isaiah Berli shkruan për sa më sipër: “ Ata që e kanë vlerësuar ndonjëherë lirinë për hir të saj, besonin se të jesh i lirë për të zgjedhur dhe jo që të jesh i zgjedhur është një përbërës i patjetërsueshëm në atë që njeriu e bën njeri.” (Dupré, B., 2012, fq.6)

Kjo nënkupton idenë se, një zgjedhje e mirëfilltë është ajo që kërkon pavarësi dhe individi ndjehet i lirë. Por në realitet individi fillon të humbasë lirinë e tij dhe bën zgjedhje jo të mirëfillta individuale, si rrjedhojë e trysnimit të shoqërisë ku ai bën pjesë. “T'u japësh njëzëzve të drejtën pozitive për të vepruar sit ë duan, do të thotë të imponosh një kërkesë shoqërore sipas së cilës të tjerët duhet t'i ndihmojnë ata. Por, të imponosh një kërkesë të tillë do të thotë t'i detyrosh ata që ta ofrojnë këtë ndihmë dhe, për rrjedhojë, të kufizosh lirinë e tyre.” (Kis, J. 1998, fq.196) Kështu liria vendos caqet e veta ashtu si kundër edhe pushteti politik. Kjo do të thotë se liria personale është e kufizuar dhe format e kufizimit të saj janë përcaktuar në legjislacione përkatëse nga autoritetet politike shtetërore kombëtare dhe ndërkombëtare. Por edhe format e kufizimit të pushtetit

politik në relacion me lirinë janë të përcaktuara në këto dokumenta. John Rowls do të shkruante se: “ *Meqënëse liritë e ndryshme themelore janë të destinuara të bien ndesh me njëra-tjetrën, rregullat institucionale që përkufizojnë këto liri duhen rregulluar në mënyrë që të përshtaten me një skemë të pranueshme të lirive. Në praktikë, përparësia e lirisë nënkupton që baza e lirisë mund të kufizohet ose të mohohet për hir të një apo më shumë lirisë të tjera, dhe kurrë për arsye të së mirës publike apo të përsosjes së vlerave.*” (Kis, J. 1998, fq135)

Pra, liria është një vlerë e rëndësishme politike, por ajo nuk mund të kufizojë tërësisht autoritetin politik, i cili synon garantim dhe zbatim të saj. Megjithatë forma e lirisë ndryshon bashkë me shfaqjen e sistemeve të ndryshme politike, nevojave dhe problemeve të reja të shoqërisë.

Ndërkohë që ideja e barazisë, po në këndvështrimin e politikës është bërë pjesë e refleksionit filozofik referuar teorisë e ideologjive barazitare dhe praktikës për të vendosur barazi. Si ideal i iluminizmit ajo teorizohet me John Locke dhe përfaqësuesve të tjerë të shekullit XVII-të. Ky ideal u bë frymëzues për Deklaratën e të Drejtave Të njeriut, dhe më pas për vendosjen e parimit të barazisë pothuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike.

Një çështje që i ka ndarë filozofët ka qënë pyetja nëse barazia është një vlerë e brendshme apo e jashtme e instrumentale. Ata që e shohin barazinë si vlerë të brendshme piren të argumentojnë se barazia duhet realizuar me çdo kusht dhe me përparësi ndaj vlerave të tjera. Ndërkohë që ata që e shohin si një të mirë instrumentale, për të arritur një mirëqenie më të lartë apo drejtësi, argumentojnë se barazia duhet realizuar vetëm aq sa është e domosdoshme për arritjen e vlerave të tjera.

Prej Aristotelit, barazia shihej si barazi formale që jepej përmes trajtimit të drejtësisë proporcionale në formulën : “ *padrejtësia lind kur të barabartët janë trajtuar jobarabar dhe po ashtu kur të pabarabartët janë trajtuar barabar*”. Por në antikitet nëse jepej një përkufizim i tillë, mbetej vetëm një formulë e cila nuk na shpalos përmbajtjen e barazisë. Ndërsa nëse do të ndaleshim tek barazia në përmbajtje, atëherë do të ishim të detyruar t'i referoheshim një kriteri: autoriteti, pushteti, prestigji, klase, statusi, ligji. Drejtimi liberal i ideologjive politike, edhe pse e gjen veten brenda kufizimeve të konceptit të “lirisë”; dallon në politikat e veta tre lloje të barazisë në kuptimin përmbajtësor: barazi të shanseve në jetë, meritat dhe autonominë e familjes.

Lidhur me qëndrimin e barazisë si një e mirë instrumentale në kushtet e zbatimit të saj si një parim demokratik ku individ i gëzon të drejta dhe detyra të barabarta, të sanksionuara në ligjet e vendeve përkatëse vecojmë dy qëndrime: Hayek dhe Narveson.

Sipas Hayek: “ *Barazia para ligjit ka qënë gjithmonë synimi i madh i luftës për liri*” (Kis, J., 1998, fq.59). Por ky pohim ngre diskutikun drejt faktit se duhet të pranojmë që askush nuk është i barabartë edhe në sistemet demokratike. Kjo përpjekje për barazi: “*është jo e vërtetë- një mendësi tekanjoze dhe një dëshirë e kotë, e nxitur politikisht*” (Dupre, B.,2012, fq.13). Kjo do të thotë sipas Hayek se barazia ka kuptimin e barazisë së shanseve. Doktrina e shanseve të barabarta nënkupton:

- a. Meritokracinë: praktikën e emërimit të personit më të kualifikuar në një pozitë të caktuar
 - b. Rezultatet e barabarta, në kuptimin e një konkurrence ku ai që spikat si më i talentuari apo me aftësi më të kompletuara për zgjidhet për tu shpërblyer më shumë.
- Pra, sipas kësaj doktrine barazia nënkupton njëkohësisht heqjen e pengesave, fetare,

racore, gjinore, etj., përballë konkurrencës mbi aftësitë dhe talentet për tu shquar ai që ka potencialin më të madh. Kjo formë e barazisë shoqërohet me ndërlikohen e saj me konceptin e drejtësisë. Rreth nocionit të **drejtësisë**, ngrihen një sërë pyetjesh:

- a. Ç'është drejtësia?
- b. Cili është relacioni i saj me qeverisjen?
- c. Cilat janë elementët e saj dhe parimet mbi të cilat ajo mbështetet?
- d. A mund të flasim për drejtësi sociale?

Drejtësia është një vrytyt individual dhe një tipar thelbësor i institucioneve në një komunitet politik. Ajo përbën një kusht të domosdoshëm për legjitimitetin e autoritetit politik. Dy format e shfaqjes së saj janë:

1. Drejtësia distributive, e cila në të njëjtën kohë dënon fajtorin dhe shpërblen të pafajshmin.

2. Drejtësia komutative, e cila shfaqet si realizim i një marrëdhënieje kontraktore midis dy individëve në përpjekje për të zbuluar barazvlefshmërinë e veprimtarisë së tyre.

Në këtë kontekst drejtësia përfshin nocionet e ndëshkimit dhe shpërblimit, por që të mund t'i ndajë ato drejtësia kërkon:

- a. trajtim konsistent të veprimeve për të reflektuar mbi thyerjen ose jo të rregullave
- b. barazinë, për t'i trajtuar të gjithë njëjloj
- c. relevancë, në rastet kur trajtimi i individëve bëhet i ndryshëm për shkaqe të ndryshme.
- d. proporcionin, kur si rrjeshojë e relevancës, trajtimi i individëve bëhet në propocion me atë që kanë bërë.

Me anë të këtyre elementëve formohen dhe parimet mbi të cilat mbështet drejtësia:

- a. parimi i barazisë
- b. parimi i nevojës
- c. parimi i meritokracisë.

Kështu mund të themi se pa drejtësi nuk mund të kishte një qeverisje të mirë dhe anasjellas.

Një nga debatet e filozofëve politikë të shekullit të njëzetë është edhe ai mbi teorinë e drejtësisë sociale, duke u parë ky koncept si mundësi krijimi të institucioneve sociale dhe politike, që sigurojnë shpërndarje të drejtë të kostove dhe përfitimeve në shoqëri. Një ndër këto debate ka qënë ai midis Fridrich Hayek dhe John Roëls.

Hayek kundërshtonte teorinë e të drejtës sociale, duke thënë se në thelb e drejta është një veti e veprimeve vetjake të individit përballë rregullave të vendosura nga shoqëria. Me anë të kësaj ideje, ai linte mënjatë faktin se modeli i shpërndarjes së kostove dhe përfitimeve bëhej nga institucionet e krjuara prej individëve. Kështu e drejta sociale ishte shuma e veprimeve vetjake të individëve. Në kundërshtim me teorinë e tij, Roëls propozon se një shoqëri e drejtë duhet të plotësojë tre kushte:

1. të mund t'i ofrojë çdo individ numrin më të madh të mundshëm të lirie dhe të drejtave
2. pozitat shoqërore, që ofrojnë një status më të lartë të jenë në dispozicion të të gjithëve duke respektuar shanset e barabarta
3. pabarazia e të ardhurave të jetë e ligjshme, kur u sjell dobi pjesëtarëve më

nevojtarë të shoqërisë.

Edhe kjo teori ofron një formë radikale të konceptimit të një teorie të së drejtës sociale. Nëse do të përpiqeshim të jepnim parimet e një drejtësie sociale do të pohonim se ajo kërkon:

- a. parimin e lirive të barabarta
- b. parimin e shanseve të barabarta
- c. minimumin e garantuar social për jetesë cilësore
- d. parimin e meritës.

Ashtu si demokracia dhe nocioni i drejtësisë sociale mbetet një nocion i papërfunduar, si rrjedhojë e ndryshimit të shoqërisë apo dhe influencave globale.

2. John Rowls: rreth lirisë dhe barazisë në kushtet e drejtësisë paanshmëri

Diskutimi që lind si rrjedhojë e refleksionit mbi të drejtën tek Roëls mund të dimensionohet në tre drejtime kryesore:

1. Përcaktimi i fushës në të cilën do të reflektohet mbi të drejtën
2. Përcaktimi i marrëdhënieve të së drejtës me individin dhe shoqërinë
3. Përcaktimi i elementëve që implikohen në kuptimin e së drejtës si paanshmëri.

Që të realizohet efektivisht ky refleksion duhet të ndalemi në disa koncepte kyce për t'iu dhënë atyre orientimin dhe dimensionimin lidhur me të drejtën. Veçojmë:

- a. Shoqëri historike - shoqëri politike - shoqëri demokratike
- b. Sistem- sistem i paanshëm - sistem i paanshëm kooperimi- sistem i paanshëm kooperimi drejt të mirës racionale - sistem i paanshëm kooperimi drejt të mirës racionale ndonjëherë të paarsyeshme
- c. Rend - rend i duhur(në kuptimin e përgjithshëm dhe atë të veçantë) - rend i duhur në konceptionin publik - rend i duhur në konceptionin politik - rend i duhur në konceptionin e efektshmërisë
- d. Strukturë - strukturë themelore - strukturë themelore si objekt parësor i së drejtës politike - strukturë themelore e përcaktuar nga principet e drejtësisë
- e. Drejtësi - drejtësi politike: lokale, në nivel shoqëror, në nivel global.
- f. Pozicioni i individit - pozicioni fillestar i individit
- g. Marrëveshja - marrëveshja politike - marrëveshja filozofike e morale - marrëveshja hipotetike e johistorike.
- h. Liri - liri e personit- liri politike e personit - liri politike në kuptimin normativ(Identitet moral, të pajisur me aftësi morale për të konceptuar të mirën
- i. Barazi – aftësi morale- etj....
- j. Pluralizëm i arsyeshem; term që do e shohim në çdo trajtesë të refleksioneve rreth së drejtës.

Le të fillojmë të analizojmë drejtimin e parë, fushën ku lind diskutimi për të drejtën sipas Rowls-it. Çështja e së drejtës shtrohet shpesh herë si një çështje parimore, mbi të cilën ngrihen vlerat që i japin kuptim botës morale të qënies humane. Kështu në përcaktimin e vlerave morale; shohim se e drejta bën pjesë në mënyrën e interpretimit subjektiv të individit, mbi parime të klasifikuara prej tij si të moralshme. Kjo do të thotë se nëse Rowls do të nisej për t'iu dhënë një kuptim " së drejtës si paanshmëri" në fushën e moralitetit; atëherë përcaktimi do të mbetet i papërfunduar dhe jo objektiv pasi do të interpretohej si: " e drejtë subjektive, personale, e qënies humane". Rowls shkruan: " Drejtësia si paanshmëri është një konception politik i drejtësisë , jo një konception

i përgjithshëm i saj..." (Rowls, J., 2007, fq.40). përmes kësaj ideje; Rowls specifikon faktin se: nga njëra anë drejtësia do të studjohet brenda fushës së filozofisë politike dhe nga ana tjetër se përcaktimi i saj në kuptimin politik do të implikojë marrëdhënien e saj me elementë të tjerë brenda rrafshit të një shoqërie politike. Kështu drejtësia duhet parë në relacion me individin; i cili më pas bëhet pjesë e një shoqërie, e cila merr kuptimin e saj politik në varësi të sistemit politik nga i cili drejtohet dhe orienton institutet e saj drejt realizimit të efektshëm të drejtësisë sipas një rendi të duhur. Ky konception mbështetet në idenë e Rowlsit se drejtësia funksionon kur kemi një shoqëri politike në rendin e duhur; çka do të thotë se: " *të gjithë të tjerët pranojnë të njëjtin konception politik të drejtësisë*" (Rowls, J., 2007, fq. 36); apo " *shoqëria me rendin e duhur është një shoqëri efektive dhe rregulluar nëpërmjet konceptionit (publik) politik të drejtësisë...*" (Rowls, J., 2007, fq. 37).

Kështu për të argumentuar dhe mbështetur idenë e tij, se drejtësia duhet parë në rrafshin politik, Rowls shkruan se tre karakteristikat që i japin konception politik drejtësisë janë:

1. Në kuptimin moral, brenda fushës specifike të politikës dhe angazhimit të shoqërisë në struktura politike
2. "në kuptimin e një konceptioni të arsyeshëm dhe racional", ku ngrihen vlerat politike që zbatohen në strukturat e ndërtuara të shoqërisë
3. " në kuptimin e realizimit të mundshëm të një kulture politike publike", të përbërë nga idetë themelore të njohura apo të nënkuptuara të drejtësisë.

Po kështu dallohen edhe 3 nivele të drejtësisë: niveli lokal, në nivel shoqërie dhe në nivel global apo ndryshe drejtësia e popujve. Rowls specifikon se: " *Drejtësia si paanshmëri fillon me nivelin e dytë të drejtësisë- në drejtësinë e strukturës themelore. Së këtejmi, ajo projektohet jashtë, në të drejtën e popujve, dhe brenda në të drejtën lokale*" (Rowls, J., 2007, fq. 40).

Për të konkluduar në faktin se drejtësia në këndvështrimin e Rowls është veç një drejtësi politike; e parë në rrafshin e politikës. Për ta bërë atë të dallueshme nga përcaktimet moralizuese të drejtësisë; Rowls identifikon dy identitete të individit: atë moral dhe atë politik. Identiteti moral është lehtësisht i ndryshueshëm; ndërsa ai politik jo. Për këtë arsye, " *... kërkojmë në kulturën politike publike të shoqërisë demokratike, si dhe në traditat e interpretimit të kushtetutës e të ligjeve të saj themelore, disa ide të zakonshme që mund të përpunohen për të ndërtuar një konception të drejtësisë politike*" (Rowls, J., 2007, fq. 31).

Le të fillojmë nga individi, për të kaluar në përcaktimet ideore dhe kuptimore të koncepteve të Rowls, që i atashohen institutive nga të cilat merr kuptim " drejtësia si paanshmëri". Lidhur me individin, Rowls evidenton:

1. Pozicionin fillestar
2. Personin e lirë dhe të barabartë
3. Roli i tij në idenë e përligjies publike
4. Roli i tij në një sistem kooperimi
5. Koncepti i qytetarisë.

Pozicioni fillestar i individi; në marrëdhënie me të tjerët brenda një shoqërie , përcaktohet në mënyrë krahasuese si " *veli i paditurisë*" sepse individi ende nuk e di pozicionin e tij, statusin që ka në të. Kjo do të thotë se nevoja për bashkëveprimin e tij lind me të, para se ai të jetë i orientuar drejt statusit politik. Ai gëzon një identitet

moral, por kjo e bën të pamundur bashkëpunimin me të tjerët; duke u nisur nga fakti se vlerat morale kanë dhe marrin përcaktime subjektive. Po kështu autoriteti moral, nuk është ai që e orienton individin për të kuptuar vendin e tij në një shoqëri politike. “Veli i padijes” i vendos individët përballë njëri-tjetrit në kushte të “barabarta” për të rrënë në një marrëveshje, për mënyrën se si duhet kuptuar drejtësia. Kjo marrëveshje e paanshme bazuar në principet e drejtësisë politike, çon në një bashkëpunim të paanshëm social të individëve. “ *Së këtejmi edhe emërtimi: drejtësia si paanshmëri*” (Rowls, J., 2007, fq.47).

Ky pozicion shihet si abstrakt sespe ende nuk është përcaktuar roli i individit në marrëveshje dhe pozicioni apo statusi që merr prej saj definohet apriori. Për këtë arsye, Rowls evidenton se marrëveshja e paanshmërisë është një marrëveshje hipotetike sepse nuk dihet se për çfarë janë marrë vesh individët; dhe marrëveshje johistorike sepse nuk supozohet realizimi i saj. Rowls shkruan se: “ Rëndësia e pozicionit fillestar qëndron në faktin se ai është një mekanizëm përfaqësimi...një eksperiment mendor për qëllime sqarimi publik dhe vetësqarimi” (Rowls, J., 2007, fq.49). Pozicioni fillestar i individit modelon sipas Rows kushtet e paanshmërisë dhe propozon se cilat principe janë ato mbi të cilat bazohet marrëveshja e bashkëpunimit me tjetrin.

Që të mund të kuptohet drejtësia në rrafshin politi; duhet të kuptojmë dhe të interpretojmë konfliktin e koncepteve “ *liri dhe barazi e individit*”. Kërkesa për liri dhe barazi është një kusht i qytetarisë por dhe një nga kriteret që kushtëzon bashkëveprimin mes individëve për të pranuar konceptionin politik të drejtësisë. Sipas Rowls, zotërimi minimal i aftësive morale për kooperim përbën sipas tij bazën e barazisë brenda një shoqërie politike. Kjo do të thotë se aftësitë morale që nxitin kooperim, nuk kufizohen në kufijtë e komunitetit apo shoqatave duke bërë të dallueshëm prej tyre shoqërinë politike dhe shoqërinë demokratike. Duke gëzuar një identitet moral, i cili mund të ndryshojë si rrjedhojë e përligjies publike të së drejtës; identiteti politik e vendos atë në kushtet e barazisë për një drejtësi politike.

Ndërsa i *lirë*; sipas Rowls, personi konsiderohet në dy pikëpamje:

1. “... të lirë në pikëpamjen se ata e shohin vetëveten dhe njeri-tjetri si të pajisur me aftësi morale për të konceptuar të mirën” (Rowls, J., 2007, fq. 55).
2. në kuptimin e identitetit “ të specifikuar në raport me disa synime e angazhime më të thella të qytetarëve. Le ta quajmë identitetet jologjor, ose moral” (Rowls, J., 2007, fq.56).

Po kështu, ai evidenton se koncepti i lirisë mund të përcaktohet nga individët si: “ *burim vetë-autentifikimi pretendimesh të vlefshme*” (Rowls, J., 2007, fq. 57). Por sipas tij, ky përcaktim bie në kontradiktë me faktin se jo gjithmonë në kuptimin praktik e politik, një shoqëri mund ta shohë veten si burim vetë-autentifikimi, duke sjellë shembullin e shoqërive skllavopronare, ku klasa e skllavëve nuk është një shtresë që mund të ketë pretendime. Përmes nocioneve, *liri dhe barazi*; merr kuptim konceptimi i qytetarit në një shoqëri demokratike. Roli i individit në përligjien publike, shtrohet atëherë kur kemi konflikte gjykimesh për çështjet e drejtësisë politike. Ky rol, i jep individit përgjegjshmërinë për të bindur me anë të aryetimit të saktë dhe argumentimit të plotë gjykimin e tij mbi çështjet e trajtesave politike të së drejtës përballë të tjerëve, në mënyrën që çdo individ të bëhet pjesë e kooperimit.

Në mbështetje të kësaj ideje ai shkruan: “ *Sigurisht, një nga synimet kryesore të përligjies publike është ruajtja e kushteve për një kooperim social efektiv dhe demokratik, mbi bazën e*

respektit të ndërsjellë midis qytetarëve të vështruar si të lirë e të barabartë” (Rowls, J., 2007, fq.65). Nga ana tjetër, Rowls dallon se ekzistojnë dy forma të përligjies publike:

1. sipas doktrineve fetare, filozofike e morale; ta cilat përpiqen të evidentojnë se cilat janë gjykimet politike të vërteta; me anë të intuitës...

2. sipas konceptimit politik, liberal; i cili nuk pranonn apo kundërshton ndonjë doktrinë specifike, por evidenton se roli i doktrineve është të mbështesim kuptimin politik të përligjies publike me synimin për të zbutur konfliktin që buron nga dallimet e doktrineve për të kuptuarit e lirisë dhe barazisë, renditjes dhe peshës së tyre; dhe për të vendosur rendin e duhur.

Përsa i përket rolit të individit brenda një kooperimi është e rëndësishme që të kalojmë në një përcaktim tjetër të Rowls duke identifikuar sistemin e bashkëpunimit dhe mënyrën e tij të funksionimit. Ky përcaktim është cilësor në teorinë e tij si kufizues; sepse trajton teorinë e drejtësisë vetëm për shoqëritë demokratike.

Referencat

- Rowls, J. (2007). Drejtësia si paanshmëri. Dita 2000. Tiranë.
- Rowls, J. (1971) A Theory of Justice. Ma: Harvard University Press. Cambridge.Revised edition, 1999.
- Rowls, J. (1993). Political Liberalism. Columbia University Press. New York. Second edition, 2005.
- Rowls, J. (1999). The Law of Peoples. MA: Harvard University Press. Cambridge.
- Audard, C., (2007), John Rawls. McGill-Queen's University Press. Montreal.
- Bailey, T., and Gentile, V. (eds.)(2014). Rawls and Religion. Columbia University Press. New York.
- Brooks, T., and Nussbaum, M. (eds.) (2015). Rawls's Political Liberalism, Columbia University Press. New York.
- Daniels, N., (ed.). (1975) Reading Rawls: Critical Studies on Rawls' A Theory of Justice, Basic Books. Reissued with new Preface, 1989. New York.
- Davion, V. and Wolf, C. (eds.) (1999). The Idea of a Political Liberalism: Essays on Rawls, Lanham, MD: Rowman and Littlefield.
- Dupré, B. (2012). 50 ide politike. Plejad, Tiranë.
- Kis, J. (1998). Filozofia politike bashkëkohore. Onufri, Tiranë.
- Stumpf, S.: Filozofia: Historia dhe problemet, Toena, Tiranë.
- Ikonomi, L.: Filozofia e së drejtës, Ekspres, Tiranë, 2006.

Ndërtimi i institucioneve shëndetësore-farmaceutike që nga periudha e pasluftës në Kosovë

Arbenita Pajaziti

Ministria e Shëndetësisë, Prishtinë, Kosovë

Melisa Troshani

Novartis Pharma Services Inc., Zyra e Përfaqësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakti

Në këtë prezantim do të përshkruhet në mënyrë kronologjike ndërtimi i sistemit farmaceutik në Kosovë që nga periudha e pasluftës, nga viti '99, kur çdo gjë ishte shkatërruar, e deri në sfidat e ditëve të sotme. Themelimi i Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, themelimi i Agjensionit për Kontrollin e Barnave e deri tek puna që po bëhet sot në ndërtimin dhe zhvillimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Hyrje

Si krahinë në kuadër të ish Jugosllavisë, Kosova ka pasur të instaluar sistemin shëndetësor të centralizuar në nivel të komunave. Sigurimet shëndetësore janë implementuar në institucionet publike shëndetësore si dhe kanë funksionuar barnatoret publike ku pacientët janë furnizuar me barna bazuar në recetat mjekësore. Pas trazirave, në fund të viteve 80-të dhe gjatë viteve 90-të, sikurse të gjitha sferat e shoqërisë, edhe shëndetësia filloi të shkatërrohet duke eliminuar kuadrot shqiptar nga institucionet publike shëndetësore, gjë që ka rezultuar edhe në ikjen e pacientëve shqiptar nga marrja e shërbimeve shëndetësore nga institucionet publike. Si kundërpërgjigje ndaj kësaj, u krijua një sistem paralel shëndetësor, i cili ka qenë në shërbim të popullatës shqiptare.

Pas konfliktit të vitit 1999, Kosova ka trashëguar një sistem të rrënuar shëndetësor. Pas vendosjes së misionit të kombeve të bashkuar, u themeluan edhe institucionet e reja të përkohshme vetëqeverisëse.

Ndërtimi i institucioneve farmaceutike në Kosovë që nga periudha e pasluftës Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Misioni i Kombeve të Bashkuara është vendosur në Kosovë menjëherë pas luftës në vitin 1999. Kjo i ka paraprirë themelimit të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është themeluar në vitin 2000 përmes Rregullores së UNMIK-ut 2000/10. Ky departament është bashkë qeverisur nga një përfaqësues i misionit të kombeve të bashkuara dhe një përfaqësues vendor.

Roli dhe detyrat e Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ishin:

T'i rekomandojë misionit të kombeve të bashkuara dhe përfaqësuesit special politika që janë si në vijim:

- (a) ë zhvillojë strategji për zhvillimin e një sistemi shëndetësor jodiskriminues, eficient, transparent dhe llogaridhënës, në shërbim të mirëqenies së qytetarëve, që respekton dinjitetin njerëzor dhe adreson nevojat e grupeve në nevojë dhe njerëzve të tjerë që mund të jenë në rrezik;
- (b) Të zhvillojë infrastrukturën shëndetësore në spitale, klinika mjekësore, institucionet për fëmijë, persona të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara;
- (c) Të zhvillojë bazën ligjore për shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
- (d) Të preventivojë, monitorojë dhe kontrollojë problemet shëndetësore dhe sociale të popullatës.

Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pasur detyrat si në vijim:
Zbaton strategjinë dhe politikën e punës për zhvillimin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe të mirëqenies sociale në kuadër të kornizës së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;

- (b) Bashkërendon punët me departamentet tjera administrative në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale;
- (c) Mbikëqyr gjendjen e shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale dhe zbaton masat e nevojshme përkatëse;
- (d) Mbikëqyr zbatimin e standardeve duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, edhe kryerjen e inspektimeve dhe shërbimet e tjera për të cilat mund të kërkohet tarifë;
- (e) Zhvillon infrastrukturën dhe resurset njerëzore për përmbushjen e nevojave shëndetësore dhe të mirëqenies sociale të popullsisë;
- (f) Rregullon dhe mbikëqyr pajisjet dhe furnizimet farmaceutike dhe mjekësore, si dhe materialin radiokativ për përdorim mjekësor;
- (g) Bashkërendon veprimtaritë e agjencive ndërkombëtare e qeveritare dhe të organizatave joqeveritare me qëllim të promovimit të zhvillimit dhe zbatimit koherent të politikave të punës së shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale;
- (h) Inkurajon pjesëmarrjen e komuniteteve dhe zhvillimin e iniciativave të komuniteteve dhe të veprimtarive të cilat kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor dhe mirëqenien sociale;
- (i) Zhvillon dhe zbaton sistemin e sigurimit social;
- (j) Ofron ndihmë sociale sa më shumë që të jetë e mundur për familjet dhe individët nevojtarë dhe
- (k) Projekton dhe zbaton një sistem të plotë operativ informativ në mënyrë që të gjitha vendimet, politika e punës dhe proceset në sektorin e shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale të mbështeten në një bazë të shëndoshë dhe bashkëkohore të të dhënave dhe
- (l) Kryen ato funksione ndihmëse të parashtruara në këtë nen të cilat i janë caktuar Departamentit nga zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile.

Agjensioni i Kosovës për Kontrollin e Barnave

Meqenëse Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka pasur detyrë të

kontrollojë edhe sektorin farmaceutik në Kosovë, në Mars të vitit 2000 përmes Udhëzimit Administrativ 2000/7 është themeluar Agjensia e Kosovës për Kontrollin e Barnave. Ky Agjension do të ketë përgjegjësitë si në vijim:

1. Themelimi i një agjencie të pavarur në kuadër të Departamentit e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e cila do të:
2. Pranojë, verifikojë dhe regjistrojë kërkesat për lejimin e importimit të barnave, prodhimeve të tjera farmaceutike, pajisjet mjekësore dhe materialet radioaktive që shfrytëzohen për nevoja mjekësore;
3. Pranojë, verifikojë dhe regjistrojë kërkesat për lejimin e objekteve farmaceutike për shitje me pakicë dhe shumicë,
4. Të lëshojë leje për importimin e artikujve të përmendur në paragrafin e mësipërm I.2 dhe për themelimin e objekteve farmaceutike për shitje me pakicë dhe shumicë, sipas kriterëve të miratuara nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
5. Vlerësojë dhe lejojë kërkesat për importin e preparateve farmaceutike të dhuruara;
6. Mbajë një listë të objekteve të pajisura me leje për shitje me shumicë dhe pakicë, dhe të drejtorëve përgjegjës të tyre;
7. Mbledhë taksat për leje sipas procedurave të përcaktuara llogaritare, duke përfshirë dhënien e vërtetimeve;
8. Kontrollojë objektet për të cilat kërkohet leja os kanë marrë leje në përputhje me këtë Udhëzim administrativ për të:
 - a. Vërtetuar përshtatshmërinë e tyre për ushtrimin e veprimtarisë së tyre;
 - b. Siguruar respektimin e rregulloreve në fuqi;
 - c. Kontrolluar mallrat e dedikuara për import në rast të mospërputhjes apo devijimit nga detajet e specifikuar në lejen e importimit;
9. T'i përkrahë teknikisht zyrtarët e doganës, kur është e nevojshme.
10. T'a këshillojë teknikisht Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në çështjet që kanë të bëjnë me rregullat dhe lejimin e produkteve të përmendura në paragrafin I.2,

II. Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është autoriteti përfundimtar në çështjet e dhënies së lejeve për importin, distribuimin dhe shitjen e produkteve të përmendura në paragrafin I.2.

III. Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mund të jap direktiva operative për të udhëhequr punën e Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHPS)

Me t'u themeluar Agjensioni i Kosovës për Kontrollin e Barnave, udhëzimi i pare administrativ është hartuar për të rregulluar importin e barnave UA 14/2000 ne Prill 2000.

Agjensioni i Kosoves per kontrollin e barnave ne ate kohe ka pasur gjithsejt te punësuar 5 farmacist që punonin në tri njësi : Njësia per import,Njësia për zhvillim,Njësia për inspektim.

Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale

Agjensioni i Kosovës për kontrollin e barnave është shndërruar në Agjensionin e Kosovës për Produkte Medicinale në vitin 2003 përmes Ligjit për Produkte Medicinale 26/2003.

Me këtë ligj janë përcaktuar edhe organet Këshillëdhënëse dhe shërbimet për

përkrahjen teknike të Agjencionit siç janë:

(i). Këshilli i Kosovës për Vlerësimin e Produkteve Medicinale dhe Pajisjeve Medicinale, (më tej "KKVPM") përgjegjës për dhënien e këshillave teknike AKPM-së dhe SHVK-së në lidhje me lëshimet dhe mirëmbajtjet e autorizimeve dhe liçensave të produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale në vijim:

- a) aplikacionet për Autorizim Marketingu, ndryshimet, përtrirjet / mirëmbajtjet e Autorizim Marketingut të lëshuar;
- b) aplikacionet për hulumtime klinike;
- c) klasifikime dhe vlerësime teknike të produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale;
- d) klasifikimin e mënyrës së shpërndarjes të produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale;
- e) vlerësimin e sigurisë të produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale që ndodhen në Kosovë;

(ii). nën komisionet e KKVPM do të krijohen kur është e nevojshme për lejimin e përmbushjes së plotë të detyrave që kanë të bëjnë me vlerësimin teknik të kategorive të ndryshme të produkteve dhe pajisjeve medicinale.

(iii) Organi për Vlerësimin e Pajtueshmërisë për Pajisjet Medicinale që mban përgjegjësinë për lëshimin e Deklaratës për Pajtueshmëri në rastin e pajisjeve medicinale të prodhuara në Kosovë apo vërtetimin e Deklaratës së Pajtueshmërisë nga organi i jashtëm për vlerësimin e pajtueshmërisë në rastin kur pajisja medicinale është prodhuar jashtë dhe e destinuar për import në Kosovë;

(iv) Bordi i Ankesave ka përgjegjësinë për shqyrtimin e çdo ankese të ngritur nga një person fizik apo person juridik që ka të bëjë me vendimet të sjella nga AKPM-ja ose SHVK-ja, në bazë të këtij Ligji dhe akteve plotësuese normative të nxjerra po në pajtim me këtë Ligj.

(v). Komisioni Etik përgjegjës për aprovimin etik të hulumtime klinike të produkteve medicinale eksperimentale dhe pajisjeve medicinale;

(vi) Laboratori Zyrtar Medicinal për Kontrollin e Cilësisë (LZMCK) do të themelohet brenda AKPM-së në mënyrë që të sigurohet shërbimi i përkrahjes teknike për kontroll të cilësisë të produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale për të mbrojtur shëndetin publik të popullit të Kosovës. LZMCK do të jetë përgjegjës për detyrat që janë përkrahur në Nenet 13 dhe 14 të këtij Ligji.

Laboratori Zyrtar Medicinal për Kontrollin e Cilësisë

Është themeluar në Shtator të vitit 2004 në pajtim me Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 2003/26, ndërkaq funksionalizimi i plotë i tij është bërë në Prill të vitit 2008. Në vitin 2009 është aprovuar Udhëzimi Administrativ 11/2009 përmes të cilit janë përcaktuar roli dhe detyrat e Laboratori Zyrtar Medicinal për Kontrollin e Cilësisë.

LZPPM-së ka një organizim të brendshëm, të përbërë prej një stafi prej 7 anëtarësh, ku përfshihen; Drejtori i departamentit, Menaxheri i Cilësisë si dhe Udhëheqësit e sektorëve.

LZPPM-ja përbëhet nga:

- Divizioni për Sigurimin e Kualitetit;
- Divizioni Kimi-Farmacit;
- Divizioni Biofarmaci/Teknologji;

- Divizioni Mikrobiologji/Biologji.

Departamenti Farmaceutik

Ministria e Shëndetësisë si Institucion i Përkohshëm Vetëqeverisës është themeluar në vitin 2001 me Rregulloren Nr. 2001/9 të datës 15 Maj 2001, "Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë

Në Aneksin VI të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/5, mbi themelimin e Ministrisë së Shëndetësisë janë përcaktuar kompetencat e kësaj ministrie. Në organogramin e Ministrisë së Shëndetësisë, në kuadër të departamentit për shërbime shëndetësore, ka funksionuar divizioni farmaceutik i cili ka qenë përgjegjës për organizimin e furnizimit me barna të të gjitha institucioneve shëndetësore të të tre niveleve të kujdesit shëndetësor.

Ne vitin 2005, me Udhëzimin Administrativ 11/2005 Divizioni Farmaceutik shndërrohet në Departamentin Farmaceutik me tre divizione: Divizionin për furnizim, Divizionin për monitorim, Divizionin për krijimin e politikave farmaceutike.

Roli dhe detyrat e divizionit farmaceutik u zgjeruan si vijon:

Detyrat dhe Përgjegjësitë

1. Menaxhimi i stafit të Departamentit, këshillimi në çështjet operative dhe vendimmarrëse;
2. DF definon, implementon, monitoron dhe menaxhon me politikën farmaceutike në Kosovë;
3. Menaxhon Buxhetin e ndarë për Departamentin e Farmaceutikës;
4. Krijimi i një strategjie të qëndrueshme për furnizim të strukturave shëndetësore të të tre niveleve shëndetësore me barna, material shpenzues, vaksina dhe produkte të hemodializës nga Lista Esenciale;
5. Koordinimi i donacioneve të ndryshme me barna dhe pajisje medicinale nëpër struktura të ndryshme shëndetësore në përputhshmëri me ligjet në fuqi;
6. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me AKPM, departamentet dhe divizionet e tjera brenda për brenda Ministrisë së Shëndetësisë;
7. Sigurimin e shërbimeve të mira farmaceutike që do të përfshijnë menaxhimin e deponimit, distribuimit dhe disperzimit të produkteve farmaceutike;
8. Përgatitjen dhe sigurimin e nevojave dhe specifikave për produktet farmaceutike, në atë mënyrë që produktet e blera të sigurojnë një kualitet të lartë dhe qasje sa me të afërt për pacientin;
9. Përgatitjen e udhëzimeve administrative në lëmin e kompetencave të departamentit;
10. Inicimin e krijimit të një strategjie për sistemin e financimit në sektorin farmaceutik;
11. Mbikqyrja e përgatitjes së dokumenteve tenderuese për furnizim me produkte;
12. farmaceutike dhe realizimin e procesit të tenderit në bashkëpunim me departamentet përkatëse;
13. Revidimin dhe përpilimin e listës esenciale për të gjitha nivelet e kujdesit Shëndetësore;
14. Dizenjimi i formularëve standard për përshkrimin, evidencën dhe porosinë e produkteve farmaceutike për të gjitha strukturat shëndetësore;
15. Hulumtimin dhe krijimin e politikave farmaceutike për një sistem sa me të qëndrueshëm farmaceutik në Kosovë;

16. Hartimi i hulumtimeve operacionale për monitorimin e disponueshmërisë, qasjes dhe përdorimit të barnave esenciale në sektorin publik shëndetësor;

17. Përpilimin e raporteve javore, tremujore dhe vjetore për Sekretarin e Përhershëm. Ne vitin 2006 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ 19/2006 përmes të cilit disperzimi i barnave nga lista esenciale transferohet nga ish barnatoret publike tek Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, të cilat menaxhohen nga komunat. Kjo ka ndodhur në kuadër të procesit të decentralizimit. Disperzimi i barnave të listës esenciale vazhdon të bëhet në këtë mënyrë edhe në ditët e sotme.

Në vitin 2007 hyn në fuqi Udhëzimi Administrativ 11-2007: Deponimi, Distribuimi dhe Disperzimi i Produkteve Farmaceutike të Listës Esenciale.

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të rregullojë në mënyrë unike për te tre nivelet e kujdesit shëndetësor deponimin, distribuimin, disperzimin dhe ofrimin efektiv të shërbimeve farmaceutike për qasjen më të afërt të pacientëve me produkte farmaceutike dhe materiale shpenzues medicinal te listës esenciale te barërave.

Shoqata e farmacistëve të Kosovës

Shoqata e farmacistëve të Kosovës u themelua në vitin 1965, si degë e Shoqatës së Farmacistëve të Serbisë.

Në atë kohë Shoqata numëronte rreth 25 farmacistë, 7 prej të cilëve ishin shqiptarë dhe Kryetar i saj ishte Mr.ph. Mahmut Mahmuti. Shoqata ka organizuar shume aktivitete profesionale shkencore deri në vitin 1981 kur si rezultat i situatës politike në Kosovë funksionimi i Shoqatës u vështirësua ndërsa me 1985 Shoqata Farmaceutike e Kosovës u shua. Në vitin 1996, Shoqata është funksionalizuar përsëri ndërsa pas luftës në Kosove në vitin 1999, Shoqata vendos kontaktet e para me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare për të koordinuar aktivitetet profesionale në ndërtimin e sektorit farmaceutik në Kosovë. Bashkëpunimi u vendos me Organizatën Botërore të Shëndetësisë e cila në atë kohë ishte bartëse e ndërtimit të shëndetësisë bashkë me strukturat e UNMIK-ut. Filloi bashkëpunimi edhe me Farmacistët Pa Kufij (PSF)

Në vitin 2003, në kongresin e 63-të të Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike (FIP) Shoqata Farmaceutike e Kosovës u pranua me vendim unanim të Këshillit të FIP-it Anëtare e Rregullt e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike – organizatës ndërkombëtare më të madhe dhe më të vjetër të shoqatave nacionale farmaceutike. Me anëtarësimin në FIP, Shoqata mori përsipër përgjegjësi për vendosjen e standardeve profesionale në praktikën farmaceutike.

Oda e Farmacisteve te Kosovës

E sponsorizuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ligji për Odat e Profesionistëve shëndetësor u miratua nga Kuvendi i Kosovës në Vitin 2013, Ligji Nr. 04/L-150. Pas miratimit te ligjit Ministria e Shëndetësisë themeloi komisionet që do të organizonin zgjedhjet e para dhe në vitin 2015 u zgjodh kryesia dhe u themeluan Organet e Odës. Kompetencat publike të Odës janë:

1.1. miraton kodin e etikës profesionale (kodin e etikës);

1.2. regjistron dhe mirëmban regjistrin e profesionistëve dhe bashkpunëtorëve

shëndetësor dhe mban regjistrin e të gjitha Institucioneve shëndetësore;

1.3. lëshimi i licencave, ri-licencimi dhe revokimi i tyre;

1.4. zbatimi i mbikëqyrjes profesionale me angazhim të eksperteve të lëmive përkatëse; 6

1.5. bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;

1.6. ushtrojnë mbikëqyrjen profesionale dhe ligjore mbi punën e profesionistëve shëndetësor;

1.7. verifikon ligjshmërinë e procesit të specializimit, organizon provimin specialistik, organizon dhe mbikëqyr sub-specializimet;

1.8. planifikojnë, zbatojnë edukimin e vazhdueshëm profesional;

1.9. ndërmjetëson në kontestet në mes anëtarëve të Odës dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;

1.10. organizon gjyqet e nderit në lidhje me përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të Odave dhe shqipton masa disiplinore;

1.11. cakton lartësinë e pagesës së anëtarësisë të anëtarëve të Odave;

1.12. cakton lartësinë e taksës për licencim, ri-licencimit, dhe lejeve tjera për ushtrim të veprimtarisë profesionale në bazë të autorizimeve ligjore;

1.13. lëshon kartelat e identifikimit dhe numrat identifikues për anëtarët e Odave;

1.14. me kërkesën e anëtarëve të Odës lëshon certifikata, vërtetime dhe dokumente tjera në bazë të evidencës zyrtare të Odës.

Pas themelimit të Organeve të Odës ka filluar bartja e kompetencave nga Ministria Shëndetësisë tek Odat e Profesionisteve Shëndetësorë. Procesi i bartjes së kompetencave ka hasur në shumë vështirësi dhe po ecën shume ngadalë. Problem shihet të jetë financimi i odës krahas problemeve të tjera teknike.

Agjensioni i Financimit Shëndetësor

Agjensioni i Financimit Shëndetësor është Agjencioni ekzekutiv nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë, para-ardhës i Fondit publik të Kosovës për sigurime shëndetësore që në emër të shtetit realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me kontraktimin dhe blerjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si edhe grumbullimin e të gjitha mjeteve financiare të Fondit për këtë qëllim, deri në themelimin e Fondit me këtë ligj.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencionit të Financimit Shëndetësor përcaktohen me Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe Ligjin Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore Në kuadër të Agjencionit të Financimit Shëndetësor, funksionon Departamenti për Shërbime farmaceutike që ka dy divizione :

- Divizioni për analize planifikim dhe menaxhim te kontratave për barna dhe material shpenzues
- Divizioni i çmimeve dhe reimbursimit te medikamenteve

Agjensioni është duke punuar në krijimin e politikave, udhëzimeve administrative dhe udhërrëfyesve për menaxhimin e barnave pasi të funksionalizohet Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Përfundime

Menjëherë pas luftës në Kosovë, me përkrahjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara, janë themeluar institucionet e vendit. Ndër institucionet e para është themeluar Agjensioni i Kosovës për Kontrollin e Barnave. Ky agjencion ka qenë ndër agjensionet e para në rajon. Në fillimet e saj, kjo agjenci kishte të punësuar 5 farmacistë që punonin në tre njësi: Njësia për import, Njësia për zhvillim, Njësia për inspektim. Agjensioni i Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale sot ka 54 të punësuar, prej tyre 18 farmacistë që punojnë në gjashtë departamente.

Sfidë në periudhën në vazhdim do të jetë bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë tek Oda e Farmacistëve të Kosovës. Financimi i odës gjithashtu është çështje me rëndësi që meriton një vëmendje të veçantë. Pas bartjes së kompetencave të plota, Oda do të luajë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit farmaceutik në Kosovë.

Instalimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore do të reformojë rëndësisht sistemin farmaceutik në Kosovë. Departamenti për shërbime farmaceutike, në kuadër të Agjencisë së financimit Shëndetësor duhet të zhvillohet dhe të kompletohet me staf profesional. Duhet të mësojmë nga përvojat e shteteve që tashmë kanë kaluar nëpër këtë rrugë në mënyrë që reforma në sistemin farmaceutik dhe shëndetësor të ketë sukses.

Referencat

Sistemi paralel shëndetësor.

http://www.advocacynet.org/cpage_view/kosovo_parallelsociety_3_42.html

Banka Botërore "Raporti i vlerësimit të varfërisë në Kosovë".

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_10.htm

<http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Nr.7-2000.AlbEngSer.pdf>

http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2003_26-Pajisjet-Medicinale.pdf

<https://akppm.com/service/licences/>

11-2009 Udhezimi Administrativ: Mbi Kontrollin e Kualitetit të Produkteve Medicinale të Plasuar në Kosovë.

Pharmaceutical Sector in Kosovo – Dardane Arifaj.

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2002regs/RA2002_05.pdf

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_09.pdf

<http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/nr.11-2005Alb.EngSer.pdf>

http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Nr.19-2006.Alb_.pdf

<http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Udhezimi-Administrativ-11-2007.pdf>

<http://shfarmks.org/>

<http://www.pharmaks.com/indeks/>

https://web.facebook.com/pharmaks1/posts/622776817767137?_rdc=1&_rdrhttp://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Ligji-per-Odat-e-profesionisteve-shendetesor-2013.pdf

<http://ofk-rks.net/>

<http://afsh.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,19>

<http://afsh.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,20>

<http://afsh.rks-gov.net/desk/inc/media/7A8D97CE-98DA-47A9-801D-8A7074D83A49.pdf>

Legal basis for granting a marketing authorization for drugs in Kosovo

Melisa Troshani

Novartis Pharma Services Inc., Representative Office, Tirana, Albania

Arbenita Pajaziti

Ministry of Health, Pristina, Kosovo

Abstract

During the last years, Kosovo has faced many social and economic changes. These changes have influenced directly the healthcare system, the pharmaceutical market, as well. The implementation of laws and regulations has given the possibility to create a challenging, and quite competitive environment, which is developing in a rapid way. Actually in Kosovo, there are present with their drugs many research and development pharmaceutical companies, generic companies as well as local manufacturers.

In this project, it is introduced the legal regulatory basis in Kosovo, including the main law provisions and regulations requirements. It is also described in detail, the procedure for granting a marketing authorization of a medicinal product from the local health authority. All the efforts have been made in order to harmonise, till now, partially the new requirements with the EU directives, as the future objective of Kosovo is to be part of the European Union.

Keywords: marketing authorization, drugs, Kosovo, legal basis, requirements, harmonisation with EU.

Introduction

Kosovo, as the newest country in Europe has faced establishing of the state institutions from the scratch. After the war of 1999, Kosovo was under the UN administration. UN and local institutions of provisional government had to build governing institutions, at the same time they to draft the new laws. In 2008, Kosovo declared independence and UN gradually transferred competences to local institutions. Today, Kosovo aspires to become member of the European Union. In order to do so, there is need to fulfil the criteria set by EU and to harmonize legislation with *acquis communautaire*. This harmonization of legislation includes, as well, the Health and Pharmaceutical system.

Health system was devastated by the war and it was one of the first focuses of the post-war reconstruction and rebuilding efforts. Adequate legislation had to be drafted, capacities had to be built and institutions had to be established so that the whole health system can serve welfare and wellbeing of the Kosovo citizens.

Establishment of the Health Insurance Fund together with the harmonization of the legislation with the EU are now the biggest challenges that the health system is facing in our country. Creating a new health insurance structure in Kosovo will start a new challenging phase of healthcare system reform. During drafting of the legislation, it is a "must" to look at the lessons learned and the best practices shared from the countries that have similar infrastructure and number of residents, compared to Kosovo. Welfare of the citizens is the essence of any successful reform.

Regulatory enviroment in Kosovo

The most important regulatory bodies in Kosovo are the Ministry of Health, the National Agency for Medicines and Medical Devices, hereafter referred to as the "Agency". The legal basis for granting a Marketing Authorization for medicinal products in Kosovo is described in the Administrative Instruction No. 01/2015 "Marketing authorization for medicinal products".

This Administrative Instruction (AI) determines procedures and the conditions for issuing the granting, suspension and withdrawal of the authorization for marketing of medicinal products. This Administrative Instruction is partially compliant with EU Directives 2001/83/EC, 2002/98/EC, 2003/63/EC, 2004/24/EC, 2004/27/EC, 2008/29/EC, 2009/53/EC, 2009/120/EC and EU Regulations no. 726/2004, 1394/2007. Authorization for Marketing of medicinal products is issued only based on valid scientific evidences on the quality, safety and efficacy of the products according to the compliance of the documentation, harmonized with provisions provided for in this Administrative Instruction.

Procedures

The following procedures related to the marketing authorization of a medicinal product are under the responsibility of the Marketing Authorization department near the local Health Authority in Kosovo:

- A. Granting of a New Marketing Authorization
- B. Renewal of the Marketing Authorization
- C. Variations to the Marketing Authorization.

Marketing authorization procedure

In order to obtain an authorization to place a medicinal product on the market, an application shall be made to the KMA. Authorization for Marketing may only be granted to a pharmaceutical company established in the Republic of Kosovo or to a pharmaceutical company with an authorized responsible person in accordance with this administrative instruction. The application shall be accompanied by the following particulars and documents, submitted in accordance with respective annex in Article 22 on administrative instruction (analytical, pharmaco-toxicological and clinical standards and protocols in respect of the testing of medicinal products) as:

Name or corporate name and permanent address of the applicant and, where applicable, of the manufacturer;

The name of the medicinal product;

Qualitative and quantitative particulars of all the constituents of the medicinal product, including the reference to its international non-proprietary name (INN) recommended by the WHO, where an INN for the medicinal product exists, or a reference to the relevant chemical name;

Impact evaluation of the potential environmental risks posed by the medicinal product shall be assessed on a case-by-case basis; due to specific arrangements to limit it shall be envisaged;

Description of the manufacturing method;

Therapeutic indications, contra-indications and side effects;
Posology, pharmaceutical form, method and route of administration and expected shelf life;

Reasons for any precautionary and safety measures to be taken for the storage of the medicinal product, its administration to patients and for the disposal of waste products, together with an indication of potential risks presented by the medicinal product for the environment;

Description of the control methods used by the manufacturer and written confirmation that the manufacturer of the medicinal product has verified compliance of the manufacturer of the active substance with principles and guidelines of good manufacturing practice by conducting audits. The written confirmation shall contain a reference to the date of the audit and a declaration that the outcome of the audit confirms that the manufacturing complies with the principles and guidelines of good manufacturing practice;

Results of:

1. Pharmaceutical (physico-chemical, biological or microbiological) tests;
2. Pre-clinical (toxicological and pharmacological) tests;
3. Clinical trials.

Summary of the medicinal product characteristics, a mock-up of the outer packaging, the immediate packaging of the medicinal product, together with package leaflets in accordance to the provisions of this administrative instruction;

Documents and information concerning the results of pharmaceutical and pre-clinical tests and clinical trials referred to in subparagraph 3.10 of this article will be accompanied by detailed summaries.

Authorization for Marketing applications, which are subject to the 'independent' procedure, required for the original medicinal products without any Authorization for Marketing in any other country and for medicinal products for which Authorization for Marketing has not previously existed in any of EU member states, the documentation has to be submitted CTD-Modules 1 to 5 and scanned in jpeg format in 300 dpi.

The simplified marketing authorization procedure

There is a simplified procedure for the Authorization for Marketing of medicinal products approved nationally of the EU and Schengen countries and USA.

The right to apply for an Authorization for Marketing under this procedure have only holder of the Authorization for Marketing of a medicinal product which is authorized within the EU in accordance with Schengen zone and USA. The applicant shall submit to the KMA the application form (Annex 1) and the file for Authorization for Marketing in written form and on CD with the documentation as following:

Proof of payment for the marketing authorization;

Certificate of Pharmaceutical Product (CPP) - Original;

Certificate of Good Manufacturing Practice (GMP);

Summary of Product Characteristics (SPC) in English or in the official languages of the Republic of Kosovo;

Package Information Leaflet (PIL) in the official languages of the Republic of Kosovo;

Mock-ups in the Latin alphabet or the official languages of the Republic of Kosovo when not in Latin alphabet;

Proof of status of the Authorization for Marketing of a medicinal product in the countries listed in paragraph a/m;

Application documents should be scanned in jpeg format in 300 dpi;

The applicant shall not be required to submit CTD - Modules 2-5;

Two (2) samples for application for marketing authorization, whereas in case of request of the official KMA laboratory the applicant is obliged to bring the requested amount of samples and working standards within the legal periods of EC.

Upon completion of the documentation specified in this article, KMA shall decide within 70 days to issue a marketing authorization.

From the moment of receipt of the marketing authorization, the Authorization for Marketing Holder or his official representative is obliged to place the products in the market equipped with package leaflet in the official languages of the Republic of Kosovo.

In case of doubt about the quality of medicinal products, at the request of the KMA, the Authorization for marketing holder is required to submit samples and reference standards of active substances for the purposes of laboratory control and protecting public health.

The Authorization for marketing holder has to inform the KMA immediately about any change or the cessation in the placing on the market of the product and the background. He is also obligated to report about all changes, especially of pharmacovigilance reasons and ensuring that the same SPC, PIL, labeling and quality of the medicinal product are in the market of all countries stated in paragraph 1 of this article and in the Republic of Kosovo.

Marketing authorization for medicinal products approved according to section 10 of this AI applies only to the series of medicinal products that are in circulation in country es highlighted above with trade names as marketed in these countries.

Biological medical products, similar to biological, oncological, of the advanced therapy, can apply only if they possess MA in EMA or FDA.

Authorization for marketing procedure for medicinal products centrally authorized within the EU

The right to apply for an Authorization for Marketing under this procedure has only the Authorization for Marketing holder or his official representative of a medicinal product which is authorized in accordance with the Regulation (EC) No 726/2004.

Simplified Authorization for marketing procedure by unilateral agreements

Pursuant of the Law on Medicinal Products and Medical Device the Ministry of Health can conclude agreements with different countries for unilateral recognition of marketing authorizations by the Republic of Kosovo. Agreements for unilateral recognition are laid down in specific Administrative Instructions and are not part of this Administrative Instruction.

The Renewal of the marketing authorization

Authorization for Marketing shall be valid for five years. The Authorization for Marketing may be renewed after five years on the basis of a re-evaluation of the risk-benefit balance by the KMA. To this end, the Authorization for Marketing holder shall provide to the KMA a consolidated version of the file in respect of quality, safety and efficacy, including all variations introduced since the Authorization for Marketing was granted, at least 3 months before the Authorization for Marketing ceases to be valid. In case of delay for applications for the remaining three months it should be applied the fee according to the administrative instruction for tariffs. After the expiry of MA, KMA cancels MA. Renewal should be made as it is foreseen in Law 04/L-190. The KMA may, in exceptional circumstances and on public health grounds, grant exemptions.

The documents that have to be submitted in KMA include:

Cover letter;

Application form for renewal;

Statement by the qualified person responsible for the "Batch Release" which states that any medicinal product and active substances contained in that medicinal product are manufactured according to GMP rules countries according to section 10 of this AI, unless there are any objections from any of the countries highlighted on this article. Or this standard is defined by the by-laws of the Law on medical supplies and products 04 / L-190 also under Article 3, paragraph 1.5 of this AI;

A list of all variations and extensions over the KMA, whereas for marketing authorizations pursuant to Article 10 or 11 all variations, extensions and renewal of the Authorization for Marketing in the country of origin;

The latest version of SPC, PIL in the official languages of the Republic of Kosovo;

Module 2 - summary of evaluation by qualified experts (statement from Quality Experts);

Risk Management Plan (RMP) or alternatively PSUR if RMP is not part of the Authorization for Marketing in the country of origin;

Receipts, half of the regular fee for the certificate;

In case of delay in the application under the applicable legislation, fees applied by AI for tariffs;

Applicants for the renewal must meet the quality standards according to this AD, without exception to any application procedure by which they have earned the right to Marketing Authorization;

Every Authorization for Marketing Holder that applies for renewal should fulfill quality standards according to this AI.

Variations

According to the KMAG19 Guidelines for Type I Minor and Type II Major Variations, variations are classified as following:

1. Type I minor variation notifications - Guidelines for notification requirements and List of modifications to an existing marketing authorisation that constitute a Type I variation

2. Type II major variation applications – Guidelines for application and list of modifications that constitute a Type II variation

Type I Minor Variations: notification requirements, list of modifications to an existing marketing authorization that constitute a Type I variation

A type I minor variation presents amendments to the contents of the documents such as they existed at the moment the decision on the marketing authorization was made. An application for a variation shall not concern more than one variation. Where several variations are proposed a separate application must be submitted in respect of each variation sought and each such application shall contain a reference to the other application(s).

Where a variation applied for entails one or further changes, a single application may cover all such consequential variations. The single application shall describe the relation between the main variation and its consequential variations.

Where a variation requires consequential updating of the summary of product characteristics, labeling, and package leaflet or packs size, this is considered part of the variation and the time period for implementing the consequential update must be agreed with the competent authority in the course of assessment of the variation. For the updating of the information to be approved the amended information should be submitted in Albanian, Serbian and English languages.

Type II major variations mean any change to the documentation of an already authorized medicinal product and that are not listed under type I variations.

To obtain a type II variation, the holder of the marketing authorization shall send to the competent authority an application accompanied by the relevant particulars and supporting documents. The application must also be accompanied by:

- supporting data relating to the variation applied for;
- All documents amended as a consequence of the application, with a reference to those to be substituted from the original dossier;
- An Addendum to or updating of existing expert report(s) to take account of the variation applied for.

An application shall not concern more than one variation to the marketing authorization. Where several variations are to be made to a single marketing authorization, an application shall be submitted in respect of each variation sought; each such application shall contain a reference to the other application(s).

Where a variation in the marketing authorization entails one or further changes, a single application may cover all such consequential variations. The single application shall describe the relation between the main variation and its consequential variations. It should be noted that certain categories of medicinal products, i.e. biotechnology medicinal products falling under List A of Council Regulation (EEC) No 2309/93, immunological medicinal products consisting of vaccines, toxins or serums and allergens and medicinal products derived from human blood or human plasma, for certain Type I categories the Type II approval procedure is followed, although a Type I fee will apply.

For Type II variations involving a complex change it is recommended that the applicant liaise with the competent authority before submission of the application.

Conclusions

The legal basis for granting a marketing authorization in Kosovo, is partially harmonised with the EU directives. In order to have an effective implementation of the legislation, it is requested an interactive collaboration between Health Authorities in one side and pharmaceutical companies/industries on the other. Local Health Authority needs to have evidence confirmation that the drugs submitted for granting a marketing authorization have already been approved in the specific countries listed in the Law regulating drugs and Pharmaceutical Service in Kosovo. The simplified marketing authorization procedures, the simplified procedures through unilateral agreements have made the local process quite smooth and have given the possibility to many originator and generics pharma companies to be part of the Kosovo Pharma market, and at the end to be available to reach the patient in Kosovo.

References

1. MA dossier guidelines: Kosovo MA Dossier .pdf KMAG1 V1 10/05.
2. CTD Module 1 Administrative information: CTD 1 (Kosovo).pdf KMAG2.1 V1 10/05.
3. EU Part I Summary of the Dossier: EU Part I (Kosovo).pdf KMAG2.2 V1 10/05.
4. CTD Module 2 – CTD Summaries: CTD 2 (Kosovo).pdf KMAG3. V1 10/05.
5. CTD Module 3 - Chemical, pharmaceutical and biological information for chemical and/or biological active substance(s): CTD 3 CAS/ BAS (Kosovo).pdf KMAG4.1.V1 10/05.
6. EU Part II – Chemical, pharmaceutical and biological documentation for chemical active substance(s):EU Part II CPBCAS (Kosovo).pdf KMAG4.2.V1 10/05.
7. EU Part II – Chemical, pharmaceutical and biological documentation for biological active substance(s):EU Part II CPBBAS (Kosovo).pdf KMAG4.3.V1 10/05.
8. CTD Module 4 – Non clinical reports: CTD 4 (Kosovo).pdf KMAG5.1 V1 10/05.
9. EU Part III – Pharmacological and toxicological documentation: EU Part III (Kosovo).pdf KMAG5.2 V1 10/05.
10. CTD Module 5 – Clinical study reports: CTD 5 (Kosovo).pdf KMAG6.1 V1 10/05.
11. EU Part IV – Clinical documentation: EU Part IV (Kosovo).pdf KMAG6.2 V1 10/05.
12. Medicinal product type summary of documentation requirement: MP type doc requirements (Kosovo).pdf KMAG7.V1 10/05.
13. Well established medicinal use of medicinal products: WEMU (Kosovo).pdf KMAG8.V1 10/05.
14. Essential similarity, bioavailability and bioequivalence: ESBioABioE (Kosovo).pdf KMAG9. V1 10/05.
15. Simplified marketing authorization procedure pursuant to the EU centralized procedure (CADREAC – EU Centralized): EU Centralized procedure (Kosovo).pdf KMAG10.V1 10/05.
16. Simplified marketing authorization procedure pursuant to the EU decentralized procedure (CADREAC - EU Decentralized): EU Decentralized procedure (Kosovo).pdf KMAG11 V1 10/05.
17. Kosovo unilateral recognition procedure: Unilateral recognition (Kosovo).pdf KMAG 12 V1 10/05.
18. "Pharmaceutical system reform in Kosovo" Pajaziti A., 8 April 2017, ICSNS I-Conference – Vienna.

Peisazhi shqiptar i gjysmës së dytë të shekullit të XIX-të (nga disa autorë që e trajtuan atë)

MND.Agron Mesi

Lektor në Universitetin Polis, Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn, Tiranë

Abstrakt

Shqipëria nje territor i shtrirë në juglindje të Europës historikisht ka qënë sa në vëmendje të politikave të saj, po aq edhe e harruar apo e neglizhuar nga ato. Për rreth 50 vjet regjimi komunist e izoloi atë nga fqinjët dhe nga bota, ndërkohë që ky pushtet vinte në fuqi pas një sërë ngjarjesh politike rajonale të gjysmës së parë të shekullit të XX-të, të cilat sa e bënë të njohur Shqipërinë, po aq dhe e diskriminuan atë. Fati i Shqipërisë në një farë mase ka qënë gjithmonë i lidhur me kancelaritë europiane dhe interes të tyre, kryesisht politike mbi këtë territor.

Shkrimi im tenton të informojë mbi interesin që pati për të huajt Shqipëria e shekullit të XIX-të, jo në sensin politik, por në atë kulturor dhe entologjik, veçanërisht në gjeografinë e peisazhit.

Shumë eksplorues, historianë, etnologë, poetë, piktorë e fotografë europianë vizituan këtë vend, thaujse të panjohur apo të harruar për ta, në kërkim të emocioneve dhe informacioneve të reja, dukuri kjo e njohur për shek. XIX-të, si rrjedhojë e atmonsferës së përparimit në përgjithësi, modernizimit teknologjik, zgjerimit të udhëtimeve tregtare dhe interesit eksplorues drejt territoreve të reja të reja. Ky interesim i disa figurave intelektuale europiane të kësaj kohe për Shqipërinë, është një fat për historinë tonë, dokumentimin e saj në shkrime apo shënime udhëtimesh, në shumë piktura e fotografi, të rëndësishme këto akoma edhe më shumë, më kalimin e kohërave.

Krijimtarija me subjekte shqiptare e anglezit Edward Lear, realizuar gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri mes viteve 1848-1849, janë informacion sa artistik, po aq dhe real dokumentues mbi atmonsferën e kohës, peizashin rural apo atë të qyteteve, veshjet dhe arkitekturën shqiptare të asaj kohe. Po I kësaj periudhe përafërsisht, është dhe dokumentimi fotografik I peisazhit nga Dr. Josef Szeleky, i cili shoqëronte ekspeditën studimore të Johann Georg van Hahn të vitit 1863 nëpër Shqipëri.

Njëkohësisht kemi mbërritjen e mediumit "magjik" të fotografisë në Shqipëri më 1856 nga italianin Pietro Marubbi. Ai na dhuroi trashëgiminë e dinastisë Marubi, me nxënësin e tij, shqiptarin Kel Marubi.

Veprat, sa dokumentuese po aq dhe artistike, të këtyre autorëve që përmendëm më sipër, duke i krahasuar, shpesh plotësojnë, përkrijnë e ndërlidhen mes tyre, dhe kështu na ofrojnë dëshmi, vërtetojnë prani, vende e peisazhe, duke ruajtur materialisht kujtesën e realitetit të asaj kohe deri te ne sot.

Përsëri sot Shqipëria është në interesat europiane dhe më gjerë, por tashmë këto janë politika globale gjithëpërfshirëse, sa politike dhe ekonomike aq edhe kulturore.

Fjalët kyçe: revolucion, modernitet, eksplorim, egzotik, romantik, atmonsferë, tipologji, orientale, kombëtare, vernakolare, arkitekturë, përngjasim, peisazh, fotografi, dokumentim, realitet, histori, fakt.

Hyrje

Shekulli i XVIII-të, për Europën, është shekulli i revolucioneve të mëdha, i zbulimeve plot aventura dhe i udhëtimeve tregtare, i afirmimit të parimeve të filozofisë racionaliste dhe iluministe, i përparimit teknologjik si asnjëherë tjetër më përpara, si parakusht i Revolucionit Industrial. Vetë ideja e modernitetit u lind në këtë klimë optimizmi dhe besimi të ripërtërirë në aftësitë njerëzore. Përhapja e shtypit dhe lindja e "opinionit publik" shfaqen si faktorë të tjerë përcaktues të kulturës së epokës; diskutimet e lira,

komentet, shfaqja e mosmarrvëshjeve, praktikohen sidomos në kryeqytetin britanik. Dukuria e qarkullimit të ideve dhe pohimi i një qëndrimi kozmopolit, nxisin etjen për udhëtime, për t'u ballafaquar, mbledhur përshtypje dhe për të rivlerësuar qytetërimi të largëta (De vercchi & Cerchiari, 1999, 42).

“Zbulimi” i Shqipërisë

Fillimi i shekullit të XIX-të dhe në vazhdim ishte koha kur Europa “zbuloi” Shqipërinë. Trojet e banuara nga shqipëtarët, të shtrira përgjate Ballkanit perëndimor, ndonëse gjeografikisht i përkisnin Europës juglindore, u mbajtën për shumë kohë larg ndikimit iluminist, ngaqë ndodheshin në skajin më të largët të Perandorisë Osmane e për rrjedhojë u ndien gati të harruara. Udhëtarët e huaj filluan të depërtojnë në këtë vënd, më të largët in e më të panjohurin e kontinentit, të cilin historiani anglez Eduard Gibon (Edward Gibbon 1737-1794) e përshkruan si “*një vënd në fushëpamje të Italise, por më pak i njohur se thellësitë e Amerikës*”.

Vizitoret e parë europianë ishin diplomatë, eksplorues, historianë, botanistë, arkeologë, shkrimtarë, piktorë e deri dhe aventurierë në kërkim të emocioneve të reja. Këta udhëtuan drejt Shqipërisë duke hyrë kryesisht nga Greqia për në juglindje të vendin, në Janinë, Kostur, Manastir, Strugë, Ohër e më poshtë, territore shqiptare këto, ku asaj kohe sundonte Ali Pashë Tepelena.

Shqipërisë dhe shqipëtarëve u janë kushtuar tabllo, portrete e gravura, por dhe vepra në gjini të tjera të artit. Vec realizimit të tabllave me tema historike nga qëndresa e popullit shqiptar ndaj pushtuesve apo ato me subjekte ekzotike e kostumografike, piktorët e huaj, të impresionuar nga pamje të mahnitëshme të një natyre të paprekur, sa epike po aq edhe lirike, përjetësuan në vepra arti dhe këto bukuri të natyrës shqiptare të asaj kohe.

Poeti dhe piktori anglez Eduard Lir (Edward Lear 1812-1888) nuk ishte i pari nga këto artistë, por mund të ketë qënë i vetmi që bëri një udhëtim më të plotë përgjatë gjithë Shqipërisë. Ambasadori britanik në kryeqytetin osman i siguroi atij një leje dokument për të udhëtuar drejt zonave “*të egra*” të perandorisë.

Ditari i tij i udhëtimeve, i botuar më 1851 me titull “*Ditar i një piktori peisazhist ë Shqipëri*” është një libër i mrekullueshëm (Hudhri, 1987, 1).

Lir, gjatë mesit të viteve 1848-1849 kur udhëtonte në Shqipërinë, krijoi më se njeqind vepra, shumica skica peisazhesh me tekniken e lapësit dhe bojës monokrone, ngjyrave të akuarelit apo të shtypit litografik. Ai në shënimet e tija të udhëtimit shprehet i egzaltuar: “*Ishte e vështirë t’i ktheje shpinën këtyre pamjeve malore të mrekullueshme, këtyre skutave e joshjeve të kësaj bote të bukur, këtyre pamjeve prej të cilave asnjë shpirt piktori nuk lodhet kurrë së sodituri*” (Lear, 1851).

Skena artistike e vendit dhe e kohës nga vinte Eduard Lir

(Zhanri i pikturës së peisazhi dhe artistë të njohur, bashkëkohës , që e trajtuan atë)

Eduard Lir vinte nga Anglia, e cila së bashku me Francën, ishin skenat më të zhvilluata të artit në fundshekullin e XVIII-të dhe atë të XIX-të. Me revolucionin Frëng të 1789-s kishte filluar dhe epoka moderne. Ashtu sikundër ky revolucion i madh i ka rrënjët në Epokën e Arsyës, po aty i kanë rrënjët edhe ndryshimet e koncepteve të njeriut

për artin. Ndryshimi i parë kishte të bënte me qëndrimin e piktorit ndaj asaj që quhet "stil" (Gombrich, 1995, 476). Artistët e ndjenë veten më të lirë për të zgjedhur si subjekt gjithçka, çdo gjë që me të vërtetë zgjonte fantazinë dhe ngjallte interesim, si temat historike, qoftë dhe ato biblike, apo të fantazisë së lirë e të vegjimeve ëndërrimtare, por po ashtu dhe ato që përshkruanin jetën e zakonshme apo thjeshtë pamje të natyrës. Ndër zhanret e pikturës që përfitoi nga kjo liri e re e zgjedhjes së subjektit pasqyruar ishte peisazhi, që deri atëherë ishte parë si një degë minore e artit. Këtë qëndrim e ndryshoi fryma romantike e fundshekullit të XVIII-të dhe fillimshekullit të XIX-të, kur shumë piktorë të njohur ngritën dinjitetin e këtij zhanri, duke e trajtuar gjërisht atë.

Geinsburg (Thomas Gainsborough 1727-1788) pikturonte peisazhe, i pëlqente natyra dhe vëzhgonte me vëmendje subjekte dhe detaje të saj. Por duke mos pasur shumë blerës për piktura me tema të tilla, një numër të madh punimesh i trajtonte për kënaqësi veti, në formë skice, etydi apo vizatimi monokrom në sepia. Këto janë peisazhe të kompozuara nga bashkimi i disa pjesëve apo detajeve të para nga natyra, me qëllim për të transmetuar një gjëndje shpirtërore të caktuar (Gombrich, 1995, 470). Ajo shije dhe prire për aspektet "piktorese" të natyrës që ka frymëzuar skicat e Geinsburgut në Angli, haset edhe në Francën e shek. XVIII-të me Fragonard (Fragonard 1732-1806). Ai vizatoi peisazhe, duke përdorur me mjeshtri efekte dhe kontraste të forta, dhe arrin të zbulojë madhësinë dhe bukurinë e peisazhit real, qoftë edhe në një copëz të vogël të tij (Gombrich, 1995, 473).



(foto1)



(foto2)

Të kësaj periudhe, por pak më të vonshëm, të të njëjtit brez, janë dhe dy piktorë të mëdhenj anglez të peisazhit, Tërner (J.M.Ë.Turner 1775-1851) dhe Konstejbëll (John Constable 1778-1837).

Tërner që një piktor jashtëzakonisht i suksesshëm edhe për kohën kur jetoi. Pikturat e tij më të mira na japin një koncept të madhësisë së natytës në trajtën e saj më romantike e më sublime. Te pikturat e Tërner-it natyra gjithmonë pasqyron dhe shpreh emocionet e njeriut, duke u kthyer kështu, më shumë se pasqyrim i realitetit të jashtëm, në frymën e realitetit të mbrendshëm. Figura e njeriut, prezente direkt apo indirekt në peisazh, ndjehet e vogël dhe e pafuqishme përballë forcash, të cilat duket

sikur ai nuk është në gjëndje t'i zotërojë dot (Gombrich, 1995, 493).



(foto3)



(foto4)

Idetë e piktorit tjetër të shquar anglez të peisazhit, Konstejbëll-it, janë krejt të tjera nga të Tërner-it. Ai donte të pikturonte jo fantazinë apo imagjinatën e natyrës, por donte t'i qëndronte besnik asaj çfarë shihte me sytë e tij. Shkonte fshat më fshat për të bërë skica dhe etyde direkt nga natyra, e më pas, këto motive, i përpunonte në studio. Këto punime, të karakterit të etydit apo skicës së shpejtë, shpesh janë më të lirshme artistikisht se punimet e tij të përfunduara mjeshtërisht (Gombrich, 1995, 495). Shkëputja nga tradita u la piktorëve të peisazhit të asaj kohe mundësitë për të qënë më ndryshe, të lirë të bëheshin poetë në pikturë dhe të kërkonin efektet dramatike e të prekshme (të mishëruara më së miri në veprat e Tërner-it), ose të kapeshin fort pas motiveve reale dhe ti trajtonin ato me mjeshtërinë artistike që zotëronin (sic ndodhte me Konstejbëll-in).

Bashkëkohës me këta piktorë anglezë ishte piktori romantik gjerman Fridrih (Caspar David Friedrich 1774-1840), peisazhet e të cilit transmetojnë frymën e poezisë lirike romantike të kohës. Pikturat e këtij autori, ndër më tipikët dhe përfaqësuesit e romantizmit, na kujtojnë disi frymën e pikturës kineze të peisazhit, e cila gjithashtu është shumë pranë përshkrimit poetic (Gombrich, 1995, 497).

Artistë të tjerë të kësaj periudhe ndoqën, disa rrugën e frymës romantike (e parapëlqyer dhe një lloj garancie suksesi për kohën), disa të tjerë u përpoqën më fort të zbulonin botën që shihet me sy, sesa të sajojnë gjëndje shpirtërore poetike ekzistenciale.

Por historia e artit e shek. XVIII-të dhe XIX-të nuk është historia e mjeshtërive më të suksesshëm e sidomos e atyre më të paguarit e asaj kohe. Ajo është më shumë historia e një grupi njerëzish të vetmuar, të cilët patën guximin dhe këmbënguljen të mendonin me kokën e tyre, të analizonin pa frikë e me sy kritik konvencionet e rrënjësura dhe t'i përmbysnin shumë nga ato, duke hapur kështu rrugë të reja për artin novator.

Delakrua (Eugene Delacroix 1798-1863) i përkiste kërrij grupi revolucionarësh të mëdhenj që nxori "vendi i revolucioneve", Franca. Që në fillimet e tija u cilësua si "rebel fanatik", sepse nuk i pranonte dot normat dhe kriteret e Akademisë, ndaj më 1832 udhëtoi për në Aftikën e veriut, Algjer dhe Marok, për të njohur e studiuar një realitet krejt ndryshe nga ai i Europës moderne të asaj kohe. Udhëtoi, jetoi dhe vizatoi disa vjet atje, duke eksploruar subjektet romantike të kësaj "bote të panjohur", i mahnitur nga ngjyrat e nderzura, simbolika dhe ornamentika e pasur arabe (Gombrich, 1995, 504).

Delakrua gjithashtu çmonte shumë një piktor francez të brezit të tij, për artin e të cilit mund të thuhet se formonte një urë bashkimi midis këtyre dy mënyrave të ndryshme

të trajtimit të natyrës, që përmendëm më sipër.

Ky piktor ishte Korot (Jean-Baptiste Camille Corot 1796-1875). Në fillim ai u tregua këmbëngulës për ta dhënë realitetin sa më besnikërisht, por e vërteta që donte të pasqyronte ishte disi më ndryshe. Vepra e tij dëshmon se ai përqëndrohej më pak me detajet dhe më shumë me formën e tonalitetet e përgjithshme të motivit, për të përcjellë kështu menjëherë atmosferën e peisazhit (Gombrich, 1995,507).

Me këto autorë të njohur, por dhe me shumë të tjerë, të cilët lëvronin pikturën e peisazhit, kjo gjininë e artit përherë e më tepër po bëhej dega më e rëndësishme e pikturës së shek. XIX-të në Europë.



(foto5)



(foto6)

Vepra e Eduard Lir me subjekt Shqipërinë

(si reflektuese e përvojave dhe drejtimeve më të suksesshme artistike të asaj kohe)

Udhëtimi i Eduard Lir në Shqipëri daton mes viteve 1848-1849. Kur vjen në Shqipëri, ai ishte një artist ilustrator si dhe një piktor i mirëformuar i zhanrit të peisazhit dhe jetonte me këtë profesion. Duke analizuar veprën e tij në përgjithsi, ai na shfaqet si një artist i qartë në pozicionimin apo fokusimin e kërkesës së tij të vazhdueshme dhe këmbëngulëse për të eksploruar territore gjeografike e situata egzotike, pak apo aspak të njohura për europianët, sic konsideroheshin për kohën territoret e jugut të Ballkanit; ato të Greqisë veriore, Shqipërisë e Maqedonisë.

Duke gjykuar mbi interesin e tij për të lëvizur, apo për t'u larguar, nga një qëndër e rëndësishme dhe e zhvilluar në të gjitha drejtimet, përfshi edhe ato kulturore artistike, sic qe Anglia moderne e shek. të XIX-të, drejt kulturash të tjera organike apo të "pacivilizuara", Lir na ngjason apo kujton shumë intelektualë apo artstë me shpirt aventure që ndërmorën të tilla nisma, sic mund të përmendim bashkëkombasin e tij, poetin dhe intelektualin e shquar Lord Bajron-in, me udhëtimet e tija të famshme në Itali, Greqi, Shqipëri apo dhe piktorin e famshëm romantik Delakrua, me "arratisjet" e tija në Algjer e Marok. Pra Lir është një artist eksperimentues, nga më të emancipuarit e kohës, që është përfshirë sinqerisht në drejtimin romantik, duke kërkuar dhe realizuar arratisjen nga normat dhe akademizmat, dhe duke i dhënë të drejtë përjetimeve të shpirtit të lirë. Vepra e tij romantike është krejtësisht e distancuar nga drejtimi tjetër, që ndiqej nga disa piktorë anglezë në atë kohë, ata "pararafaelianë".

Peisazhet e piktorit Eduard Lir na informojnë, por kryesisht na trasetojnë artistikisht, imazhe të shumë objekteve të kulturës sonë kombëtare. Disa litografi,

që paraqesin qytetet tona, me përzjerje tiparesh mesjetare dhe orientale së bashku, si Shkodrën, Durrësin, Krujën, Gjirokastrën, Beratin, kanë në qëndër kështjella mesjetare dhe lagje varoshe banesash e ura përrreth, ndërsa në të tjera, me pamje nga Vlora, Elbasani, Tirana, tipologjia është më e shtrirë dhe vizatohen ura, rrugë dhe shtëpi karakteristike. Gjëlberimi vecanërisht është i pranishëm si element kudo (Hudhri, 1987, 102).

Në vizatimin “ *Kruja – 1848*”, autori zhvillon një kompozim monumental me një shkallëzim ngjites, që fillon nga plani i parë me një figurë burri me veshje kombëtare të zonës, vazhdon me siluetin dinamik të disa pemëve të larta e banesave të mbështjella me gjëlberim, për t’u ngjitur me elementët e shkëmbinjve, rrugën gjarpëruese dhe lagjen karakteristike të përfshirë në dritë, poshtë shkëmbit gjigand, mbi të cilin ngrihet kështjella me kullën e vrojtimit, të gjitha këto në sfondin e një qielli të qetë (Hudhri, 1987, 102).



(foto7,8)



Po aq dinamike, janë edhe peisazhet në teknikën e litografisë, me subjekt: “*Akuadukti i Gjirokastrës*”, “*Perëndim në Himarë*” apo ai me akuarel “*Berati 1848*”. Ndërsa me një shtrirje horizontale kompozicionale dhe pafundësi planesh, që pasojnë njëra tjetrin deri sa humbin mes reve e horizontit të qiellit, janë ndërtuar disa peisazhe të tjera, të cilat na sjellin informacione të shumta dhe të detajuara te pasurisë së elementëve të peisazhit urban të kohës. Me vërtetësinë e artistit të vëmendshëm që punon direkt në natyrë, shohim të përshkruar përveçse mjeshtërisht, edhe realisht, kalatë me shtresëzimet e tyre arkitekturore të ndërtimve të hershe dhe të më vonshme mesjetare, banesat karakteristike dhe elementë të tjerë të shumtë të arkitekturës vernakolare të kohës si pazaret, urat me harqe poshtë kështjellave, ndërtesat e kultit, vecanërisht xhamitë me minaretë e tyre të holla e të gjata, bimësinë e shumëllojtë, selvitë e mocme e rrepët shekullorë. Kudo nuk mungon dhe pranina e figurave jetësore; ajo e njerëzve me veshjet karakteristike të kohës dhe e kafshëve të ngarkesës apo të udhëtimit. Të tillë janë peisazhet: “*Shkodër 1848*”- litografi; “*Ura e Bahcallëkut, Shkodër*”- akuarel; dy të tjerë “*Berati 1848*”- litografi ; “*Vlorë 1848*” me ngjyra vaji, si dhe “*Tirana 1848*”- litografi.

Por në gjithë krijimtarinë e tij, duke përfshirë edhe akuarelet, vizatimet apo tabllotë me ngjyra vaji që Lir krijoi më vonë, dy nga punimet që përmendëm më sipër, janë me

interes të vecantë për historinë e arkitekturës shqiptare; akuareli *"Ura e Bahcallëkut"* dhe litografia *"Akuadukti i Gjirokastrës"*. Në të parën kemi një dëshmi figurative për urën e gurtë mbi lumin Drin poshtë kalasë së Shkodrës. Vlera e peisazhit të Lir qëndron në paraqitjen e plotë të urës si një monument me vlera arkitektonike, e quajtur me të drejtë "veprër arti", pasi ajo paraqitet vizualisht, në këtë pikturë, për herë të parë dhe sot thuhet nuk gjendet asnjë gjurmë prej sajë. Ura është përshkruar si e rrallë në llojin e vet kohë më parë, që nga Marin Barleti në veprën e tij *"Rrethimi i Shkodrës"*. Lir përvëcse e vizaton, edhe e përshkruan në ditarin e tij të udhëtimit këtë urë me kalanë në sfond: *"Vizatova pa pushim gjatë gjithë ditës nga pika të ndryshme të anës jugore të kështjellës, prej nga pamja është fort imponante, si dhe urën më të vjetër mbi lum, e ndërtuar me harqe me masë dhe gjerësi të ndryshme. Ndofta pamja më madhështore e Shkodrës është nga shkëmbi në anën lindore të pazarit. Kështjella dhe malet sipër, qyteti poshtë tyre, lumi që gjarpëron nën urë dhe shkon tutje, të gjitha këto krijojnë një pamje të mrekullueshme"* (Hudhri, 1987, 103).

Janë dy punime të Lir që paraqesin urën mbi lumin Drin, këtë monument me rëndësi, nga i cili nuk kemi ndonjë dokumentim tjetër figurativ të mëparshëm. Më vonë, më 1863 austriaku Jozef Szekeley¹ do të fotografonte këtë peisazh, duke realizuar kështu ndë të parat fotografi të peisazhit shqiptar. Mediumi që përdor Szekeley, fotografia, e dokumenton me vërtetësi këtë pamje, dhe duke e krahasuar me dy pikturat e Lir,



(foto9)



(foto10)

vërejmë se ato janë mjaft të vërteta dhe të ngjashme me fotografinë, për sa i përket

¹ Sipas studiuesit Robert Elsie: "Dr. Josef Szeleky (1838-1901) u lind në Hungari, diplomohet për kimi dhe farmaci në Vjenë dhe doktorohet më 1862. Më 1863 Hahn kërkon nga Akademia e Shkencave e Vjenës rekomandim për një fotograf që do ta shoqëronte atë në ekspeditën e Ballkanit juglindor. Akademia i propozon Szeleky-n, i cili në atë kohë ishte 25 vjeç. Më 1867 J.Szeleky merr cmimin "Bronze Prize" në Eörd's Fair në Paris(ka mundësi për fotografitë nga Shqipëria), ndërsa më 1878 merr cmimin "Silver Medal" në Paris".

informacionit arkitekturor. Kjo na bën të besojmë se trajtimi i peisazheve, përvesce artistikisht, është bërë nga Lir me mjaft vërtetësi, gjithnjë mbrenda atmosferës romantike, e cila mbështjell në përgjithësi të gjithë subjektet e tij mbi Shqipërinë. Edhe në peisazhin tjetër "*Akuadukti i Gjirokastrës*" paraqitet me mjaft vërtetësi, ujësjellësi i famshëm i këtij qyteti, prej të cilit sot fatkeqësisht ruhen vetëm pak gjurmë nga kjo vepër madhështore arkitekturore, inxhinerike dhe hidrike, e ndërtuar në kohën e pashallëkut nga Ali Pasha i Janinës.

Eduard Lir ishte 36 vjec kur udhëtoj nëpër Shqipëri dhe realizoj veprat e tij me subjekte peisazhin shqiptar të kohës. Por udhëtimet e tija kishin filluar më heret, rreth dhjetë vjet më përpara, në vitin 1837 ai ndërmerr udhëtime e para, që do të vazhdonon për rreth 26 vjet me rradhë, duke jetuar dhe pikturuar nëpër Europë e Mesdhe (Itali, Greqi, Shqipëri, Egjipt, Siri, Palestinë) dhe në Indi e deri në Ceilon. Ndërsa për të pikturuar kishte filluar akoma më heret, që në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare (Hudhri, 2003, 104).

Lir u bë një ilustrator profesionist, por ishte njëkohësisht dhe një poet e shkrimtar, që shumë shpejt do të njihej në Angli për pikturat dhe shënimet e tija të udhëtimeve egzotike. Me gjithë informacionin e shumtë dhe të vërtetë që japin, peisazhet e Lir, janë në fund të fundit vepra arti, dhe si të tilla ato i përshkon një atmosferën idilike dhe një tis romantik, duke na transmetuar kështu dukshëm dhe qëndrimin apo preferencën e autorit si një artist në ndjekje të subjekteve ekzotike, dukuri kjo mjaft e përhapur për Europën e përparuar të asaj kohe. Peisazhet e Lir ndjehen se janë në vazhden e drejtimit romantik apo ekzotik, i njohur në historinë e artit të fillimshkullit të XIX-të dhe i përfaqësuar nga emra artistësh, të cilët i përmendëm më lart. Duket se Lir e njeh mirë zhanrin e peisazhit dhe autorët që e kanë lëvruar atë. Për nga ana e konceptimit, shumica e peisazheve të tij janë të menduar të jenë etyde perceptimesh dhe përjetimesh të marra direkt nga natyra, krejt të cliruara nga nevoja për të qënë skrupuloze, inventarizuese apo imituese mediokre të saj. Mjeti i përdorur nuk përpiqet asnjëherë të fshihet, përkundrazi deklarohet qartazi si xhest dhe testurë, karakteristike kjo për disa nga piktorët më të njohur romantikë apo dhe ata realistë të kohës, sidomos në punimet e tyre të karakterit të etydeve nga natyra, me teknikën e bojërave të ujit apo dhe të vajit. Si të tillë, me të cilët vepra e Lir ka përngjasime në lidhje me qasjen e trajtimit plastik të mediumit të përdorur, por dhe të ekspresionit apo impresionit të pamjes perceptive, mund të përmendim disa punime të vecanta të Cloud Lorain, Thomas Gainsborough, Fragonard, J.M.Ë.Turner, John Constable, Delacroix e deri Corot.

Megjithëse piktura e tij ka mjaft frymë romantike, ne lidhje me trajtimin plastik apo realizimin e efektit të thellësisë së planeve, Lir guxon dhe na prezanton një lloj përmbysje të skemës së mirënjohur të romantikëve mbi prespektivën tonale dhe koloristike. Trajtimi i planit të parë të pesazhit në pikturë, tradicionalisht bëhej duke e errësuar tonalisht dhe duke e ngrohur nga ana koloristike atë, kryesisht me përdorimin e ngjyrave të kafta apo të gjelbra të errëta, duke vazhduar më në thellësi me aplikimin e toneve më të celura dhe nuancave më të ftohta ngjyrore, me qëllim përfitim të iluzionit të thellësisë maksimale. Në shum peisazhe të Lir plani i parë i pikturës është më i "*neglizhuari*" apo më i çeluri si tonalitë dhe më i shuari si potencë ngjyrore. Megjithatë, kjo nuk e pengon aspak pikturën e tij të arrijë dhënien e efektit të thellësisë apo variacioneve, përkundrazi, e bën atë të jetë më e gjallë dhe emocionuese



(foto11)



(foto12)

me evidentimin e qëllimtë të disa pjesëve, për të cilat ndjehet se autori ka më shumë interes.

Në shumë pak punime, me ngjyra vaji kryesisht këto, ndjehet konceptimi tipik romantik apo idilik i atmosferës së peisazhit, i cili ngarkohet me informacion të inventarizimit disi të tepruar të detajeve apo thellësisë së pafund të planeve. Në këto punime, edhe trajtimi kromatik e tonal është bërë nga Lir duke ndjekur skemën

(foto13,14)



klasike apo romantike, me aplikimin e nuancave të ngjyrës kafe në të gjelbër të errët për planin e parë të tabllësë, për të vazhduar më në thellësi me ngjyra më të ftohta si temperatura dhe më të celura si tonalitetet. Ky ndryshim bëhet krejt evident po të krahasojmë dy punimet e tij të të njëjtit subjekt, *"Mali i Tomorrit"*, njëra e vitit 1848 në teknikën e ngjyrave të ujit, dhe tjetra e mëvonëshme në teknikën e ngjyrave të vajit.

Mesi i shekullit të XIX-të dhe *"Magjia"* e mediumit të Fotografisë shfaqet në Shqipëri

Trojet shqiptare dhe banorët e tyre, herë pas here përshkruheshin nga këta udhëtarë europianë të shumtë, piktorë, historianë, filologë, gjeografë, poetë e antropologë. Këta si eksplorues të apasionuar të kulturave ekzotike të pa përballura akoma me zhvillimet e shumta e të shpejta me të cilat po prezantohej Europa e asaj kohe, surprizoheshin e mahniteshin nga ky habitat sa i afërt gjeografikisht, po dhe aq i largët njëkohësisht për ta. Kur Ami Boue (1794-1881) më 1842-shin u jepte europianëve me *"La Turquie e d'Europe"*, përshkrimet e pamjeve të mahnitëshme të natyrës dhe të

tipareve të bukura të racës shqiptare, nuk i kish mundësitë që t'i ilustronte realisht ato². Me fillimin e epokës së fotografisë, do të niste ndërkohë zbulimi i plotë, apo më mirë të themi dokumentimi i vërtetë i Shqipërisë.

Brezi i shqiptarëve të sotëm janë mësuar që fotografët e dinastisë Marubi t'i quajnë vendas, por vetëm brezi i dytë, djemtë e Rrok Kodhelit, që trashëguan mbiemrin Marubi, si pasues të studios, janë shqiptarë. I pari i Marubëve ishte një italian nga Piacenza. Themeluesi, Pietro Marubbi (1834-1903), rreth njëzet vjet pas shpikjes së fotografisë (nga Ë.F.Talbot në Angli e Daguerri në Francë më 1839), i përndjekur në Itali si garibaldiist, vjen në Shqipëri e themelon në vitin 1856 në Shkodër të parën studio fotografike në vendin tonë e madje dhe në Ballkan.

"Qyteti kishte mir'prit' n'krah'hap një magjistar, qi ndezte flakë do pluhma dhe langje e mandej t'nepte në dorë një copë letër të trashë ku ishte pikrisht ti"-shkruanin kronikat e kohës për shfaqjen e Marubbit dhe të procesit të fotografimit³.

Prej këtij autoriteti të madh të fotografisë dhe prej *"dritëshkronjave"* të tij, të gjithë ne, por në veçanti historianët, kemi mundësi të trashëgojnë e të shqyrtojnë momente historike të Shqipërisë së kohës.

Fotografia më e hershme, dhe njëkohësisht e para për historinë e fotografisë shqiptare, mendohet se daton më 1858 dhe paraqet një figurë imponante burri, *"stolisur"* më veshje kombëtare e armë të kohës. Do të vazhdojë pas kësaj një prodhimtari e bollshme fiksimesh fotografike, që tregojnë sot për një botë të zhdukur mes lindjes e perëndimit, për forcimin e qytetarisë, për jetën fshatare, për luftën e lëvizjet kombëtare shqiptare apo dhe për depërtimin e modës së Parisit deri në këto zona të largëta ballkanase. Marubbi i parë dhe më vonë Keli, çiraku dhe djali që Pietro adoptoi, apo dhe Gega, i biri i Kelit, që është dhe brezi i tretë e i fundit i dinastisë së famshme Marubi, fotografuan për plot një shekull me radhë. Ata lanë trashëgimi një fond prej rreth 150.000 mijë negativësh, një pasuri e cmuar me vlera dokumentuese dhe artistike për ne sot.

Në subjektet e fotografisë Marubi nuk ka sesi të mungojë ajo e fotografimit të natyrës, të peisazhit të Shkodrës e trevave të tjera, rrethinave dhe malësisë. Këto foto datojnë filimisht që në vitet 1860-të e duke vazhduar më vonë. Mendohet që fotografitë e para me subjekt të mirëfilltë dokumentimin e peisazhit shqiptar janë disa fiksime të pamjeve nga qyteti shqiptar i Tivarit (i aneksuar pas Konferencës së Ambasadorëve të 1913-tës në Londër dhe sot i njohur si Bar-i i Malit të Zi). Fotografitë, realizuar nga Pietro Marubbi, nga një distancë mjaft e largët tregojnë një pamje të gjërë të Kalasë së vjetër të këtij qyteti, ku dokumentohen mjaft qartë shtresëzimet arkitektonike të ndërtimit të mureve rrethuese në stilin mesjetar, venecian e atë otoman të mëvonshëm. Gjithashtu është me mjaft interes informacioni mbi tipologjinë e ndërtesave të banimit brënda mureve të Kalasë si dhe të lagjeve jashtë, të varura poshtë sajë. Dallohet stili venecian i ndërtimit, që dominon në përgjithësi në të gjithë dregun dalmat, dhe miksimi i tij me atë oriental dhe tradicional vernakolar.

Po këtë qytet shqiptar e fotografon pas pak viteve, më 1863-shin, një tjetër i huaj fotograf, austriaku Jozef Szekely (1838-1901), i cili në vjeshtën e vitit 1863 ishte në shërbim të albanologut Hahn (Johan Georg fon Hahn 1811-1869), si pjesë e një ekspedite austro-hungareze në veri të Shqipërisë, në Mal të Zi, në Kosovë dhe në

² Sipas Robert Elsie/ citon Bajram Peçi në Gazeta Shqiptare.

³ "Njerz në Za e sende të kujdesshme", botim 2012, Fototeka Kombëtare" Marubi", Shkodër .

Maqedoni, duke qënë kështu ndër të parët që kanë fotografuar Ballkanin juglindor⁴.



(foto15)



(foto16)

Emrin e fotografit J.Szekely e përmëndëm dhe më sipër kur analizuam peisazhin e Lir të "Urës së Bahcallëkut" me kalanë e Shkodrës në sfond, punim i realizuar më 1848. Është ky fotograf që më 1863 do të fotografojë po këtë urë dhe kalanë, duke na lënë një dëshmi fotografike, mbase të vetmen të këtij monumenti arkitekturor që daton e ndërtuar në vitin 1768, në kohën e Pashallëkut të Shkodrës, gjatë sundimit të Mehmet Pashë Bushatit.

Që në vitin 1854 Hahn përshkruan se" mbi lumin Kir kalon një urë guri që të çon në Bahcallëk. Ura përvec harqeve kryesore ka dhe harqe më të vegjël në këmbët ndërmjetëse".

Pas mesit të shek. XIX-të, konkretisht pas viteve 1859 kur lumi i Drinit u kthye vrullshëm përsëri në shtratin e tij të vjetër, kjo urë, vepër e Bushatllinjve, u shkatërrua dalgadal. Me rrëzimin e kësaj ure, në vitet 1891-93 u ndërtua ura e re mbi lumin Drin. Kjo urë e re u bë me pesë harqe druri të mbështetura mbi kolona masive me mur guri (Shtylla, 1997, 105). Pamje të kësaj ure të e hasim të dokumentuar në një fotografi të realizuar nga Kel Marubi në fillim të viteve 1900. Edhe kjo urë është prishur me kohë dhe sot nuk kemi asgjë, përvec fotove të saj.

Kohëqëndrimi i austrohungarezit Jozef Szekely në Shqipëri dha ndër të parat shkrepje fotografike të peisazhit shqiptar. Janë mbi 50 foto të bëra në Shkodër, Tivar, Prizren, Ohër, Manastir dhe në luginat Drin e Vardar. Për kimistin e fotografin Jozef Szekely, Hahn shkruan: "...Szekely e përmbushi detyrën e tij me një zell të jashtëzakonshëm dhe bëri një sërë pamjesh, të cilat mund të vihen në një rang me gjërat më të bukura që ka mundur të realizojë arti i fotografisë"⁵.

Pietro Marubbi, (që më vonë u bë shqiptar duke u quajtur Pjetër Marubi), njihet kryesisht për dokumentimin e eventeve, ngjarjeve historike dhe figurave të njohura të kohës. Por falë këtij artist ne sot kemi të fiksuara dhe pamje urbane e peisazhe, ndonëse numri i këtyre fotove është më i pakët. Këto foto janë të një rëndësie të vecantë, pasi ato na informojnë për tipologjinë e nivelin e arkitekturës dhe evolucionin e peisazhit urban në kohë. Të tilla foto janë ato të Kalasë së Shkodrës me lagjet e banimit

⁴ Sipas Robert Elsie, / citon Bajram Peçi në Gazeta Shqiptare.

⁵ Sipas Robert Elsie: "Johann Georg von Hahn (1811-1869) është konsideruar si babai i studimeve për Shqipërinë" - citon Bajram Peçi në Gazeta Shqiptare.



(foto17)



(foto18)

poshtë saj, apo dhe ato brënda qytetit, psh *"Fushë Qela"*-1870; *"Lulishtja Popullore, apo Milet Bahcja në qëndër të qytetit"*-1875; *"Hoteli Ballkan në sheshin e Parrucës"*-1885 etj. Dallohet qartë një hapësirë urbane me tipare ballkanike orientale në bashkëjetesë me elementë arkitekturor disi më modern, që fillojnë të shfaqen nga fundi i shek. XIX-të.



(foto19)



(foto20)

Fotografi i brezit të dytë, Mikel Kodheli (1870-1940), ndihmësi dhe nxënësi i Pjetrit, do të trashëgonte studion dhe mbiemrin Marubi pas vdekjes së mjeshtrit më 1903, duke u njohur si Kel Marubi. Ai do të eksploronte shumë më tepër fotografimin e pesazhit. Njëkohësisht, edhe përdorimi nga ana e tij e aparateve më të avancuara teknikisht dhe më praktike, krijojnë më lehtësi për fotografimin në natyrë. Keli do të fotografonte peisazhe që datojnë kryesisht në fundin e shek. XIX-të dhe fillimin e atij të XX-të, sic janë ato me pamje të; *"Bashkisë Belvedije"*-1881; *"Qyteti i Shkodrës"*-1900; *"Dogana në brigjet e lumit Buna"*-1900-1905; *"Pamje nga Kruja"*-1900-1905 etj.



(foto21)



(foto22)

Shekulli i ardhshëm, ai i XX-të, do të jetë koha kur Shqipëria dhe shqiptarët, historia dhe politika, natyra dhe peisazhi, do të jenë interesi i shumë eksploruesve; etnologve, gjeografve, historianve, muzikologve, piktorve, fotografve etj. të huaj, por sidomos të atyre vendas.

Konkluzion

Veprat, sa shkencore po aq dhe artistike, të gjithë këtyrë autorëve që përmëndëm më sipër, shpesh plotësojnë, përkojnë e ndërliohen mes tyre, dhe kështu na ofrojnë dëshmi, vërtetojnë prani, ngjarje, caste, vende e gjeografi, duke ruajtur materialisht kujtesën e realitetit të asaj kohe deri te ne sot.

Përsëri sot, Shqipëria është në interesat europiane dhe më gjërë, por tashmë këto janë politika globale gjithëpërfshirëse, sa politike dhe ekonomike aq edhe kulturore, që synojnë integrimin tonë lokal dhe kozmopolit në familjen e përbashkët.

Referenca

- Pierluigi De Vecchi, Elda Cerchiari, "I tempi dell'arte", RCS Libri S.f.A. Milano, 1999;
E.H. Gombrich, "The Story of Art" Phaidon Press Limited, 1995.
Edward Lear, "Journals of a Landscape Painter in Albania", London 1851.
Eduard Gibon, "The History of the Fall the Roman Empire", London: Strahan & Cadell 1787.
Ferid Hudhri, "Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e piktorëve të huaj", SH.B.8 Nëntori, Tiranë 1987.
Ferid Hudhri, "Albania Through Art", Onufri Publishing House, Tirana, 2003.
Valter Shtylla, "Rrugët dhe Urat e vjetra në Shqipëri", Botimet Toena, Tiranë, 1997.
Robert Elsie, citon Bajram Peci në "Gazeta Shqiptare".
Fototeka Kombëtare "Marubi", Shkodër, botim "Njerz në Za e sende të kujdesshme" 2012.

Hartimi dhe ndryshimi i bazës ligjore në sektorin farmaceutik në Kosovë që nga periudha e pasluftës

Arbenita Pajaziti

Ministria e Shëndetësisë, Prishtinë, Kosovë

Melisa Troshani

Novartis Pharma Services Inc., Zyra e Përfaqësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakti

Hartimi dhe implementimi i normatives ligjore është bazë për funksionimin e çdo shoqërie. Çdo shoqëri përcakton ligje dhe rregulla mbi të cilat do të funksionojnë institucionet e atij vendi. Pas luftës së vitit 1999, Kosova ka trashëguar një sistem te rrënuar shëndetësor. Është dashur që nga fillimi të hartohet baza ligjore dhe në këtë mënyrë të ndërtohen institucionet e vendit. Në këtë prezantim është studiuar ne mënyrë kronologjike ndërtimi i bazës ligjore shëndetësore dhe farmaceutike në Kosovë që nga periudha e pasluftës deri në ditët e sotme si dhe sfidat në harmonizimin e legjislacionit me BE-në.

Hyrje

Bashkimi Europian zhvillon politika shëndetësore përmes të cilave synon të përmirësojë dhe mbrojë shëndetin e popullatës si dhe të modernizojë sistemin shëndetësor.

Vendet të ndryshme në botë kanë te organizuar në mënyra të ndryshme sistemin shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën. Edhe në kuadër të shteteve të BE-së, sistemi shëndetësor është i organizuar në mënyra te ndryshme, mirëpo ekzistojnë disa çështje të caktuara të cilat tejkalojnë interesat individuale dhe bëhen preokupim i përbashkët për të gjitha shtetet anëtare te BE-së si:

- sëmundjet ngjitesë;
- sëmundjet e shkaktuara nga duhanpirja;
- kequshqyerja;
- abuzimi me alkool, substanca narkotike.

Gjithashtu ,tregu i përbashkët imponon edhe përgjegjësi te përbashkëta lidhur me:

- Sigurimin e barnave cilësore,
- Sigurimin e cilësisë të gjakut dhe produkteve te gjakut,
- Indeve dhe organeve të cilat përdoren gjatë transplantimit.

Kosova menjëherë pas luftës me ndihmën e organizatave të ndryshme ndërkombëtare ka hartuar legjislacionin ne mënyrë emergjente për të vënë rend dhe rregull në sektorin farmaceutik ndërsa këto vitet e fundit, pas shpalljes se pavarësisë me 2008, po punon për te harmonizuar dhe përafuar legjislacionin me BE-në.

Hartimi i rregulloreve të para

Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është themeluar menjëherë pas

luftës, në vitin 2000, përmes Rregullores së UNMIK-ut 2000/10. Ky departament, krahas detyrave dhe detyrimeve të tjera të sektorit shëndetësor ka pasur edhe detyrat si në vijim:

- të rregullojë dhe të mbikëqyrë pajisjet dhe furnizimet farmaceutike dhe mjekësore, si dhe materialin radiokativ për përdorim mjekësor;
- të zhvillojë dhe implementojë sistemin e sigurimeve shëndetësore;
- të dizenojë dhe të implementojë një sistem të informimit shëndetësor.

Për te vënë rend dhe rregull në sektorin farmaceutik, i cili sipas raportit të ekspertëve, menjëherë pas luftës ishte mbushur me donacione dhe importe te pakontrolluara, Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka themeluar Agjensionin për Kontrollin e Barnave përmes udhëzimit administrativ 2000/7.

Kontrollimi i Importit të Barnave

Me themelimin e Agjensionit të Kosovës për Kontrollin e Barnave, udhëzimi i parë administrativ është hartuar për të rregulluar importin e barnave UA 14/2000 në Prill 2000.

Sipas këtij udhëzimi:

1. Të gjitha agjencionet, duke përfshirë këtu edhe kompanitë private dhe agjencionet qeveritare dhe jo-qeveritare, të cilat dëshirojnë të importojnë farmaceutikë dhe mallra medicinale në Kosovë duhet që para importit të marrin miratimin e Agjencionit për Kontrollim të Barnave të Kosovës (AKBK) që është në kuadër të Departamentit të Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale;
2. Shitësit e autorizuar komercialë duhet që gjatë plotësimit të kërkesave që vijnë, të kenë lejen për import të lëshuar nga AKBK-ja, AKBK ka të drejtë të marrë pagesë për lëshimin e këtyre lejeve;
3. Lejet për import nuk do të nevojiten për barnat e dhuruara nëse këto donacione janë lejuar paraprakisht nga AKBK-ja dhe nëse ato janë në përputhje me Udhëzimet Ndëragjenciare për Donacione të Barnave;
4. Kërkesa e shitësve komercialë për lejen e importit duhet të përmbajë:
 - a) Listën e prodhimeve farmaceutike që dëshiron të importojë;
 - b) Një certifikatë për secilin produkt për të vërtetuar kualitetin dhe sigurinë për përdorimin e atij produktit (p.sh. një certifikatë në përputhje me Skemën e Certifikimit për Produktet Farmaceutike që Qarkullojnë në Tregun Ndërkombëtar të hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetit) duke përfshirë këtu edhe autorizimin për marketing dhe përputhjen me Praktikën e Prodhimit të Mirë (PPM) në shtetet eksportuese;
5. Importi i produkteve të pakryera dhe produkteve me sasi më të mëdha do të lejohet vetëm atëherë kur agjencioni që i importon ka leje valide për prodhimin e produkteve farmaceutike dhe kur këto produkte janë të shoqëruara me certifikatat që vërtetojnë kualitetin e produktit si dhe përputhjen e atij produkti me PPM;
6. Nuk do të lejohet importi i barnave të cilat gjenden në Listën e Përgjithshme të Produkteve Përdorimi dheose Shitja e të Cilave. Është e Ndaluar, e Ndalur, Rreptësisht e Kufizuar ose e Pamiruar nga Qeveritë e hartuar nga Kombet e Bashkuara;
7. Afati i përdorimit të farmaceutikëve duhet të ketë kohëzgjatje prej së paku një vit nga data e pranimit. Afatet e përdorimit më të shkurtra mund të pranohen për raste të veçanta;

8. AKBK-ja ka të drejtë të kontrollojë importuesit e autorizuar në mënyrë që të sigurohet se ata po punojnë në pajtim me kërkesat e lartpërmendura, duke përfshirë edhe kontrollimin e të dhënave të importit, certifikatave të lejes së produktit, certifikatave të analizave dhe vërtetimin për autorizim/deklarim të eksportit;
9. AKBK-ja do të lëshojë një listë të produkteve të lejuara farmaceutike për import. Kjo listë dhe kopjet e lejeve të miratuara për import do të ju shpërndahen doganave për përdorim në kontrollin doganor nëpër kufij;
10. Dogana do të kontrollojë se a përpunet malli i dërguar për import me listën dhe lejet e lartpërmendura. Shënimet dhe faturat për doganë duhet të përmbajnë:
 - a) Emrin e barnave,
 - b) Sasinë e secilës nga barnat që po eksportohet/importohet,
 - c) Emrin dhe adresën e eksportuesit/importuesit dhe, kur është e mundur, porositesit të mallit të dërguar,
 - d) Afati i mbetur i përdorimit të barnave,
11. Dogana ka të drejtë që të kontrollojë edhe fizikisht mallin e dërguar përfshirë këtu kontrollimin e kontejnerëve dhe pakove, etiketave dhe shtesave të paketimeve si dhe marrjen e mostrave nga malli për t'i dërguar ato në analizë;
12. Leja për import mund të anulohet nëse nuk përmbushet cilado nga kërkesat e lartpërmendura.

Rregullorja e UNMIKUT 2000/52

Pas këtij Udhëzimi Administrativ, është aprovuar rregullorja e UNMIK-ut 2000/52 ku për herë të parë janë dhënë përkufizimet dhe është vendosur baza ligjore mbi të cilën pastaj janë hartuar udhëzime të tjera administrative. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/52 ka qënë rregullorja bazë mbi të cilën ka funksionuar sektori farmaceutik. Ajo ka shërbyer edhe si bazë për ligjin për produkte dhe pajisje medicinale i cili është aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2003.

Rregullorja e UNMIK-ut për herë të parë ka paraparë kushtet për licencimin e qarkulluesve farmaceutik me shumice, qarkulluesve farmaceutik me pakice, si dhe licencimin e importit.

Në kuadër të Udhëzimi Administrativ 28/2000 janë bashkangjitur 5 shtojca të cilat kanë dhënë informata për procedurat si ne vijim:

1. Licenca për punë si qarkullues farmaceutik me shumicë;
2. Licenca për importimin e produkteve farmaceutike duke përfshirë edhe produkte e pafinalizuara;
3. Licenca për importin e barërave narkotike dhe substancave psikotrope;
4. Licenca për prodhimin e produkteve farmaceutike;
5. Licenca për importimin e lëndës së parë për përdorim në prodhimin e produkteve farmaceutike;
6. Licenca për punë si qarkullues farmaceutik me pakicë;
7. farmacisti përgjegjës;
8. Kundërvajtjet dhe dënimet;
9. Tarifa.

Zhvillimi i bazës ligjore

Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale është ndër të parat ligje të sponsorizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji për Produkte Medicinale është aprovuar nga ana e Kuvendi te Kosovës para Ligjit për Shëndetësi. Ligji për Produkte Medicinale është amenduar tre here nga Kuvendi i Kosovës

- 2003_26 Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale
- 2010-188 Produktet dhe Pajisjet Mjekësore plotësim ndryshim
- 2013_04 – L- 190 Ligji për Produkte dhe Paisje Medicinale

Në mënyrë kronologjike, më poshtë gjenden të përshkruara Udhëzimet Administrative te cilat kanë plotësuar ligjin për produkte medicinale.2003

- 04-2003 Udhëzim administrativ: Mbi Liçencimin e Farmacive në Kosovë;
- 09-2003 Udhëzimi administrativ: mbi Autorizim Marketingu i Përkohshëm;2004
- 19-2004 Udhëzim Administrativ: Mbi themelimin e Komisionit të Kosovës për Evaluimin e Produkteve Medicinale dhe Pajisjeve Mjekësore;
- 25-2004 Udhëzim Administrativ: Mbi Obligimin e Vendorsjes së Banderolave në Produktet Farmaceutike;
- 32-2004 Udhëzim Administrativ: Për Përcaktimin e Listës së Produkteve Medicinale dhe Pajisjeve Medicinale për të cilat Nevojitet Licenca për Import;2005
- 05-2005 Udhëzimi Administrativ: Mbi Autorizim Marketingun e Produkteve Medicinale ne Kosove; 2006
- 07-2006 Udhëzim Administrativ: Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë (Barnatoret);
- 08-2006 Udhëzim Administrativ: Farmakovigjilenca e Produkteve Medicinale për Përdorim Human të Plasuar në Kosovë;
- 09-2006 Udhëzim Administrativ: Mbi liçencimin e Laboratoreve Galenike dhe Produkteve Galenike në RKS; 2008
- 04-2008 Udhëzim Administrativ: Mbi Autorizim Marketingun e Produkteve Medicinale ne Kosove; 2009
- 08-2009 Udhëzim Administrativ: Inspektoriati Shëndetësor për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- 09-2009 Udhëzim Administrativ: Për Vendorsjën e Banderolave në Produktet Medicinale;
- 11-2009 Udhëzimi Administrativ: Mbi Kontrollin e Kualitetit të Produkteve Medicinale të Plasuar në Kosovë; 2010
- 08-2010 Udhëzim Administrativ: Vendorsja e Banderolave në Produktet Medicinale; 2011
- 03-2011 Udhëzimi Administrativ: Njohja nga ana e Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale te Autorizimeve te Marketingut për produktet medicinale për përdorim njerëzor te lëshuara nga Instituti Federal Gjerman për medikamente dhe pajisje medicinale; 2013
- 05-2013 Udhëzim Administrativ: Për Licencimin e Prodhuesve të Pajisjeve Medicinale në RKS;
- 12-2013 Udhëzim Administrativ: Vendorsja e Banderollave në Produktet Medicinale;
- 13-2013 Udhëzim Administrativ: Qarkulluesit me Shumicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale;

- 14-2013 Udhëzim Administrativ: Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- 17-2013 Udhëzim Administrativ: Mbi Autorizim të marketingut për plasimin e produkteve medicinale në Republikën e Kosovës;
- 18-2013 Udhëzim Administrativ: Për Thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin e produkteve medicinale të cilat nuk janë paralele të rregjistruara në Republikën e Kosovës;
- 20-2013 Udhëzim Administrativ: Plotësim-ndryshim i UA nr. 17-2013 Mbi Autorizim të Marketingut për Plasimin e Produkteve Medicinale në Republikën e Kosovës 2014
- Udhëzim Administrativ 01-2014. Për Tarifat e Shërbimeve të Ofruara në AKPM
- Udhëzimi Administrativ- Nr 02-2014 Për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruar (2)
- Udhëzimi Administrativ 03-2014 Për kontrollin e cilësisë së produkteve dhe pajisjeve medicinale të plasuar në Republikën e Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ 06-2014. Për përcaktimin e listës së produkteve medicinale, pajisjeve medicinale dhe produktet e linjës kufitare, për të cilat nevojitet autorizimi për import apo eksport;
- Udhëzimi Administrativ 07-2014 Njohja unilaterale e Autorizimit për Marketing të produkteve medicinale të aprovuara nga Agjencia Rregullative e Kujdesit Shëndetësor në Britani të Madhe 2015
- Udhëzim Administrativ 01-2015-Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale;
- Udhëzim Administrativ 03-2015 Labororet Galenike;
- Udhëzim Administrativ 04-2015 Komisioni për Vlerësimin e Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale;
- Udhëzim Administrativ 05-2015 Bordi i Ankesave;
- Udhëzim Administrativ – nr. 07/2015 – Mbi kërkesat e praktikës së mirë të prodhimit- lëshimit të autorizim prodhimit dhe certifikatës për praktikën e mirë të prodhimit për produkte medicinale;
- Udhëzim Administrativ 11-2015
- Qarkulluesit me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale; 2016
- Udhëzim Administrativ 04-2016
- Tarifat e shërbimeve të ofruara në AKPPM;

Ligji per sigurimet shëndetësore

Themelimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore pritet të reformojë në terësi sistemin shëndetësor në Kosovë. Edhe në sektorin farmaceutik priten ndryshime, përse i përket mënyrës se furnizimit të institucioneve shëndetësore me barna dhe material shpenzues medicinal. Po ashtu, ndryshime do te ketë edhe në sektorin privat kur pritet të fillojë rimbuzimi i barnave përmes kontraktimit të barnatoreve private të cilat do të ofrojnë këtë shërbim për pacientët.

Përfundime

Sikurse mund të shihet nga rezultatet e prezantuara, ligji për produkte dhe pajisje medicinale është amenduar tre herë duke bërë ndryshime të duhura në mënyrë që të harmonizohet me legjislacionin e BE-së. Edhe udhëzimet administrative janë hartuar dhe ndryshuar sipas nevojës për të plotësuar ndryshimet që ka kaluar ligji gjatë amendimit.

Problem i pazgjidhur ende mbetet kontrollimi i çmimeve të barnave në Kosovë dhe përcaktimi i marzheve të fitimit për secilin nivel.

Të gjithë aktorët, institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare duhet të punojnë së bashku që reforma në shëndetësi me rastin e implementimit të skemës së sigurimeve shëndetësore të ketë sukses. Rimbursimi i barnave është sfida e radhës me të cilën do të ballafaqohen institucionet publike si dhe sektori privat farmaceutik në Kosovë.

Referencat

https://ec.europa.eu/health/strategy/policy_en

<https://ec.europa.eu/health>

Harmonizimi i legjislacionit me BE-ne, sfide dhe domosdoshmëri Arbenita Pajaziti Prill 2010 Prishtine 1st Kosova Pharmaceutical Congress with International Participation.

Vleresimi i Sektorit Farmaceutik ne Kosove Lutfi Mulaku; Arbenita Pajaziti; Lirim Azizi - International forum - University for Business and Technology – Pristine 2005.

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_10.htm

<http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Nr.7-2000.AlbEngSer.pdf>

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2000regs/RA2000_52.htm

http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2003_26-Pajisjet-Medicinale.pdf

<http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2010-188-Produktet-dhe-Pajisjet-Mjekesore-plotesim-ndryshim.pdf>

http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2014_-04L-249-Ligji-p%C3%ABr-Sigurime-Sh%C3%ABndet%C3%ABsore.pdf

http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2013-_04-L-190-Ligji-p%C3%ABr-produkte-dhe-pajisje-medicinale.pdf

Stresi në punë dhe burnouti tek mësuesit në shkollat 9-vjeçare

Msc. Iris Mitro

Msc. Ergysejda Bylyshi (Caushi)
Drejtorja Arsimore Rajonale Vlorë

Abstrakt

Mësimdhënia në kontekstin organizativ, në stafin mësimor të shkollës i cili përbëhet nga individë të ndryshëm me shkallë të ndryshme të aftësive profesionale dhe nivele kualifikimesh, me cilësi personaliteti të ndryshme, kërkon një ndërveprim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Mjedisi i shkollës është në sfida të vazhdueshme, kërkon që mësuesit të jenë më të përgatitur, më tepër të përfshirë emocionalisht me nxënësin, për mirëqënien fizike e mendore të tij. Në realitetin shqiptar shkollat janë subjekte të ndryshimeve të menjëhershme dhe të vazhdueshme në aspektin e integritit të teknologjive, në aspektin organizativ, në standardet profesionale, në ndryshimet e kurrikulave, sistemit arsimor etj. Së fundmi në politikat e reja arsimore zë një vend të rëndësishëm edhe procesi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme. Te gjitha këto përbëjnë një sfidë për mësuesit e sotëm për të ndjekur jo vetëm hapat e këtyre ndryshimeve por edhe për t'u përshtatur në këtë sistem.

Duke krijuar tablonë e vështirësive dhe problematikave që procesi i gjithëpërfshirjes ka dhe se si këto vështirësi ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e mësuesit, i cili nuk është më një problem vetëm për mësuesin si individ por edhe për nxënësit, shkollën, profesionin, mësimdhënien dhe sistemin e edukimit, vendosë m të trajtojmë në këtë punim:

“Stresi në punë dhe Burnout-i tek mësuesit në shkollat 9-vjeçare”

Qëllimi i këtij studimi është që të përshkruajë prezencën e nivelit të stresit dhe burnoutit tek mësuesit që punojnë në shkollat 9-vjeçare. Gjithashtu synon të vërtetojë lidhjen mes dy variablave të studimit, përkatësisht stresit dhe burnoutit tek mësuesit.

Metodologjia e këtij studimi është cilësore dhe sasiore. Metoda e kërkimit është e natyrës korrelacionale, e cila synon realizimin e një analize statistikore, për përpunimin e të dhënave. Mbledhja e të dhënave u realizua përmes vëzhgimeve dhe pyetësorëve: (inventari për matjen e stresit në punë, Inventari i Maslach për matjen e Burnoutit), të cilët u realizuan në 3 shkolla të qytetit të Vlorës.

Ky studim evidentoi se ekziston një lidhje mes nivelit të lartë të stresit në punë dhe shfaqjes së burnout-it tek mësuesit që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta. Koeficienti i korrelacionit doli pozitiv. Ç'ka do të thotë se lidhja mes tyre është e fortë dhe me rritjen e njëres, shfaqet dhe rritet edhe tjetra.

Fjalë kyçe: stres, burn-out, ezaurim emocional, depersonalizim, arritje personale.

Hyrje

Mësimdhënia tradicionalisht është konsideruar si një nga profesionet stresuese. Mësuesit përballen me stresorë të shumtë si: problemet në sjellje të nxënësve, ndërveprimi me prindër agresivë, mbingarkësë në punë, ruajtja e disiplinës, mungesa e stimuljeve etj.

Stresi në punë është domethënës për mësuesit që në momentin që ai prek, jo vetëm

mësuesit, por mund të ketë ndikim edhe tek nxënësit. Stresi tek mësuesit është pra, një problem për mësuesin si individ, nxënësit, shkollën, profesionin, mësuesin dhe sistemin e edukimit.

Një përjetim i vazhdueshëm i stresit, mbi të cilin nuk veprohet, apo nuk zbatohen mekanizmat e përshtatjes dhe të menaxhimit shpesh mund të rezultojë edhe me shfaqjen e burnoutit dhe me probleme psikologjike.

I.1 Stresi dhe puna : Efektet individuale dhe organizative

Individi mund t'i japi një peshë të ndryshme të njëjtit stresor. Vlerësimi i kësaj mbetet kështu e lidhur me faktorët personal: qëndrimi, mënyra e të menduarit dhe të sjellurit në situata të caktuara, eksperiencat e shkuara, mendimet, aspiratat për të ardhmen, aftësitë e fituara, karakteristikat fizike dhe faktorët mjedisorë.

Por në ç'mënyrë aktiviteti i punës është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me stresin ?

Duke e rimarrë përkufizimin e shprehur nga Jayaratne, Tripodi dhe Chess (1983) " Stresi i punës" manifestohet kur " kërkesat e jashtme të përcaktuara nga individi paraqiten si më të tepruara sesa është kapaciteti i tij për t'iu përgjigjur" ose kur " individi percepton një konflikt krahasuar me vlerat dhe nevojat" në këto raste mjedisi i punës shndërrohet në burim stresi për subjektin që është në kontakt të drejtpërdrejtë me të.

Një nga modelet që shpjegon më së miri këtë tematikë është ai i propozuar nga Cooper (1998), që përcakton 5 burime të stresit në punë:

- Burimet e brendshme të punës
- Roli në punë
- Zhvillimi i karrieres
- Marrëdhëniet e punës
- Struktura dhe klima e punës

Duke parë kushtet e ndryshme që mund të ndikojnë në shfaqjen e stresit, nëse individi nuk përshtat strategji të përshtatjes ndaj kushteve të tilla, mund të gjendet në një situatë të mospërshtatjes në brendësi të vendit të punës.

I.2 Fenomeni i Burnout-it: Aspekte teorike

Për ata që punojnë në profesionet e ndihmës dhe në kontakt të vazhdueshëm me njerëzit, burnout-i shihet si një strategji e papërshtatshme për t'iu përgjigjur tensioneve të akumuluar në kontekstin e punës, që manifestohet me përgjigje të papërshtatshme kundrejt vetes, të tjerëve dhe vetë roleve profesionale për të evituar dëmet që mund të derivojnë nga nevojat e vazhdueshme të personave me të cilët punohet dhe të cilëve u ofrohet mbështetje (Del Rio 1990).

I pari ndër studiuesit që është përpjekur të japi një përcaktim të burnoutit ka qenë Freudenberg (1974) që përdori këtë term në mjedisin sportiv për të treguar nivelin e ulët të performancës së sportistit që nuk do të jetë më në gjendje për të rekuperuar performancën fillestare. Kërkimet e mëvonshme e kanë përshtatur termin në mjedisin profesional, duke e asociuar në mënyrë të vecantë me profesionet sociale- sanitare, për ta shtrirë më tej në të gjitha profesionet e ndihmës, domethënë në ato mjedise ku

është qëndror raporti me individin /klientin.

Merita për thellimin e këtij koncepti i shkon Maslach në 1982 e cila grumbulloi një seri historish, dëshmish të punonjësve që po përballëshin me sindromën burnout, duke evidentuar aspektet e përbashkëta dhe duke shkruar me tej librin e saj " Burnouti. Kostoja e ndihmës së të tjerëve".. Modeli i punuar nga Maslach , përfaqësonte sindromën e Burnoutit në 3 dimensione :

1- Ezaurimi emocional: Manifestohet me ndjesinë e të paturit " të djegura" energjitë e veta psikologjike, me një rënie të dukshme të burimeve emocionale, që subjekti nuk arrin t'i rivendosë më. Kjo i detyrohet një kontakti të stërgjatur me emocione stresuese që ndikojnë negativisht në mirëqënien fizike.

2- Depersonalizimi- Mund të shihet si një strategji mbrojtje, që manifestohet me indiferentizëm , cinizëm ndaj emocioneve apo nevojave të të tjerëve, për të evituar ndjesinë e kërcënimit të perceptuar në raportin me klientin. Punonjësi do të tentojë të sillt në mënyrë të ftohtë dhe të shkëputur nga vetë puna, duke kërkuar një përfshirje sa më të vogël dhe braktisje të entuziazmit fillestar.

3- Reduktimi i realizimit personal- Punonjësi do të tentojë të ndihet i padobishëm në zhvillimin e aktivitetit, do të ketë një rënie të besimit në mundësinë për të zhvilluar në mënyrë efikase punën e tij dhe në mënyrë progresive do të tentojë të zhvillojë një ndjenjë të pakënaqësisë , ndjesi mospasë, rënie të vetëvlerësimit , kundrejt aftësive dhe kapacitetit vetjak, duke u ndjerë i paaftë për të ndihmuar të tjerët.

I.3 Burnout-i tek mësuesit

Peracchi(1992) supozon se profesioni i mësuesit është në themel të marrëdhënies së mësues-nxënës, ku finalizimi është mësimdhënia apo rritja personale dhe intelektuale e subjektit, është për t'u theksuar se mësuesit ashtu si edhe profesionet e tjera të ndihmës janë " në një rrezik të lartë për shfaqjen e burnout-it". Ashtu si për të gjitha kategoritë e tjera profesionale edhe në mjediset e shkollës , shfaqja e burnout-it është e influencuar nga ndërveprimet e e variablave psikologjik dhe më konkretisht sipas analizës së Rosstai dhe Magro (1999), nga marrëdhënia që mësuesit vendosin me nxënësit, me kolegët dhe dimensionin fizik e psikologjik i mjedisit të punës është e qartë se këta faktorë siç edhe e supozojnë autorët janë aktive në raportin që mësuesi ka në situata të caktuara dhe në shkallën e caktuar (Rossat & Magro 1999) .

Metodologjia

Kërkimi shkencor i përdorur është një kërkim sasior i natyrës korrelacionale, pra synon të masë marrëdhënien mes variablave të studimit, nëse kanë lidhje mes tyre e nëse kanë , sa e fortë është ajo. Në këtë studim, variabli i pavarur është stresi në punë (pikëzimi i stresit), variablat e varur janë: 1- Ezaurimi emocional, 2- Depersonalizimi, 3- Arritja personale (Burnout-i).

Instrumentet e kërkimit

Instrumentet e kërkimit të përdorura, janë : inventari për matjen e stresit në punë, i cili përbëhet nga 42 pohime/deklarata dhe Inventari i Maslach për matjen e Burnoutit, i cili përbëhet nga 22 pohime, është i shkallës Likert i cili synon të masi shpeshësinë e veprimeve ,ndjenjave të caktuara (Kurrë, Rrallë, Ndonjëhere, Shpesh, Gjithmone).

MBI e përkrahet Burnoutin si një sindromë 3 dimensionale që konkretisht janë: 1. Ezaurimi Emocional, 2. Depersonalizimi, dhe 3. Reduktimi i arritjes personale. Ky version u kërkon të intervistuarve të përgjigjen për frekuencën (shpeshherë, kurrë, cdo ditë) dhe për shpeshësinë.

Administrimi i pyetësorëve: Inventarët ishin me vetëadministrim.

Hipoteza kryesore e studimit

“Niveli i lartë i stresit ndikon në shfaqjen e Burnoutit tek mësuesit që punojnë në shkollat 9-vjeçare”

Hipoteza të tjera të studimit:

- 1- Mësuesit e C. L përjetojnë një nivel më të lartë stresi krahasuar me ata të C.U
- 2- Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë shfaqin gjithashtu një nivel më të lartë të ezaurimit emocional (burnouti-it) krahasuar me mësuesit të cilët kanë një nivel më të ulët të stresit në punë.
- 3- Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë shfaqin gjithashtu një nivel më të lartë të depersonalizimit (burnouti-it) krahasuar me mësuesit të cilët kanë një nivel më të ulët të stresit në punë.
- 4- Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë shfaqin gjithashtu një nivel më të lartë të reduktimit të arritjes personale (burnouti-it) krahasuar me mësuesit të cilët kanë një nivel më të ulët të stresit në punë.

Kampionimi : Kampioni që kemi zgjedhur përbehet nga tre shkolla 9-vjeçare të qytetit. Shkollat e përfshira në studim janë “Rilindja”, “Avni Rustemi”, “Jani Minga”. Përzgjedhja e këtij kampioni është bërë në mënyrë rastësore. Në secilën shkollë pyetësori u realizua me mësues të ciklit të lartë dhe të ciklit të ulët. Përzgjedhja e mësuesve u bë në mënyrë rastësore. Në total kampioni përbëhet nga 72 mësues. **Perpunimi i të dhënave** është realizuar përmes programit kompjuterik të perpunimit të të dhënave SPSS 16 (Statistical Package for Social Scientists).

Konkluzione

Qëllimi i këtij studimi ishte që të vërtetonte lidhjen mes 2 variablave të studimit, përkatësisht stresit dhe burnoutit tek mësuesit.

Për të realizuar qëllimin e studimit, u ndërmorr një kërkim sasior, jo-eksperimental. Variabli i pavarur ishte stresi në punë tek mësuesit dhe variabli i varur ishte burnout-i tek mësuesit. Pyetësori u realizua me mësues të 3 shkollave 9-vjeçare të qytetit. Në pyetësor u përfshinë edhe pyetje që synonin grumbullimin e të dhënave demografike për variablat.

Tabela .1. Të dhëna përshkruese mbi karakteristikat e mësuesve të përfshirë në studim.

Moshë			
		Frekuenca	Perqindja
Alternativat	26-30 vjec	3	4.1
	31-35 vjec	22	29.7
	36-40 vjec	14	18.9
	41-45 vjec	17	23.0

	46-50 vjec	6	8.1
	51-55 vjec	4	5.4
	56-60 vjec	3	4.1
	61-65 vjec	3	4.1
	Total	72	97.3
Missing System		2	2.7
Total		74	100.0
Vjetërsia në arsim			
		Frekuenca	Perqindja
Alternativat	3 vjet	5	6.8
	5 vjet	8	10.8
	10 vjet	30	40.5
	15 vjet	14	18.9
	20 vjet	5	6.8
	25 vjet	3	4.1
	30 vjet	3	4.1
	35 vjet	3	4.1
	40 vjet	1	1.4
	Total	72	97.3
Missing System		2	2.7
Total		74	100.0
Klasat ku jep mësim			
		Frekuenca	Perqindja
Alternativat	1-5	25	33.8
	8	2	2.7
	9	2	2.7
	6-9	7	9.5
	7-9	24	32.4
	8-9	12	16.2
	Total	72	97.3
Missing System		2	2.7
Total		74	100.0
Dalja në pension			
		Frekuenca	Perqindja
Alternativat	nen 5 vjet	3	4.1
	Nen 10 vjet	24	32.4
	Nen 15 vjet	7	9.5
	Nen 20 vjet	19	25.7
	Nen 25 vjet	14	18.9
	Nen 30 vjet	5	6.8
	Total	72	97.3
Missing System		2	2.7
Total		74	100.0

Konkluzionet


1- Hipoteza₁ : Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë shfaqin gjithashtu një nivel më të lartë të ezaurimit emocional (burnouti-it) krahasuar me mësuesit të cilët kanë një nivel më të ulët të stresit në punë.

Kjo hipotezë u vërtetua, ku koeficienti i korrelacionit spearman rezultoi ($r=0.656$, $p < 0.1$). Pra ekziston një lidhje mes 2 variablave dhe kjo lidhje është një lidhje lineare dhe positive, cka do të thotë se me rritjen e nivelit të stresit rritet edhe niveli i ezaurimit emocional (burnoutit).

1. Korrelacioni midis nivelit të stresit tek mësuesit dhe ezaurimit emocional

		Pikezimi i stresit tek mësuesit	Ezaurimi emocional
Pikezimi i stresit tek mësuesit	Pearson Correlation	1	.656(**)
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	72	72
Ezaurimi emocional	Pearson Correlation	.656(**)	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	72	72

** Korrelacioni është domethënës prej nivelit 0.01




2- Hipoteza₂: Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë shfaqin gjithashtu një nivel më të lartë të depersonalizimit (burnouti-it) krahasuar me mësuesit të cilët kanë një nivel më të ulët të stresit në punë.

Kjo hipotezë u vërtetua, koeficienti i korrelacionit spearman rezultoi ($r=.570$, $p < 0.5$). Pra ekziston një lidhje mes 2 variablave dhe kjo lidhje është një lidhje lineare dhe positive, cka do të thotë se me rritjen e nivelit të stresit rritet edhe niveli i depersonalizimit (burnoutit).

2. Korrelacioni mes nivelit të stresit tek mësuesit dhe depersonalizimit

		Pikezimi i stresit tek mësuesit	Depersonalizimi
Pikezimi i stresit tek mësuesit	Pearson Correlation	1	.570(*)
	Sig. (2-tailed)		.010
	N	72	72
Depersonalizimi	Pearson Correlation	.570(*)	1
	Sig. (2-tailed)	.010	
	N	72	72

* Korrelacioni është domethënës nivelit 0.05




3- Hipoteza 3: Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë shfaqin gjithashtu një nivel më të lartë të reduktimit të arritjes personale (burnout-it) krahasuar me mësuesit të cilët kanë një nivel më të ulët të stresit në punë. Kjo hipotezë u vërtetua, koeficienti i korrelacionit spearman rezultoi ($r = -0.642$, $p < 0.5$) Pra ekziston një lidhje mes 2 variablave dhe kjo lidhje është një lidhje lineare dhe negative, cka do të thotë se me rritjen e nivelit të stresit zvogëlohet edhe niveli i arritjes personale ose mund të themi se kemi reduktim të realizimit personal. (burnoutit).

3. Korrelacioni midis nivelit të stresit dhe arritjes personale

		Pikezimi i stresit tek mësuesit	Arritja personale
Pikezimi i stresit tek mësuesit	Pearson Correlation	1	.642(*)
	Sig. (2-tailed)		.234
	N	72	72
Arritja personale	Pearson Correlation	.642	1
	Sig. (2-tailed)	.234	
	N	72	72

Korrelacioni është domethënës nivelit 0.05



4- Hipoteza₄: Mësuesit e ciklit të lartë përjetojnë një nivel më të lartë të stresit në punë sesa mësuesit e ciklit të ulët. Kjo hipotezë është vërtetuar jo përmes koeficientit të korrelacionit por përmes analizës përshruese të pikëzimit në shkallën e matjes së nivelit të stresit. Janë krahasuar pikët për mësuesit e ciklit të lartë dhe mësuesve të ciklit të ulët.

Hipoteza₅ e cila përbën edhe hipotezën kryesore të studimit është: Mësuesit të cilët kanë një nivel më të lartë të stresit në punë kanë tendencën për të përjetuar burnout-in.

Si konkluzion, analiza e të dhënave rezultoi në vërtetimin e hipotezave të ngritura, 3 të parat, ku mësuesit që kishin një nivel më të lartë të stresit në punë kishin pikë më të larta në: ezaurimin emocional, depersonalizimin dhe reduktimin e arritjes personale krahasuar me mësuesit që kishin një nivel më të ulët të stresit në punë. Rezultatet e këtij studimi kanë konfirmuar se stresi i mësuesve lidhet pozitivisht me burnout-in në të 3 fushat e tij.

Referencat

- Bertinetto P.M., Ossola C., (1982). *"Insegnare stanca"*. Bologna.
- Caprara G. V., Borgogni L.,(1988) . *"Stress e organizzazione del lavoro"*. Buletin i psikologjisë së aplikuar.
- Cherniss C., (1983). *La sindrome del burnout. Lo Stress Lavorativo degli operatori dei servizi socio-sanitari*, e përkthyer në italisht.
- Maslach, C., Schaufeli, W. B., & Leiter, M.P. (2001). Job burnout. *Annual Review of Psychology*, 52, 397- 422.
- Maslach C.,(1992). *"La sindrome del burnout. Il prezzo dell'aiuto agli altri."* Cittadella Editrice, Assisi.
- Karaj , Th. (2005) *"Psikologjia e stresit"*, Tiranë.
- Kyriacou, C. (2001). Teacher stress: directions for future research. *Educational Review*, 53, 27-35.
- Prandstraller, G., (1980). *Sociologia delle professioni.*, Roma.
- Selye H., (1976). *Stress senza paura*. Milano.
- Schaufeli W . B., Enzmann D., (1998). *"The burnout companion to study and practice: a critical analysis"* gjendet tek *"Giornale Italiano di Psicologia"* , mars. 2005, vol. XXXII, n. 1.

Përdorimi i burimeve të jashtme të kreditimit nga NVM në Shqipëri – Analizë e Anketës SAFE

Eugen Musta
HEI "Marin Barleti University"

Abstrakt

Rëndësia e një klime të shëndoshë për investime është themeli për të ndërtuar një ekonomi me rritje të qëndrueshme. Në mënyrë që bizneset të realizojnë planet e tyre të investimeve ato shpesh kanë nevojë për burime të jashtme për ti financuar këto projekte. Për këtë arsye disponibiliteti i kreditit dhe aksesit që firmat kanë në të ka një rëndësi të veçantë në rritjen dhe zhvillimin e tyre. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një peshë të madhe në ekonominë shqiptare si nga numri i tyre ashtu edhe nga kontributi në punësim dhe në vlerën e shtuar. Në të njëjtën kohë ato janë edhe kategoria më e prekur nga problemet e financimit për shkak të shkallës më të lartë të asimetrisë së informacionit e ndjekur edhe nga pamjaftueshmëria e kolateralit dhe vëllimet e vogla të transaksioneve. Ky punim ka për objektiv të analizojë ndryshimin në sjelljen e NVM-ve rreth mënyrave të financimit të jashtëm të përdorur nga to në 5 vitet e fundit duke u bazuar në rezultatet e marra nga anketimet e Bankës Qendrore Evropiane dhe Këshillit të Evropës për Aksesin në financim të ndërmarrjeve (SAFE) të organizuara në vitet 2011, 2013, 2015 dhe 2016. Nga analiza rezulton se firmat në Shqipëri janë në një situatë më pak të favorshme në lidhje me kreditimin krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe Evropës. Ato janë përdorues më të mëdhenj të kreditimit afatshkurtër sesa atij afatgjatë.

Fjalët kyçe: NVM, Financim i jashtëm, Shqipëri, SAFE, akses në financim.

Hyrje

Pa dyshim që rëndësia e një klime të shëndoshë për investime është themeli për të ndërtuar një ekonomi me rritje të qëndrueshme. Në mënyrë që bizneset të realizojnë planet e tyre të investimeve ato shpesh kanë nevojë për burime të jashtme për ti financuar këto projekte. Për këtë arsye disponibiliteti i kreditit dhe aksesit që firmat kanë në të ka një rëndësi të veçantë në rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Struktura ekonomike në Shqipëri dominohet nga Ndërmarrjet e Vogla të Mesme (NVM) që përveçse janë më të shumtat në numër, rreth 99%, janë gjithashtu pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë së vendit me një peshë mbi 60% në punësimin e përgjithshëm dhe me mbi 55% në vlerën e shtuar (EIB, 2016). Duhet pasur parasysh se klasifikimi i ndërmarrjeve në Shqipëri ndryshon nga ai evropian. Në Shqipëri ndërmarrjet klasifikohen si mikro njësi kur numri i të punësuarve në to nuk i kalon 4 persona, si njësi të vogla kur numri i të punësuarve është 5-9, njësi të mesme kur numri i të punësuarve është 10-49 dhe ato mbi 50 të punësuar klasifikohen si të mëdha. Nëse do ti përmbaheshim përkufizimit të BE-së mbi NVM-të që i klasifikon të tilla të gjitha firmat me më pak se 250 të punësuar dhe një xhiro vjetore jo më të madhe se 50 milion euro, atëherë gati të gjithë firmat në Shqipëri do të kategorizoheshin si NVM duke lënë jashtë vetëm një pakicë firmash të mëdha. Pra nëse përdornim kriteret kategorizuese të BE-së, kontributi i NMV në rastin e Shqipërisë do të rezultonte i

nënvlerësuar dhe pesha e tyre në ekonomi do të ishte shumë më e madhe. Modeli strukturor i ndërmarrjeve në Shqipëri nuk është realisht shumë i ndryshëm se ai që gjejmë edhe në shumë vende të tjera që aplikojnë parimet e ekonomisë së tregut, qofshin ato të zhvilluara apo në zhvillim. Për këtë arsye NVM-e u kushtohet një vëmendje e veçantë qoftë në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik për sa u përket faktorëve dhe politikave që do të stimulonin dhe mbështesnin zhvillimin e tyre. Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në rritjen apo edhe mbijetesën e NVM është edhe niveli i aksesit që ato kanë në gjetjen e financimit pasi kjo kategori e biznesit është zakonisht më e prekura nga problemet e asimetrisë së informacionit, kolateralit të pamjaftueshëm dhe vëllimeve të vogla të transaksioneve. Në këtë prizëm shumë studime të ndryshme e kanë lidhur përdorimin e financimit të jashtëm të NVM me karakteristika të veçanta të tyre si p.sh. me madhësinë e firmës, me moshën, strukturën e pronësisë së saj apo me nivelin e inovacionit që ajo ofron (Berger dhe Udell, 1998; Ferrando and Grieshaber 2011; Huyghebaert et al. 2007, Musta, 2016; etj.), me industrinë në të cilën operon (Hall et al. 2000; Degryse et al. 2012) apo me ambjentin ligjor dhe makroekonomik që i rrethon (Beck et al. 2008; La Porta et al. 1997), etj.

Studime dhe anketime të mëparshme mbi Shqipërinë kanë identifikuar konkurrencën e sektorit informal si një nga problemet kryesore të të bërit biznes, ndërsa mungesa e financimit dhe barra e taksave edhe pse jo më pak të rëndësishme zënë një peshë relativisht më të vogël (BEEPS, 2013). Në fund të dekadës së parë në ekonominë e tregut, Shqipëria rezultonte me një ofertë të limituar të kreditimit bankar ndaj NVM-ve, për shkak të një sistemi bankar të pazhvilluar dhe me probleme të tranzicionit. Për këtë arsye bizneset ishin shpesh të detyruara të kërkonin burime të tjera financimi të cilat i gjenin zakonisht në kursimet e veta apo në remitancat që vinin nga emigracioni (Muent etj. 2000). Në të njëjtin përfundim gjejmë edhe studimin e Kule etj. (2000) të cilët theksojnë se disponibiliteti i financimit me burim nga familja apo miqtë është i ndikuar fort nga shkalla e lartë e remitancave hyrëse nga shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Pra siç shihet gjatë kësaj periudhe mungesën në kreditim që vinte për shkak të strukturës së dobët të sektorit bankar e kompensonte kreditimi i ardhur nga miqtë dhe familja. Kjo situatë vazhdoi edhe gjatë viteve 2000 që gjithashtu regjistruan norma të larta prurjesh nga remitancat shpesh deri në vlerën e 16 % të PBB (siç raportohet nga statistikat zyrtare, por që nga studiues të ndryshëm mendohet të kenë qenë në vlera deri në 30-40% e PBB-së). Gjatë këtyre viteve kemi gjithashtu edhe një zhvillim pozitiv të sektorit privat bankar që shënon privatizimin e disa bankave shtetërore si dhe hapjen e bankave të reja private duke ndihmuar kështu në rritjen e konkurrencës në sektorin bankar dhe në ofrimin e mundësive më të mëdha për kreditim për biznesin. Dhe me të vërtete një periudhë e karakterizuar nga kreditimi i lartë i sektorit privat nga bankat ishte prezente deri në vitet e para të pas krizës financiare botërore të 2008. Kjo rritje është e dukshme në dinamikën e indikatorit “Kreditimi i brendshëm i sektorit privat nga bankat” që pëson një rritje të ndjeshme nga vlerat e 4,6% ndaj PBB-së në vitin 2000 në 39% ndaj PBB-së në 2011 për të rënë në 35% në 2015 (WB Development Indicators, 2016).

Kriza financiare, megjithëse e largët në dukje për Shqipërinë, pati shumë shpejt ndikim edhe në ekonominë e vendit. Në fillim me një ulje të ndjeshme të nivelit të remitancave për shkak të krizës së borxhit që goditi Greqinë dhe me pas me rënien ekonomike të Italisë. Të dy këto vende për shkak edhe të afërsisë gjeografike kanë qenë dhe janë destinacionet kryesore të emigrimit nga shqiptarët dhe për pasojë

ato kanë qenë edhe burimi kryesor i remitancave. Rëniet e remitancave, nga ana tyre ndikuan direkt në rënien e konsumit në vend sidomos në sektorët e ndërtimit dhe ato të shërbimeve duke bërë që një ekonomi e brishtë si ajo e Shqipërisë e ngritur kryesisht mbi konsumin të ngadalësoje ndjeshëm rritjen. Kjo situatë shfaqti edhe një nivel të lartë të kredive me problem në sektorin bankar i cili nga ana e tij reagoi duke ulur kreditimin dhe duke rritur kërkesat për të. Kjo situatë e kreditimit të kontraktuar siç sugjerohet nga literatura, ka një efekt më të madh mbi firmat e vogla dhe të mesme sesa mbi ato të mëdha (Levy, 1993; Beck et al. 2005; etj.). Në këto kushte mbijetesa e shumë NVM u vu në pikëpyetje dhe siç edhe tregojnë statistikat shumë të tilla nuk ja dolën dot. Duke qenë se pjesa më e madhe e kreditimit bankar është e bazuar mbi kolateral, zonat rurale ku forma dominante e biznesit është agrikultura mbetet gjerësisht e pa shërbyer. Në të njëjtën situatë ndodhen edhe zonat e thella malore. Pavarësisht se përqendrimi më i madh i ndërmarrjeve është në zonat urbane, sidomos në rajonin e Tiranës dhe Durrësit, kreditimi i NVM në rajonet periferike të vendit është i një rëndësie të veçantë për këto zona.

Situata e kontraktimit në kreditim vazhdon akoma edhe sot kur kreditimi bankar është në nivele shumë të ulëta pavarësisht normës së lartë të depozitave në sistemin bankar. Kjo shihet qartë në raportin kredi / depozita që është në vlerën 50%, një normë e ulët kjo e krahasuar me mesataret e shumë vendeve të zhvilluara që sugjerojnë se bankat kanë tepriç rezervash të pashfrytëzuara. Edhe pas uljes për të disatën herë të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore¹ në tentativa për të stimuluar investimet dhe kreditdhënien në ekonomi, kjo e fundit nuk ka reaguar sipas pritshmërisë. Shkak kryesor për këtë mendohet të jetë numri akoma i lartë i kredive me probleme që bankat mbajnë në portofolet e tyre² dhe perceptimi i një risku të lartë në ekonomi nga bankat. Sistemi rregullator dhe ai ligjor kontribuoi në rritjen e kredive të këqija për shkak të pengesave të shumta në lidhje me falimentimin, ekzekutimin e kolateralit apo ristrukturimin e borxhit si nga ana rregullatore ashtu edhe nga ajo fiskale. Nivelet e ulëta të kreditimit mund të shpjegohen pjesërisht edhe nga rënia e kërkesës për shkak të mungesës së alternativave fitimprurëse në investim siç sugjerojnë edhe rritja e normave të depozitave në sektorin bankar me rreth 9.3% për 5 vitet e fundit, përkundrejt rritjes së aseteve me 7.9%.

Një faktor tjetër që ndikon në nivelet e ulëta të kreditimit është edhe konkurrenca në sistemin bankar në Shqipëri. Konkurrencë kjo që megjithëse rezultoi e moderuar, rezultat ky i këshilluar nga literatura për vendet në zhvillim, paraqet një tendencë rritje të indeksit HHI të përqendrimit sidomos të dy bankave më të mëdha në vend që së bashku zotërojnë rreth 50% të aseteve të sektorit bankar (Musta dhe Shehu, 2015), nuk duket e mjaftueshme për të zhbllokuar ngërçin në kreditdhënie.

Raporti i fundit i Bankës Evropiane për Investim (2016) vlerëson se klima e investimeve është e moderuar dhe se sektori bankar do të rifillojë kreditimin e bizneseve duke marrë masa lehtësuese, por a do të jetë vërtetë kështu? A do të shohim një rivitalizim të kreditimit në vitet në vazhdim? Ky punim ka për objektivi të analizojë ndryshimin në sjelljen e NVM rreth mënyrave të financimit të jashtëm të përdorur nga to në 5 vitet e fundit duke u bazuar në rezultatet e marra nga anketimet e Bankës Qendrore Evropiane dhe Këshillit të Evropës për Aksesin në financim të ndërmarrjeve (SAFE)

¹ Aktualisht në nivelin më të ulët historik prej 1.25%, nga vlera e 6.2% në fillim të krizës në 2008-ën.

² Në 2015 niveli i kredive të këqija ishte në rreth 21%, me një përmirësim të lehtë nga nivel 23.5% i vitit 2013.

të organizuara në vitet 2011, 2013, 2015 dhe 2016. Në vijim fokusi do të jetë në llojet e financimit të kërkuara nga bizneset gjatë vitit të fundit dhe ndryshimet që kanë pësuar ato në vitet e analizës tonë. Do të ndalojmë të analizojmë destinacionin e përdorimit të financimit të marrë dhe krahasimi në përdorim me vendet e tjera të rajonit dhe të BE-së.

Anketa për Aksesin në Financim të Ndërmarrjeve (SAFE)

Në 2008 Komiteti Evropian (KE) së bashku me Bankën Qendrore Evropiane (BQE) nisën një anketim mbi aksesin në financim të ndërmarrjeve (Survey on the access to finance of enterprises - SAFE.) Ai zhvillohet për 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe disa shteteve të tjera jo anëtare si Islanda, Turqia, Shqipëria, Mali I Zi, Serbia dhe Maqedonia. Anketimi SAFE është konceptuar si instrument për të mbuluar si nevojat e Këshillit Evropian për qëllimet strukturore ashtu edhe ato të BQE për politikën monetare. Ky anketim u organizua në baza dy vjeçare deri në vitin 2013 kur në strukturën e tij pati disa ndryshime dhe frekuenca e zhvillimit të tij u bë e përvitshme. Këto ndryshime u aplikuan në anketimin e vitit 2015 dhe njihen edhe si vala e dytë e anketimit. Ndërmarrjet që marrin pjesë në anketim janë të përzgjedhura në mënyrë rastësore dhe pyetësi është zhvilluar duke përdorur metodën Computer Assisted Telephone Interviews (CATI). Ndër të dhënat që anketimi mbledh janë informacione mbi strukturën e tilla si: madhësia (si numër të punësuarish dhe xhiro), mosha e firmës dhe pronësia; si dhe mbi aktivitetin, rritjen, mbi burimet financiare që firma përdor, si dhe nevojat e saj për financime të ardhshme.


Në analizën tonë u përdorën rezultatet e anketimit SAFE të zhvilluara për Shqipërinë në periudhat 2011, 2013, 2015 dhe 2016. Të anketuarit janë pyetur ndër të tjera nëse kanë përdorur instrumente të ndryshëm financimi gjatë gjashtë muajve të fundit para anketimit, nëse nuk i kanë përdorur këto instrumente gjatë gjashtë muajve të fundit, por i kanë përdorur në të shkuarën ose nuk i kanë përdorur asnjëherë. Instrumentet e financimit për të cilat janë pyetur të anketuarit janë (1) fitimet e pashpërndara ose shitja e asetëve, (2) grantet ose huatë bankare të subvencionuara, (3) overdrafti bankar, linja e kreditit apo overdraft mbi kartën e kreditit, (4) hua bankare, (5) kredit tregtar, (6) hua të tjera (nga kompani, aksionarë apo nga familja dhe të afërmit), (7) lizing apo faktoring, (8) emetimi i instrumenteve të borxhit, (9) aksione (shitje e pjesëmarrjes në kompani). Në pyetjet që janë zgjedhur për tu përdorur në analizë në këtë punim janë konsideruar të rëndësishme përdorimi i instrumenteve financuese gjatë gjashtë muajve të fundit të pyetësorit, për shkak se edhe pse firmat mund të kenë përdorur në etapa të ndryshme në të shkuarën mënyra të tjera financimi, në kohën e anketimit ato nuk kanë qenë ndikuese në aktivitetin e firmës. Gjithashtu pyetjet mbi instrumente të financimit që nuk janë përdorur nga firmat në Shqipëri janë përjashtuar nga analiza ose në disa raste për shkak të peshës së vogël janë bashkuar me pyetje ose alternativa të tjera përgjigjesh.

Përdorimi i llojeve të ndryshme të financimit të jashtëm nga firmat në Shqipëri në 4 vitet e anketës SAFE

Figura 1. Aplikimi për kredi bankare dhe rezultati i tij për vitin 2016. Ndërtuar nga autori

mbi rezultatet e anketës SAFE (2016) për pyetjet Q7aa dhe Q7ba

Siç shihet ne Figurën 1, gjatë vitit 2016 vetëm 14% e firmave kanë aplikuar për kredi



bankare. Kjo shifër shënon një rënie nga viti në vit ku në vitin 2011 ishin 24% e firmave që aplikuan për kredi bankare për të rënë në 18% në 2013 dhe më pas në 15% në 2015. Ndërkohë norma mesatare e përdorimit të kësaj metode financimi në BE për vitin 2016 është 27%. Arsyeja kryesore për këtë rënie në aplikime siç duket nuk është e ndikuar nga rënia e nevojës për këtë lloj financimi, por nga perceptimi për kushte më të vështira të dhënies së kredisë nga bankat gjë që shihet në rritjen e ndjeshme të përgjigjes “Jo, për frikë të refuzimit të mundshëm”, të dhënë nga firmat që nuk kanë aplikuar për këtë lloj kreditimi, nga 0.8% në 2013 në 2016 shënon një vlerë prej 9%. Nga firmat që aplikuan në 2016, 47% e tyre morën të plotë shumën e kredisë së kërkuar. Kjo përqindje është më e madhe se ajo e vitit 2013 dhe 2015 me respektivisht 40 dhe 37%, por përsëri mbetet më e vogël se vlera e regjistruar në vitin 2011 prej 78%. Gjithashtu kjo përqindje është e vogël edhe krahasuar me mesataren e BE prej 70%. Kjo rënie në përqindjen e kredive të miratuara sugjeron për politika të shtrënguara në kredidhënie nga ana e bankave dhe një prezencë të ndjeshme të problemeve të asimetrisë së informacionit që theksohen në kohë krizash sidomos në formën e zgjedhjes së gabuar³. Përqindja e aplikantëve që morën më pak seç kërkuar por përsëri mbi 75% duket e stabilizuar ndër vite në vlerat e rreth 30% por mbetet e lartë krahasuar me mesataren evropiane prej 5%. Ndërkohë që vërehet një rritje në numrin e aplikimeve të refuzuara nga 2.6% në 2011 në 8% në 2016, por jo larg mesatares evropiane prej 7%.




Figura 2. Aplikimi për kredit tregtar dhe rezultati i tij për vitin 2016. Ndërtuar nga autori

³ Adverse selection

mbi rezultatet e anketës SAFE (2016) për pyetjet Q7ab dhe Q7bb

Në analizën e pyetjes mbi përdorimin e kreditit tregtar si formë e financimit të jashtëm, Figura 2 shohim një rritje të konsiderueshme nga viti 2011 ku vetëm 1.3% kishin aplikuar për të, në 18% në vitin 2015 për të rënë në nivelin e 13% për vitin 2016. Tek ato firma që kanë zgjedhur të mos aplikojnë shohim një rritje të ndjeshme, nga 0.6% në 2013 në 12% në 2016, në ato që mendojnë se kërkesa e tyre do të refuzohet. Ndër ato që kanë aplikuar gjatë vitit 2016 kemi për herë të parë 21% që e kanë refuzuar kreditimin mbas aprovimit të tij për shkak të kostove të larta. Një ndryshim interesant duke pasur parasysh se kjo përqindje ka qenë 0 për vitet e shkuara




Figura 3. Aplikimi për forma të tjera kreditimi dhe rezultati i tij për vitin 2016. Ndërtuar mbi rezultatet e anketës SAFE (2016) për pyetjet Q7ac dhe Q7bc

Në forma e tjera të kreditimit të jashtëm janë përfshirë hua të kërkuara kryesisht nga familjarë apo miq të pronarit/ve të firmës. Nga të dhënat e krahasuara në vitet e ndryshme të anketës SAFE vihet re se kjo formë financimi përveç vitit 2015 kur rreth 22% e firmave kanë aplikuar për një kreditim të tillë, në vitet e tjera normat e përdorimit kanë qenë rreth 3%, ndërsa në vitin 2016 siç shihet edhe në Figurën 3 ato janë 7%. Edhe në këtë rast si në rastet e formave të tjera të kreditimit të jashtëm shohim një përqindje relativisht të madhe të firmave që kanë hezitur të kërkojnë financim për shkak të frikës së refuzimit të kërkesës. Rezultati i firmave që kërkuan këtë lloj kreditimi është përgjithësisht pozitiv edhe pse se jo të gjithë arrijnë të sigurojnë vlerën e kërkuar të kreditimit. Për këtë vit rezulton se nuk ka pasur refuzime që në vitet paraardhëse kanë qenë të pranishme në normat e 14-15%.

Linjat e kreditit dhe overdrafti bankar rezultojnë të kenë pasur popullaritetin më të madh si instrumenti më i zgjedhur nga firmat për financim të jashtëm. Mbi 50% të tyre kanë aplikuar për një të tillë në 2016. Gjithashtu vihet re një trend rritës në përdorimin e këtij lloj financimi nga firmat duke filluar nga një përdorim modest prej vetëm 5.5% të tyre në 2011, në 18% dhe në 32% respektivisht në vitet 2013 dhe 2015. Kjo rritje mund të ketë ardhur si pasojë e vështirësimit të kreditimit me anën e instrumenteve të tjerë të sipërpërmendur të financimit, sidomos të




Figura 4. Aplikimi për overdraft, linjë krediti apo overdraft i kartës së kreditit dhe rezultati i tij për vitin 2016. Ndërtuar mbi rezultatet e anketës SAFE (2016) për pyetjet Q7ad dhe Q7bd formave afatgjata të kreditimit siç janë huatë bankare. Duke ditur që kjo formë kreditimi është afatshkurtër supozojmë gjithashtu se firmat kanë ulur nivelin e investimeve afatgjata. Kjo formë kreditimi duket edhe më lehtë për tu marrë, kjo gjykuar nga rezultati pozitiv i të gjithë aplikimeve dhe nga numri i vogël i firmave që refuzojnë të aplikojnë për shkak të frikës së refuzimit.

Destinacioni i përdorimit të financimit të jashtëm të përfituar nga NVM

Në analizën krahasuese të destinacionit të përdorimit të financimit të jashtëm, nga firmat që përfituan financim, hasim një ndryshim në të dhënat e mbledhura nga vala e parë e anketimit SAFE të kryer deri në 2013 me anketimet e mëvonshme. Ndryshimi në fjalë ka të bëjë me kategoritë e destinacioneve të përdorimit të financimit, për këtë arsye kemi bërë disa kompromise duke i pranuar disa vlera në kategoritë më të afërta me to në anketimin e fundit të 2016 si më poshtë: kategorinë e “kërkimit dhe zhvillimit” së bashku me kategorinë e “promovimit” për vitet 2011 dhe 2013 i kemi pasqyruar në kategorinë “zhvillimi dhe lëshimi i një produkti apo shërbimi të ri”; kategorinë “për blerjen e një biznesi tjetër” e kemi pasqyruar në kategorinë “tjetër”. Për shkak se një firmë financimin e marrë mund ta përdorë për më shumë se një qëllim totali nuk është gjithmonë 100%.

Siç vihet re në Figurën 5 financimi i marrë më së shumti shkon për kapital punues dhe blerje inventari. Trendi rritës i përdorimit të financimit të siguruar për këtë qëllim sugjeron një mungesë të theksuar likuiditeti afatshkurtër. Mbështetur edhe në rezultatin e analizës së mëparshme, që tregonte se edhe niveli i aplikimeve për kreditim afatshkurtër në formën e overdraftit apo linjave të kreditit ishte më i madhi dhe me trend rritës. Përdorimi i kreditimit për qëllime investimi vjen i dyti për nga madhësia. Në këtë zë shohim një rënie nga viti 2011 në vitin 2015 pasuar nga një rikuperim i lehtë për 2016. Kjo sjellje duket e koreluar me nivelin e aplikimeve dhe aprovimeve të huasë bankare gjatë viteve përkatëse duke sugjeruar që kreditimi bankar siç pritët, përdoret kryesisht për të financuar investimet në aktive




Figura 5. Destinacionet e përdorimit të financimit të jashtëm. Burimi SAFE (2011; 2013; 2015; 2016)⁴

afatgjata. Kreditimi i përdorur për trajnime të punonjësve shfaqet vetëm në vitin 2015 me një normë të krahasueshme me mesataren evropiane për të pësuar një ulje në vitin pasardhës. Përdorimi i kreditimit për të financuar krijimin e produkteve të reja apo për të promovuar edhe ato ekzistuese shfaq një pamje të qëndrueshme në vitet e analizës tonë. Në vitet e fundit shohim që financimi i jashtëm ka një përdorim domethënës edhe për shlyerjen e borxheve të vjetra apo për rifinancim. Mos prezenca e këtij destinacioni më parë mund të ketë bërë që përgjigjet e kësaj kategorie të kenë rënë nën alternativën “tjetër” por sidoqoftë përmasa relativisht e vogël e këtij zëri në rreth 5 % mbështet pohimin se ky përdorim po përdoret në përmasa më të mëdha në dy vitet e fundit. Marrja e financimit për arsye të tjera duket se ruan një peshë të njëjtë ndër vite, ku duhet të kemi parasysh se fryrja që shihet në dy vitet e para të analizës vjen për arsye se këtij zëri i kemi shtuar edhe peshën e zërit “për blerje të një biznesi tjetër” i cili mungon në anketimet e valës së dytë.

Krahasim i përdorimit të formave të ndryshme të kreditimit midis firmave në Shqipëri dhe atyre në Evropë gjatë vitit 2016⁵

Për nga përdorimi overdraftit dhe linjës së kredisë gjatë 6 muajve të fundit të vitit 2016 Shqipëria renditet pranë vendeve me përdorim të lartë të tyre. Ajo ka përdorimin më të lartë në rajon me 41% përkundrejt Maqedonisë me 31%. Përdorimi i këtij lloji të kreditimit nga SME në Shqipëri është me i lartë edhe se mesatarja evropiane prej 37% ku vlera me e lartë është 55% për Finlandën dhe me e ulëta 17 për Greqinë.

Nuk është e njëjta gjë kur flasim për kredinë bankare ku Shqipëria ka përdorimin me të ulët të saj në rajon prej vetëm 19% përkundrejt vlerës më të lartë të përdorimit nga Mali I zi me 31%. Ndërsa vlerat mesatare evropiane janë 18% me përdorim me intensiv nga Malta dhe Belgjika me 28% dhe përdorim me të vogël nga Rumania me vetëm 8%.

Në 2016 Lizingu në Shqipëri është përdorur vetëm nga 9% e NVM kundrejt një mesatareje evropiane prej 21% dhe një përdorimi më të lartë se 35% për Gjermaninë dhe Poloninë.

⁴ Grafiku është ndërtuar nga autori me të dhënat e marra nga përgjigjet e pyetjes q6a1 q6a6 i anketës SAFE të viteve 2015 dhe 2016 dhe pyetjes q14 të anketës SAFE të viteve 2011 dhe 2013.

⁵ Analiza krahasimore është bërë mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik të SAFE (Graaf et al, 2016) .

Përdorimi i Kreditit tregtar në Shqipëri është i moderuar me 10% krahasuar me vendet e rajonit ku Mali I zi dhe Serbia përdorin vetëm 2% ndërsa Maqedonia 17%. Mesatarja evropiane është ne 17% ndërsa përdoruesi me i madh rezulton Irlanda me 57%

Në përdorimin e granteve dhe kredive të subvencionuara Shqipëria është afër mesatares evropiane prej 7%. Përdoruesja me e madhe e kësaj forme të financimit të jashtëm rezulton Italia me 15%. Ndërsa në rajon kryeson Serbia me 9% dhe ne fund është Maqedonia me 3%

Për sa i përket përdorimit të fitimit të pashpërndare apo të ardhurave nga shitja e asetëve Shqipëria radhitet e para në rajon për këtë periudhe me një përdorim prej 20% të kësaj forme përkundrejt Malit të zi qe e ka përdorur vetëm ne 4 % të rasteve. Mesatarja Evropiane e përdorimit ka qene 15% dhe përdoruesi me I madh ka qene Irlanda me 28%.

Përdorimi i burimeve të tjera të financimit, kategori kjo që përfaqëson kryesisht huatë e marra nga familjare apo miq rezulton i përdorur në masën 9% qe është ne vlere të njëjtë me mesataren e vendeve të BE ku në krye të listës është Rumania me 16%. Ne rajon Mali I zi kryeson me 11% dhe ne fund ndodhet Serbia me 3%.

Financimi nëpërmjet kapitalit nuk është një forme e preferuar për NVM-të dhe për këtë arsye përdorimi i saj nuk është i madh sidomos për vendet ku tregjet kapitale nuk janë të zhvilluara. Në gjashtëmujorin e fundit shohim që mesatarja evropiane në përdorimin e këtij lloji të financimit është 11% ndërkohë qe në shumë vende përdorimi është 0%. Ne përdorimin e këtij financimi NMV-të shqiptare rezultojnë relativisht shume aktive me rreth 9% përkundrejt vendeve të tjera të rajonit qe kane vlere afër 0%.

Ndryshimet në kushtet e financimit bankar

Ndryshimi në normat e interesit në Shqipëri është me trend rënës duke ndjekur edhe trendin mesatar të vendeve të BE-së. Ngjashmëria me trendin e BE-së vazhdon edhe për nivelin e kostove të tjera të financimit⁶, vetëm se në këtë rast trendi është rritës nga 16% në 2011 në 42% në 2016. Një ndryshim i kundërt me trendin evropian vjen në zërin e kolateralit ku rezulton që kërkesa për të në Shqipëri të jetë rritur ndjeshëm nga 13% në 2011 në 40% në 2016 ndërkohë që mesatarja e BE-së ka një rënie nga 33 në 21%. Kërkesat për kolateral në Shqipëri rezultojnë të jenë më e larta në rajon dhe e barabartë vetëm me Greqinë nga vendet e BE-së.

Pritshmëritë

Për sa i përket pritshmërive për të ardhmen firmat shqiptare renditen më optimistat në rajon dhe në Evropë. 33% e tyre parashikojnë një rritje me më shumë se 20% në vit, 42% parashikojnë një rritje të moderuar nën 20%. Një pritshmëri të tillë të lartë për rritje mbi 20% në vit e gjejmë edhe tek disa vende të tjera të rajonit ku më afër Shqipërisë renditen Maqedonia dhe Serbia me respektivisht 29% dhe 27%. Këto vlere janë relativisht të larta krahasuar me mesataren e BE-së për 2016 që është në nivelin 10%. Nëse do të analizonim rezultatet duke e zgjeruar grupin në mënyrë që të përfshijmë në të edhe kategorinë e firmave që presin një rritje të moderuar më pak se 20% do të shohim se

⁶ Kosto të tjera përveç normës së interesit siç janë pagesat dhe komisionet e ndryshme.

Shqipëria nuk përbën më një rast të veçantë, por bie në kufijtë e sjelljes mesatare. Kur analizojmë ndryshimin në pritshmërinë për rritje të firmave nga viti 2011 në vitin 2016 vëmë re se tendenca e firmave që presin rritje është rritur gradualisht nga 43% në 75%.

Preferencat në financim

Në përputhje me teorinë e rendit përzgjedhës⁷ firmat në Shqipëri do të preferonin të përdorin financimin me borxh kundrejt financimit me kapital. Megjithëse kemi një rënie në zgjedhjen e kreditimit bankar si formë kryesore në kreditim nga nivelet e 47 dhe 54% për vitet 2011 dhe 2013 në 35 dhe 41% në 2015 dhe 2016, rritja në nivelin 24% e zgjedhjes së financimit me kapital në 2015 ra përsëri në nivele të krahasueshme me 2011 prej 16%. Gjithashtu shohim se ulja në kërkesën e kreditimit bankar është kompensuar me rritje në kreditimin nga burime të tjera. Krahasuar me vendet e tjera niveli i përdorimit të kreditimit bankar i Shqipërisë është ndër më të ulëtit me rreth 25% më pak se mesatarja evropiane, ndërkohë që niveli i financimit me kapital është me 10% mbi mesataren e BE-së. Financimi nga burime të tjera është gjithashtu më i larti në Evropë me 15% dhe rreth 10% më i lartë se mesatarja evropiane.

Pengesa më e madhe në kreditim

Në vitin 2016, për 31% të firmave pengesa më e madhe në kreditim janë normat e larta të interesit apo e kostos totale të kredisë. Pengesa e dytë për 18% të firmave është pamjaftueshmëria për të përmbushur kërkesën e kolateralit apo garancisë. Këto pengesa duken të qëndrueshme edhe gjatë viteve të mëparshme. Por ndërsa mungesa e kolateralit është në një nivel të krahasueshëm me vendet e tjera të rajonit dhe BE-së, normat e larta të interesit janë shqetësim për një numër më të madh firmash shqiptare se sa shumica e vendeve të BE-së me rreth 20% mbi mesataren evropiane, ndërkohë që vlerat janë më të krahasueshme me vendet e rajonit. Mungesa e pengesave perceptohet vetëm nga 13% e firmave që e bën Shqipërinë të radhitet ndër vendet me aksesin më të vogël në financim krahasuar me një mesatare të BE-së në vlerat e 44%. 19% e firmave në Shqipëri deklarojnë se nuk kanë akses në financim duke e tejkaluar me 15% mesataren evropiane për këtë kategori.




Figura 6. Faktori më i rëndësishëm pengues në marrjen e një kreditimi. Ndërtuar mbi rezultatet e anketës SAFE (2015; 2016) për pyetjet Q22

⁷ Pecking order theory nga Myers and Majluf (1984).

Konkluzione

Nga analiza e kryer bazuar në rezultatet e ofruara nga anketa SAFE, rezulton se firmat në Shqipëri janë duke përdorur më së shumti kreditimin afatshkurtër në formën e overdraftit apo linjës së kreditit, përkundrejt kreditimit afatgjatë kryesisht në formën e huasë bankare apo financimit me kapital. Niveli i përdorimit të këtyre alternativave të financimit rezulton më i lartë se mesatarja evropiane në rastin e parë pra në atë të kreditimit afatshkurtër dhe më i ulët se ajo në rastin e dytë atë të kreditimit afatgjatë. Ky rezultat tregon se firmat shqiptare gjenden në një situatë më të keqe për sa i përket mundësive të financimit krahasuar me vendet e tjera evropiane.

Kjo sjellje e firmave në preferencën e tyre në kreditim vjen e kushtëzuar edhe nga oferta për kredit e institucioneve kredi-dhënëse në vend. Siç dihet në Shqipëri kreditimi i jashtëm i NMV-ve kryhet në mbi 88% nga bankat (EIB, 2016), kjo është një situatë tipike e vendeve në zhvillim sidomos në rastet kur tregjet e kapitalit janë jofunksionale. Sistemi bankar edhe pse raportohet si i shëndoshë, fitimprurës dhe i mirë kapitalizuar prej disa kohësh është duke u përballur me problemin e kredive të këqija duke i bërë bankat të kenë një sjellje të kujdesshme në drejtim të kredive që lëshojnë. Kjo shihet në kërkesat në rritje për kolateral, normave relativisht të larta të interesit, dhe kostos së lartë të kreditimit duke e bërë atë njëkohësisht edhe jo atraktiv për firmat që kërkojnë mundësi fitimprurëse investimi.

Përdorimi i fitimit të pashpërndarë apo shitja e aseteve përsëri shfaqen në norma të larta mbi mesataren evropiane duke sugjeruar që firmat shqiptare mbështeten më shumë në forcat e veta për të financuar aktivitetin e tyre. Kjo sjellje nuk është atipike pasi ajo është në përputhje me teorinë e rendit përzgjedhës në kreditim (Myers and Majluf, 1984). Kjo teori sugjeron se firmat preferojnë në fillim të përdorin financimin e brendshëm të siguruar nga fitimet e akumuluar. Në rastet kur ky burim do të jetë i pamjaftueshëm apo i pamundshëm atëherë preferenca e dytë do të ishte përdorimi i financimit të jashtëm me borxh përpara përdorimit të financimit me kapital. Pra financimi me kapital llogaritet si financim i alternativës së fundit, kjo për shkak se lejimi i kapitalit të ri nga menaxherët perceptohet si lëshim i frerëve të drejtimit. Sipas BEI (2016) financimi me kapital është i panjohur në Shqipëri duke bërë që shumë sipërmarrës të mos e preferojnë atë për shkak të njohurive të pakta të principeve të ndarjes së riskut dhe fitimit. Të dhënat e anketimit SAFE, përkundër konkluzioneve të BEI tregojnë se përdorimi i këtij burimi në Shqipëri është relativisht i lartë krahasuar me vendet e rajonit ashtu edhe me ato të BE-së. Arsyet për këtë mund të spekulohet se është akses i limituar dhe jo i mjaftueshëm në format e tjera të financimit është arsyeja që i bën firmat që duan të investojnë të ndjehen të përjashtuara nga zgjedhja e dy alternativave të para.

Format e tjera të kreditimit si lizingu, krediti tregtar etj. nuk duken shumë popullore për biznesin shqiptar. Shpesh arsyeja për këtë është në mos informimin e duhur të tyre për ekzistencën apo avantazhet e përdorimit të tyre, por edhe mos ofrimi i një produkti atraktiv apo konkurrues nga ana e institucioneve përkatëse duke e bërë huan bankare shpesh më të lehtë për tu marrë. Shpesh p.sh. në rastin e lizingut ofruesit janë pjesë apo nën kompani të bankave tregtare duke e ofruar këtë shërbim si një produkt suplementar dhe jo si një konkurrues i huasë bankare. Si pasojë përdorimi i

lizingut rezulton të jetë ndjeshëm nën mesataren evropiane.

Pavarësisht situatës jo të mirë në kreditim, pamë që firmat në Shqipëri shfaqen optimiste për të ardhmen duke parashikuar një rritje mbi mesataren e vendeve të tjera. Por kjo rritje zakonisht kërkon kreditim që sipas “Raporti për vlerësimin e nevojës për kreditim” të Bankës Evropiane për Investim (2016), kërkesa totale për kredit nga SME-të në Shqipëri është përllogaritur në 1.4 miliard Euro, vlerë kjo e barabartë me rreth 14% të PBB-së dhe 34% të kredisë së përgjithshme të sistemit financiar në vend. Edhe pse kërkesa për kreditim duket e shëndoshë kredidhënia shfaqet e ulët dhe bankat ndihen të rrezikuara duke e përfshirë këtë risk në strukturën e normës së interesit që ato ofrojnë dhe në kërkesat në rritje të kolateralit. Si masa për lehtësimin e kreditimit janë ndërtuar edhe disa skema garancie për NVM në Shqipëri, por me gjithë potencialin për të përmirësuar aksesin në financim të NVM-ve sipas BEI suksesi i tyre do të varet nga efienca me të cilën ato do të menaxhohen.

Të gjitha bankat në vend ofrojnë shërbime për NVM në raporte të ndryshme. Ndërkohë që disa banka nuk preferojnë të merren me biznese të vogla, disa banka të vogla si FIB dhe BNT e kanë fokusuar kredi dhënien tek NVM dhe duke qenë se nuk kanë minimume kredidhënie ato shpesh konkurrojnë me Institucionet financiare jo bankare (IBJF). IBJF megjithëse rezultojnë në rritje, pesha e tyre është akoma e vogël e përllogaritur në rreth 3.2% e portofolit kombëtar të kredisë sipas raportit të BEI (2016). Shoqëritë e kursim kredisë (SHKK) nga ana tjetër edhe pse në modelin e tyre të biznesit shërbejnë vetëm antarët e tyre, kredidhënien e kanë të kufizuar vetëm për qëllime biznesi duke i dhënë mundësi financimi firmave të vogla sidomos në zonat rurale ku problemet e kreditimit të NVM rezultojnë edhe më të theksuara.

Referenca

- Beck, T., Degryse, H., Kneer, C.,** 2012. Is more finance better? Disentangling intermediation and size effects of financial systems, Center for Economic Research, Discussion Paper No. 2012-060, Tilburg University.
- Beck, T., Demirguc-Kunt, A. & Maksimovic, V.** 2005. Financial and Legal Constraints to Firm Growth: Does Size Matter? *Journal of Finance*, 60, 137-77
- Beck, T., Demirguc-Kunt, A. and Maksimovic, V.** (2008), “Financing Patterns Around the World: Are Small Firms Different?”, *Journal of Financial Economics*, Vol. 89 No. 3, pp. 467–487.
- Berger, A.N. and Udell, G.F.** (1998), “The Economics of Small Business Finance: The Roles of Private Equity and Debt Markets in the Financial Growth Cycle”, *Journal of Banking & Finance*, Vol. 22 No. 6, pp. 613–673.
- BEEPS (Business Environment and Enterprise Performance Survey) database,** (2013). European Bank for Reconstruction and Development. Retrieved from <http://ebrd-beeps.com/data/>
- D. Kule, A. Mançellari, H. Papapanagos, S. Qirici, and P. Sanfey** (2000), “The Causes and Consequences of Albanian Emigration during Transition: Evidence from Micro Data”, *Internacional Migration Review*.
- Degryse, H., de Goeij, P. and Kappert, P.** (2012), “The Impact of Firm and Industry Characteristics on Small Firms’ Capital Structure”, *Small Business Economics*, Vol. 38 No. 4, pp. 431–447.
- ECB,** (2011; 2013; 2015; 2016). Survey on Access to Finance of Enterprises (SAFE). As retrieved from <http://www.ecb.europa.eu/stats/money/surveys/sme/html/index.en.html>
- EIB (European Investment Bank),** (2016). Assessment of financing needs of SMEs in the

- Western Balkans countries - Country report: Albania. Retrieved from <http://www.eib.org/infocentre/publications/all/econ-assessment-of-financing-needs-of-smes-in-albania.htm>
- EIB (European Investment Bank)**, (2016). CESEE Bank Lending Survey. Retrieved from <http://www.eib.org/infocentre/publications/all/cesee-bls-2016-h1.htm>
- Ferrando, A. and Griesshaber, N.** (2011), "Financing Obstacles among Euro Area Firms: Who Suffers the Most?", ECB Working Paper Series No 1293, available at: <http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecbwp1293.pdf>
- Graaf, A., Kwaak, T., Zeijden, P.** (2016). Survey on the access to finance of enterprises (SAFE) Analytical Report. Retrieved from <https://www.ecb.europa.eu/stats/money/surveys/sme/html/index.en.html>.
- La Porta, R., Lopez-de-Silanes, F., Shleifer, A. and Vishny, R.** (1997), "Legal Determinants of External Finance", *The Journal of Finance*, Vol. 52 No. 3, pp. 1131–1150.
- Levy, B.** (1993). Obstacles to Developing Indigenous Small and Medium Enterprises: An Empirical Assessment. *The World Bank Economic Review*, 7, 65-83
- Mehl, A., Vespro, C., Winkler, A.** (2005), "The Finance-Growth Nexus and Financial Sector Environment: New Evidence from Southeast Europe." Conference on European Economic Integration, Austrian National Bank, Vienna.
- Muent, H., Pissarides F. and Sanfey P.** (2000). Taxes, competition and finance for Albanian enterprises: evidence from a field study. European Bank for Reconstruction and Development Working Paper nr. 54. As retrieved from <http://www.ebrd.com/downloads/research/economics/workingpapers/wp0054.pdf>
- Musta, E.** (2016). Analyses of financing needs of SMEs by size and age in Albania. *European Journal of Economics, Law and Social Sciences*.
- Myers, Stewart C.; Majluf, Nicholas S.** (1984). "Corporate financing and investment decisions when firms have information that investors do not have". *Journal of Financial Economics*. 13 (2): 187–221
- Hall, G., Hutchinson, P.J. and Michaelas, N.** (2000), "Industry Effects on the Determinants of Unquoted SMEs' Capital Structure", *International Journal of the Economics of Business*, Vol. 7 No. 3, pp. 297–312.
- Huyghebaert, N. and van de Gucht, L.** (2007), "The Determinants of Financial Structure: New Insights from Business Start-ups", *European Financial Management*, Vol. 13 No. 1, pp. 101–133
- The World Bank, World Development Indicators** (2016). Retrieved from <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?source=world-development-indicators#>

Shkathtësitë e menaxhimit të drejtorit të shkollës ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies

Venera Këndusi

Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

Abstrakt

Ndikimi i jashtëzakonshëm të cilin e ka sistemi arsimor në dinamikën e përgjithshme sociale të një vendi e bën atë të jetë element substancial i strukturës shoqërore.

Rëndësia e sistemit arsimor është aq e madhe, sa që në fakt çdo qelizë e shoqërisë – në një aspekt të caktuar - varet prej këtij sistemi. Rrjedhimisht, edhe suksesi apo dështimi i strukturave të caktuara të shoqërisë është i lidhur shumë ngushtë me nivelin e kualitetit të arsimit.

Kjo është arsyeja kryesore që studimet dhe hulumtimet për sistemet arsimore, pa marrë parasysh vendin apo kohën, ngërthejnë në vete një peshë të madhe shoqërore, kulturore, politike, ekonomike, etj. Hulumtimi i mirëfilltë dhe profesional i sistemit arsimor në përgjithësi, por edhe i përbërësve të tij specifikë në veçanti, ndikon fuqishëm në analizimin objektiv të gjendjes aktuale, duke ndihmuar në identifikimin e shkaqeve dhe pasojave që ndikojnë (dhe ndikohen) prej saj.

Në këtë kontekst, analizimi i shkathtësive të menaxhimit të arsimit të drejtorëve të shkollave është njëra prej pikave më të rëndësishme të mozaikut të përgjithshëm arsimor.

Drejtorët e shkollave janë "*të parët mes të barabartëve*", kurse aftësia e tyre menaxheriale e determinon orientimin zhvillimor të një shkolle të caktuar. Për këtë arsye, rëndësia që duhet t'i kushtohet punës së tyre vjen për pasojë të implikimeve afatgjate në mbarëvajtjen kolektive të punës së një shkolle.

Duke u nisur nga ky parim, qëllimi parësor i këtij hulumtimi qëndron në identifikimin e rolit, funksionit dhe rëndësisë së drejtorëve të shkollave në menaxhimin e një shkolle të suksesshme dhe cilësore.

Hyrja

Sqarimi i nocioneve themelore dhe vështrimi teorik

Sipas "Fjalorit të psikologjisë", me nocionin shkathtësi kuptojmë llojin e veprimtarisë së njeriut, të cilën e karakterizon gatishmëria për t'i kuptuar kërkesat e situatës së krijuar dhe për të reaguar shpejt, lehtë, e mirë ndaj tyre, duke zbatuar me sa më përpikëri veprimet e mësuara. (Nushi,1987:285).

Në "Fjalor edukimi", ky nocion përshkruhet si mundësi që bazohet në aftësinë e zhvilluar nëpërmjet mësimnxënies, ushtrimit, përvojës dhe fitimit të dijeve (Grillo,2002:295)

Nga kjo kuptojmë se sa është njeriu i gatshëm dhe i aftë të kuptojë shpejt dhe të reagojë në rrethana të caktuara duke i shfrytëzuar mirë njohuritë e tij.

Në fjalorë të ndryshëm të gjuhës angleze, nocioni menaxhim rrjedh nga fjala angleze "manage", që do të thotë drejtoj, administroj, qeveris.

Përfaqësuesi i teorisë klasike mbi menaxhimin, Henry Fayol, menaxhimin e definonte si "parashikim, planifikim, komandim, koordinim dhe kontroll në procesin e arritjes së qëllimeve të kompanisë (Ramosaj,2004:26).

Në fushën e arsimit, nocionet menaxhim dhe administrim shkollor në gjuhën shqipe përkthehen si drejtim dhe qeverisje shkollore.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë, kuptojmë se menaxhimi është sinonim i fjalëve drejtim, administrim, udhëheqje.

Nocioni drejtor rrjedh nga latinishtja director – drejtues, udhëheqës i një institucioni ose i një organizate punuese (Ndreca, 2007:140).

Drejtor është nëpunësi që drejton një ndërmarrje, një institucion, një sektor të administratës qendrore, etj (ASHSH, 2005:214).

Ai/ajo është personi që drejton, planifikon, organizon, kontrollojnë dhe është përgjegjës/e për të ardhmen e organizatës, institucionit.

Në fushën tonë të studimit, kuptimi i nocionit drejtor ka të bëjë me drejtuesin, udhëheqësin e institucionit arsimor – shkollës.

Nocionin shkollë mund ta gjejmë në një numër të madh përkufizimesh.

Në “Fjalorin e psikologjisë”, nocioni shkollë rrjedh nga greqishtja, që do të thotë - lexim, shpjegim i veprave shkencore, dhe ky nocion shpjegohet si institucion edukativo–arsimor, në të cilin organizohet veprimtaria e edukimit dhe e arsimimit të brezit të ri sipas planit dhe programit të caktuar në bazë të bashkëveprimit të arsimitarëve dhe nxënësve. (Nushi,1987:285).

Po ashtu, shkolla është institucion i organizuar dhe i specializuar për edukimin e nxënësve (Kraja,2002:75)

Rrjedhimisht, mund të thuhet se shkolla është një institucion, qëllimi i së cilës është edukimi dhe arsimimi i nxënësve. Shkolla duhet të mbështesë zhvillimin e personalitetit të nxënësve, të respektojë nevojat, interesat dhe të veçantat e nxënësit.

Që një shkollë të jetë efektive, faktorët kryesorë janë: Udhëheqja e fortë administrative, pikënisjet e qarta shkollore të ndërthurura nga aftësia mendore dhe administrimi, ambient i sigurt dhe i disiplinuar shkollor, kontroll dhe vlerësim i shpeshtë i përparimit të nxënësve, kërkesa të larta ndaj përparimit të nxënësve (Sadker dhe Sadker,1995:224).

Vazhdimisht ka debate nëse udhëheqës i suksesshëm mund të bëhet kushdo, apo ekzistojnë predispozita të veçanta për t’u bërë udhëheqës. Që të bëheni udhëheqës, ju duhet ta kuptoni qartë dhe mirë se udhëheqësi efektiv në rend të parë duhet të jetë njeri me virtyte të larta njerëzore dhe humane, aftësi të larta akademike, organizuese, me shprehje dhe kulturë të lartë pune. Vetëm nëse jeni njeri i vërtetë, me virtyte të larta njerëzore, me energji pozitive, aftësi për të tërhequr njerëz, ju do të siguronit përkrahës, bashkëmendimtarë, njerëz që ju besojnë dhe që do të vijnë pas jush (QAK,2003:12).

Mund të ndodhë që ju të zgjidheni udhëheqës, që të siguronit njerëz dhe pasardhës, të keni aftësi intelektuale, mirëpo, po si patët virtytet njerëzore, ju nuk do të jeni i suksesshëm për një kohë të gjatë, ju do të pësoni sepse nuk do të arrini ta kryeni një kohë të gjatë këtë punë.

Nëse krahasojmë dy shkolla që janë në të njëjtin vend me numër përafërsisht të njëjtë të nxënësve, me mësimdhënësnë të përgatitur profesionalisht, në njërën shkollë arritja e rezultateve është shumë më e lartë se në shkollën tjetër, atëherë shtrohet pyetja se çfarë e bënë atë shkollë më të mirë. Pse duhet të ketë dallime të tilla? Përgjigjja është e thjeshtë: drejtuesi i suksesshëm e ka misionin e qartë për shkollën. Drejtuesit e suksesshëm sigurojnë drejtim orientues. Ata harxhojnë më shumë nga koha e tyre për të punuar me nxënësit dhe më pak nga koha e tyre e zyrës. Ata janë aktivë dhe të angazhuar dhe për pasojë krijojnë shkolla që sjellin një ndryshim pozitiv në jetën e nxënësve (Sadker dhe Sadker,1995:224).

Disa nga këto shkathtësi menaxhuese më të rëndësishme të drejtorëve të shkollave janë: shkathtësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit, shkathtësitë për të vlerësuar

dhe zhvilluar stafin e shkollës, shkathtësitë për planifikim dhe organizim, shkathtësitë për zhvillimin e kurrikulës shkollore, etj.

Që ajo shkollë të jetë e suksesshme dhe cilësore, janë dhe shkathtësitë komunikuese dhe bashkëpunuese të drejtorit të asaj shkolle. Komunikimi, bashkëpunimi dhe aftësia për komunikim e bashkëpunim është një aktivitet shumë i rëndësishëm i drejtorit për menaxhim të mirëfilltë, informatat duhet të kuptohen, të pranohen dhe të barten.

Problemi themelor i një shkolle është procesi i të mësuarit. Por, sa është arritur ky proces, sa kanë arritur nxënësit të mësojnë, në ç'shikallë ka mësuar nxënësi, kjo i intereson vetë nxënësit dhe mësime të mësimit. Sikur që për mësime të mësimit është i rëndësishëm kontrolli dhe vlerësimi i nxënësve, ashtu edhe për drejtorin e një shkolle është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm vlerësimi i performancës së mësime të mësimit dhe anëtarëve të tjerë të shkollës.

Inspektimi arsimor, duke qenë, në thelb, vlerësim, është gjykim që orientohet nga kriteret për nivelin cilësor të vlerave ose të arritjeve arsimore. Prandaj, të inspektosh do të thotë të procedosh mbi bazën e të dhënave të përfituara nga monitorimi, për të gjykuar për efektshmërinë e procesit dhe për vlerat dhe meritat e produktit (ISP,2003:100).

Gjatë procesit të monitorimit drejtori mbledh informacionet e duhura, vlerëson performancën e mësime të mësimit dhe harton planin për zhvillimin e mëtutjeshëm të stafit të shkollës, hapat dhe aktivitetet që duhet t'i ndërmerret, përkrahjen që mund t'i ofrojë. Me anë të monitorimit apo të mbikëqyrjes së vazhdueshme drejtori kupton se si është gjendja tani dhe se çfarë po kërkon të arrijë në shkollën që udhëheq, cilat janë qëllimet dhe objektivat. Ai kupton se a është mësime të mësimit i përkushtuar për mësime të mësimit dhe arritje të rezultateve tek nxënësit, a e njej fushën e vet profesionale, planin, programin mësues, a zotëron teknika të llojllojshme të mësime të mësimit dhe të vlerësimit, menaxhimin e punës dhe disiplinës në klasë. Pas monitorimit që bën në klasë, mund t'i japë këshillat e duhura mësime të mësimit, në cilën pikë mësime të mësimit ka mangësi dhe ku kërkohet përmirësim për arritjen e rezultateve sa më të mira në mësime të mësimit.

Të aftësohen nxënësit për dallimin e dukurive gjuhësore dhe përdorimin e rregullive të saj drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore. Ky objektivi synon përdorimin e drejtë gramatikor të gjuhës.

3.4. 1 Analizë mbi objektivat e përgjithshëm

Mbështetur në analizën e objektiveve të përgjithshëm vërehet se i kushtohet rëndësi disa elementeve si:

- aspektit ndërveprues, i cili është integruar me aspektin etik dhe zhvillimor mendor
- kreativitetit të nxënësit, të ndërthurur me zhvillimin e mendimit kritik
- aspektit shprehës, gjuhësor dhe komunikativ
- përdorimit të gjuhës në aspektin etik dhe funksional të saj në situata reale jetësore
- aftësimin për strukturimin e ideve dhe mendimeve në formë të shkruar
- përdorimit gramatikor dhe drejtshkrimor të gjuhës

Nga analiza e mësipërme vërejmë se objektivat e përgjithshëm e kanë vënë theksin kryesisht në aspektin shprehës të gjuhës nëpërmjet të folurit dhe të shkruarit, përdorimit të drejtë gramatikor aspekteve ndërvepruese, etke dhe funksionale, ndërkohë që është anashkaluar zhvillimi i anës kuptimore të saj. Në objektivat e përgjithshëm nuk vërehet synimi për të zhvilluar dhe konsoliduar të kuptuarit si në aspektin dëgjimor, ashtu dhe nëpërmjet materialeve të lexuara. Edhe pse katër fushat e studimit kanë në përbërje të tyre të lexuarin dhe të dëgjuarin në objektivat e përgjithshëm nuk është reflektuar dhe integruar fokusi për zhvillimin e këtyre aftësive. Një element tjetër që vërehet janë kërkesat e larta të arritjeve që synohen në këtë klasë. Kështu folje si "ngre hipoteza" shkon përtej potencialit të nxënësit në klasë të tretë. Përtej duhet theksuar se objektivat e përgjithshëm të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë nuk përfshijnë objektiva që synojnë t'u mësojnë nxënësve të përdorin strategjitë e të kuptuarit, me qëllim përfutimin e mekanizmave të të kuptuarit.

3.5 Nënlinjat e të lexuarit

Nënlinjat e të lexuarit synojnë zhvillimin e:

- të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion;
- të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave;
- të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës;
- të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare;
- të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje;
- njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.

3.5.1 Analizë mbi nënlinjat e të lexuarit

Nënlinjat e vënë theksin në të kuptuarin e teksteve, në rritjen e motivimit për të lexuar, për përdorimin e mesazheve dhe informacioneve, dallimin e veçorive që karakterizon gjinitë e teksteve të ndryshme, anën intonative të gjuhës, si dhe përdorimit të drejtë të saj, në aspektin gramatikor. Vihet re se aftësia për të sintetizuar ka marrë rëndësi të veçantë, pasi është trajtuar në një nënlinjë të veçantë. Nënlinja " *Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje*" përmban vetëm objektiva që e aftësojnë nxënësin të konsolidojë anën intonative dhe shprehëse të gjuhës me zë të lartë, dhe nuk përfshijnë objektiva që mundësojnë rritjen e të kuptuarit me anë të leximit në heshtje. Në pamje të parë nënlinjat shpalosin qëllimet e të lexuarit.

3.6 Objektivave specifike të të lexuarit.

Në objektivat e linjës së të lexuarit *synohet që nxënësi:*

Të lexojë në mënyrë të tillë që të kuptojë informacionin që merr nga fusha të ndryshme. Theksi është vënë mbi rolin e të kuptuarit në aspektin ndërlëndor. Objektivi nuk është specifik, pasi shprehja "në mënyrë të tillë" është i paqartë si kriter.

Të lexojë për të kuptuar materialin që i jepet për qëllime të ndryshme. Ta interpretojë bukur atë që lexon. Objektivi ka parasysh aspektin intonativ dhe rolin e tij në të kuptuar. Edhe pse objektivi citon qëllimin e të lexuarit nuk specifikon qëllimin e të lexuarit si për t'u informuar, argëtuar, dalluar të rëndësishmen nga më pak e rëndësishmja, krahasuar, analizuar, dalluar të përbashkëtat etj.. Rrethanori "bukur" është i pamatshëm.

Të zhvillojë e të pasurojë dëshirë, ëndrra e ndjenja vetjake, i nxitur nga leximet që bën. Objektivi ka për qëllim të mundësojë zgjerimin e skemave, pasurimin konjitiv nëpërmjet të lexuarit. Përtej rëndësi i jepet përdorimit të informacionit të asimiluar për ta përdorur në aspektin personal. Objektivi mbart nota frymëzimi që lidhen me motivimin dhe shtysën e nxënësit për të lexuar.

Të kuptojë idetë, mendimet dhe ndjenjat e shkrimtarit në pjesët që lexon. Objektivi është trajtuar në kontekst të gjerë, pasi folja *kuptoj* mbart në vetvete disa procese si: të lexojë mes rreshtave, të dallojë nëntekstin, të perifranojë, të interpretojë, të përdorë kontekstin për interpretimin e ngjarjeve, etj..

Të argumentojë duke u mbështetur në të dhënat e pjesës që lexon. Objektivi synon që nxënësi të identifikojë të dhëna që i përdor si argumente për të bindur, kundërshtuar, sugjeruar etj..

Të nxjerrë çështjet kryesore që trajtohen në pjesën që lexon. Ky objektivi e vë theksin në përfundimin e aftësisë për të dalluar të rëndësishmen nga më pak e rëndësishmja si dhe të përzgjedhë thelbin e ngjarjeve.

Të shprehë mendimin e vet për situatat që ndodhin në pjesët që lexon. Të analizojë me

fjalë të thjeshta sjelljen dhe veprimet e personazheve kryesore në pjesët që lexon. Objektivi synon të aftësojë nxënësin të përdorë informacionin për të arritur në përfundime, të mbajë qëndrim duke justifikuar pozicionin e tij të mbështetur në të dhëna që bindin bashkëbiseduesin.

Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të fushave të ndryshme tematike. Zgjerimi i leksikut dhe skemave, ndikon në të kuptuarin e teksteve, por kemi të bëjmë me një objektiv të përgjithshëm dhe jo specifik, pasi fushat tematike mbeten të papërcaktuara.

Të njohë gjini dhe lloje letrare të tilla, si: përralla, tregimi, vjersha, fabula e gjëgjëza, duke dalluar elementet e thjeshta gjuhësore që i dallojnë ato nga njëra –tjetra. -Të njihet me gjuhën dhe veçoritë e veprave letrare. Objektivi ka në fokus dallimin e strukturës së teksteve, elementeve strukturore dhe përmbajtësore të tyre. Folja " të njohë" është jo specifike dhe e matshme, e njëjta gjë vërehet kur citohet "dallon elementet e thjeshta gjuhësore", këto elemente janë të papërcaktuara. "folja" të njihet me veçoritë është e pamatshme si dhe veçoritë nuk specifikohen.

Të lexojë, të interpretojë, të recitojë dhe të luajë në role pjesë të thjeshta në prozë a poezi. Objektivi synon konsolidimin e aftësive intonative dhe shprehëse.

3.6.1 Analizë mbi objektivat specifike të lëndës.

Fokus në fushën e të lexuarit është:

Konsolidimi i të kuptuarit dhe roli e tij në kuadrin ndërëndor. Në program nuk është integruar leximi i teksteve informuese, por fokusi është vënë kryesisht në trajtimin e teksteve narrative. Ndarja në tekste narrative dhe informuese, do të ishte më e saktë, si dhe një specifike e teksteve sipas funksioneve përshkruese, argumentuese dhe rrëfyese do të krijonte një panoramë më të plotë të formimit të nxënësit dhe prezantimit të tij me elemente strukturore të teksteve informuese.

Elementi intonativ dhe roli i tij në të kuptuar. Përfitimi i aftësisë së rrjedhshmërisë në të lexuar është një komponent i rëndësishëm që ndikon në cilësinë e të kuptuarit. Studimet shkencore kanë provuar se gjuha e konsoliduar në aspektin shqiptues, ku ndërthuren elemente si saktësia, rrjedhshmëria, prozodia dhe intonacioni është një parakusht për realizimin e të kuptuarit cilësor. Në fakt programi synon një element të vetëm që është ai intonativ dhe nuk e trajton rrjedhshmërinë dhe shprehinë e të lexuarit në tërësi. Aftësimi i përfitimit të rrjedhshmërisë është parakusht për të kuptuarin cilësor, pasi referuar studimeve psikologjike lidhet me faktin se nuk mund të kryhen dy veprime konjitive të njëkohshme. Një nxënës që has vështirësi në dekodimin e informacionit, e ka shumë të vështirë për të realizuar të kuptuarin, pasi vëmendja e tij është përqendruar në dekodimin e tekstit.

Fjalori. Zgjerimi i skemave të fjalëve dhe pasurimi konjitiv nëpërmjet të lexuarit ndikon në të kuptuarin e gjuhës si dhe në rritjen e aftësisë shprehëse. Leksiku zë një vend të rëndësishëm në të kuptuarin e teksteve. Studime të shumta kanë provuar se leksiku përbën një barrierë serioze për realizimin e të kuptuarit. Sipas teorisë së skemës, sa më të zgjeruara ato dhe sa më e konsoliduar dija paraprake aq më e lehtë bëhet për të asimiluar dhe akomoduar informacionin e ri. Njohja paraprake ka një rëndësi themelore në integrimin dhe ndërtimin e dijes së re dhe në këtë kontekst, interpretimi, përkufizimi dhe përdorimi i fjalorit zë një vend të veçantë.

Zhvillimi i aftësive analitike. Aftësitë analitike supozojnë detajimin e elementeve përbërëse dhe montimin e tyre në një të tërë duke krijuar lidhje funksionale. Trajtimi i

problemeve nga këndvështrime të ndryshme, apo analiza se si janë trajtuar elemente të ndryshme në tekstet e leximit, ndikon në formimin e nxënësit dhe rritjen e aftësisë së tij analitike dhe bindëse. *Nxjerrja e argumenteve*, synon aftësimin e nxënësve për të identifikuar, përzgjedhur dhe dalluar elementet e rëndësishme nga ato më pak të rëndësishme.

Struktura e teksteve. Në program i është dhënë rëndësi strukturës së teksteve, por nuk janë specifikuar elementet strukturore të cilat do të dallojnë nxënësit. Përtej përdorimi i organizuesve grafikë që e ndihmon nxënësin të qartësojë panoramën e ngjarjeve, dhe raportet mes tyre nuk është integruar.

3.6.2 Këndvështrim mbi hartimin e objektivave

Nga vëzhgimi i kujdesshëm që iu bë objektivave specifike u vërejt se objektiva të caktuar nuk janë specifike dhe të matshëm, gjë që ndikon në përmbushjen e tyre dhe arritjet e nxënësve. Kështu në program hasen objektiva që përmbajnë më shumë se dy folje si p.sh: *-të njohë dhe dallojë; -të dallojë dhe analizojë*; objektiva të ndërtuar me folje të pamatshme *"të njohë", "të kuptojë", "të lexojë me dëshirë" "të respektojë"*, si dhe me kriteret të paqarta si *"në mënyrë të tillë që", "bukur", "me ndjenjë", "tërësisht", "sipas fushave të ndryshme tematike" etj.*

Përtej konsolidimit të aspektit intonativ një pjesë e objektivave që lidhen me aftësitë shprehëse janë integruar dhe synohen të përmbushen në aftësinë e të lexuarit.

U ndeshën objektiva që janë mbi nivelin e moshës së nxënësve në klasën e tretë. p.sh.: objektivi *:-Të japë udhëzime të thjeshta rreth mënyrës më të mirë të të lexuarit të teksteve që japin informacione, porosi, udhëzime për veprimtari të ndryshme.*" Ky objektivi është larg nivelit, aftësive dhe potencialit të nxënësit të klasës së tretë, pasi supozohet se nxënësi është një lexues i mirë strategjik dhe mund të ndihmojë bashkëmohatarët që nuk e kanë arritur këtë aftësi. Vlen të theksohet se në kurrikul nuk synohet mësimdhënia e strategjive të të kuptuarit, ndërkohë që objektivi synon që nxënësi e ka konsoliduar këtë aftësi dhe duhet ta ndajë me të tjerët. Kjo lloj inkoherence e vë në vështirësi mësuesin dhe nuk i shërben formimit të nxënësit. Një tjetër element për t'u diskutuar ka të bëjë me faktin se në objektivat specifike citohen "tekste që japin informacione", por në gjinitë e përcaktuara në program, nuk janë përfshirë tekstet informuese.

U ndeshën objektiva që kanë karakter shprehës, ndërkohë që janë integruar në linjën e "të lexuarit". Përtej përmbushjes së aftësisë së të kuptuarit programi synon etapën e zbatimi dhe përdorimit të njohurive dhe aftësive në situata reale të të nxënësit. Elementet shprehëse që lidhen me aftësinë e të folurit dhe interpretimit ndeshen në nënlinjën e të lexuarit. p.sh. *Të luajë në role figura të personazheve të tregimeve dhe të përrallave që ka lexuar.* Objektivi: *-Të lexojë, të interpretojë, të recitojë dhe të luajë në role pjesë të thjeshta në prozë a poezi*, ka të bëjë me aspektin interpretativ, dhe intonativ të gjuhës, i cili lidhet me aftësinë gjuhësore të të folurit. Pa zbehur rolin e aspektit intonativ, i cili luan një rol të rëndësishëm në të kuptuar, në objektivi theksi është vendosur tek aftësitë shprehëse dhe jo ato kuptimore.

3.7 Përmbledhje e analizës

Në programin e klasës së tretë gjuhë shqipe synohet aftësimi i nxënësve për të arritur:

- të zgjerojnë skemat leksikore aktuale
- të informohen nga burime të ndryshme informacioni
- të gjenerojë pyetje

- të analizojnë
- të përmbledhin
- të vlerësojnë
- të mbajnë qëndrime

Programi i klasës së tretë në gjuhën shqipe nuk ka integruar mësimdhënien e strategjive të të kuptuarit dhe nuk synon t'i mësojë nxënësit se si të:

- përcaktojnë qëllimin e të lexuarit;
- parashikojnë nëpërmjet titullit, figurës dhe elementeve të tjera gjatë tekstit;
- monitorojnë të kuptuarin dhe përshtatin strategjitë e të kuptuarit, kur nevojitet;
- të dallojë kur të kuptuarit është shkëputur, të qartësojnë të kuptuarin duke rilexuar pyetur dhe ndryshuar parashikimet;
- reflektojnë mbi mënyrën e të kuptuarit;
- lexojnë ndërmjet rreshtave, duke lidhur njohuritë paraprake me informacionin e tekstit dallojnë nëntekstin;
- përdorin grafikët organizues;
- përmbledhin duke nxjerrë idenë kryesore, konceptet kyçe, veprimet kyçe, dhe detajet mbështetëse.

4. Konkluzione

Nga analiza që iu bë kërkesave dhe objektivave të programit lëndor të "Gjuhës Shqipe" klasa e tretë vërehet se programi lëndor synon zhvillimin mendor të nxënësve në nivele të larta konjitive si analiza; krahasimi; sinteza, vlerësimi dhe mbajtja e qëndrimeve. Përtej, nga analiza u arrit në konkluzion se programi nuk synon mësimdhënien e strategjive të të kuptuarit duke mos synuar formimin e një lexuesi të pavarur, që i jep zgjidhje situatave kur të kuptuarit vështirësohet. Kjo qasje provon se në thelb kurrikula aktuale nuk i mëshon qasjes pedagogjike "t'i mësojmë nxënësit, si të nxënë". Programi i mëshon konsolidimit të aftësive konjitive, sipas niveleve të arritjeve por mënyrat dhe mekanizmat mbi arritjen e aftësive nuk janë shqyrtuar. Arritjet e nxënësve janë trajtuar në frymën e produktit, pa e vënë theksin tek procesi dhe strategjitë që e çojnë nxënësin drejt cilësisë dhe përfutimit të aftësive.

Referenca

- Agjensia Kombëtare e Provimeve, (2014, 2015). Raport publik Vlerësimi Kombëtar për lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë, Dituri natyre, klasa 3 dhe 5.
- Durkin, D. (1993). Teaching them to read (6th ed.). Boston, MA. Allyn & Bacon.
- Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve, Programi i gjuhës shqipe, klasa 3, 2005.
- Mier, M. (1984). Comprehension monitoring in the elementary classroom. Reading Teacher, 37, 770-774.
- National Reading Panel. (2000). Teaching children to read: An evidence-based assessment of the scientific research literature on reading and its implications for reading instruction (NIH Publication No. 00-4769). Washington, DC.
- Rosenshine, B. & Meister, C. (1994). Reciprocal teaching: A review of the research. Review of Educational Research, 64, 479-530.
- Rosenshine, B., Meister, C., & Chapman, S. (1996). Teaching students to generate questions: A review of the intervention studies. Review of Educational Research, 66, 181- 221.

Reflections about the concept of being in the world and the coexistence with the other

Jetmira Fekolli
University of Tirana

1. Interpretation of the thought about the individual-society relationship

We usually come to know ourselves by basing our own experience on the contacts that we have with the outside world. Even Williams James, who is one of the founding fathers of psychology, has said that understanding who we are, the sense of "me" (knowing) is a result of the experiences that we have with the others. Social comparison is one of the tools that we use to learn about ourselves. We can determine our math skills by comparing our achievements with those of the others. Leon Festinger, best known for his research on the social comparison, thinks that our self-esteem is directly influenced when we compare ourselves with the others (Leon Festinger, 1954). We tend to make the individual responsible for everything that happens, for every social problem. Durkheim thinks different. Society is composed by social facts that overcome our intuitive sense.

When people answer the question "who am I? They tend to focus on things that are exclusively applied to them, and they described themselves as unique when compared with the others. For example, children answered this question by saying whether they are boys or girls, especially when they come from a family where their gender does not constitute the majority of family's gender (McGuire, 1981). So, by being the only boy in the family, being the only male, it makes you different and you become part of the respective self-concept. In the same way, people prefer to mention their race and ethnicity, especially when these characteristics make them distinctive, or they prefer to say that they are fat or slim when these qualities are special and exclusively applied to them (McGuire, 1978).

The modern era with its philosophy went back to reasoning by giving us a new idea about individualism. What are some of the determining features of this kind of individualism? Firstly, we have the secularism of society. Since the Renaissance, the dominance of European society by Christianity was shaken. The natural right was modernized, which meant that this right was valid if God was not existent. Now the reason gained its place by throwing away every element of faith. So, the stoic individualism and then the Christian one, appeared in a purer way. The modern individualism took from stoicism the idea of a harmonious and transcendental cosmos with humanity. Now, the society came to be determined as a product of a union, of a contract reached between independent individuals. That's how the modern freedom began to develop its own features of the rule of law. Of course, this process was also influenced by other historical social factors of the new era that was being born. As a result, Protestantism began to favor capitalism and, consequently, the individualism of the market economy. Completion of legal systems by the end of the XVIII century and the beginning of the XIX century consolidated the safeguards and guarantees of individual freedoms. The crisis of the collective values left its place to the individual

of this world. It was the time when Niche wrote: God died. Individualisms? Is it an epiphenomenon or an essential phenomenon of contemporary societies?

2. The history of philosophy of the concept of being in the world and the coexistence with the other

The philosophical history of this concept showed us that there are two tendencies in its origins. The first is that of the Sophists who saw social order as a result of an agreement. Against this tendency, Plato said that in this case the citizens could be manipulated by deceitful and savage lazy people who covet power, and then democracy destroys itself and by doing that, it is endangered by chaos. The second tendency is that power should be given to the smartest one, the most reasonable one, who knows the world order and thus is able to design a free society. The first tendency is individualistic in the political sense of the word, whereas the second tendency is philosophical. The individual rules as long as he is guided by reason. We find this opposition more or less in every society. To better illustrate this, let's give the criticism that Karl Popper makes towards the theory of revolution made by the Marxists. According to Marxists, the revolution will lead to a better society than it will replace the old gentlemen with new "companions". But who assures us that these young people will be the best? –Popper asks¹. The theory of revolution goes on further. Popper forgets the most important aspect of social life, that what we need is not so good people as good institutions.

Because of Russell's work in logic and Wittgenstein's formulation of the logic connection with language, they now had the other argument that metaphysics is impossible, as indicated by the logical and essential character of the language. To distinguish themselves from the earliest Contextual Positivists and to emphasize that they would combine the stringent new logic techniques with the empirical temperament of the Hume, they called themselves Logical positivists or sometimes Logical Empirists. This position required complete denial of metaphysics, and arguments for this denial are found in the famous Vienna District Principle. Their ideal was to clarify the language of science and sciences and their primary task would be to formulate a standard over clarity. So this was their famous principle: the principle of Verification. Time would indicate that this principle suffered from some defects and it was required so much effort and attempts to change it. Since ancient Greek philosophy we face with the issue of the relationship between the individual and his city. In Socrates's philosophy we see the opposition of the individual to traditional authority (mainly based on prejudices or religion). In this way, the person put the imperative of his consciousness in front of such authority, that is, a human power can be called legitimate if he passes the test of the criticism of philosophy. So, in its essence, is this power in accordance with the principles recognized by reason, by the so called "logos"? So, there is an individualistic feature in the beginnings of the moral philosophy. Is the individual who reveals the good, the only judge is his conscience, and there is no collective or factual tradition that applies to this criterion. Of course that such a conception of the conscience, which will later be called as "free thought", should not be identified

¹ Karl Popper "Philosophy and science" Tirana

with the arbitrariness of unmotivated subjective choices of individuals' actions. Consciousness is not merely a tendency, a desire, a hiccup "to the criticisms that Plato did to the Sophists because, then the mess would reign, and in this case Socrates could be criticized as a supporter of anarchy and decadence. But Socrates and Plato are opposed to such a chaos, against extreme individualism. They were in favor of the general, the "polis", through a self-restitution. The individual must attain to evaluate his specialty and thus discover the essence of the basic virtues (justice, mercy, etc.) Thus, the individual manages to accord with the harmony of the universe, regenerates the lost unity, he agrees with his relatives as long as they are as fit as himself. At the core of their philosophy lies the idea that the wise man is happy. Nobody converts into a bad person voluntarily.

People have the right to choose their own lifestyles, to knowingly decide what beliefs to embrace, to define life forms in a variety of ways their predecessors could not control. In principle people are no longer sacrificed on the altar of so-called sacred ladies that go beyond them. Modern freedom was gained by exploding the old moral horizons. People looked at themselves as part of a larger order. In some cases, it was about a cosmic order, a "great chain of being" where humans were brought to their place with angels, heavenly bodies, and other earthly creatures. This hierarchical order in the universe was also reflected in the hierarchy of human society. The objects that surround us were not just raw material or potential instruments for our projects, but also possessed the pervasiveness of the country that occupied the chain of being. Based on that same logic, the rites and norms of society had something more than merely an instrumental significance. Of course, almost all subsequent thinkers have not upheld Plato's utopia for the king-philosopher. Thus Aristotle's attitude is more versatile, because it requires a mixed constitution, a kind of balance between the principle of monarchy (as a principle of unity and order) and that of democracy (the principle of freedom and individualism). It is worth dwelling on what is essential in these reasoning. The end of civilization and that of Greek organization, which was based on the "polis", made the individual to face himself. It is precisely this moment that Hegel considers the emergence of subjectivity. As stated above, the Greek city formed a real organization. He did not think that there was a distinction between private and public sphere. Being free, according to the Greek philosophical concept, did not mean to create a space around the individual where power could not penetrate, but not being governed by a higher power. Political power could penetrate into the individual's private life for the sake of harmony of the general order. Individualism is considered as a product of modernism, as the main feature of our society and in the cultural context, it plays a major role in contemporary philosophical and ideological debates. But discussing this problem should be detached from the ideological language in order for us to understand the relevant philosophy. Thus, in the Renaissance, we can say that God was extradited and the reason became dominant (a paradoxically outlined dichotomy, because God cannot be understood without the indispensable help of reason), and here, we can mention Averroes, Avicenna and Thomas of Aquinas, thus disconnected not only from God and what the God represents, but from all the order that is related to him, the order with which man was connected at the very beginning. Taylor confirms this thing when he says: "People looked at themselves as part of a greater order. In some cases it was about a cosmic order, a "bigger chain

of Being” where humans were brought to their place together with angels, celestial bodies, and other earthly creatures. This hierarchical order in the universe was also reflected in the hierarchy of human society. The objects that surround us were not just raw material or potential instruments for our projects, but they also possessed the pervasiveness that the land that they occupied gave in the chain of Being (Taylor, 2008, 83).

Thus, the man saw himself as part of a sublime and harmonious whole, through which he understood not only his role in relation to the hierarchy of this universe, but also understood his mission for which he was motivated and therefore ready to sacrifice everything. Even the Heidegger’s critics about the thought and the process of thinking, are quite significant in this regard. First, Heidegger knew the limits of thought, implicitly saying that the process of thinking is simply an opportunity for man, through which one can cast even a little light on his being, on Dasein. Taylor says that “the items that surround us” were not just raw materials or potential instruments about our projects, but they also possessed pervasiveness that the country was giving to the chain of Being. Therefore, it is the individual as a self-end and as a disengagement from this chain that causes the deep crisis of being because by being disengaged from this chain, from this whole, or from this excellence, individualism can be alienated and can lose its role in this order (Taylor, 2008, 83).

So it is the group and not the individual who dominates the social universe that sociologists call community. It should be noted that this community is homogeneous and hierarchical, that is, every individual is determined by his relation to a certain whole, which imposes on him a strict conformation, a very precise code of attitudes and rites. While the hierarchy is characterized by the fact that each individual must occupy a certain place within this community, it does not have individual requirements formulated in absolute terms, but it must be sacrificed, devoted to common interests. Thus the individual is reduced to the state of one's own, of an object.

Other thinkers like Ferdinand Tonnies likes to put the individual in front of the concept of community. In this case, we have a society where priority is given to individuals who possess a basic freedom gap and are legitimately seeking to fulfill their interests. At first glance it seems like we are dealing with an anarchic order. But this is not the case, because the normal functioning of society is achieved through compromise or conventions, which make it possible to create an order where individualism must not live in anarchy. Don’t just the different acts and conventions have this role in the national and international level for human rights and freedoms? In order for us to understand this reality, it must be seen the impact that philosophy has had in the development of individualism. Even the best man can be corrupted by power, but the institutions that allow the governed to exercise effective control over the leaders and rulers, will even compel the worst leaders to do what the governed consider it as in their own interest. In other words, we would like to have good leaders, but the historical experience shows us that we are not able to find them. That is why it is important, concludes Popper, to design institutions that prevent bad executives from causing great damage. Now we are living in a time when the design of such institutions is happening every day, and the fate of democracy will depend on such design.

Individualism is one of those phenomena that has been treated by many thinkers and

philosophers, especially during the last two centuries. This has occupied a great deal of space in the works of Nietzsche, Heidegger, Sartre, Guenon, Vattimo and many others. Given the fact that this phenomenon is directly related to man and to the space that he occupies after being casted into existence, of course this thing cannot be interpreted differently. Even in Taylor's point of view, individualism occupies a special place, but unlike Haidegger and Guenon, Taylor treats it mainly in the sociological field, despite the fact that he mentions the fact that individualism appeared when the man was detached by the so called "The Great Chain of Being", which is a plan that Heidegger has included a lot in his work. Individualism is not a new phenomenon. In essence, it is nothing but the revival of the old selfishness of the ancient Greece. Individualism was born in the European Renaissance, as it is known that Renaissance is precisely the repatriation of the heritage of the Greeks, mainly of the thought and of the art of that period. The quote of Protagoras that "man is the dimension of everything" (Durkheim, 2011) is basically the same as Descartes's well-known thesis: "Cogito ergo sum" (I think, so I exist), which means that in some way my existence begins when I think, that is, I can give meaning to existence only through thought, so consequently thought is the one that defines everything. The basic nature of a person is not individual affirmation. It doesn't extend to partition, but to communication. For a spectator of human drama, this truth is far from self-explanatory. Man is necessarily either tyrannical or a slave. My freedom is limited when I am in the presence of another person. Individualism is a system of morals, feelings, ideas and institutions in which individuals can be organized by their mutual isolation and protection. This was the ideology and the dominant structure of Western rich society in the 18th and 19th centuries. This is the antithesis of personality with the enemy of individualism. The essence of modern society and relationships with man have changed in the modern world. But this era came later to us. But even though we have been in this era for more than two decades, it seems that in our people's concepts there has been a real "revolution". This is the quintessence of the struggle of our people who have now entered individual battles to be "someone" to be a being with a personal identity, because the thing that was supposed to happen, has finally happen in our lives. Now we live in a new social era, in a new era for human relationships, which is a new stage in the "life drama". Of course, "The Wilsonian idea" that people in society are related with each other as individuals, might be a little bit exaggerated for our time. Because despite the super-coltivism deformations that our society has had in the past, despite the deep tendency of individualization of life as an expression of social modernity, we must recognize that people need a "mass of socialization" even in the conditions of modern life. The pragmatist philosopher John Dewey says, "People have always been socialized in living and socialization in related behaviors has influenced their relationships with each other as individuals"².

3. Efforts for the studying of the Albanian reality about the individual-society relationship

4.

² Dewey John: "the public and its problems", pg. 102, Quote taken from "Someone or no one?", taken from www.gazetametropol.com, 28.10.2010

Among the representatives of neo-Albanianism, VangjelKoçe is the one who is mostly noticed in the conceptualization of philosophy. He, by basing his ideas on such a methodological criterion such as the construction of philosophy, he takes into account the need of Albania developed philosophical thought. He considers philosophy as an introduction to the way in which it is developed and tries to elaborate the methodology used by Descartes to explain the functioning of philosophy from its particular point of view. He accomplishes this by defining a philosophical examination scheme that expresses not only the connection between basic concepts but, at the same time, warns the instruments that serve to realize the structure of philosophical thought. Taking into consideration the E. Durkheim's scheme regarding the conception of society, one can understand in what he says that society is not a mere cluster of individuals, but a system formed by their interaction that presents a special reality and that it has its own special characters. There is no doubt that there can't be anything collective if the particular elements are missing, but even this necessary condition is not enough. There must be something else needed. There is something else: these elements must be connected and intertwined, and even intertwined in a visible way. Within his conceptual scheme, E. Durkheim supports his point of view when saying that there is no individual without a society. For VangjelKoçe, our historical condition, given the fact that it is not that much developed, produces individualism, which appears as a force acting against negativity and does not affect raising the level of conscience in general. For VangjelKoçe, the self-individual and the whole of selfs are part of the past, the present and the future of the society.

According to him, the goal of neo-Albanianism was to create a mental life as well as to the social supportive principles of national life. According to him, the neo-Albanian doctrine, as in all logical plans, programs and bills, was aimed at improving this rule, perfecting its functions and overcoming the shocks, possessing justice, laws, and peace. Not the state as a state, but the state and social feeling is the shaking power of every essential human action, because the Albanian society was at an intermediate stage between the governing of collective rule and a given solution which was based on the strength. The first represented society, while the second represented the state. The philosophy of thought was necessary for the creation of national sentiment, which stood above that of tribe and religion. Most prominent representatives of neo-Albanianism have been trying to giving a sense of self to the individual-society relationship. It is a very much treated problem, but still unresolved in our opinion. This treatment should include issues related to structure, social organization, political institutions that combine the individual-society relationship. In a society, all forms of association have distinct structures that allow analysis and definition of their elements, as well as the way they operate together as a whole within the structures. Of course, the elements of the structure are clearly visible or hidden in relation to their functions.

The most important thing is the effort of the most prominent representatives of neo-Albanianism, such as B. Merxhani, V. Koça, to illuminate this problem. You get the perception that VangjelKoça supports the thought of e. Durkheim. In one of the pages of the magazine "The Efforts of Albania", we find the e. Durkheim quote when he says: "Society is not a simple gathering of individuals, but a system formed by their interaction that presents a special reality that it has special characters. There is no

doubt that there can't be anything collective if the particular elements are missing, but even this necessary condition is not enough. There must be something else needed. There is something else: these elements must be connected and intertwined, and even intertwined in a visible way. This combination produces social life". We think that these explanations may not be that complete, given that the analysis of society made by the leading representatives of neo-Albanianism approaches the problems of the individual-nation relationship. Researcher Gani Bobi in the "Cultural Paradox" study defines the leading representatives of neo-Albanian thinking as radical and disciplined democrats, based on the definitions they have made for themselves. He values the declaration of neo-Albanians as an attempt to oppose Marxism from a practical point of view and to strengthen patriotism. He appreciates the neo-Albanian thought by saying: In order not to prolong the presentation of the "views" of the "disciplined democrats" on the various issues of Albanian society and culture, we are saying that, in addition to their statements about the creation of a "mental movement" aimed at "description", "classification" and "concentration" of all the issues related to the "special structure" of Albanian society to create a "non-literary-romantic Albanian", but "radical-democratic", "neo-Albanians" were disciplined "to move essentially something in life and, in general, in Albanian culture" (Bobi, 1986, 147).

Furthermore, the researcher G. Bobi continues to reveal the value of the neo-Albanians, and magazines today have play a huge role in determining the cultural facts that show us a period of complex social and historical circumstances for a time when Marx, Nietzsche, Descartes, Bergson, Croce, Freud, Jung, Adler, Kont, Weber, Durkheim, Mannheim, Valeria, Pirandello and many other writers and philosophers and other scholars had started to talk about these things in the Albanian language. As an attempt to self-discovery, self-reliance and self-confidence, this functional type of Albanian culture has the motto "no politics, but only culture". In this context of judgment, the scholar Genta Skura has the right to say that in her development efforts, modern society in Albania was born and developed with a historical delay. The main cause for this circumstance lies not in the nature of the Albanian people but in the unfavorable development of historical circumstances in most of the territory of the Balkan Peninsula. This territory has been a clash of conflict between the two world civilizations for centuries.

Secondly, due to the historical delay of modern society in Albanian reality, the feudal style and powerful state machine in Europe emerged. Modern society in Albania was a society of an autocratic regime, with a totalitarian style of dictatorship.

Thirdly, modern society in Albania, due to the short deadlines of its existence, could not consolidate democratic traditions at the political-national level.

Fourthly, due to its specificity, there were elements of feudalism and initial capitalist accumulation in the birth of the modern Albanian society.

Fifth, in Albania, like everywhere else in the world, the sanctioning of modern society also served as a sanctioning the Albanian nation, which passed into natural nationalism.

This whole thing put the Albanian nationalism in a delicate backward situation and contradictory configuration. This was the source of one or more extreme situations, of an undying radicalism and of crises and of an unforeseen passivity.

References

- Bobi, G. "Cultural paradox", Publishing house "Uzalnica", Prishtina, 1986.
- E. "Individualism at the ethics of Authenticity", taken from the web address www.gazetastart.com, published on. 28.07. 2011.
- Dewey John. "The Public and its problems", pg. 102, Quote taken from "Someone or no one?", taken from www.gazetametropol.com, 28.10.2010.
- Festinger, L (1954). A Theory of Cognitive dissonance, Stanford: Standford University Press. (p.337).
- Mc. Guire, W.J (1981) The spontaneous self-concept as affected the personal distinctiveness. In M.D. Lynch, A.A. Norem-Hebeisen, &KJ.Gerben ,*Self-concept: Advances in Theory and research* . Cambridge, Mass. Ballinger.
- Karl Popper "The philosophy and science" Tirana.
- Taylor, Ch. "The ethics of authenticity", translated by .VirgilMuçi, Publishing house "Dita 2000", Tirana, 2008.

Leximi i lektyrës shkollore dhe roli i saj në formimin e përgjithshëm të nxënësve

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-Baliu
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt

Ky hulumtim studimor ka për qëllim të theksoj rolin dhe rëndësinë e pazëvendësueshme që ka leximi i lektyrës shkollore në zhvillimin dhe formimin e përgjithshëm të nxënësve në Kosovë. Ajo është e lidhur ngushtë me ngritjen e kulturës së leximit dhe të të shprehurit përgjithësisht, me zhvillimin kognitiv dhe moral, me aspektin e marrjes së njohurive arsimore, si obligim shkollor dhe si formësim jetësor i tyre. Pra, duke luajtur rol të madh në jetën e përditshme të fëmijëve, leximi i lektyrës shkollore e formëson botën shpirtërore të tyre, e fisnikëron atë me vlera edukative, pedagogjike, estetike e letrare.

Mbështetur në studimin e bërë për këtë çështje dhe në vëzhgimin e bërë me studentët gjatë mësimit praktik, përafërsisht në shkollë Kosove, kam arritur ta kuptoj rolin dhe rëndësinë që ka lektyra shkollore, para se gjithash si mjet kryesor ndihmës, pas teksteve shkollore, e cila jep një kontribut të madh, më shumë se të gjitha mjetet e tjera ndihmëse të cilësdo disiplinë tjetër, në zhvillimin e aftësive mendore dhe të karakterit të nxënësve, të arriturave të tyre në shkollë dhe në përgatitjen e përgjithshme për njohjen e vetvetes dhe të jetës.

Mësimit të letërsisë dhe përmes saj edhe leximit të lektyrës shkollore i kushtohet kujdes i veçantë nga të gjithë popujt dhe të gjitha shtetet që kujdesen për aftësimin e nxënësve dhe arsimimin e tyre. Ky studim është i rëndësishëm pikërisht në këtë aspekt dhe është i vëzhguar për shumë vjet gjatë mësimit praktik me studentët, sepse arritja e njëmendtë e suksesit të nxënësve në shkollë kalon nëpër funksionin e procesit të leximit të lektyrës shkollore dhe të rolit të saj elitare në zhvillimin dhe formimin e përgjithshëm të tyre, në rritjen e aftësive shprehëse dhe krijuese të tyre, në pasurimin shpirtëror dhe në zgjerimin e horizontit të njohurive të tyre.

Fjalët çelës: lektyrë shkollore, nxënës, lexim, rol, aftësim, formim.

Hyrje

Të lexuarit është një aktivitet mjaft i rëndësishëm, burim kryesor njohurish, mjet ndërlidhjeje dhe komunikimi përgjithësisht, ndërsa te nxënësit leximi është njëra prej shkathtësive më të rëndësishme që duhet të zhvillojë secili fëmijë gjatë nivelit të parë të shkollimit. Prandaj, leximi zë vend të rëndësishëm në planprogramin bashkëkohor të shkollës shqipe, ndërsa zë vend të veçantë në programin e gjuhës shqipe (që përmbledh edhe letërsinë), bashkë me lektyrën shkollore letrare, që do të duhej të përfshihej me përmbajtje dhe orë të veçanta mësimore.

Në kushtet dhe rrethanat e organizimit të shkollës në Kosovë, me sistem gjysmëditor të qëndrimin në të, leximi i lektyrës shkollore bartet në shtëpi dhe një interpretim i parë me shkrim, po ashtu i bëhet në shtëpi, ndërsa qasja më metodologjike dhe analizuuese, do të duhej t'i bëhej në orë të veçanta mësimore sipas planprogramit të gjuhës shqipe, gjë me të cilën do ta bënte të radhitej me planprogramet bashkëkohore të gjuhës amtare të vendeve me sistem të avancuar të arsimit. Me një qasje dhe

organizim të tillë të leximit të lektyrës shkollore në Kosovë, historikisht kemi qenë shumë më të avancuar dhe me një vend të veçantë të saj në planet e programet mësimore, si dhe me një interesim të veçantë të nxënësve për leximin e saj deri në dekadën e fundit. Mospërfshirja e saj në planprogramet e reja shkollore dhe lënia në vullnetin e mësimdhënësve se a do ta bëjnë këtë, si dhe zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, ka bërë që edhe tek nxënësit tanë të zbehet, e nganjëherë edhe të harrohet leximi i lektyrës shkollore; meqë leximi i saj nuk ngjallë më interesimin e tyre në përmasat e mëhershme dhe po nuk u propagandua nga mësimdhënësit nuk është aq atraktiv në krahasim me programet me karakter loje e argëtimi, informimi e edukimi, që ofrojnë mediumet elektronike. Edhe nxënësi ynë po përpiqet të fshihet prapa “kulturës kompjuterike” të shekullit në të cilin po jetojmë.

Si mësimdhënëse, duke qenë e ndjeshme e realiste në pranimin e këtyre situatave ekzistenciale, si dhe duke njohur mirë natyrën e lëndës së letërsisë dhe misionin e leximit të lektyrës shkollore nga nxënësit e shkollës 9-vjeçare, në këtë punim do t'i qasem rolit, rëndësisë dhe ndikimit që sjellë leximi i lektyrës shkollore nga nxënësit në aftësimin, zhvillimin dhe formimin e përgjithshëm të tyre.

I. Lektyra shkollore: Çështje dhe probleme

I. 1. Çështje të terminologjisë

Me nocionin *lektyrë shkollore*, në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginën e Preshevës, nënkuptojmë tekstet letrare që jepen si lexime jashtë klase, për nxënësit e ciklit të ulët e të lartë të shkollës 9-vjeçare (Bishqemi, 2004, f. 13). Në literaturën metodike dedikuar gjuhës amtare dhe në enciklopeditë pedagogjike hasim në emërtime dhe interpretime të ndryshme të këtij nocioni. Në Planprogramin e gjuhës shqipe emërtimi *lektyrë shkollore* (pavarësisht emërtimeve jo adekuat dhe konfuz: nga latinishtja *lektura* – të lexuarit dhe redaktura gjuhësore e teksteve në dorëshkrim), ka ruajtur dhe kultivuar esencën përmbajtjesore të saj që veçohet qartë nga emërtimi *literatura shkollore*, që ka të bëjë me literaturën nga shkencat dhe teknika, nga artet dhe informimi shoqëror që përdoret në shkollë për realizimin e objektivave edukativë të lëndëve mësimore dhe niveleve të caktuara të shkollimit në përgjithësi. Metodologu i gjuhës shqipe, Riza Brada (2005) thekson se: “Më adekuat dhe që do të shpie drejtpërsëdrejti në realizimin e objektivave të mësimin të gjuhës shqipe është emërtimi dhe nocioni *lekturë letrare*, që në instancën e fundit, si lexim letrar i përgjigjet etimologjisë së fjalës, esencës dhe funksionit adekuat pedagogjik, që luan dhe duhet të luajë në proceset e formimit të kulturës së leximit dhe të kulturës nga letërsia të nxënësit e shkollës fillore” (f. 449). Nga struktura përmbajtjesore e planprogrameve mësimore të gjuhës shqipe ky emërtim, *lekturë letrare /lektyrë shkollore* kuptimisht është kompatibil dhe i konceptuar si fushë e posaçme e lëndës mësimore nga gjuha shqipe, me orë të caktuara mësimore për lektyrën shkollore (letrare), e cila merr rolin dhe funksionin e saj pedagogjik në relacionet shkollë-shtëpi.

I. 2. Përzgjedhja dhe natyra e lektyrës shkollore në Kosovë

Lektyra shkollore e përzgjedhur dhe e normuar sipas MASHT-it¹, me përpjekje që të jetë në harmoni e përfaqëse me planprogramet mësimore dhe në përmbushjen e kriterëve dhe veçantive të grupmohave të nxënësve, përfshin këta autorë përfaqësues shqiptarë e botërorë dhe këto vepra të tyre:

¹ *Shih, Ligji nr. 02/I-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik dhe* <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2437>

Klasa e parë: Bedri Dedja, "Përralla popullore mbi kafshët"; Skënder Hasko, "Vallja e shkronjave"; Xhevat Beqaraj, "Kam një harmonikë"; Rifat Kukaj, "Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Ramadan Pasmaçi, Tregime për Kecin Bardhosh"; Rexhep Hoxha, "Gu-gu, pici gu".

Klasa e dytë: Ali Huruglica, "Vjersha të zgjedhura"; Adelina Mamaqi, "Poezi të zgjedhura"; Rifat Kukaj, "Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Agim Deva, Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Qamil Batalli, "Zemërarta"; Qamil Guranjaku, Xixëllonjat e vogla"; Bedri Dedja, "Përralla popullore mbi kafshët"; Qamil Batalli, "Tregime të bukura për fëmijë"; Ndre Mjedja, "Guxo"; Ndre Mjeda, "Vjersha të zgjedhura për fëmijë".

Klasa e tretë: Agim Deva, "Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Grup autorësh, "Vendlindja ime"; Leon Tolstoi, "Fabula, përralla e tregime për fëmijë"; Mark Krasniqi, "Posta e porositur"; Qamil Batalli, Tregime të zgjedhura për fëmijë"; Anton Çetta, Në prehër të gjyshes; Esad Mekuli, "Popullit tim"; Dionis Bubani, Aventurat e Çapaçulit në Afrikë; Konstatin Kristoforidhi, Gjahu i malësorëvet; Ndre Mjedja, Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Mark Krasniqi, Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Mark Krasniqi, "Posta e porositur"; Naim Frashëri, Të vegjëlit"; Sami Frashëri, Dheu është flori"; Spiro Çomora, "Vjersha të zgjedhura për fëmijë"; Vëllezërit Grim, Përralla; Lojëra e kashelasha".

Klasa e katërt: Kolë Jakova, "Mbreti i divave"; Astrit Lindgren, "Pipi Çorapëgjata"; Bedri Dedja, "Klamajtë e pallatit tim"; Dritëro Agolli, Zgjimi i baladave"; Ezopi, Përallëzat; Luis Keroll, Liza në botën e çudirave"; Naim Frashëri, "Të vegjëlit"; Naum Prifti, Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun"; Migjeni, "Luli i vocërr"; Vehbi Kikaj, Shtëpia ime ka sy"; Rexhep Hoxha, Lugjet e verdha; Rahman Dedaj, Dy liqej"; Tajar Hatipi, Djaloshi i çetës"; Vedat Kokona, Lulja dhe Shega"; Këngë e lojëra dhe këngë të motmotit .

